

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**dhe**

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI**

---

**SEMINARI XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË  
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

---

**Materialët e punimeve të Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën,  
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare  
Prishtinë, 19-30.08.2013**



FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË

FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

SEMINARI XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE  
KULTURËN SHQIPTARE

---

THE XXXII INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,  
LITERATURE AND CULTURE

PRISHTINË, 2013

Fakulteti i Filologjisë – Prishtinë  
Fakulteti Histori-Filologji – Tiranë

SEMINARI XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE  
KULTURËN SHQIPTARE

Prishtinë, 19-30.08.2013

THE XXXII INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,  
LITERATURE AND CULTURE

**Kryeredaktor:**

Bardh Rugova

**Redaksia:**

**Drejtor:** Bardh Rugova

**Bashkëdrejtor:** Aljula Jubani

**Sekretar:** Nysret Krasniqi

**Bashkësekretar:** Persida Asllani

**Sekretar profesional:** Blertë Ismajli

**Drejtor nderi:** Akademik Idriz Ajeti

**Këshilli Drejtues i Seminarit:**

Bardh Rugova, Nysret Krasniqi, Rrahman Paçarizi, Anton Berishaj, Mehdi Polisi,  
Bajram Kosumi, Muhamet Hamiti, Teuta Abrashi, Suzana Canhasi, Valbona Gashi,  
Aljula Jubani, Persida Asllani

**Përgjegjëse për kurset e gjuhës dhe drejtuese e referimeve të gjuhësisë:**

Sala Ahmetaj

**Drejtues i referimeve të letërsisë:**

Liman Matoshi

**Redaktor teknik:** Besfort Krasniqi

**Botues:** Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë





**Sedat KUÇI, dekan i Fakultetit të Filologjisë**

**FJALA PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E PUNIMEVE TË  
SEMINARIT XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,  
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE**

I nderuari drejtor nderi i Seminarit, akademik Idriz Ajeti,  
I nderuari ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë, z. Ramë Buja,  
I nderuari zëvendëskryeministër, z. Hajredin Kuçi,  
I nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës, akademik  
Hivzi Islami,

I nderuari ministër i Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj,  
I nderuari zëvendësministër i Kulturës, z. Hajdin Abazi,  
I nderuari kryetar i Komunës së Prishtinës akademik Isa Mustafa,  
I nderuari prorektor Bajraktari,  
I nderuari drejtor i Seminarit, profesor Bardh Rugova,

Të nderuar dekanë, anëtarë të Këshillit Drejtues, senatorë, seminaristë, mysafirë,  
zonja dhe zotërinj, në emrin tim si dekan i Fakultetit të Filologjisë dhe në emrin e  
Rektorit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” z. Ibrahim Gashi ju falënderoj  
për pjesëmarrjen tuaj në hapjen solemne të punimeve të Seminarit.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, tashmë  
është emblemë jo vetëm e Fakultetit të Filologjisë, por edhe e Universitetit të Prishtinës.

Java e tretë e muajit gusht është java kur, tashmë tradicionalisht, fillon në vendin  
tonë, në Prishtinë ngjarja më e madhe ndërkombëtare për gjuhën shqipe, letërsinë  
shqipe dhe kulturën shqiptare. Pra, sot po i nis punimet Seminari Ndërkombëtar për  
Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, i 32-ti me radhë me bindje të thellë që do t'i  
arrijë nivelet e edicioneve të mëparshme dhe do të bëjë së paku një hap përpara. Po  
themi i 32-ti e në fakt do të duhej të ishte i 39-ti. Arsytet e diskontinuitetit në organizimin  
e tij dihen. Seminari, gjatë periudhës së ekzistencës dhe të veprimtarisë së tij, e përjetoi  
fatin e gjithë Kosovës.

E përmenda këtë fakt, sepse vitin e ardhshëm Seminari i mbush plot 40 vjet nga  
themelimi, së pari si Qendër e Gjuhës Shqipe për të Huaj. Themeluesve të tij,

akademikëve Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli dhe kolegëve të tjerë që kontribuan dhe po kontribojnë në realizimin e punimeve të Seminarit, me këtë rast u shpreh mirënjohje dhe falënderim.

Seminari për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, përveç rolit arsimor, shkencor e kulturor kryen edhe:

Misionin e afirmimit të vlerave të kulturës shqiptare në botë;

Misionin e përhapjes së mendimit intelektual shqiptar për probleme të caktuara gjuhësore, letrare e kulturore;

Misionin e njohjes reciproke me rezultatet e studiuesve shqiptarë dhe të huaj në fusha të ndryshme të albanologjisë;

Misionin e krijimit të miqësive të reja midis studiuesve shqiptarë dhe atyre të huaj që ka një rëndësi të madhe në aspektin e bashkëpunimit ndërnjerëzor dhe ndërkombëtar midis kulturave e popujve.

Të gjitha këto realizohen falë pranisë tuaj në këtë Seminar, të dashur seminaristë, që vini nga vende të ndryshme të botës.

Më lejoni që për ndihmën e dhënë t'i falënderoj:

Ministrinë e Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë të Republikës së Kosovës;

Rektoratin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";

Kuvendin Komunal të Prishtinës;

Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës për gatishmërinë e shprehur për ta ndihmuar Seminarin.

Dhe, natyrisht, i falënderoj Drejtorin, Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues të Seminarit që e bartin barrën kryesore në realizimin e programit të Seminarit.

Të gjithë pjesëmarrësve të Seminarit të sivjetëm ju dëshiroj punë të mbarë dhe qëndrim të këndshëm në ambientet e Fakultetit tonë, në Prishtinë e në Kosovë.

Ju faleminderit.



**Bardh RUGOVA, drejtor i Seminarit**

**FJALA E HAPJES SË SEMINARIT XXXII NDËRKOMBËTAR PËR  
GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE**

I nderuar drejtor nderi, profesor Ajeti,  
I nderuar ministër i Arsimit, dr. Ramë Buja  
I nderuar zv.ministër i Kulturës, z. Ajdin Abazi,  
I nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, prof.  
Hivzi Islami  
I nderuari kryetar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, profesor Isa Mustafa,  
Të nderuar kolegë,  
Të dashur miq,  
Të dashur seminaristë,  
Mirë se erdhët në vatrën e albanologjisë.  
Mirësevini në Seminarin XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe  
Kulturën Shqiptare.

Siç e thanë edhe të gjithë parafolësit, Seminari është një ngjarje e madhe, ngjarja më e madhe botërore e albanologjisë. Mirëpo, unë nuk jam këtu sot, në këtë hapje solemne, për të përsëritur atë që të gjithë e dimë: për të thënë se vlera e Seminarit është e shumëfishtë – është një shkollë për krijimin e albanologëve, një tubim për krijimin e miqve të shqipes dhe një forum shkencor për shpalosjen dhe diskutimin e rezultateve të albanologjisë.

Më lejoni, që para jush të shpreh shqetësimin se shoqëria jonë borxhin ndaj albanologjisë nuk mund ta shlyejë vetëm nëpërmjet këtij Seminarit. Janë edhe pesëdhjetë javë të secilit vit, në të cilat albanologjia ka nevojë për mbështetje dhe ndihmë institucionale.

Sistemi i Bolonjës nuk është treguar gjithaq zemërgjerë me departamentet e vogla, siç janë departamentet e shqipes gjithandej nëpër Evropë. Institucionet tona do të mund të punonin për ta parandaluar mbylljen e departamenteve ose shkrirjen e tyre në departamente të tjera.

Edhe në Kosovë, do të mund të ndërtohej një strategji për rritjen e vlerave të departamenteve të albanologjisë e jo të lejohet degradimi i tyre.

Megjithatë, ne si shoqëri kemi shumë punë përpara dhe uroj që Seminari të shërbejë si shembull se si mund të ndihmohen studimet shqiptare përgjithësisht.

Të dashur miq,

Më lejoni me këtë rast të falënderoj Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë të Republikës së Kosovës për ndihmën e pakursyer edhe sivjet për vendosjen e seminaristëve nga vendet e ndryshme të botës. Më lejoni të falënderoj Kuvendin e Komunës së Prishtinës për mbështetje edhe sivjet.

Falënderoj nga zemra, Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, që di t'i çmojë vlerat e veta.

Para së gjithash, më lejoni, t'i falënderoj profesor Ajetin, profesor Ismajlin, profesor Bokshin, e të tjerët, për themelimin e këtij Seminari dhe për vënien e themeleve aq të forta të albanologjisë përgjithësisht.

Shëmbëlltyra Juaj shërben si frymëzim për ne. Fytyrën nuk do t'Jua marrim.

Ju faleminderit.

## LIGJËRATA



Rexhep ISMAJLI

## DISKUTIME PËR PREJARDHJEN E GJUHËS SHQIPE

Tema për të cilën do të flasim sot është nga të rëndësishmet në albanistikë. Është e vjetër, ndërsa për mua nuk është hera e parë që të flas për të kështuqë diçka mund të rimerret (Ismajli 1987).<sup>1</sup> Kuptohet, një paraqitje si kjo nuk mund të mëtohet të jetë shteruese as sistematike: jepen disa kënde vështrimi që janë bërë nxitës për diskutime.

Në vitin 1964 gjuhëtari i rëndësishëm italian Vittore Pisani botoi artikullin “Les origines de la langue albanaise” (Pisani 1964), që shtronte çështje të metodës së studimit të këtij subjekti. Në atë vështrim parimor Pisani tërhoqte vërejtjen në parim:

*“Historia e një gjuhe mund të bëhet vetëm ‘duke u nisur nga e tashmja për të arritur tek traditat që presupozon ajo’.<sup>2</sup> Nga e tërë kjo del se për të rindërtuar historinë e shqipes do duhet të niseshim nga shqipja ashtu siç flitet në Shqipëri nga një popullatë që në shumicën e saj të madhe paraqet vazhdimësinë gjenetike të grupeve njerëzore që kanë jetuar në këtë vend qysh nga kohët e parahistorisë më të hershme, duke konsideruar se gjuha shqipe e sotme është rezultati i krijimeve gjuhësore të brezave që kanë suksesuar njëri tjetrin në Shqipëri nga ato kohë deri në ditët tona”* (përkthimi r.i., Pisani 1964: 63).<sup>3</sup>

Në këto rrethana, sipas tij, çështja nëse shqipja është vazhduesja e ilirishtes apo e trakishtes nuk ishte shtruar mirë. Nëse në Shqipëri në lashtësi flitej një gjuhë ilire, ai nuk shihte se si ka mundur që ajo popullatë ta ketë zëvendësuar gjuhën e vet me trakishten. E kuptonte mirë sesi ka mundur që ilirët të romanizoheshin gjuhësisht, si ka qenë e mundur të merrnin

<sup>1</sup> Ky tekst paraqet tejskrimin e ligjëratës së folur, prandaj e ruan tërësisht atë strukturë.

<sup>2</sup> Teksti në thonjëza është i M. Devoto, tek Omagiu lui Iorgu Iordan, Bucuresti, 1958, f. 236, të cilin e referonte me këtë rast Pisani.

<sup>3</sup> “... l’histoire d’une langue ne peut se faire qu’en partant du présent pour arriver aux traditions qu’il présume. Il s’ensuit de tout cela, que pour reconstruire l’histoire de l’albanais il faut partir de l’albanais tel qu’il est parlé en Albanie par une population qui dans sa grande majorité représente la continuation génétique des groupements humains qui ont vécu dans ce pays dès les temps de la préhistoire la plus reculée, en considérant que la langue albanaise d’aujourd’hui est l’aboutissement des créations linguistiques des générations qui se sont succédées en Albanie depuis ces temps-là jusqu’à nos jours”. Këtu ai rikujton se këtë ide e kishte shprehur në studimin e mëhershëm L’albanais et les autres langues indoeuropéennes në Mélanges Grégoire II, f. 521, rimarrë te Pisani (1959 : 98).

një gjuhë të madhe qytetërimi si greqishtja, por nuk e kuptonte sesi paska ndodhur që ilirët, të cilët deri në pushtimin romak kanë folur gjuhën e tyre, ta kenë ndërruar atë me një gjuhë të një populli që kurrë nuk e ka pushtuar Shqipërinë dhe nuk kishte një qytetërim me prestigj të atillë që ta justifikonte atë ndryshim. Për fat të keq, në këtë rast duhet të flasim në bazë të emërtimeve që mbulojnë entitete gati të panjohura. Më tej ai shpjegonte se i tërë diskutimi nëse shqipja vinte nga ilirishtja apo nga trakishtja ka lindur pas diskutimeve të Hermann Hirt-it dhe vazhdimeve të Henrik Barić-it (cf. Barić 1955), sipas të cilave, meqë gjuhët indoeuropiane ndaheshin në të tipit centum e satem, meqë shqipja në elementet e saj indigjene shfaqej e grupit satem, ndërsa ilirishtja në vështrimet e tyre ishte centum e trakishtja satem, edhe shqipja duhej parë si pasardhëse trakishtes (Pisani 1964: 64). Dhe vërente:

*“... një gjuhë mund të jetë satem, jo pse ka qenë e tillë gjëmonë prej kohës së përbashkësisë indoeuropiane, ... po për shkak se kjo është arritur nga vala që sillte asimilimin e palataleve. Mund të thuhet megjithatë se kjo valë ka arritur në Iliri njaft vonë që ilirishtja të na paraqitej si gjuhë centum dhe shqipja si gjuhë satem”* (Pisani 1964: 65).<sup>4</sup>

Meqë ilirishten nuk e njohim, rindërtimet e ligjeve fonetike mund të jenë arbitrare, prandaj edhe ka pasur diskutime lidhur me karakterin centum apo satem të ilirishtes, mendonte ai.

Pak më vonë se Pisani, Radoslav Katičić, të cilin Akademia jonë e zgjodhi anëtar të jashtëm para një viti, një studiues shumë i rëndësishëm i kohëve moderne për gjuhët e Ballkanit të lashtë, sidomos për ilirishten, por edhe për trakishten, për ato pak materiale që kemi në dorë nxirrte këtë përfundim:

*“Asgjë në natyrën e provës nuk është paraqitur deri tash për prejardhjen trakease të gjuhës shqipe, por vetëm akumulim indiciesh që, pa e vendosur çështjen, na ndalojnë ta hedhim poshtë krejtësisht hipotezën. E vetmja gjë që mund të bëjmë tash është të jemi mendjehapur duke mbajtur mend në këtë kontraverzë se barra e provës u bie atyre që mohojnë prejardhjen ilire të shqipes.”* (Katičić 1976: 187-8).<sup>5</sup>

Teoritë për prejardhjen e gjuhës shqipe janë të vjetra, në fakt shkojnë baraz me fillimet e këtyre studimeve. Johanes Thunmann më 1784 kishte nxjerrë përafërsisht përfundimin se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe shqipja pasardhëse e ilirishtes, sepse ata ishin pjesë e botës romake, ishin në fqinjësi të pandërmjetme me grekët e lashtë dhe kjo ishte e vetmja

<sup>4</sup> “... [qu] une langue peut être satem, non parcequ'elle l'a toujours été à partir des temps de l'unité indo-européenne..., mais parce qu'elle a été atteinte par la vague portant l'assibilation des palatales. On pourrait pourtant dire que cette vague est arrivée en Illyrie assez tard pour que l'illyrien nous apparaisse comme une langue centum est l'albanais comme une langue satem”.

<sup>5</sup> “Nothing in the nature of a proof has been presented so far for the Thracian origin of Albanian, only a cumulation of indications which, without deciding the question, prevent us from rejecting the Thracian hypothesis outright. The only thing one can do is to keep an open mind while remembering that in this controversy the burden of proof is with those who deny the Illyrian descent of Albanian”.

hapësirë ku mund të ndodheshin në atë situatë që të krijohej një popull siç ishin shqiptarët. Më pas studimet kanë vijuar në drejtime të ndryshme. E para, gjuha shqipe qysh me Bopp-in në mesin e shek. XIX ishte parë prëfundimisht si gjuhë indoeuropiane në bazë të analizës së përmrave, të numërorëve, të strukturës gramatikore. Bopp-i thoshte madje se shqipja përbën një degë të veçantë të gjuhëve IE pa lidhje më të mëdha afërie me asnjërën prej degëve o gjuhëve simotra IE, pra një degë të veçantë dhe prej atëherë edhe sot shkenca këtë e ka marrë si një të vërtetë tashmë të verifikuar (Bopp 1955: 1).

Me kohë gjatë atij shekulli në kuadër të gjuhëve indoeuropiane shqipes iu caktua dhe një vend i afërt me greqishten, çka u bë e pëlqyeshme për arbëreshët e Rilindjes, po edhe për një pjesë të studiuesve arbëreshë, sidomos kur dihet se ide të ngjashme mund të kishin dhe autoritete të mëdha në fushën e studimeve krahasimtare-historike si August Schleicher (Schleicher 1861).

Pas Bopp-it kemi një hov të ri zhvillimesh në studimet albanistike dhe në fushën e studimeve të prejardhjes së gjuhës shqipe, me Gustav Meyer-in sidomos në fund të shek. XIX, i cili e kishte vendosur edhe fonetikusht edhe gjuhësisht gjuhën shqipe në kuadër të gjuhëve IE, e kishte vendosur në kuadër të terminologjisë, të kategorive me të cilat flitej atëherë në gjuhësinë IE, si gjuhë të tipit *satem* dhe gjuhë që kishte lidhje me gjuhët IE të veriut.

Çka domethënë gjuhë *satem*? Ndoshta është e tepërt ta përsërisim, megjithatë ndoshta mund të themi diçka që mund të sugjerojë ndonjë gjë lidhur me mundësitë e interpretimit. Në gjuhët IE ka pasur një radhë bashkëtingëlloresh që sot quhen tektale, atëherë quheshin guturale, grykore, dhe ato janë afërsisht bashkëtingëlloret *k, g* - sot i quajmë velare, atëherë mendohej se kishte edhe *kb, gb* të frymëtuara, aspirate, si në anglishten e sotme dhe palatale *k̄, ĝ*, afërsisht si në skajin e shqipes së sotme në jug, jo këtu në Kosovë. Tani, këto guturale IE në një pjesë të gjuhëve IE në kohën e paragjuhës së përbashkët, në një pjesë kishin marrë rrugë zhvillimi drejt velarizimit, dhe këto palatale ishin bërë velare *k, g*: lat. *centum*, p.sh., prej një forme të rindërtuar që mund të ishte *\*k̄m̄ton̄r̄*. Nuk e dimë shqiptimin, ato janë vetëm formula të gjuhëtarëve, jo realitet gjuhësor. Pjesa tjetër i kishte spirantizuar. Çka d.m.th. spirantizoj? D.m.th. këto palatale kishin shkuar pak përpara, ishin bërë diçka si *ç, x̄b*, pastaj *ç, x*, pastaj *s, z*, në shqipen deri në *th, dh*. Është afërsisht ai fenomeni që kemi në gjuhët romane: lat. kemi *centum* ['*kentum*], it. *cinque* ['*finkwe*], fr. kemi *cent* [*sã*], spanjisht kemi *ciento* [*θiento*]. Siç vërente Hamp (1998: 333), dikotomia *satem-centum* në terma IE nuk mund të jetë diagnostike. "Palatalet IE nuk u bënë universalisht sibilante, në fakt". Dhe këtu referon situatën e shqipes në hapësirat nga Mali i Zi drejt Ohrit e më tej në Greqi lidhur me realizimet për [k̄] drejt ç, [ts], apo nga Peja drejt Gusisë e Thethit, ku ç bëhet ś. Te Korça do të keni *q, gj* psh. *gjarpën* dhe *gjashtë*, në Pogradec tashmë kemi levizje në pjesën e përparme të shpinës së gjuhës, e edhe pak më tej, në Dibër do të keni ['*d̄jarpën, d̄jaf̄i*]. Edhe këtej në Kosovë po ashtu, nëse shkoni pak më larg në Junik ose pak më në veri do të keni [*darpen, d̄af̄i*], d.m.th. diçka pak më në mes. Po të shkoni

pak më tutje midis Gusisë dhe Kelmendit, atje midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, atje do të kemi [ʒarpën, ʒāsh], d.m.th. do të kemi një spirantizim të plotë.

Pak a shumë një proces i ngjashëm ka ndodhur edhe në paragjuhën IE dhe kështu me kohë janë ndarë dialektet, pastaj gjuhët. Më vonë kjo ndarje u absolutizua shumë dhe mendohej se gjuhët që kanë qenë në njëren anë ishin krejt të ndryshme nga gjuhët në anën tjetër. Por nuk duhet të harrojmë që këtu ndërmjet ka pasur proces kronologjik: në disa dialekte procesi ka ndodhur më herët, në disa më vonë, në disa, si në shqipen, e ka përfshirë hapësirën pjesë-pjesë, në disa pjesë të tjera ndryshe, d.m.th. nuk mund të absolutizohet në gjendjen e sotme kjo çështje, pikërisht ashtu siç tërhiqte vërejtjen Pisani.

E dyta, gjuha shqipe vendoset në paralele me gjuhët IE veriore, konkretisht me gjuhët baltike dhe sllave, sepse gjindeshin më shumë relacione sidomos leksikore specifike, të vjetra me gjuhët sllave dhe baltike dhe ngapak edhe korrelacione me gjermanikishten. P.sh. zanorja *ǵ* e shkurtë IE në shqipen është bërë *a. natë*, lat. *nox*, gjerm. *Nacht*. Kjo është një paralele me gjuhët gjermanike dhe shqipen. Ka të tilla edhe me gjuhët baltike dhe gjuhët sllave. Pak a shumë kjo ishte vendosja e Gustav Meyer-it. Meyer-i për palatalet, për *q, g* IE thoshte se në shqipen kishin dhënë edhe *s, ʒ* edhe *th, dh* dhe shembulli për refleksin e parë ishte *vīs* nga lat. *viuis*. Më vonë Çabej ka dëshmuar, edhe Jokl-i, Pedersen-i më herët, e të gjithë të tjerët më vonë, se kjo fazë me *s, ʒ* mund të jetë më e hershme, por nuk ka definitivisht në shqipen një rezultat të tillë, shqipja ka vetëm *th* dhe *dh* atje ku gjuhët perëndimore si gjermaniket, si italiket ose edhe greqishtja, kanë *k, g*. Armenishtja, gjuhët sllave, gjuhët baltike, gjuhët indase, iraniane kanë *s, sh, ksh*, por jo *k, g*. Kjo ndarje, pra, është parë si e rëndësishme.

Holger Pedersen (Pedersen 1900) e korrigjoi teorinë e Meyer-it në etimologji dhe në refleksat e palataleve IE. Palatalet IE, pas tij, në shqipen kanë dhënë *k', k'b --> th; g', g'b → dh, d* dhe jo *s, ʒ*. Në rastin e shqipes, sipas tij, vërtetohet se kishte tri radhë guturalesh: palatale, velare, labiovelare. Platalet në shqipen, janë spirantizuar, velaret janë ruajtur; labiovelaret kanë pësuar një zhvillim të veçantë: para zanoreve të përparme *k<sup>v</sup>, g<sup>v</sup>, k<sup>v</sup>h, g<sup>v</sup>h → s, ʒ*: *pesë: penque; darsëmë* në raport me *darkeë, vdes* në raport me *vdekeje*, etj. Para zanoreve të tjera janë velarizuar. Me ndihmën e shqipes dëshmohej se paragjuha IE kishte tri radhë të këtyre guturaleve ose tektaleve. Dhe ka një vend pak specifik në kuadër të këtyre gjuhëve perëndimore dhe lindore. Këtë rrugë e kanë ndjekur shumë albanologë seriozë të kohës sonë. Sigurisht apote të reja kanë sjellë Jokl-i, Çabej. Çabej është figura kyçe në këto hulumtime, por edhe studiues si W. Cimosowski, A. V. Desnickaja, E. P. Hamp kanë ndihmesat e tyre. Në kohët e fundit një libër shumë të mirë me paraqitjen e këtyre ideve ka botuar Giovan Battista Pellegrini në Itali, (Pellegrini 1995). E ka botuar Universiteti i Kalabrisë nën përkujdesjen e F. Altmarit. Natyrisht, ne kemi këtu libra të Sh. Demirajt (Demiraj 1988, Demiraj 1999), vepra të Çabejt (Çabej 1970, Çabej 1976), e edhe të tjerët kanë shkruar për këtë çështje.

Përveç këtij aspekti në gjuhësinë historike u shtrua një çështje tjetër: mirë, meqë qenka gjuhë pasardhëse, një degë e veçantë e gjuhëve IE, e tipit satem, me vendosje veriore, me lidhje



të veçanta - Çabej ka shtuar - me gjuhët jugore, me greqishten më vonë, ndoshta në raporte me armenishten, siç ka thënë Pedersen, dhe pastaj ka edhe sot si Klingenschmitt (1993) e të tjerë që përhapin këtë ide: *Ku ka qenë shqipja në botën e lashtë?* Në bazë të dokumenteve në Gadishullin Apenin ne e dimë që latinishtja është folur nga shek. VI-VII para K., që gjuhët gjermanike janë dokumentuar më vonë, gotishtja në Ballkanin verior afër Danubit, gjuhët kelitke kanë qenë fqinje këtu në veri të Danubit, pastaj kanë ikur në perëndim, sot vetëm në Francën perëndimore dhe në Britani, gjuhët sllave në lindje, gjuhët baltike në veri etj. Ku ka qenë ajo gjuhë prej së cilës doli shqipja? Ku është folur? Dokumente të shkruara ne për këtë nuk kemi, shqipja është gjuhë e shkruar nga viti 1462 - "Formula a pagëzimit". Kemi 15 shekujt në mes për të cilët nuk dimë gjë, praktikisht errësirë. Tani, shkenca në këtë situatë ka qenë e detyruar të përdorë mjete ndihmëse: kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera, dhe eventualisht dokumentacionin ndihmës onomastik, emrat e njerëzve, të vendeve, të lumenjve, të zotërve etj. Në aspektin e parë Thunmann-i e kishte vendosur mirë çështjen. Shqipja ka një numër shumë të madh fjalësh latine, në shkallën që G. Meyer e quante gjuhë gjysmëromane. Pedersen-i e kishte kritikuar pastaj, sepse ishte e tepruar kjo, vërtet. Megjithatë mbetet fakti që ka shumë huazime latine. Këto huazime latine na ndihmojnë që të rindërtojmë faza më të hershme të shqipes. Duke parë si kanë hyrë latinizmat ne shohim si ka qenë sistemi i shqipes. Dhe këta latinizma janë të vjetër në shqipen. Iliria u pushtua në vitin 167 p. K. Ilirët kanë pasur kontakte me romakët në Adriatik, ndanin detin e përbashkët, luftonin, grabisnin anijet romake, i plaçkisnin e plaçkiteshin d.m.th. kishin kontakt së paku nga shek. II ose III p.K. Dhe këto kontakte kanë zgjatur shumë.

Në Europën jugore përgjithësisht dy janë gjuhët që kanë shpëtuar nga romanizimi i plotë. Lëmë anash greqishten, sepse ishte kulutra greke, ishte diçka tjetër, gjuhë e shkruar. Nga të tjerat vetëm shqipja dhe baskishtja në Francën jugore e Spanjën veriore, vetëm këto gjuhë, këta dy popuj kanë shpëtuar nga romanizimi i plotë pas pushtimit romak. Të gjithë janë shkriër, janë bërë francezë, italianë, piemontezë etj. Pse? Si ndodhi?

Janë parë edhe argumente të tjera. P.sh. është menduar që mos është kjo e pamjaftueshme të thuhet se shqipja është folur në këtë pjesë, dhe është shtuar argumenti tjetër që në shqipen ka një numër fjalësh greke, por ka pak. Në raport me fjalët latine në shqipen ka pak fjalë greke, rreth 40. Që nga 1910 A. Thumb dhe pastaj N. Jokl, albanologët e kishin ngritur këtë çështje. Unë do t'ju sjell këtu një mendim të Jokl-it. Në studimin e tij të botuar pas vdekjes "Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel" merrej me marrëdhëniet më të vjetra greko-shqipe, konkretisht me fjalët greke në shqipen. Do të referoj dy-tri pika. Sipas tij, në raportet midis greqishtes e shqipe duan veçuar tri lloje të dhënash, që u përgjigjen tri fazave të ndryshme.

*"Kështu do të përpiqem të gjej tipare për të mbështetur raportet e stërlasshta të afrisë, ashtu si dhe të shqyrtoj huazime të shqipes nga greqishtja e vjetër, që në literaturën e derisotme nuk janë paraqitur. Por do të shqyrtohen edhe elemente që përbëjnë një grup të tretë, që nuk u përkasin as*

*veçorive të përbashkëta para ndarjes në gjubë të veçanta as huazimeve të qarta, pra që duan parë si një lloj tiparësh të ndërmjetme. Këtu të dy gjubët janë të pavarura nga njëra tjetra, por sugjerojnë njëfarë zhvillimi paralel... Ndarja që unë kam vendosur në bazë të konceptimit tim është kronologjike: raportet para ndarjes në gjubë të veçanta përbëjnë segmentin e parë, që ndiqet nga grupi i karakterizuar si i mesëm, që përfundon me huazimet e lashta të shqipës. Po ta shtrijmë çështjen në terma të renditjes gjubësore-geografike të këtyre grupeve, grupi I mund të ketë ndodhur me siguri jashtë Sijidhesës Ballkanike, kjo do të ishte më e besueshme. Me grupet II dhe III jemi në Sijidhesën Ballkanike, çka mund të shihet nga rrathët e përhapjes dhe të kuptimit të fjalëve në shqyrtim” (Jokl 1984: 15-16).<sup>6</sup>*

Pra, edhe greqishtja edhe shqipja në Ballkan janë të ardhura nga diku më në veri. Ka arkeologë, sidomos arkeologë shqiptarë, që thonë se ilirët janë formuar këtu në Ballkan, s’kanë ardhur nga veriu dhe kanë lidhje ballkanike dhe anatolike, me pjesën anatolike. Diskutimi ekziston dhe Çabej ka një kontraverzë gjysmë të heshtur me arekologët dhe historianët. Edhe Buda, që gjithandaj ndjek mendimin e Çabejt, kur vjen këtu thotë se kishte ‘edhe lidhje anatolike’. Është një koncesion që i bëhet të ashtuquajturës teori pellazgjike?

Në pjesën e dytë Jokl-i saktësonte:

*“Shqipja gëzof të shpie tek gjurmët e vazhdueshme nga kobët pararomake; nuk është identike me γαβοσατος, gausapes, por megjithatë shumë e afërt me to” (Jokl 1984: 36)<sup>7</sup>.*

Përfundimi tjetër është:

*“Po të përmbledhim ato që u thanë në materialet këtuashme, del se shqipja është gjuba e një populli që qysh në lashtësi, dhe pikërisht në kobën pararomake ashtu si në romaken, kishte këmbime me greqishten dhe më tej se shqipja e greqishtja përkasin bashkë”<sup>8</sup>.*

<sup>6</sup> “Ich werde demnach sowohl Belege für urverwandtschaftliche Beziehungen nachzuweisen suchen, als auch Entlehnungen des Alb. aus dem Altgriechischen, die in der bisherigen Literatur noch nicht festgestellt sind, besprechen. Aber auch Elemente, die eine dritte Gruppe bilden, die also weder den voreinzelsprachlichen Gemeinsamkeiten noch den klaren Entlehnungen angehören, demnach eine Art Mittelstellung einnehmen, sollen zur Sprache kommen. Hier sind beide Sprachen voneinander unabhängig, weisen aber dennoch eine Parallelentwicklung auf. ... Die Gliederung die ich der Darstellung zugrunde lege, ist eine chronologische: Voreinzelsprachliche Beziehungen bilden den ersten Abschnitt, die eben charakterisierte Mittelgruppe folgt, die alten Entlehnungen des Alb. bilden den Schluß. Fragt man nach der sprachgeographischen Zuordnung dieser Gruppen, so kann Gruppe I sehr wohl außerhalb der Balkanhalbinsel ihren Schauplatz haben, ja dies wäre das allerwahrscheinlichste; mit Gruppe II und III befinden wir uns auf der Balkanhalbinsel, wie dies Verbreitungsbezirk und Bedeutungsinhalt der zu bearbeiteten Wörter ergeben wird”. Jokl 1984: 15-16.

<sup>7</sup> “Das das alb. *gëzof* weist auf kontinuierliche Überlieferung seit vorrömischer Zeit; es ist mit *γαβοσατος, gausapes*, nicht identisch, wohl aber sehr nahe verwandt”.

<sup>8</sup> “Ziehen wir somit aus dem hier ausgeführten Wortmaterial die Summe, so ergibt sich, das das Alb. die Sprache eines Volkes ist, das schon im Altertum, und zwar sowohl in vorrömischer als in römischer Zeit mit dem Gr. in sprachlichem Austausch stand, des weiteren, daß Alb. und Illyr. zusammengehören”, f. 46.

çka domethënë se

*“shqipja qëndron shumë afër me ilirishten, ashtu siç na doli tek gausapes, γαύσας; hapësira gjubësore shqipe qysh nga kohët pararomake duhet të shihet në afërsi me të greqishtes dhe të latinishtes”<sup>9</sup>*

Këtë mendim të Jokl-it e pashë të arsyeshme ta përsëris sepse është prononcimi i tij i fundit, pas vdekjes. Më 1924 në një studim tjetër ai kishte thënë pak ndryshe dhe citohet teoria e tij për shkrimin midis ilirishtes dhe trakishtes, ose për dy komponente brenda shqipes, jo për shkrimin, por për ekzistencën e dy komponentëve. Jokl-i këtë studimin e fundit e kishte bërë si diskutim lidhur me hipotezat e studiuesve rumunë A. Philippide dhe G. Pärvan, nga të cilët i pari shqipen dhe shqiptarët në lashtësi i shihte në periferinë e jashtme të Orbis Romanus, në Panoni, ndërsa tjetri i sillte nga Karpatet. Prandaj Jokl-i nxirrte këtë përfundim:

*“Kontaktet gjubësore të shqipes me greqishten e latinishten të shqyrtuara më sipër paraqesin, siç dua të besoj, fundin e të gjitha hipotezave të atilla. Studimeve të mëtejme u mbetet të tregojnë se cilit prej dy popujve - shqiptarëve dhe grekëve – i përket e drejta për të qenë i parilenë në Ballkan”<sup>10</sup>*

*I parilenë* është një fjalë shqipe që e ka përdorur Buzuku për primogenitus. Jokl-i vendin e shqipes në ato kohë e shihte ndërkaq në një mënyrë pak më të përcaktuar, jo në të gjithë hapësirën e sotme shqiptare, por konkretisht në Dardani, çka d.m.th. se përjashtonte pjesë si Shkodra – mendonte se forma e sotme e emrit *Shkodra* për do arsye të tjera, që janë kontestuar nga Çabej, nuk mund të vinte përmes shqipes, dhe prandaj i shihte më shumë në Dardani. Dardania ishte hapësira që përfshin Kosovën e sotme, pjesë të Shqipërisë veriore: Kukësin, Malësinë e Gjakovës etj., Maqedoninë veriore deri te Tetova, në jug të Shkupit, Serbinë jugore deri në veri të Nishit. Kjo Dardani, sipas Jokl-it, mund të ishte djepi i shqipes së hershme.

Këto diskutime kanë zgjatur pak më shumë. Rumunët e kanë parë lidhjen e prejardhjes së shqipes me prejardhjen e rumanishtes - është problematike a është formuar rumanishtja në jug të Danubit apo në veri të Danubit - si një çështje shumë të rëndësishme. Romakët e pushtuan Dakinë në shek. II pas K. dhe qëndruan atje në veri vetëm pak, 70 vjet saktë, dhe pastaj ikën në jug, aty krijuan Limesin dhe aty sollën kolonë. Mendohet se pikërisht në jug u bë rumanishtja nga romanishtja popullore e folur, ndërsa në veri shkuan më vonë, ashtu siç zbritën arumunët drejt jugut në Greqi, Shqipëri, Maqedoni. Ka hipoteza të tjera që e shpjegojnë ndryshe këtë punë. E vërteta është se romanizimi ka ndodhur gjithandej. Romakët kur erdhën romanizonin të gjithë, ilirë, trakas, çkado që ishte bëhej romane. E kemi parasysh p.sh. Perandorinë Osmane, shkoni në Stamboll, Stambolli është gjithçka, por më së paku turq të

<sup>9</sup> “Das Alb. steht also jedenfalls dem Illyr., wie es uns in *gausapes, γαύσας* entgegentritt, sehr nahe; das Alb. Sprachgebiet ist seit vorrömischer Zeit in der Nähe des Gr. und des lat. zu suchen”, f. 36.

<sup>10</sup> “Die hier besprochenen sprachlichen Berührungen des Alb. zum Gr. und Lat. bereiten, wie ich glauben möchte, allen derartigen Hypothesen ein Ende. Gegenstand weiterer Untersuchung wird es sein festzustellen, welchem von den beiden Völkern – Albanern und Griechen – auf der Balkanhalbinsel das Erstgeburtsrecht zukommt”, f. 47.

viseve tatare. Mund të jenë më shumë shqiptarë, grekë, serbë, bullgarë, popuj të Kaukazit etj. se sa vetë turqit. Por të gjithë flasin vetëm turqisht, të gjithë thonë jemi turq. Pra, kur vinin romakët këtu, romanizonin të gjithë, të gjithë bëheshin romanë, pos atyre që nuk romanizoheshin. Pra, e kemi të vështirë t'i diferencojmë etnikisht në bazë të romanizimit.

Megjithatë në Ballkan ka pasur një teori që thoshte se aty janë dy aspekte të romanitetit: një që krijoi dalmatishten në ujdhesat e Bregdetit dalmatin dhe në Dubrovnik dhe tjetra që krijoi rumanishten në lindje. Shqipja ka shumë elemente latine. Ku përkojnë këto elemente? Studimet kanë treguar se elementet latine të shqipes janë të vjetra, disa janë më të vjetra se ato që dëshmohen në gjuhët romane, edhe se perëndimoret edhe se lindoret. P.sh. shqip kemi *qepë*, diku *kepë*, lat. *cēpa*. Pra, kemi pasur *k* të ruajtur, velare. Ka një numër fjalësh latine që vetëm shqipja i ka ruajtur, nuk janë ruajtur as në perëndim as në lindje, nja 90 fjalë, s'janë pak. D.m.th. ka mjaft fjalë që janë të ngjashme me të rumanishtes, por këto janë pas shek. VI e më vonë, jo më të hershme. E. Banfi veçon një zonë të tretë ballkanike të latinizmave, zonën e Via Egnatia, ku ka ngjashmëri mes latinizmave të shqipes dhe të greqishtes së re (Banfi 1972). Pra, përgjithësisht shqipja është folur në një hapësirë romane, latine. Ky është një argument i rëndësishëm. Dhe ku ka mundur të marrë fjalë greke. Fjalët greke nuk kanë hyrë si ato të latinishtes, grekët nuk e kanë pushtuar truallin shqiptar, me grekët paraardhësit tanë kanë pasur një raport tjetër. Grekët kanë krijuar koloni në bregdet kudo, pra Apolonia, Dyrrachion, Epidamnus, pastaj Epidaurus, Issa ... deri në jug të Francës. Gjithandëj kanë krijuar koloni, ishin popull detar, jetonin në koloni buzë detit, merreshin me tregti dhe me kulturën e tyre. Dhe po të shikoni mirë fjalët greke në shqipen, ato që janë ruajtur janë të vjetra dhe janë kryesisht të fushave të kulturës mesdhetare, p.sh. *lakër*, *drapër*, *pjepër*. Ka dhe fjalë të tjera, *machanon – mokën* – një makinë e vogël për thyerjen e grunit, *drapbanon – drapër*, etj. Pra janë të kulturës materiale të zonës mesdhetare. Ndoshta edhe *vena*, *presb* kanë hyrë andej dhe pak a shumë reflektojnë dialektin dorik, që ishte në pjesën perëndimore, që u shpërmda edhe në Italinë e Jugut pastaj.

Këto elemente janë shumë precize për përcaktimin e vendit ku ka qenë paraardhësja e shqipes. Në atë vend ka pasur vetëm ilirë. Ilirët ishin popullatë që shtriheshin midis Danubit deri në Adriatik dhe poshtë deri në malet Akrokeraune ose andej pak a shumë deri te Korfuzi. Në jug ishin makedonët, grekët, në lindje ishin trakasit, në lindje të lumit Morava dhe Vardar. Afërsisht kjo është pasqyra që na kanë lënë autorët e lashtë grekë dhe romakë në shkrimet historike të tyre. Megjithatë, ka pasur një teori që ilirët i lidhte me kulturën e Hallstadtit, i binte të ardhur nga Evropa e mesme dhe pastaj Hans Krahe, një gjuhëtar gjerman, i çonte nëpër gjithë Europën, shpjegonte shumë emra të lumenjve me anë të ilirishtes. Më vonë u pa, në vitet '60 të shek të kaluar, se kjo ishte gabim dhe u bënë kritika të rrepta në këtë drejtim. U pa se venetët p.sh. në veri ishin më të afërt me latinët në Itali. Katičić në studimet e tij për onomastikën ilire ka veçuar tri zona onomastike: një të ilirëve, që latinët i quanin *Illyrii proprie dicti*, ilirët në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, që shtriheshin në jug të lumit Neretva, pastaj zonën

dalmato-panone dhe në fund zonën liburne, që ishte krejt tjetër. Nuk thuhet a pasqyrore kjo gjendje tri gjuhë, por më vonë gjuhëtarët kanë nxjerrë përfundimin se mund të ishin tri gjuhë. Qysh Meyer-i thoshte se shqipja ishte pasardhëse e njërit prej dialekteve të ilirishtes, edhe Pedersen-i thoshte e ilirishtes së jugut, edhe të tjerët pastaj dhe kjo u precizua me kohë. Studimet arkeologjike, etnografike, historiograifke bënë një kompleks të tërë që e shohin shqipen pasardhëse të ilirishtes së jugut ose të ilirëve në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Jo një herë u shtrua çështja, po çfarë ishin dardanët? A ishin dardanët ilirë? Ka pasur diskutime dhe sot mbisundon mendimi se dardanët ishin ilirë.

Në anën tjetër kjo shkon krahas me teorinë tjetër që ka lindur në fillim të shekullit për prejardhjen trakase të shqipes, sepse argumentimi është ky: shqipja është gjuhë satem, ilirishtja mendohej centum. Ka pasur për ilirishten, aq sa e njohim, edhe argumente që duan ta tregojnë satem, edhe të atilla që e shfaqin centum. Kemi emrin *Bersinium* - *Podgorica* e sotme, pra kemi pasur palatale që është bërë *z*. Kemi pastaj *Vesclaves*, ku në fqinjësi të sonanteve palatalja është ruajtur si velare, nuk është bërë *th*, pra nuk është bërë sepse është ndodhur në fqinjësi të sonanteve. Ka edhe të tjera që mund të thonë të kundërtën.

G. Weigand-i erdhi me historinë për mungesën e toponimeve. Toponimet në trollin shqiptar kanë pasqyrë vetëm sllave ose romane nga lashtësia, jo shqipe, thoshte ai, shqiptarët nuk kanë terminologji detare në gjuhën e tyre, shqipja paska kryesisht leksik baritor e shumë elemente tjera. Diskutimet kanë qenë të shumta. Por po të nisim ashtu, çdo gjë bëhet absurde. Merrni trupin tonë: *flokë, faqe, fytyrë, shpindë, llërë, kofshë*, të gjitha janë fjalë latine, *qiell, gjel, qen, si peshkë*, etj. po ashtu. A do të thotë që shqiptarët s'kanë qenë as në fusha as në male, se s'kanë njohur pjesë e trupit e çka jo tjetër? Anglezët fjalët për ushqimet prej mishi i kanë frënge. Fjalët për kafshë pë mishin përkatës i kanë të vetat sepse shtresa e pasur ushqehej si në Paris, atëherë Parisi ishte model dhe emërtimet i merrte prej France, kurse fshatari britanik i kishte fjalët e vjetra dhe i ruante. Njësoj kanë ndodhur proceset edhe në shqipen (Ismajli 1987). Prandaj prej kësaj nuk mund të nxjerrim asnjë argument sado që Çabej e L. Dodbiba kanë bërë përpjekje të tregojnë se edhe terminologjia detare ekziston në shqipen. Për terminologjinë detare është thënë po ashtu se shqiptarët kanë edhe terminologji të tillë, p.sh. fjala *det* është fjalë e vjetër IE në shqipen. E dyta. Janë të njohur emrat e vendeve: *Scodra* nga shek. IV para K., *Scupi* nga shek. II, *Scampinus* pak më vonë, *Scardus mons*, *Isamnus*, *Matis* – lumi Mati etj. Është thënë se *Scodra* dhe *Shkodra* nuk janë një sepse qysh Jokli thoshte se grupi *-dr-* do të zhdukej. Por ka fjalë të tjera që e kanë grupin *-dr-*. Çabej është përgjigjur se kjo reflekton periudhën e huazimeve romane. Kurse *shkamb* e të tjera fjalë me *sc* nga latinishtja edhe *Scodra* edhe *Scupi* kanë dhënë të njëjtën gjë. *Scupi*, shumë, nga *Scupi* u bë *Shkup* në gjuhën shqipe. Këtu kemi një problem me *Sharrin* - *Scardus mons*, nuk e kemi zhvillimin si do të duhej në një fazë më të hershme, nuk kemi *\*Shkarr*, as *\*Harr*, d.m.th. ka mbetur *Sharr*. Shpjegimin nuk e kemi. Por shpjegimin e kemi tjetër, sikur të ishte nga sllavishtja do të bëhej *\*Skerad* sikurse te *Sardona* - *Skeradin*. Pra sllavët e kanë marrë nga të tjerët. Emri *Mat*, *Matis* është një emër që vjen nga lashtësia, që është

trashëguar e domethënë *breg*. Te Kaçaniku na del *Matlumë* – ‘*Breglumi*’, që duhet të jetë e vjetër sepse në këtë hapësirë s’ekziston as *mat* as *lumë* si apelativ, por vetëm te ky toponim. Pra, është një fjalë e vjetër. D.m.th. kjo terminologji, sipas Çabejt, paraqet zhvillimin fonetik të shqipes nga periudha e lashtë e tej, nga periudha antike. Nuk mund të flitet për periudha më të hershme. Dhe kjo tregon se shqipja është folur gjithë kohën, ashtu siç thoshte Jokl-i, në këtë hapësirë.

Përkrahësit e teorisë trakase dhe sidomos me modifikimet e V. Georgiev-it, gjuhëtar i shquar bullgar, ngritën një teori tjetër. Trakishtja ishte gjuha e popullatave të hapësirave të sotme bullgare, më saktësisht të Trakisë së sotme me disa rajone fqinje. Nga W. Tomaschek e P. Kretschmer e më vonë mendohej se trakishtja shtrihej në një hapësirë nga Karpatet e deri në Detin Egje. Ishte gjuhë indoeuropiane e tipit satem. V. Georgiev mendonte se në pjesën Lindore të Siujdhesës ballkanike dhe të Zonës së Karpateve, flitej një tjetër gjuhë IE, dakomezishtja apo dakishtja, e ndryshme nga trakishtja. Ideja për ekzistencën e kufirit midis dy gjuhëve mbështetej në radhë të parë në indiciet e toponimisë – në hapësirën dakase janë karakteristike emrat bitematikë të vendeve me pjesën e dytë – *dava/ -daua/ -daba* “qytet”, ndërsa në hapësirën trakase emrat bitematike të vendeve me *-bria* “qytet”. Vetëm në trakishten, pa paralele në dakishten, janë tipike dy izoglosa: *para-* “katund” dhe *diza/ -os* “kështjellë”. Trakishtja s’kishte shkrim të vetin, mbetjet e saj janë me shkrim grek apo latin. Para ardhjes së sllavëve pjesë të rëndësishme të popullatave trakase u helenizuan dhe u romanizuan (sh. 1-3), sidomos në qytete. Në zonat malore popullata trakase pjesërisht u ruajt më gjatë, kështu që me të ranë në kontakt sllavët pas sh. 6 dhe prej saj i morën fjalët dhe toponimet (kryesisht emrat e lumenjve). Studimi i trakishtes mbështetet në materialet vijuese: glosa të shënuara tek autorët antikë; mbishkrimet, prej të cilave për shkencën kanë rëndësi 4, ndërsa të tjerat (rreth 28) janë të shkurtra; një numër i caktuar emrash gjeografikë; një numër i caktuar emrash të njerëzve, të fiseve dhe të zotrave. Glosa trakase merren ato që tek autorët antikë shënohen si trakase apo ato që përdorshin nga trakasit. Si besueshëm trakase më tej merren fjalët që dalin si pjesë të emrave tipikisht trakas (Ž. Velkova 1986). Nga ato glosa nuk ka shumë që interpretohen të afra me shqipen, ndërsa karakteristikat e tjera që rindërtohen për trakishten e ndajnë atë nga shqipja si gjuhë indoeuropiane (Duridanov 1976; Ismajli 1987).

Sido që të jetë, njohjet për trakishten janë të mangëta. Përveç emrave (të njerëzve, fiseve, vendeve, perëndive, lumenjve), në Bullgari janë zbuluar disa mbishkrime të vogla nga sh. 5-4 para erës së re. Janë ruajtur dhe disa emra të bimëve, ndërkohë që janë identifikuar disa glosa tek autorët grekë. Gjuhëtarët janë përpjekur që mbi bazë të këtyre elementeve ta rindërtojnë gjuhën trakase. Mbishkrimet trakase ende nuk janë deshifruar në mënyrë të kënaqshme, ndërsa përpjekjet që janë bërë për të interpretuar ndonjë element përmes krahasimit me shqipen nuk kanë dhënë rezultat. Rindërtimet fonetike kanë lënë të kuptohet se trakishtja ishte gjuhë indoeuropiane e tipit satem, por me ndryshime të tjera fonetike, të cilat

do ta largonin atë krejtësisht nga shqipja e do ta afronin më tepër me armenishten. As interpretimi i glosave apo emrave të vendeve a të njerëzve nuk ka lënë shumë mundësi për ta afruar me shqipen. Në Rumani nuk parapëlqehet teza e Georgievit (pos te Poghirc) për diferencimet dako/ trakase. (cf. Nerozank 1978, Ismajli 1987, Brixë-Panayotou, etj.).

Ndërkaq materialet e interpretuara onomastike dhe të glosave në interpretimet e gjuhëtarit bullgar I. Duridanov kanë lënë të kuptohet më shumë se trakishtja dhe dakishtja duhej të kishin pasur afri me gjuhët e lashta baltosllave.

Afërsisht këto kanë qenë dijet që konsideroheshin të njohura deri në vitet '80 e ndoshta deri sot. Botimet serioze në këtë fushë kanë qenë ato të emrave që përmendëm: Çabej, Cimohovski, Desnickaja, Hamp, e albanologë të tjerë për shqipen. Paraqitja e bërë atëherë nuk ka ndryshuar shumë ndërkohë, siç mund të shihet në librin e botuar nga Sh. Demiraj tash vonë (Demiraj 1999), ku kemi një paraqitje të gjerë e me shumë diskutime. Për ilirishten, trakishten e kompleksin lashtoballkanik ka pasur botime të ndryshme. Përveç atyre të Krahe-s, të Mayer-it, të Deçev-it, duan përmendur studimet përmbledhëse të Katičić (1976), të Neroznak (1978), studimet e Çabejtë, të Georgiev-it, të Cimochovski-t, të Duridanov-it, të Poghirc-ut, të Vraciu-it, të Hamp-it, të Brixë-Panayotu, e të tjerëve.

Dija në vijim ndoqi rrugë të ndryshme. Studimet iliristike, për mungesë materialesh, kanë qenë më të pakta. Në studimet trakologjike është investuar shumë energji në Rumani e në Bullgari. Raportet e kompleksit trako-dakas me gjuhët balto-sllave kanë qenë një fushë e hulumtimit. Aspekti tjetër ka qenë ai i hulumtimit të raporteve midis elementit autokton të rumanishtes dhe trako-dakishtes, e të gjitha këto të para në raport me shqipen. Lidhur me këtë, disa studiues kanë ngulur këmbë në hetimin e leksikut baritor të përbashkët për këto dy gjuhë, duke e lidhur atë me hapësirën karpato-ballkanike. Në këtë pikë kanë rënë në sy botimet nëpër revista të ndryshme të E. P. Hamp. Në vitet '50-'60 ai kishte bërë shkrime me interes për interpretimin eventual të elementeve të identifikuar në mbishkrimet mesape përmes shqipes. Më vonë ai sikur nuk shihte qartë se çka fshihet prapa emërimit *ilir* dhe *ilirisht*. Studimet lidhur me trakishten tek ai sikur tregojnë se shqipja nuk mund të lidhej me atë gjuhë. Në një anë ai merret me vendosjen e shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane. Ka theksuar raportet e saj të hershme me gjuhët indoeuropiane veriore – baltosllave e gjermanike. Kjo do të thotë se protoshqipja do të jetë folur dikur në hapësirat e Evropës veriore-qendrore, ku do të ketë qenë e mundshme afria me ato gjuhë. Për Hamp-in në vijim shtrohet çështja e statusit të elementeve të përbashkëta të shqipes me rumanishten. Ato fjalë ai i konsideron jo huazime, po fjalë mbetje. Kjo kërkon një shpjegim që do ta vendoste para-shqipen dhe gjuhën substrat të rumanishtes (dakishten, mezishten?) në një hapësirë të përbashkët. Këtu ndërthuret hipoteza për elementin karpato-ballkanik. Aspekti i tretë i studimit të E. Hamp ka të bëjë me interpretimin e glosave apo të emrave të vendeve/ njerëzve të lashtësisë përmes shqipes. Vija më e rëndësishme e studimeve të Hamp-it lidhur me këto çështje ka të bëjë me raportet midis dialekteve

indoeuropiane në lashtësi dhe të gjuhëve para-shqipe, para-sllave, para-baltike, etj. me to. Në botimet e tij të vona Hamp ka sugjeruar se në një kohë relativisht të lashtë një grup dialektesh para-indoeuropiane është folur në një hapësirë të Europës Veriore; aty janë ndodhur pranë e pranë para-gjuhë të ndryshme në raporte unioni gjuhësor dhe jo afrie, sado që të gjitha kanë qenë indoeuropiane, por të degëzimeve të ndryshme. Aty ai ka përfshirë para-albanishten, para-balto-sllavishten, po edhe atë që quhet dakishte. Pak më herët Hamp, duke folur për hipotezën për raportet e shqipes me elementin leksikor ‘karpato-ballkanik’ e me rumanishten, kishte supozuar se ato i sugjeronin relievimin e një zone të hershme dialektore indoeuropiane që mund të quhet ‘protoalbanoid’ dhe shtrihej nga hapësirat ku flitet ukrainishtja perëndimore, polonishtja jugore, sllovakishtja, pjesërisht çekishtja, rumanishtja bashkë me dialektet jugdanubiane e arumune deri në Greqinë veriore, dialektet e bullgarishtes perëndimore dhe të maqedonishtes e të Banatit, të serbishtes dhe të shqipes. Sipas tij, e tërë kjo zonë do të ketë formuar një fashë nga Karpatet deri në Shqipërinë e Veriut. Një gjendje e tillë, sipas tij, mund të ketë ekzistuar afërsisht rreth 3 mijë vjet më herët. Tash vonë, ai këto qëndrime i ka interpretuar më tej, duke theksuar se tash edhe më shumë beson në afrinë e para-shqipes me mesapishten. (shih Ismajli 1997).

Veçimi i grupit të gjuhëve indoeuropiane verieuropiane nga ana e Hamp-it në vitet ’90 sikur qe një shtysë për vështrime të tjera. Do të përmend me këtë rast studimet e lntuanistit Harvey Mayer, i cili në një sërë artikujsh në revistën ‘Litanus’ ka kërkuar të shpjegojë raportet e mundshme midis shqipes, gjuhëve baltike dhe gjuhëve sllave. Interpretimet e tij mbështeten në dy baza: në një anë i elaboron raportet midis trakishtes-dakishtes e gjuhëve baltike e sllave, duke u mbështetur te Duridanov, ndërsa në anën tjetër i hulumton raportet e mundshme strukturore midis para-shqipes dhe para-sllavishtes e para-baltishtes (studimet e tij përqendrohen në reflekset e mundshme të segmentit IE *s̥-*, *ks-*, të sonanteve, etj. në shqipen, në një anë, dhe në baltishten e sllavishten në anën tjetër). H. Mayer supozon dhe argumenton se trakishtja do të ketë qenë më e afërt me baltishten, duke e quajtur këtë grup hipotetik “baltoid”, ndërsa para-shqipja (në këtë rast ilirishtja e mesapishtja) më e afërt me sllavishten, duke e quajtur atë grup hipotetik “albanoid”. Në këto interpretime ka shumëçka të pasaktësuar dhe lartësisht të supozuar, por është me interes diskutimi i raporteve të hershme të shqipes me baltishten e me sllavishten.

Në këtë grup çështjesh Desnickaja i fuste dhe raportet me gjermanishten, ndërsa në një studim të vonë për elementin latin të shqipes ajo vijonte ta mbështeste tezën për prejardhjen ilire të shqipes, por duke vendosur një raport të ri midis elementit të romanizuar në shkallë të ndryshme dhe atij relativisht të paromanizuar të ilirëve dhe duke supozuar se shqipja lindi si rezultat i një shkrirjeje të re të këtyre shtresave ilire nga fillimi i epokës së vjetër.

Botimet standarde të indoeuropianistikës sa i përket vendit të shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane i mbahen zakonisht rrugës së rrahur më herët, ndërsa në atë



kuadër, megjithë kujdesin e dukshëm, më shpesh përparësi i japin lidhjes së shqipes me ilirishten. Pak më tej në këtë drejtim ka shkuar Bernard Sergent në botimin e tij për indoeuropianët, duke e interpretuar më tej grupimin e përmendur të Hamp-it. Sergent e interpreton pikëpamjen e Hamp-it për familjen gjuhësore ballkano-baltike, ku sllavishtja është e afërt me gjuhët baltike, shqipja i përket të njëjtit grup, duke u larguar prej tyre. Kemi një bosht veri-jug, nga Baltiku në Adriatik; mund të jetë që këtij grupi në lashtësi, pas tij, i bashkohej grupi trakas, midis grekëve e sllavëve. Interpretimet e mëtejme duken jokonkluzive, por me interes del këmbëngulja për të parë një grupim eventual tjetër nga ata që janë hetuar më herët në kuadër të gjuhëve indoevropiane (Sergent 1995).

Në albanistikë mbisundon mendimi se shqipja është gjuhë indoevropiane e tipit satem, grup më vete, me prejardhje në lashtësi nga ilirishtja (apo kompleksi iliro-mesap), me afri në rrafshin indoevropian me gjuhët veriore balto-sllave e gjermanike, me lidhje kohësisht mbase më të vona me greqishten në jug; mendohet po ashtu se shqipja është folur në Ballkanin e lashtë afërsisht aty ku flitet sot e ndoshta pak më gjerë, në kontakt intensiv me latinishten, po edhe me greqishten e vjetër. Vështrimi kompleks i këtyre elementeve, i formave të emrave të vendeve që në gjendjen e sotme kanë arritur përmes transformimeve fonetike brenda shqipes, i elementeve të kulturës materiale, ndërldhja e emrit *albanoi* dhe *Albanoplis* me *arbër/ albër* (arbanët/ albanët) e mëvonë, e elemente të tjera e bëjnë për shumëkënd të besueshme këtë hipotezë. Po ashtu deri tash ka mbisunduar hipoteza për lidhjet e lashta indoevropiane të para-shqipes me gjuhët veriore balto-sllave dhe gjermanike, hipotezë që të detyron ta kërkojë lëvizjen e proto-shqipes, ashtu si të proto-greqishtes, nga veriu evropian drejt jugut diku në mijëvjeçarin e dytë para Krishtit. Mirëpo, në indoeuropeistikë, sidomos në studimet që mbështeten më parë në arkeologji, ka dhe mendime të tjera për djepin e hershëm.

Me më pak mbështetje konkrete dalin supozimet e K. T. Witzzak (1994: 21-26; Witzzak 1995: 309-312). Ai nisat nga argumentet mohuese. Thotë se besët numërohen si të mbetur gjallë edhe pas ardhjes së sllavëve. Shqipja nuk është pasardhëse e ilirishtes, sepse ajo është satem, ndërsa ilirishtja centum. Pra as e makedonishtes e frigishtes. Dakasit ishin gjeografikisht në tjetër hapësirë; ndërsa romakët i vranë. Vetëm trakasit mbeten, pas tij, si mundësi: tribalët rreth Danubit apo besët në Rodope. Për gjuhën s'ka asgjë.

Një fushë pak më konkrete e diskutimeve në rrafshin e lashtësisë ka qenë ajo e hulumtimeve të raporteve midis shqipes, gjuhëve baltike dhe sllavishtes. Duan përmendur fillimisht: L. Bednarczuk (1986: 77-83); A. Breidaks (*Linguistique balkanique*, 33 (1-2), 43-53); A. V. Desnickaja (1984); K. Liukkonen (*Scando-slavica*, 35, 197-202); V. Orel (1993); V. Orel (1998); V. N. Toporov (*Acta Balto-slavica* 17, 275-293), etj.

Edhe pse kishte vënë në pah disa momente me vlerë në diskutimet më të hershme për raportet midis shqipes e ilirishtes, sidomos sa i përket kontekstit të refleksive të palataleve IE në fqinjësi me sonantet, apo edhe afri të tjera leksikore, me kohë Hamp nuk iu kishte kthyer raportit të shqipes me ilirishten. Lidhjet e shqipes me rumanishten dhe nevoja e shpjegimit të përbashkësive midis këtyre dy gjuhëve, ashtu si dhe supozimi se djepi i hershëm i gjuhëve IE do të ketë qenë Europa Verilindore, prandaj indoeuropianët që u bënë protoalbanë, si duket, e kanë shtyrë atë më tej drejt vështrimit për fazën në të cilën paraardhësit e atyre protoalbanëve do të kenë kaluar nëpër vise më të gjera ndërmjet Europës Verilindore dhe Jugut të saj Ballkanik. Studimet e V. Georgiev-it për trakishten e dakishten dhe diferencimin e tyre, sidomos studimet e mëvona të I. Duridanov për trakishten-dakishten dhe lidhjet e tyre me gjuhët baltosllave i kanë shërbyer Hamp-it më se një herë si rast për të shprehur mendime në këtë drejtim. Në një artikull të shkurtë “Shqipja dhe baltishtja si çelësa për trakishten” (Hamp 1974: 367-8) theksonte se Duridanov po bënte punë me vlerë në kërkimin e lidhjeve të hershme midis Ballkanit të lashtë dhe Baltikut IE. Duke mbindërtuar në një sugjerim më të hershëm të Jokl-it edhe ai vetë kishte shtruar çështje që e lidhin shqipen me grupin balt (Rocznik slawistyczny, 1969, 44-45), tipare, që, po të dëshmohen të sakta, do të flisnin për një lidhje të funtme gjenetike gjuhësore por të një faze shumë të lashtë pas-IE. Tani, karakteri shumë arkaik i baltishtes, njohjet e reduktuara të trakishtes, po edhe afërsia gjeografike e saj me proto-baltishten, na e bëjnë të vështirë të themi nëse ato lidhje trako-baltike janë të natyrës gjenetike më të afërt, apo të natyrës së kontaktit parahistorik. Shembulli *Akmonia* (lit. *akmuo*, sl.vj. *kamy*) flet për një tip më të përgjithshëm kentum të velarëve, por pikërisht në kuptimin e zhvillimit specifik të velarëve dhe palataleve në pozitë para sonanteve, që, sipas tij, është një veçori e historisë së shqipes dhe për një fqinjësi me baltishten. Kjo nuk ka të bëjë me relacioni gjenetik, po me afërsinë e baltëve me paraardhësit e shqipes. Këtu forma dakase mund të vinte natyrshëm. Në tërësi, “lidhjet baltike me dakishten (dhe me shqipen) më duken më trimëruese se ato me trakishten”. Më herët, madje, Hamp përmes analizës së emrit trakas *Biso* kishte provuar të tregonte, për mendimin tim me sukses, se “trakishtja nuk mund të jetë parardhëse gjenetike e shqipes”. Duke dhënë shpjegimet për prejardhjen e këtij emri (*Biso*) nga *\*bhidh-t(ó)-*, ai e shihte të nevojshme të ikte nga kurthi i barazimit të trakishtes *-s-* me shqipen *-s-*, sepse, siç e dimë nga historia e huazimeve sllave dhe nga rindërtimi i brendshëm, nga mesi i mijëvjeçarit të parë pas Krishtit paraardhësi i *s-* së sotme do të ketë qenë *ś*. Kjo do të thotë se trakishtja nuk e kishte të përbashkët me shqipen zhvillimin e grupit *\*tt*, edhe pse në të dy rastet kemi *s*.

“Ky emër na ndihmon të tregojmë, pra, se trakishtja nuk mund të jetë parardhëse gjenetike i shqipes” (368).

Dallimi i delte dhe kuptimor: \**bhoidh-ā*, si lat. *toga* – be; \**bhidh-tó*- gr. ‘besues, besnik’, ku hyn dhe *Biso*; \**bhidh-tí-*, \**-tā* (shqip) – besë.

Qysh në studimin *The position of Albanian* (1966) Hamp e kishte vënë në pah veçimin e Jokl-it të raporteve midis shqipes dhe gjuhëve baltosllave, problematikë që nuk u hoq nga vëmendja asnjëherë, por që nuk u shterrua. Kësaj çështjeje iu kthyen më se një herë A. V. Desnickaja, Eqrem Çabej dhe vetë Eric Hamp. Në studimin e gjatë “Kush ishin Tokarët? Nëngrupimi gjuhësor dhe idiosinkrezia diagnostike”, të botuar vëllimin *The Bronze Age and Early Iron Age Peoples of Eastern Central Asia*, më 1998, E. Hamp shtronte çështje me rëndësi në aspektin që na intereson këtu. Përveç shumë shënimeve të tjera në raportet e shqipes me tokarishten dhe me gjuhët e tjera IE, këtu i trajtonte në mënyrë të veçantë raportet e shqipes me balto-sllavishten (f. 321-322), fliste për një grupim të ri të gjuhëve IE, që ai e quante North West IE European, e që i atribuonte natyrën e Sprachbundit në raportet midis tyre.

Lidhur me raportet e shqipes me gjuhët veriore, konkretisht balto-sllave, shënonte janë diskutuar gjatë. Ai megjithatë, ato i sheh të ngjashme me raportet e dy dialekteve të shqipes – gegërishte/ toskërishte. Ato raporte paraqesin midis tyre idiosinkrezi komplekse, prandaj nuk mund të jenë huazime.

*“E konsideroj të padyshtimtë (sepse shumë të vjetër) relacionin e shqipes me balto-sllavishten absolutisht të qartë dhe të sigurt”.*

Si pengesë e shihte faktin se shumë pak dijetarë janë marrë me shqipen, por edhe faktin se shqipja ka lëvizur shumë kohë më herët nga zona kulturore verieuropiane drejt zonës së Danubit-Mesdheut. Pasi të ketë paraqitur disa korrespondenca të natyrës fonetike dhe morfologjike për afërsinë e shqipes me këtë grup më shumë se me grupin heleno-armen, ai nxirrte këtë përfundim:

*“Nga studimet e mia të viteve të kaluara (mbi bazë të një duzine tiparesh) po kthehem (pas 40 vjetësh) te bindja se mesapishnja (nuk po them gjë për ilirishten, as çka është ajo) është e lidhur me shqipen. Por ende është shumë herët për mua të paraqes dëshmitë” (Whose were the Tocharians?, 322..*

Grupimin “Europa Veriore” Hamp e cilësonte hapur si areal, difuzional, Sprachbund, i cili mund të jetë mbase 4 mijëvjeçarë i largët prej nesh, por që mund të hetohet si një substrat përmes tipareve që kanë dalë nga kontakti shoqëror me të. Tipare të tilla karakterizojnë degë gjuhësh IE si gjermanikishtja, balto-sllavishtja, shqipja, prahelenishtja (pellazgjishtja), më pak keltishtja, margjinalisht italikishtja. Në kuptimin indoeuropian ‘Europa veriore’ është koncept i përdorshëm. Këtë territor ai e vendoste në veri të Alpeve (329).

Duke folur për trakishten dhe paqartësitë që e shoqërojnë historikun e studimit të saj për shkak të mungesave të materialit, Hamp shënonte:

“studiuësit thjesht akceptonin emrat dhe termat për etnicitetet nga antikët dhe i zbatonin pastaj në tufën e të dhënave areale apo gjenerike duke lidhur argumentet e tyre apo linjat e prejardhjes më tepër me popullatat tashmë të supozuara nga nomenklatura. Kështu, pa korrespondencë të qartë justifikuese linguistike, ndeshim terma si trako-frigishte, ilirishte, trako-ilirishte, trako-dakishte, dako-getishte, geto-dakishte, trako-getishte dhe shoqërime si trakishte + shqipe, +ilirishte, +figishte dhe frigishte + armenishte”. (330).

Sipas mendimit të tij, pas Georgiev-it vendosen disa parametra më konkretë me 7 grupet regjionale: dako-mez, trakas, para-helen, proto-helen, makedon, proto-frig, ilir (në veri nëpër Dalmaci dhe Panoni jugore). E përmend lidhjen nga Georgiev të dako-mezishtes me shqipen, por thekson se dakishtja e trakishtja ishin gjuhë krejt të ndryshme. Këtu ai jep diçka më konkrete nga argumentimet për prejardhjen e shqipes. Vendosja gjeografike e dako-mezishtes mund të pajtohej me praninë e shqipes para ardhjes së sllavëve të jugut.

*“Në bazë të pranisë së huazimeve latine në shqipen, por të mungesës relative të huazimeve greke, rezidenca e shqiptarëve në veri të linjës Jireček (në veri-perëndim të linjës Shkumbi – Scupi – Naissos dhe Sofia deri te malet Ballkan, me çka pajtohet demarkacioni midis mbishkrimeve me gjuhë latine dhe greke, pajtohet me pretendimin për dako-mezishten (mezishten)” (331-2).*

Për ta parë më afër mënyrën e rindërtimit të raporteve shqipe-baltike sipas Hamp-it, le të shohim rastin e rrënjës IE *\*leugh-*, që ka shërbyer për të shpjeguar *bélos Lougeon* të Strabonit, që është lidhur me shqipen *lëgatë* dhe format balte *liúgas* “morast” dhe *ludza*, rus., sll. k. *lužá*. Me këtë rrënjë ai lidhte një numër fjalësh në shqipen: folja lag me derivatet lagët nga *\*long-* - *\*lang* > *lag*; emri *lagë* nga *\*longā*; këtu shihet të larat (menstruacionet) - nga derivat. *\*longrā* neutr. pl.; *lang* < *\*laung-* < *laungno-* < *\*laug-no-* si te *bung*, *fagus*; përmes *\*lukta-* > *\*lut-* nga *\*lug-to-* me sufiksin *\*-tja* – *lucë*; pastaj lumë prej *\*lug-mōn-*; *\*lougro-*, *\*lug-ro-* del te *\*leugro-/ legura*>*lerë*. Të gjitha këto lidhen me lit. *liúgas*, që lidhet me *lug-*, *liang-* < *\*leug-*, pra *\*leugh-* (Hamp 1982-83: 7-8).

Agnja Vasiljevna Desnickaja njihet dhe për studimet e saj të shqipes në raport me gjuhët e tjera IE të hershme dhe më të vona të kontaktit. Këtu do të përmend dy ndihmesa të saj me idetë që me këtë rast më duken me peshë. Në librin **Sravniteljnoe jazykoznanije i istoriija jazykov**, M. 1984 kishte botuar studimin: *Drevnie balkano-baltijskie sootvetsnija i albanskij jazyk* (ff. 192-210). Si dhe në raste të tjera ajo aty vlerësonte rezultatet e studimeve që kishin theksuar karakterin satem IE të shqipes me lidhjet me gjuhët e Europës veriore dhe prejardhjen e shqipes nga ilirishtja paleobalkanike në vijën Meyer-Pedersen-Jokl-Çabej-Cimochowski-Katičić, etj. Gjithë duke i vënë në pah raportet e shqipes me ilirishten, madje duke pasë bërë dhe një kritikë me interes për hipotezën e Georgiev-it lidhur me prejardhjen trakase të shqipes, Desnickaja kërkonte

të dinte më shumë për raportet e shqipes me gjuhët e tjera IE dhe për vendin e saj më të hershëm. Për këtë arsye ajo qysh më 1965 kishte botuar studimin *Drevnie gjermano-albanske jazykovie svjazj*, ku kishte shqyrtuar një numër përkimesh leksikore dhe strukturore midis shqipes dhe gjuhëve gjermanike, duke përfunduar:

“lidhjet e lashta areale të shqipes me gjuhët e zonës gjuhësore veri-europiane dalin lidhje areale që rindërtohen përmes ilirishtes. Në pajtim me konceptin e zhvilluar me kohë nga Krahe, gjuha ilire parahistorike (deri te migrimi i pjesëve të fiseve ilire në Ballkan) ka pasur kontakte më të afërta me gjermanikishten, sllavishten dhe në mënyrë të veçantë me baltishten. Ky është rrethi i kontakteve parahistorike të vendosura për proto-shqipen.” (239).

Duke vazhduar këtë interesim, Desnickaja i bëri objekt studimesh të veçanta raportet e shqipes me baltishten. Duke i njohur dhe studimet e Duridanov-it për raportet dako- dhe trako-baltike, ajo ngulte këmbë në hulumtimin e raporteve iliro-baltike dhe shqipe-baltike. Lidhjet e indikuara nga ajo me gjermanikishten, qoftë për ilirishten, qoftë për shqipen, marrin një kuptim të veçantë: të tilla lidhje në studimet trako-dake nuk janë vënë re dhe kjo flet vetvetiu dhe për prejardhjen e shqipes në raport me gjuhët paleobalkanike. Nevojën e hulumtimit të lidhjeve të gjuhëve paleobalkanike me gjuhët baltike e arsyetojnë jo vetëm kontaktet parahistorike të këtyre popujve me para-baltikët po edhe fakti se

“vetë gjuhët paleobalkanike dalin nga një areal i përbashkësisë së vonë indoeuropiane dhe se, meqë të bartura në Sijndhesën Ballkanike për pasojë shpërnguljes të fiseve trak-dakase dhe ilire, ato, me siguri, duhet të ruajnë një shkallë të rëndësishme afrie”. 195.

Në këtë kuptim ajo sheh mundësi studimi në fushën e leksikut, po sidomos në fushën e fonetikës, po edhe të segmenteve të tjera strukturore. Të dhënat e rendit të brendshëm historik dhe ato pak të dhëna gjuhësore (mesape e ilire) flasin për faktin se parardhësit e shqiptarëve në periudhën antike kanë jetuar në pjesën perëndimore të Ballkanit, prandaj shqipja është pasardhëse e ilirishtes, mendonte ajo. f. 196.

Në këtë punë ajo nisat nga rindërtimi i formave proto-shqipe dhe të shqipes së hershme (në periudhën nga 500 para deri në 500 pas Krishtit). Niset nga rindërtimi i çerdheve të derivateve me shembullin \*lug. \*lugas m. – lug, \*luga f. (<\*lugā) – lugë; \*lugja f. (<\*lugjā) – lugje; \*lugarja f. (< lugarjā, lugoria) – lugare; \*lujanja f. (\*lujanjā, lugonia) – lugajë; \*luguras – lugur; \*lugatas – i lugët; \*lugetjas – lugës; \*lugonja (< \*lugonjō) lugonj, etj. Më tej \*anna – anë, \*ahas – ah, \*balga – balgë, \*balta – baltë, \*bala – ballë, \*bieska – bjeshkë, etj. Posaçërsisht me peshë i dalin rindërtimet e formanteve fjalëformuese, ndërsa këto pastaj mund të krahasohen me përkatëset baltike.

Në fushën e leksikut ajo, në vijën e Meyer-it, theksonte lidhjet e veçanta të shqipes me gjuhët e Europës veriore në fushën e veprimtarisë së hershme bujqësore dhe blegtorale, të drurit, dhe këto flasin për lidhjet e para-shqiptarëve me para-baltikët,

para-sllavët e para-gjermanikët. Në vijim jepete disa shembuj: \**liga, ligë, \*ligas* - i *lig, ligustas* - i *līgsbtē* = lit. *ligà, ligustas*; \**metas* - *mot*, lit. *mētas*, pl. *mētai*; \**sīrmas* - i *thjermë*, lit. *šīrmas, šīrvas*; \**delas, \*dela* > *djalë*, let. *dēls*, lat. *filius*. 203; \**malas* (molo) - *mal*, let. *mala* 'kraj, breg'; \**megla* - *mjegull*, lit. *migl*, let. *migla*, sl *mēgla*; \**landā, landē* - lit. *lenta* 'dërrasë'; \**lāpā, lopē* - let. *luops, lopi*; \**lāmā, lamē* - lit. *loma* 'log, nižina'; \**skalā, balē* - lit. *skala*; \**gardas, gardh* - lit. *gardas*

Në fushë fjalëformimi: IE \*-i-mo-: *vrapim* - lit. *begimas* - 'beg', nga *begti*; ndoshta tipar i veçantë i lidhjeve me baltiket. Shuarja e asnjansësit në shqipen e lashtë ka pajtime me baltiket.

Desnickaja këto raporte i shihte në kuadrin e përgjithshëm të lidhjeve me gjuhët veriore të Europës, pra edhe në raport me gjuhët paleoballkanike. Mungesa e shqipes në raportet që janë veçuar si specifike për lidhjet trako-dako-baltike dhe eventualiteti i raporteve të ilirishtes me ato gjuhë flet vetvetiu në favor të prejardhjes ilire të shqipes.

Simona Klemenčič në dorëshkrimin e saj të diseratcionit të doktoratës në mbrojtur në Lubjanë në vitin 2005 me titull *Starejšje jezikovne povezave albanščine, baltščine in slovanščine*, ff. 201, shqyrton çështje nga më të ndryshmet, prej historisë së shqipes e deri te raportet e saj me gjuhët baltike e sllave. Ka qëndrime kritike për etimologjizimet, sidomos për etimologjitë që sillen në rreth. Një kapitull i kushton parahistorisë së shqipes dhe, pasi i shqyrton të gjitha hipotezat e paraqitura, përfundon se nuk mund të saktësohet cila prej gjuhëve paleoballkanike është paraardhësja e shqipes. I trajton në mënyrë të veçantë raportet me rumanishten dhe çështjet e terminologjisë baritore, të shënuar si karpatiane. Shqyrtimi i gjuhëve paleoballkanike është sumarizues, pra jo i veçuar. Në pjesën qendrore flet për shqipen, baltishten e sllavishten, duke veçuar paralelet midis shqipes, baltishtes e sllavishtes, pastaj paralelet me baltishten, paralelet me sllavishten, lidhjet shqipe, baltishte, sllavishte, gjermanikishte; shqipe, baltishte, gjermanikishte; shqipe sllavishte, gjermanikishte; paralele që përfshijnë gjuhët e lashta ballkanike dhe paralele që përfshijnë rumanishten. Mendon se shumë etimologji nuk u qëndrojnë kriterëve shkencore, sidomos nëse krahasohen gjuhët paleoballkanike. Çështja e parardhësit të shqipes i duket e pazgjdhshme. Ka shumë indicie për prejardhje prej njëres nga gjuhët e lashta ballkanike. Prandaj korrespondencat hipotetike midis gjuhëve paleoballkanike, baltishtes e sllavishtes nuk mund t'i përfshijmë bashkë me korrespondencat hipotetike midis shqipes, baltishtes e sllavishtes. Shënon 45 paralele shqip, baltisht, sllavisht; 67 paralele leksikore shqip-baltisht; shqip sllavisht 26; shqip-baltisht-sllavisht-gjermanikisht 13; shqip-baltisht-gjermanikisht 10; shqip-sllavisht-gjerm. 5. Paralele që përfshijnë gjuhët lashtoballkanike - 16; paralele që përfshijnë rumanishten - *bređh, çupis, mushkë, shpendër*; paralele midis rumanishtes, baltishtes e sllavishtes pa shqipen: *doina, bata, pat, teafar, a socoti*.

Gottfried Schramm e rikthen teorinë për prejardhjen trakase duke i parë shqiptarët si pasardhës të besëve. Besët ishin fis trakas që jetonte në lindje të Nishit dejt Sofjes e më tej.

Do të vë në pah gjithashtu që në shqyrtimet e mëvona për këto çështje sikur ka një rikthim tek ndonjë prej ideve të Stadtmüller-it e të tjerëve, qoftë përmes referimit të tyre si të tilla, qoftë dhe përmes kritikave të tezave të Çabejtë. Në shqyrtimet e tyre Schramm (1981; 1998), A. Loma (1991) e të tjerë nisen nga diskutimi i pohimeve të Çabejtë lidhur me vazhdimësinë shqipe të toponimeve të hapësirës shqiptare, si: *Shkodër, Shkumbin, Shkup, Shar, Durrës*, etj. Rezultatet e tyre kanë pika të përbashkëta, por kanë edhe dallime. Për mjaft prej këtyre toponimeve ka pasur diskutime të shumta edhe më herët. Për to është shprehur mjaft ndryshe nga ta Sh. Demiraj (1999) në librin e tij.

Edhe pse mund të mos e kishte bërë eksplicite deri në fund e për çdo rast, Çabej kishte bërë një vërejtje paraprake lidhur me kontestimet e tilla të mundshme: në shqyrtimin e zhvillimit fonetik të këtyre emrave ka dhe çështje kronologjike. Sipas disa diskutuesve, *Scupi, Scodra, Scampinus* janë përshtatur sipas ndryshimit *sk: shk*, ndërsa te *Scardus* sipas *sk: sh*, ndërkohë që mendohet se *sk-* e hershme do të ketë dhënë *b*. Ashtu si te *Durrës* nga *Durrazzo* apo *Duračb*, mendojnë ata, në rastet e sipërme nuk shihet shqipja, çka do të thoshte se shqiptarët s'kanë qenë në ato anë. Për G. Schramm kjo do të thotë se ata janë të ardhur atje nga brendia e Ballkanit, do të kenë lëvizur drejt hapësirave shqiptare veriore duke ikur si të krishterë nga bullgarët para-sllavë paganë. Emrat *Astibos* dhe *Naisus* në gjendjen e sotme të tyre, siç kishte theksuar qysh brezi Barić-Weigand, *Shtip* dhe *Nisb* kanë arritur vetëm përmes shqipes, e këtilla nuk kanë mbetur pa u shqyrtuar nga historianët të kohës sonë.<sup>11</sup>

Noel Malcolm në veprën *Histori e shkurte e Kosovës* e kishte rivështruar çështjen duke e rikthyer pjesërisht te koncepti i mëhershëm i ngjashëm i Jokl-it për djepin e lashtë të shqiptarëve në Dardani e përreth. Malcolm ishte marrë me kritikën e pikëpamjeve të Schramm-it lidhur me prejardhjen e shqiptarëve nga fisi i besëve trakas. Besët e flisnin gjuhën e tyre deri në shekullin e gjashtë; dihet po ashtu se ishin kristianizuar. E tërë kjo lidhet me historinë e raportuar të murgjve besë që flisnin gjuhën e tyre ashtu si latinishten e gjuhë të tjera në një manastir të Malit Sinaj në vitin 560. Kjo histori e besëve është diskutuar në mënyra të ndryshme, ndërsa G. Schramm në konceptimet e tij këta besët i konsideronte paraardhës të shqiptarëve. Sipas Schramm-it gjithnjë, këta besë do të kenë lëvizur nga atdheu i tyre drejt viseve shqiptare veriore nga fillimi i shekullit nëntë, mbase për të ikur nga përndjekjet e të krishterëve nga ana e kanëve bullgarë paganë. Në fakt, sipas tij, besët ishin kristianizuar herët përmes ndërmarrjes së peshkopit Niketa, mbase në shekullin e katërt, ndërsa, siç thuhet, nga shkrimet e një miku të tij mësohet se Niketa e kishte mësuar gjuhën e besëve dhe u kishte

<sup>11</sup> Tani, shembulli i *Naisus*: *Nisb* na shpie më në veri, por gjithnjë brenda hapësirës dardane, pra ende jo bese; nga ana tjetër, *Astibos*: *Shtip* na çon më tepër drejt peonëve, për gjuhën e të cilëve ka shumë hamendësime: ishte ilire, trakase, apo gjuhë më vete. Të gjitha këto, natyrisht, nuk flasin në të mirë të supozimit të përmendur.

mësuar atyre ta ushtronin krishterimin në atë gjuhë. Kjo do të thotë se besishtja përdorej si gjuhë liturgjike. Më tej shtrihet supozimi se Niketa, gjuhë e të cilit ishte latinishtja, mund të kishte përkthyer pjesë nga Bibla, diçka sipas modelit të peshkopit heretik Wulfila, i cili e kishte përdorur gotishten për liturgji e përkthim të Biblës te popullata fqinje gote në hapësirat e Bullgarisë veriore. Dhe sipas tij, siç tregojnë edhe rastet e armenishtes a të koptishtes, mbi jetesën e një gjuhe nga kohë të hershme e bën të mundur ekzistenca e një lloj kishe nacionale. Por si u bë që te shqiptarët gjuha u shkrua mjaft vonë?

Tani, historiani me njohuri jo të vogla filologjike, Noel Malcolm, nuk e kishte të vështirë të pranonte se shqiptarët e morën krishterimin nga mësues latinishtfolës. Gjithashtu nuk e kishte të vështirë të shënonte se gjuha shqipe kishte huazuar shumë fjalë nga latinishtja, nga romanët fqinj apo nga barbarë të romanizuar dhe kjo mund të shkonte madje deri nga sh. II para Krishtit. Ai gjithsesi nuk mund të mos shënonte se elementi latin i shqipes është mjaft i gjerë në fushën e besimit të krishterë dhe të praktikës kishtarë të krishterë. Ai shënonte fjalë si *meshë, peshk, ungjill, mrekull*, nga fusha e pandërmjetme, por edhe fjalë që mund të dalin në fusha të afërta, si psikologji, moral a bota e natyrës (*qiell*, p.sh.). Shumë prej fjalëve latine në shqipen nga këto fusha në fakt nuk janë terma thjesht kishtarë: për *shpirt, mëkat, i shenjtë* në shumë gjuhë edhe para krishterimit ka fjalë vendëse. Përkthyesit e Biblës armenisht, gotisht apo anglosaksonisht kishin përdorur fjalë vendëse për këtë qëllim. Pas këtij konstatimi, Malcolm pyeste:

*“Pse do të duhej Niketa, duke përkthyer në proto-shqipen, thjesht të transferonte një sasi të gjerë fjalësh latine?”<sup>12</sup>*

Arsyet e veçanta kulturore që përmend Schramm-i në sytë e Malcolm-it nuk mjaftojnë për të shpjeguar se përse, ta zëmë, në shqipen ishte marrë edhe një fjalë baritore latine si *grigjë*, ndërkohë që shqiptarët si popull baritor do të kishin fjalë të tyre për të. Tërë këtë ndërtim Malcolm e shihte të zgjidhshëm përmes interpretimit të zakonshëm të huazimeve latine në shqipen.

*“Këto elemente të vokabularit latin kanë kaluar saketësisht nëpër të njëjtat lloje të ndryshimeve tingullore, tkurrje dhe rrëgjime, si të gjitha fjalët e tjera latine që kanë hyrë në shqipen gjatë disa shekujve; dhe arsyeja pse ato fjalë hynë në gjuhë ishte se shqiptarët ishin në kontakt, gjatë një periudhe të gjatë, me njerëz që flisnin latinisht. Ekzistenca e sasive të gjera të fjalëve latine të lidhura me Krishterimin nuk tregon se dikush e ka ‘përkthyer’ ligjëratën e krishterë në shqipen e hershme. Ajo tregon pikërisht të kundërtën - pra, se shqiptarët për një kohë të gjatë i ishin ekspozuar sjelljes në fenë e tyre jo në përkthim po në origjinalin latin” (përkthimi R.I.).<sup>13</sup>*

<sup>12</sup> “Why should Nicetas, translating into proto-Albanian, have simply transferred huge quantities of Latin words?”, MALCOLM (1998), f. 36.

<sup>13</sup> “These elements of Latin vocabulary have undergone exactly the same sores of smund changes, compressions and erosions as all the ther Latin words which entered the Albanian language over several centuries; and the reson hy thoshe words entered the language was that the Albanians were in contact, over a long period, whith people who spoke Latin. The existence of large quantities of such Christianity



Më tej ai merrej dhe me analiza gramatikore, të cilat duhet ta dëshmojnë këtë pohim të Malcolm-it, e të cilat janë të njohura në albanistikë. Kështu Malcolm vinte me përfundimin e qartë:

*“Teoria e Schramm-it, pra, bie; dhe duke bërë kështu ajo na jep një shërbim të shënueshëm. Falë Schramm-it, trakasit tani mund të eliminohen nga hulumtimet e tilla. Hulumtimi i tij për veprimtaritë e Niketës tregon se besët e morën krishterimin e tyre, të themi kështu, në përkthim; kjo dubet të na detyrojë të konkludojmë se shqiptarët, të cilët e morën të tyrin në origjinalin latin, nuk mund të identifikohen me besët...”*<sup>14</sup>

*“Prandaj, prejardhja e shqiptarëve dubet të kërkohet në anën ilire, sidomos në malet përreth Kosovës, në Malësi dhe në vargjet e maleve që shtrihen në veri prej andej nëpër Mal të Zi”* (përkth. R. I.).<sup>15</sup>

Më tej ai shpjegonte dhe teorinë pas së cilës kjo hapësirë duhej të shtrihej në jug deri në Mat e Dibër, deri te Shkumbini, por njëherësh sillte çështjen e raporteve me rumanishten, për të parapëlqyer teorinë që këto raporte i shpjegon përmes kontakteve midis rumunëve e shqiptarëve të hershëm. Hapësira ku mund të ketë ndodhur kontakti midis vllëve dhe shqiptarëve, sipas tij, pas invazionit sllav, do të ketë qenë ajo e luginës së Moravës, e Maqedonisë së epër dhe tërë Kosovës, pra pjesët e larta të Kosovës, sidomos në anën perëndimore, përfshirë Malin e Zi:

*“Kjo sugjeron se regjioni i Kosovës, bashkë me së paku një pjesë të Shqipërisë Veriore ishte fokusi crucial i dy historive të ndërlidhura por të ndryshme etnike: i mbijetesës së shqiptarëve dhe i emergjencës së rumunëve dhe të vllëve. Një grup i madh i vllëve duket të jetë larguar dhe të ketë ikur drejt jugut rreth sh. nëntë ose dhjetë; proto-rumunët mbetën në kontakt me shqiptarët ndjeshëm më gjatë, para se të largoheshin në verilindje dhe të kalonin Danubin në shekullin dymbëdhjetë”*(përkthimi R. I.).<sup>16</sup>

---

related Latin vocabulary does not show that someone ‘translated’ Christian discourses into early Albanian. It shows the precise opposite – namely, that the Albanians were for a long time exposed to the conduct of their religion not in translation but in the original Latin”, MALCOLM (1998), 36-37.

<sup>14</sup> “Schramm’s theory falls, therefore; and in so doing it performs a signal service. Thanks to Schramm, the Thracians can now be eliminated from these inquiries. His research into Niceta’s activities does indeed show that the Bessi received their Christianity, so to speak, in translation; this must force us to conclude that the Albanians, who received theirs in the original Latin, cannot be identified with Bessi”, MALCOLM (1998), 37;

<sup>15</sup> “The origins of the Albanians must be sought, therefore, on the Illyrian side of the divide - particularly in the mountains round Kosovo, in the Malësi, and in the tangle of mountains stretching north from there through Montenegro”, MALCOLM (1998), 37-38.

<sup>16</sup> “What it suggests is that the Kosovo region, together with at least part of north Albania, was the crucial focus of two distinct but interlinked ethnic histories: the survival of the Albanians, and the emergence of Romanians and Vlachs. One large group of Vlachs seems to have broken away and moved southwards by the ninth or tenth century; the proto-Romanians stayed in

Ka mjaft vend për diskutime lidhur me këto pohime. Në Kosovë, në Mal të Zi e në tërë Serbinë ka pasur popullatë vllahe (romane, pra ilirë-dardanë të romanizuar, ashtu si dhe më në lindje trakas të romanizuar). Gjurmët romane-vllahe në Kosovë në toponimi ekzistojnë (*Partesh, Sharban, Llashtivë, Vlashnje, Llashkobare, Vllasi, Stanishor, Nishor, Muçibabë (Munçi Baba), Ponesh*, etj.), por ato janë mbase më të pakta se në Serbi a në Mal të Zi e madje edhe në Bosnje, ku shënohen dhe male si *Visitor, Pirlitor, Palator, Romanija*, etj. Nuk më duket e dyshimtë se kontaktet e shqiptarëve të hershëm me rumunët e hershëm për një pjesë do të kenë ndodhur në zonat e përmendura (sidomos në luginën e Moravës Jugore - *Vllasina, Vlasotince, Surdulica, Korbevac, Kriva Feja*, etj.). Por rumunët e hershëm do të jenë shtrirë edhe ndjeshëm më larg në veri; shqiptarët e hershëm edhe ndjeshëm më në jug. Lokalizimi i përmendur i hapësirës së shqiptarëve të hershëm, nga ana tjetër, nuk arrin të shpjegojë shtrirjen dhe dispozicionin dialektor të shqipes, sidomos jo në raport me izoglosa të mëdha si rotacizmi, që kohësisht vendoset para sh. VIII.

Bartësit e teorive për prejardhjen trakase të shqipes e shqiptarëve shpesh shfaqin vlerësime për ata që mbështesin teori të tjera, sidomos për prejardhjen ilire të shqipes e shqiptarëve, duke i cilësuar, kur janë shqiptarë, si nacionalistë, etj. Në fakt, të kenë qenë parardhësit ilirë apo trakas është krejt njësoj, rëndësi e vërteta. Në Traki janë gjetur mbishkrime, p.sh. është një mbishkrim afër Plovdivit *dadaleme* dhe Georgiev e interpretonte kështu: “dhe del më” d.m.th.. ai ose ajo që kishte vdekur e luste zotin në këtë mënyrë “dhe mbamë”. Por këtu gjuhësisht problemet janë shumë të rëndësishme: si u bë *dhe* nga *da*, ka qenë *q* IE ajo dhe prandaj u bë *dh*? Si u bë *më* nga *\*mem*. Në shqipen përmemri duhet të ketë qenë *mëm* ose *mon* në atë kohë, shek. V para Krishut, kurrsesi jo *më*. Çabej e ka pasë pranuar një kohë dhe e korigjonte pak, por nuk qëndron, gjuhësia s’i ka dhënë të drejtë.

Për mendimin tim në këtë situatë kur nuk e njohim asnjë prej gjuhëve të lashta ballkanike, pos latinishtes e greqishtes, mund të zgjedhim: është një hipotezë që thotë se shqipja është pasardhëse e ilirishtes dhe ka këto argumente, është një tjetër që paravendon trakishten dhe ka argumentet përkatëse. Kur bëjmë krahasimin, shohim dhe mbishkrimet e trakishtes, vërejmë se argumentet për trakishten në aspektin gjuhësor nuk janë. Ka pasur kritika edhe për Gerorgiev-in, di Giovine, Koedderitsch, Desnickaja, se rindërtimet nuk i ka pasur të mira. As ilirishten nuk mund ta rindërtojmë, s’e kemi. I kemi ato fjalë, glosa, një numër glosash, p.sh. *drenis* lidhet me fjalën *dre-dreni*, pastaj *rinon*, *rinos* lidhet me shqipen *rë-rëja*, më herët ka qenë *ren*, pra mund të lidhet me *\*rin* në këtë kuptim; *lugeon lug-lugat, tsika-thikë, mal*, e ndonjë tjetër. Këto pak fjalë nuk na japin të drejtë që të nxjerrim përfundim për gjuhën, sepse fjalët mund të huazohen. Por kur i mbledhim argumentent, latinizmat, greqizmat e të gjitha të tjerat, situatë historike-gjeografike, atëherë na del më e pranueshme hipoteza për prejardhjen ilire të shqipes.

---

contact with Albanians significantly longer, before drifting north-eastwards, and crossing the Danube in the twelfth century”, MALCOLM (1998), 40.

Prandaj në këtë gjendje do të themi vetëm këtë: nuk e di a mund të themi që është dëshmuar prejarhdja ilire, sepse për ta dëshmuar duhet ta kishim ilirishten dhe atë nuk e kemi. Shkenca punon me hipoteza, me teori. Në albanistikën vendëse, Sh. Demiraj p.sh., në librat e fundit është marrë me problemet e onomastikës dhe ka pasqyruar gjerësisht mendimet edhe të Çabejt edhe të tjerëve në mënyrë relativisht të plotë. Demiraj është pak më i prerë në këtë drejtim. Thotë “shqipja është pasardhëse e ilirishtes” në shkallën që ilirishtja është nëna e saj dhe në periodizimin e historisë së shqipes ai bën kështu: deri nga shek 4-5 është nëna, pastaj vjen shqipja e lashtë dhe me radhë. Një ide të ngjashme e ka thënë edhe Fiedler, duke pohuar se shqiptarët u formuan në shek 5-6. Nuk e di shumë argumentimin historik dhe sa qëndron, por është referuar si ide e tij. Për mendimin tim, në kur flasim në aspektin IE duhet të flasim me terminologji IE, duhet të flasim për shqipe, shqipe të lashtë, para-shqipe, proto-shqipe deri të IE. Ndoshta kjo do të ishte më e saktë sa kohë që nuk i dimë gjuhët e lashta të Ballkanit, nuk i kemi. Ndoshta një ditë do të gjinden mbishkrime, do të kemi më shumë argumente.

Hamp-i, Paliga e ndonjë studiues rumun, thonë, pa argumentim përkatës, se shqiptarët kanë shkuar më në jug – d.m.th. u formuan në veri të Shkumbinit, në Dardani, por pastaj kanë shkuar në jug. Kjo do të duhej, pas tyre, të shpjegonte afritë e pretenduara më të mëdha midis toskëroishtes e rumanishtes. Por kur? Në studimet dialektore të shqipes ne dimë se gegërishtja dhe toskërishtja u ndanë pak a shumë me rotacizmin dhe rotacizmi në bazë të hulumtimeve del se nuk është më i vjetër se shek. VIII. Rotacizmi është vetëm në jug, pra në jug të Shkumbinit ata ishin para shek. VIII. Në shek. XIII tashmë i kemi në Greqi. Në qoftë se ishin këtu bashkë, pse u nda ai dialekt tjetër? Dispozicioni dialektor i shqipes dhe historia e tij nuk i tumir këto hipoteza.

Për ta mbyllur dua të them edhe një gjë. Është menduar se emri *alban - arbën* lidhet me emrin e përmendur të Ptolomeu. Në shek II e.s. Ptolomeu kishte shënuar *Albanoi* dhe *Albanopolis*. *Albanopolis* ishte te Zgërdheshi afër Krujës, qyteti i albanëve, Albanoi ishte fisi i albanëve. Ka disa hipoteza për këtë, por kryesorja është kjo: që albanët janë fisi që më vonë, në porocetin etnolitik, shkrihen e fiseve të ndryshme, luajti rolin në krijimin e arbërve të mesjetës. Shqiptarë janë nga shek. XVII-XVIII, më herët kanë qenë arbën dhe Arbënë ka qenë emri i vendit. Edhe tek autorët e vjetër Buzuku, Budi etj., vetëm në një vend Buzuku ka *nd'Arbanit*. Në sllavishten pak para vitit 1200 është shënuar *Рабѣнь*. Tani, *Rabënë* është një formë që është me metatezë. Në gjuhët sllave në shek. IX ka ndodhur metateza, grupet ar, al u bënë ra, la dhe kjo mund të verifikohet saktësisht. Metateza ndodhi në fund të sh. VIII dhe në fillim të sh. IX. *Rabënë*, po të ishte nga *arbanum* ose *arbanon*, në sllavishten do të jetpe *\*rabon* dhe jo *rabënë*. Ndryshe nga të tjerët dua të nxjerr faktin se ata kur erdhën në kontakt këtu mund ta kenë marrë nga shqipja *Arbënë* dhe kjo formë dha *rabënë* në sllavishten. Dhe fundja Ipeshkvia e Krujës ishte formuar në shek. VII-VIII.

Përfundimi do të ishte afërsisht ky: pavarësisht se ka shumë diskutime, sepse ka vend për diskutime, ka shumë mundësi për argumentime të ndryshme, në po themi se shqipja është

gjuhë IE, është e tipit satem, ka afrinë e saj me gjuhët lindore dhe perëndimore, jugore dhe veriore në shumë aspekte të lashta, ka afri me greqishten në aspekte të reja, psh. krijimi i nyjes. Nyja në shqipen së pari u krijua si e përparme, edhe në greqishten u krijua si e përparme nga dëftori. Dhe kjo është një areal që u krijua ndoshta rreth kohës së Krishit, në atë periudhë në gjuhët europiane dhe pastaj brenda shqipes ka ndryshuar vendosja, me zhvillimet në rrethanat e renditjes. Ne kemi këtu një autor të rëndësishëm, prof. Bokshi me librin e tij “Prapavendosja e nyjave në gjuhët e Ballkanit”, ka treguar, edhe pse jo shumë i lexuar nga ballkanologët, ndoshta do të duhej të ishte në një gjuhë të huaj, prapavendosja ka ndodhur më vonë dhe ajo prapavendosje në shek. VI-VIII, kur pati kontakte direkte midis rumunëve dhe shqiptarëve të hershëm pati mundësi shqipja të ndikonte dhe pastaj te rumunët, te bullgarët. U përgjithësua prapavendosja e nyjes në gjuhët e Ballkanit. Pra, një proces më kompleks. Teoria për prejardhjen trakase të shqipes mund të jetë një episod interesant për studimet e gjuhësisë, por mua më duket se nuk qëndron. Ndërkaq, hipotezë e mundshme mbetet kjo për prejardhjen ilire, me edhe një mundësi që e ka përmendur Benveniste pak më herët në skicën e tij, ndërsa Hans Krahe më 1970 thoshte se shqipja mund të ishte gjuhë e veçantë, as ilirishte, as trakishte, por albanishte e veçantë. Në frymën e grupimeve IE diçka të ngjashme thoshte edhe Hamp derisa ngulte këmbë tek Protoalbanoidi i tij, të cilin pastaj konceptualisht e afronte me dakomezishten në frymën e Georgiev-it, por të ndryshme nga trakishtja. Kësaj i shtohet edhe koncepti i tij për NWIEE, por edhe për lidhjet e parashqipes me mesapishten. Koncepti për Balkanindogermanisch, që afronte më shumë greqishten, armenishten, trakishten duket më vështirë i përshtatshëm në këto rrjedha idesh.

Dhe në këtë fazë mendoj se është i drejtë qëndrimi sipas të cilit duhet të nisemi - ashtu siç thoshte Pisani – nga vendi dhe me argumentet e tjera të themi se shqipja është pasardhëse e ilirishtes.

## Bibliografi

ANAMALI, S. & BIÇOKU, K. & DUKA F. & ISLAMI, S. & KORKUTI, M. & NAÇI, S. & PRENDI, F. & PULAHA, S. & XHUFI, P. (2002): **Historia e popullit shqiptar**, Vëllimi i parë, Toena, Tiranë.

ANAMALI, S. (1984): *The problem of the Formation of the Albanian People in the Light of Archaeological Data*, në **Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture**, Tirana, 65-94;

BADER (1997), Françoise: **Les langues indo-européennes**, Paris, 1997. I dobishëm, hyrje e avancuar, pas gjuhëve. Ka për shqipen.

BANFI (1972), Emanuele: **Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della Via Egnazia)**, në Istituto Lombardo - Academia di Scienze e lettere, Estratto dai rendiconti. Classe di lettere, v ol. 106, Milano, ff. 185-233.

BARIĆ, H. (1954a): Poreklo Arbanasa u svetlu vezika, në **Lingvističke studije**, Sarajevo, 1954, 7-48.

BARIĆ, H. (1955): **HËmje në historín e gjuhës shqipe**, Mustafa Bakija, Prishtinë, 1955;

Bednarczuk (1986), L.: *On the development of the Indo-European Syllabic Sonants in Balto-Slavic and Albanian*, **Acta Balto-Slavica**, 17, 77-83;

BENVENISTE, Emile: **Le vocabulaire des institutions indo-européennes I-II**, Paris, 1969.

BIRNBAUM (1985), Henrik: *New aproaches to Balkan linguistics*, **Zbornik u čast Petru Skoku**, JAZU, Zagreb, 79-87.

BREIDAKS, A. *Concerning the parallels between Baltic and ancient Balkan languages*, **Linguistique balkanique**, 33 (1-2), 43-53;

BUDA shih ANAMALI, S. & BIÇOKU, K. & DUKA F. & ISLAMI, S. & KORKUTI, M. & NAÇI, S. & PRENDI, F. & PULAHA, S. & XHUFI, P. (2002): **Historia e popullit shqiptar**, Vëllimi i parë, Toena, Tiranë, 2002, 39-195;

BUDA, A. (2006): Studime historike, ASHAK, Prishtinë.

BUDA, A.: *Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë*, në BUDA, A. (2006).

BUDA, A.: *Ilirët e jugut si problem i historiografisë*, BUDA, A. (2006).

BUDA, A.: *Vështtrim mbi historinë e shqiptarëve dhe të kulturës së tyre*, 11-18; *Vendi i shqiptarëve në historinë evropiane të shekujve VIII-XVIII*, 78-101, J. F. Falmerajer dhe historia mesjetare e shqiptarëve, 102-118 në BUDA, A. (2006).

Çabej (1962), E.: *Zur Charakteristik der Lateinischen Lehnwörter der Albanischen*, **Revue de ling.** 7, București, 161-199;

- ÇABEJ, E. (1970): L'Illyrien et l'Albanais. Questions de principe, *Studia albanica*, 1, 157-170, etj.
- ÇABEJ, E. (1972): *Le problème du territoire de la formation de la langue albanaise*, Bulletin de l'Association Internationale d'Etudes du Sud-Est-Européen X, 2, Bucarest, 71-99;
- ÇABEJ, E. (1976): *Hyrje në historinë e gjuhës. Fonetika historike*, **Studime gjuhësore III**, Rilindja, Prishtinë, 7-146.
- ÇABEJ, E. (1976a): **Studime gjuhësore III**, 1976.
- CAMARDA, D. (1864): **Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese**, Livorno, borim i ri Palermo, 1989;
- ĆIRKOVIĆ, S. (1988): Albanci u ogledalu južnoslovenskih izvora, në GARAŠANIN, M. (Ured.): **Iliri i Albanci**, SANU, Beograd, 1988, 323-340, në vijim përkthimi frëngjisht.
- CLEWING, K. (2005): An den Grenzen der Geschichtswissenschaft: Thraker und Illyrier, in GENESIN, M. und MATZINGER, J. (Hrsg.) **Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler**, Hamburg, 2005, 215-225.
- ĆOROVIĆ, V. (1928): **Spisi sv. Save**, ed. V., Beograd-Sr. Karlovci, 1928, 151-152.
- DEMIRAJ, Sh. (1989): **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Rilindja, Prishtinë, 1989.
- DEMIRAJ, Sh. (1999): **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe**, Tiranë, 1999.
- DENSUSIANU, **Histoire de la langue roumaine I**, Bucuresti, 1929.
- DESNICKAJA, A. V. (1984): Drevnye balkano-baltijskie sootvestvija i albanskij jazyk, **Baltisitca XIX** (1), 15-22; rimarrë te Sravnitel'noe jazykoznanije i istorija jazykov, Moskva, 1984, 214-215).
- DESNICKAJA, A. V. (1987): *K probleme obrazovanija albanskogo jazyka i albanski narodnosti. O latinskih elementah albanskoi leksiki*, në **Albanskaja literatura i albanskij jazyk**, 1987;
- DOMI, M. (1984): *Problems of the History of the Formation of the Albanian Language, achievements and tasks*, The Academy of Sciences of the People's Republic of Albania: **Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture**, 8 Nëntori, Tirana, 1984, 35-64;
- DU NAY (1977), André: **The early History of the Rumanian Language**, Lake, Bluff, Illinois.
- DURIDANOV (1976), Ivan: *Ezikat na Trakite*, Sofia.
- DURIDANOV (1999), Ivan: *Thrakisch, Dakisch, Illyrisch*, në *Handbuch der Suedoosteuropalinguistik*, hsg. U. Hinrichs, Wiesbaden 1999, 733-
- Eric P. Hamp, Indo-European \*laugh- in the Ponto-Baltic Region, *Ponto-baltica* 2-3, 1982-83, Academia Toscana di Scienze e lettere "La Colombaria", ff. 7-8.
- GARAŠANIN (1988a), M. (Urednik): **Iliri i Albanci**, SANU, Beograd.
- GARAŠANIN, M. (1988): *Nastanak i poreklo Ilira*, në GARAŠANIN (1988a), 9-80.

- GEORGIEV, VI. (1957): **Trakijskijat ezik**, Bŭlgarska Akademija na Naukite, Sofija, 1957.
- GEORGIEV, VI. (1960): *Albanisch, Dakisch-Mysisch und Rumänisch*, **Linguistique balkanique** 2, 1960, ff. 1-19.
- GEORGIEV, VI. (1977): **Trakite i tehrijat ezik**, Bŭlgarska Akademija na Naukite, Sofija, 1977;
- GRAUR (1936), Al.: *Coup d'oeil sur la linguistique balkanique*, **Bulletin linguistique**, București-Paris (I- 1933- XV/XVI 1948), IV, 31-45.
- HAARMANN (1972), Harald: **Der Lateinische Lehnwortschatz im Albanischen**, Hamburg 1972.
- HAMP (?): *Biso*, **Actes du XIe Congrès int. des Sciences Onomastiques**, t. 1, Sofia , 367-369.
- HAMP (1957), Eric P.: *Albanian and Messapic*, në **Studies presented to Joshua Whatmough**, 73-89;
- HAMP (1960), Eric P.: *Palatal before resonant in Albanian*, **KZ** 76, 257-280;
- HAMP (1960a), **KZ** 76, 275-80.
- HAMP (1961), Eric P.: *Albanian be, besë*, **KZ** 77, 252-253;
- HAMP (1961a), Eric P.: *Indo-European bhendh in Albanian*, **KZ** 77, 253-254;
- HAMP (1965), Eric P.: *Evidence in Albanian*, në **Evidence for Laryngeals**, The Hague, 123-141;
- HAMP (1966), Eric P.: *The position of Albanian*, **Ancient Indo-European Dialects**, Berkeley, 97-122, shqip te **Studime për shqipen** ASHAK, Prishtinë 2007;
- HAMP (1972), Eric P.: *Albanian*, në **Current trends in linguistics**, Hague, 1626-1692;
- HAMP (1978b), Eric P.: *Strunga*, **Balkansko ezikoznanie** 20, 115-119;
- HAMP (1980), E. P.: *Thracian, Dacian and Albanian-Romanian correspondences*, në **Actes du IIe congrès international de thracologie**, 1980, 575-60;
- HAMP (1981), E. P.: *On the distribution and Origin of (b)urda*, **Linguistique balkanique XXIV**, 3, 47-50.
- HAMP (1981a), Eric P.: *Autochthonous vatra*, **RRL** 24, 315;
- HAMP (1982), E. P.: *The Oldest Albanian Syntagma*, **Linguistique balkanique XXV**, 77-79.
- HAMP, E. P. (1957): *Albanian and Messapic*, në PULGRAM, E. (Ed.): **Studies Presented to Joshua Watmaugh on his sixties birthday**, 'S-Grevehage, 73-89, shih përktimin shqip te Hamp (2007), 147-170.
- HAMP, E. P. (1973): *On Baltic, Luwian and Albanian participles in \*-m*, **Baltistica** IX (1), 45-50;

HAMP, E. P. (1981): *On the distribution and Origin of (b)urda*, **Linguistique balkanique XXIV**, 3, 1981, 47-50. Shih përkthimet shqip te HAMP, E. P.: **Studime krahasuese për shqipen**, ASHAK, Prishtinë, 2007.

HAMP, E. P. (1982): *Indo-European \*leugh- in the Ponto-Baltic Region*, **Ponto-Baltica**, 2-3, 7-8; *Indoeuropäania \*leugh- në shqipen*, HAMP (2007), 407;

HAMP, E. P. (1988): *Northwest Indo-European 'spoon'*, në **Studies in Anatolian, Italic and the Indo-European Languages**, ed. By Yoël L. ERBEITMAN, Louvain-la-Neuve, 501-504, të gjitha të rimarra shqip në Hamp (2007).

HAMP, E. P. (2007): **Studime krahasuese për shqipen**, ASHAK, Prishtinë.

HAMP, E.: *Biso*, në **Actes du XIe Congrès international des Sciences Onomastiques**, t. 1, Sofia , 367-369;

HAMP, Eric P. (1978a): *Strunga*, **Balkansko ezikoznanie** 20, 1978, 115-119;

HULD, M. (1984): **Basic Albanian Etymologies**, Ohio, 158-170.

ISMAJLI (1987), Rexhep: **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Prishtinë, 34-35.

ISMAJLI, R. (1966): *Balkanistika dhe prejardhja e shqipes*, **Studime** 3, Prishtinë, 1997, 255-274.

ISMAJLI, R. (1987): *Prejardhja e gjubës shqipe*, në **Artikuj për gjuhën shqipe**, Rilindja, Prishtinë, 1987, 9-41;

JIREČEK (1901), Konstantin: **Die Romanen in den Staedten Dalmatiens des Mittelalters I**, Wien, 13.

JIREČEK: *Albanien in der Vergangenheit*, **Illyrsch-albanische Forschungen**, München-Leipzig 1916.

JOKL, N. (1917): *Albanisch*, in W. STREITBERG (Hgg.) **Die Erforschung der indogermanischen Sprachen**, Bd. 3 (Slavisch Litauisch, Albanisch), Strassburg, 1917, 109-154.

JOKL, N. (1924): *Albaner*, in M. EBERT (Hgg.) **Reallexicon der Vorgeschichte**, Bd. 1, 84-94.

JOKL, N. (1926): *Griechisch-albanische Studien*, in **Festschrift für Paul Kretschmer**, Wien-Leipzig-New York, 78-95.

JOKL, N. (1927): *Altmakedonisch-Griechisch-Albanisch*, **Indogermanische Forschungen** 44, 13-70.

JOKL, N. (1929): *Zur Vorgeschichte des Albanischen und Albaner*, in **Wörter und Sachen** 12, Heidelberg, 63-91.

JOKL, N. (1963): *Die Verwandtschaftsverhältnisse des Albanischen zu den übrigen indogermanischen Sprachen*, **Die Sprache** 9, 113-156.

JOKL, N. (1984): **Sprachliche beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel (Zur Frage der ältesten griechisch-albanischen Beziehungen)**, Aus dem Nachlass herausgegeben von O. PFEIFFER, Wien;



- KLEPIKOVA (1973): *Iz Karpato-Balkanskoj terminologii vysokogornogo skotovodstva. 2. Vatra*, **Balkanskoe jazykoznanie**, Moskva, 149-169.
- KLINGENSCHMIT, G.: *Albanisch und Urindogermanisch*, in **MSS** 40, 93-131;
- KLINGENSCHMITT, G. (1994): *Das albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*, in Rasmussen, J. E. (Hrsgb.) *In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 221-233;
- KLINGENSCHMITT, G. (1994a): *Die verwandschaftsverhältnisse der indogermanischen Sprachen*, in RASMUNSEN (Hrsg): **In honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden, 235-251,
- KORTLAND, F. (1986): *Albanian and Armenian*, në LEROI, Maurice-MAWET, Francine (Hgg.), **La place de l'arménien dans les langues indoeuropéennes**, Louvain, 1986, 38-47.
- KRAHE (1964), Hans: *Die Sprache der Illyrier*, vol. I 1964, pp. 27-8.
- LIUKKONEN, K.: *Albano-balto-slavjanskeje etimologiji*, **Scando-slavica**, 35, 197-202;
- LOMA, A. (1991): *Sloveni i Albanci do XII veka u svetlu toponomastike*, në **Stanovništvo slovenskog porekla u Albaniji. Zbornik radova sa medjunarodnog naučnog skupa održanog u Cetinju 21, 22 i 23. juna 1990**, Titograd, 1991, 279-327.
- MALKOLM, N.: **Kosovo. A Short History**, Macmillan, 1998, bot. Papermac, London-Oxford, 1998.
- MALLORY, J.P. 1989): **In the Search of the Indo-Europeans. Language, Archaeology and Myth**, Thames & Hudson Ltd. London, 1989, repr. 2001, f. 91.
- MANSAKU, S. (1995-1999): *Problèmes de l'histoire de l'albanais à la lumière de ses relations avec le grec*, **Studia albanica**, 111-124;
- MANSAKU, S. (1997): *Quelques caractéristiques des éléments du grec ancien en albanais*, **Zeitschrift für Balkanologie** 33, 182-186.
- MARTINET, André: **Des steppes aux océans. L'indo-européen et les "Indo-Européens"**, Paris, Payot, 1986.
- MATASOVIĆ (2008), R.: **Poredbeno povijesna gramatika hrvatskoga jezika**, Matica hrvatska, Zagreb, 2008.
- MATZINGER, J. (2006): **Der Altalbanische Text [e] Mbsuame e krështerë (Dottrina cristiana des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft**, Dettelbach, 47-92.
- MATZINGER, J. (2005): *Messapisch und Albanisch*, në **International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction** 2, 2005, 29-54.
- MATZINGER, J. (2009): *Die Albaner als Nachkommen der Illyrier aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft*, në O. J. SCHMITT & E. A. FRANTZ (Herausg.): **Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung**, München, 13-36.
- MAYER, H. (1982): *Dacian, Thracian as Souther Baltoitic*, **Lituanus** 38, no. 2;
- MAYER, H. (1991): *Reflexes of Indo-European Syllabic Resonants in Baltic, Slavic and Albanian*, **Lituanus** 37, no. 4;
- MAYER, H. (1991a): *Tokharian and Baltic versus Slavic and Albanian*, **Lituanus** 37, no. 1;

- MAYER, H. (1993): *Slavic, a Balticized Albanian?*, **Lituanus** 39, 2;
- MAYER, H. (1997): *Balts and Carpathians*, **Lituanus** 43, no. 2;
- MAYER, H. (2003): *Shifts in early albano-slavic syllable boundaries*, **Lituanus** 49, no. 3;
- MEYER, G. (1884): *Die Stellung des Albanesischen im Kreise der indogermanischen Sprachen*, BB, Göttingen, 1884, 185-189, **Essays und Studien**, Bd. I, Berlin 1885, 52-56. BB 8, 185-189.
- MEYER, G. (1885): **Essays und Studien**, Bd. I, Berlin 1885, 52-56. BB 8, 185-189
- MEYER, G. (1891): **Albanesische Studien III**, Jena, 1891;
- MIHĂESCU (1966), Haralambie: *Les éléments latin de la langue albanaise*, **Revue des études sud-est européennes** 1-2-3-4, Bucuresti;
- MIHĂESCU (1981), H.: *Local elementelor latine din limba albaneza in cadrul romanității sud-est europene*, **Semantica și semiotica**, București, 216-235;
- MIKLOSICH, F. (1858): **Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae Bosnae Ragusii**, Vindbonae 1858, 4;
- OREL (1993), V.: *Albanian and Indo-European*, In honorem Holger Pedersen, 1993, Wiesbaden;
- OREL (1998), V.: *Albanian Etymological Dictionary*, Leiden, Boston, Koeln, Brill, 1998;
- OREL, V. (1993): *Albanian and Indo-European*, **In honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden;
- OREL, V. (1998): **Albanian Etymological Dictionary**, Leiden, Boston, Koeln, Brill;
- PAPAZOGLU, F. (1988): *Ilirska i dardanska kraljevina*, në GARAŠANIN (1998a), 145-172.
- PEDERSEN, H.: *Albanesisch und Armenisch*, **KZ** 36, 1900, 340-341;
- PEDERSEN, H.: **Studime për gjuhën shqipe**, ASHAK, Prishtinë, 2003, 115-117;
- PELLEGRINI, G. B.: **Avviamento alla linguistica albanese**, Università degli studi della Calabria, Rende, 1998, 69-76.
- PHILIPPIDE (1925), A. : **Originea românilor I**, Iași, 1925, 71 deh
- PISANI (1950), Vittorio: *L'albanais et les autres langues indoeuropéennes* në *Annuaire de l'Institut de Philologie et d'histoire orientales et slaves*, t. X, Mélanges Grégoire II, Bruxelles.
- PISANI (1964), Vittorio: *Les origines de la langue albanaise. Question de principes et de méthode*. *Studia Albanica* 1, ff. 61-68.
- POPOVIĆ, I. (1958): *Slaven und Albaner in Albanien und Montenegro*, **Zeitschrift für slavische Philologie** 26, 1958, 301-324.
- POPOVIĆ, I. (1960): **Geschichte der serbokroatischen Sprache**, Wiesbaden, 1960.
- POPOVIĆ, V. (1988): *Albanija u kasnoj antici*, në GARAŠANIN, M. (Ured.): **Iliri i Albanci**, SANU, Beograd, 1988, 201-250.
- POPOVIĆ, V.: *Albanija u kasnoj antici*, në GARAŠANIN, M. (Urednik): **Iliri i Albanci**, SANU, Beograd, 1988, ff. 201-250.

PRENDI, F. & ZHEKU, K. (1984): *The Illyrian-Arbër Ethno-cultural Continuity in the City of Lissus*, në **Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture**, Tirana, 109-116.

RĂDULESCU, M. M.: *The Indo-European Position of Messapic*, në **Journal of Indo-European Studies**, 22, 1994, 329-344;

RAMOVŠ, F. (1936): **Kratka zgodovina slovenskega vezika I**, Znanstvenoraziskovalni center SAZU, Ljubljana 1995;

RENFREW, C. (1990): **Archeology and Language, The Puzzle of Indo-European Origins**, 1987, përkthimi frëngjisht: C. RENFREW: **L'énigme indo-européenne. Archéologie et Langage**, trad. Michèle Miech-Chatenay, Flammarion, Paris, 1990.

RIZA, S. (2004): *Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjubës shqipe me greqishten*, **Vepra 4**, ASHAK, Prishtinë, 2004, 91-114;

SCHMITT, O. J. & FRANTZ, E. A. (2009) (Herausg.): **Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung**, Oldenburg, München.

SCHRAMM, G. (1981): **Eroberer und Eingessene. Geographische Lehnnamen als Zeugen der Geschichte Südosteuropas im ersten Jahrtausend nach Chr.**, Stuttgart, 1981;

SCHRAMM, G. (1999): **Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen**, Freiburg/ Br.;

SCHRAMM, G. (2006): **Fillet e krishtërimt shqiptar**, përkthimi shqip nga S. Gashi, Albanisches Institut, St. Gallen, 2006, ff. 316;

SCHUCHARDT (1868), H.: **Vokalismus des Vulgärlateins III**, Leipzig, 46.

SERGENT (1995), Bernard: **Les Indo-européens: histoire, langues, mythes**, Paris, Payot-Rivages, 1995.

SKOK (1931), Petar: *Byzance comme centre d'irradiation pour les mots latins des langues balkaniques*, **Byzantion VI**, 371.

SKOK (1934), Petar: *Zum Balkanlatein IV*, **Zeitschrift für romanische Philologie**, **LIV**, 175-215

SOLOVJEV, A. (1926): **Odabrani spomenici srpskog prava (od 12 do kraja XV veka)**, Beograd, 12.

SOLTA (1980), R. S.: **Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen**, Darmstadt.

STADTMÜLLER, G. (1950): **Geschichte Südosteuropas**, München, 10-11.

STADTMÜLLER, G. (1966): **Forschungen zur albanischen Frühgeschichte**, Harrassowitz, Wiesbaden.

STOJANOVIĆ, Lj. (1934): **Stare srpske povelje i pisma II**, Beograd-Sr. Karlovci 1934;

TAGLIAVINI, **Rivista d'Albania III**, Roma, f. 4.

TAGLIAVINI (1941), Carlo: *Gli elementi latini nell'albanese*, **Cultura neolatina I, II**, 1941, ff. 90-94.

THALLÓCZY, L. & JIREČEK, C. & ŠUFFLAY, E. (1918): **Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia II**, Vindobonae.

TOPOROV, V. N.: *Balto-albanica*, **Acta Balto-slavica** 17, 275-293.

USPENSKIJ, F. (1902): **Izvestija ruskogo arheologičeskogo instituta v Konstantinopolu** 7, 1902 11, sl. 5. Cf. **Acta Albaniae I**, nr. 163. f. 330.

VELKOVA (1986), Z.: **The Thracian Glosses**, Amsterdam, 1986.)

WEIGAND, G. (1927): *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?*, **Balkan-Archiv** 3, 1927, 227-251, përthimi shqip nga A. Xhuvani te **Dituria**, 8, 291 dhe 9-11, 333-334, 1928, Tiranë.

WITCZAK (1994), K. T.: *Proto-Albanian and the Problem of the Ethnogenesis of the Albanian Nation*, **Biuletin polskiego towarzystwa językoznawczego** L, 1994, ff. 21-26;

WITCZAK, K. T. (1995): *Where the Bessans ancestors of the Albanians?*, *A new Opinion on the Ethnogenesis of the Albanian nation*, **Thraco-Dacica** 16, 1-2, 309-312.

**Bashkim KUÇUKU**

## **DINAMIKA E IDENTITETIT SHQIPTAR NË BASHKËKOHËSI**

Çështjet:

1. Problemi i identitetit në Europën bashkëkohore. Teoria, politika dhe realiteti.
2. Identiteti shqiptar në bashkëkohësi.
3. Situata, gjendja.
4. Mbarëvajtje në rrjedhën e sotme.
5. Rreziqe të zhbërjes.
  - A. Rreziku nga copëzimi politik-shtetëror.
  - B. Rreziku nga emigracioni ekonomik.
  - C. Mungesa e organizimit për vetëruajtje.
6. Gjuha dhe letërsia mbartëse dhe pohuese/afirmuese të identitetit shqiptar.

Problemi i identitetit në Europën bashkëkohore. Teoria, politika dhe realiteti

Në politikat e përgjithshme për konsolidimin e Bashkësisë Europiane, vend të posaçëm zenë politikat për shmangien e konflikteve, afrimin dhe harmonizimin e identiteteve kombëtare, të cilët, duke qenë në nyjen kyç të procesit të integritimit, përbëjnë njëkohësisht edhe problemin me zgjidhjen më të vështirë.

Trajtimet teorike dhe qasjet praktike janë të ndryshme, sepse çdo komb ka historinë, traditat, kulturën, përvojat, mendësitë, dinjitetin dhe ndjeshmërinë e vet, me të cilat është i lidhur ngushtësisht, qoftë prej ekzistencës/qeniesisë shekullore, qoftë edhe për arsye psiko-morale. Dhe, po ashtu, secili ka një pozicion të caktuar dhe marrëdhënie të dallueshme me tërësinë e Europës.

Në botën shqiptare me magësi kulturore, historike dhe politike të theksuara, me mendësi e praktika veçan Europës, madje dhe vendeve të tjera ballkanike, të mbuluar nga reja e dendur e demagogjisë kozmopolite dhe gjoja kozmopolite, në të vërtetë e qëllimshme kundërshqiptare, *është e domosdoshme të sqarohet, nëse identiteti dhe vetëdija kombëtare janë pjesë e qeniesisë/ekzistencës bashkëkohore apo i takojnë së kaluarës.* E thënë më shqip, e më konkretisht, nëse, sot, jemi e jetojmë si shqiptarë *apo bëjmë, se jemi dhe i bëjmë qejfin vetes se jetojmë si europianë dhe gjithëkë kombëtare e kemi humbur dhe duhet ta humbasim për t'u dukur si europianë,* për të qenë më të pranueshëm prej të tjerëve, për mos të na përbuzur

prej mbrapshtive tona dhe për të na pranuar formalisht kandidatë në Bashkimin Europian? Dhe, për më keq! *A është normale, kur, edhe pas njëqind vjetësh të formimit të shtetit të parë shqiptar, qindra mijëra janë regjistruar e duan të regjistrohen grekë, serbë, maqedonas, turq, bullgarë, për të përfituar lehtësi përditshmërie? Po ligjet e miratuar nga dy Kuvendet e qeveritë, duhet t'i hapin apo t'i mbyllin dyert kësaj hemorragjie të paparë?*

Edhe në vendet më të përparuar, problematika e madhe e tyre është në qendër të vëmendjes, trajtohet dhe ritrajtohet e shkallëzuar, në rrafshet: politike, ekonomike, sociologjike, kulturore, psikologjike, etj. Nuk është e rastit, që, në këto 20 vjet, bibliografia e kësaj literature është pasuruar ndjeshëm, me dhjetra tituj, në gjuhët më të ndryshme.

Prej saj, të viteve më të fundit, do të citohen dy autorë me formime kulturore dhe identitete kombëtare të ndryshme, njëri amerikan, Erik Hobsbaum, dhe tjetra franceze, Anne-Marie Thiesse. Sipas librave të tyre, kombet, identitetet kombëtare dhe shtetet-kombe nuk janë zhdukur, ata vazhdojnë të jenë ende të fuqishëm e përcaktues në ekzistencën/geniesinë njerëzore, në organizimin shoqëror, qytetar dhe shtetëror.

Historiani i mirënjohur Erik J.Hobsbaum, të cilin disa specialistë e quajnë të madh, në librin “Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780-a, programi, miti, realiteti”, shkruan, se, separatizmi kombëtar, në fundin e shekullit XX, ka qenë më i theksuar se në fillim të tij.

*“Qëkurse ky libër (“Kombet dhe nacionalizmi”), shkruan ai, është botuar për herë të parë aty nga fillimi i 1990-s, të tjera shtete-kombe të reja janë formuar, ose janë në formim e sipër, më shumë se në çdo periudhë tjetër të këtij shekulli. Nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe e Jugosllavisë janë shtuar deri tani gjashtëmbëdhjetë entitete sovraane të njohura në shkallë ndërkombëtare dhe nuk ka ndonjë kufi lehtësisht të parashikueshëm për vazhdimësinë e mëtejshme të separatizmit kombëtar.”*

1)

Politikanët, sociologët, legjislacioni bashkëkohor, institucionet shtetërore dhe qytetare, mediat dhe shkollat, institucionet fetare dëshirojnë dhe propagandojnë gjithnjë e më tepër tolerancën, bashkëjetesën, ndihmën e ndërsjelltë dhe harmoninë e identiteteve, kulturave dhe të besimeve. Edhe për këtë mjedis botëror, vazhdimisht të përpunueshëm për bashkëjetesë ndërientitare dhe ndërkombëtare, Hobsbaum-i bën një pohim të frikshëm, gati, tmerrues: “*Ksenofobia, e cila lehtësisht kalon në racizëm, që është një dukuri më e përhapur në Europën dhe Amerikën Veriore të viteve 1990 nga sa ishte në kohën e fashizmit, është edhe më pa bazë për nga përmbajtja e mundshme si program historik se sa nacionalizmi i Maxinit.”* 2) Megjithëse, ai mendon, që, edhe tani, shtetet-kombe nuk janë në përputhje me qytetërimin bashkëkohor, me gjendjen e shoqërisë njerëzore në përgjithësi dhe të çdo kombi-shtet në veçanti, në mbyllje të librit, është i detyruar të pohojë: “*E tërë kjo nuk do të thotë se nacionalizmi nuk është shumë i rëndësishëm në politikën botërore në ditët e sotme,*

ose që është më pak i rëndësishëm se dikur. Ajo që dua të theksoj është se pavarësisht nga roli i tij i privilegjuar, nacionalizmi është bërë historikisht më pak i rëndësishëm.”<sup>3)</sup>

Edhe për Anne-Marie Thiesse në librin “Krijimi i identiteteve kombëtare, Europa e shekullit XVIII-XX”, botuar për herë të parë më 1999, identitetet kombëtare janë gjallëruar edhe përballë globalizmit të sotëm: *“Identitetet kombëtare, a janë të kërcënuar nga globalizmi? Në çdo rast, ato kanë gjetur hëpërbë një gjallëri të re falë ndërmjetësit planetar, simbol të ndryshimeve në rrugë e sipër.”*<sup>4)</sup> Ajo i shikon kombet dhe identitetet kombëtare ende të fortë, të domosdoshme dhe të pazëvendësueshme.

*“Nëse tërësia mbikombëtare e Bashkimit European bëhet një hapësirë juridike, ekonomike, financiare, politike, monetare: kjo nuk është një hapësirë identitare. Asaj i mungon kjo pasuri simbolike, nëpërmjet së cilës, kombet kanë ditur t’u propozojnë individëve një interes të përbashkët, një vëllazëri, një mbrojtje, nënvizon ajo. Tërheqja në identitetet kombëtare si tek një strehë, është gjithësesi e kapteshme: Euro nuk përbën një ideal. Po sikur Baballarët e Europës ta kenë themeluar atë duke barruar ta ndërtonin?”*<sup>5)</sup>

Bashkimit European, që po krijohet, i mungon njësia identitare. Dhe, kjo është mungesa kryesore e tij. Ndryshe nga Europa e djeshme, që përbëhej nga shtetet-kombe, më shumë të mbyllur se të hapur me të tjerët, Europa e sotme është një bashkësi shtetesh me ligje, ekonomi, financë, politikë, monedhë, parlament dhe qeveri të përbashkët, sipas konceptit modern të ekonomisë- botë, për të krijuar mirëqenie sa më të lartë dhe qarkullim të lirë të njerëzve dhe të kulturave. Për Anne-Marie Thiesse, megjithë këto epërsi, asaj i mungojnë ato që ka kombi, e, mbi të gjitha, identiteti i përbashkët. *“Europa po merr një strukturë të paracaktuar për t’i u përgjigjur sfidave të ekonomisë- botë. Konceptimi i saj rrjedh nga ai i shteteve. Bashkimi European shpall rregullore të përbashkëta, vendos në territorin e tij qarkullimin e lirë të njerëzve dhe të mallrave, nxjerr një monedhë; ai ka një parlament dhe një ekzekutiv. Por nga ana tjetër i qëndron si mangësi gjithë sa i përket një kombi: një identitet i përbashkët, përngjitja ndaj një territori të përbashkët, ideali i ndarë bashkërisht i një vëllazërie solidare. Europeanët, në gjendjen e tanishme të gjërave duken sa të pajisur me identitet kombëtar aq edhe të shpajisur me identitet european.”*<sup>6)</sup>

Europeanët kanë identitete kombëtare, por nuk kanë identitet european, atë që synohet. Përfundimi prej këtij krahasimi është i qartë. Ata, që e humbin, në fazën e tanishme, identitetin kombëtar, do të mbeten pa identitet.

Me përparimin e integritimit, të hapjes gjithnjë e më të madhe ndaj të tjerëve, vitet e fundit, në vendet e Europës Perëndimore, ndjenja kombëtare, frika e kujdesi për të ruajtur identitetin, traditën dhe kulturën përkatëse janë në rritje. Në Francë, p.sh., që, për vet historinë e brendshme dhe marrëdhëniet me kombet, identitetet e tjera fetare e kulturore edhe jashtë Europës, ka qenë dhe është më e hapur e më pranuese ndaj tyre, ndjenja e krenarisë të të qenit francez është ngjitur në shkallaren më të lartë. Një shkrim

i specialistëve Bruno Cautrès (“Qendra Shkencore e Kërkimeve Politike”) dhe Céline Belot (“Qendra Kombëtare e Kërkimeve Shkencore”), botuar tek “Le Monde” 7), ku pasqyrohen përfundimet e një ankete, ka këtë titull: “Më krenar për qenien franceze, por më pak ksenofob”. Në të krahasohet dinamika e ndjeshmërisë kombëtare të francezëve në vitet 2000, me vitet 1981 dhe 1970. Në artikull pohohet, më 2008-ën,

*“Franca paraqet një paradoks të dukshëm: ndërsa (kur) norma kundërraciste përparon dhe vlerat e tolerancës forcohen, ndjenja e krenarisë kombëtare rritet dhe hapja në Europë është burim i shqetësimeve të thellë. Paradoks apo pamje e kundërt e të njëjtës dukuri?”* 8)

Integrimi dhe ndjenja e identitetit kombëtar, sidoqoftë, janë ballë për ballë. Mund ta nxisin për mbrojtje e zhvillim, po ashtu, mbase, edhe më shumë, mund ta kufizojnë, tkurrin e çenojnë, pse jo edhe ta shpërbëjnë, në masa të ndryshme, njëri tjetrin. Së paku, në Francë, përparimi i integritit nuk e ka dobësuar, përkundrazi, e ka rritur, saktësisht, sipas artikullit, *ka një kthim të saj me forcë*. Integrimi, pavarësisht prej vlerave humane që sjell, vazhdimisht e rrezikon identitetin kombëtar, nëse nuk janë kushtet dhe kujdesi i ruajtjes së tij. Prandaj, 53% e francezëve kanë frikë se integrimi evropian shpie në humbjen e pushtetit të Francës në botë, dhe 54% se e dobëson **identitetin dhe kulturën kombëtare**.

Në vitin 1981, në 100 francezë 82 shpreheshin se ishin krenarë që ishin francezë. Megjithëse shifra ishte e lartë, ka patur një zbritje relative, në krahasim me vitin 1970, si në shumë vende europiane.

Më 2008 për këto rreziqe e frikëra, ngrihet në pikën më të lartë.

**Në 100 francezë ndjehen krenarë 90.** Dhe, në këta, 39 ndjehen shumë krenarë.

Më e rëndësishmja është, se, ndryshe nga herët e tjera, ndjenja shumë fortë e identitetit kombëtar është më e njëzëshme/më unanime. Prej këtyre të dhënave është arritur në përfundimin, se, në këto tridhjetë vjetët e fundit, *Franca ka qenë më e hapur, më tolerante dhe më “huamniste”, ka ditur t’i shprehë vlerat e saj me një ndjenjë të fortë të përkatësisë kombëtare*. Ndjenja e fortë e përkatësisë kombëtare është mbi integritimin, mbi vlerat e tolerancës bashkëkohore.

Procesi i deritanishëm i integritit ka treguar se “kombet e vjetër” mundet të bashkëpunojnë. Nga veçimi e mbyllja, madje kundërshtia dhe armiqësia e mëparëshme është kaluar në paqe, në mirëkuptim e bashkëpunim. Vetëm në rrethanat e këtij bashkëpunimi dhe nëpërmjet tij mund t’i kushtohen edhe një fati të përbashkët, i cili nuk mohon dallimet dhe thellësitë e historive përkatëse, të pacënueshme dhe vlerat qeniesore të tyre.

*Ndjenat e përkatësisë kombëtare dhe europiane*, më shumë se konkurrencte, specialistët e lartpërmendur i shikojnë, se, *bashkëjetojnë, bashkohen e mblidhen*. Përveç kësaj, jo pak fakte kanë treguar dhe vazhdojnë të tregojnë se kombëtarizmi ka kaluar në **racizëm**, si



dikur para 50 vjetësh. Mund të kujtohet për këtë, mes të tjerave, videoja me marshin e kënduar të ushtarëve grekë dhe kënga e detarëve në paradën zyrtare në Athinë, të cilët, me fjalët raciste më fyese, hapur shqiptojnë, se, shqiptarët duan t'i zhdukën, t'i rrjepin dhe t'i lidhin me zorrët e tyre!!!

Integrimi europian nuk është zhbërje, mohim e humbje e identiteteve kombëtare. Para së gjithash, është shmangie e armiqësive dhe e konflikteve, liri dhe kushte të përshtatshëm për zhvillimin e tyre dhe të pakicave, kudo qofshin dhe në çfarëdo gjendje të jenë, mbrojtje ligjore dhe praktike, bashkëjetesë dhe harmoni midis tyre. Ligjet, institucionet, mendësitë dhe praktikat mbikombëtare, nuk janë të papajtueshme dhe në konflikt, nuk i fshijnë dhe nuk i shkatërrojnë krejtësisht të mëparshmet, kombëtareshtetëroret. Disa i zëvendësojnë, të tjerë i zbusin dhe i zhvillojnë, në përputhje me to.

Është e pabesueshme, që, gjermanët, francezët, italianët, spanjollët, grekët, slovenët, etj., anëtarë të Bashkimit Europian, nuk jetojnë më, nuk organizohen shtetërisht e qytetarisht dhe nuk përjetojnë më, si gjermanë, francezë, italianë, spanjollë, grekë, slovenë, por thjesht si europianë, pa identitetin origjinar, të trashëguar dhe pa asnjë ndjeshmëri ndaj tij.

Shkencat shoqërore dhe psikologjike ende nuk kanë treguar, sepse është shumë herët, se sa janë bërë europianë këta qytetarë të Bashkimit Europian, dhe sa janë zhbërë kombëtarisht. Me sa shihet, në përditshmërinë e tyre, në kulturë e mënyrë jetese, në mediat dhe mjetet e tjerë të informacionit, vazhdojnë të jetojnë, të organizohen, të edukohen e të shkollohen, të përjetojnë si të tillë, sikurse më parë, veçse me më pak paragjykime, gjithnjë e më të hapur, të përgatitur për të pranuar e pranues të të tjerëve, pa ato ndarjet dalluese e përçmuese të skajshme. Identitetin, traditat, zakonet, të veçantat e tyre, në të menduarit e të sjellurit, në mënyrën e jetesës dhe të komunikimit, në kulturë e histori, në banesa e në veshje, në marrëdhënie me të huajt dhe me veten i propagandojnë me të gjitha mjetet moderne e gjithandej, jo vetëm pa frikën e përçmimit prej të tjerëve për këto “arkaizma”, por, përkundrazi, me ndjenjën e detyrimit të përkushtuar ndaj vetvetes dhe bashkësisë që i përket.

## **Identiteti shqiptar në bashkëkohësi**

### **Situata, gjendja**

Në botën shqiptare me magësi kulturore, historike dhe politike të mëdha, me mendësi e praktika veçan Europës, madje dhe vendeve të tjera ballkanike, të mbuluar nga reja e dendur e demagogjisë kozmopolite dhe gjoja kozmopolite me qëllime kundërshtqiptare, *është e domosdoshme të sqarohet, nëse identiteti dhe vetëdija kombëtare janë pjesë e qeniesisë/ekzistencës bashkëkohore apo i takojnë së kaluarës.* E thënë më shqip, e më konkretisht, nëse, sot, jemi e jetojmë si shqiptarë *apo hiqemi, se jemi dhe i bëjmë qejfin vetes*

*se jetojmë si europianë dhe gjithçka kombëtare e kemi humbur dhe duhet ta humbasim për t'u dukur si europianë, për të qenë më të pranueshëm prej të tjerëve, për mos të na përbuzur prej mbrapshtive tona dhe për të na pranuar formalisht kandidatë në Bashkimin Europian? Dhe, për më keq! A është normale, kur, edhe pas njëqind vjetësh të formimit të shtetit të parë shqiptar, qindra mijëra janë regjistruar e duan të regjistrohen grekë, serbë, maqedonas, turq, bullgarë, për të përfituar lehtësi përditshmërie? Po ligjet e miratuar nga dy Kuvendet e qeveritë, duhet t'i hapin apo t'i mbyllin dyert kësaj hemorragjie të paparë?*

Identiteti shqiptar në ditët e sotme është në një situatë dhe gjendje paradoksale. Nga njëra anë, është përgjithësisht i lirë, kur mund të shpërfaqet dhe të zhvillohet natyrshëm, dhe, nga ana tjetër, është i rrezikuar nga disa rrethana dhe faktorë të kësaj lirie, konkretisht nga ndërkomunikimi me identitete të tjerë, nga konkurenca ekonomike, kulturore e gjuhësore me ta, pa përmendur përplasjet me agresivitetin armiqësor të identiteteve të fqinjëve jugorë, veriorë e verilindorë.

Historikisht identiteti shqiptar, sikurse edhe i popujve të tjerë të pushtuar, ka qenë i rrezikuar nga mungesa e lirisë. Pavarësisht pushtimeve të ndryshme, të cilët nuk lejonin as shkrim-këndimin shqip deri në krijimin e shtetit të parë shqiptar më 1912, dhe, më pas, në trajta të moderuara të pushtimit, në trojet shqiptare në Kosovë, nën Maqedoni, Mal të Zi e nën Greqi në Çamëri, ai mbijetoi përmes një vetëmbrojtjeje e mbylljeje në vetvete të theksuar.

Në sistemin stalinist, në Shqipërinë shtetërore, propagandohej ruajtja e tij. Ato të dhëna që përputheshin me të apo i interesonin atij, u mbrojtën dhe përparuan, bie fjala, dashuria për atdheun dhe sakrifica në emër të tij, edhe pse barazohej me atdheun socialist, njohja e historisë së lashtë, mesjetës dhe kohëve moderne, përvetësimi dhe zhvillimi i traditave kulturore dhe artistike, popullore e të kultivuara, sidomos të Rilindjes Kombëtare, zhdukja e paragjykimve për ndarjet dhe përçarjet fetare. Të dhëna të tjera, që nuk i interesonin u mënjantuan ose u tjetërsuan. Ndhimesat e çmuara atdhetare të klasave të larta, portretet e figurave të tyre të shquara, traditat dhe zakonet fetare, afria dhe ngjashmëritë me identitete të tjerë, përfutur prej historisë së përbashkët dhe bashkëjetesës në fqinjësi, ose nuk përmendeshin, ose negativizoheshin.

Ishte më e lehtë të ruhej identiteti në një vend të mbyllur plotësisht, sikurse ishte Shqipëria staliniste, pa patur përballë e drejtpërdrejt fuqinë konkurrese dhe agresivitetin e identiteteve të tjerë dhe të kulturave të tyre. Mbyllja, mungesa e komunikimit, ballafaqimit dhe e konkurrencës me ta, pati disa pasoja: rënie dhe zbehje të madhe të aftësisë mbrojtëse, të aftësisë përballuese të konkurrencës, ngadalësim të zhvillimit bashkëkohor, krahas identiteteve të tjera.

Në hapësirat shqiptare në ish Jugosllavi, përkatësisht në Kosovë, nën Maqedoni dhe Mal të Zi, me arsimimin masiv në vitet 1950-1980, u kalua nga ruajtja në kushtet e mbijetesës në kulturim dhe emancipim, pohuar veçanërisht në arsimin amëtar, në letërsi

e arte, në gjuhësi dhe shkencat alanologjike, ndonëse brenda cakut politik, me përpjekje për ta tejkaluar sa herë ishte e mundur. Atëherë shpesh dhe, më pas, vazhdimisht, ka qenë në përplasje të forta, sidomos me identitetin racist serb, që, në vitet 1997-1999, kaloi në ndeshje ushatarake. Shkurt, deri më 1990 në Shqipërinë shtetërore, dhe deri më 1999 në Kosovë, është ruajtur dhe zhvilluar, ku më shumë e ku më pak, në kushtet e lirisë së kufizuar.

Në sistemin demokratik u hapën tërësisht kufijtë. Kështu, tani, identiteti shqiptar, njëlloj dhe identitete të tjera të vegjël, duket se është i rrezikuar nga liria e vet, hapja, ndërkomunikimi, ballafaqimi, konkurenca, përplasje paqësore me identitete të tjera të konsoliduar në shekuj, me gjuhët, kulturat, ekonomitë, politikat e tyre më të fuqishme e më cilësore. Në të vërtetë, rreziqet për dobësimin, nënshtrimin, zhbërje dhe tjetërsim vijnë nga keqpërdorimi i lirisë, paaftësia për t'i shmangur e kapërcyer ata.

### **Mbarëvajtje në rrjedhën e sotme**

Rënja e kufijve politiko-ideologjikë, e, bashkë me to edhe e mendësive dhe e praktikave, që, me dashje apo pa dashje, e pranonin copëzimin, ka shënuar fillimin e një epoke të re historike, atë të intergimit dhe të bashkimit, ose, e parë në këndvështrimin e identitetit, epoka e zhvillimit të plotë dhe të gjithanshëm, e pohimit të njësisë së tij para vetvetes dhe të tjerëve.

Në Republikën e Kosovës, tanimë, është Kushtetuta, institucionet përkatëse, që, ligjërisht dhe në praktikë, e mbrojnë dhe kanë detyrim kushtetues të krijojnë kushte sa më të përshtatshme për zhvillimin e identitetit shqiptar, ndryshe nga më parë, kur fyhej, pengohej dhe me lloj-lloj trysnish synohej për ta shpërbërë. Situata dhe gjendja për shqiptarët nën Maqedoni, me përpjekjet e tyre politike dhe kulturore, shoqëruar edhe me sakrificë, është përmirësuar ndjeshëm, edhe pse rreziqet ende janë fort veprues dhe insinuatat për ta dobësuar e shpërbërë përsëriten rregullisht. Më i rrezikuar është nën Serbi dhe nën Mal të Zi, ku trysnitë tradicionale, politike, ekonomike, kulturore, arsimore e psikologjike vazhdojnë të rëndojnë si më parë, përballë të cilave, të dy shtetet shqiptare, me ligjet ndërkombëtare, kanë të drejtën, dhe, me kushtetutat e tyre, edhe detyrimin për t'i mbrojtur e ndihmuar.

Në vitet 1990-2013, shqiptarët për herë të parë në histori panë dhe njohën vetveten në tërësinë njerëzore, historike, kulturore dhe psiko-arsimore, drejtpërsëdrejti në marrëdhënie familjare, miqësore, ekonomike, turistike, dhe, nëpërmjet televizioneve, medias, librave. Në rrethana të tilla mbarëvajtëse është rritur përherë e më tepër bashkëpunimi institucional shkencor mes universiteteve dhe akademive, afrimi i programeve dhe i barazvlershmërisë së diplomave. Për njohjen, ndërkomunikimin dhe integrimin paraprijnë televizionet me njoftimet e rregullta, që japin për çfarë ndodh, me

veprimtaritë kulturore dhe artistike të organizuara dhe të emetuara prej tyre në të cilat marrin pjesë specialistë dhe talente të përzgjedhur nga mbarë hapësira shqiptare.

Këto, megjithëse të pakta, në njërin, ose, në tjetrën mënyrë, janë paramenduar, dhe njëmendësisht janë forcim dhe fuqizim i identitetit, faktorë dhe përbërës të integrim- njësimit brenda shqiptar. Ndërkohë, mungon strategjia, projektet për ndërlidhjen dhe afrimin e domosdoshëm deri në njësim të arësimit parauniversitar, sikurse mungojnë projektet, veprimtaritë e përbashkëta kulturore gjithëpërfshirëse, fusha me rëndësi të posaçme, pa përmendur parësorin, integrimin ekonomik, që ende nuk po jep shenja konkrete për të filluar.

## **Rreziqe të zhbërjes**

### **A. Rreziku nga copëzimi politiko-shtetëror**

Shqiptarët, përgjithësisht, janë e ndjehen, jetojnë, organizohen, edukohen dhe arsimohen, përjetojnë si shqiptarë. Mangësia e tyre kryesore është se, ata, ende nuk janë të organizuar në tërësi si të tillë nëpërmjet të njëjtave institucione shtetërore e shoqërore. Ky është edhe problemi i veçantë i tyre, që nuk e kanë kombe a identitete të tjerë. Ne, që, me zell të madh e me padurim adoleshenti dëshirojmë të hyjmë në Bashkimin Europian, fatëkeqësisht, ende pa patur vetëdijen, kulturën dhe qytetarinë e duhur, ndryshe nga të tjerët, nuk do të dalim nga një, por nga disa dyer, jo me një, por me disa pasaporta njëjtësimi/identifikimi ligjor, sikurse vazhdojmë të jemi të ndarë politikisht e shtetërisht. Ata që do të dalin nga Republika e Shqipërisë do njihen dhe do të quhen, me dokumente, shqiptarë. Të tjerët, ata që do të dalin nga Republika e Kosovës, me dokumente do të njihen dhe do të quhen kosovarë, e, një lloj me ta edhe serbët apo romët, që jetojnë atje; nga Maqedonia, maqedonas dhe nga Mali i Zi, malazezë. Shkurt, shqiptarë do të njihen dhe do të shënohen, për aq kohë sa nuk do të kenë marrë qytetari e identitet tjetër, vetëm ata që dalin nga Republika e Shqipërisë. Copëzimi politiko-shtetëror, tek e fundit, një shënim formal ligjor në dokument, të cilit nuk i jepet aq rëndësi, ja ku shndërrohet në mjet dhe mënyrë praktike të heqjes formale dhe, më pas, të humbjes së identitetit përballë të tjerëve dhe më vonë edhe para vetes.

### **B. Rreziku nga emigracioni ekonomik**

Emigracioni ekonomik është hemorragji njerëzore dhe po aq kombëtare identitare.

Shqipëria shtetërore e mbyllur me tela me gjemba, përveç emigracionit politik të pasluftës së Dytë Botërore, për 45 vjet nuk pati asnjë lloj emigracioni. Nga trojet në ish

Jugosllavi në sundimin e Titos dhe të Miloshviçit, pati vazhdimisht emigracion ekonomik dhe politik në Turqi, Gjermani, Zvicër e gjetkë, herë-herë, në vitet 1950, 1970, sidomos në vitet 1982- 1999, në formën e dallgëve të mëdha, të programuar, përkrahur dhe shpërblyer nga shteti, në marrëveshje me shtetet përkatëse.

Prej 1990, nga Shqipëria shtetërore kanë emigruar për arsye ekonomike qindra mijëra vetë bashkë me familjet. Nuk ka të dhëna statistikore, por në mënyrë empirike, duke ndjekur të dhënat që japin mediat e përditshme nga tërë hapësirat mund të jenë larguar 1.5 milionë vetë nga trangu 7 milion i shqiptarëve, pra, afërsisht më shumë se 1/5-ta. Me regjistrimin e 2011, popullsia e Republikës së Shqipërisë ishte 2 milionë e 822 mijë, me një rënie 8/100, krahasuar më dhjetë vjet më parë.<sup>9</sup> Kahja e popullsisë është ende në rënie të vazhdueshme.

Fqinjët, veçanërisht Greqia, mbi të gjitha, kisha e saj dhe kisha shqiptare me në krye Janullatosin, të detyruar/imponuar me trysni politike dhe ekonomike nga shteti dhe kisha greke, i ka keqpërdorur emigrantët me ligje dhe propagandë, me privilegje a ndëshkime pune dhe biznesi, me shpërblime a mosdhënie rrogash e pensionesh për t'i tjetërsuar në grekë etnikë. Me politikën e vet mesjetare ka shumëfishuar numrin e banorëve në të ashtuquajturin Epir i Veriut/Vorioepir, njëmendësisht, Shqipëria e Jugut për ta patur, në rastin e përshtatshëm, si pretekst të drejte për ta bashkëngjitur në shtetin e vet, dhe, në pamundësi të kësaj, të arrijë artificialisht numrin e mjaftueshëm për të detyruar me anë të organizmave ndërkombëtare greqishten gjuhë zyrtare të shtetit shqiptar.

Në nëntor 2006, qeveria e Athinës mori vendimin për t'u dhënë pasaportë shtetasve shqiptarë, të quajtur me kombësi greke, që kishin Kartën e Homogjenitetit, d. m. th., dokumentin vërtetues të saj, i cili, sipas ministrit të brendshëm, Prokopis Pavlopulos *“është marrë pas një sërë bisedimesh me Shqipërinë dhe përfaqëseve të Tiranës për të amenduar Kushtetutën.”*<sup>10</sup>

E përditshmja politiko-financiare “Kathimerini”, shkruan se ai *“ishte i përgatitur prej vitesh, por rrinte në sirtar nga frika se mos shkaktonte tërmet politik në marrëdhëniet mes dy vendeve.”*<sup>11</sup> Tej frikës së tyre për *“tërmet politik”*, kryeministri i atëhershëm e përshëndeti menjëherë, sepse *“lehtëson jetën e shqiptarëve me origjinë shqiptare”*, dhe, për të mos prishur idilin, shprehu keqardhje për *“shtrembërimet”* që i bënë media, disa politikanë dhe intelektualë.<sup>12</sup> Është e vërtetë, që e lehtëson jetën e shqipëtarëve të atjeshëm. Gracka është se ata shpallen grekë etnikë, historikisht e në brezat e ardhshëm.

Ministria e Brendshme e Greqisë ka njoftuar se numri i tyre është 200 mijë. “Kathimerini” të gjithë këta i quan Vorioepirotë dhe pasaporta u jep statusin e grekut etnik<sup>13</sup>, edhe pse shumica e tyre janë shqiptarë nga të gjitha krahinat, nga Jugu e Veriu, Korça e Peshkopia, Gjirokastra e Kukësi, Tirana, Elbasani e Lezha, Bregu dhe Myzeqeja. Lëvizja Socialiste Panhelenike (PASOK), në një Deklaratë tërhoqi vëmendjen

për ta zbatuar vendimin me kujdes, në mënyrë që të përfshihen “*të gjithë grekët etnikë dhe familjet e tyre që jetojnë në Shqipëri*”<sup>14)</sup> Kjo do të thotë se pasaporta nuk u jepet vetëm emigrantëve, por edhe familjeve të tyre në Shqipëri. Me këtë tregues, shifra e tyre nga 200 mijë, bëhet tre-katër-pesë herë më shumë.

Emigracioni, ky realitet gllabërues, në thelb, është problem ekonomik, prandaj, edhe zgjidhja do të jetë ekonomike. Atë e ndërpret zhvillimi ekonomik i Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës, ngritja e mirëqënies në mënyrë të natyrshme, e, në radhë të parë, nëpërmjet rritjes së prodhimeve të llojllojshme, të ngritjes së teknikës dhe të teknologjisë në shkallare europiane, qëndrueshmëria politike dhe besueshmëria qytetare në të. Kurse, zgjidhja themelore dhe e përhershme është intergimi dhe bashkimi ekonomik, kur të dyja pjesët të ushqejnë e të plotësojnë njëra tjetrën. Mirëpërdorimi i pasurive natyrore dhe njerëzore, mirëqënia, paqja dhe harmonia shoqërore krijojnë kushtet e përshtatshme për ruajtjen dhe zhvillimin e tij, e fuqizojnë, i japin atij dinjitet dhe siguri, qoftë në përballjen miqësore e dashamirëse, qoftë në mospranimin dhe armiqësinë e identiteteve të tjerë.

### **C. Mungesa e organizimit për vetëruajtje**

Për të ndihmuar në ruajtjen e identitetit të mërgimtarëve, e, në radhë të parë, të gjuhës, të traditës dhe kulturës, çdo shtet e shoqëri amë ka institucione të specializuara e të programuara, që i ndjekin, i ndihmojnë në zgjidhjen e problemve, qoftë drejtpërdrejtë me ta, qoftë me interesimin pranë qeverive të vendeve ku janë integruar. Gjithashtu, vet mërgimtarët, sipas mundësive dhe rrethanave, krijojnë institucione e organizma jo vetëm për të mbrojtur e ndihmuar njëri tjetrin në vështirësitë jetike, por edhe për të ruajtur e kultivuar gjuhën, traditat, kulturën e të parëve. Kjo është përvoja mbarëvajtëse shekullore e të gjithë emigracioneve të kombeve të qytetëruara për të cilat vendet e Europës kanë edhe ligje e institucione, madje edhe fonde të caktuara, sidomos për shkollimin në gjuhën amtare. Edhe në shtetin më racist të Ballkanit, në Greqi, ka ligj që e lejon shkollën shqipe për fëmijët e emigrantëve.

Problemi i parë, është botëkuptimor dhe psiko-kulturor. Shqiptarët, në pjesën më të madhe, pavarësisht, se ku ndodhen, nuk e ndjejnë dhe as nuk e kuptojnë këtë domosdoshmëri, disa e shohin të pa dobishme, dhe disa të dëmshme, pasi “i pengon” në integrim, më shqip, në tjetërsimin e tyre. Kam patur rastin të shikoj, p.sh. , në Gjermani, ambjentet e një shkolle për fëmijët e emigrantëve me kombësi të ndryshme, ku kishte klasë edhe për shqiptarët, me program, tekste, mjetet e nevojshme dhe një mësuese që paguhej. Prindërit më të painteresuar, që e shikonin si të tepërt, ishin shqiptarët. Klasa praktikisht ishte e mbyllur nga mungesa e fëmijëve. Prindër të tillë nuk i drejtohen për ndihmë as shtetit amë dhe as shtetit ku jetojnë.

Problemi i dytë është papërgjegjësia zyrtare. Shtetet shqiptare, së paku ai i Republikës së Shqipërisë, edhe nja dy institucione që ka në trajtën e organizmave, thuajse, nuk funksionojnë, veç derdhjes së pagave për punonjësit, plotësimin formal të ca dokumentave, dhe ndoca teksteve shkollore, që, edhe ato u dërgohen kur ankohen mësuesit e pasionuar.

Rreziqe të tillë qeniesore/ekzistenciale shmangen me strategji institucionale shtetërore, emergjente, afatshkurtra dhe afatgjata, me tërësi institucionesh dhe organizmash bashkëpunuese, sa me institucionet dhe organizmat e emigrantëve, aq dhe me insitucionet dhe organizmat e shteteve ku ata janë vendosur.

Brezi i parë i të mërguarve mund të ruajë gjuhën, traditën lidhjen me vendlindjen. Brezi i dytë, dhe më pas, në mungesë të interesimit dhe të rrethanave ndihmuese, i humbasin, e, bashkë me to edhe identitetin. Emigracionet e kombeve të qytetëruara dhe të mirëorganizuara e kanë ruajtur dhe vazhdojnë ta ruajnë në shekuj gjuhën, traditën, besimin, kulturën, madje i kanë përhapur e popullarizuar edhe në vendet ku janë vendosur, sidomos me anë të muzikës, filmit, letërisë, veshjes, deri dhe kulturës së kulinarisë. Në qytetet më të mëdha e kozmopolite të Europës, në Paris, Londër, Romë dhe gjithandej janë të pëlqyer restorantet kineze, japoneze, indiane, pakistaneze, koreane, turke, libaneze, greke, etj. Kuzhina tradicionale është përbërës i identitetit. Në këtë rast, tradita, kultura, identiteti, të shndërruar në mjet fitimi ekonomik, janë njëherësh edhe ruajtje dhe propagandim i tyre.

### **Gjuha dhe letërsia mbartëse dhe pohuese kryesore të identitetit shqiptar**

Identiteti shfaqet, fillon dhe zhvillohet në vetvete, në radhë të parë, me gjuhën e nëpërmjet gjuhës, sepse, ajo, përcakton qeniesinë/ekzistencën dhe njësinë e krejt bashkësisë, që e flet, në llojshmërinë e pafundme të marrdhënieve, që nga ato intime familjare, të fisit, fqinjësisë dhe të miqësisë, ekonomike, arësimore, e deri tek ato administrative, ushtarake dhe historike. Shtrirja e saj është zanafilla, themeli dhe ngrehina bazore e kombit, paraprospekti i sendërtimit të shtetit. Dobësimi, humbja e saj është dobësim dhe humbje e identitetit. Bashkësia e madhe, që quhet komb, dhe çdo bashkësi, përderisa ruan gjuhën ka mëvehtësi dhe identitet, dhe, kur e humbet atë pushon, së qeni, ose ka vdekur, ose, është tjetërsuar, prandaj fshihet nga atlasit i identiteteve të gjalla. Po ashtu, dallohet, jeton e mbijeton, pohon aftësitë në konkurrencë, shpesh dhe në armiqësi, me identitet e tjerë, para së gjithash, nëpërmjet gjuhës.

Në dokumentet e para të autorëve të huaj për shqiptarët, shqipja është argumenti më i padiskutueshëm i qeniesisë/ekzistencës dhe i dallimit thelbësor të tyre prej popujve të tjerë. Përkthimi dhe botimi në shqip i teksteve fetare “Meshari” (1555) i Gjon Buzukut, “E mbsuame e krështerë” (1592) i Lekë Matrangës dhe i autorëve të tjerë të

vjetër, ka qenë ngjarje historike me të cilët jo vetëm dokumentohet shqipja e shkruar, por edhe aftësitë e saj për të kryer edhe funksionet arësimore, letrare, kancelareske, etj.

Veprat e Marin Barletit, edhe pse të shkruara në latinisht: “Rrethimi i Shkodrës” (1504, Venedik), e përkthyer dhe e ribotuar disa herë në italisht, frëngjisht e polonisht, veçanërisht “Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut”, e cila në gjuhën latine ka patur katër botime (mes viteve 1508-1510, Romë; 1537, Strasburg; 1578, Frankfurt mbi Main; 1743, Zagreb), e përkthyer dhe e përshtatur më pas në një numër të madh gjuhësh: gjermanisht, italisht, portugalisht, spanjisht, frëngjisht, polonisht, anglisht, rusisht, suedisht, greqisht, etj. kanë pohuar, në mesjetë dhe në kohët moderne, krahas identitetit evropian të shqiptarëve edhe ndihmesat e tyre në mbrojtje të tij me sakrificat të mëdha. Shtresat intelektuale evropiane ata i kanë parë në shekuj me shëmbëlltjrën aq pozitive të këtyre veprave monumentale.

Rilindja, me poezi, këngë, tekste didaktikë, propagandë, me edukimin shkollor, me studime në shqip dhe në gjuhë të huaj e poetizuan dhe e idealizuan në shkallën e shenjtërimit, si e bekuar prej Zotit, duke e mësuar në kishë, xhami e teqe, sepse prej saj varej prova e qeniesisë dhe njësisë shqiptare para vetes dhe të tjerëve, ruajtja dhe zhvillimi, e tanishmja dhe e ardhmja e saj si e tillë. Miratimi i gjuhës standartë për mbarë trevat shqiptare, pavarësisht ndarjes politike në pesë shtete, lëvrimi i saj me përgjegjësi të madhe historike në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Preshevë- Bujanovc, ka qenë lidhja e pashqitshme mes tyre, dëshmia e vullnetit dhe e përpjekjeve për t’i hapur rrugën njësimi politik. Në këto vite të pluralizmit dhe të lirisë, gjuha e njësuar ka lehtësuar dhe intimiduar ndjeshëm tërë ecurinë e integritit ndërshqiptar. Me të, me letërsinë dhe kulturën e njësuar, pjesërisht me institucionet arsimore dhe kulturore, tanimë, janë ngritur themelet dhe çatia e ngrehinës së përbashkët shqiptare. I ka mbetur politikës të ngrejë katet ekonomike, ligjore e administrative të integritit-bashkimit të saj.

Në botën e huaj historikisht identiteti shqiptar është pohuar më gjerësisht nëpërmjet letërsisë, të shkruar qëllimisht prej tyre ose të përkthyer në gjuhë të huaj. Vepra të De Radës, Naim e Sami Frashërit, Pashko Vasës, Faik Konicës, Fan Nolit, Gjergj Fishtës, veçanërisht të Migjenit, Ismail Kadarese, Ali Podrimjes dhe autorëve të tjerë bashkëkohorë kanë krijuar në vetëdijen evropiane dhe botërore shëmbëlltjrën më autentike dhe më dinjitoze për të. Mirëpo, qeveritë, ndonëse përkthimin dhe propagandimin e saj në gjuhë të tjera e kanë detyrim kushtetues, zakonisht, as nuk investojnë dhe as nuk duan t’ia dinë për të.



**Bibliografi:**

**Literatura**

**Autorë të huaj në shqip:**

1. Erik J. Hobsbaum “Kombet dhe nacionalizmi” që nga 1780-a”, programi, miti, realiteti, “Toena”, Tiranë, 1996
2. Anne- Marie Thiesse “Krijimi i identiteteve kombëtare”, Evropa e shekujve XVIII-XX, “Dukagjini”, Pejë, 2004

**Autorë shqiptarë:**

1. Ismail Kadare “Identiteti evropian i shqiptarëve”, “Onufri”, Tiranë, 2006
2. Ismail Kadare “Mosmarrëveshja”, “Onufri”, Tiranë, 2100
3. Rexhep Qosja “Realiteti i shpërfillur”, vështrim kritik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar, “Toena”, Tiranë, 2006
4. Rexhep Qosja “Ideologjia e shpërbërjes”, trajtesë mbi idetë çintegruese në shoqërinë e sotme shqiptare, “Toena”, Tiranë, 2006
5. Fehmi Agani “Demokracia, kombi, vetëvendosja”, “Dukagjini”, Pejë, 1994
6. Muhamedin Kullashi “Përplasja e identiteteve”, “Dukagjini”, Pejë, 2003
7. Rexhep Ismajli “Gjuhë standarte dhe histori identitetesh”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005
8. Mehmet Kraja “Identiteti kosovar”, “PEN Qendra e Kosovës”, 2011
9. Hivzi Islami «Spastrimet etnike», politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve, «Dukagjini», Pejë, 2003
10. Bashkim Kuçuku «Kombi gjen vetveten, Çamëria dhe Kosova», «Toena», Tiranë, 2012

**Citime:**

1. Erik Hobsbaum, “Kombet dhe nacionalizmi, që nga 1780-a, Programi, Miti, Realiteti”, “Toena”, 1996, faqe 163.
2. Po aty, faqe 170.
3. Po aty, faqe 190-191.
4. Anne-Marie Thiesse, “Krijimi i identiteteve kombëtare, Europa e shekullit XVIII-XX, “Dukagjini”, Pejë, 2004, faqe 357.
5. Po aty, faqe 19.
6. Po aty, faqe 359.
7. “Le Monde”, më 25 prill, 2009.

8. Po aty.
9. “Shekulli, 14 dhjetor, 2012
10. “Shqip”, 9 nëntor 2006.
11. Po aty.
12. *Po aty.*
13. “*Shqip*”, 9 nëntor 2006.
14. *Po aty.*

**Rrahman PAÇARIZI**

**QASJA SOCIOKOGNITIVE NË TERMINOLOGJI – MEDIET E  
REJA DHE TEKNOLOGJIA**

1

Është hera e tretë që në një konferencë shkencore përpiqem të zhvilloj teorinë e qasjes sociokognitive në terminologji duke qenë i vetëdijshëm për vështirësinë e kapjes së fillit të kësaj teorie të zhvilluar nga Rita Temmerman e sidomos për vështirësinë e aplikimit të saj praktik në terminologjinë shkencore e profesionale në gjuhën shqipe. Vitin e kaluar jam përpjekur të zhvilloj disa vija të aplikimit të kësaj qasjeje me rastin e përkthimit dhe përdorimit të terminologjisë në fushën e psikolinguistikës. Duke qenë fushë e re studimore ka vështirësitë e veta, por meqë nuk është mjaft e përhapur dhe e nevojshme për nevojat ekstraprofesionale dhe ekstrashkencore, atëherë mundësitë e lëvizjes me rastin e përcaktimit për termat e caktuar janë më të mëdha, sepse në secilin variant për ekspertët e fushës termat janë potencialist më lehtë të kuptueshëm, ndonëse, edhe këtu ka vështirësi të shumta. Për shembull, në një fjalorth të termave të psikolinguistikës ku jam përpjekur të ndjek orientimin sociokognitiv kam përdorur termin “akomodim” për atë që fonetika tradicionale e shqipes e njeh me termin “asimilim” dhe natyrisht që ka pasur edhe mospajtime për këtë. Për shembull nyjëtimi prapagjuhor i “n”-së para tingujve “k” e “g”. Në këtë rast tingulli “n” nuk asimilohet por përshtatet brenda një rrethimi fonetik, duke humbur disa nga vetitë, në këtë rast vendin e nyjëtitimit që është një veti fonetike, por duke ruajtur vlerën fonologjike që shikuar në aspektin psikolinguistik është me vlerë thelbësore, pa cka se ndryshon vendin e nyjëtitimit. Por, pse duhet të përdoret termi “akomodim” e jo “asimilim”. Arsytet janë dy: e para se në vetëdijen gjuhësore të shqiptarëve termi asimilim e ka kuptimin e zhdukjes apo shkrirjes brenda një mase a komuniteti të ndryshëm nga ai i origjinës, ndërsa këtu nuk ndodh kjo por ndodh ndryshimi i vetëm një apo disa tiparesh dhe ky është aspekti social i qasjes sociokognitive, ndërsa aspekti kognitiv ka të bëjë me faktin që tipari që ndryshon në rastin e nyjëtitimit prapagjuhor të “n”-së nuk është qenësor për ndryshimin e vlerës së fonemës, pra ai tipar nuk shkakton kundërvënje fonologjike. Këeto dy aspekte ndërtojnë bashkë qasjen sociokognitive. Arsyeja e dytë është se i njëjti

term përdoret edhe në anglisht dhe në këtë kuptim shkenca arrin të komunikojë më lehtë jashtë kodit gjuhësor të shqipes.

2

Një pyetje tjetër që mund të shtrohet është nëse ky term do të ishte i përdorshëm po të përkthehej. Përgjigja është po, por shtrohet dilema se si do të përkthehej termi për të qenë i përshtatshëm dhe jo vetëm i përkthyer. Nëse do të përdornim termin përshtatje në shqip, kjo sigurisht që nuk do ta mbulonte gjuhësisht të gjithë fenomenin e akomodimit, pasi tingulli në këtë rast jo vetëm që përshtatet brenda një rrethimi fonetik, por ai tingull, duke pësuar një ndryshim të caktuar të vendit të nyjetimit pa shkaktuar telashe fonologjike, rehatohet në atë pozicion. Nga kjo del se termi në këtë rast do të mund të përkthehej në shqip si “rehatim”. Ky term nuk do të kishte asgjë të keqe, vetëm se do të ishte vështirë i pranueshëm për komunitetin jashtë profesional, prandaj varianti më i pranueshëm mbetet termi “akomodim”. Pra, përdërisa termi përshtatje nuk e plotëson komponentin kognitiv, termi rehatim nuk e përmbush komponentin social, i cili është i domosdoshëm që një term të fitojë attribute të fjalës apo të jetë njësi gjuhësore e domethënshme.

3

Sager (1990:13) ka identifikuar tri dimensione të teorisë së terminologjisë, ndër të cilat dimensionin kognitiv që ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet formës linguistike dhe përmbajtjes konceptuale (referenti në botën reale); dimensionin gjuhësor që ekzaminon format ekzistuese dhe potenciale të përfaqësimit të terminologjisë dhe dimensionin komunikativ që ka të bëjë me përdorimin e terminologjisë dhe duhet të arsyetojë aktivitetin njerëzor të prodhimit dhe kompilimit të terminologjisë.

Sipas qasjes sociokognitive, me rastin e definimit të një termi, duhet të ekzistojë një raport i saktë ndërmjet perspektivës semasiologjike (mënyra e krijimit të domethënies në gjuhë përmes përdorimit dhe marrëdhënieve ndërmjet fjalëve, frazave dhe fjalive) dhe perspektivës onomasiologjike (mënyra se si shprehet kuptimi) – e para nisët nga aspekti formal, apo nga fjala, ndërsa e dyta nisët nga aspekti përmbajtësor i shenjës ose kuptimi.

4

T’i rikujtojmë edhe një herë dallimet ndërmjet Teorisë së Terminologjisë së Përgjithshme dhe teorisë së Qasjes Sociokognitive:

QASJA SOCIOKOGNITIVE NË TERMINOLOGJI – MEDIET E REJA DHE  
TEKNOLOGJIA

	GTT Felber	SCA Temmerman
1	Konceptet kanë rol qendror në raport me dizajnimin e tyre linguishtik	Gjuha nuk mund të konsiderohet si e shkëputur nga konceptet përderisa luan rol crucial në konceptimin e kategorive
2	Konceptet dhe kategoritë kanë kufij qartë të dallueshëm	Shumë kategori kanë kufij të paqartë dhe nuk mund të definohen
3	Definicionet terminografike gjithmonë duhet të jenë intensionale (me referencë të qartë)	Struktura dhe lloji optimal i definicionit nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në një mënyrë dhe përfundimisht kjo varet nga koncepti të cilin e definojnë
4	Referencat monosemike janë rregull në terminologji kur ka një marrëdhënie një me një ndërmjet termit dhe konceptit	Polisemia dhe sinonimia ndodhin shpesh në gjuhën e specializuar dhe duhen përfshirë në analizat realiste të terminologjike
5	Gjuha e specializuar mund të studiohet vetëm në aspektin sinkronik	Kategoritë, konceptet si dhe termat që zhvillohen me kalimin e kohës, duhet të studiohen në aspektin diakronik. Në këtë kuptim, modelet kognitive luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ideve të reja

5

Dhe, përderisa në fushë të psikolinguistikës dhe të disa fushave të tjera të gjuhësisë ka më shumë hapësirë për të lëvizur, ka fusha të tjera që janë më popullore të themi kushtimisht apo që komunikojnë më shumë me publikun, ku variantet terminologjike janë më të ndjeshme dhe ku duhet të lidhen më ngushtësisht termi me domethënien. Sa për sqarim, në teorinë sociokognitive, termi konsiderohet njësi gjuhësore e kuptimshme, prandaj edhe domethënëse.

Për shembull, terminologjia në fushë të gazetarisë ka implikime të shumta në fusha të ndryshme. Termit e produksionit televiziv që janë për përdorim të brendshëm nuk është e domosdoshme të trajtohen nga aspekti sociokognitiv, meqenëse komuniteti nuk ka nevojë për ata terma por për produktin final. Ndërkaq, termat që emërtojnë për shembull forma të reja të gazetarisë të kushtëzuara nga zhvillimet tekniko-teknologjike detyrimisht do të futen në fusha të tjera dhe kërkojnë trajtim terminologjik sociokognitiv, meqë do të shndërrohen në njësi gjuhësore të domethënshme e të kuptimshme, e rrjedhimisht u nënshtrohen proceseve sociokognitive, si secila fjalë jo e parme që është e motivueshme semantikisht.

Mirëpo, ashtu si në çdo fushë tjetër të veprimtarisë shkencore e profesionale, edhe në gazetari termat ndahen në dy grupe më të mëdha – terma të fushës së ngushtë profesionale që nuk komunikojnë me publikun dhe nuk kanë përdorim ekstraprofesional, dhe termat profesionale që komunikojnë me publikun dhe kanë përdorim ekstraprofesional.

6

Të parët janë për shembull termat SNG dhe OB VAN që janë terma të produksionit, të cilët edhe vetë gazetarët shpesh nuk i kuptojnë.

SNG është akronimi për Satellite Neës Gathering dhe shumica e punëtorëve në produksion nuk e dinë emërtimin e plotë apo nuk dinë ta zbërthejnë këtë akronim, por e dinë se për cilën pajisje bëhet fjalë. Ajo është një pajisje e vendosur në një makinë të madhe të lëvizshme, që përdoret për transmetime të drejtpëdrejta të ngjarjeve të caktuara që ndodhin larg studiove të televizionit. Kjo pajisje quhet ES-EN-GJI që është shqiptimi anglisht i akronomit SNG dhe shumica e subjekteve të trajtuara në këtë temë nuk e kanë madje as idenë se si shkruhet drejt SNG, por e dijnë me saktësi se për çfarë bëhet fjalë. Njerëzit jashtë gazetarisë së televizionit nuk e kanë fare idenë se për çfarë pajisjeje bëhet fjalë, që do të thotë ky term jeton vetëm brenda një komuniteti të caktuar profesional. Si i tillë ky term nuk ka pasur nevojë t'u nënshtrohet proceseve të modelimit terminologjik, mbi baza sociokognitive, pasi as shoqëria ka pasur nevojë ta njohë të shënjuarin e rrjedhimisht as të shënjuarin dhe vetë shenja gjuhësore nuk ka pasur nevojë të trajtohet në më shumë se një parametër kognitiv. Në këtë rrafsh, ky term barazohet në tipare me fjalët e parme, pasi është pranuar arbitrarisht si i tillë dhe përdoret i pamotivuar semantikisht. Aq i izoluar është ky term, saqë askush nuk ka bërë përpjekje të krijojë një fjalë shqipe në vend të saj, përveç fjalës saç për shkak të ngjashmërisë së antenës me saçin, një pajisje kuzhine. Madje as në anglisht nuk kontestohet si term. Nëse analizojmë Satellite News Gathering si grup fjalësh me një kuptim të caktuar, kjo nuk na jep idenë e plotë të pajisjes dhe funksionit që ajo pajisje kryen. Pavarësisht nga kjo, termi vazhdon të mbijetojë më shumë falë akronimit, meqë dihet se akronimet janë shumë të qëndrueshme. Sa për ilustrim ta marrim termat UNESCO (**United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization**) apo NATO (**North Atlantic Treaty Organization**) që të gjithë i kanë të njohura, por pakush di t'i zbërthejë në fjalë të plota. Kjo bën të kuptohet se termi SNG nuk i nënshtrohet ndonjë procesi kognitiv, por aq fort është akomoduar në këtë domen përdorimi saqë ka arritur një shkallë të lartë eptimi.

7

Pothuajse njëjtë ka ndodhur me një term tjetër OBIVAN (OB-Van) nga anglishtja **Outside Broadcasting Van që do të thotë Furgon për transmetime nga jashtë**. Duke qenë një pajisje më e hershme se SNG-ja, termi OBIVAN ka lëshuar edhe sinonime si në anglisht Production Control Room, Production Truck, Scanner, Mobile Unit, Remote Truck, Live Truck madje edhe Live Eye, apo në shqip krahas OBIVAN përdoret edhe termi “Kerri i reportazhit”. Por, a prish punë kjo? Sigurisht që jo, pasi termat përdoren në një fushë tepër të kufizuar dhe nga një komunitet profesional i kufizuar. Madje, qoftë termi kerr i reportazhit për OBI-Van-in, qoftë termi saç për SNG-në janë terma që teknikët e produksionit televiziv i përdorin vetëm kur komunikojnë me persona që potencialisht nuk do t’i kuptonin ata terma, që do të thotë se këtu ndodh një solidarizim gjuhësor me folësit që nuk i takojnë atij komuniteti.

Për këtë arsye, termat SNG dhe OB VAN nuk kanë nevojë të jenë të kuptimshëm e së këndejmi mund të mos jenë fare njësi gjuhësore, ose edhe nëse mund të jenë, janë krejtësisht arbitrare, pasi mjafton të dihet se çfarë shenjojnë dhe nuk ka ndonjë proces kognitiv që vepron mbi to, ndërsa procesi social është krejtësisht i kufizuar brenda një komuniteti të ngushtë. Pra, në këto raste ka gjetur zbatim Teoria e Terminologjisë së Përgjithshme, sipas të cilës termi nuk trajtohej si njësi gjuhësore dhe në vete nuk përmbante tiparet e konceptit të synuar dhe së këndejmi vlera semantike ishte arbitrare dhe e ngulitur dhe jo heuristike, në mënyrë që të kishte një kuptim i cili krijon parakushte për të gjetur kuptimin themelor.

Me këtë nuk dua ta përjashtoj qasjen heuristike që është krejtësisht normale të zhvillohet por që kërkon parakushte gjuhësore për t’u zhvilluar drejt.

Në kushtet kur terminologjia nuk është më krejtësisht e mbështetur mbi latinishten, e cila duke qenë gjuhë e vdekur nuk arrin të përmbushë nevojat komunikuese të gjuhëve të gjalla për sisteme që zhvillohen vazhdimisht, zhvillimi i qasjes sociokognitive në terminologji është, nëse jo i domosdoshëm atëherë së paku i dobishëm dhe frytdhënës.

## 8

Të merremi me dy respektivisht tre terma gazetarie që përfaqësojnë forma dhe formate të reja mediale si koncepte, gjithnjë duke parasysh parimet e qasjes sociokognitive e sidomos duke mos e harruar parimin se dallimi ndërmjet koncepteve nuk është krejtësisht i qartë siç thoshte teroia e terminologjisë tradicionale. Termat në anglisht janë CIVIC JOURNALISM, CITIZEN JOURNALISM DHE COLLABORATIVE JOURNALISM. Kjo e treta, sic mund të kuptohet nga termi është një produkt i kombinuar.

Bashkë me studentët e nivelit bachelor dhe atij master per dy vjet kemi diskutuar për këta tre terma, edhe për të marrë një input për aspektin social të funksionimit të këtyre termave, por edhe në përpjekje të gjetjes së termit të duhur në bazë të diferencimit konceptual ndërmjet dy termave Civic Journalism dhe Citizen Journalism.

9

Civic Journalism është përgjithësisht ideja e integritit të gazetarisë në proceset demokratike. Sipas kësaj qasjeje media jo vetëm që e informon publikun, por njëkohësisht punon drejt angazhimit të qytetarëve dhe krijimit të debatit publik. Lëvizja për Civic Journalism, sipas profesorit David Perry nga Universiteti Alabama është përpjekje për ta mohuar nocionin se gazetarët dhe audienca e tyre janë vetëm spektatorë në proceset politike dhe shoqërore. Në këtë kuptim, Civic journalism kërkon që lexuesit dhe gazetarët të trajtohen si pjesëmarrës të këtyre zhvillimeve

10

Ndërkaq, Citizen Journalism ka të bëjë me qytetarin si publik që luan rol aktiv në procesin e mbledhjes, raportimit dhe analizimit të lajmit. Courtney C. Radsch e përkufizon citizen journalism si një formë alternative dhe aktivizuese të mbledhjes së lajmit dhe plasimit të tyre jashtë institucioneve mediale. Ndërkaq, Jay Rosen propozon një përkufizim edhe më të thjeshtë, duke thënë se Citizen Journalism kemi kur njeriut që dikur njiheshin si audiencë përdorin mjetet që kanë në dispozicion për të informuar të tjerët. Kjo do të thotë se Citizen Journalism kemi kur shpërndajnë lajme ata që nuk janë formalisht gazetarë apo që nuk punojnë për medie formale.

11

Civic Journalism

- Gazetarë profesionistë
- Lajme të sforcuara
- Koncepti politik dhe filozofik

Citizen Journalism

- Gazetarë joprofesionistë
- Lajme, fotografi, muzikë, video etj
- Koncepti gazetaresk

Tani, nëse kemi parasysh parimet e qasjes sociokognitive të zhvilluar nga Rita Temmerman dhe konceptet e këtyre dy llojeve të reja të gazetarisë, mund të gjejmë termat e përshtatshëm për këto dy forma të reja të gazetarisë.



<b>Qasja sociokognitive</b>	<b>Civic Journalism</b>
Gjuha nuk mund të konsiderohet si e shkëputur nga konceptet përderisa luan rol crucial në konceptimin e kategorive	Fjala baraz me konceptin dhe e kuptueshme nga bashkësia folëse. Shenjë barazie mes fjalës dhe termit që shndërrohet në njësi gjuhësore.
Shumë kategori kanë kufij të paqartë dhe nuk mund të definojnë	Kufijtë e kategorisë që emërtohet janë të definuar, por jo edhe përkthimi nga anglishtja.
Struktura dhe lloji optimal i definicionit nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në një mënyrë dhe përfundimisht kjo varet nga koncepti të cilin e definojnë	Struktura dhe lloji optimal i definicionit nuk është i kufizuar vetëm në një alternativë, por koncepti në këtë rast është krejt i qartë e sidomos i dallueshëm nga ciziten journalism
Polisemia dhe sinonimia ndodhin shpesh në gjuhën e specializuar dhe duhen përfshirë në analizat realiste terminologjike	Në anglisht civic dhe citizen janë sinonimike. Prandaj, analiza mbështetet në perceptimin social të raportit ndërmjet konceptit të synuar dhe kuptimit të fjalës
Kategoritë, konceptet si dhe termat që zhvillohen me kalimin e kohës, duhet të studiohen në aspektin diakronik. Në këtë kuptim, modelet kognitive luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ideve të reja	Në aspektin diakronik duhet të përzjgjidhet fjala e cila është akomoduar më së miri në raport me konceptin.

Rekomandimi: Gazetari qytetare. (Guxim qytetar, angazhim qytetar, koncept qytetar, drejtësi qytetare etj)

<b>Qasja sociokognitive</b>
Gjuha nuk mund të konsiderohet si e shkëputur nga konceptet përderisa luan rol crucial në konceptimin e kategorive
Shumë kategori kanë kufij të paqartë dhe nuk mund të definohen
Struktura dhe lloji optimal i definicionit nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në një mënyrë dhe përfundimisht kjo varet nga koncepti të cilin e definojnë
Polisemia dhe sinonimia ndodhin shpesh në gjuhën e specializuar dhe duhen përfshirë në analizat realiste terminologjike
Kategoritë, konceptet si dhe termat që zhvillohen me kalimin e kohës, duhet të studiohen në aspektin diakronik. Në këtë kuptim, modelet kognitive luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ideve të reja

<b>Citizen Journalism</b>
Fjala baraz me konceptin dhe e kuptueshme nga bashkësia folëse. Shenjë barazie mes fjalës dhe termit që shndërrohet në njësi gjuhësore.
Kufijtë e kategorisë që emërtohet janë të definuar, por jo edhe përkthimi nga anglishtja.
Struktura dhe lloji optimal i definicionit nuk është i kufizuar vetëm në një alternativë, por koncepti në këtë rast është krejt i qartë e sidomos i dallueshëm nga citizen journalism
Në anglisht civic dhe citizen janë sinonimike. Prandaj, analiza mbështetet në perceptimin social të raportit ndërmjet konceptit të synuar dhe kuptimit të fjalës
Në aspektin diakronik duhet të përzgjidhet fjala e cila është akomoduar më së miri në raport me konceptin.

Rekomandim: Gazetari civile (ushtar vs civil, zyrtar vs civil etj) në kuptimin jo formale, jo institucionale që nuk i takojnë ndonjë grupi (nëpunës civilë).

12

Shihet qartë se këtu bëhet fjalë për gjetjen e termave shqip për produkte mediale që kanë ardhur në shqipen bashkë me termat përkatës në anglisht. Tani, na mbetet vetëm t'i përkthejmë (dhe fjalën vetëm nuk e përdora për të treguar rrugën e lehtë) apo duhet të gjejmë termin e përshtatshëm në shqip, gjithnjë duke pasur parasysh se në kushtet e zhvillimit tekniko-teknologjike, nevoja e standardizimit terminologjik është e jashtëzakonshme.

13

Gjithsesi, përkthimi i fjalëpërfjalshëm nuk na çon askund, pasi ekzistojnë korniza të ndryshme refernciale. Prandaj, thotë studiuesja ruse, Natalya Gvishani, duhet njohur sistemi si tërësi për të qenë në gjendje të gjejmë ekuivalentin e qëndrueshëm në gjuhën e synuar nacionale, për termin e huaj, pasi analiza kontrastive e terminologjive nacionale mbështetet në përparësinë e përmbajtjes. Ne nuk mund ta kufizojmë vetveten vetëm tek emrat pa pasur parasysh edhe vetë subjektin – konceptet dhe nocionet themelore të tij. Interesimi për faktet dhe idetë na shtyn të ndërmarrim një qasje kognitive, me përqendrim në dijen enciklopedike. Ne fillojmë me konceptin, pasi besojmë se duke identifikuar konceptin, mund ta zgjidhim së paku një pjesë të problemit- të ofrojmë një definicion të qartë për atë që bëhet fjalë, pra për nocionin në shqyrtim. Problemi tjetër është se si ne flasim për këtë nocion, pasi mund të ketë më shumë se një term për një koncept të vetëm dhe ky është një nga premiset me të cilat Timmerman i kundërvihet Teorisë së Terminologjisë së Përgjithshme.

Për këtë arsye, analiza kontrastive përmes metadialekteve na mundëson të krijojmë një ide se si përdoret termi. Ne nivelin metataksonomik (praktika e parimeve për klasifikimin) , shqetësimi ynë kryesor është aspekti heuristik i subjektit (metoda e gjetjes së zgjidhjeve) – metodologjia e marrjes me termin dhe sistemin terminologjik me qëllim të standardizimit dhe optimalizimit të mëtejshëm. “Dimensioni ndërkombëtar” i përdorimit të termave përbën majën e kërkimeve në këtë fushë. Qasja heuristike është e pandashme nga ajo ontologjike: nëse formuluesi i termit merr parasysh strukturën dhe përbërjen e termit (plani ekspresiv), më pas ai është përgjegjës edhe për përmbajtjen.

14

Në rastin tonë kemi të bëjmë me epitetet civic dhe citizen që në anglisht kanë vlerë sinonimike, por në rastin konkret emërtojnë lloje të ndryshme gazetarie apo sigazetarie. Së këndejmi, në rastin konkret nuk guxojmë të mbështetemi në kuptimin që këta terma japin në anglisht, pasi sipas fjalorëve të Oxford-it këto dy fjalë dallojnë aq pak saqë përdoren shpesh edhe në vend të njëra-tjetrës.

Përpjekja për të gjetur dallime ndërmjet termave dhe fjalëve nuk është më e frytshme dhe e vlefshme, prandaj mënyra më e mirë e studimit të njëjësive të dijes së specializuar është studimi i sjelljes së tyre brenda tekstit. Meqenëse funksioni i përgjithshëm i teksteve të specializuara gjuhësore është transmetimi i dijes, tekstet e tilla synojnë të formësohen në modele me qëllim të sigurimit të kuptimit dhe përgjithësisht karakterizohen nga një përsëritje më e madhe sesa termat e zakonshëm, frazat, fjalitë dhe madje edhe paragrafët e tërë. Tekstet shkencore dhe teknike zakonisht janë më të pasura në aspektin e terminologjisë, për shkak të sasisë së njëjësive të specializuara gjuhësore që përmbajnë. Përqendrimi i madh i njëjësive të tilla në tekst çon kah një aktivizim i sektorëve në domene specifike të dijes dhe si rrjedhojë, të kuptuarit e tekstit të pasur me terminologji, kërkon njohje të domenit, të koncepteve brenda tij dhe raporteve propozicionale në kuadër të tekstit, si dhe të marrdhënieve konceptuale në kuadër të domenit. Ky është hapi i parë drejt krijimit të një teksti të synuar që është i pranueshëm. Të gjitha këto elemente janë të synuara nga terminologjia e mbështetur në kornizën kuptimore.

15

Duke mbetur gjithnjë te këta dy terma që sipas analizës sime sociokognitive duhet të jenë Gazetari qytetare për gazetarinë e profesionistëve që mëtojnë të jenë pjesë e zhvillimeve politike dhe shoqërore dhe Gazetari civile për gazetarinë e amatorëve që synojnë të plasojnë lajme por jo edhe të jenë pjesë e ndryshimeve politike e shoqërore, duhet përkujtuar se sipas Pamela Faber (2009) Terminologjia e kornizuar përqendrohet në: (1) organizimin konceptual; (2) natyrën shumëdimensionale të njëjësive terminologjike; dhe (3) ekstraktimin e informacionit semantik dhe sintaksor përmes përdorimit të korpusit multilingual. Në terminologjinë e kornizuar, rrjetet konceptuale mbështeten në një domen i cili prodhon yrrneqe për veprimet dhe proceset që ndodhin në fushën e specializuar, si dhe për entitetet që marrin pjesë në të.

16

Studimi i gjuhës së specializuar po kalon nëpër një ndryshim kognitiv që çon kah një përqendrim i theksuar në kuptimin si dhe në strukturën konceptuale të cilës i nënshtrohen teksti dhe gjuha në përgjithësi. Duket se teoria mbi terminologjinë po përqendrohet në studimin e njëjësive të gjuhës së specializuar nga perspektiva sociale, linguistike dhe kognitive.

Kognitivistët si Faber, Temmerman e të tjerë mendojnë se terminologjia është veprimtari linguistike dhe kognitive, pasi termat janë njësi gjuhësore që përmbajnë kuptime konceptuale në kuadër të kornizës së teksteve të dijes së specializuar. Në kuptim të natyrës së termit, ky proces i transmetimit të kuptimit është po aq i

rëndësishëm sa edhe koncepti të cilin ai e dizajnon. Një qasje e tillë, sipas tyre, duhet të jetë leksikocentrike dhe e mbështetur në përdorim, si dhe e fokusuar në përfaqësimin kuptimor dhe konceptual. Në të vërtetë, kjo është esenca teorike e qasjes kognitive gjuhësore.

Në të kaluarën, Terminologjia dhe Linguistika kryesisht kanë injoruar njëra-tjetrën. Në fazat fillestare, Terminologjia ka qenë e interesuar për pavarësim nga fushat e tjera të dijes, me synimin për të krijuar një disiplinë krejtësisht të pavarur. Terminologët kanë shkuar aq larg sa kanë thënë se termat nuk janë fjalë. Njëjtë është sjellë edhe linguistika duke sforcuar idenë se gjuha e specializuar është konsideruar si rast i vecantë i gjuhësisë së përgjithshme.

Sipas Pamela Faber, teoritë kognitive përqendrohen në aspekte sociale, komunikative dhe kognitive të terminologjisë. Vizioni që ofrojnë është më realist, pasi ata analizojnë termat ashtu siç përdoren dhe ashtu siç sillen në tekst. Ky prandaj, është ndërrimi kognitiv në qasjen ndaj terminologjisë.

17

Çështja del te qasja që duhet adoptuar për t'iu qasur terminologjisë. Si të vepohet me traditën terminologjike të shkencës botërore, që është një qasje standardizuese optimalizuese e mbështetur në latinishten dhe në greqishten e vjetër. Akhmanova (1977, 91-92) thotë se fjalët ndërkombëtare (me origjinë latine ose greke) që na kthejnë në retorikën e lashtë nuk sigurojnë transmetim direkt dhe të tërësishëm të informatës, por në të njëjtën kohë sigurojnë korrespondencën më të plotë të mundshme ndërmjet shprehjes origjinale dhe asaj metalinguistike të përkthyer.

Tani, qasja kognitive kërkon që të përdoret një term i cili vihet në funksion të informatës dhe të komunikimit, dhe jo që të jetë term për vetveten, sic janë termat latinë. Kjo qasje siguron komunikim më efikas dhe më përmbajtësor, rrjedhimisht edhe më të gjerë, brenda një komuniteti gjuhësor, pasi termat e latinishtes dhe të greqishtes së vjetër, jo vetëm që kanë probabilitet më të lartë të të qenit të pakuptueshëm, por duke qenë se vijnë nga gjuhë tashmë të vdekura, nuk arrijnë të jenë krejtësisht të përputhshme me nevojat e komunikimit, pra nuk e krijojnë maksimalizimin e përputhjes konceptuale me rastin e të kuptuarit të gjuhës në secilin domen përdorimi.

Interdisiplinariteti shkencor, rrit edhe më shumë nevojën për standardizim terminologjik. Rainer Arntz (1993:5) thekson se parimi rrënjësor në shkencë dhe metodologji si dhe në mjetet e komunikimit, sa i përket terminologjisë kërkon rregulla strikte dhe një standardizim më rrënjësor të gjuhës. Për të qenë në gjendje të sistematizojmë informatat që futen në bazat e të dhënave apo për të analizuar sasi të konsiderueshme të të dhënash nxjerrë nga sistem të ndryshme, vokabulari i fushave të

caktuara duhet të kontrollohet. Të kontrollohet në këtë kuptim do të thotë se ka shumë nevojë për përpjekje për zhvillim të leksikut mendor që na mban në linjë me zhvillimet në fushat e caktuara dhe që ndihmojnë për të ndërtuar vokabularë të qëndrueshëm.

18

Në punimin e tij “Terminological equivalence and translation”, Arntz flet për ekuivalencën ndërgjuhësore, me rastin e marrjes me punë shkencore, ku involvohen më shumë se një gjuhë, qoftë për shkak të literaturës së shfrytëzuar, qoftë për shkak të gjuhës së korpusit të hulumtuar në shkencat humane. “Problemi bëhet edhe më i komplikuar kur krahasohen njësi më të mëdha si fjalitë, pjesët e tekstit apo tekste të tëra. Së këndejmi, nuk është befasuese se çështja e ekuivalencës interlinguale luan rol qendror në teorinë e përkthimit”. Mirëpo, thotë Arntz kushtet për krahasim ndërgjuhësor janë shumë të favorshme në fushën e terminologjisë, pasi “termat e definueshëm apo të definuar janë në qendër të interesit, ndërkohë që konotacionet luajnë rol dytësor”.

Sigurisht që nga gjuhët e gjalla sot vetëm anglishtja ka kapacitete për të përmbushur nevojat e një terminologjie të standardizuar, mirëpo jo gjithmonë ndodh kështu, pasi gjuhët e caktuara janë në shërbim të komuniteteve të caktuara të cilat kanë vetëdije dhe mentalitet të ndryshëm gjuhësor, ku anglishtja nuk arrin të ushtrojë ndikimin e saj për të realizuar të trija dimensionet e domosdoshme për qasje moderne terminologjike. Nëse realizohet aspekti lingvistik dhe ai kognitiv, mund të dështojë aspekti komunikativ etj.

19

Sa për ta menduar çështjen edhe më thjesht krahasoni termat e përdorur për peshë dhe masë në librat e fizikës në gjuhën shqipe. Ato alternohen ndërmjet tyre dhe janë në shpërputhje me aspektin komunikativ. Rëndesa aty nuk quhet peshë, por masë. Mirëpo, sado i arsyetueshëm të jetë përdorimi i këtyre termave në aspektin shkencor, në rrafshin komunikativ kjo terminologji nuk arrin të realizohet. Një shembull të kundërt kemi përdorimin e termit temperaturë për zjarrmi. Sigurisht që nëse themi se dikush ka temperaturë nuk kemi thënë nëse ai person ka temperaturë të lartë apo të ulët. Termi popullor në shqip është zjarrmi që nënkupton temperaturë të lartë trupore, ndërkohë që termi temperaturë nuk është marrë nga anglishtja pasi aty përdoret termi fever, ndërsa në latinisht përdoren termat hipertermi dhe hipotermi për temperaturë të lartë dhe temperaturë të ulët trupore.

## Literatura

1. Akhmanova, O. S. (1966): A dictionary of linguistic terms. Sovetskaja ènciklopedija, Moscow.
2. Barsalou, L.W. (2003) "Situated simulation in the human conceptual system". *Language and Cognitive Processes* 18. pp. 513-562.
3. Cabré Castellví, M.T. (2000a) "Elements for a theory of terminology: Towards an alternative paradigm". *Terminology* 6(1). pp. 35-57.
4. Faber, Pamela. 2009. The cognitive shift in terminology and specialized translation. *MonTI. Monografías de Traducción e Interpretación*, no. 1: 107-134
5. FABer, P. (2002) "Terminographic definition and concept representation". In: Maia, B. (ed.) *Training the Language Services Provider for the Neë Millennium*. Oporto (Portugal): University of Oporto. pp. 343-354.
6. FelBer, H. (1984) *Terminology Manual*. París: UNESCO & INFOTERM.
7. Felber, Helmut, *Terminology Manual*, Prep. H. Felber/General Information Programme and UNISIST/ International Information Centre for Terminology, Paris; UNESCO and Infoterm, 1984:31
8. Fillmore, C. J. (1976) "Frame semantics and the nature of language". In: Harnad, S. R.; H. D. Steklis & J. Lancaster (eds.) *Origins and Evolution of Language and Speech*. *Annals of the NY Academy of Sciences*, 280. pp. 20-32.
9. Natalya B. Gvishiani, *Terminology as knowledge banks: the cognitive approach (with special reference to multilingual lexicography) në:* [http://www.euralex.org/elx\\_proceedings/Euralex1992\\_1/023\\_Natalya%20B.%20Gvishiani%20-Terminology%20as%20knowledge%20banks-%20the%20cognitive%20approach%20\(with%20special%20re.pdf](http://www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex1992_1/023_Natalya%20B.%20Gvishiani%20-Terminology%20as%20knowledge%20banks-%20the%20cognitive%20approach%20(with%20special%20re.pdf)
10. Sager, J. C., *A practical course in terminology Process*, Amsterdam / Philadelphia, Benjamins 1990
11. TemmerAn, R. (1997) "Questioning the univocity ideal. The difference between sociocognitive Terminology and traditional Terminology". *Hermes. Journal of Linguistics* 18. pp. 51-91.
12. TemmerAn, R. (2000) *Toëards Neë Èays of Terminology Description*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.

13. Temmerman, R. (2001) "Sociocognitive terminology theory". In: Cabré, M.T. & J. Feliu (eds.) Terminología y Cognición. Barcelona: Universitat Pompeu Fabra. pp. 75-92.
14. Wüster, E. (1968) The Machine Tool. An interlingual dictionary of basic concepts. London: Technical Press.

Bardh Rugova, 4

Cabré, 10, 17, 18

Eugen Wüster, 5

Faber, 10, 17

Fleber, 6

Pamela Faber, 4, 9, 11

Sager, 5

Temmerman, 6, 7, 10



**Kujtim M. SHALA**

**SAMI FRASHËRI - AUTOR YNI**  
*(Letërsi, identitet e ideologji)*

**I**  
**SAMI FRASHËRI - AUTOR YNI**

Autori i njohur, Sami Frashëri, dijetar e letrar, përkthyes, një nga figurat e mëdha të dijes, gjuhësisë e të kulturës perandorake osmane/turke, është njëherit ideologu (me shkrim) i Rilindjes Shqiptare, me *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë?* (1899).

Sami Frashëri është një figurë e ndërliqshme, që provon raportet e dy letërsive, të dy kulturave, gjuhëve dhe të dy ideologjive (njëra *identifikuese/përbashkuese* e tjetra *diferencuese*). Ky raport i dyzuar, në nivel shkrimi, më së thelli duket te drama e tij *Besa* (1874), që është një vepër tematikisht shqiptare, por me *ndodhi* në gjirin e jetës së përbashkët (perandorake) të shqiptarëve me të tjerët dhe e shkruar në turqishte.

*Sami Frashëri - autoryni*, i lakuar si *Letërsi, identitet e ideologji*, e hap veprën e Sami Frashërit në kapërcimin nga kultura perandorake, të cilës i dha e mori, te diskutet nacionale, madje tek artikulumet programatike të veprimit e të jetës nacionale. Gjithë kjo kërkohet në prozën *Dashuria e Talatit me Fitneten* (1872), në dramën e njohur *Besa* dhe në traktatin *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë?*, dy të parat si fikcion e figurë, ndërsa e fundit si projekt idesh e normash të veprimit nacional, si ëndërr e dhënë dhe e thënë në një utopi të rrallë nacionale.

*Sami Frashëri - autor yni* nënvizon e provon, në veçanti, Frashërin si ideolog nacional, si një projektues të idesë nacionale në formë traktati, si norme të shkruar. Njya e tillë ndërliqësohet fort kur kemi parasysh punët e mëdha të Sami Frashërit në fushën e dijes e të kulturës osmane/turke. Ndaj, formulimi *Sami Frashëri - autor yni* vetiu merr parasysh *Sami Frashërin - autor të atyre*, apo *autor të përbashkët*.

Vepra e tij e shenjon, tashmë në fushën e kulturës, kthimin e shqiptarëve nga vetja, nga esencat dhe nga fytyra autentike e tyre. Sami Frashëri e provon përnjëherë historinë me të tjerët dhe projektionet e ndarjes nga të tjerët, për të shenjuar nyjat e njësisë nacionale përtej kohëve, në jetën autentike shqiptare. Kërkimi i kapërcimit të tillë

brenda diskurseve të Frashërit, sa diskurset nacionale, zbulon shenjat e ndarjes nga diskurset e përbashkëta, që kanë dhe manifestojnë iluzionin e universale. Por, vetë ndarja e provon se universaljet bëhen projeksione, marrëveshje, kode që na bëjnë të ndihemi bashkë ose të jemi bashkë.

*Sami Frashëri - autor yni* e provon të përbashkëtën që ndahet, skajet e jetës e të kulturës që bëhen qendër, por edhe autorin që kthehet nga vetja, nga kultura (e parë) e vendit.

## II LETËRSI: TALATI E FITNETJA

Përcaktimi themelor tematik dhe i diskursit të *Dashuria e Talatit me Fitneten* (*Taşşuk-i Tal'at ve Fitnat*) të Sami Frashërit bëhet në fund, kur autori përmbledh, në shenja komenti të përqendruar, rrëfimin, dhe jep si titull tjetër të veprës: *Libri i fatkeqësisë*. Ky titull buron nga rrëfimi, duke e ndjekur, por dhe duke e interpretuar atë. *Libri i fatkeqësisë* thuret si rrëfim për dashurinë e jetën e humbur të Talatit e të Fitnetes, në shenja diskursi të literaturës sentimentale/lakrimale. Po ky titull shenjon ngrysjen e diskursit, të prerë me fatkeqësinë e të mbyllur si tragjedi. Ndërsa, titulli i veprës, *Dashuria e Talatit me Fitneten* shenjon përnjëherë temën dhe subjektet e rrëfimit, duke i vënë në një shkallë barabarësie narrative, që duket e provohet kur hapet teksti faqe pas faqeje. Talati e Fitnetja janë si dy faqe të një letre, që shkruhet me dhimbjen e dashurisë dhe të jetës së tretur e të mbyllur me fatkeqësi.

Tematikisht, *Dashuria e Talatit me Fitneten* është rrëfim për dashurinë si esencë universale, e cila provohet në një situatë konkrete e që i jep shenjat e kontekstit social të ndodhisë. Ky kontekst bën që universaliteti i dashurisë të këputetet nga arbitrariteti i vendimeve të *autoritetit*. Fitnetja do Talatin e ri dhe kjo është sjellje universale; njerku, që kjo e mendon si baba, e jep për një të vjetër, që del të jetë babai i vërtetë i Fitnetes, dhe kjo është sjellje kontekstuale, që zbulon premisa sociale e kulturore, mënyrë sjelljeje, një kanun që fiton, edhe kur rrënon jetët. Lidhja e fortë me kontekstin dhe me shenjat kulturore e sociale, e bën *Dashurinë e Talatit me Fitneten* një rrëfim për vendin e kohën, për normën e rëndë, përballë të cilave rri historia e fatkeqësisë së Talatit e të Fitnetes, si një dëshmi e zezë. Po kjo lidhje, e bën Sami Frashërin tonë, autor të tyre, Şemsettin Sami, një autor të perandorisë e të jetës në perandori.

\*\*\*

*Dashuria e Talatit me Fitneten* është strukturuar në kapituj të shkurtër, në tekst narrativ, të shoqëruar me dialogë e letra, dhe në komente, që zbulojnë strategjinë

narrative. Teksti është klasik, pa shtresime të gjera semantike, i lidhur në mënyrë lineare, me personazhe që përfaqësojnë rrafshin tematik, veti që *Dashurinë e Talatit me Fitneten* e bëjnë një vepër të mbyllur/klasike, të *lexueshme* (Rolan Bart).

Veprat e tilla lidhen fort me fabulën dhe kërkojnë të lexohet ajo fjalë pas fjale, ashtu siç është shkruar, për ta ndjekur *ndodhinë* dhe për të marrë *mësimin* nga ajo që *ndodh*. Këtë e përforcon më tej paralajmërimi i *ndodhive* në titull të çdo kapitulli, që përnjëherë shenjojnë edhe diskursin: *Hyrja në rrëfim*, *Biseda*, *Puna e martesës* apo *Brengosja*, *Dita e zezë*, *Brenga* etj. Ndërsa, narratori, që di gjithçka, gjithnjë krijon paktin me lexuesin, për të rrëfyer, për të ndërruar fokusin e për t'u rikthyer sërish te rrëfimi i parë, i lidhur me dy heronjtë e tij, Talatin e Fitneten: "Talatin dhe Fitneten po i lëmë të takohen, të bisedojnë, të dashurohen, e ne, të kalojmë pak në Yskydar".<sup>1</sup> Strategjia e tillë ndiqet ngado tekstit, edhe kur nuk shpallet në këtë trajtë. Kapërcimet e tilla ndërtojnë kontekstin, për ta vijuar më tej rrëfimin themelor, qoftë dhe duke thurur një rrëfim alternativ, me të cilin do të takohet e do të kryqëzohet rrëfimi i parë. Narratori dhe strategjia e tillë narrative në tërësi janë tipike për rrëfimet klasike, të lidhura me veprimet, që prodhojnë ose zbulojnë fate personazhesh.

Rrafshi i motivimit letrar dhe i të *vërtetduksbmes* reduktohen nga ndërhyrjet për të lidhur apo për të zgjidhur situatat, që janë ndërhyrje autoriale, me shenja të forta arbitrariteti, sa për shkak të formës, aq dhe për shkak të prozatorit. Gjithë kjo e dobëson retorikën e tekstit, e cila është një rrjet strategjish me synim lexuesin, por dhe një kategori/esencë ontologjike e veprës letrare.

Për t'i provuar së bashku formën narrative të tekstit dhe strategjinë retorike të tij, në fund, rrëfimi përmbledhet në një koment, që do të jetë mësimi themelor i veprës:

### **Përmbledhje**

*Po qe se kuptuam rrjedhën e ngjarjes, del kjo: Salihja, Eminja, Haxhibaba dhe Ajshja kur dëgjuan për këtë ndodhi, përjetuan fate të vështira, Salihja, nga vaji i tepërt u verbua në të dy sytë, Eminja, duke mos duruar këtë fatkeqësi, vdiq e pikëlluar brenda një jave. Mendoj se edhe zemrat e të tjerëve nuk kanë mundur të durojnë një vepër të tillë. Titulli i këtij libri do të mund të ishte edhe "LIBRI I FATKEQËSISË" (Musij-bet-name).<sup>2</sup>*

Shenjat e moralizimit forcohen nga situata finale, që kap fatin e zi, pra fatkeqësinë, e të gjitha personazheve, në të cilën të gjithë janë të humbur. Vritet dashuria, vriten të gjithë, dëshmon e provon teksti i Sami Frashërit.

<sup>1</sup> Sami Frashëri, *Dashuria e Talatit me Fitneten*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 89.

<sup>2</sup> Po aty, f. 152.

*Dasburia e Talatit me Fitneten* është shkruar në turqishte dhe për herë të parë është botuar në vitin 1872, në qendrën e perandorisë, në Stamboll. Është vepra që hapi literaturën e këtij autori. Janë këto shenja të vendit e të kohës, por edhe të kulturës së autorit, ashtu siç janë shenja që shpjegojnë njohjen e vonë të veprës në kulturën shqiptare.

Kjo vepër zbulon shenjat e para të kulturës letrare të Sami Frashërit, lidhjen e hershme me letërsinë, që do të provohet si lidhje e përhershme, dhe e hap njëren faqe të veprës ditunore e kulturore të tij, atë në turqishte.

### III

#### LETËRSI E IDENTITET: *BESA*

Dramën *Besaose fjala e dhënë (Besa yabud Abde Vefâ)*, veprën e tij të rëndësishme letrare, Sami Frashëri e shkroi në vitin 1874, ndërsa e botoi një vit më pas, në Stamboll. E shkroi në turqishte. Vendi i shkrimit/botimit dhe gjuha janë shenja biografike të autorit e bibliografike të veprës, të shqiptarit që jeton në Stamboll e që shkruan turqisht. Autori shqiptar zgjedh një temë shqiptare, ambient shqiptar, në Perandorinë osmane/turke, për të kapur cepat e jetës së shqiptarëve në këtë perandori, shenja të jetës autentike e të etikës së vendit. Besa e dhënë duhet të mbahet përtej çdo situatë e emocioni, përtej çdo humbjeje e dhimbjeje, një formulë kjo shqiptare, që shfaqet përtej një kohe e një konteksti, sepse besa është kodi që mban nderin e nderi është njësi që e përcakton jetën autentike shqiptare. Në këtë një lidhet mësimi i veprës, të cilin teksti e sprovon në situata të rënda, të përkthyer në sprovë personazhesh.

\*\*\*

Teksti është strukturuar në gjashtë pamje, secila me status akti. E dominojnë dialogët. Në tri pamjet e para veprimi është minimal, madje mungon drama dhe teksti shkon drejt një idile. Personazhet hyjnë në ndodhi të ndërtuar dhe nuk determinohen nga ajo. Janë ata që e prodhojnë ngjarjen, si rrjedhim të sjelljes së tyre, që buron nga kodi social ambiantal i sjelljes e nga karakteri i tyre. Drama nis kur krijohet trekëndëshi dramatik i dashurisë dhe arrin kulmin me vrasjen e Selfos nga i ati, Fetahu.

Në këtë pikë, për të hapur kontekstin e kodit të sjelljes dhe të mësimin themelor të veprës së Frashërit, na duket e nevojshme që të parafrancojmë tekstin.

Gjithçka nis në Progonat, në Malësi të Jugut shqiptar, si histori dashurie barinjsh, me shenjat e një idile. Të rritur në një shtëpi, si vëlla e motër, kushërinjtë Rexhepi dhe Merushja, duhen e druhen për dashurinë e tyre. Pamjet e para të dramës shtrihen si zbulim i ngadaltë i kësaj dashurie, në monologët e personazheve, derisa atë të mos e

kuptojë dhe provojë Zyberi, i ati i Merushes. Ai e pranon dashurinë e tyre dhe i fejon. Por, Selfo, trim i beut e djalë i vetëm i Fetahut, luftëtar i mërguar, e do Merushen dhe, pasi nuk arrin ta fitojë, me lejen e beut, e vret Zyberin dhe e rrëmben atë. Vahideja betohet të marrë hak për vrasjen e burrit dhe rrëmbimin e së bijës. Po atë ditë, Selfo kishte marrë lajmin për kthimin e shpejtë të të atit. Fetahun e pret dhe do ta vrasë me dredhi Selmani, një luftëtar tjetër nga Borshi, vendës i Fetahut. Vahideja e vret Selmanin, e shpëton Fetahun, ndërsa ky i jep besën se do të marrë hak në vend të saj, për vrasjen e burrit dhe vajzën e rrëmbyer, duke e njohur Vahidenë për motër. Fetahu shpejt e kupton se vrasësi e rrëmbyesi është Selfo. Këtu nis drama e madhe, thyerjet e mëdha, këtu testohet kodi, besa/fjala e dhënë. Ai s'ia thotë Vahidesë se Selfo është i biri i tij, e vret për të marrë hak dhe pastaj godet veten. Vret të birin, për të mbajtur besën e dhënë, dhe vret veten si gjakës të djalit.

Edhe kjo parafrazë e provon shtrirjen e mythos-it, peripecitë dhe thyerjet e tij, që, së bashku, e ndërlikojnë atë përtej lidhjes së fortë, tipike për tekstet dramatike. Kështu zvogëlohet tensioni dramatik, dominon gjuha, prandaj domi-nojnë idetë e mësimi.

Mësimi themelor për besën, si shenjë morale (autentike) e jetës shqiptare, shoqërohet me ide të rrafshit social e politik, pra nacional. Janë këto që diferencojnë barinjët e njerëzit e beut, si diferencim ndërmjet pushtetit e popullit, në planin social e politik. Po Frashëri e dramatizon jetën shqiptare në një cep të Perandorisë osmane/turke, për të provuar shenja autentike të jetës, përballë jetës në një perandori, që ka shenjat e jetës së përbashkët me të tjerët. Samiu shenjon jetën baritore si jetë autentike, si jetë që mban shenjat autentike, ndaj shenjat e identitetit. Këto shenja japin personazhet që mbajnë e mbrojnë nderin, si esencë të jetës, personat që jetojnë ndershëm dhe që vdesin për të mbrojtur nderin. Kjo do të thotë ta mbrosh jetën me vdekje, meqë jetën e bën nderi dhe nga ai buron gjithçka, nga ai buron lumturia, ai ruan shenjat e thella të identitetit. Kjo, në dramën e Frashërit, provohet me fjalë e me veprime.

Nder e besë lidhen fort, meqë besa, fjala e dhënë dhe e mbajtur, është shenjë nderi autentik, ndërsa nderi - shenjë e jetës autentike. Këtë jetë shqiptare Sami Frashëri e kryqëzon me jetën në perandori, kur besën, nga një kod vendi, e bën edhe kod të lidhur me religjionin, meqë personazhi i tij, Fetahu, lidh besën mbi Librin e shenjtë (*enamnë*), pra ai jep *besën* duke bërë *benë*. Por, beja është e fortë vetëm në zemrën e atij që ka besë.

Se shenjat e jetës autentike kërkohen në qarkun e jetës së përbashkët në perandori, e provon diskursi i personazhit, kur bëhet zëdhënës i ideve të autorit, për ta shpallur perandorinë mëmëdhe të përbashkët dhe luftën për të, luftë për mëmëdheun. Te *Shqipëria...*, vite më pas, kjo ideologji do të relativizohet e pastaj do të kontestohet, në kapërcimin nga kërkesa për jetë autentike përbrenda perandorisë, te projekti për jetë

më vete. Po këtu Samiu sillet në qarkun e letërsisë, ndërsa te traktati i njohur bëhet ideolog nacional dhe projekton rrugën politike nacionale. Vëllai i tij e poeti kombëtar, Naim Frashëri, përkundër, gjithçka e bënte letërsi, së pari idetë nacionale, të lidhura me veprimet e heroit nacional, Skënderbeut, të kënduara në kohë të ligë, si ngjallje të kujtesës, të lavdisë e të krenarisë nacionale. Ideologu Sami Frashëri shtrin idetë e tij në diskurse racionale e në frymë iluminizmi. Poeti Naim Frashëri këndon me mall kohët e lavdisë shqiptare në retorikë që synon emocionet e si thirrje për veprim nacional. Te *Besa*, Samiu shenjon e veçon vendlindjen si vend të identitetit e të emocionit.

Në leximin që ndjek dramën e përbashkët të personazheve, evidentohen disa drama, në të cilat mbyten Vehideja, Merushja, po më së thelli Fetahu.

Është drama e këtij të fundit që e bën atë personazh themelor, qoftë kur e jep, qoftë kur e jeton së brendshmi, qoftë kur e përmbush besën, në fund kur vret veten. Ai është baba që vret djalën për të mbajtur besën. Gjakësi i lidhur për fjalën e vet, që bëhet dhe katil i vetes. Ai është njeriu i ambientit, i lidhur për kodin e tij, që bëhet fjalë e fjala duhet të bëhet vepër, por vepra prodhon tragjedinë. Këtu drama është në kulm, në pikën e tensionit dhe gjithçka tjetër bëhet vetëm për t'u mbyllur ajo.

Parafraza, si dhe karakterizimet e veprimeve e provojnë *Besën* e Sami Frashërit si një dramë të etikës së vendit e të rendit, që buron nga jeta shqiptare, e lidhur me kodin e nderit e të besës. Fjala është fytyra e njeriut, fjala e dhënë duhet të bëhet veprim, qoftë edhe kur vritet shpirti. Kjo është historia e dramës së Frashërit, etika që shenjon ajo, jo për ta universalizuar, por për të dëshmuar jetën e një ambienti, të matur me kode të rënda gur.

#### IV SHQIPËRIA NË TRI PAMJE (Ideologjia nacionale)

*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?*-Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga rezultat që e kanë rethuarë është vepra themelore ideologjike e Rilindjes Shqiptare, që lidh e jep idetë e mëdha të nacionit e të jetës politike të tij, njësitë e identitetit historik, madje mitik, dhe që projekton të ardhmen e tij politike.

Kjo vepër e zbulon Sami Frashërin dijetar në fushë të jetës nacionale, njeri që projekton e përshkruan veprimet politike nacionale, sistematizues të ideve për pavarësi të shqiptarëve. Është vepra e ideve nacionale të Sami Frashërit, e gjuhës shqipe të tij, vepra e Sami Frashërit - autor yni.

*Shqipëria...* është botuar në Bukuresht, më 1899, kur po thyhej shekulli, në thyerjet e mëdha të jetës politike në Ballkan dhe në Perandorinë osmane/turke, në përthyerjet e veprimit nacional shqiptar, të lidhur me Lidhjen e Prizrenit e të rihapur me Lidhjen e

Pejës. Në këtë pikë të jetës nacionale, Sami Frashëri, në struktura të forta retorike e të mbushura moralizime, artikulon mësimet e tij për Shqipërinë dhe shqiptarët në histori, në aktualitet dhe projektin jetën e tyre të ardhme, jetën e Shqipërisë së pavarur e të shqiptarëve të bashkuar. Duke ndjekur këto kohë, vepra është strukturuar në tre krerë: *Ç'ka qenë Shqipëria?*, *Ç'është Shqipëria?* dhe *Ç'do të bëhet Shqipëria?* Kreu i fundit e zbulon ideologun nacional e politik, në diskurse të filozofisë politike, në diskutet e rezonit të shtetit, një traditë kjo e vyer e mendimit për politikën dhe për shtetin, si strukturë që lidh njerëzit politikisht e që do të garantojë qenie e identitetet. Ndërsa, projeksionet politike e bëjnë Samiun një ëndërrimtar, që, në traditën e vjetër, e kërkon drejtësinë si themel të shtetit dhe etikën si frymë të jetës së përbashkët.

E strukturuar në tre krerë, *Shqipëria...* jep tri pamje kohore të Shqipërisë: të shkuarën historike e mitike, të identifikuar me pellazgët; të tashmen, në pikën e veprimeve për pavarësi; e të ardhmen, Shqipërinë e projeksionit të Sami Frashë-rit, Shqipërinë e shqiptarëve, të lidhur pazgjidhshëm me gjuhën e me nacionin. Në përputhje me kohët, teksti strukturohet një herë si rrëfim, me evidenca historike, pastaj si dëshmi, me evidenca politike, së fundmi si prospeksion, me shenjat e mëdha të një projekti politik a të një utopie nacionale.

\*\*\*

Kreu i parë është strukturuar si kujtim historie e lavdi mitologjike e pellazgëve, ilirëve, epirotëve e shqiptarëve, që Samiu, në frymën e rilindësve, i mendon që të gjithë si paraardhës e (proto)shqiptarë, shqiptarë të vjetër e të rinj. Skica historike e Frashërit kap shqiptarët nën romakët, mbretëritë e vogla të shqiptarëve të kohëve të fundit të Bizantit, Shqipërinë e Skënderbeut dhe shqiptarët nën e në Perandorinë osmane, për të nënvizuar fort gjuhën si shenjë të nationit, por dhe punët e shqiptarëve në shërbim të të tjerëve. Në këto nyja Frashëri bën skicën e tij, me pamje të mëdha, në diskurs që kërkon evidencat, por që paprerë mbytet në emocionet e shqiptarit për historinë e shqiptarëve. Gjithë kjo bën që të ndërtohet skema e kalimit të moralizimit e mëdha nacionale, kur, përballë lavdisë së shkuar e të tretur, skicohet e tashmja e rrëguar, në teh të humbjes e të zhbërjes. Si emocionet, ashtu edhe mësimet e Sami Frashërit i japin tekstit ngjyra të forta retorike, me të cilat ai do të bindë shqiptarët për të ndërtuar Shqipërinë, duke ua kujtuar historinë e shkëlqimit të saj, krenarinë dhe lavdinë e dikurshme, përballë zisë së sotme, përfundimisht për t'i kthyer nga e ardhmja, përmjet shpirtit të lartë të së shkuarës.

Nëse ky ishte një iluzion, kur Frashëri i shkruante idetë e pak shqiptarë mund të lexonin, është çështje tjetër. Por, teksti i tij kërkon të nxisë veprim në fushën e jetës nacionale, veprim të ngjyrosur politikisht, duke e parë dhe artikulluar politikën si diskurs

të vetëdijes nacionale. Kërkesa e Sami Frashërit lidhet pazgjidhshëm me idenë për të punuar për vete, si Skënderbeu e si në kohën e tij. Puna për vete, në ideologjinë e Frashërit, është veprim për mëvetësi.

\*\*\*

Pamja e dytë që jep traktati i Sami Frashërit është ajo e Shqipërisë së kohës së tij, e lidhur në nyja përkufizimi të territorit, të vendit, të njerëzve, bashkë me shqiptarët jashtë Shqipërisë. Pamja përthyeret në përshkrim e vlerësime të gjendjes së shqiptarëve, të çështjes së nacionit e të veprimeve, të rreziqeve, miqve të Shqipërisë, shkrimit të gjuhës shqipe, si esencë nacionale, dhe mbyllet me përshkrimin social e politik të Shqipërisë, të mbytur në varfëri e pa një qeveri që ta udhëheqë.

Në pikën e parë, Frashëri shenjon rrudhjen e vazhdueshme të territoreve të Shqipërisë, që nga lashtësia e deri në bashkëkohësi. Në diskursin e tij, rrudhja ka përmasa të tmerrshme, duke ditur se Samiu vend të parë të shqiptarëve i shenjon vendet pellazge, ilire, epirotase, maqedonase, trakase e frigjase. Ndërsa, ajo që përkufizon si Shqipëria sot, është Shqipëria në kufijtë etnikë, shenjim projekti autorial e nacional, meqë zbulon pretendimin politik të tij për shtetin e shqiptarëve. Ky shtet i pretenduar, i përshkruar si vend, i shtrohet një diskursi romantik, me etiketat e një vendi të bukur, me përshkrime të vetive e të shenjave të një ekonomie.

Diskursi i tillë racionalizohet në rezymime që burojnë nga evidencat, kur jepen numri dhe struktura sociale e religjioze e Shqipërisë, që shoqërohen me qëndrime autoriale, sidomos çështja e besës (fesë), që, edhe pse e ndarë, nuk i ka ndarë shqiptarët. Nga këtu, Samiu e artikulon edhe një herë tezën rilindëse, vërtet ideologjinë, për *Shqiptar(ës)inë* si besë të shqiptarëve.

Raporti i shqiptarëve me turqit lexohet si themelor dhe Frashëri e hap atë në dy faza: e para, kur shqiptarët, në dallim nga popujt e tjerë, nuk u bënë robër, por u vunë krah turqve, dhe e dyta, kur shqiptarët u bënë robër e të poshtëruar më shumë se gjithë të tjerët. Kjo fazë e dytë kap kohën e Samiut. Ai sikur shenjon kalimin universal nga shërbëtori në të robëruar dhe me këtë e shpjegon gjendjen shqiptare, raportet e thyera e të ndryshuara në dëm të tyre. Vërtet, ai shkon më tej, duke i dhënë shqiptarët në optikën e turqve, si armiq e tradhtarë të tyre.

Shenjat e zeza që nënvizon fort Samiu, përballë të shkuarës, duan të zgjojnë ndjenjën e refuzimit të së sotmes, rezonimin për gjendjen, si pikë që thyen drejtimin nga një gjendje tjetër. Një diskurs racional, që, paradoksisht, do të prekë emocionet, një provë empirike, që do të funksionojë si provë psikologjike. Pamja e dyzuar, atëherë e sot, si dhe pretendimet, strategjia e diskursit, provohen në rrafsh të ndryshme të tekstit, nga evidencat te strukturimi i paragrafëve, të cilët vihen përballë, për të shenjuar kontrastet.



Qoftë dhe në paragrafë të veçantë, hapet e rrezaton strategjia tekstore e ideologjia autoriale e bindjes dhe e veprimit nacional: vepra për të ndërtuar vendin e qeverinë shqiptare, për të qeverisur me nder e me drejtësi. Vërtet, kjo është një kërkesë universale, që lidhet pazgjidhshëm me rezonin e shtetit modern.

Po, Samiu e di dhe e thotë se: “Për njerinë në këtë jetë s’ka gjë m’e vjejtur’ e m’e dashurë se kombërija”, edhe kjo një formulë rilindëse, që përqendron në vete kuptimet e ideologjisë nacionale dhe të veprimeve në fushë të jetës nacionale.

Por, cilat janë rreziqet e Shqipërisë së Samiut, nga kush dhe si vinë ato? Si duhet të sillen shqiptarët përballë tyre? Kënd kanë miq ata? Janë pyetjet e mëdha që shtron Sami Frashëri, përgjigjet e të cilave do t’i shndërrojë në *mësim nacional*.

Nyja e rrezikut mbetet Turqia, që nuk i lë shqiptarët, që i mban të robëruar e në shërbim, që i zhvat e i varfëron, nuk i mbron nga të tjerët, që, në humbjen e vet historike, do t’i marrë me vete edhe ata. Kjo e zbulon raportin e ndërlikuar të shqiptarëve me turqit, por edhe me të tjerët përreth, meqë historikisht, secili, duke e marrë religjionin e shqiptarëve për shenjë identiteti etnik e nacional, i konsideron si vetja, grekë, serbë, turq, për t’i tretur e humbur, për t’i lënë pa nacion e atdhe.

Në kërkimin e shenjave të identitetit nacional, por edhe historik, Sami Frashëri shenjë të parë e njeh *gjuhën*, për ta shndërruar diskursin për të në mësim për identitetin dje e sot, në dëshmi për gjuhën si njësi që ka ruajtur shqiptarët. Frashëri, duke patur parasysh kontekstin historik të shqipes, e njeh si themelor shkrimin e gjuhës. Shqipja i mbrojti e ruajti shqiptarët edhe pa u shkruar, po, që të jetë edhe më tej shenjë identiteti e tyre, duhet të shkruhet. Gjuhët që nuk shkruhen, bëjnë që njerëzve që i flasin të mos u njihet nacionaliteti.

Nga kjo pikë, Samiu mbledh mësimin që mban brenda vetëdijen se shqiptarët me shekuj nuk e kanë shkruargjuhën e tyre, vetëdijen se po s’e shkruan gjuhën, bashkë me të, do të humbasin edhe vetë. Sami Frashëri, rilindësi ynë, bashkë me shenjimin e rrezikut, kur bën ideologjinë e mësimin për gjuhën, shenjon dashurinë e shqiptarëve për nacionin, si dashuri për gjuhën shqipe.

Këtu, teksti i Samiut i kthehet diskursit politik, si përherë me shenja të një retorike që nxjerr robërinë e varfërinë e shqiptarëve, përballë begatisë e lavdisë që kanë humbur.

Kreu i dytë i veprës këputet për të hapur dilemat e rënda të kreut të tretë, të lidhura në pyetjen fillestare: A mund të qëndrojë Shqipëria si është?

\*\*\*

Sami Frashëri e njeh Shqipërinë si një copë të Turqisë evropiane, e ardhmja e së cilës lidhet me çfarë do të ngjajë me Turqinë. Samiu lidhte me variantin në të cilin ajo s’do të arrijë të qëndrojë, ndaj nis e thur projektin e Shqipërisë më vete. Ai tërheq

vëmendjen se shqiptarët që lidhin vendin e tyre me fatin e Turqisë evropiane, do të humbasin bashkë me të. Po ideja e pavarë-sisë e çon te pyetja tjetër, po aq e rëndë në planin politik e të qenësisë nacionale: A mund të jenë zotër të vetes shqiptarët, të mbahen e të ruajnë veten? Frashëri vijon mësimin për të drejtën dhe forcën, që, pa njëra-tjetrën, janë të humbura. Ai që ka të drejtën, duhet të ketë dhe forcën. Shqiptarët kanë të drejtën, tani u duhet forca, meqë e drejta u jep të drejtë edhe për forcën. Por, as njëra, as tjera nuk kanë ndonjë vlerë, kur shqiptarët vijnë të jenë të paditur, pa shkolla e pa gjuhë të shkruar gjerësisht. Të paditurit i kanë duart e lidhura.

Samiu ynë u flet shqiptarëve sa me evidenca e racio të fortë, sa me diskurse që synojnë emocionet. Ai do të zgjojnë përnjëherë vetëdije e krenari, meqë beson se shpëtimi apo humbja e Shqipërisë janë në dorë të vetë shqiptarëve. Ndaj, shqiptarët, së pari duhet të lidhin një besë të madhe, besën shqiptare, për t'u bashkuar. Kjo është rruga e shpëtimit, e shenjuar nga Samiu, që bëhet dhe ëndër politike.

Në mësimin e Sami Frashërit, qëllimi i vetëm i shqiptarëve është ruajtja e Shqipërisë së tërë, e gjuhës dhe e nacionit, që së bashku e bëjnë *Shqiptarinë*. Për të përmbushur qëllimin, është i rëndësishëm një rend projektimesh e veprimesh të fushës së politikës nacionale, nga ndërtimi i institucioneve të shtetit, te përcaktimi i fushave të tyre të veprimit. Samiu kërkon një qeveri të Shqipërisë ndaras Turqisë dhe jep shenjat themelore të saj. Ai e di që Turqia nuk do të dhurojë asgjë, që shqiptarët duhet t'i fitojnë të gjitha vetë, me fjalë e veprë. Qeveria i duhet Shqipërisë si buka e uji.

Nga shkrimi i vullnetit të tillë, gjithë teksti i Frashërit bën projektin për strukturat shtetërore të Shqipërisë, për natyrën e tyre, fushat dhe fuqinë e vendimmarrjes. Në projektin e tij, Samiu ndjek skemat e organizimit të shteteve evropiane, por ka parasysh përherë specifikat e njerëzve, të vendit dhe të kontekstit historik e politik. Në të dy rrafshet, ai do qeveri që nuk e takon direkt nënshtetasin, qeveri që e delegon vendimmarrjen, institucione të së drejtës direkte.

Teksti i Samiut më tej shtrihet si projekt për strukturën institucionale të shtetit, për përbërjen dhe funksionin e institucioneve, projeksionet financiare etj. Kjo pjesë, disi më teknike, vetëm sa e provon Frashërin njohës të shtetit e të praktikave të funksionimit të tij, si dhe shtrin projektin e tij për Shqipërinë politike në dimensione konkrete.

Në të gjitha nyjat, kreu i tretë i veprës, pamja e tretë e Shqipërisë së Samiut, lidh mësimin për qeverisjen e Shqipërisë shqiptare, nga vetë shqiptarët, një mësim ky themelor i Rilindjes, madje një ideologji, që projektton e lidh veprimet nacionale.

\*\*\*

Një “libërth rebelimi” është cilësimi i nënvizuar në debatin turk për *Shqipërinë...* e Sami Frashërit (sipas Agâh Sirri Levend). Debati i ashpër për të arrin në shkallën sa ta

mohojë Samiun si autor të saj dhe veprën ia njeh Naimit. Kjo e provon Sami Frashërin autoritet të kulturës turke, një dijetar e dinjitar të gjuhës turke, sa të mos pranohet Sami Frashëri nacionalist shqiptar. Në këtë debat lidhet nyja fillestare e autorit *tonë* apo të *atyre*, që merr shenjën e autorit të përbashkët.

Vërtet, vepra, si leximet e saj, e hapin çështjen e përfaqësimit të Samiut në fushën e jetës politike, në nyja që lidhin e ndajnë Tanzimatin e jetuar politikisht, iluminizmin e racionalizmin e mësuar dhe Rilindjen Shqiptare të projektuar.

Sami Frashëri është ideolog politik që vjen nga kultura dhe literatura, studiues që turqishten e quan *gjuha jonë* dhe shqipen shpëtimtare të shqiptarëve në stuhitë e shekujve. Në këto nyja lidhet portreti i ndërliqshëm i tij, me *faqen* e kthyer edhe *nga ne*.

Sami Frashëri kërkon diferencimin e *kavm*-it (kombit) turk, duke njohur ngarkesën religjioze e kulturore të tij, diferencimin e turqishtes si gjuhë të turqve, ashtu siç bën ideologjinë e nacionit shqiptar, duke njohur ngarkesën poli-tike të mëvetësimit shqiptar, përtej semantikës religjioze, në hullitë e etnisë e të gjuhës shqipe. Kapërcimi i tillë është ikje nga kultura në ideologji, me bazë gjuhën si kategori identitare e ideologjike.

## V

### LETËRSI, IDENTITET E IDEOLOGJI

Formula *Letërsi, identitet e ideologji*, që e shoqëron Sami Frashërin në këtë lexim, lidh në një vend *krijimin (veprën kulturore)*, *origjinën/përkatësinë e projektionet*, për t'i dhënë tri faqe të një vepre, që, vërtet, janë faqe të një jete, madje të një jete që përfaqëson një fenomen e një epokë, ndoshta një paradoks.

E hapur, kjo formulë e shenjon shqiptarin që shkruan në gjuhë *tjetër*, por që konceptohet si gjuhë universale, pra e përbashkët; shqiptarin që me vepër shenjon identitetet, bashkë e ndaras, për të thënë se në përbashkësi ka një ndarje; përfundimisht, ideologun e madh të Rilindjes, e cila është një projekt politik, me rrënjë në veprën kulturore të shqiptarëve dhe në historinë shpirtërore të tyre.

Në këto nyja lidhet dhe provohet jeta shqiptare e dekadave të fundit të shekullit XIX, si *kulturë* e si *ideologji* që e projektton veprimin. Kështu, Sami Frashëri, nga autor, bëhet *autoritet*, për të cilin lidhen pyetje e pikëpyetje të rënda, madje kërkohen përgjigje të rënda.

Si u pushtuan shqiptarët e si shërbyen? Si mbetën gjallë dhe si e ëndërruan rilindjen? Çfarë ndodh me religjionet (në shumës), përballë nacionit (në njëjës)? Si u ruajt gjuha shqipe e pashkruar dhe a mjafton ajo që të jesh shqiptar?

Vërtet, këto dilema, siç e provon edhe vepra e Frashërit, të çojnë nga kultura në pragmatikë, për ta lidhur, pa e thënë, identitetin me veprimin, edhe me jetën kolektive

të lidhur me shtetin, i cili është një *ontos* politik. Të rikujtojmë në pikë të fundit, Sami Frashëri e shkroi dramën për *besën* shqiptare, me shenjat e moralitetit autentik, por edhe veprën për veprimin politik shqiptar.

Veprimi politik i projektuar, mësimin e Frashërit e bën kontekstual, por çështjet e mësimin janë universale. Identiteti *rrjedh*, mësimi shenjon strukturat që e garantojnë dhe këtu hapet paradoksi ndërmjet rrjedhës dhe kategorive që fiksohen e duan të jenë trashëgimi.

Në këtë pikë, vepra e Sami Frashërisht i jep të gjitha shenjat *me u kujtue*, përballë paradokseve të mëdha kulturore e nacionale, për të rënë te mësimi universal: Për identitetet përherë duhet *me u kujtue*. Pastaj vijnë ideologjitë e veprimi.

**Maria MOROZOVA, Aleksandër RUSAKOV**

## **KORPUSI ELEKTRONIK I SHQIPES: PËRPUNIMI, PËRMBAJTJA DHE PËRDORIMI**

Përpunimi i korpuseve gjuhësore merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e gjuhësisë kompjuterike dhe të studimeve gjuhësore në përgjithësi. Korpusi gjuhësor është një përmbledhje tekstesh, përfshirë tekstet e shkruara në një gjuhë, ashtu edhe gjuhën e folur. Ndryshe nga bibliotekat elektronike, në korpusin gjuhësor të gjitha tekstet dhe pjesët e tyre, siç janë paragrafët, fjalitë dhe fjalëformat, duhen të jenë të analizuara dhe të pajisura me përshkrimin e informacionit gjuhësor dhe jogjuhësor, d.m.th. të **annotuara** (angl. *annotation* ‘shënim, sqarim’). Mjetet programore të kërkimit në korpuse të mëdha marrin për bazë sistemin e **annotimit** dhe i ndihmojnë përdoruesit të gjejë fjalëformat, fjalët dhe togfjalëshat sipas veçorive të tyre morfologjike ose duke pasur parasysh karakteristikat jogjuhësore të teksteve.

Krijimi i korpusit të tillë të annotuar ka për qëllim që t’i ndihmojë punën e gjuhëtarëve lidhur me grumbullimin e shembujve gjuhësore të shumta. Puna e tillë më përpara zakonisht bëhej me dorë përmes shfletimit të librave të shumtë dhe burimeve të tjera të shtypura. Korpusi elektronik u jep mundësinë përdoruesve të gjejnë shpejt shembuj të duhura, ashtu edhe të nxjerrin statistikën për dendurinë e fjalëve të përdorura në një ose disa tekste të preferuara (ose në gjithë korpusin). Rezultatet e studimeve gjuhësore të bazuara në korpusin elektronik mund t’u shërbejnë fushave të morfologjisë dhe sintaksës, ashtu edhe të ortografisë, fonetikës, semantikës, leksikografisë etj. Qëllimi tjetër i krijimit të korpusit gjuhësor gjithëpërfshirës është dokumentimi i gjuhës sipas fushës, kohës, përkatësisë dialektore të teksteve, tipit ose zhanrit të tyre etj. Korpusi i tillë mund të shfrytëzohet në studime diakronike të zhvillimit gjuhësor të shfaqur në tekstet që u përkasin periudhave të ndryshme historike.

Gjuha shqipe, një gjuhë indoevropiane që flitet nga më shumë se 8 milionë folës amtare në mbarë botën, më përpara nuk kishte Korpusin e vet të annotuar. Në fund të vitit 2011 Korpusin e tillë e filluan të krijojnë specialistët nga Sankt-Peterburgu dhe

Moska<sup>1</sup>. Grupin e Moskës e kryeson Prof. Dr. Vladimir A. Plungian, drejtori i departamentit për *Corpus linguistics* (“gjuhësi e korpuseve”) në Institutin e gjuhës ruse të Akademisë së shkencave të Rusisë dhe pjesëmarrësi i projekteve “Korpusi nacional i gjuhës ruse” (*Национальный корпус русского языка*) dhe “Korpusi nacional i armenishtes lindore” (*Восточноармянский национальный корпус*)<sup>2</sup>. Specialistët nga Moska kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve teknike dhe gjuhësore që lidhen me përpunimin e Korpusit. Shkencëtarët nga Sankt-Peterburgu, me Prof. Dr. Aleksandër Ju. Rusakovin në krye, përfaqësojnë institucione të tilla si Instituti i studimeve linguistike i Akademisë së shkencave të Rusisë dhe Universiteti shtetëror i Sankt-Peterburgut. Puna e ekipit të Sankt-Peterburgut lidhet me grumbullimin dhe përgatitjen e teksteve për bazën tekstuale, me përpunimin e annotimit, krijimin e fjalorit gramatikor të Korpusit dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme teorike. Grumbullimi i teksteve bëhet me ndihmën e kolegëve dhe të shtëpive botuese të Kosovës dhe Shqipërisë.

Krijimi i një korpusi gjuhësor, përfshirë edhe atë të shqipes, ndahet në disa etapa kryesore. Në etapën e parë grumbullohet dhe përshkruhet baza tekstuale, d.m.th. tekstet në formë elektronike ku dokumentohet gjuha në shqyrtim. Në etapën e dytë tekste të grumbulluara pajisen me informacionin gjuhësor. Për këtë duhet puna paraprake që lidhet me krijimin e sistemit të annotimit dhe me përpunimin e fjalorit gramatikor, që përdoret pastaj brenda programit të analizës automatike morfologjike, ose *parser*-it. Etapa e tretë përfshin krijimin ose adaptimin e platformës kërkimi dhe vendosjen e korpusit gjuhësor në Internet.

**1. Përbërja e Korpusit elektronik të shqipes.** Në nëntorin e vitit 2012 e përgatitëm dhe vendosëm online versionin provë të Korpusit të shqipes me rreth 750 mijë fjalë teksti. Korpusi vazhdon të zhvillohet dhe plotësohet që nga ai moment, dhe sipas të dhënave të dhjetorit 2013 përmbante rreth 16,8 milionë fjalë teksti (shih Tabelën 1). Vlen përmendur që një “standard madhësie” i arritur së pari në Korpusin nacional Britanik (*British National Corpus*) është 100 milionë fjalë teksti, kurse madhësia e korpuseve të tjera bashkëkohore shkon shumëfish përtej. Për shembull, Korpusi nacional i gjuhës ruse përmbante më shumë se 500 milionë fjalë teksti në fund të vitit 2013. Këta numra duhen konsideruar si qëllim për zhvillimin e mëtejshëm të Korpusit të shqipes.

Nga pikëpamja e trajtimit të teksteve, Korpusi i shqipes zhvillohet si një korpus i baraspeshuar (angl. *Reference corpus*), që pasqyron gjuhën në mënyrë gjithëpërfshirëse

---

<sup>1</sup> Përpunimi i Korpusit mbështetet nga Programi i kërkimeve fundamentale të Akademisë së shkencave të Rusisë “Corpus linguistics”, granti “Korpusi nacional i gjuhës shqipe”. Versioni aktual i Korpusit në përpunim gjendet online:

<http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/>

<sup>2</sup> Versionet online: <http://www.ruscorpora.ru/>, <http://eanc.net/EANC/search/>

duke shfaqur sa më shumë tekste të zhanreve të ndryshme dhe të çdo madhësie. Kështu korpuset e tanishme dallohen nga ato të gjeneratës së parë, për shembull, nga Korpusi i Braunit (*Brown University Standard Corpus of Present-Day American English*), i cili përmban 500 tekste dhe fragmente të teksteve të mëdha, me madhësinë e kufizuar deri në 2000 fjalë. Për sa i përket mënyrës së plotësimit, Korpusi i shqipes trajtohet si një korpus **dinamik**, ose “i hapur”, përmbajtja e të cilit do të ndryshojë kohë pas kohe, duke mbajtur strukturën dhe disa veçori të tjera themelore – ndryshe nga korpuset **statike**, madhësia e të cilave caktohet në fazën e krijimit dhe pastaj mbetet e pandryshueshme.

**Tabela 1.** Struktura dhe përmbajtja e Korpusit elektronik të shqipes (më 1 dhjetor 2013).

	Fjalë teksti	Përqindja në tërë Korpusin	Sasia e dokumenteve
<b>Vepra letrare</b>			
Romanet	1,202,284	7,15%	23
tregime të shkurtra	505,272	3,01%	121
Dramat	16,334	0,1%	2
<b>Vepra joletrare</b>			
Fetare	1,095,960	6,43%	62
Esetë	181,750	1,08%	18
Shkencore	1,119,248	6,66%	15
Zyrtare	329,168	1,96%	43
<b>Shtypi</b>			
	12,369,042	73,61%	39,310
<b>Tekstet gojore</b>			
	-	-	-
<b>TOTAL</b>	16,804,058	100%	39,594

Tekstet që përbëjnë versionin e sotshme të Korpusit elektronik të shqipes nxirren nga internet-burime të hapura (siç janë, për shembull, tekstet gazetare të “Gazetës shqiptare”, <http://www.balkanweb.com/gazetav5/>), ose skanohen dhe përgatiten

pastaj me dorë (siç janë shumica e veprave letrare dhe joletrare në Korpusin). Për të krijuar një korpus të baraspeshuar, krijuesit kanë zgjedhur tekstet e fushave të ndryshme dhe i kanë ndarë ato në disa nënkorpuse të veçanta sipas fushave të caktuara (tekstet letrare, joletrare, shtypi dhe nënkorpusi i planifikuar i teksteve gojore). Tekstet letrare dhe joletrare brenda nënkorpuseve përkatëse ndahen në grupet edhe sipas zhanrit të tekstit (për shembull, tekste letrare përfshijnë tregime të shkurtra, romanet, dramat etj.). Me rendësi thelbësore është edhe përqindja e teksteve të çdo tipi në krahasim me tipat e tjerë. Për sa i përket Korpusit tonë, për momentin shumica dërmuese e teksteve të bazës tekstuale bie në fushën e gazetarisë, por gjatë punës së mëtejshme përmbajtja e Korpusit do të balancohet me anë të teksteve të tjera.

**Zhvillimi i mëtejshëm** i bazës tekstuale të Korpusit lidhet, në radhë të parë, me zmadhimin e saj, që të gjenden në korpus të gjitha fjalët, strukturat dhe shprehjet e shqipes e kërkuara. Drejtimi tjetër i zhvillimit lidhet me krijimin e nënkorpuseve të reja me tekste të përfituara nga gjuha e folur, poezi, dialektet, internet-komunikimi dhe me tekste të periudhave të ndryshme historike. Momentalisht nënkorpusi i **teksteve letrare** përmban vetëm tekstet në gjuhën standarde e viteve 1960-të – 2010-të. Përveç këtij nënkorpusi kryesor që do të zgjerohet, gjatë plotësimit të mëtejshëm të bazës tekstuale mund të krijohen: nënkorpusi i **teksteve të vjetra** të shkruara shumë kohë përpara standardizimit të shqipes, ashtu edhe një nënkorpus i **gegërishtes** dhe një përzgjedhje reprezentative e **teksteve letrare të arbëreshëve të Italisë**.

Për një pasqyrim më të plotë dhe adekuat të gjuhës së sotme shqipe, Korpusi elektronik mund të plotësohet edhe me **tekstet e përfituara nga gjuha e folur** – spontane dhe të parapërgatitura, të karakterit dialogjik dhe atij monologjik, të stilit zyrtar dhe atij bisedor; tekstet që u përkasin sferave të ndryshme të komunikimit etj. Si shembull mund të përmendet këtu Korpusi i rusishtes, në përbërjen e të cilit ka pjesa e quajtur “Korpusi i gjuhës së folur” që përmban incizime të transkriptuara të programeve televizive dhe radio, ligjëratave dhe bisedave të përditshme në rrugë, në zyrë ose në shtëpi. Një tip tjetër tekstesh që mund të përbëjnë një nënkorpus të veçantë i përket fushës së **Internet-komunikimit** me e-mail, nëpër çatë, blogë dhe forume, në të cilin, faktikisht, ndërthurin veçori të të shkruarit me këto të të folurit. Së fundi, llojllojshmëria regionale e varianteve të të folurit mund të shfaqet në Korpusin elektronik të shqipes me anë të një nënkorpusi **dialektor** me tekste të mbledhura në krahina të ndryshme shqipfolëse.

**2. Annotimi në Korpusin elektronik të shqipes.** Siç u përmend në fillim, pjesën e rëndësishme të ndërtimit të një korpusi gjuhësor përbën analiza dhe përshkrimi i teksteve, d.m.th. **annotimi**. Tekstet e Korpusit elektronik të shqipes janë të pajisura me dy tipa të annotimit të karakterit gjuhësor dhe jogjuhësor.



**2.1. Annotimi metatekstual.** Së pari, secili nga 39,594 dokumente të Korpusit pajiset me informacionin **metatekstual** (jogjuhësor) të caktuar. Duke pasur parasysh këtë informacion, vet përdoruesi mund të formojë një nënkorpus me parametra të dëshiruara dhe të realizojë kërkimin e mëtejshëm brenda këtij nënkorpusi. Për shembull, mund të zgjidhen vetëm tekstet publicistike (Shtypi) ose vetëm tekstet e krijuara në vitet 1980-të. Informacioni metatekstual mund të luajë një rol të rëndësishëm edhe në radhitjen e rezultateve të kërkimit – për shembull, sipas autorit ose periudhës së krijimit të tekstit.

Në Korpusin elektronik të shqipes përshkrimi metatekstual i teksteve të shkruara (përveç shtypit) e ndjek modelin e Korpusit të armenishtes lindore dhe përfshin: informacionin që lidhet me autorin, d.m.th. emrin dhe mbiemrin i autorit; titullin e librit; tipin e tekstit (letrare dhe joletrare), ashtu edhe zhanrin e tij (për shembull, për veprat letrare ato janë: tregime të shkurtra, romanet, dramat; për veprat joletrare – esetë, kujtimet etj.). Paraqitet detyrimisht viti i krijimit të tekstit, ose një periudhë kohe gjatë së cilës krijohet teksti. Në rastet kur s’ka gjasë të saktësohet viti i krijimit, përmendet një periudhë të përafërt ose të paktën viti i botimit të veprës. Për tekstet publicistike përmendet titulli i botimit periodik (gazetë ose revistë), data dhe numri i botimit.

Më sa duket, në etapën e sotshme sistemi i tillë i përshkrimit të teksteve mjafton për përdorimin e rregullt të Korpusit të shqipes. Megjithatë, në procesin e plotësimit të Korpusit me tekstet e zhanreve, periudhave dhe fushave të ndryshme mund të dalë nevoja për detajimin e mëtejshëm të annotimit metatekstual. Për shembull, një parametër i ri si “forma e gjuhës letrare” do të ishte i nevojshëm për të dalluar tekstet letrare të toskërishtes dhe gegërishtes. Si modeli i zhvillimit të mëtejshëm mund të shërbejë edhe Korpusi nacional i gjuhës ruse, i cili, më sa duket, ka një annotim metatekstual më të hollësishëm në mbarë botën (për shembull, në përshkrimin e teksteve të shkruara përdoren rreth 25 parametra të ndryshme [Savçuk 2005]).

**2.2. Annotimi leksiko-morfologjik i Korpusit të shqipes.** Annotimi leksiko-morfologjik, ose gjuhësor i Korpusit elektronik të shqipes është një sistem i informacionit leksikor dhe të shenjave gramatikore (angl. *tags*). Shenjat gramatikore u shtohen fjalëve teksti me anë të programit të analizës morfologjike (ose *parser-it*). Informacioni i duhur për të gjitha fjalët që kërkohen paraprakisht shënjohe me dorë në “fjalorin gramatikor” (angl. *grammatical wordlist*). Kur bëhet kërkimi në korpusin, informacioni leksikor dhe gramatikor për çdo fjalëformë të kërkuar del në dritareza të veçanta. Për shembull, fjalëforma *djalin* në Korpusin do të pajiset me informacionin, si më poshtë vijon:

- 1) lemma (forma bazë e fjalës): *djalë*
- 2) veçori gramatikore të fjalës (pjesa e ligjëratës, gjinia e emrit, emër frymori / jofrymori, folja kalimtare / jokolimtare): (NOUN, *m*, *anim*)

3) veçori gramatikore të fjalëformës së dhënë (për shembull, rasa e emrit, koha e foljes etj.): *def, sg, acc*

4) përkthimi: *boy*.

**Figura 1.** Fjalëforma *djalin* në Korpusin elektronik të shqipes.

The screenshot shows the Albanian National Corpus website. At the top, there is a search bar with the word 'djalë' entered. Below the search bar, there are two search results. The first result is for the word 'djalë' with the lemma 'djalë' and the part of speech 'm'. The second result is for the word 'djalë' with the lemma 'djalë' and the part of speech 'm'. The search results are displayed in a table with columns for the word, lemma, and part of speech. The search results are also displayed in a list format with a search bar and a 'Kërkim i avancuar' button. The search results are also displayed in a list format with a search bar and a 'Kërkim i avancuar' button. The search results are also displayed in a list format with a search bar and a 'Kërkim i avancuar' button.

Në përputhje me Korpusin e armenishtes lindore, sistemi i *tag*-ëve të annotimit gjuhësor në Korpusin e shqipes bazohet në listën e ofruar prej *Leipzig Glossing Rules Conventions for interlinear morpheme-by-morpheme glosses* (<http://www.eva.mpg.de/lingua/resources/glossing-rules.php>)<sup>3</sup>. Kjo listë është plotësuar me *tag*-ët për disa kategori të veçanta të pranishme në shqipen dhe menjëherë të rralla nga pikëpamja tipologjike, siç janë, për shembull, *adm* – mënyra habitore, *opt* – mënyra dëshirore.

**3. Standardi morfologjik dhe trajtimi i disa dukurive gramatikore në Korpusin e elektronik të shqipes.** Pasqyrimi i rregullt të të dhënave në Korpusin sigurohet me anë të standardit të tij morfologjik. Standardi përcakton inventarin e veçorive morfologjike, strukturën e paradigmes së fjalës, formën e saj bazë dhe mënyrën e pasqyrit të normës gramatikore në Korpusin [Lashevskaja, Plungian, Siçinava 2005].

<sup>3</sup> Bie fjala për rregullat e përpunuar prej B. Comrie, M. Haspelmath dhe B. Bickel, që përmbajnë listën e shkurtesave për termat anglezë që përdoren për të emërtuar kategoritë gramatikore më të përhapura në gjuhët e botës (për shembull, shkurtesa *acc* për rasën kallëzore, *sg* për numrin njëjës etj.). Këto rregulla të Lajpcigut konsiderohen si një standard ndërkombëtar për tipologjinë gjuhësore.

Për shembull, si standard për Korpusin nacional të gjuhës ruse përdoret “Fjalori gramatikor i gjuhës ruse” i grumbulluar prej autorit A. Zaliznjak [Zaliznjak 1980].

Standardi morfologjik i Korpusit nacional të shqipes merr parasysh parime kryesore të “Gramatikës së gjuhës shqipe” prej Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler-it [Buchholz, Fiedler 1987]. Struktura e annotimit të Korpusit të shqipes, pra, përputhet përgjithësisht me traditën e përshkrimit të gramatikës së shqipes, për të lehtësuar të paktën punën kërkimore të një përdoruesi “prototipik”, d.m.th. të një gjuhëtari të mësuar me gramatikën klasike të shqipes dhe me kategoritë e saj kryesore. Siç e përcakton G. Leech, një nga krijuesit e Korpusit nacional Britanik, annotimi i një korpusi gjuhësor duhet të bazohet në parime të kuptueshme për përdoruesin<sup>4</sup>. Megjithatë, standardi morfologjik i Korpusit të shqipes përmban edhe disa dallime nga kjo traditë, që kemi propozuar për arsyet e ndryshme teorike dhe praktike, përfshirë edhe veçoritë e pasqyrimin dhe përpunimit teknike të informatës gramatikore në Korpusin. Do të jepen tani disa shembuj të lidhur me përfaqësimin e sistemit rasor.

**3.1. Trajtimi i rasave. Rasa gjinore-dhanore.** Për sa u përket rasave gjinore dhe dhanore, dallimi i këtyre kategorive është një nga çështjet më të diskutueshme të gramatikës së shqipes. Si trajtë dalluese sintaksore mund të konsiderohet nyja e përparme të gjinore që nuk del në dhanoren dhe përdorimi i domosdoshëm i trajtës së shkurtër me dhanoren. Megjithatë, nga pikëpamja e morfologjisë, vet format e të dy rasave njësojnë gjithandej te emrat, ashtu edhe te përemrat e lakuar. Pra, programi i analizës morfologjike (*parser-i*) nuk do të dallojë automatikisht gjinoren nga dhanorja (kjo mund të bëhet vetëm me dorë dhe në kontekste të caktuara). Për të pakësuar sasinë e varianteve homonimike të analizës morfologjike, në Korpusin elektronik të shqipes këto rasa janë bashkuar në një rasë që quhet dhe kërkohet si “gjinore-dhanore” (*gen-dat*).

**3.2. Rrjedhorja II.** Përveç rasave të gramatikës tradicionale të shqipes (emërorja, gjinorja e bashkuar me dhanoren, kallëzorja, rrjedhorja), annotimi i Korpusit elektronik të shqipes përfshin shënimin e veçantë për të ashtuquajturin “rrjedhore të dytë” (*abl 2*). Nga pikëpamja formale ajo trajtohet në Korpusin si rasa që demonstroi një formë krejtësisht të veçantë me mbaresën *-sh* në shumësin e pashquar. Veçoritë funksionale e kësaj forme gjithashtu u bënë arsye për ta dalluar atë në sistemin rasor: rrjedhorja e dytë, siç dihet, përdoret zakonisht pa parafjalë; ka raste kur përdoren më shpesh format e rrjedhores së dytë (për shembull, shprehje me përcaktor, *lesh dele-sh*), kurse në rastet e tjera mund të dalin të dyja (*prej fshatra-sh = prej fshatra-ve*). Për hir të pranimit të rrjedhores dhe të rrjedhores së dytë në standardin morfologjik të Korpusit, këto dy forma mund të kërkohen veç e veç me anë të kërkimit të thjeshtë (*abl ose abl 2*). Tërësia e formave të

<sup>4</sup> “The scheme of analysis presupposed by the annotations – the annotation scheme – should be based on principles or guidelines accesible to the end-user” [Leech 1993: 275].

rrjedhore gjetet lehtësisht me anë të kërkimit të përbërë nga “rrjedhore + rrjedhore II” (*abl + abl 2*).


**3.3. Rasa zero.** Me interes është rasti i përdorimit të formës së quajtur “rasa zero” në annotimin morfologjik të Korpusit të shqipes. Sipas gramatikës së O. Buchholz dhe W. Fiedler-it, kjo formë quhet *Merkmalloser Kasus* dhe u ngjan emërores dhe kallëzores njëjës të pashquar. Ajo mund të shërbejë në fjali si ndajshtim (*lumi Shkumbin*) dhe si përcaktor i emrave me kuptimin e sasisë, numrit etj. (*një kovë ujë*) [Buchholz, Fiedler 1987: 226]. Sipas mendimit tonë, edhe një rast për të trajtuar si përdorimi i “rasës zero” është forma e emrit në togfjalëshin me përcaktor mbiemëror e paravendosur: *Kërkonte trupin e të zjunt djalë*. Pra, të tri rastet e lartpërmendura, që nuk kanë trajtimin e tyre të saktë në gramatikën klasike, në Korpusin e shqipes mund të interpretohen në një mënyrë të përbashkët. Pas heqjes së homonimisë leksikore dhe gramatikore (për heqjen e homonimisë shih p. 4) do të jetë i mundur kërkimi i veç këtyre formave dhe studimi i mëtejshëm i shpërndarjes së tyre në tekstet e tipave të ndryshme.

**4. Analiza morfologjike në Korpusin elektronik të shqipes.** Për sa i përket analizës leksiko-morfologjike të teksteve, kjo bëhet automatikisht me anë të programit të analizës morfologjike “UniParser” prej autorit T. Arkhangelskij. Analiza dhe annotimi i teksteve bëhet **fjalë pas fjale**, d.m.th. duke analizuar ndonjë fjalëformë, parser-i nuk merr parasysh kontekstin sintaksor majtas dhe djathtas. Në procesin e annotimit morfologjik me anë të parser-it, çdo fjalëformë pajiset me informacionin për formën e saj bazë dhe për veçori të saj gramatikore. Që të identifikohen të gjitha fjalët teksti në korpusin si fjalëformat e leksemave përkatëse, së pari të gjitha këto leksema duhen futur dhe përshkruar në fjalorin gramatikor.

Pa tjetër, një sasi e fjalëformave të paanalizuara (angl. *parcing error rate*) do të ekzistojë në korpusin pothuaj në çdo periudhë kohe. Bie fjala, para së gjithash, për huazime të reja, variante të parregullta të lakimit ose zgjedhimit, shkurtime, emra të përveçëm dhe terma speciale, fjalë të shkruara me një standard tjetër drejtshkrimi (ose me gabime). Pjesa e fjalëformave të paanalizuara do të minimizohet hap pas hapi në procesin e plotësisht të mëtejshëm të fjalorit gramatikor, e cili për momentin bazohet në fjalorët të shqipes [FShS 2002; FGjShS 2006; Newmark 2000 etj.].

Në qoftë se ndonjë varg shenjash identifikohet nga parser-i si fjalëforma me disa kuptime gramatikore, programi i jep kësaj formës të gjitha variantet e mundshme (homonimike) të analizës. Analiza të tilla, në fakt, nuk janë plotësisht të gabuara dhe mund të konsiderohen si analizat hipotetike.

**Figura 2.** Fjalëforma *dhe* në Korpusin elektronik të shqipes: variantet homonimike e analizës leksiko-morfologjike.



Heqja e **homonimisë gramatikore** në korpuset gjuhësore bashkëkohore bëhet në mënyrën gjysmë automatizuar, d.m.th. me dorë dhe me ndihmën e veglave programore. Së pari, hiqen automatikisht variante jo të sakta të analizës morfologjike. Pastaj përpunohen me dorë fjalëforma që paraqesin vështirësi për analizën automatike (për shembull, format homonimike rasore – gjinore-dhanorja dhe rrjedhorja), ashtu edhe homonimet leksiko-gramatikore që u takojnë pjesëve të ndryshme të ligjëratës (p. sh. mbiemrat dhe emrat prejmbiemërore). Në kontekstet, ku përcaktimi përfundimtar i rasës së emrit nuk është mundur, do të mbeten dy analiza alternative, sepse pikëpamja e përdoruesit në atë rast mund të ndryshojë nga ajo e krijuesit të Korpusit.

**5. Mjete kërkimi.** Korpusi elektronik i shqipes shfrytëzon programin e kërkimit dhe interfejsin që përdoren në korpuset të tjera gjuhësore të krijuara në kuadrin e Programit të Akademisë së shkencave të Rusisë për “Corpus linguistics”, përfshirë edhe Korpusin e armenishtes lindore.

Kërkimi në Korpusin bëhet sipas parametrave të tilla si fjalëforma, lemma, përkthimi dhe informacioni gramatikor. Po të zgjidhet opsioni “Fjalëforma” (*djalin*), do të dalin të gjitha shembujt ku gjetet vargu shenjash, ose fjalëforma të kërkuesit (i ngjan kërkimit në Google etj.). Nëse kërkohet *lemma* e ndonjë fjale (*djalë*), si rezultat e kërkimit

do të dalin të gjitha fjalëformat që i përkasin. Duhet të nënvizojmë që kërkimi sipas lemma-s do t'u japë përdoruesit vetëm fjalëforma të annotuara (të futura në fjalorin gramatikor të Korpusit); këto të paannotuara nuk do të kërkohen, ndryshe nga kërkimi sipas fjalëformës. Përveç kërkimit sipas lemma-s dhe fjalëformës, mund të kërkohen edhe përkthime në anglisht (*boy*), që ka vlerë për hulumtuesit që nuk e zotërojnë shqipen në një nivel të lartë.

Në dritaren “Gramatika dhe pjesët e ligjëratës” mund të përcaktohen tipare gramatikore të fjalëformave të kërkua. Ky lloj kërkimi kombinohet edhe me kërkimin e lemma-ve. Gjithashtu kushtet e kërkimit mund të përcaktohen në dritaren “Kërkim i avancuar”. Këtu, për shembull, mund të caktoni çfarë shenjat pikësimi duhen të dalin në anën e majtë dhe të djathtë të fjalëformës, ku do të ndodhet fjalëforma brenda fjalisë (fillimi, mesi, fundi i fjalisë) etj.

Një mundësi tjetër e parashikuar në Korpus është kërkimi i **përbërë** i formave analitike dhe të togfjalëshave. D.m.th. mund të kërkohen disa fjalëforma të vendosura njëra pas tjetrit në kontekstin, ashtu edhe ato të ndara me fjalëforma të tjera. Ky lloj kërkimi mund të përdoret për të gjetur format analitike që janë shumë të përhapura në shqipen. Bie fjala kryesisht për format foljore, format krahasore dhe sipërore të mbiemrave dhe të ndajfoljeve etj. Për shembull, kërkimi i foljes *kam* në kohën e tashme të dëftores + pjesore do t'ju japë një sasi të konsiderueshme të shembujve me format e kohës së kryer të diatezës veprorë (*kam punuar*, *kam shkruar* etj.).

Si rezultat i kërkimit dalin shembuj gjuhësore me fjalëforma të kërkua, përcaktohet numri i rezultateve dhe numri i dokumenteve ku gjenden këto shembuj. Çdo shembull është pajisur me informacionin metatekstual: titulli i tekstit, emri i autorit dhe data e krijimit. Çdo fjalëforma, që ka të paktën një variant të analizës, pajiset me lemma-n, informacionin për veçoritë fjalëformuese dhe fjalëndryshuese, ashtu edhe me përkthimin. Mënyra e shfaqjes së rezultateve të kërkimit ndërrohet nëpërmjet dritares “Shfaqja e rezultateve” në disa mënyra: ka formati i plotë, i thjeshtë, formati KWIC (*Key Word In Context*) dhe formati me shënime gramatikore (angl. *glossed*). Në formatin KWIC fjalëforma e kërkuar shfaqet në interfejsin kështu, që të duket sa më mirë pozita e saj në fjalinë (inicialet, qendrore, fundore). Formatin me shënime gramatikore supozon që gjithë informacioni gramatikor për fjalëformën, përfshirë lemma-n e saj dhe karakteristikat gramatikore, shfaqet nën fjalëformën, prapësepapë pa asnjë ndarje në morfemat. Mund të përcaktohet edhe sasia e shembujve gjuhësore të shfaqura menjëherë në një faqe, ashtu edhe rendi i shembujve.

Me rendësi është të përmendet, që çdo shembull gjuhësor përmban vetëm një fjali të ndonjë teksti, dhe konteksti mund të zgjerohet maksimalisht deri në **shtatë** fjali (plus tri majtas dhe plus tri djathtas). Kontekste më të mëdha dhe tekste të plota **nuk shfaqen** në korpusin nga shkaku që shumë tekste të korpusit janë objektet e të drejtës

së autorit, dhe për këtë arsye përdoruesi **nuk mund** t'i shikojë ose të shkarkojë plotësisht.

**6. Përfundim.** Detyrat e dorës së parë në zhvillimin e mëtejshëm të Korpusit të shqipes lidhen me zgjerimin e fjalorit gramatikor, plotësimin e bazës së teksteve elektronike dhe heqjen e homonimisë leksiko-gramatikore. Korpusi i madh, i plotë dhe gjithëpërfshirës, si rezultat i punës së tillë, do të jetë i dobishëm për gjuhëtarët që merren me çështjet e gramatikës, historisë dhe leksikut të gjuhës shqipe, ashtu edhe për ata që flasin shqipen si gjuhë amtare ose e studiojnë si gjuhë të huaj.

## Literature

1. Buchholz, Fiedler 1987 – Buccholz O., Fiedler W. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopadie, 1987. 582 s.
2. FShS 2002 – *Fjalor i shqipëse së sotme*. Botim i dytë i ripunuar (me rreth 35.000 fjalë). Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: TOENA, 2002.
3. FGjShS 2006 – *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (me rreth 40.000 fjalë). Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: TOENA, 2006.
4. Lashevskaja, Plungjan, Siçinava 2005 – Ляшевская О. Н., Плунгян В. А., Сичинава Д. В. О морфологическом стандарте Национального корпуса русского языка // *Национальный корпус русского языка 2003–2005: результаты и перспективы* [сборник]. Рос. акад. наук, Ин-т рус. яз. им. В. В. Виноградова. М.: Индрик, 2005. С. 111–135.
5. Leech 1993 – Leech G. Corpus annotation schemes // *Literary and Linguistic Computing* 8/4, 1993. P. 275–281.
6. Newmark 2000 – *Albanian English Dictionary* / Ed. by L. Newmark. Tiranë: Albin, 2000.
7. Savçuk 2005 – Савчук С. О. Метатекстовая разметка в Национальном корпусе русского языка: базовые принципы и основные функции // *Национальный корпус русского языка 2003–2005: результаты и перспективы* [сборник]. Рос. акад. наук, Ин-т рус. яз. им. В. В. Виноградова. М. : Индрик, 2005. С. 62–88.
8. Zaliznjak 1980 – Зализняк А. А. *Грамматический словарь русского языка*. Словоизменение. Около 100000 слов. М.: Русский язык, 1980. 880 с.



**Maria MOROZOVA, Aleksandër RUSAKOV**

**PERFEKTI NË SHQIPEN E SOTME:  
STUDIMI I BAZUAR NË TEKSTET E KORPUSIT ELEKTRONIK  
TË SHQIPES<sup>1</sup>**

**1. Hyrje.** Si shembull i përdorimit të Korpusit të shqipes mund të jepen këtu rezultatet paraprake e një studimi të bazuar në tekstet e Korpusit (angl. *case study*). Në studimin tonë përqendruam vëmendjen mbi funksionimin e formit të perfektit (kohës së kryer) në krahasim me atë të aoristit ((së kryerës së thjeshtë) në tekste të shkruara në shqipen që i kemi në disponim në korpus. Studimi i tillë mund të konsiderohet kryesisht si përpjekja për të bërë një “portret” të një kategorie gramatikore duke shfrytëzuar mjetet e korpusit elektronik. Qëllimi tjetër i studimit ishte për të provuar mundësitë e korpusit të shqipes në etapën e tanishme të ekzistencës së tij.

Duke folur për perfektin ose kohën e kryer të shqipes, që nga fillimi le të përmendim si ajo përcaktohej në veprat e gramatikanëve më të mëdhenj. Siç u vu në dukje Sh. Demiraj, “kuptimi themelor i së kryerës është të tregojë një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit” [Demiraj 1985: 797]. Sipas Buchholz dhe Fiedler-it, “das Perfekt hat nur ein obligatorisches Merkmal: Doppelzeitigkeit, d.h. Bezug auf zwei Zeitstufen, meist Vergangenheit und Gegenwart” [Buchholz, Fiedler 1987: 129].

Për sa i përket formës morfologjike, e kryerja ose perfekt i vepron në shqipen përfaqëson një perfekt posesiv, tipik për gjuhët e arealit SAE (Standard Average European) [Haspelmath 2001]. Siç u vu në dukje në studime të ndryshme tipologjike, perfekt i këtyre gjuhëve demonstroi shumë shpesh tendencën për të zgjeruar sferën e përdorimit, duke lëvizur drejt së shkuarës perfekteve, ose aoristike. Siç u vu në dukje në Gramatikën e shqipes prej Buchholz – Fiedler-it, kjo tendencë është karakteristike edhe për shqipen dhe dominon në disa të folme të saj: “In einigen (bes. nordostgeg.) Mundarten ist das Merkmal der Doppelzeitigkeit verblasst, und die Bedeutung tendiert

---

<sup>1</sup> Studimi është bërë në bazën e versionit të Korpusit me më shumë se 5 milionë fjalë teksti (aktual më 1 gusht 2013).

im ganzen zu der des Aor. Entsprechendes kommt auch in der Lit.-spr. vor” [Buchholz, Fiedler 1987: 130].

Pra, zhvillimi i kuptimit gramatikor të formës analitike të perfektit në gjuhët e sotshme indoevropiane përgjithësisht mund të përcaktohet si një lloj zgjerimi të shkallëshkallshëm të kuptimit “perfekt” të kësaj forme në atë “perfektiv”. Për sa i përket shqipes, do të ishte interesant të shqyrtonim në ç’pikë të kësaj rrugës së zhvillimit ndodhet tani perfektit, ose koha e kryer, në gjuhën e sotme letrare shqipe. Për të përcaktuar, ç’lloj kategorie gramatikore mund të trajtohet si perfekt, do të marrim parasysh dy kritere kryesore operationale të propozuara në [Lindstedt 2000], etj.:

- 1) Perfekti nuk përdoret si koha narrative;
- 2) Perfekti nuk përdoret me ndajfoljet kohore.

Në këtë etapë të studimit tonë ne do të shqyrtojmë vetëm e kryerën e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, duke marrë parasysh parametra të tilla, si: zhanri e tipi i diskursit, përdorimi ose mospërdorimi i rrethanorëve të kohës dhe karakteri akcional i foljes në shqyrtim.

**2. Përdorimi i formave perfektëve të disa foljeve në tekstet e Korpusit elektronike të shqipes (më 1 gusht 2013).** Duke nxjerrë statistikën e përdorimit të formave foljore në tekstet e korpusit, duhet pasur parasysh faktin që të dhëna për raportin sasior e formave të së kryerës me format e së kryerës së thjeshtë të disa foljeve momentalisht kanë një karakter të përafërt për shkak të homonimisë që s’është hequr akoma në korpusin. Për shembull, ka disa fjalë ndihmëse shumë të përhapura, sidomos *dhe* e *pa*, që janë homonime me format e së kryerës së thjeshtë të foljeve shumë të përdorura *jap* dhe *shoh*. Pra, kërkimi i vargjeve shenjash (fjalëformave) *dhe* e *pa* në korpusin na jep një përzierje të konteksteve ku përdoren ose fjalët ndihmëse të lartpërmendura, ose format foljore përkatëse. Pas heqjes së homonimisë në korpusin situata do të ndryshojë.

Për etapën e parë të studimit kemi zgjedhur 10 folje që u përkasin klasave akcionale të ndryshme. Rezultatet e analizës tonë sasiorë pasqyrohen në tabelën 1. Mund të konstatojmë se për të gjithë foljet (përveç *qëlloj*) forma e perfektit përdoret më dendur se ajo e aorisitit. Në këtë artikull ne do të shqyrtojmë më hollësi vetëm dy folje: *vij* dhe *jetoj*.

**Tabela 1.** Format e perfektit dhe e aoristit të disa foljeve në Korpusin elektronik të shqipes (më 1 gusht 2013).

Folja	Sasia e formave të perfektit	Sasia e formave të aoristit	Ratio
<i>vë</i>	392	1000	0.392
<i>vdës</i>	151	375	0.402
<i>dëgjoj</i>	321	768	0,418
<i>kuptoj</i>	68	402	0,169
<i>shikoj</i>	9	429	0,020
<b><i>jetoj</i></b>	<b>67</b>	<b>101</b>	<b>0,663</b>
<b><i>vij</i></b>	<b>692</b>	<b>1740</b>	<b>0,397</b>
<i>gjej</i>	319	615	0,518
<i>qëlloj</i>	100	73	1,369
<i>shkroj</i>	315	1158	0,272

**2.1. Folja *vij*.** Sipas karakterit akcional, folja *vij* përcaktohet si “*strong terminative verb*” [Tatevosov 2005]. Forma e së kryerës së thjeshtë (forma perfekteve prototipike) e kësaj foljeje ka kuptimin e “hyrjes në gjendje” (kuptimi inceptiv). Shpërndarja e formave të perfektit dhe të aoristit shfaqet në tabelën 2.

**Tabela 2.** Folja *vij*: shpërndarja e formave.

	Perfekti	Aoristi	Ratio
Korpusi i tërë	692	1740	0.397
Nënkorpusi letrar	198	825	0.240
Nënkorpusi publicistik	<b>327</b>	277	<b>1.181</b>
Nënkorpusi eseistik	29	208	0.139
Nënkorpusi fetar (Bibla)	119	365	0.326

Aoristi, ose e kryera e thjeshtë e foljes *vij* mbizotëron në tekstet letrare, eseistike dhe fetare, kurse në tekstet publicistike, përkundrazi, forma më e përdorur është ajo e perfektit. Nga kjo situatë mund të nxjerrim një përfundim paraprak që përdorimi i perfektit në tekste të shkruara shqipe reagon ndaj tipit të diskursit.

**Tabela 3.** Folja *vij* dhe tipi i diskursit (në bazë të nënkorporit letrar).

Koha	Ligjërata e drejtë	Narrativi	Së bashku	% e ligjërates së drejtë
perfekti	174	24	198	87,8%
aoristi	≈187	≈638	≈825	≈29%

Tabela 3 që pasqyron rezultatet e gjurmimit statistikor brenda nënkorporit letrar, na tregon që përgjithësisht aoristi i foljes *vij* në tekstet e letërsisë artistike përdoret më shpesh se perfekti. Po të marrim përdorimin e perfektit dhe të aoristit veç e veç, do të duket qartë se përmes 198 rasteve të përdorimit të perfektit predominon shumë fort përdorimi në ligjëraten e drejtë (pothuaj 88%). Aoristi gjithashtu përdoret në ligjëraten e drejtë (jo më rrallë se perfekti) por predominon në narrativ (përqindja e rasteve të përdorimeve të aoristit në ligjëraten e drejtë përbën afër 29%).

Duke bërë analizën cilësore të përdorimit të perfektit në ligjëraten e drejtë, mund të përfundojmë se:

1) Shumica dërmuese (nja 169 nga 175) i rasteve të përdorimeve të perfektit në ligjëraten e drejtë mund të karakterizohen si rastet e ashtuquajturit “*perfect of current relevance*”, d.m.th. rastet kur rezultatet ose pasojat e veprimit mbeten aktual deri në momentin e ligjërimit:

(1) *U dëgjuan zëra grash e fëmijësh: ka ardhur Ago Jakupi, Ago Jakupi.* (Mitrush Kuteli, “Tregime të moçme shqiptare”, 1965)

2) Nganjëherë perfekti i këtij tipi ka edhe një ngjyrim semantik të “*perfect of recent past*”, që sinjalizon se veprimi u ndodh drejtpërdrejt para momentit të ligjërimit<sup>2</sup>:

(2) *Unë kam ardhur sot në Medinën tuaj për t’ju thënë se sakrificat, lufta dhe gjaku i myslimanëve të parë është drita që ndriçon rrugën tuaj.* (Ben Blushi, “Të jetosh në ishull”, 2008)

3) Një sasi mjaftë e vogël e shembujve (3 ose 4) pasqyrojnë të ashtuquajturën “*experiential perfect*”. Kjo sasi i kufizuar mund të shkaktohet nga vet semantika e foljes *vij*:

<sup>2</sup> Na duket se kuptimi i “*recent past*” nuk është një kuptim i veçantë në gjuhën shqipe: thjeshtë, shumë shpesh veprimi që është aktual për të tashmen ndodhet drejtë për drejtë para momentit të së tashmes.

(3) *Dubet ta pranoj, në njëfarë mënyre mua jeta më ka përkëdhelur, në kuptimin se gjërat më **kanë ardhur** të kollajta...* (Fatos Kongoli, “Ne të tre”, 1985)

4) Në ligjëratën e drejtë kemi vetëm një rast të përdorimit të perfektin me kuptimin thjeshtë *aoristikë*:

(4) *Mbaj mend se më **ke ardhur** një herë në ambulancë.* (Fatos Kongoli, “Ne të tre”, 1985)

Për sa i përket **aoristit** të përdorur *në ligjëratën e drejtë*, 28 nga 45 raste të analizuara kanë kuptim thjeshtë *aoristikë*:

(5) *Një ditë, ai **erdhi** në Sul dhe takoi gjysbin tim që sa ishte bërë kryetar i pleqësisë.* (Ben Blushi, “Të jetosh në ishull”, 2008)

17 shembuj mund të interpretohen si rastet e përdorimit të aoristit në kuptimin e “*perfect of current relevance*”:

(6) *Nga Velania **erdhi** kush me këtë tren?* (Binak Kelmendi, “Tenda ose shtëpia prej plastmasti”, 1999–2001)

Duke analizuar përdorimin e foljes *vij* në *kontekste narrative*, mund të përfundojmë që rastet jo të shumta (nja 20) të përdorimit të perfektit të kësaj foljeje në fragmentet me karakterin narrativ gjenden kryesisht në narrative të treguara nga veta e parë ose në të ashtuquajturin “diskurs të lirë të zhdrejtë”, që kanë si bazë ligjëratën e drejtë. Këto raste, kështu, u afrojnë atyre të ligjëratës së drejtë dhe i përkasin “regjimit të ligjëratës” (për gjuhën shqipe sh. [Ismajli 1977]). Format e perfektit në kontekste narrative kanë kuptimin e “*perfect of current relevance*”:

(7) *Sa ka rëndësi ai çast në të cilin Roberto e sheh në imagjinatën e tij që Nena **ka ardhur** me ne.* (Beqë Cufaj, “Shkëlqimi i huaj”, 1999–2003)

Përveç kësaj, në korpusin tonë gjenden edhe shembuj shumë të paktë (vetëm një ose dy), ku format e perfektit mund të jenë trajtuar si një lloj perfektit evidencial në kuptimin e citativit:

(8) *Më pas, ajri i ftohtë i natës ka bërë që njëri prej tyre, doktor Gurametoja i madh, **ka ardhur** në vete dhe ka dashur të thotë diçka.* (Ismail Kadare, “Darka e gabuar” (botimi i tretë, i riparë prej autorit), 2007–2008) (fragmenti i dëshmisë)

Për sa u përket teksteve publicistike, ato përfaqësojnë të vetmin lloj tekstesh ku format e perfektit predominojnë mbi ato të aoristit (327 krahasuar me 277). Kjo dukuri sqarohet nga vet karakteri i publicistikës që është “tipi i tekstit që zë një vend të ndërmjetëm midis ligjëratës së folur dhe narrativit” [Dobrushina 2008: 173]. Format e

perfektit këtu janë shembuj të “*hot news perfect*” (një lloj i “*perfect of current relevance*”), i cili nënkupton që lajmet duhen të jenë aktual për momentin e ligjërimit gazetar<sup>3</sup>.

Mund të përfundojmë këtu që perfekti i foljes *vij* (“terminative verb”) afrohet nga kuptimi me perfektin e përcaktuar si “prototipik” nga pikëpamja tipologjike. Kuptimi kryesor është ai i “*current relevante*”, ka edhe shembuj të perfektit e quajtur “*experiential perfect*”. Perfekti i foljes *vij* në shqipen nuk demonstroi tendencën e lëvizjes kuptimore drejt së shkuarës perfektive (aoristike). Shembujt e përdorimit të aoristit në kuptimin e perfektit janë më të shumtë. Për sa u përket dy kritereve të lartpërmendura që përcaktojnë kategorinë e perfektit, ato nuk arrijnë të përdoren këtu. Perfekti mund të përdoret në narrativ (sado që shumë rrallë) dhe përdoret me rrethanore kohore (gjithashtu rrallë). Vlen përmendur, megjithatë, se këto kritere të përpunuara për gjuhën angleze nuk punojnë shumë mirë edhe në gjuhët e tjera me perfektin “prototipik”, p.sh. në gjuhën spanjolle (sh. [Gorbova 2013]).

**2.2. Folja *jetoj*.** Sipas karakterit të tij akcional, folja *jetoj* është “proces”. Forma e së kryerës së thjeshtë (ose forma perfektive prototipike) e kësaj foljeje ka kuptimin e “procesit” (kuptimi limitativ) dhe kurrë ose pothuajse kurrë s’ka kuptimin inceptiv. Në tekstet e Korpusit të shqipes ne kemi regjistruar 67 shembuj ku përdoret perfekti i foljes *jetoj* dhe 100 shembuj me formën e aoristit. 39 nga 67 shembuj me formën e perfektit u përkasin teksteve letrare dhe kujtimeve (aoristi – 26). Në shumicën e rasteve format e perfektit të foljes *jetoj* që gjenden në nënkorpusin letrar kanë një nga tri kuptime kryesore (që nganjëherë identifikohen me vështirësi). Këto janë:

1) Kuptimi limitativ dhe perdurativ (të dy janë kuptime aoristike) që del afërsisht në 10 shembuj:

(9) ***Kam jetuar 5 vjet në SHBA dhe nuk është e lehtë aspak të jetosh në një vend në të cilin nuk e njeh askë dhe nuk të njeh askush!*** (Beqë Cufaj, “Shkëlqimi i huaj”, 1999–2003)

2) Kuptimi që quhet “*general factual*”, sipas [Comrie 1998] (kuptimi aoristik, kemi gjetur nja 19 shembuj):

(10) *Qyteti më i kulturuar, ku kanë jetuar shqiptarët, u dogj.* (Ben Blushi, “Të jetosh në ishull”, 2008)

3) Perfekti i eksperiencës (nja 6 shembuj):

(11) *Unë i njoh mirë këto shtëpi që përmenda, pse kemi jetuar me familje herë te njëra mëhallë, herë te tjetra.* (Enver Hoxha, “Vite të vegjëlisë”, 1962–1976)

Pothuajse të gjithë shembujt e perfektit të foljes *jetoj* dalin në ligjëratën e drejtë, ose në pjesët e kujtimeve që i kushtohen lexuesit, ose në “diskursin e lirë të zhdrejtë”.

<sup>3</sup> Ky fakt sqaron shumë mirë predominancën e perfektit midis formave të foljes *qëlloj*: shumica e rasteve të përdorimit të kësaj foljeje në Korpusin e gjuhës shqipe janë nxjerrë nga kronika kriminale.

D.m.th. ne kemi të bëjmë me “regjistrin e ligjërates” në kuptimin e Benvenistit (për gjuhën shqipe sh. [Ismajli 1977]).

Pra, mënyra e përdorimit të perfektit të foljes *jetoj* (“*process verb*”) ka shumë dallime thelbësore nga perfektin i foljes *vij*. Pothuajse plotësisht mungojnë rastet e përdorimit të perfektit në kuptimin e tij kryesor – kuptimin e “*current relevant*”. Pra, për sa i takon perfektin të foljes *jetoj*, mund të flasim për një formë që dallon nga aoristi vetëm nga pikëpamja e përkitjes regjistrit të caktuar të ligjërates.

**3. Përfundime e detyra e mëtejshme.** Krahasimi i dy foljeve që u përkasin klasave të ndryshme akcionale (*vij* dhe *jetoj*) tregon qartë rëndësinë e këtij parametri për realizimin e kategorisë së perfektit (sh. për këtë problem edhe [Dodi: 1968]). Folja terminative *vij* demonstroi tipare karakteristike të perfektit rezultativ (*perfect of current relevance*), kurse foljes së procesit *jetoj* i mungojnë këto tipare. Përkitja “regjistres së caktuar të ligjërates” i afron perfektet e dy foljeve. Ne mund të supozojmë këtu zhvillimin e tillë:

Faza e parë. Veprimi lidhet me momentin e ligjërimit nëpërmjet pasojave të këtij veprimi.

Faza e dytë. Veprimi lidhet me momentin e ligjërimit nëpërmjet vet konstatimit e këtij veprimi nga perspektiva e momentit të ligjërimit (sh. [Maslov 1981: 254] për perfektin bullgar: “Lidhja mund të përbëhet vetëm në atë, se fakti i së kaluarës konstatohet në kontekstin e kohës së tashme”).

Në radhë të parë faza e dytë e zhvillimit të tillë i pushton foljet që sipas natyrës së tyre akcionale nuk mund të kanë interpretimin rezultativ (proceset e gjendjet). Fazën e mëpasshme demonstrojnë gjuhë të tilla si frëngjishtja dhe rumanishtja, që kanë zhvilluar shpërndarjen diskursivo-stilistike të formave të thjeshta dhe të përbëra të së shkuarës.

Studimi i mëtejshëm të formave foljore, siç janë perfektin dhe aoristin, në kuadrin e Korpusit duhet të përfshijë medoemos folje të tjera. Ndonëse Korpusi i shqipes nuk lejon akoma të bëjmë studime diakronike dhe dialektologjike, shpresojmë se zgjerimi i tij do ta ndreqë situatën. Pa dyshim, studimi i plotë dhe shumanshëm i perfektit kërkon analizën e thellë diskursive dhe studimin e teksteve reale shqipe – gojore, ashtu edhe letrare.

## Literatura

1. Buchholz, Fiedler 1987 – Buccholz O., Fiedler W. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopadie, 1987. 582 s.
2. Comrie 1998 – Comrie B. *Aspect: An Introduction to the Study of Verbal Aspect and Related Problems*. Cambridge: CUP, 2008.
3. Demiraj 1985 – Demiraj Sh. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Shtëpia botuese “8 nëntori”, 1985. 1168 f.
4. Dobrushina 2008 – Добрушина Н. Р. Наклонения и дискурсивный режим текста: на примере употреблений частицы пусть // Плуныян В. А. (ред.). *Исследования по теории грамматики 4. Грамматические категории в дискурсе*. М.: Гнозис, 2008. С. 167–193.
5. Dodi 1968 – Dodi A. Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe // *Studime filologjike*, 1968, 2. F. 58–74.
6. Gorbova 2013 – Горбова Е. В. Испанский перфект: еще перфект или уже перфектив / претерит? // *Вопросы языкознания*. 2013. № 4. С. 97–125.
7. Haspelmath 2001 – Haspelmath M. The European linguistic Area: Standard Average European // M. Haspelmath et al. (eds.). *Language typology and Language Universals*. B. 2. Berlin – New York: Walter de Gruyter, 2001. P. 1492–1510.
8. Ismajli 1977 – Ismajli R. *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja, 1977.
9. Lindstedt 2000 – Lindstedt J. The perfect – aspectual, temporal and evidential // Ö. Dahl (ed). *Tense and Aspect in the Languages of Europe*. Berlin – New-York: Mouton de Gruyter, 2000. P. 365–383.
10. Maslov 1981 – Маслов Ю. С. *Грамматика болгарского языка*. М.: Высшая школа, 1981. 407 с.
11. Tatevosov 2005 – Татевосов С. Г. Акциональность: типология и теория // *Вопросы языкознания*. 2005. №1. С. 108–141.



# TRYEZA



**Kujtim M. SHALA**

## **ORA E REXHEP ISMAJLIT**

### I

Ky diskurs yni bën Portretin e përqendruar të Rexhep Ismajlit, të lidhur me nyja themelore të veprës së tij e të lakuar në disa pamje të mëdha. Portreti i tillë lidhet me veprën *e shkruar* dhe di të ëndërrojë veprën *e shkrueshme* të Ismajlit, ashtu si dhe diskurset përreth saj, që burojnë nga ajo, për ta kaluar nga një vepër moderne, në vepër të trashëguar, ashtu siç ndodh përherë me veprat që bëhen klasike. Një vepër e tillë mban shenjat e kulturës së shekullit tonë dhe bëhet vetë një *shenjë* e jona.

Veprat e mëdha krijohen për të shkuar përtej vetes, në kufijtë e shenjave të epokës, kur *shenjën e vet* e lakojnë si *shenjë tonën*. Autorët e tyre ngadalë bëhen autoritete, që në gjuhën e kërkimit quhen *referenca*, ndërsa ne do t'i quanim *esenca*.

Në këto nyja do lexuar vepra e Ismajlit si autor, për të hapur faqet e rralla të veprës dhe faqet e rënda të epokës, atëherë kur vepra *mëson* e *përfaqëson*. Mësimi i Ismajlit buron nga njohja e thellë e jetës së gjuhës, që bëhet jetë e kulturës, madje shenjë e ekzistencës, ndërsa përfaqësimi shkon përtej mësimi, në hullitë e veprave identitare.

### II

Portreti i studiuesit, d.m.th. portreti i autorit, është *bibliografi*, që do të thotë *vepër*. Kësisoj, *bibliografia* bëhet *biografi*. Ajo kalon evidencat dhe lidhet e jeton me esencat e veprës. I lidhur në këto nyja, Portreti i Rexhep Ismajlit lidh diskurset e tij si përshkrim i kërkimeve e i diskursivitetit.

Portreti i Ismajlit buron nga *vepra* e tij, duke nisur nga semiogjia e parë, për t'u pasuruar e zgjeruar me paradigma dhe diskurse të tjera, që vetë Ismajlin e kanë çuar te historia e gjuhës, apo e kanë kthyer te sociolinguistika. Semiologu i parë apo sociolinguisti i mbramë lidhen për të dhënë *portretin* e Rexhep Ismajlit, të lakuar ndërmjet autenticitetit e projeksioneve tipike të një portretimi.

Vepra ditnore e Rexhep Ismajlit, e nyjëtuar në linguistikë, semiologji e

strukturalizëm, histori gjuhe, seociolinguistikë, kërkime e përkthime letrare, madje kërkime kulturore, i provon paradigmat kërkimore moderne shqiptare, të lidhura me Prishtinën kulturore e ditunore.

Kulturës teorike shqiptare Rexhep Ismajli i shtoi idetë e mëdha të linguitikës moderne, së bashku me diskurset e saj. Nxënës e përkthyes i Martinesë, njohës e përkthyes i Ferdinand të Sosyrit, njohës i madh i Bartit, dashurues i përhershëm i letërsisë, Ismajli propozoi e provoi leximin e letërsisë nga perspektiva e një poetike linguitike, që hap shenjat, kap ligjërimet dhe njeh shumësinë e tekstit letrar.

Në jetën me idetë e linguitikës së përgjithshme, e cila është dija moderne linguitike, Ismajli përherë e ruajti mallin për kërkime historike, me bazë filologjinë, etimologjinë, që strukturohet si histori e gjuhës. Kjo atë e ktheu përherë te *tekstet e vjetra* shqipe, apo e zbriti te rrënjët para/indoevropiane të shqipes.

Kërkimi i lakuar në këto fusha, provohet me veprat e Ismajlit: *Shenjë e ide* (1974), e cila del si një amzë kërkimi; *Shumësia e tekstit* (1977), me vetëdije letrare; *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, 1985, analizë e histori gjuhe; *Gjuhë dhe etni* (1991), që shenjon kapërcime në kulturologji e çështje identitare; *Etni e modernitet* (1994), kërkim i shenjave dhe i kategorive të identitetit, të lidhura në bashkëkohësi me statusin social e politik shqiptar; *“Në gjuhë” dhe “për gjuhë”* (1999), sociolinguistikë; *Standarde dhe identitete* (2003), procese standardizimi gjuhësor dhe identitete në Ballkan. Këto dhe vepra të tjera, së bashku me përkthimet ditunore e letrare, e bëjnë *bibliografjinë* e dijetarit Rexhep Ismajli.

### III

Librin e tij të parë, *Shenjë e ide*, Ismajli ia kushtoi Eqrem Çabejt, historianit të madh të gjuhës shqipe, ndërsa, përballë pasionit për historinë e gjuhës, vetë eci përherë në fillin e linguitikës moderne, të semiologjisë e të sociolinguistikës dhe pati autorë të zgjedhur për vete e për të tjerët Ferdinand të Sosyrit e Andre Martinenë, Rolan Martin e Selman Rizën tonë...

Ndërmjet Çabejt e Rizës, ndërmjet diskurseve për *diakroninë* e për *sinkroninë*, ndërtohet e hapet Portreti i Rexhep Ismajlit në faqet e tij të mëdha. Këto dy faqe sikur bëhen bashkë kur diskursi shtrihet në sociolinguistikë, me përqendrim të parë te planifikimi i shqipes.

Po këto faqe dalin më parë të kryqëzuara e të lidhura te *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, si studim që ndërton pamjen e shqipes në shekullin e Kuvendit, bashkë me analizën e sistemit e të funksionit të shqipes së Kuvendit të Arbënit, në kapërcimet nga semiologjia te strukturalizmi. Pasioni e dija lidhen fort dhe e përcaktojnë metodën e diskursin e Ismajlit këtu si kudo veprës së tij.

Vërtet, lidhja e Ismajlit me *tekstet e vjetra* shqipe kap shekullin e tij të kërkimit, në të cilin ka shenja filologjike e interpretimi, madje përgjithësimi lingvistik, letrar e kulturor. Autori i hershëm që studioi më së thelli Ismajli është Pjetër Budi, i kapur si gjuhë dhe i hapur në format e veprës së tij. Ismajli është një *zbulues* i Budit, në trajtën që e *zbuloi* Ibrahim Rugova Pjetër Bogdanin, në fushën e gjerë të kulturës, teologjisë e të humanistikës.

Por, diskurset e Ismajlit për *të vjetrën* shtrihen në kërkime historike të rrënjëve të shqipes e të raporteve të saj, në një metodë që tregon shenja të gjuhësisë krahasuese. Shqipja hapet në kontekstin indoevropian, në raportet që ka me gjuhët e Evropës Juglindore, me fqinj të lashtë e të rinj.

Në cepin tjetër, dijen dhe pasionin Ismajli i bëri bashkë edhe një herë, kur shkroi librin *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës* (2009), si dëshmi për autorin e zgjedhur, homazh për jetën e humbur dhe si zbulim të veprës së madhe të Rizës. Kujtojmë që Riza të ketë qenë *autori i parë* i Ismajlit, një profil që do ai, i lidhur në dy nyja: studim i autorëve të vjetër, kritikë e rithemelime, që, vërtet, bëhet *kritikë rithemeluese*.

#### IV

Portreti i Rexhep Ismajlit përvijohet edhe përmjet (në pasqyrën e) autorëve *të tij*, të zgjedhur, të lexuar apo dhe të kthyer në gjuhën shqipe. Autorët janë shenja të mëdha të *bibliografisë*, në këtë dhe raste të tjera.

Autorët e zgjedhur bëhen shenja të dijes së zgjedhur, të cilën Ismajli e ka provuar edhe kur solli në shqipe vepra të mëdha të gjuhësisë, të semiologjisë e të dijeve të shekullit XX. Së pari, në vitin 1974, solli në shqip *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme* të Andre Martinesë, pastaj, më 1977, *Kursin e gjuhësisë së përgjithshme* të Ferdinand dë Sosyrit, një vepër bazë e gjuhësisë së përgjithshme, semiologjisë e gjuhësisë strukturaliste. Më 1984 - *Fjalorin enciklopedik të shkencave të ligjërimit* të Todorovit e Dykrosë. U hap drejt diskurseve moderne gjuhësore e semiologjike, më 1987, kur ktheu në gjuhën shqipe *Aventurën semiologjike* të Bartit.

Në fushë të letërsisë, përpos me diskurset interpretuese, Ismajli njihet me shqipërimin e poezisë së zgjedhur evropiane. Shqipërimet, këtu si kudo, shenjojnë identifikime të forta me autorët e zgjedhur, meqë zgjedhja bëhet në kushte motivimi të lartë. Në këtë frymë, autorë të Ismajlit bëhen edhe: Eminesku, Soresku e poetë të tjerë rumunë, të shqipëruar dhe të interpretuar nga ai, pastaj Hëlderlini, Niçe, George, Gras, Kavafi, Kuazimodo, Ungareti, Elyar, Prever, Boske etj. Të gjithë të zgjedhur dhe, dihet, *zgjedhjet* i ngjajnë *zgjedhësit*.

## V

Rexhep Ismajli, ngjashëm me Eqrem Çabejn apo dhe me Selman Rizën, e nisi jetën me dijet si lexues e si studiues i letërsisë. Këta, nga dashurues të letërsisë, u bënë mbretër të gjuhësisë. Një figurë e jona për Çabejn si Princ i ndaluar i kërkimeve letrare, kujtohet për Ismajlin, për të mbajtur e dhënë shenjat e para të dijetarit dhe dashurinë letrare të përjetshme të gjuhëtarit.

Në frymën e kësaj figure, që merr jetë në veprën e Ismajlit, do duhej të kërkohet teoricieni i hershëm te veprat e tij të identitetit kërkimor, *Shenjë e ide e Shumësia e tekstit*, dhe përthyerjet e kërkimeve të tij në shtrirjen e veprës në tërësi.

Veprat e para e zbulojnë poeticienin që e analizon tekstin letrar si *qenie gjuhësore*, gjithnjë duke patur sensin e vetëdijes për strukturën poetike të saj dhe për një natyrë autentike të letërsisë, pikëpamje kjo e njohur e autorëve të Qarkut të Prishtinës, të cilit i përket që në fillime edhe Ismajli.

Një përcaktim i tillë, edhe metodologjik, e shoqëron gjithë veprën studimore të Ismajlit, prandaj kërkimi dhe hapja e një metode të tillë, shndërrohet në synim të leximeve të veprës së tij.

## VI

Në këtë diskurs të përqendruar, shenjat e metodës, të sistematikës, dijes e të profilit të Ismajlit hapen te vepra themelore e tij, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, e lidhur në dy fusha: kërkim i sistemit gjuhësor të tekstit dhe analizë e funksionit të tij, pra semiologji. Vërtet, siç kemi nënvizuar, gjuhësia e semiologjia janë fushat e para të Ismajlit, të zgjedhura e të lidhura bashkë që në fillimet e kërkimeve të tij, herë të shtrira në diskurse teorike, si te *Shenjë e ide* dhe *Shumësia e tekstit*, e herë të provuara në tekste e korpuse konkrete, si në analizën e tekstit shqip të Kuvendit të Arbënit.

Në të dy fushat e nënvizuara, Ismajli është thellë natyrës së tij kërkimore, që përherë shfaqet me dy pamje të lidhura ekzistencialisht, *gjuhësia moderne*, si amzë metodologjike dhe fushë e pikëpamjeve nga e cila buron e dyta, *semiologjia* (gjuhësore). Këtë rend kushtëzimi e këtë raport ekzistencial ka ndjekur e ka kërkuar Ismajli edhe te studimi për gjuhën shqipe të Kuvendit të Arbënit.

Kërkimi gjuhësor i Ismajlit, i përqendruar te sistemi i gjuhës/tekstit shqip të Kuvendit të Arbënit, ka dhënë rezultate të vjera për grafinë dhe sistemin fonematik të këtij teksti, për ekzistencën e për funksionin. Në këtë rrafsh, Ismajli silltet kryesisht në qarkun e kërkimeve strukturaliste, të njohura si gjuhësi funksionale.

Për atë që ndjek lakoren e punës së semiologut Rexhep Ismajli, rrafshi i dytë i studimit *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, në të cilin analizohet *funksioni* i tekstit, përbën pjesën më interesante. Këtu kërkimi kapërcen fort rrafshet teknike të analizës dhe gjurmon semiologjinë e formave të tekstit, të lidhura me mesazhin. Në një përcaktim më insitues, do të thoshim se Ismajli hap retorikën e tekstit, nga pikëshikimi i semiologjisë, për t'i provuar nyjat që i lidhin këto dy fusha, njërën si *praktikë*, pra si teknikë/art shkrimi, e tjetrën si *dije*, pra si fushë interpretimi.

E lakuar përtej kërkimit teknik, që karakterizon analizën e sistemit, analiza e funksionit të tekstit rrjedh në një diskurs më të hapur, interpretues e më të stilizuar. Por, lidhja me kërkimin e parë nuk humbet asnjëherë, meqë ruhet kujtesa e rezultateve dhe shenja metodologjike që e provon gjuhën në funksion. Ky do të ishte një përcaktim përgjithësues, studim *gjuhe* e studim *funksioni*. Një shenjë që do ndjekur në diskursin e gjerë kërkimor të Ismajlit.

Studimi për Gjuhën shqipe të Kuvendit të Arbënit zgjerohet në studim për korpusin e teksteve shqipe të shekullit XVIII, për ta shenjuar këtë tekst si *vepër* kulturaklisht përfaqësuese.

## VII

Rexhep Ismajli në këtë diskurs e Orë do menduar si autor i trashëguar, bashkëkohës e i hapur, shenja që vetiu kalojnë nga Portreti i autorit, te kultura që mban e jep vepra e tij përtej vetes. Kjo ndodh, meqë vepra e tij çliron dije në diskutet përreth, për të krijuar rrjetin e vet kulturor.

Një autor i tillë, me mirë, një vepër e tillë bëhet e shenjueshme dhe shenjuese, që do të thotë *përfaqësuese*, një *vepër e jona*, meqë përfaqësimi buron nga identifikimi.

Ora e madhe e Rexhep Ismajlit, si *kobë* a si *qeniesi*, është përpara, në brezat që do t'i shtohen ekzistencës e kulturës sonë.

Vepra e Ismajlit është një Orë që përkulet para gjuhës dhe që e ruan kulturën shqiptare edhe përtej kohës së vet.





**Linditë SEJDIU – RUGOVA**

**REXHEP ISMAJLI PËR GJUHËSINË TEKSTORE**

**Hyrje**

Ky artikull synon të nxjerrë në dritë një përshkrim të shkurtër të punës shumëvjeçare të njërës nga gjuhëtarët më të shquar të gjuhësisë shqiptare në Kosovë dhe më gjerë, akademik Rexhep Ismajlit, me theks të veçantë kontributin e tij dhënë zhvillimit të gjuhësisë tekstore ndër shqiptarët dhe afirmimit të saj te brezat e rinj të gjuhëtarëve. Po qe se e vështrojmë kontributin e gjithmbarshëm të studiesve shqiptarë drejt integritimit shkencor evropian, kontributi i akademik Ismajlit në këtë rrafsh është i shumanshëm dhe qenësor. Veprimtaria akademike e Rexhep Ismajlit do të mund të zërthehet në rrafsh të një specialisti të gjuhës si sociolinguist, si historian i gjuhës, si përkthyes dhe si promotori kryesor i albanologjisë në botë. Nuk do të mjaftonin qindra artikujsh e punimesh për t'i përmbledhur dhe për t'i diskutuar veprat më të rëndësishme të këtij albanologu të mirënjohur, të cilat kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e gjuhësisë shqiptare. Do të përpiqemi ta theksojmë karakterin inovator të veprës së akademik Ismajlit, si një kontribut të pazëvendësueshëm të një njeriu për gjenerata të tëra albanologësh vendorë dhe të huaj e që ende vazhdon ta mbajë gjallë frymën e studimeve moderne gjuhësore në Kosovë, me theks të veçantë në zhvillimin e analizës së diskursit të ne.

**Rexhep Ismajli dhe gjuhësia e përtej frazës<sup>1</sup>**

Janë dy profesorët e mi që ndikuan që unë përfundimisht të merresha me sintaksë dhe me gramatikë të tekstit: akademikët Besim Bokshi dhe Rexhep Ismajli. I pari, me thellësinë e tij të analizës sintagmatike të grupeve emërore nga aspekti diakronik dhe krahasues, dhe i dyti, me zgjerimin e vazhdueshëm të horizontit tim gjuhësor duke më

---

<sup>1</sup> Rexhep Ismajli e përdor këtë term për gjuhësinë e tekstit në një nga artikujt e tij në veprën *Shumësia e tekstit*, 1980, Rilindja, Prishtinë, fq.92

sugjeruar të merresha me fusha shumë pak ose aspak të lëvruara të gjuhësisë shqiptare, me theks të veçantë në atë të gjuhësisë së tekstit.

Qysh në vitet 80'të të shekullit të kaluar, Ismajli flet për gjuhësinë tekstore dhe përpqet t'i sintetizojë shumë nga përkufizimet për tekstin si njësi gjuhësore e rendit më të lartë hierarkik se fjalja, të shprehura nga gjuhëtarët më eminentë botërorë të kohës. Në këtë rrafsh, Ismajli citon Sapire-in, Bloomfield-in, Togeby-në, Benveniste-n, Weinrich-un, etj. dhe përvojat e këtyre studiesëve i sjell edhe në shqipen duke i konkretizuar nëpërmjet të funksionimit të kohëve të foljeve në shqipen në tekstet e Gurakuqit, De Radës, Nolit, etj.

Ismajli, për herë të parë e njofton studiuesin shqiptar me analizën e përtejfrazës dhe bashkë me analizat e mëparshme të brenda fjalisë e vë në ekuilibër nivelin e raporteve sintagmatike dhe paradigmatiske të gjuhës (Ismajli, 1980:93). Ismajli, pas një studimi të kohëve të foljeve nga aspekti tekstor arrin në përfundim se shkrimtarët tanë të Rilindjes e kanë përdorur në shkrimin e tyre gjuhën e letërsisë gojore, kishin kulturë të ngritur mbi baza folklorike (Ismajli, 1980:105) dhe se studimi i kohëve të foljeve nga tekstet e shkruara të këyre shkrimtarëve vë në pah klasifikime plotësisht të ndryshme të teksteve varësisht nga trajtat foljore të përdorura në atë tekst.

Studimet e tilla u hapën rrugë studimeve të reja në fushë të analizës së tekstit duke u mbështetur në pjesët përbërëse përkatëse, në semantikën dhe në funksionin e tyre.

Në artikullin *Teksti* në përmbledhjen e tij të punimeve *Shumësia e tekstit* (1980: 69-90), Rexhep Ismajli i përmbledh përvojat e linguistike dhe semiotike të Lotman-it, të Salganjik-ut, Greimas-it, etj sa i përket përkufizimit të tekstit si njësi gjuhësore, me qëllim të identifikimit të tekstit artistik nga ai i zakonshëm apo të ligjëratës artistike nga ligjërata në përgjithësi. Ismajli tanimë kishte përvojë në studimin e ligjërimit poetik, të krahasimit të gjuhës shkencore dhe të asaj poetike (lirike) si dhe të studimve të tjera ndërdisiplinare, për të cilat bën apel të studiohen sa më shpejt që është e mundur meqë “koha e bashkëpunimit ndërdisiplinar po u bie të gjitha këmbanave”, dhe se pa të “as që mund të kërkohen rezultate që mund të na kënaqin në rrafsh të përgjithësimin shkencor” (Ismajli, 1974: 112).

Përpos që u muar me analizën e tekstit, kryesisht letrar, në shumë artikuj të përmbledhur dhe të botuar në vitet 70'të dhe 80'të të shekullit të kaluar, Rexhep Ismajli e studioi gjuhën dhe tekstin joletrar të shumë nga fytyrave më të ndritura të gjuhësisë botërore duke i përkthyer ato në shqipen. Nëpërmjet të përkthimeve të tij të shumta, ai ua mundësoi bashkëkombasve të tij të njihen me margaritarët e shkencës së gjuhësisë botërore duke ua sjellur në shqip veprat më të rëndësishme të kohës në fushë të gjuhësisë. Ismajli me të drejtë thekson në parathënien e Fjalorit enciklopedik të shkencave të ligjërimit (Dykro/Todorov, 1984: 8), të përkthyer nga vetë ai në gjuhën shqipe, se veprat e përkthyer në shqipen e kryejnë më efektivisht funksionin e tyre me

përkthimin e tyre në shqipen. Veprat e tilla janë botuar e ribotuar disa herë tash e 40 vjet më parë dhe ende vazhdojnë të lexohen e të përdoren nga studiuesit e rinj. Kontributi i Rexhep Ismajlit në këtë urë lidhëse të linguistëve shqiptarëve me Evropën dhe botën dhe anasjelltas është pothuajse i paarritshëm për breza me radhë.

Sa i përket relacionit *Rexhep Ismajli : Gjuhësi tekstore*, kontributi i tij më i madh është padyshim ndikimi që profesori ka patur te brezat e studiuesve të rinj për t'u marrë me një fushë të tillë, e cila deri në fillim të shekullit 21 ishte shumë pak e shtjelluar në shqipen (kryesisht është analizuar gjuha e letërsisë por jo edhe gjuha joletrare). Sot, analiza e diskursit dhe gjuhësia tekstore apo gramatika e tekstit janë lëndë obligative në shumë programe të studimit të gjuhësisë në Fakultetin e Filologjisë, disa punime të doktoratës dhe të masterit janë bërë nga kjo fushë dhe kanë sjellë rezultatet të lakmueshme për shqipen, disa sosh edhe janë botuar tanimë. Përkthimet e Rexhep Ismajlit përdoren si korpus i analizës gjuhësore tekstore kontrastive nga ana e studentëve të gjuhëve të huaja, përpos funksionit të tyre qenësor dhe të domosdoshëm që kanë për mësimin e koncepteve gjuhësore në studimet themelore.

### **Në vend të përfundimit**

Simboli i Seminarit ndërkombëtar të gjuhës, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare, institucionit më të rëndësishëm ndërkombëtar të albanologjisë në botë, është hyjnesha në fron, një relik i së kaluarës me një rëndësi shumë të madhe për historinë e Kosovës dhe të popullit shqiptar. Gjuhëtari i gjallë, më i shquar dhe më meritor për mbarëvajtjen 30 vjeçare dhe afirmimin e Seminarit në botë është padyshim akademik Rexhep Ismajli. Fronin ia ka siguruar vetes që moti!

Zatën, figura e këtij albanologu të shquar tanimë e ka zënë një vend të denjë në kolonën e emrave të papërsëritshëm të personaliteteve shqiptare në vend dhe në botë. Pa emrin dhe veprën e Rexhep Ismajlit shkenca e albanologjisë nuk do të ishte as për së afërmi ajo që është sot, nuk do ta kishte fuqinë dhe rëndësinë që e ka sot.

## **Bibliografi**

1. Ismajli, Rexhep: *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Rilindja, Prishtinë, 1984;
2. Ismajli, Rexhep: *Shenjë dhe ide*, Rilindja, Prishtinë, 1974;
3. Ismajli, Rexhep: *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1980;
4. Ismajli, Rexhep: *Gjuha shqipe e Kuëndit të Arbënit(1706)*, Rilindja, Prishtinë, 1985

## **Shkumbin MUNISHI**

### **REXHEP ISMAJLI – NISMËTAR I DREJTIMEVE MODERNE LINGUISTIKE SHQIPTARE**

#### **Hyrje**

Gjuhësia shqiptare filloi të formësohej si disiplinë e veçantë në kuadër të albanologjisë që nga fillimi i shekullit XX e këndej. Para asaj kohë, por edhe më vonë, interesimet për shqipen dhe për problemet e ndryshme gjuhësore të saj ishin objekt studimi kryesisht i gjuhëtarëve të huaj. Qenë gjuhëtarët shqiptarë të shkolluar jashtë Shqipërisë, si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Selman Riza e disa të tjerë, që dhanë një kontribut të çmuar në formësimin e gjuhësisë shqiptare gjatë viteve 20-30 të shekullit të kaluar. Megjithatë, gjuhësia shqiptare konsolidimin më të plotë arriti ta ketë pas Luftës së Dytë Botërore (LDB), kur studimet gjuhësore shqiptare morën hov në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Ndonëse gjuhësia shqiptare e asaj periudhe mbetej në skemat e gjuhësisë tradicionale e klasike, me një ndikim nga gjuhësia historike-komparative, më vonë nga gjuhësia sovjetike, megjithatë arriti të shënojë rezultate pozitive në studimet e çështjeve gramatikore, leksikore, dialektore e normative. Puna kryesore që përqendruar në studimin e problemeve në fushën e fonetikës, morfologjisë, sintaksës, leksikut, si dhe në hartimin e gramatikave dhe të fjalorëve të shqipes. Kjo veprimtari studimore shkante pothuajse paralelisht me përpjekjet për normimin e shqipes dhe si rezultat ishte botimi i një sërë ortografish të shqipes, të cilat u botuan që nga viti 1948 e këndej. Në fushën e dialektologjisë pati një sërë aktivitete për studimin e dialekteve e të folmeve të shqipes, studime këto që kishin për qëllim hartimin e Atlasit Dialektor të Shqipes. Por, përkundër këtyre përpjekjeve dhe të arriturave studimore, gjuhësia shqiptare e asaj periudhe vazhdonte të mbetej e pa ndikuar nga drejtimit moderne të shekullit XX, siç ishin strukturalizmi, funksionalizmi e gramatika gjenerativiste transformacionale. Drejtimit intersidiplinare, siç ishin sociolinguistika e psikolinguistika, të cilat filluan të zhvilloheshin gjatë viteve '50 të shekullit të kaluar, pothuajse ishin të panjohura për gjuhësinë shqiptare të para 3-4 dekadave. Arsyet për mos depërtimin e këtyre drejtimeve linguistike në Shqipëri mbase duhet kërkuar në rrethanat politike, ekonomike e

kulturore, të cilat mbretëronin në Shqipërinë e asaj periudhe. Mbyllja hermetike dhe izolimi i vendit pengonin kontaktet me botën tjetër dhe ndikonin në përcjelljen e rrjedhave studimore moderne të kohës.

Në anën tjetër, në Kosovën e pasluftës (pas LDB-së) mungonin gjuhëtarët dhe ata pak gjuhëtarë që ishin, u takonin kryesisht shkollave tradicionale të gjuhësisë. Mungesa e informatave për drejtimitet linguistike të kohës dhe mosnjohja teorike e tyre, nganjëherë shfaqej përmes refuzimit ideologjik të drejttimeve moderne linguistike. Ideologjia bëhej mburojë për mosdije dhe refuzim. Konceptet e pakta teorike të strukturalizmit, gjenerativizmit e funksionalizmit, për të cilat ndonjë gjuhëtar kishte informacione të kufizuara, hidheshin poshtë duke u stigmatizuar e cilësuar me përplot attribute negative ideologjike. Në anën tjetër, kishte edhe gjuhëtarë, që mbase kishin sadopak njohuri për zhvillimet moderne në fushën e gjuhësisë, por pikërisht për shkak të stigmatizimit ideologjik, nuk zbatonin dot në studimet e tyre metoda e skema teorike të drejttimeve të përmendura linguistike.

Në rrethana të tilla gjuhësia shqiptare e periudhës së pas LDB-së mbeti e izoluar dhe e pandikuar nga shkollat e drejtimitet e atëhershme moderne linguistike. Kjo situatë ndikoi drejtpërdrejt në nivelin e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare dhe pati për pasojë shfaqjen e mangësive të shumta teorike e praktike në studimet në fushën e gjuhësisë. Në fakt, gjuhësia shqiptare edhe sot e gjithë ditën nuk ka arritur të dalë krejtësisht nga skemat e gjuhësisë tradicionale, në të cilat ka qenë e ngjuar për gati 4 dekada. Ndryshimi i rrethanave politike, ekonomike e kulturore, si dhe zhvillimi i teknologjisë informative, në këto dy dekadat e fundit, i ka hapur rrugë depërtimit të drejttimeve moderne linguistike, të cilat kanë filluar të përqafohen nga studiuesit e brezit të rinj. Këto zhvillime sigurisht që do të ndikojnë në zhvillimin pozitiv të gjuhësisë shqiptare në shekullin në të cilin po jetojmë.

## **1. Saussure dhe Martinet flasin shqip nëpërmjet Ismajlit**

Përderisa gjuhësia shqiptare, jo me fajin e linguistëve shqiptarë, ishte vetëizoluar në Shqipërinë komuniste, në Kosovë, pas vitit 1968, u krijuan mundësitë që studentët e atëhershëm shqiptarë të vazhdonin specializimin dhe t'i ndiqnin studimet pasuniversitare në universitetet e ndryshme të Europës Perëndimore. Kjo mundësi iu dha edhe studentit të atëhershëm të posadiplomuar të gjuhës dhe letërsisë shqipe, Rexhep Ismajlit, i cili në vitet 1971-1973 specializoi për gjuhësi në Institut de linguistique générale et appliqué "René Descartes" (Sorbonne), Paris, nën drejtimin e linguistit me famë botërore André Martinet. Qëndrimi në Paris dhe njohja e gjuhës frënge dhe e gjuhëve kryesore botërore, i dhanë mundësi Ismajlit që të vijë në kontakt me fushat kryesore studimore linguistike dhe me literaturën teorike të atyre fushave. Pas

interesimeve dhe trajtimeve të para të problemeve të historisë së gjuhës shqipe, ai gradualisht u orientua në çështje e trajtime të problemeve në fushën e gjuhësisë teorike. I pajisur me dije nga drejtimit moderne të gjuhësisë, Ismajli u bë përçuesi kryesor i këtyre drejtimeve në gjuhësinë shqiptare. Krahas trajtimeve të problemeve teorike nga fushat e tilla, si semiologjia, strukturalizmi e funksionalizmi, Ismajli ndërmori edhe hapa konkretë në mënyrë që disa nga studiuesit kryesor të shekullit XX t'i afrojë me gjuhësinë shqiptare. Kështu, ai i hyri përkthimit të dy veprave tejet të rëndësishme të gjuhësisë botërore: *Kursit të gjuhësisë së përgjithshme* të Ferdinand de Saussure-it dhe *Elementet e gjuhësisë së përgjithshme* të lingvistit francez, profesorit të tij, Andre Martinet. Përmes *Kursit të gjuhësisë së përgjithshme* gjuhësia shqiptare erdhi në kontakt me strukturalizmin dhe semioogjinë e Saussure-it. Ndarja dikotomike e ligjërimit në gjuhë dhe të folur, konceptet për shenjë dhe përbërësit e saj, të shënjuarin dhe shënjesin, për vlerën dhe raportet midis shenjave, si dhe për gjuhën si dukuri shoqërore, u bënë të njohura për shqipfolësit nëpërmjet përkthimit të Ismajlit. Ndërkaq, me *Elementet e gjuhësisë së përgjithshme*, gjuhësia shqiptare u njoh me drejtimin funksional në gjuhësi, me konceptet teorike të Martinet-së për gjuhën, si dhe me pikëpamjen e tij për nyjetimin e dyfishtë të gjuhës.

Përkthimet e këtyre dy veprave tejet të rëndësishme sigurisht që hapën një dritare të re për gjuhësinë shqiptare në përgjithësi, edhe përkundër faktit që ndikimi i tyre te studiuesit shqiptarë si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipërinë e izoluar mbeti i kufizuar. U deshën më shumë se 25 vite që këto dy vepra të përkthyer të botohen edhe në Shqipëri. Natyrisht, Ismajli nuk u mjaftua vetëm me përkthimin e këtyre dy veprave. Në librin e tij *Shenja dhe ide*, ai u thellua më tej në leximin dhe interpretimin kritik të veprave të këtyre dy studiuesve, duke u thelluar më tej edhe në trajtimin e çështjeve të ndryshme teorike e praktike nga fusha e gjuhësisë teorike, punë të cilën nuk e kishte bërë asnjë gjuhëtar tjetër para tij. Përmes përkthimeve dhe trajtimeve teorike të problemeve nga fusha e gjuhësisë së përgjithshme, Ismajli po e njoftonte gjuhësinë shqiptare me drejtimit moderne linguistike të kohës. Në këtë mënyrë, përmes ligjëratave të tij në fushën e gjuhësisë së përgjithshme për studentët e Fakultetit të Filologjisë dhe përmes shkrimeve të shumta, ai po i orientonte studentët e tij, por edhe studiuesit e tjerë shqiptarë drejt të arriturave të gjuhësisë moderne.

Në punimet e tij të mëvonshme, Ismajli u zgjerua edhe më tej në studimet linguistike, duke trajtuar probleme të filozofisë së gjuhës, të raporteve midis gjuhës dhe shoqërisë dhe të ndikimit të gjuhës në kategoritë sociologjike. Këto trajtesa zgjeruan edhe më shumë diapazonin e interesimeve të Ismajlit, duke e shndërruar atë në gjuhëtarin më të kompletuar shqiptar.

## 2. Themelues i sociolinguistikës shqiptare

Nga gjysma e dytë e viteve '70 të shekullit XX, në disa punime të tij, Rexhep Ismajli në mënyrë të vazhdueshme u mor me trajtimin çështjeve të planifikimit gjuhësor dhe të shqipes standarde, duke mos u kufizuar vetëm në përshkrimin e normës së saj e në çështje të kulturës së gjuhës, që ishte bërë zakon në atë periudhë, por duke trajtuar problemet e planifikimit të shqipes nga një këndvështrim i ri deri atëherë në gjuhësinë shqiptare – nga këndvështrimi sociolinguistik. Sociolinguistika si shkencë interdisiplinare që nga vitet '60 të shek. XX kishte marr hov në SHBA dhe në Europën Perëndimore, por në botën shqiptare mbetej fushë e paprekur. Politika gjuhësore dhe planifikimi i gjuhës ishin bërë fushat kryesore të studimeve sociolinguistike, në të cilat ishin arritur rezultatet domethënëse. Kjo për faktin se trajtimi i politikave gjuhësore dhe i proceseve të planifikimit të gjuhës bëhej duke marrë në konsideratë jo vetëm faktorët gjuhësorë, por në masë të madhe edhe ndikimin e faktorëve të tjerë shoqërorë, kulturorë e ideologjikë.

Përkundër jehonës dhe ndikimit që patën studimet sociolinguistike në fushën e politikës dhe të planifikimit gjuhësor gjithandej nëpër botë, në gjuhësinë shqiptare sociolinguistika mbetej fushë e palëvruar fare. Ndërkaq, sa i përket problemeve të trajtimit të çështjeve të standardizimit të shqipes nga këndvështrimi sociolinguistik, as që mund të flitej për një gjë të tillë, për shkak se çdo trajtimi i çështjeve të standardizimit të shqipes duhej të ishte në përputhje me skemat ideologjike të sistemit të atëhershëm monist. Çdo qasje tjetër ose nuk mund të shfaqej brenda Shqipërisë së atëhershme komuniste, ose nëse shfaqej jashtë trullit shqiptar, stigmatizohet dhe nuk mund të depërtonte fare në gjuhësinë shqiptare. Si ilustrim mund të merret shembull trajtimi i pikëpamjeve të J. Byron për standardizimin e shqipes nga Androkli Kostallari, duke i quajtur “pohime kundërthënëse”, se “formimi i shqipes letrare të njësuar trajtohet në mënyrë të shtrembëruar e të thjeshtëzuar”, se “përfundimet themelore që jepen aty nuk kanë dalë nga analiza e thelluar objektive e sistemit dhe e nënsistemeve të gjuhës letrare shqipe, të parë në zhvillimin e saj të pandërprerë” etj. etj., se “ato janë nxjerrë në mënyrë subjektive, duke zbatuar mekanikisht e me një metodë eklektike për shqipen teza e përfundime të një vargu sociolinguistësh si Punya Sloka Ray, Einar Haugen, Valter Tauli, Jiri V. Neustupny, Joshua A. Fishman, Charles A. Ferguson etj., të cilët, siç dihet kanë trajtuar, mjaft herë nga pozita të ndryshme e të njëanshme aspekte të përgjithshme të standardizimit të gjuhëve e çështje të gjuhëve të veçanta, sidomos jo evropiane, por nuk kanë pasur asnjëherë si objekt studimi gjuhën shqipe (Kostallari, 1984:37).

Pikërisht, duke pasur parasysh pikëpamjet e sociolinguistëve më të njohur të kohës, Rexhep Ismajli mori në trajtim çështjet e shqipes standarde, të normës, të



tipareve e të statusit së saj. Në këtë mënyrë, për herë të parë çështjet e standardizimit shqipes nuk po trajtoheshin brenda skemave të fabrikuara të ideologjisë marksiste, por po trajtoheshin në kuadrin e pikëpamjeve e koncepteve më moderne sociolinguistike. Pikëpamjet e tij patën ndikim të drejtpërdrejtë në trajtimin objektiv të procesit të planifikimit të shqipes dhe në shembjen e miteve të konstruara ideologjike për shqipen standarde. Ai arriti me plotë sukses që trajtimin e çështjeve të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor ta vendosë në binarë shkencorë. Në këtë mënyrë Ismajli po i hapte rrugë sociolinguistikës që të depërtonte edhe në gjuhësinë shqiptare. Kështu, që nga viti 1978 e deri në ditët e sotme, në një sërë punimesh të vazhdueshme ai trajtoi probleme nga më të ndryshmet nga fusha e politikës gjuhësore dhe planifikimit gjuhësor, duke u bërë kështu sociolinguisti i parë shqiptar.

Puna e tij pioniere në fushën e sociolinguistikës jo vetëm që u bë model për disa linguistë të rinj që ta ndjekin rrugën e tij, por pati ndikim të drejtpërdrejtë në rrjedhat e kahet e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare.

### **Përfundime**

Në botën shkencore ka pak shkencëtarë që kanë fatin që me punën dhe veprimtarinë e tyre arrijnë të lënë gjurmë të pashlyeshme dhe të kenë rol vendimtar në drejtimin e zhvillimit të shkencës së kombit të tyre. Një gjë të tillë e ka arritur padyshim Rexhep Ismajli, puna dhe veprimtaria e të cilit luajtën rol vendimtar që gjuhësia shqiptare të dalë nga skemat anakronike të gjuhësisë tradicionale, në të cilat ishte ngujuar deri para tri dekadash, dhe t'i përqafojë rrjedhat moderne linguistike. Kontributi i tij në fushën e gjuhësisë së përgjithshme ndikoi drejtpërdrejt drejtimet e tilla linguistike, si strukturalizmi e funksionalizmi, të hyjnë në fushat studimore të gjuhësisë shqiptare dhe të lënë gjurmë në trajtimet shkencore të problemeve gjuhësore të shqipes.

Po ashtu, punimet e tij në fushën e politikës gjuhësore dhe të planifikimit të shqipes dhe të gjuhëve të Ballkanit, si dhe në fushën e filozofisë së gjuhës, e bëjnë atë pionier dhe themelues të sociolinguistikës shqiptare. Krahas vlerave të shumta shkencore, punimet e trajtesat e Ismajlit në fushën e sociolinguistikës, në fakt e orientuan kahun studimor të gjuhësisë shqiptare drejt ujërave sociolinguistike. Kontributi studimor shkencor i Ismajlit pati ndikim të drejtpërdrejtë që gjuhësia shqiptare të mos ngelet mbrapa pas studimeve të avancuara linguistike, por që përkundër vështirësive t'i përcjellë dhe t'i zbatojë ato në kontekstin e trajtimit të problemeve të shqipes. Veprimtaria e tij shkencore e bën atë nismëtar të drejtimeve moderne linguistike shqiptare.

Krejt në fund, vlen të theksohet se kur merret parasysh konteksti jashtëzakonisht i vështirë historik, politik e ideologjik, në të cilin ka punuar e vepruar Rexhep Ismajli, atëherë bëhet krejtësisht e qartë që kontributi dhe veprimtaria e tij, me plotë të drejtë, mund të cilësohen si kolosale për gjuhësinë shqiptare dhe më gjerë, dhe që mbase e bëjnë Ismajlin të papërsëritshëm edhe për një periudhë të gjatë kohore.

### **Literatura**

1. Dë Sosyr, Ferdinand (1978). Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, përkthyer nga Rexhep Ismajli, Rilindja, Prishtinë.
2. Ismajli, Rexhep (2005). Gjuhë standarde dhe histori identitetesh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
3. Ismajli, Rexhep (2003). Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë.
4. Ismajli, Rexhep (1998). “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, Dukagjini, Pejë.
5. Ismajli, Rexhep (1994). Etni e modernitet, Dukagjini, Pejë.
6. Ismajli, Rexhep (1991). Gjuhë dhe etni, Rilindja, Prishtinë.
7. Kostallari, Androkli (1984). Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë (referat), në: Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë, 1988.
8. Martinet, Andre (1974). Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, përkthyer nga Rexhep Ismajli, Rilindja , Prishtinë.



**Bardh RUGOVA**

## **NDIKIMI I SHUMËFISHTË I REXHEP ISMAJLIT NË GJUHËSINË SHQIPTARE**

Rexhep Ismajli, si asnjë albanolog tjetër, e ka shtrirë rrezen e studimit të tij në një flurudhë të gjerë që e përfshin strukturën e gjuhës, në të gjitha nivelet e saj, që nga fonema, deri te njësitë e tekstit, dhe që i kap më tutje diakroninë dhe studimet funksionale.

Ndikimi i tij është i shumëfishtë. Unë sot do të flas për një dimension në dy nivele të këtij ndikimi, për gjuhësinë shqiptare përgjithësisht:

1. Niveli i parë ka të bëjë me sjelljen e mendimeve të reja në gjuhësinë e botës shqiptare – strukturalizimin para së gjithash dhe zbatimin e tij, duke sjellë me të edhe terminologjinë e re në studimet shqiptare. (Për studimet e tekstit tashmë u fol këtu)

2. Niveli i dytë ka të bëjë me zbatimin e këtyre metodave dhe të teorive të reja në studime empirike, në leximet e teksteve të vjetra dhe në studimet diakronike përgjithësisht.

Në të vërtetë, studimet e shqipes në botën shqiptare kanë ndjekur për një kohë të gjatë thujt një trajektore të vetme, lineare, të mbështetur në bazën e gjuhësisë tradicionale. Ndonjë shmangie e rastit si ajo e Rizës, nuk kishte pasur ndikim, në atë kohë, për shkak të historisë së autorit dhe mundësisë së marrjes së materialeve të tij.

Megjithatë, në vitet shtatëdhjetë, dy autorë do të shmangin këtë trajektore tradicionale për të hapur një dimension të ri, apo disa dimensione të reja: Besim Bokshi dhe Rexhep Ismajli, ky i dyti atëbotë fare i ri në moshë, po sillnin këndvështrime të reja për probleme të gjuhës shqipe.

Gjuhësia strukturale po hynte tamam në studimet e shqipes, të botës shqiptare.

Po them të botës shqiptare, duke e pasur fjalën për autorë shqiptarë: autorë të ndryshëm, Hamp (nxënës i Harrisit), Fiedler kishin publikuar që më parë; Buchholz kishte edhe trajtime gjenerativiste. Mirëpo, ky tani ishte një lloj revolucioni historik në gjuhësinë shqiptare.

Ismajli do të vazhdojë tutje edhe me trajtimet funksionale (për çka foli prof. Munishi), me trajtimin e shenjës (për çfarë foli profesor Shala) dhe zgjerimin e objektit

të studimit gjuhësor në nivel të përtej frazës siç shprehej vetë Ismajli (për çka foli Lindita).

Këtu, në këtë kumtesë, do të diskutojmë vetëm për sjelljen e koncepteve dhe me to të termave të rinj në gjuhësinë shqiptare përmes punimeve origjinale dhe përkthimeve të autorëve themelorë të gjuhësisë së shekullit XX; dhe për zbatimin e tyre në studimet gjuhësore, duke e vënë theksin në tekstet e vjetra dhe studimet e historisë së gjuhës.

### **Terminologjia**

Kontributi i Rexhep Ismajlit për terminologjinë është i dyfishtë. Në rrafshin e parë, ai është një autor që sjell koncepte të reja në gjuhësinë shqiptare dhe me to edhe nevojën për termat e rinj, të cilët i përshtat dhe i krijon.

Në indekset e termave të përkthimeve të tij është farkuar edhe baza teorike e studimeve të sotme, të paktën në mesin e autorëve seriozë në Kosovë.

Ismajli ofron një indeks prej 130 termash të përkthimi i Sosyrit, rreth 250 të përkthimi i Andre Martinesë, profesorit të tij në Paris, dhe 810 të Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit të Osvald Dykrosë dhe Cvetan Todorovit, nga të cilët 50 janë terma të fushës së studimeve tekstore, për çfarë kemi kumtuar në Konferencën për terminologjisë e gjuhësisë të mbajtur në Elbasan më 2012.

Këta terma tok me të tjerët të ofruar në studimet e tij origjinale, e sjellin në rreth 1500 numrin e përgjithshëm të termave të rinj, të krijuar a përshtatur nga vetë Ismajli.

### **Diakronia**

E dyta pjesë e këtij kumtimi lidhet me zbatimin e dijeve të reja në studimet e Ismajlit.

Interesimet e para të Ismajlit lidhen me fonologjinë, në sinkroni e diakroni, duke u orientuar më pas kryesisht në fushën e teksteve të vjetra e të historisë së gjuhës, por edhe në studime krahasimtare të shqipes, po e zëmë me rumanishten e gjuhët e tjera të Ballkanit, që e bëjnë Ismajlin edhe njërin ndër ballkanologët autoritativë.

Këtu më duhet të bëj një ndërprerje për të vërejtur se idetë dhe konceptet e Ismajlit të shprehura në moshë të re, në fillim të viteve shtatëdhjetë, vazhdojnë të jenë të qëndrueshme edhe sot.

Sa për ilustrim, po e marr shembullin e përshkrimit të procesit të krijimit të rotacizmit në gjuhën shqipe, duke e parë në mbështetje të kundërvënies së n-së geminante me atë jogeminante. Kjo krijonte kundërvënie funksionalisht të ngatërruar, duke nxitur që n-ja jogeminante të shqiptohej e labërguar sa për të mos u ngatërruar me n-në geminante (nënna, hënna). Në veri, për shkak të fonologjizimit të hundorësisë –

me një lloj tendence e hapjes së rrokjes, krijohen kushtet për ruajtjen e kundërvënies në kuadër të fjalës, prandaj nuk ka rotacizëm.

Në veri, ashtu edhe në jug, kemi fonologjizimin e variantit ekspresiv kuantitativisht më të gjatë të dridhëses r, i cili u ndihmua edhe nga asimilimi i grupit konsonantik rn.

Ky është një këndvështrim i ndryshëm nga ai i autorëve të tjerë që e kanë përshkruar dukurinë e rotacizmit, por sqarimi i atij djali të ri, 23 – 24 vjeç atëbotë, nuk mund të kontestohet as sot.

Po ashtu, javën e shkuar e dëgjuam ligjëratën e profesorit për prejardhjen e shqipes dhe besoj se shumë prej jush që e kanë lexuar artikullin e tij të tridhjetë vjetëve më parë, do të jenë dakord se në pikëpamje të rezultatit, Ismajli i mbetet besnik mendimit të tij të shprehur 3 dekada më parë, ndërsa në ligjëratën e re, bën rilexim të rezultateve të të tjerëve dhe gjetjeve të reja, të bëra ndërkohë.

Po e njëjtë si tri dekada më parë, mbetet edhe kritika ndaj njëanshmërisë që ndeshet në studimet për prejardhjen e gjuhëve nga autorë të ndryshëm.

Kjo e dëshmon profesor Ismajlin, autor serioz, që nuk publikon pa qenë i sigurt për atë që shkruan.

Thashë se Ismajli nis me studimet e fonologjisë, duke kaluar edhe në rrafshin diakronik, ndërsa ai ofron studimin për sistemin fonologjik të shqipes, të shekullit 18, ku pos që përshkruhet sistemi, ofrohen edhe zgjidhje për shumë detaje të tij.

Ai ofron kontribut për grafinë e autorëve të vjetër, përfshirë po e zëmë përshkrimin e sistemit fonologjik të Buzukut mbështetur në grafinë e tij.

Në këtë vazhdë, Ismajli nis të bëjë tutje fonologjisë, duke ofruar zgjidhjet e para edhe në rrafshin morfologjik – artikulli i tij i fundit të viteve shtatëdhjetë për kohët e foljeve, i rimarrë edhe në veprën “Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)” është shembull i tillë. Aty mes tjerash, Ismajli e sheh nevojën dhe bën klasifikimin e kohëve të foljeve të shqipes në rrafshin e tekstit.

Në librin për gramatikën e parë të shqipes, Dorëshkrimin e Grotaferatës, siç vëren edhe Shala, duke nisur nga rrafshi fonologjik, kalon në atë gramatikor.

Shkrimet e Ismajlit për historinë e gjuhës janë të ndryshme për nga tematika, por edhe për nga mënyra e konceptimit të tyre dhe kjo mund të sqarohet me rrezen e gjerë të bazës teorike që shfrytëzon Ismajli në studimet e tij e për çka u fol në fillim të kësaj kumtese.

Ai i trajton problemet në rrafshin e konceptimit thjesht struktural të zhvillimit të gjuhëve, por vjen duke e zgjeruar objektin me njësi më të gjera se fjalia dhe vazhdon me konceptime më të gjera të procesit gjuhësor, përfshirë sociolinguistikën.

Duke e thënë këtë, e argumentojmë tezën tonë, me të cilën edhe e nisëm këtë kumtesë.





## I. GJUHËSI



**Teuta ABRASHI**

## **KONTRIBUTI I ODA BUCHHOLZ-it NË GJUHËSINË SHQIPTARE**

Oda Buchholz, një albanologe nga Gjermania, me punimet e saja ka kontribuar rreth disa çështjeve të gjuhësisë së shqipes. Ndër to janë: rimarrja e kundrinës, që ishte edhe temë disertacioni, pastaj punimet rreth kategorisë së shquarsisë/jo shquarsisë, valencës së foljes, strukturës së fjalisë së shqipes dhe të tjera. Por ajo, së bashku me Wilfried Fidler-in, po ashtu një albanolog gjerman, janë ko-autorë të librit *Albanische Grammatik*<sup>1</sup>, për të cilin mund të thuhet se është mbase edhe burimi më i cituar lidhur me gramatikën dhe gjuhën shqipe në publikimet ndërkombëtare linguistike. Në këtë kumtesë do të provoj të pasqyroj këtë kontribut të saj duke paraqitur shkurtazi problematikën rreth rimarrjes së kundrinës së drejtë dhe trajtimin e predikacionit sekondar të mbiemrat depiktivë, të cilat edhe sot nuk e kanë humbur aktualitetin e tyre. Mirëpo, para se të paraqes këto trajtesa më lejoni t'i them disa fjalë rreth librit.

### **1. Gramatika e gjuhës shqipe**

Para së gjithash, libri drejtpërdrejt ose tërthorazi i përfshin kontributet e të dy autorëve. Por, cila është e veçanta e librit? Sipas mendimit tim arsyet janë të shumta, këtu po i përmendim disa :

**Së pari:** Për të paraqitur sistemin e gjuhës shqipe është përvetësuar modeli dhe metodologjia e përdorur për përpilimin e doracakut të gramatikës së gjuhës gjermane për të huaj nga Gerhard Helbig dhe Joachim Buscha<sup>2</sup>, i cili ende është aktual dhe shumë i preferuar për studentët e huaj të gjuhës gjermane, por, gjithashtu, shumë shpesh në punime e monografi shkencore citohet edhe si burim i gramatikës gjermane.

**Së dyti:** baza teorike e librit mbështetet në gramatikën e Institutit qendror të Gjuhësisë pranë Akademisë së Shkencave të Gjermanisë së atëhershme Lindore apo DDR-it. Kjo gramatikë e botuar më 1981 në Berlin, e redaktuar nga një grup autorësh:

---

<sup>1</sup> Buchholz, Oda/Wilfried Fiedler (1987): *Albanische Grammatik*, Akademie Verlag, Berlin

<sup>2</sup> Helbig, Gerhard/ Joachim Buscha (1991): *Deutsche Grammatik-Ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt • Verlag Enzyklopädie. 10. Auflage, Berlin

Karl Erich Heildoph, Wolfgang Motsch dhe Walter Flämig<sup>3</sup> dhe përpiluar nga së paku 6 autorë dhe të diskutuar nga një numër i konsiderueshëm i gjuhëtarëve shumë të spikatur, ishte dhe vazhdon të jetë një “konkurrençe” shumë serioze e gramatikës së DUDEN<sup>4</sup> dhe gramatikës së Institutit të Gjuhës Gjermane nga Mannheim-i. Një ndër veçantitë e këtij libri gramatikor është paraqitja e moderuar me një frymë të theksuar strukturaliste. Ky fakt, siç pohon Admoni (1982: 35)<sup>5</sup>, nuk befason nëse kihet parasysh se qysh në fund të viteve 50-ta gjuhëtarë të rinj të Gjermanisë Lindore, përfshirë pra edhe autorët e këtij libri, filluan të aplikojnë metoda gjenerativiste për të hulumtuar dukuritë e gjuhës gjermane. Duke pas parasysh se në këtë se mbizotëronte një frymë e tillë, atëherë nuk befason fakti se Buchholz zgjodhi modelin gjenerativist, konkretisht: modelin e vitit 1965 të Chomskit apo i njohur si modeli i Aspektit<sup>6</sup>, për të rrahur problematikën në disertacionin e saj.

**Së treti:** nisur nga arsyet e mësipërme, modeli, metodika dhe baza solide teorike e bëjnë këtë gramatikë koherente me shumë gramatika të tjera. Kështu, pasaktësitë rreth përkufizimit të njërive themelore sintaksore, siç është p. sh. rasti i togfjalëshit në gjuhësinë shqiptare, nuk janë të pranishme. Aty njësi bazë merren grupfjalëshat: emëror, foljor, mbiemëror dhe parafjalor. Gjithashtu, autorët përfshijnë konceptet siç janë p. sh. valenca dhe rolet semantike të plotësve të foljes (Agensi, Patiensi), por edhe trajtimin nga aspekti komunikativo-kontekstual të fjalisë (Thema dhe Rhema).

**Së katërti:** Ndonëse libri nuk përfshinë një kontrastim sistematik ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj gjermane, megjithatë, jo rrallë, kontrastimi i dukurive gjuhësore ndërmjet të dy gjuhëve është i pranishëm. Kjo sidomos te dukuritë të cilat për një gjermano-folës do të ishin më të kapshmet si p. sh. karakteri i pjesëzave dhe struktura e fjalisë. Por, gjithashtu edhe në rastet kur një dukuri, përfshirë edhe ato në rrafshin fonetik, është ndryshe e strukturuar apo nuk ekziston fare në gjuhën gjermane, autorët bëjnë një analizë konforntative më të thukët, e cila nuk mund të gjendet në ndonjë libër tjetër gramatikor. Kështu p. sh. te disa gramatika të gjuhës gjermane dhe gjuhëve të tjera, të shfaqura së fundi, mbiemrat dhe ndajfoljet janë të përfshira në të njëjtin klasë të fjalëve të ligjëratës për shkak të kuptimit shpesh të njëjtë dhe për shkak të shkallëzimit të tyre. Por, në gjuhën shqipe mbiemrat dhe ndajfoljet kanë një ndarje të qartë. Morfologjikisht ato dallohen me anë të njëjës së parme të mbiemrit, kurse rrafshin sintaksor, mbiemrat në mënyrë sistematike, kurse ndajfoljet vetëm në raste tepër të veçanta përdoren në funksion atributiv. Leksemat të cilat përdoren në funksion

<sup>3</sup> *Grundzüge einer deutschen Grammatik*. Von einem Autorenkollektiv unter der Leitung von K. E. Heildoph, W. Flämig und W. Motsch. Akademie Verlag, Berlin

<sup>4</sup> DUDEN (2009): *Duden Grammatik*, 8. Auflage, Dudenverlag, Mannheim

<sup>5</sup> Admoni, Wladimir (1982): *Der deutsche Sprachbau*, 4. Auflage, Beck Verlag, München

<sup>6</sup> Chomsky, Noam (1965): *Aspects of the Theory of Syntax*, de Gruyter, Berlin

predikativ (pa këpujë) në gjuhën shqipe klasifikohen si ndajfolje. Mbiemri mund të përdoret vetëm në funksion dytësor predikativ të mbiemrat depiktiv, por jo edhe të mbiemrat rezultativ si në gjuhën gjermane apo angleze.

Në faqen 462 të gramatikës, Buchholz dhe Fiedler, pohojnë se një fjali që në veti ngërthen një atribut predikativ (siç e quajnë ata), ka një strukturë të brendshme e cila përbëhet prej dy fjalive:

- (I) një fjali të plotë dhe
- (II) një fjali të përbërë: SUBJEKTI+është+Predikati dytësor,


Kështu për shembullin:

*Agimi e hëngri supën të ngrohtë.*

themi se predikati depiktiv i referohet objektit nëse kryefjala e fjalisë së dytë është identike me kundrinën e fjalisë së parë:

- (I) *Agimi e hëngri **supën**.* dhe
- II) ***Supa** ishte/ qe e ngrohtë.*

Skematikisht predikacioni dytësor mund të paraqitet kështu:




Gjithashtu fjalia e dytë mund të modifikohet duke përfshirë formën pronominale të antecedentit të kryefjalës, të shënuar me indeksin *i*:

*Agimi e hëngri **supën<sub>i</sub>**. Ajo<sub>i</sub> ishte e ngrohtë.*

Por, për shkak të eptimit, sipas Buchholz në gjuhën shqipe kryefjala mund edhe të hiqet fare sepse ajo nënkuptohet. Prandaj fjalitë marrin këtë formë:

*Agimi e hëngri **supën<sub>i</sub>**. Ø<sub>i</sub> ishte e ngrohtë.*

Pema sintaksore e kësaj strukture do të dukej kështu:



Fjala e dytë e kësaj strukture është shënuar me SC, e cila në literaturë është e njohur si *small clause*. Kjo strukturë është një ndër strukturat të cilat përdoren për të paraqitur mbiemrat depiktiv në funksion të predikacionit dytësor, e cila ka përparësitë dhe të metat e veta, por këtu nuk po merrem me to, për shkak se kalojnë kufirin e ravijëzuar të kësaj kumtese.

## 2. Disertacioni

Tema e disertacionit të Oda Buchholz titullohet: *Zur Verdoppelung des Objekte im Albanischen* (Dyfishimi i kundrinës në shqipe apo rimarrja e kundrinës në shqipe), të mbrojtur më 1969 dhe të botuar më 1977<sup>7</sup>, në një version më të shkurtuar, nga Instituti Qendror i Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave të DDR-it, me po të njëjtin titull.

Siç dihet, rimarrja e kundrinës është një veçanti gramatikore e gjuhës shqipe dhe gjuhëve ballkanike, e gjithashtu edhe disa gjuhëve romane si p. sh. spanjishtja. Qëllimi i disertacionit është studimi më i thellë i konditave të rimarrjes së kundrinës në gjuhën shqipe, sepse siç pohon Buchholz (1977: 3) një studim apostafat për këtë çështje në gjuhën shqipe ende nuk është bërë. Për shkak të hapësirës së limituar në këtë kumtesë po kufizohem vetëm me rimarrjen e kundrinës së drejtë, e cila për dallim nga rimarrja e

<sup>7</sup> Buchholz, Oda (1977): *Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen-Beiträge zur Balkanlinguistik II*, Linguistische Studien, Reihe A Arbeitsberichte, Akademie der Wissenschaften der DDR, Zentralinstitut für Sprachwissenschaft, Berlin

kundrinës së zhdrejtë është më e ndërlikuar. Te kjo dukuri janë të përfshira praktikisht të gjitha rrafshet gjuhësore si dhe struktura informative e fjalisë apo rrethanat komunikativo-kontekstuale.

Sipas Buchholz, parakushti themelor sintaksor për rimarrjen apo rishfaqjen e kundrinës së drejtë në strukturën sipërfaqësore të fjalisë në gjuhën shqipe është prania e kundrinës së drejtë në strukturën e thellë të fjalisë. Buchholz përpilon rregullat për rimarrjen e kundrinës, disa prej të cilave duhet të aplikohen para e disa pas transformimeve (shiko faqen 119). Në këto rregulla ajo përfshinë edhe kushtet komunikativo-kontekstuale dhe konstaton se “rimarrja e kundrinës ndodh kur kundrina e drejtë gjendet në domenin e Themës” (f.440 të gramatikës), pra është një send i njohur apo është përmendur më herët në diskursin gjuhësor. Prandaj, edhe theksi i fjalisë bie mbi foljen. Rregullat e saja gjithashtu parashohin se kundrina nuk mund të rimerret nëse ajo është në domenin e Rhemës, pra është një send i panjohur apo ai futet për herë të parë në diskursin gjuhësor. Rregullat e saja janë koherente me konstatimet aktuale rreth kësaj problematike. Kështu, Kallulli, një gjuhëtare e spikatur shqiptare, e cila në qarqet shkencore ndërkombëtare njihet si ndër njohëset më të dalluara të kësaj problematike, konstaton se rimarrja e kundrinës nëpërmjet strukturës informative të fjalisë e signalizon dëgjuesin se veprimi bie mbi një send të njohur apo të përmendur më parë, i cili sipas modelit aktual gjenerativit quhet Topik, si ekuivalencë e Themës, kurse rimarrja e kundrinës nuk bëhet nëse kundrina është Fokus i fjalisë, pra si ekuivalencë e Rhemës. Prandaj, në shembujt e mëposhtëm, për shkak të kontekstit, rimarrja është e domosdoshme:

- |                          |                            |
|--------------------------|----------------------------|
| (1) Kush e lexoi librin? | <i>Ana e lexoi librin.</i> |
| Ç'bëri Ana me librin?    | <i>Ana e lexoi librin.</i> |

Kurse, te shembujt e shënuar me kursiv në (2) rimarrja është e pamundshme (gjithashtu) për shkak të kontestit:

- |                    |                          |
|--------------------|--------------------------|
| (2) Çka bënte Ana? | <i>Ana lexoi librin.</i> |
| Çka lexonte Ana?   | <i>Ana lexoi librin.</i> |

Që lë të përfundojmë se (mos)rimarrja e kundrinës nuk është thjesht një çështje fakultative. Mirëpo, Buchholz, siç pohon edhe vet në f. 189 të disertacionit, nuk arrin të sqarojë se pse shembujt si:

*Ai e mbante një dorë te dera.*

rimarrin kundrinën e drejtë, kurse sipas rregullave të përpiluara ato ishte dashur të dalin në pikëpamje gramatikore jo korrekte. Mirëpo, konkluzionin e fundit ajo nuk e merr parasysh sepse kjo do të binte ndesh me shqipfolësit të cilët rregullisht e përdorin gjatë komunikimit.

Mbetet e paqartë se pse ky rast dhe rasti i përemrit *çdo* klasifikohen si raste të pashpjegueshme, ndonëse ajo, ngjashëm si Riza 1979: 164)<sup>8</sup>, e njeh tiparin [+SPEC] të nyjës jo shquese *një*, kur sendi është i njohur për folësin, e jo për dëgjuesin.

Siç duket aparatura e modelit të atëhershëm gjenerativist ka kufizuar dukshëm mënyrën e trajtesës. Sot, kur modeli përfshin e dhe sintagmat funksionale, shpjegimi është jo vetëm elegant por edhe i logjikshëm. Kështu, sipas Kallullit<sup>9</sup>, format e shkurtuara të përemrave janë shndërruar në klitik, të cilët i bashkangjiten foljes. Por, ato janë elemente funksionale D, ngjashëm si nyjat, dëftori e vetori, të cilat ngërthejnë në veti tiparet D apo të determinativitetit, siç janë CAKTUAR dhe SPECIFIKUAR . Prandaj, emrat të cilat nuk e kanë së paku tiparin SPECIFIKUAR, nuk mund të projektojnë në pemën sintaksore sintagmën DP, rrjedhimisht për shkak të mungesës së kongruencës ndërmjet emrit dhe klitikut, struktura është e pa qëndrueshme prandaj edhe dështon shfaqja e saj. Një shpjegim tjetër alternativ lidhur me këtë çështje mund të dukej si vijon; forma e shkurtuar e përemrit dhe kundrina e drejtë janë në një relacion kataforik, që imponon kongruencë ndërmjet këtyre dy elementeve në *tipare semantike*  $\Phi$  (gjini, numër, vetë<sup>10</sup>) dhe rasë. Mirëpo, në rastet si (3c):

- (3) a) Nita e bleu fustan-**in**.  
 b) Nita e bleu një fustan-**Ø**.  
 c) Nita bleu fustan.

emri shënon një tipar (që shënon fustanin) e jo një send, andaj edhe *tiparet semantike*  $\Phi$  nuk janë të pranishme. Prandaj për shkak të inkongruencës rimarrja e kundrinës nuk është e mundshme.

<sup>8</sup> Riza flet për nyjën e pacaktuar absolute dhe relative. E fundit është e njohur për folësin. Shiko më gjërësisht: Riza, Selman (1979): *Studime Albanistike I*, Rilindja Prishtinë

<sup>9</sup> Docekal & Kallulli fn. 5, f. 115, shiko Docekal & Kallulli (2012): More on the semantics of clitic doubling: principal filters, minimal witnesses, and other bits of truth. In C. Piñón (eds.) *Empirical Issues in Syntax and Semantics 9* 113–128. COLLOQUE DE SYNTAXE ET SÉMANTIQUE À PARIS

<sup>10</sup> Sipas Benveniste veta e 1. dhe veta e 2. Shënojnë bashkëbiseduesit, kurse veta e 3. i referohet personit ose sendit jo të pranishëm. Rrjedhimisht, secili emër (si shënues i një personi a sendi) konsiderohet se është në vetën e 3. Për këtë arsye veta konsiderohet tipar i brendshëm i emrit, i cili reflektohet edhe te mbaresat e foljes gjegjësisht te kallëzuesi. Lidhur me përemrat vetor shiko Benveniste, Emil (1971): *Problems in general linguistics*, University of Miami Press, Miami



### 3. Të dhëna biografike

Oda Buchholz u lind Dessau më 21 Janar 1940. Diplomoi në Univesitetin Humbolt të Berlinit albanologjinë dhe letërsinë bullgare. U nda nga jeta më 2 Janar 1914. U morr kryesisht me morfo-sintaksë të gjuhës shqipe dhe gjuhëve ballkanike në përgjithësi si dhe me leksikologji. Punimet e tjera në morfo-sintaksë, përveç disertacionit, si autore, janë:

**Buchholz**, Oda: Zur Frage der Verdoppelung der Objekte im Albanischen. Actes du Premier Congres International des Etudes. Balkaniques et Sud-Est Europeennes. VI. Sofia 1968, 711-724.

**Buchholz**, Oda: Zu Verben, die durch ein Objekt und ein Objektsprädikativ ergänzt werden. Balkansko Ezikoznanie XX 1977/1-2, Sofija 1977, 147-159.

**Buchholz**, Oda: Mbi gershetimin e aspekteve morfologjike e sintaksore te rasat ne gjuhen shqipe.- Gjurmime Albanologjike VII (1977), P. 1978, 145-158.

**Buchholz**, Oda: On the Post-Positive Article in Albanian - Its Role in the Expression of Determinacy. Folia Slavica Volume 4/2-3 (Festschrift Eric P. Hamp), Columbus (Ohio) 1981, 227-234.

**Buchholz**, Oda: Mbi kategorine gramatikore te shquarsise/ pashquarsise dhe mbi kategorine semantiko-funksionale te determinativitetit/ indeterminativitetit. - Seminari i Kultures Shqiptare per te Huaj 7 (1982), 85-93.

**Buchholz**, Oda: Rreth fjalive ekzistenciale me foljen *habere* ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te tjera te Ballkanit.- Seminari i Kultures Shqiptare per te Huaj 7 (1982), 161-171.

**Buchholz**, Oda: Modele fjalish te shqipes dhe te gjermanishtes.- Seminari i Kultures Shqiptare per te Huaj 8 (1983), 91-100.

**Buchholz**, Oda: Kallezuesori ne gjuhen shqipe (ne krahasim me gjermanishten). - Seminari i Kultures Shqiptare per te Huaj 9 (1984), 53-60.

Si ko-autore:

**Buchholz**, Oda und W. Fiedler: Zur Stellung der Objektzeichen in der albanischen Literatursprache der Gegenwart und bei Gjon Buzuku.- Akten des IAK, Innsbruck 1977, 433-458.

**Buchholz**, Oda und W. Fiedler: Probleme des Vergleichs von Satzmodellen des Albanischen und Deutschen. - Zeitschrift für Phonetik, Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung Band 35/H. 4, Berlin 1982, 383-391.

**Buchholz**, Oda und A. Beyrer, W. Fiedler, K. Kostov: Zur Rektion der Verben in den Balkansprachen.- Linguistische Studien/ZISW/A, H. 43, Berlin 1977, 1-115

Ajo u morr edhe me hulumtime tipologjike, kështu kohën e fundit së bashku me Martin Haspelmath botoi edhe:

Martin Haspelmath / Oda **Buchholz** (1998): "Equative and similitive constructions in the languages of Europe." In: van der Auwera, Johan (ed.) *Adverbial constructions in the languages of Europe*. (Empirical Approaches to Language Typology/EUROTYP, 20- 3.) Berlin: Mouton de Gruyter, 277-334

Kurse, në lëmin e leksikologjisë ajo së bashku me Wilfried Fiedler dhe Gerda Uhlisch përpiluan fjalorin shqip-gjermanisht:

**Buchholz**, O. und W. Fiedler, G. Uhlisch (1998): Wörterbuch Albanisch-Deutsch. Leipzig 1977. Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, **i cili përmban edhe një gramatikë të shkurtër të gjuhës shqipe.**

Oda Buchholz u morr gjithashtu edhe me përkthime. Së bashku me kolegun e saj Wilfried Fiedler ajo kontribuoi në shkëmbimin kulturor shqiptaro-gjerman. Në vitin 1976 u botua në serinë “*Erkundungen*” vëllimi “*8 Albanische Erzähler*” (“8 Tregimtarë shqiptarë”) me tregime nga: Fatmir Gjata, Sotir Andoni, Dritëro Agolli, Shefqet Musaraj, Jakov Xoxa, Dhimitër Shuteriqi, Naum Prifti, Ismail Kadare. Më 1977, Buchholz dhe Fiedler përkthyen në gjermanisht “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur” të Ismail Kadaresë. Përmbledhjen me tregime dhe novela të Kadaresë “*Die Schleierkaravane. Erzählungen.*” (1988), “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” të Dritëro Agollit (1993) me titull në gjermanisht: “*Zylo oder die abenteuerliche Reise durch die wundersame Welt von Bürokratien*”. etj.

**Linditë SEJDIU - RUGOVA**

**BRIAN JOSEPH-I PËR INFINITIVIN E SHQIPES**

### **Sfondi**

Hulumtimi i proceseve gjuhësore dhe i tipareve të gjuhëve të Ballkanit kanë qenë dhe mbeten preokupim i shumë linguistëve, midis tyre edhe i profesorit të mirënjohur të sllavistikës së jugut dhe të greqishtes, si dhe i gjuhëve të Ballkanit në përgjithësi, historianit të gjuhës dhe adhuruesit të sanskritishtes (siç e konsideron ai veten), profesorit Brian D. Joseph.

Në librin e tij të botuar nga Cambridge University Press “The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive”, të vitit 1983 dhe të ribotuar edhe në mënyrë digjitale si vëllim shtesë në vitin 2009, e që në të vërtetë i përmban edhe disa teza nga disertacioni i tij i doktoratës i mbrojtur në vitin 1978, Brian Joseph-i i kushton një kapitull të tërë infinitivit të shqipes dhe zëvendësimit të tij me trajtat e shtjelluara. Për më tepër, Joseph-i në librin e tij përpiqet që ta definojë konceptin e infinitivit si ballkanizëm, duke dhënë më pas argumentet e tij lidhur me historitë e zhvillimit dhe të humbjes së infinitivit në secilën nga gjuhët e Ballkanit në kapituj të veçantë. Si gramatikan që është, Joseph-i merret edhe me shtjellimin e disa prej kriterëve themelore që e vendosin dallimin ndërmjet trajtave të shtjelluara dhe të atyre të pashtjelluara dhe më pas ndalet te fenomeni i humbjes së infinitivit në greqishten, në shqipen (dialekti jugor), në maqedonishten, në bullgarishten, në serbo-kroatishten dhe në rumanishten.

### **Koncepti i Joseph-it për infinitivin ballkanik**

Joseph-i mendon se është e kotë të flitet për humbje të infinitivit në gjuhët e Ballkanit pa e shtjelluar esencën e këtij fenomeni gjuhësor në secilën nga këto gjuhë veç e veç. (Joseph, 1983:6). Brian Joseph-i përpiqet të japë një zgjidhje duke e theksuar rëndësinë e kombinimit universal të tipareve gramatikore të shtjellueshmërisë në disa gjuhë bashkë me caktimin e tipareve dalluese të kësaj shtjellueshmërie, siç janë: shënjimi vector, shënjimi kohor apo në numër, në çdo gjuhë veç e veç. Pra, gramatika universale,

sipas tij, do të mund ta bënte dallimin e tillë në sistemin foljor, por gjuhët nuk është e thënë ta kenë këtë dallim brenda tyre. (Joseph, 1983:30)

Argumentimet paraprake për shpjegimin e humbjes së infinitivit që mbështeten në teoritë e kontakteve gjuhësore dhe të zhvillimeve të veçanta brendagjuhësore ai i quan tradicionale dhe, përpos tyre, ai përpiket që nëpërmjet ndryshimeve sintaksore apo pasojave gjuhësore që sjell humbja e infinitivit në një gjuhë ta shpjegojë këtë dukuri. Në këtë rrafsh, duke u mbështetur në rregullën *Object Raising Sentences* (shfaqja e kundrinës) dhe *Object Deletion Sentences* (heqja e kundrinës), pra fjalive ku kryefjala e fjalisë kryesore paraqitet ose jo semantikisht si kundrinë e fjalisë së varur e shprehur me një infinitiv, Joseph-i e mbështet tendencën apo kufizimin, siç e quan ai, të mospërdorimit të trajtave të shtjelluara në shqipen në përgjithësi. Këtë universalie gjuhësore, Joseph-i e konsideron konvergencë midis shqipes, greqishtes dhe rumanishtes në veçanti.

Ai merret më pas edhe me definimin e konceptit të infinitivit në gjuhët e ndryshme, duke e marrë parasysh shënjimin gramatikor të infinitivit si tregues të (pa)shtjellueshmërisë së tij dhe duke e marrë për bazë përshtatjen e infinitivit si kompliment (plotës) i një foljeje (sidomos i atyre modale të volicionit), plotës i një mbiemri apo tregues i qëllimit. Ai thekson se infinitivi paraqitet në një gjuhë atëherë kur synohet dhe arrihet nevoja për t'i akumuluar përgjithësimet që u referohen disa trajtave foljore të shtjelluara. Kur kjo kategori bëhet prodhimtare dhe kur përdorimi i saj gjuhësor është pozitiv, atëherë prania e kësaj trajte në një gjuhë të caktuar është më se e evidente (Joseph, 1983:33).

### **Koncepti i Joseph-it për infinitivin e shqipes**

Ai shpjegon se rruga e krijimit të trajtës *për të bërë* në shqipen është shumë analoge me atë në greqishten, por, gjithnjë sipas tij, në shqipen nuk pati ndryshime drastike të sistemit foljor kur u fut trajta e shtjelluar sepse shqipja tanimë i kishte të theksuar klitikët.

Joseph-i konsideron se shqipja e sotme i përmban disa trajta foljore që korrespondojnë me trajtat e shtjelluara të greqishtes si dhe me konstruktionet foljore infinitivale të gjuhëve të tjera evropiane.

Trajtat e tilla mund të jenë: (gjithnjë sipas Joseph-it)

1. Plotës të një foljeje volitive (dua të shkruaj)
2. Plotës të një foljeje që shpreh aspekt foljor (vazhdoj të shkruaj)
3. Plotës të një foljeje modale (mund të shkruaj)
4. Plotës të një mbiemri (është e vështirë që ta bëjmë këtë)
5. Plotës të një emri (propozimi yt të shkoj atje)
6. Tregues të qëllimit (vijmë në shkollë që të mësojmë) dhe
7. Fjalitë pyetëse të zhdrejta (të lira) (ai nuk dinte ku të vinte).

Sipas Joseph-it, këto ekuivalenca kuptimore midis shqipes dhe gjuhëve të tjera të Ballkanit sa u përket trajtave që e kanë zëvendësuar infinitivin dëshmojnë se edhe shqipja hyn në të njëjtën vijë me greqishten, bullgarishten, maqedonishten dhe rumanishten sa i përket humbjes së infinitivit. Por, ai sugjeron se të gjitha këto trajta që paraqiten si trajta ekuivalente me një infinitiv të dikurshëm në shqipen nuk e pasqyrojnë saktësisht gjuhën shqipe në plotninë e saj për dy arsye:

a) e para, se këto trajta përdoren kryesisht në dialektin jugor që më vonë u bë bazë e standardit gjuhësor të shqipes dhe

b) e dyta, se edhe brenda vetë dialektit jugor të shqipes këto të dhëna nuk e japin një pasqyrë të plotë sa i përket distribuimit dhe përdorimit të plotësve infinitivalë dhe të atyre të shtjelluar.

Pse ndodh kjo? Për shkak të ekzistimit të trajtave foljore që kombinohen me lidhore e që në dialektin jugor janë shumë të shprehura, si dhe të ekzistimit të trajtës infinitivale apo korrespondencës jugore të infinitivit Gegë *me punue* (siç e quan Josephi trajtën *për të bërë*) e që sipas tij nuk përkon plotësisht me trajtën e lidhore për nga kuptimet që shpreh (nuk del në funksion të plotësit të fjalive të varura pyetëse: (*Ai nuk dinte ku të vinte*). Për më tepër, shumë gramatika të shqipes trajtën *për të punuar* e paraqesin ekskluzivisht si infinitiv të qëllimit!

Pra, Joseph-i flet për ekzistencën e trajtave infinitivale që në dialektin jugor përzihen funksionalisht gjatë përdorimit me trajtat e shtjelluara foljore të kombinuara me lidhoren. Ai më tutje potencon se dialekti jugor e ka infinitivin por në një formë të rishikuar kuptimisht, pra kemi një “qetësim” të përdorimeve të tij. Gegërishtja, ndërkaq, nuk ka treguar gjurmë të tilla. Në këtë aspekt, pohimi i Sandfeldit se në toskërishten procesi i humbjes së infinitivit nuk ka përfunduar dhe se është proces i kthyeshëm, sipas tij, qëndron. (Joseph, 1983:91).

Joseph-i e kundërshton teorinë e mëparshme të natyrës së humbjes së infinitivit si tipar që shtrihet nga jugu në veri. Joseph-i mendon se këtu kemi të bëjmë me një dukuri qendrore ballkanike, me përqëndrim në gjuhët më qendrore si maqedonishtja, greqishtja, bullgarishtja dhe torllakishtja. Greqishtja futet në këtë mes meqë Joseph-i konsideron se në greqishten e mesjetës pati një ringjallje të përkohshme të infinitivit.

Joseph-i argumenton edhe për vjetërsinë e trajtave *me punue* dhe *për të punuar* dhe sjell mjaft argumente pro vjetërsisë së trajtës dialektore infinitivale veriore. Sipas tij, ekzistimi i trajtës inovative *më vjen me thënë* në dialektin e Falkonarës në Itali te Camaj dëshmon për një gjë të tillë. Ai këtu e paraqet edhe opozicionin Gabinski-Demiraj lidhur me një ringjallje të mundshme të infinitivit në shqipen (trajta foljore e substantivizuar *së bëri*).

Mendojmë se një shpjegim mjaft shtjerrues për daljen e përdorimit të infinitivit *me+forma e pjesores* në toskërishte e paraqet mjaft qartë Bokshi në veprën e tij

“Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes” (Bokshi, 2010: 166-168), duke e lidhur këtë humbje me ndikimin e greqishtes si dhe të humbjes së funksioneve të infinitivit *me+forma e pjesores* për shkak të zëvendësimit të saj nga fjalia lidhore me të gjitha funksionet e saj. Ekzistimin e trajtës *për të thanë/thënë* Bokshi e shpjegon me pamundësinë e zëvendësimit të funksionit të kësaj sintagme parafjalore me funksionet e një sintagme emërore (pra, pamundësia e përdorimit të saj si kryefjalë a kundrinë).

Në këtë rrjedhë studimesh, duhet theksuar se çështja e infinitivit të shqipes është diskutuar mjaft edhe nga studiuesi Nuhi Veselaj në studimin e tij monografik për paskajoren gege dhe problemet që i nxorri në pah, sipas tij, mënjanimi i saj nga norma letrare dhe lënia në hije (Veselaj, 2000: 153). Por, ndryshe nga Joseph-i, Veselaj merret më shumë me çështjen e përdorimit aktual të paskajores dhe mospërfaqësimit të saj në gjuhën standarde.

Kelmendi (1982: 57) e trajton paskajoren gege si paskajore parësore, Demiraj (1988: 284, 1004) e quan të mirëfilltë dhe Bokshi (1998: 165) i referohet paskajores së trajtës *për të punuar* si paskajore me funksione shumë të kufizuara sintaksore. Pra, me përjashtim të disa gjuhëtarëve, si Bokshi, Demiraj e Topalli, Joseph-i është nga të paktit që merret me këtë problem kaq të ndërlikuar të shqipes nga aspekti historik – diakronik.

## Përfundim

Krejt në fund, mund të përfundojmë se Josephi konsideron se humbja e infinitivit në gjuhët ballkanike përgjithësisht nuk është aq uniforme për nga natyra e saj dhe se shkalla e humbjes së tij në gjuhët ballkanike është e ndryshme. Derisa në maqedonishte apo greqishte dukuria e humbjes së infinitivit del si humbje e kategorisë dhe e trajtave infinitivale, në shqipen nënkupton vetëm humbjen e trajtave të vjetra infinitivale, por jo edhe të konceptit.

Joseph-i tërë zhvillimin e infinitivit të shqipes dhe të humbjes së pjesësme të tij në shqipen e paraqet si një devijim nga “rregulli” i përbashkët i gjuhëve të tjera ballkanike, pra përbën një divergjencë në *Shprachbundin* ballkanik meqë infinitivi në toskërishten tregon shenja të zëvendësimit me lidhoren por edhe shenja të forcimit të vetë kategorisë infinitivale. Joseph-i, ngjashëm me Fridmanin, sugjeron se nuk është i rëndësishëm vetëm demonstrimi i fenomeneve areale të përbashkëta apo i paraleleve gjuhësore, por edhe krahasimi i divergjencave. Sipas tij, humbja e infinitivit dhe zëvendësimi i tij me trajtat e shtjelluara foljore paraqesin një konvergencë sipërfaqësore, por nuk duhet mjaftuar me kaq. Thelbi i humbjes së infinitivit, gjithnjë sipas tij, duhet shikuar në një aspekt më gjithpërfshirës dhe më të thellë historikisht!

### **Bibliografia**

1. JOSEPH, D. Brian: The synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive (A study in areal, general and historical linguistics), Cambridge Studies in Linguistics, New York, 1983
2. BOKSHI, Besim: Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, ASHAK, Botime të veçanta CX, Libri 45, Prishtinë, 2010
3. VESELAJ, Nuhi: Paskajorja – çështje e shqipes standarde, Dardania Sacra, Prishtinë, 2000
4. BOKSHI, Besim: Pjesorja e shqipes-vështrim diakronik, ASHAK, Prishtinë, 1998
5. DEMIRAJ, Shaban: Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1988
6. KELMENDI, Tafil: Paskajorja, përdorimet e saj dhe ndërtimet me paskajore në gjuhën popullore shqipe, SNGJLKSH VII, Prishtinë, 1982
7. TOPALLI, Kolec: Gramatikë historike e shqipes, QSA, Tiranë, 2012





Ludmila BUXHELI

## GIUSEPPINA TURANO PËR PROCESËT MORFOLOGJIKE NË SHQIPEN E SOTME

Giuseppina Turano është një nga studiueset e reja italo-arbëreshe me kontribute të vyera në fushën e studimeve sintaksore për shqipen. Ajo i përket brezit të ri të studiuesve që studimet në fushën e sintaksës së shqipes i trajton në këndvështrim gjenerativist. Nëpërmjet studimeve të saj jo vetëm bëhen përpjekje për një përshkrim më të thelluar të strukturës sintaksore të kësaj gjuhe, por njëkohësisht tregohet se gjuha shqipe sjell lëndë të pasur sintaksore që hedh dritë në vërtetësinë e tezave gjenerativiste ose përsosjen e mëtejshme të tyre. Në mënyrë të veçantë ndihmesa e Turanos në fushë të sintaksës së shqipes është pasqyruar në veprën “Le dipendenze sintattiche in albanese” (1995)<sup>1</sup>, në tekstin universitar “Hyrje në sintaksën gjenerative të gjuhës shqipe” SHBLU, Tiranë, (2011), me bashkautore gjuhëtaren Flora Koleci, si dhe në një sërë artikujsh për probleme të sintaksës së shqipes sipas traditës gramatikore gjenerativiste.

Ndonëse sintaksa është fusha e saj e preferuar, Turano nuk ka lënë pa trajtuar në këndvështrim gjenerativist edhe probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe duke treguar përsëri se shqipja është një burim shumë i mirë për konfirmimin dhe pasurimin e mëtejshëm të mendimit gjuhësor në fushën e morfologjisë. Nga kjo pikëpamje, është me interes artikulli “PREJARDHJA, KOMPOZIMI DHE FLEKSIONI: TRE PROCESË MJAFT PRODHIMTARË NË GJUHËN SHQIPE”<sup>2</sup>, i cili ka shërbyer si nxitje për këtë kumtesë. Artikulli është një përshkrim i shkurtër me karakter krahasues i proceseve morfologjike të shqipes në përfaqje me ato të italishtes. Si bazë teorike ka shërbyer teoria që njihet si “Hipoteza leksikaliste e dobët”<sup>3</sup>, e zbatuar nga Sergio Scalise në studimet e

---

1. G. Torano, *Le dipendenze sintattiche in albanese*, Unipress, Padova (1995).

2. G. Turano, PREJARDHJA, KOMPOZIMI DHE FLEKSIONI: TRE PROCESË MJAFT PRODHIMTARË NË GJUHËN SHQIPE SF 1-2, 2012.

3. A. Spencer, *Morphological Theory*, Blackwell Publishers, UK 1991, f.178-179, 230.

tij morfologjike.<sup>4</sup> Kjo teori është një thellim i mëtejshëm i Teorisë standarde të zgjeruar (Chomsky, 1965)<sup>5</sup>, i cili përcakton si objekt të morfologjisë të ashtuquajturin përbërës leksikor ose fjalën si fushën në të cilën vepronë rregullat morfologjike të fjalëformimit dhe të eptimit. Gjithashtu, sipas kësaj teorie proceset morfologjike kanë edhe aspektin e tyre sintaksor.<sup>6</sup>

Autorja vëren se në morfologjinë e shqipes së sotme, ashtu si dhe në italishte, dallohen tri procese kryesore morfologjike që vepronë në strukturën e fjalëve: prejardhja, kompozimi dhe fleksioni. Sipas Turanos, *prejardhja* me llojet e saj dhe *kompozimi* i dy kategorive leksikore janë mekanizmat më të shpeshtë të fjalëformimit që vepronë mbi fjalën bazë, ashtu dhe atë të prejardhur, duke respektuar një sërë kufizimesh (të ashtuquajturat ‘rregulla të fjalëformimit’) të cilat iu nënshtrohen (edhe pse në mënyrë të kufizuar) rregullave morfo-fonologjike të përshtatjes (rënie ose shtim zanoresh) nëpërmjet të cilave ‘lëmohe’ forma sipërfaqësore e fjalëve të reja. Këto rregulla shfaqin kështu disa kufizime morfologjike, fonologjike, dhe/ose sintaksore dhe jo gjithmonë veprimi i tyre ka ngjashmëri ndërjet shqipes dhe italishtes. Kështu, Turano vëren se ndryshimi kryesor midis dy proceseve të prejardhjes, parashtesimit dhe prapashtesimit, në shqipe është masa e aftësisë së tyre për të ndryshuar bazën e fjalës. Në shqipe procesi i shtimit të një prapashtese shoqërohet me tri lloje ndryshimesh: a) ndryshimi i kategorisë leksikore *punë-punoj*, b) mosndryshim i kategorisë leksikore, por ndryshim i tipareve sintaksore të lidhura me të për shkak të ndryshimit të kuptimit *arkë(-frymor)-arkëtar(+frymor)*, c) zhvendosje e theksit: *oriz* → *orizóre*.

Kurse rregullat e parashtesimit shoqërohen me më pak dryshime, ato nuk e ndryshojnë kurrë kategorinë leksikore të bazës mbi të cilën vepronë dhe nuk aktivizojnë asnjë rregull përshtatjeje.

Sipas autores, rrjedha që ndjek kompozimi në gjuhën shqipe përgjithësisht është në përputhje me ligjet sintaksore të kësaj gjuhe. Shqipja ndryshe nga italishtja, nuk pranon që mbiemri të zërë vendin e parë gjatë fjalëformimit. Tek fjalët e përbëra, mbiemri vendoset gjithmonë në të djathtë të emrit duke shfaqur një strukturë leksikore të njëjtë me atë sintaksore.

Po ashtu, në gjuhën shqipe, ndryshe nga italishtja, prapashtesimi shpeshherë i shmanget rregullës së bazës unike, që do të thotë se ndryshe nga italishtja, në shqipe jo gjithmonë një prapashtesë mund të bashkohet vetëm me një pjesë të caktuar të ligjëratës (*popull-si, i aftë-si*). Po ashtu, autorja sjell mjaft raste kur në shqipe rregullat fonologjike të

<sup>4</sup> S. Scalise, *Morfologia lessicale*, Padova: Clesp Editrice, 1983; *Morfologia e lessico*, Bologna: Il Mulino, 1990;

*Morfologia*, Bologna: Il Mulino, 1994.

<sup>5</sup> N. Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*, Cambridge, MA: MIT Press, 1965.

<sup>6</sup> A. Spencer, po aty, f.200.

përshtatjes nuk veprojnë njësoj si në italisht. Ndërsa këto rregulla ndeshen në të dy gjuhët në formimet prapashtesore, gjatë parashtesimit ose kompozimit në shqipe sipas autores, nuk ndërhyjnë asnjë rregull fonologjik, pra, nuk mund të flitet as për rënie zanoresh dhe as për dyfishim të tyre. Edhe mundësitë e kombinimit të fjalëve gjatë procesit të kompozimit nuk janë të njëjta. Në shqipe mundësitë e kompozimit të fjalëve të shqipes, sipas autores, janë më të shumta se në italishte. Raporti është 15 me 10.

Po aq prodhimtare, sipas autores, janë edhe rregullat e fleksionit, zbatimi i të cilave përcaktohet nga konteksti morfologjik dhe/ose sintaksor. Gjithë morfologjia themelore e shqipes ndikohet nga rregullat e fleksionit, të cilat ndonëse janë procese morfologjike, dallohen nga proceset morfologjike të fjalëformimit, sepse, ndryshe nga rregullat e prejardhjes dhe të përbërjes, nuk formojnë fjalë të reja, por forma të ndryshme të së njëjtës fjalë. Fleksioni përshkruhet si një proces morfo-sintaksor që ndodh pasi të kenë vepruar rregullat e prejardhjes dhe të kompozimit. Rregullat e eptimit janë rregulla që vijnë pas çdo procesi fjalëformues.

Ndonëse problemet që trajtohen në këtë artikull nuk janë krejtësisht të panjohura për studiuesit e shqipes, artikulli është me interes së pari për bazën teorike dhe metodologjinë ku është mbështetur autorja, sepse të dy këto aspekte shërbejnë për një orjentim më të qartë në studimet morfologjike, duke dalluar nga njëra anë proceset morfologjike të shqipes që veprojnë te fjala, dhe nga ana tjetër rregullat e fjalëformimit, të përshtatjes dhe të eptimit. Por artikulli është me interes edhe për këndvështrimin e objektit të morfologjisë dhe vendit të fjalëformimit në gramatikë, çështje të diskutueshme si nga studiuesit e huaj, por edhe ata shqiptarë.

Nga analiza dhe përshkrimi i proceseve morfologjike të fjalëve në shqipe duket qartë që autorja renditet krahas gjuhëtarëve që e trajtojnë morfologjinë si disiplinë shkencore me objekt fjalën, si dhe rregullat fjalëformuese, të përshtatjes dhe ato formëformuese që veprojnë në strukturën e saj. Një përshkrim të ngjashëm të objektit të morfologjisë e ka bërë shumë më herët edhe S. Riza në dorëshkrimin me titull “Disa teza mbi teorinë dhe praktikën e analizës morfologjike përshkruese shqip” (4gusht, 1964), ruajtur në arkivin e familjes dhe botuar në veprën “*SELMAN RIZA, VEPRAT IV*”, PRISHTINË 2004, f. 43-44, në të cilin ai dallon dy procese kryesore morfologjike: *fjalëndërtimin* ku përfshin proceset e prejardhjes dhe kompozimit, dhe *formëndërtimin*.<sup>7</sup>

Nisur nga këta dy studiues, por edhe nga një artikull për trajtimin e fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare të studiueses Sh. Islamaj<sup>8</sup>, vërehet se për vendin e fjalëformimit si disiplinë shkencore në botimet tona gjuhësore nuk ka një mendim unik. Mendimet

<sup>7</sup> S. Riza, Disa teza mbi teorinë dhe praktikën e analizës morfologjike përshkruese shqip, në “*SELMAN RIZA, VEPRAT IV*”, PRISHTINË 2004, f. 43-44.

<sup>8</sup> Sh. Islamaj, Trajtimi i fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare, *Gjuba shqipe*, 2, 2004.

mbizotëruese janë dy: a) fjalëformimi i përket morfologjisë si një nëndarje e saj; b) fjalëformimi është një disiplinë më vete, jashtë morfologjisë dhe leksikologjisë.

Kjo çështje meriton studime më të thelluara, megjithatë mendojmë që vendi i fjalëformimit dhe i eptimit është në morfologji, sepse fjalëformimi, ashtu si dhe eptimi, është proces morfologjik që vepron në strukturën morfematike të fjalës. Morfologjia, në fund të fundit, ka të bëjë me përshkrimin e rregullave që shpjegojnë strukturën e brendshme të fjalëve, lidhjet strukturore të fjalëve ose formave të fjalëve me njëra-tjetrën, përshkrime të cilat i bën morfologu. Për morfologun, proceset ose rregullat që veprojnë mbi fjalën, si njësi themelore e gjuhës, nuk janë të njëjta, por në fund të fundit kemi të bëjmë me procese morfologjike që ndikojnë në strukturën e fjalës, rezultat i të cilave mund të jetë ose një fjalë e re ose një formë tjetër e së njëjtës fjalë. Dallimi është se rregullat e fjalëformimit, si rregulla morfologjike, veprojnë para lidhjes së fjalëve në sintagma, kurse rregullat e eptimit veprojnë pas lidhjes së fjalëve në sintagma.

Argument kryesor që sillet për trajtimin e fjalëformimit si disiplinë më vete, jashtë morfologjisë e leksikologjisë, është përcaktimi i tij si një proces kompleks, që lidhet me semantikën<sup>9</sup>. Madje mendohet se objekti i fjalëformimit, si teori e veçantë, duhet zgjeruar më tej, duke përfshirë në të derivacionin semantik.<sup>10</sup> Në të vërtetë shpeshherë morfologu u referohet veçorive semantike në përshkrimin e proceseve fjalëformuese, por kjo nuk është arsye për ta trajtuar fjalëformimin si disiplinë më vete jashtë morfologjisë, sepse synimi i morfologut është përcaktimi i kuptimit tipësor fjalëformues<sup>11</sup>, si pjesë përbërëse e tipit fjalëformues, dhe jo derivacioni semantik dmth. përshkrimi i kuptimit leksikor ose i strukturës kuptimore të fjalëve, i lëvizjeve të saj etj. Një model shumë i mirë, se ku duhet të përqendrohet leksikologu në përshkrimin e proceseve semantike sot është vepra e J. Thomajt, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe* (1989) kushtuar strukturës kuptimore të fjalëve, kuptimit leksikor dhe përbërjes së tij, lëvizjeve semantike në leksik, prejardhjes së kuptimeve, ndryshimet që ndodhin në semantikën e fjalëve dhe zhvillimeve semantike që pësojnë fjalët. Kjo vepër dëshmon ndër të tjera se semanticieni, kur është e nevojshme, mbështetet në modelet e fjalëformimit për të shpjeguar llojet e ndryshme semantike ose lëvizjet semantike gjatë fjalëformimit.<sup>12</sup> Me gjithë lidhjet e fjalëformimit me semantikën, nga pikëpamja metodike rregullat e derivacionit semantik dhe rregullat e fjalëformimit janë dy procese krejtësisht të ndryshme, që ndonëse veprojnë te fjala, shfaqen si veprime në dy anë të

<sup>9</sup> Sh. Islamaj, Trajtimi i fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare, *Cjuba shqipe*, 2, 2004.

<sup>10</sup> J. Thomaj, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, fq. 242-270.

<sup>11</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, f. 58.

<sup>12</sup> J. Thomaj, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, fq. 242-270.

ndryshme të së njëjtës medalje, dhe për pasojë secili është objekt studimi i një fushe të veçantë.

Argument tjetër kryesor që silltet për trajtimin e fjalëformimit si disiplinë më vete, jashtë morfologjisë e leksikologjisë, është përcaktimi i tij si një proces kompleks, që lidhet edhe me neologjinë<sup>13</sup>. Përsëri mendojmë se pikat e takimit midis fjalëformimit dhe neologjisë nuk janë argument për trajtimin e fjalëformimit si disiplinë e veçantë, jashtë morfologjisë. Është e vërtetë që morfologu, gjatë studimit të proceseve fjalëformuese mund të analizojë edhe fjalë të reja ose neologjizma, por ky argument nuk mjafton për të pranuar fjalëformimin si disiplinë më vete, jashtë morfologjisë. Për studimet në fushën e fjalëformimit, nuk ka rëndësi nëse fjala është neologjizëm ose jo. Studiuesi i fjalëformimit bën objekt studimi çdo fjalë, për pasojë edhe neologjizmat, në planin strukturor-fjalëformues. Neologjia, si disiplinë që merret me neologjizmat, ka si objekt studimi vetëm fjalët, qofshin këto të parme ose jo të parme, por edhe shprehjet ose kuptimet që ndihen ende të reja në gjuhë. Në këto raste neologu mund të përshkruajë neologjizmat edhe në planin fjalëformues, nëse është e nevojshme, por kjo s'do të thotë se neologjia është qëllim në vetvete i fjalëformimit.

Nga ana tjetër, është e vërtetë që trajtimi i fjalëformimit si në gramatikën akademike edhe në botimin *Leksikologjia e gjuhës shqipe* të akademikut Jani Thomaj, të krijon përshtypjen se fjalëformimi është një fushë e ndërmjetme, me një këmbë në morfologji dhe tjetrën në leksikologji. Nëse do të pranohej që fjalëformimi është një fushë e ndërmjetme, do të duhej të bëhej i njëjti pohim edhe për leksikologjinë. E përmendëm edhe më sipër që, për shpjegimin e dukurive të ndryshme morfologjike, morfologu u referohet shpeshherë jo vetëm dukurive fonetike e sintaksore, por edhe atyre semantike.<sup>14</sup> Po ashtu, për leksikologun që ka p.sh. si objekt studimi procesin semantik të antonimisë së fjalëve në gjuhën shqipe, roli i parashtesimit në gjuhën shqipe nuk është objekt studimi. Megjithatë ai i referohet këtij procesi morfologjik për të treguar një nga rrugët e realizimit të kuptimit antonimik të fjalëve të shqipes.<sup>15</sup>

Si përfundim, fjalëformimi është një fushë e veçantë studimi me karakter kompleks, sepse lidhet me disa disiplina, megjithatë, pavarësisht bashkëveprimit me to, mendojmë se mbetet pjesë e morfologjisë, sepse ka të bëjë me strukturën e brendshme të fjalëve dhe llojin e lidhjeve ndërmjet tyre. Studimi i fjalëve si pjesë ligjërata, por edhe i proceseve morfologjike që ndikojnë në strukturën e fjalëve, në mirëformimin e tyre nga pikëpamja eptimore dhe fjalëformuese, përbën thelbin e morfologjisë. Po ashtu,

<sup>13</sup> Sh. Islamaj, Trajtimi i fjalëformimit në gjuhësinë shqipt are, *Cjuba shqipe*, 2, 2004.

<sup>14</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995, f.1.

<sup>15</sup> M. Samara, *Vëzhgime mbi antonimet me parashtesa në gjuhën shqipe*, në "Studime filologjike" I, Tiranë, 1965.

nisur nga prania e tre proceseve kryesore morfologjike në gjuhën shqipe, mendojmë se është i nevjoshëm një konceptim i ri i morfologjisë, si pjesë e gramatikës, duke e parë si një të tërë, të përbërë nga dy pjesë: 1) morfologjia fjalëformuese dhe 2) morfologjia eptimore dhe klasifikuese.

Anila ÇEPANI, Adelina ÇERPJA

**VËSHTRIME TË REJA PËR GRAMATIKËN E SHQIPES NË  
VEPRËN<sup>1</sup> E AUTORËVE NEWMARK, HUBBARD DHE PRIFTI**

Gramatika *Standard Albanian. A reference Grammar for Students*, siç theksohet që në parathënien e saj, është menduar si një tekst për studentët anglishtfolës të cilët po mësonin shqipen gjatë viteve '80, kur dhe u hartua kjo gramatikë. Pavarësisht se autorët tregohen modestë kur shprehen se ky tekst nuk është një studim shkencor apo një gramatikë e gjuhëtarëve, kapitujt e strukturuar me shumë kujdes sipas kategorive leksiko-gramatikore, informacionet e hollësishme që kanë dhënë për secilën prej tyre, si dhe shembujt e shumtë ilustrues dëshmojnë për një gramatikë të përparuar për ata që dëshironin të thelloheshin në studimin e gjuhës shqipe.

Sipas Peter R. Priftit kjo gramatikë ishte rezultat i një projekti trevjeçar studimesh për gjuhën shqipe dhe së bashku me dy vepra të tjera<sup>2</sup> bënë që Universiteti i Kalifornisë në San-Diego të njihet si një qendër mjaft e rëndësishme e lëvritit të gjuhës shqipe në Amerikë.<sup>3</sup>

Autorët vënë në dukje se për këtë gramatikë janë mbështetur kryesisht në tri vepra normative të shqipes të hartuara nga gjuhëtarë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të RP të Shqipërisë: *Morfologjia*<sup>4</sup>, si vëllim i dytë i veprës madhore *Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së Sotme Letrare Shqipe* Tiranë, 1976; *Drejtskrimi i Gjuhës Shqipe* 1974 (autorët kanë shfrytëzuar botimin e Institutit Albanologjik të Prishtinës) dhe *Fjalori Drejtskrimor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1976. Që në hyrje të parathënies autorët shprehen se

---

<sup>1</sup> Béhet fjalë për *Standard Albanian - A reference grammar for students*, Stanford University Press Stanford, California, 1982.

<sup>2</sup> Leonard Newmark, Philip Hubbard, Peter Prifti, *Readings in Albanian* ("Lexime në gjuhën shqipe"), Washington, D.C., 1979; Leonard Newmark, Ismail Haznedari, Philip Hubbard, Peter Prifti, *Spoken Albanian* ("Shqipja e folur"), Ithaca, New York, 1980.

<sup>3</sup> Peter R. Prifti, "Mësimi i gjuhës shqipe në Amerikë (II)", *Gjuba jonë*, 1998.

<sup>4</sup> Më poshtë do të jetë *G.A.*

pjesa më e madhe e librit është një përshtatje, pjesërisht dhe përkthim i drejtpërdrejtë, si dhe ripunim i *Morfologjisë* së sipërpërmendur.

Nisur nga ky fakt, menduam që objekt të kumtesës sonë të kemi pikërisht këtë gramatikë, e konkretisht të bëjmë një krahasim të hollësishëm të kësaj gramatike me Morfologjinë mbi të cilën është bazuar, duke nxjerrë dhe dallimet në trajtimin e sistemit gramatikor të shqipes në *Standard Albanian*, dallime që vijnë si rezultat i ndikimit nga drejtime të tjera gjuhësore me të cilat kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë.

Pas një vështrimi të përgjithshëm, të krijohet përshtypja se kjo gramatikë është e njëjtë me atë të *GA*, madje një përkthim i drejtpërdrejtë i saj. Këtë ide ta krijojnë jo vetëm paragrafët e ngjashëm, por dhe të njëjtët shembuj ilustrues. Madje dhe nga pasqyra e lëndës vihet re se kjo gramatikë ka 12 kapituj, ashtu si dhe *GA*, me të vetmin ndryshim që në vend të kapitullit për njohuritë rreth fjalëformimit në këtë gramatikë ka një kapitull më vete për shkallëzimin dhe krahasimin. Për mënyrat e formimit të fjalëve është folur në kapitullin përkatës të çdo pjese të ligjëratës. Por, nëse shihet me kujdes, vihen re dhe ndryshime midis tyre. Çdo kapitull i kësaj gramatike trajton jo vetëm pjesën e ligjëratës si një kategori morfologjike, por edhe funksionin sintaksor përkatës, funksion ky i cili mund të kryhet edhe nga fjalë të tjera ose grupe fjalësh. Kjo vihet në dukje nga autorët, të cilët pohojnë se “Në këtë libër do të dallojmë fjalët *emër, përemër, mbiemër, folje, ndajfolje, numëror, parafrjalë* dhe *lidhëz*, të cilat janë emrat e pjesëve të ligjëratës të përcaktuara si fjalë të vetme me një grup karakteristikash të funksioneve sintaksore nga fjalët *emëror, përemëror, mbiemëror, foljor, ndajfoljor, numëror, parafrjalor* dhe *lidhëzor*, të cilat janë emrat e roleve përkatëse sintaksore”<sup>5</sup>.

Të ndikuar nga gjuhësia strukturaliste ku funksioni i çdo njësie përcaktohet duke u bazuar në lidhjen e ndërsjellë midis elementeve dhe jo duke treguar vetëm lidhjet semantiko-logjike midis tyre, autorët e kësaj gramatike e nisin çdo kapitull për pjesët e ligjëratës me përkufizimin e sintagmës në të cilën pjesa e ligjëratës shërben si kokë. Ata vazhdojnë më tej me përshkrimin e strukturës sintagmatike ku, përveç kokës, si elemente përbërëse të sintagmës janë edhe determinantët, modifikuesit dhe komplementët. Madje autorët përshkruajnë dhe elemente të cilët mund të funksionojnë si determinantë, modifikues e komplementë sipas sintagmës ku përfshihen. Ndonëse është një libër për morfologjinë e gjuhës shqipe, autorët në çdo kapitull i kushtojnë rëndësi anës strukturore të njëjësive duke përdorur konceptin e sintagmës në një kohë

<sup>5</sup> Newmark, Leonard; Hubbard, Philip; Prifti, Peter, *Standard Albanian - A reference grammar for students*, Stanford University Press Stanford, California, 1982, f. 38.



kur përgjithësisht në gramatikat e shqipes (sintaksat e ndryshme) brenda vendit, ndikuar nga gjuhësia ruse, operohej me konceptin e togfjalëshit.

I menduar si një libër për të huajt që mësojnë shqipen, autorët në kapitullin hyrës japin disa informacione për Shqipërinë dhe banorët e saj, për dy dialektet dhe gjuhën standarde shqipe, më tej kalojnë në njohuri për strukturën fonetike të shqipes, duke përshkruar zanoret e bashkëtingëlloret, dhe më pas ndalen në strukturën morfematike të shqipes, informacione të cilat jepen gjerësisht në kapitullin hyrës të *Morfologjisë* së Akademisë.

Secilës pjesë të ligjëratës i është kushtuar një kapitull në të cilin autorët bëjnë një ndërthurje të aspektit morfologjik, sintaksor e semantik.

Ndryshe nga GA në të cilën në fillim jepet sistemi emëror i shqipes, ai mbiemëror, numëror, përemëror, pastaj kalohet në atë foljor e me radhë, këtë gramatikë autorët e nisin me trajtimin e sistemit foljor. Ata vijnë me sistemin emëror, e më tej me sistemin mbiemëror e ndajfoljor që ndiqen nga kapitulli i shkallëzimit, shkallës krahasore dhe sipërore. Në kapitujt e fundit janë trajtuar numërorët, përemrat, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat e pasthirrat.

1. Nga krahasimi që i kemi bërë kapitullit të foljes në GA dhe në këtë gramatikë, vihet re se autorët janë mbështetur gjerësisht në trajtimin e GA, ndonëse ndeshen dhe ndryshime të llojeve të ndryshme, si p.sh. në klasifikimin e foljeve sipas kuptimit dhe funksionit, në grupimin e foljeve të zgjedhimeve të ndryshme në nënklasa, në kategori të ndryshme gramatikore, si veta, diateza e aspekti apo në grupimin e formave të pashtjelluara.

Që në fillim të këtij kapitulli autorët nuk mjaftohen vetëm me përkufizimin e foljes, por japin informacion dhe për grupin foljor (VP), si dhe shpjegojnë proklitikët si tregues të mënyrës, të aspektit e të kohës, dhe komplementët, që mund të jenë foljorë, ndajfoljorë e emërorë.

Ajo çka bie në sy në klasifikimin e foljeve sipas kuptimit dhe funksionit është se në dallim nga GA ku dalin dy grupe: folje ndihmëse dhe gjysmëndihmëse, autorët bëjnë këtë ndarje në grupe: 1. foljet ndihmëse e pseudondihmëse dhe 2. foljet gjysmëndihmëse.

- Në grupin e parë: krahas *kam e jam*, autorët quajnë ndihmëse dhe foljet *dubet, do* (të cilat në GA quhen gjysmëndihmëse). Ata dallojnë dhe raste kur këto folje përdoren si pseudondihmëse (shih më poshtë).

Këtu bëjnë pjesë foljet *kam e jam* si folje ndihmëse për kohët e përbëra, folja *jam* si këpujë (*Ata janë djem të mirë dhe duben ndihmuar*), folja ndihmëse *do e dubet* (*Kjo këmbishë do/duhet larë. Duhet të kem qenë atëherë nja gjashtë-shtatëmbëdhjetë vjeç*). Për foljen ndihmëse *dubet* autorët sqarojnë më mirë përdorimin e saj me pjesore dhe me lidhore.

Autorët dallojnë gjithashtu dhe foljet pseudondihmëse, që janë folje të ndjekura nga forma të pashtjelluara foljore, por ndryshe nga foljet ndihmëse, midis tyre mund të qëndrojnë fjalë të tjera. Sipas tyre edhe foljet *kam* e *jam* mund të përdoren si pseudondihmëse kur ndiqen nga ndërtime të tipit *për të larë*, duke shprehur kështu në mënyrë më të zbutur kuptimin modal të nevojës sesa ndërtimet me *dubet* e *do*. Autorët vënë në dukje se ky është i njëjti ndërtim që përdoret dhe për të shprehur të ardhmen dhe se forca e kuptimit të tij modal varet nga konteksti. Folja *jam* mund të përdoret si pseudondihmëse edhe me format e përcjellores për të formuar të tashmen e të pakryerën e vazhdimësisë: *jam duke larë, isha duke larë*.

Të tjera folje pseudondihmëse janë dhe: *bëhem* e *mbetet* (kjo e fundit vetëm në vetën III njëjës) të ndjekura nga ndërtime të tipit *për të larë*: *Kur u bënë nipërit për të martuar ...*; folja *jam* në të tashmen ose të pakryerën + parafjalën *në* ose *me* + *të* + pjesoren: *Tanush Topia mezi po e mbante ushtrinë e tij, e cila ishte më të thyer e sipër*, folja *vij* kur ndiqet nga një përcjellore ose paraprihet nga lidhëza *sa* dhe ndiqet nga një folje e lidhur me të me lidhëzën *e* ose *dhe* për të shprehur një rritje progresive të veprimit: *Ja vuri edhe një herë dorën në ballë e tha se temperatura vinte duke rënë; Buçima sa vinte e zgjerohej dhe përrenjtë në të dy anët e xhadesë; pushoj / mbaroj + klitikun e pandryshuar *së* + pjesore me prapashtesën *-i* (që në origjinë është një emër prejfoljor asnjans në rasën rrjedhore) për të shprehur përfundimin e një veprimi ose ngopjen me të: *Profesor Hazari, që e kish zëkon të shtonte domosdo diçka, kur mbaronte së foluri ndonjë tjetër, shtoi ... Vjen një ditë që ne pushojmë së ekzistuari*.*

- Në grupin e dytë, pra të foljeve gjysmëndihmëse, autorët përfshijnë *do*, *le*, (forma të veçanta të vetës III të foljes *dua* e *lë*), foljet modale (*mund*, *dubet* ose *lipset*) dhe foljet që përdoren për të shprehur fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e një veprimi (*filloj*, *nis*, *zë*, *bëj*, *marr*, *vazhdoj*, *vijoj*). Këto ndërtime formohen nga dy elemente: elementi i parë është një prej foljeve të mësipërme, elementi i dytë është një folje në të tashmen ose në të pakryerën e mënyrës lidhore.

Në shpjegimin e vetës autorët ndalen gjatë dhe bëjnë një shpjegim të hollësishëm të trajtave të shkurtra e të bashkuara, të pozicionit të tyre në raport me foljen, si dhe të përdorimit të tyre.

Lidhur me përdorimin e foljeve vetëm në një vetë, këtu ndeshet një tjetër grupim i tyre. Ndërsa në GA bëhet dallimi midis foljeve njëvetore si folje që mund të kenë një kryefjalë të shprehur ose të nënkuptueshme nga ato pavetore si folje që nuk kanë kryefjalë të shprehur, as të nënkuptueshme, në *Standard Albanian* si folje njëvetore janë të gjitha foljet që përdoren vetëm në vetën III dhe në një nga nënndarjet e tyre përfshihen edhe foljet pavetore. Pra te foljet njëvetore autorët përfshijnë: a. folje që emërtojnë veprime karakteristike të kafshëve (*hingëllin*, *kakarit*, *pëllet* etj.); b. folje pavetore (*gjelbëron*, *bubullin*); c. folje me pseudosubjekte, të cilat kanë një pseudosubjekt

të vetës III njëjës (*s'më besohet, më duket, më pëlqen, më rastis, më qëllon* etj.); d. përdorime ekzistenciale të foljes *kam* (*Ata nuk e kuptojnë se politikë ka kudo*); dh. folje jokalimtare, joveprorë, pavetore në vetën III njëjës të shoqëruara shpesh me tregues të mohimit (*s'shkohet, s'lybet, s'rrohet, s'flibet*).

Në njohuritë që këta autorë kanë dhënë për diatezën bie në sy se janë ndalur më gjatë se në GA në trajtimin e saj. Dallohen njëjloj si në GA 4 diateza, por ndryshe nga kjo e fundit këtu dallohen dy grupe të mëdha: veprorë dhe joveprorë. Brenda diatezës joveprorë dallohen: mesorja, pësorja dhe vetvetorja.

Dallime vihen re dhe në trajtimin e kategorisë së mënyrës. Në GA jepen 6 mënyra të foljes, ndërsa këtu dallohen 5 mënyra: dëftore, habitore, lidhore, dëshirore, urdhërore. Pra autorët kanë përjashtuar mënyrën kushtore si mënyrë të mirëfilltë, duke dhënë shpjegimin se disa forma foljore me bazë format e lidhore përfshihen ndonjëherë te mënyrat bazuar në kuptimet e tyre modale, siç janë p.sh. mënyra kushtore apo e ashtuquajtura lidhore-habitorë.

Ndërsa në GA njohuritë për aspektin jepen brenda kategorisë së kohës, jo si kategori e mëvetëshme gramatikore e foljes, në *Standard Albanian* trajtohet si çështje më vete, ashtu si kategoritë e tjera

Në përgjithësi, në klasifikimin e foljeve në zgjedhime janë ndjekur të njëjtat parime si në GA, me përjashtim të kriterit të pestë që këtu mungon. Autorët kanë bërë klasifikim të njëjtë në tri zgjedhimet bazë, por ndryshime vihen re në ndarjen e mëtejshme në nënklasa. Te foljet e parregullta supletive çuditërisht nuk është përfshirë folja *bie* (*rashë, rënë*).

Karakteristikë e kësaj gramatike është se ndryshe nga GA, për paradigmën foljore autorët kanë dhënë më shumë modele foljesh për zgjedhime të ndryshme të shoqëruara nga shpjegime të herëpashershme më të hollësishme sesa shpjegimet në GA. Nuk vihen re dallime në format foljore, por hasen të tilla në emërtimin ose në mënyrën e formimit të tyre.

Për të ardhmen e mënyrës dëftore në GA jepet vetëm tipi i parë më i përdorur *do të punoj* dhe tipi i dytë *kam për të punuar*, ndërsa autorët kanë dhënë shpjegime më të hollësishme. Sipas tyre variantet gege kanë një të ardhme të ndërtuar nga *kam + me + pjesore e shkurtër*, ndërsa në vitet e fundit është zhvilluar një formë hibride e së ardhmes në shqipen standarde e ndërtuar nga *për + të + pjesore*, duke dhënë forma si *kam* (*ke, ka, kemi, keni, kanë*) *për të larë*. Autorët vënë në dukje se për disa folës ky ndërtim ka një nuancë modale të detyrimit.

Lidhur me format joveprorë, ndryshe nga GA, autorët dallojnë tema të posaçme joveprorë të cilat dalin më *-he* për foljet më zanore dhe më *-e* për foljet më bashkëtingëllore. Pikërisht këtyre temave joveprorë u shtohen mbaresat përkatëse: *-m, -*

*sb, -t, -mi, -ni, -n* (khs. me mbaresat e joveprore të GA *-(h)em, -(h)esh, -(h)et, -(h)emi, -eni, (h)en*).

Në trajtimin e formave të pashtjelluara bie në sy se autorët dallojnë pjesoren dhe format e tjera të ndërtuara mbi bazën e saj, të cilat i ndajnë në dy grupe: në kohët e përbëra të foljes, si dhe në ndërtime të tjera prejpjesore. Në këto të fundit ata vërejnë dy lloje:

- format prejpjesore veprorë, ku përfshihet: forma e pashtjelluar mohore (*pa larë*), përcjellorja (*duke larë*), infinitivi *për të larë*, absolutivi *me të larë* dhe infinitivi karakteristik geg *me punue*.

- format prejpjesore joveprore, të cilat janë format joveprore përgjegjëse të formave veprorë dhe që ndërtohen me klitikun *u* që vendoset menjëherë para temës foljore: *pa u larë, duke u hapur, për t'u larë, me t'u hapur*. Përdoret gjithashtu dhe pjesorja e foljes *jam* (*qenë*) për të dhënë aspektin e kryer të formës mohore dhe përcjellorë: *pa qenë larë, duke qenë hapur*.

Lidhur me format e mënyrës kushtore, autorët janë ndalur gjatë në përdorimet e formave të ndryshme foljore dhe të lidhëzave të ndryshme në ndërtimet hipotetike, duke mos u kufizuar mirëfilli në aspektin morfologjik, por duke bërë përpjekje për ndërthurje me aspektin sintaksor. Në GA këto shpjegime jepen të shpërndara, p.sh. te kuptimet e formave të dëshirores jepen dhe përdorimet e saj në fjali të varura kushtore dhe lejore etj.

**2. Njohuritë për emrin në kapitullin III nisin me përkufizimin e sintagmës emërore e cila sipas tyre ka një element emëror të shoqëruar ose jo nga një determinant që së bashku shërbejnë si bërthamë apo kokë e sintagmës. Kjo kokë mund të ndiqet nga një ose më shumë modifikues. Autorët përcaktojnë qartë se cilat elemente shërbejnë si determinantë e modifikues dhe u bëjnë një përshkrim të hollësishëm determinantëve të cilët i grupojnë në disa kategori duke dhënë dhe tabelat përkatëse: determinantët *pyetës* (përemrat *pyetës cili, ç', çfarë*); *përzgjedhës* (përemrat *dëftorë*); *e pacaktuar* (e ashtuquajtura *nyja e pacaktuar një* dhe përemrat e *pacaktuar*); *numerikë* dhe *përemërorë* (përemrat *pronorë ime, yt*).**

Sa për modifikuesit, autorët nuk ndalen gjatë duke e justifikuar me faktin se për ta do të flitet në kapitujt përkatës, por pasqyrojnë në mënyrë të hollësishme në një tabelë të gjithë llojet e modifikuesve. Nën emërtimin *modifikues mbiemërorë*, në tabelë janë rreshtuar si të tillë *emrat e nyjshëm* (bëhet fjalë për emrat e sasës gjinore - shën. ynë), *mbiemrat e nyjshëm* dhe të *panyjshëm, ndajfoljet predikative dhe fjalitë lidhore*.

Nën një paragraf më vete përshkruhen ‘predeterminantët’ të cilët sipas autorëve kanë një funksion specifik në lidhje me sintagmën emërore. Ata mund të jenë negativë (*jo, as*) dhe thirrmore (*ej, hej, more, ore, moj*).

Pas këtyre informacioneve për strukturën e sintagmave emërore vijojnë njohuritë për kategorinë e gjinisë, rasës, numrit dhe shquarsisë së emrave si dhe për mënyrën e formimit të tyre ku vihet re se janë të pakta dallimet me njohuritë e dhëna në GA.

Ndryshe nga GA ku në emrat e dygjinishëm përfshihen emrat mashkullorë që e formojnë temë e shumësit me prapashtesën *-e* dhe disa emra të lëndës me prapashtesën *-ra*, në këtë gramatikë autorët pranojnë edhe një grup të tretë me disa emra mashkullorë jofrymorë me prapashtesën *a* (*hap/a, kolektiv/a*), të cilët sipas GA marrin përcaktorë mashkullorë.

Sa i përket kategorisë së numrit, i vetmi dallim nga GA është mënyra e sistemimit të njohurive për shumësin e emrave në paragrafë të ndryshëm nisur nga përkatësia e emrit në gjininë mashkullore, femërore dhe asnjandëse përkundrajt mënyrës së përzier në GA.

Duke bërë një përshkrim të njave shquese dhe joshquese në gjuhët e tjera, përfshirë dhe anglishten, me anë të krahasimit autorët e gramatikës vënë në dukje se në gjuhën shqipe shquarsia nuk shënohet me fjalë të veçanta, por bëhet e dukshme me anë të mbaresave rasore të shquarsisë. Për trajtën e pashquar pohojnë se nyja më e zakonshme joshquese është *një*, por edhe determinantët *ndonjë, njëfarë*. Nyjes joshqyese *një*, së cilës në GA i referohen me termin e përgjithshëm ‘fjalë’ me burim nga numërori *një*, i është kushtuar vëmendje e veçantë në një paragraf më vete ku flitet për përdorimin e kësaj nyje nga ana kuptimore. Në këtë paragraf për kategorinë e shquarsisë vihet re mungesë koherence në përdorimin e termave *determinant* dhe *modifikues*: ndërsa në pjesën hyrëse të kapitullit të emrit determinantët përcaktohen si përbërës së bërthamës së sintagmës së bashku me kokën emërore duke e veçuar nga modifikuesit, në këtë paragraf pohohet se “Nyjat përfshihen në klasën e modifikuesve, të quajtur determinantë ...”<sup>6</sup>.

Ndërsa në GA quhen siparashtesa (prefiksoide) pjesa e parë e disa emrave të burimit të huaj, te gramatika në shqyrtim nuk emërtohen kështu por thjesht elemente parashtesore me karakter ndërkombëtar. Siç shihet dhe në pjesët e tjera për

---

<sup>6</sup> Newmark, L.; Hubbard, Ph.; Prifti, P., *Standard Albanian - A reference grammar for students*, Stanford University Press Stanford, California, 1982, f. 194.

fjalëformimin, nuk përmenden gjëkund në këtë gramatikë sindajshtesat (affixoide) si një nga mënyra e formimit të fjalëve.

Formimi pa ndajshtesa dhe ai me konversion trajtohen veçmas në GA, ndërsa në *Standard Albanian* përfshihen në një: si formime me konversion, pra emrat **si** *pjellë* (pjell), *kullotë* (kullot), *dredhë* (dredh), *pritë* (pritur), *rrjedhë* (rrjedh), *presë* (pres), *plasë* (plasur), *mburojë* (mburoj), *shtrojë* (shtroj), *lojë* (luaj), *ndjenjë* (*ndjenj* > *ndiej*), që në GA shihen si formime pa ndajshtesa, këtu trajtohen në të njëjtin grup me emrat e ardhur nga konversioni (*besnik*, *gënjeshhtar*, *i gjallë*, *mëngjërash*, *i ri* etj.). Madje autorët e kësaj gramatike shkojnë edhe më tej kur pranojnë si formime me konversion edhe emërzimin e mbiemrave prejpesorë të cilët në GA trajtohen si formime me nyjëzim.

**3. Kapitulli për mbiemrin nis me përkufizimin e sintagmës mbiemërore dhe përcaktimin e funksionit të saj si modifikuese e një emri a përemri drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet foljes.** Nisur nga ky funksion i ngjashëm, autorët përfshijnë në sintagma mbiemërore jo vetëm ato me kokë një mbiemër, por edhe sintagmat emërore (të nyjshme) në rasën gjinore, ndajfoljorët predikativë dhe fjalitë lidhore.

U kushtohet rëndësi e veçantë nyjave të mbiemrave për të cilat ka një paragraf më vete, por nën emrin *nyja mbiemërore*, përfshihen të gjitha llojet e nyjave: ato para mbiemrave, përemrave të v. III, para emrave të rasës gjinore, para përemrave të pacaktuar (të gjithë), para ditëve të javës, para emrave të farefisnisë *i ati*, *e ëma.*, para emrave asnjans të *folurit*. Bëhet një paralelizëm midis nyjave të mbiemrave dhe nyjave shquese të prapavendosura të mbiemrave të emëruar duke i konkretizuar me shembujt: I mir-I, TË mirë-T, SË mirë-S, TË miri-T.

Nisur nga rëndësia që ka rendi dhe përshtatja e duhur e mbiemrave me emrat që përcaktojnë për një të huaj që mëson shqipen, në gramatikë këto njohuri janë dhënë në paragraf më vete, pavarësisht se i takojnë sintaksës. Aty jepen të gjitha rastet e mundshme të rendit të mbiemrave, edhe kur këta janë më shumë se një e po ashtu të përshtatjes së mbiemrave të nyjshëm e të panyjshëm me emrat që modifikojnë. Të gjitha konkretizohen me shembuj duke i bërë më të qarta situatat e më të përvetësueshme nga të huajt.

*Nuk flitet për shkallën e mbiemrave në kapitullin e mbiemrave por është një kapitull më vete për kategorinë gramatikore të shkallës e cila ndeshet dhe te ndajfoljet. Por ama shkallët e ndajfoljeve jepen brenda kapitullit të ndajfoljeve.*

*Njohuritë për formimin e mbiemrave janë dhënë të ndara në dy grupe të mëdha sipas prodhimitarisë ose jo të ndajshtesave të ndryshme. Në këtë mënyrë studentët i ngulisin më mirë se cilat ndajshtesa janë më prodhimitare.*

4. Ashtu si dhe kapitujt e tjerë, ai për ndajfoljen nis me përshkrimin funksional të sintagmave ndajfoljore duke i përshkruar si fjalë ose sekuenca fjalësh të cilat kanë funksione tipike të një ndajfoljeje, siç është modifikimi i fjalisë, i një foljeje, një mbiemri, një emri ose i një ndajfoljeje tjetër.

Brenda klasës së ndajfoljeve, si dhe në GA, dallohen ndajfoljet përemërore nën termin *pro-adverbs* dhe vihet në dukje ngjashmëria e tyre me klasën e përemrave (*proforms*). Grupimi i ndajfoljeve në përcaktore dhe rrethanoë është i njëjtë si në GA, por në këtë gramatikë vihet re prirja për të përdorur terma specifikë për çdo lloj ndajfoljeje, pjesë e grupimeve më të vogla sipas nuancave kuptimore brenda dy grupeve kryesore. Kështu nëse në GA përmenden p.sh. ndajfoljet e mënyrës të tipit *mirë, keq* duke përshkruar kuptimin e tyre, por pa ndonjë term përkatës, ky grup ndajfoljesh në këtë gramatikë emërtohet *qualitative adverbs* (ndajfolje cilësore). Më poshtë po japim listën e termave për nëngrupimet e ndajfoljeve: 1. **Manner Adverbs - Qualitative Adverbs (Spatial Adverbs; Aspectual Adverbs; Adverbs in-(i)sht)** dhe **Adverbial Quantifiers**; 2. **Circumstantial Adverbs - Temporal Adverbs (Time Relative to Speech Moment, Periods, Frequency, Momentary Action, Duration, Negatives of Time)** dhe **Locative Adverbs (Definite Locatives, Indefinite Locatives, Negative Locatives)**; 3. **Causal Adverbs**.

5. Në këtë gramatikë autorët i kushtojnë një kapitull më vete kategorisë së shkallës duke e parë në një plan më të gjerë me përfshirjen e të gjithë elementeve që mund ta kenë këtë kategori. Në fakt vihet re një mungesë koherence në trajtimin e kësaj kategorie brenda kapitujve përkatës të mbiemrave dhe ndajfoljeve, si dy pjesë ligjërata ku kjo kategori ndeshet më gjerësisht. Kështu në kapitullin e mbiemrave nuk përmendet kjo kategori, ndërsa në atë të ndajfoljes bëhet një përshkrim i shkallës së ndajfoljeve pavarësisht se një informacion i tillë del dhe më pas në kapitullin e posaçëm për shkallën.

Në këtë kapitull përshkruhet vetëm shkalla krahasore (comparison) me të gjitha nënndarjet e saj dhe shkalla sipërore (qualification) ndryshe nga GA ku si një shkallë më vete njihet edhe ajo pohore. Nga 4 nëgrupe që ka shkalla krahasore në GA (e barazisë, e sipërisë relative, e sipërisë absolute dhe e ultësisë) këtu del vetëm me 3 të tilla (e barazisë, e sipërisë dhe e ultësisë. Edhe shkalla e sipërisë e cila në GA nuk klasifikohet më tej, në këtë gramatikë ka tre grupe: përforcuese, zvogëluese dhe përfruese. Ndërsa nga përshkrimi del se shkallën sipërore e kanë vetëm mbiemrat e ndajfoljet, atë krahasore mund ta kenë edhe elemente të tjera sipas autorëve. Kjo shkallë përshkruhet në tre grupe sipas elementeve ku shfaqet kjo kategori: në grupin *e parë* është shkalla krahasore e modifikuesve ku futen mbiemrat dhe ndajfoljet (vihet në dukje se konstruktet për krahasimin janë identike si te mbiemrat ashtu dhe te ndajfoljet ndaj shembujt jepen të përzier); në grupin *e dytë* përfshihet shkalla krahasore e emrave dhe

në të tretin shkalla krahasore e elementeve të tjera me të cilat kihet parasysh folja, parafjala dhe madje një fjali e tërë. Aty theksohet se krahasimi i foljeve, parafjalëve dhe fjalive është i ngjashëm me atë të emrave dhe del në të gjitha shkallët. Siç shihet nga këto grupime, sipas autorëve të kësaj gramatike, janë të shkallëzueshme edhe disa pjesë të tjera të ligjëratës si emri, folja etj. gjë që është krejt e ndryshme nga GA ku kategoria e shkallës i përket vetë mbiemrave dhe ndajfoljeve.

6. Në kapitullin përkatës numërorët dhe shprehjet numërore përshkruhen gjerësisht sipas strukturës së tyre dhe jepet një informacion i hollësishëm për të gjitha rastet e përdorimit të numërorëve themelorë. Theksohet përdorimi i presjes në numrat dhjetorë gjë që është e ndryshe nga sistemi amerikan i cili përdor pikë.

7. Autorët e kësaj gramatike i përkufizojnë përemrat si një lloj proforme që nuk ka kuptim specifik e të pavarur por që i referohet elementeve të ndryshme në kontekste të ndryshme. Sipas kuptimit dhe funksionit dallohen 10 lloje proformash: përemra vetorë, emra refleksivë, dëftorët, mbiemrat deiktikë, mbiemra pronorë, përemra pyetës, përemra lidhorë, përemra të pacaktuar, përemra reciprokë, sasiore të pacaktuar. Siç shihet nga emërtimet, klasa e përemrave paraqitet mjaft heterogjene sa i përket termave për çdo nënklasë ku ndeshen përemra, emra, mbiemra dhe sasiore ndryshe nga GA ku kjo klase shfaqet nën emërtimin e vetëm *përemra*, pavarësisht se dhe këtu bëhet një grupim sipas veçorive gramatikore, përdorimit dhe pjesërisht sipas anës kuptimore në tri grupe: ***përemrat-emra, përemrat-mbiemra dhe përemrat-numërorë.***

Një dallim tjetër për këtë klasë fjalësh vihet re dhe në sasinë e llojeve të tyre: te gramatika në shqyrtim dallohen 10 të tillë kurse në GA vetëm 7. Ato që në GA emërtohen *përemra vetvetorë*, këtu thirren *emra refleksivë* nisur dhe nga origjina e tyre emërore gjë që theksohet edhe në GA. Si një grup më vete nga *përemrat dëftorë* dallohen *mbiemrat deiktikë* vetëm për ngjashmërinë e tyre me mbiemrat e nyjshëm që shfaqen pas dhe ndonjëherë para emrave për efekte stilistike. Po ashtu, të veçuar nga grupi i përemrave të pacaktuar siç ndodh në GA, dalin përemrat e reciprokë te gramatika e Newmarkut. Në fakt na duket i drejtë ky veçim sepse reciprokët shfaqin dallime në aspektin sintaksor nga pjesa tjetër e përemrave të pacaktuar.

Të veçuar nga grupi i përemrave të pacaktuar dalin sasiore të pacaktuar *shumë, disa, gjithë* etj., të cilët janë të pacaktuar në raport me numërorët që janë sasiore të caktuar.

8. Në përkufizimin e GA për parafjalët përmenden vetëm marrëdhëniet *sintaksore* të varësisë midis një emri, një numërori ose një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyrë tjetër në një togfjalësh ndërsa te *Standard Albanian* ... shtohen edhe marrëdhëniet semantike midis këtyre ku gjymtyra e varur emërtohet *objekt* i parafjalës.

9. Në kapitullin për lidhëzat i vetmi dallim nga GA është përfshirja e lidhëzave shpjeguese *domethënë, bie fjala, për shembull* etj. në grupin e lidhëzave bashkërenditëse. Në GA shpjegohet qartësisht lënia e tyre si një grup i veçantë: as bashkërenditëse e as



nënrenditëse pasi “nga disa tipare afrohen me bashkërenditëset: fjalia që lidhin ato nuk mund të rrijë në ballë të periudhës, ato shërbejnë për të lidhur jo vetëm fjali, po edhe gjymtyrë fjalie; nga disa tipare të tjera afrohen me nënrenditëset: ato nuk mund të lidhin gjymtyrë e fjali dhe nuk mund të përsëriten.”<sup>77</sup>

10. Një grup **formantesh** me prejardhje nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat janë shndërruar prej kohësh në mjete për të ndërtuar disa forma gramatikore të fjalëve, si *u, do, të, me, për, pa, duke* dhe *më* në GA janë përfshirë në mënyrë konvencionale te pjesëzat, por pa u përmendur në fillim si një grup më vete i pjesëzave. Edhe në *Standard Albanian* nuk mbahet një qëndrim i prerë për vendin e këtyre formave dhe përdoret i njëjti argument për përfshirjen e tyre te pjesëzat, por që në fillim renditen si një grup i katërt i pjesëzave nën emërtimin *pjesëza foljore*. Prej këtij grupimi është hequr pjesëza *më* e cila nuk shërben për të ndërtuar forma gramatikore të foljeve.

\*            \*  
                 \*  
                 \*

Nga një vështrim i hollësishëm krahasues që i kemi bërë *Standard Albanian* dhe *Gramatikës së Akademisë* arrijmë në përfundimin se dallimet më të qenësishme dhe më të shumta midis këtyre dy veprave i përkasin sistemit foljor. Kjo ndoshta dhe për vetë faktin se kategoria e foljes është shumë e ndërlikuar dhe përbën një ndër çështjet më të diskutueshme edhe në gjuhësinë shqiptare.

Kjo gramatikë është e rëndësishme jo vetëm për të huajt që mësojnë gjuhën shqipe, por dhe për studiuesit e gjuhës, të cilët mund t’i referohen asaj për ndonjë qëndrim alternativ në çështje specifike. Një tjetër kontribut i saj është dhe terminologjia e përdorur, e cila ndonëse nuk është në gjuhën shqipe, ndihmon në kuptimin më mirë të grupeve e nëngrupeve të shumta të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore në krahasim me *Gramatikën* e Akademisë.

Gramatika *Standard Albanian* ... përbën sigurisht një hap përpara për kohën kur u hartua lidhur me përshtkrimin gramatikor të gjuhës shqipe. Ajo jo vetëm u mbështet në traditën gramatikore të deriatëhershme, por u plotësua dhe me elemente të reja të gjuhësisë bashkëkohore, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm në përvetësimin e shqipes nga të huajt, si pjesë e mësimin të shqipes nëpër botë, si dhe duke zënë një vend të veçantë në historinë e gramatologjisë së gjuhës shqipe.

---

<sup>77</sup> Dhrimo, A.; Angoni, E.; Hysa, E.; Lafe, E.; Likaj, E.; Agalliu, F.; Demiraj, Sh.: *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1976, f. 362.

## Literatura

1. Newmark, Leonard; Hubbard, Philip; Prifti, Peter, *Standard Albanian - A reference grammar for students*, Stanford University Press Stanford, California, 1982.
2. *Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I Morfologjia*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
3. Dhrimo, Ali; Angoni, Engjëll; Hysa, Enver; Lafe, Emil; Likaj, Ethem; Agalliu, Fatmir; Demiraj, Shaban. *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1976, 400 f.
4. Peter R. Prifti, “Mësimi i gjuhës shqipe në Amerikë (II)”, *Gjuha jonë*, 1998.

Haki HYSENAJ

## IRENA SAWICKA PËR STRUKTURËN E RROKJES NË SHQIPEN E KOSOVËS

### Hyrje

**Abstrakt:** Gjuhëtarja polake, Irena Sawicka, është e para që ka trajtuar strukturën e rrokjes në shqipen dialektore. Korpusi i ngritur mbi bazë të një numri të konsiderueshëm monografish, të hartuara nga studiues shqiptarë, i kanë mundësuar autores që të mbërrijë në përfundime interesante (Sawicka, 2008:61-62).

Në punimin “*Struktura e rrokjes së shqipes kosovare*” Sawicka ka trajtuar përndarjen e grupeve konsonantike, posaçërisht rastet kur grupet e bashkëtingëlloreve obstruente përmbajnë në strukturën e tyre edhe sonante. Duke pasur parasysh vlerën fonologjike të sonoritetit, Sawicka ka provuar të studiojë funksionin e këtij tipi në përndarjet fonematike sonante-obstruente dhe e kundërta.

Në këtë studim fonetiko-fonologjik Sawicka ka përcaktuar edhe tiparet shoqëruese dhe përjashtuese midis bashkëtingëlloreve të ndryshme në pozicionin nistor, fundor dhe në atë kundruall kulmit të rrokjes. Nga ana tjetër, autorja konstaton se në të folme të ndryshme, si rezultat i rënies së zanoreve të patheksuara, kanë lindur togje zanoresh me një kulm plotësues sonoriteti. Në këtë mes Sawicka ka pohuar (jo prerazi) se në shqipen dialektore edhe tingujt obstruentë mund të dalin si tinguj silabikë, posaçërisht kur janë elemente të vetme të morfemave.

Punimi “*Irena Sawicka për strukturën e rrokjes në shqipen e Kosovës*” mëton të vë në pah këtë qasje të re të gjuhëtares Sawicka në hulumtimet fonetike në shqipe.

**Fjalët kyçe:** rrokja, sonante, obstruente, modelet fonologjike, modelet fonetike, togje konsonantike, zanore joetimologjike, kulmi i rrokjes, kulme plotësuese.

### 1. Sfondi

Pak vite më parë Irena Sawicka botoi edhe një studim të rëndësishëm në fushë të fonetikës së shqipes. Punimi i kushtohet strukturës së rrokjes në shqipen dialektore.

U publikua në revistën shkencore “Gjurmime albanologjike” të Institutit Albanologjik (Sawicka, 2008:55-62).

Rrokja në fonetikë cilësohet si një ndër njësitë më të pastuduara. Në aspektin teorik në shqipe është trajtuar nga Anastas Dodi (Dodi, 2004:125-142), Rexhep Ismajli (Ismajli, 1985:156-160) dhe tash së voni edhe nga Aljula Jubani (Jubani-Bengu Aljula, 2013).

Gjuhëtarë të tjerë shqiptarë rrokjen dhe strukturën e saj e kanë përmendur përciptazi në hulumtimet e tyre për të folme të ndryshme dialektore të shqipes, mirëpo interpretimet për të nuk kanë shkuar përtej përshkrimeve teorike që kanë bërë autorët e përmendur. Prandaj, përzgjedhja e punimit studimor “*Struktura e rrokjes në shqipen kosovare*” i gjuhëtares polake, Irena Sawicka për kumtesë në këtë seminar, kujtoj se sjell disa interpretime të reja për modelet rrokjesore në shqipen dialektore, si dhe interpretime për shoqërimet dhe restriksionet kombinatorike të tingujve bashkëtingëllorë në kuadër të kësaj njësie.

## 2. Hyrje

Punimi ka të bëjë me përshkrimin e modeleve të rrokjeve në të folme të ndryshme të Kosovës dhe me kombinimet e tingujve bashkëtingëllorë gjatë procesit të rrokjeformimit. Në bibliografi përmenden edhe të folme të tjera jashtë kufijve të territorial të Kosovës, të cilave ndonjëherë u referohet autorja. Megjithatë, Sawicka sqaron se studimi i kushtohet strukturës së rrokjes, siç thotë ajo, të shqipes kosovare (Sawicka, 2008:55).

Për të realizuar këtë studim Sawicka ka shfrytëzuar disa monografi autorësh shqiptarë, të cilët më parë kanë bërë përshkrimin dialektor të disa të folmeve të Kosovës dhe të folmeve të tjera jashtë saj (Sawicka, 2008:56-57). Monografitë janë të viteve të shtatëdhjeta e të tetëdhjeta. Korpusi i hulumtimit është i ngritur mbi bazën e materialeve të këtyre monografive.

Në punim mungojnë matjet nga vetë autorja, prandaj disa konstatime ndonjëherë dalin të paqëndrueshme. Konstatimet e kësaj natyre lidhen më shumë me përshkrimet kombinatorike të fonemave bashkëtingëllore.

## 3. Modelet rrokjesore

Siç u tha edhe më parë, në këtë punim studimor, në fokus të interesimit të Sawickës dalin përcaktimet e modeleve fonologjike dhe fonetike të rrokjeve në shqipen dialektore, si dhe hulumtimi i përndarjeve të fonemave konsonantike, përfshirë edhe restriksionin kombinatorik në të dy anët e rrokjes, në fillim (**onest**) dhe në fund (**coda**).

Që në fillim autorja problem kryesor nxjerr përcaktimin e rendit të sonanteve dhe të obstruenteve në togjet konsonantike të fillimit dhe të fundit të silabës. Sonoritetin e shënjon *kushtëzues funksional* të sonanteve në togje konsonantike.

Bazuar në teorinë e sonoritetit autorja konstaton se rrokja në shqipen dialektore, pos kulmit të zakonshëm që identifikohet me një zanore të plotë, ndonjëherë përcillet edhe me një kulm plotësues sonoriteti. Ky kulm, sipas saj, shkaktohet nga shkalla e sonoritetit të tingujve bashkëtingëllorë në anët e rrokjeve dhe nga reduktimi ose rënia e tërësishme e tingujve të shkurtër të patheksuar. “Në fillim të fjalës lejohen rrokjet me dy kulme. Në këto pozita anët nistore të rrokjeve mund të kenë kulme plotësuese sonoriteti, p. sh. **mdha**, **lpenël**, **lshon**, **mshil**, **rrvoka**, **ndall**, **ndesh** (Shala), **nxbhall**, **lkeun** (Morava e Poshtme), etj. (Sawicka, 2008:59).

Siç shihet, në shembujt e përzgjedhur nga Sawicka, në fillim të rrokjes bie plotësisht elementi zanor midis sonanteve dhe obstruenteve. Përimtimi i mëtejshëm na dërgon në konstatimin se në shqipen dialektore ndonjëherë, varësisht nga kombinacioni konsonantik, rrokja realizohet me një kulm të plotë vokalik dhe ndonjëherë edhe me një kulm dytësor. Kulmi i dytë ngrihet mbi shkallën e sonoritetit të tingujve bashkëtingëllorë. Segmenti i parë identifikohet me elementet sonante: **m**, **l**, **rr**, **n**.

Në të vërtetë, këto sonante kryejnë funksionin e kulmeve plotësuese të sonoritetit të rrokjeve me strukturë të ngjashme e assesi të kulmeve silabike. Kështu, **mja** në fjalët **mshel** dhe **mshil** kryen funksionin plotësues të sonoritetit të rrokjes **dha** dhe **shil**. Të njëjtin funksion e kryejnë edhe elementet e tjera sonante. Sipas këtij parimi del se në fillim të rrokjes nistore lejohen strukturat josilabike dhe sonanti që thyen vijën e sonoritetit. Duke e cilësuar këtë strukturë rrokjeje si shumë frekuentuese në të folmet e Kosovës, Sawicka thekson se një model i këtillë del edhe në gjuhën çeke (Sawicka, 2008:59). Për modele të ngjashme rrokjesore në dialektet çeke ka shkruar edhe Trubeckoi (Trubeckoi, 1985: 298).

#### 4. Restriktionet kombinatorike

Modeli i përmendur rrokjesor, që nënkupton një kulm të plotë sonoriteti, i ngritur mbi bazën e pranisë së një vokali në qendër të rrokjes dhe të një kulmi plotësues në fillim të rrokjes, që realizohet me ndihmën e sonanteve rrokjeformuese, sipas Sawickës është karakteristikë vetëm për të folmen e Shalës së Bajgorës dhe të Moravës së Poshtme.

Ne mendojmë se kombinime të këtilla fonemash: **sonant + obstruent**, që rezultojnë në shumicën e rasteve si pasojë e rënies së elementit vokalik, nuk janë karakteristikë vetëm e këtyre dy të folmeve. Rrokje nistore me strukturë të njëjtë dalin në shumicën e të folmeve geqe.

Bazuar në hulumtime perceptive situatë e njëjtë ndonjëherë del edhe në gjuhën standarde, në variantin e folur të saj. Në ligjërimet formale, të realizuara me një temp më të shpejtë se zakonisht, krijohen kushte fonetike të favorshme për rënie tingujsh dhe për pasojë edhe për kombinime të ngjashme. Pra, strukturat e këtilla rrokjesore kujtojnë se kanë shtrirje më të gjerë se në të folmen e Shalës së Bajgorës dhe të Moravës së Poshtme.

Po ashtu, autorja e këtij studimi thekson se rrokje me kulm plotësues sonoriteti dalin edhe në fund të fjalës sa herë që kemi të bëjmë me të njëjtat procese fonetike, d.m.th. me rënien a reduktimin e tingujve, si p.sh. në kallëzoren njëjës të emrave të shquar, kur në fund kemi një **bashkëtingëllore + n**, ose në huazime me **-izm, -tr**, etj. “Në të gjitha pozitat e tilla paraqitet një zanore joetimologjike, e cila e ndan togun dhe formohet një rrokje e re”, shprehet autorja, duke dhënë shembuj konkretë për të folmen e Shalës së Bajgorës dhe të Moravës së Poshtme. Sipas këtij konstatimi del se togjet konsonantike jasonorike, me ndihmën e tingujve vokale lëvizës, zhbëhen “*likuidohen*” gjithsesi.

Nga ana tjetër, Sawicka konstaton se togjet e padëshirueshme konsonantike, siç i quan grupet që nuk mund të realizohen në aspektin nyjëtimor e që mund të jenë pasojë e derivacioneve të ndryshme ose e huazimeve leksikore, zhbëhen (“*likuidohen*”) me ndihmën e disa proceseve fonetike. “*Sonanti zhbuket, togu i nënshtrohet metatezës, ose një kulm plotësues shfaqet, prandaj në rrokje plotësuese – sonanti silabifikohet ose një zanore shtohet*” (Sawicka, 2008:56). Këto procese përshkruhen të përbashkëta për shumicën e gjuhëve, prandaj këtë konstatim autorja e këtij punimi studimor e argumenton me shembuj nga serbishtja, si: **magla** në vend të \***mgla**, ose **udovica** në vend të \***vdovica**, pa dhënë shembuj edhe nga shqipja. ( Siç shihet në rastin e parë **m**-ja silabifikohet, ndërsa në rastin e dytë labiodentalja **v** bie tërësisht, për t’u zëvendësuar me një segment lëvizës vokalik, që në këtë rast është zanorja **u** ). Zanorja **a** në fjalën e parë dhe **u** në të dytën, si dhe elemente të tjera, që kryejnë funksione të ngjashme fonetiko-fonologjike, njihen si segmente lëvizëse në kuadër të leksemave (Ismajli, 1985:158). Ato gjithmonë aktivizohen në rastet kur kemi restriksione kombinatorike midis fonemash të ndryshme, kombinimi i të cilave do të krijonte grupe konsonantike të vështira për nyjëtim.

Sipas Sawickës, në shqipen dialektore të Kosovës për zhbërjen e togjeve “*të padëshirueshme*” një rol të rëndësishëm e luan zanorja **ë**. Funksionin e saj e cilëson fonologjik. Funksionalisht të pavarur këtë zanore e sheh në të folmen e Kaçanikut, e cila zhdok togjet e këtilla edhe në rastet kur shërben si “*përkerabës*” vokalik i sonoritetit. Në këtë të folme, sipas autores, **ë**-ja me vlerë të njëjtë del edhe në pozita të tjera, posaçërisht kur nuk ka motivacion kombinatorik (Sawicka, 2008:60). “*Ndryshimin tjetër nga rrokja tipike e kam gjetur në të folmen e Kaçanikut ku ë-ja ka karakter fonologjik, sepse ky tingull përdoret jo vetëm si një përkerabje vokalice e sonantit, por edhe në pozitat e tjera kur ai nuk ka motivacion kombinatorik*, p.sh. **duhët, mërzzitet, flutrës, punës, bahët**, etj. Prandaj, në

*Kaçanik struktura e rrokjes fundore e fjalës shfaq modelin sonorik në kuptimin fonologjik dhe gjithashtu në kuptimin fonetik*” (Saëicka, 2008:60).

Studimi “*Struktura e rrokjes në shqipen kosovare*” i autores polake Irena Sawicka tregon se proces i kundërt ndodh me statusin e ë-së në të folmet e Lugut të Drinit të Bardhë. “*Në këto të folme ë-ja nuk ekziston as si fonemë as si tingull fonologjik*” (Sawicka, 2008:60). Për këtë konstatim jep shembujt: **flokt, lopt, kokerr, lopen, baben, le: per.**

Dodi e përshkruan e cilëson rrokjen si një nga nocionet themelore të fonetikës, sepse aty realizohen tiparet kryesore të fonemave (Dodi, 2004:125). Nisur nga ky konstatim mund të thuhet se Sawicka hulumton kështu disa nga tiparet e përbërësve të rrokjes, posaçërisht sonoritetin dhe llojin e konsonantit sipas pengesës. Këto dy çështje i përshkruan edhe në planin funksional. Ndonëse sonantet në shqipe nuk dalin me funksion rrokjeformues (Ismajli, 1985:159), në shqipen dialektore, siç u tha më lart, sipas Sawickës ndonjëherë ato shërbejnë si mbështetëse të sonoritetit të kulmit të rrokjes, ndërsa obstruentet, në raste të caktuara, posaçërisht në kufijtë midis morfemave, ndonjëherë shërbejnë për të ndërtuar një kulm dytësor të rrokjes.

Për ta mbështetur konstatimin e vet, Sawicka sjell shembujt e prezencës së togjeve konsonantike në kufijtë morfologjikë, si p. sh. **t’lshoj, t’lku:n. t’dha, t’mdel, m’xuni** etj. Ndonëse thekson se në situata të këtilla kërkohen përcaktime vlerash fonetike të këtyre kufijve morfologjikë dhe vlerash fonetike të obstruenteve nistorë me ndihmën e fonetikës eksperimentale, ajo, megjithatë, lë mëdyshjen se ka gjasë që në këto situata obstruentet janë silabikë edhe kur janë elementë të vetëm të morfemës. Duket se këtu kemi të bëjmë me realizimin e reduktuar të elementëve proklitikë, posaçërisht të ë-së, e cila realizohet si një zanore shumë e reduktuar.

### **Përfundime:**

Pas hulumtimit që i bën korpusit të saj të hartuar mbi bazën e 11 monografive dialektore, autorja e këtij punimi studimor, Irena Sawicka, arrin në këto përfundime:

1. Kulmi fonetik i rrokjes në shqipen dialektore gjithmonë formohet nga elementi zanor.

2. Në reprezentacione të ndryshme fonologjike ky kulm mund të jetë gjithashtu një sonant.

3. Në anët e rrokjes, për dallim nga shumica e gjuhëve evropiane, në shqipen dialektore paraqiten kombinime, si:

**okluziv +okluziv** P.sh. (gjithçka)

**okluziv +afrikat** P. sh. (pshtove) dhe

**okluziv + frikativ** P.sh. (kqir)

4. Në fund të fjalës në shqipen dialektore nuk paraqiten grupe të tipit:

**obstruent + sonant**, që do të thotë se në këtë pozitë nuk shfaqet ndonjë kulm plotësues i sonoritetit.

Këtu vlen përmendur se autorja duket të mos ketë hasur në korpusin e saj grupe të të njëjtit tip, që dalin në të folme të tjera dialektore, por edhe në gjuhën standarde, si:

**mbylltore + sonante**

P. sh.

a) **Britm**, m. vjet. (Një nga 3 muajt e vjeshtës. Britmi i parë, shtatori. Britmi i dytë, vjeshta e dytë, tetori. Britmi i tretë, vjeshta e tretë, nëntori.

b) **Rrezm**, m. (Shkalla më e lartë e gjendjes së mirë të një njeriu a familjeje; mbarësi. Shtëpi me rrezm.....

c) **Hasm**, m. (Ai që është në gjak për shkak vrasjeje..... Fjalori i gjuhës Shqipe, 1981)

5. Autorja konstaton se në pozicionin fundor dalin raste restriksionesh kombinatorike midis sonanteve.

Edhe këtu ka gjasë që materialet e shfrytëzuara për formimin e korpusit të saj hulumtues nuk i kanë ofruar rastet si: **film**, **ngulm**, **kulm**, **sulm**, etj. Prandaj, Sawicka duket se ka theksuar si veçanti dialektore këtë restriksion kombinatorik, i cili në fakt nuk ekziston, sepse në të folmet e tjera, po edhe në gjuhën standarde, në rrokjen e fundit të fjalës kombinimet sonante+sonante janë të realizueshme.

6. Përfundimi tjetër i Sawickës është se në rrokjen e shqipes së Kosovës, në fillim të fjalës, dalin togje të tipit: **sonant + obstruent**, në të dy nivelet, në atë fonologjik dhe fonetik.

7. Autorja konstaton se në fund të rrokjes nuk mund të realizohen kombinimet e tipit : **obstruent + sonant**. Sipas saj, mungesa e këtij tipi është i nivelit fonetik, ndërkohë konstaton se në nivelin fonologjik kombinimet e tilla funksionojnë në rastet kur midis obstruentit dhe sonantit nyjëtohet **ë**-ja (-S ë C).

Pavarësisht lëshimeve dhe ndonjëherë edhe përfundimeve jo të qëndrueshme, punimi studimor “*Struktura e rrokjes në shqipen kosovare*” i studiueses polake Irena Sawicka hap horizont të ri në studimet fonetike të shqipes. Modelet rrokjesore, funksioni fonologjik i sonanteve dhe kombinimet e fonemave në strukturat rrokjesore, pas këtij punimi identifikohen si fushë e hapur për studime të mëtejshme dhe më të thelluara.



### **Referencat**

1. Dodi, Anastas (2004), Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe
2. Ismajli, Rexhep (1985), Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)
3. Jubani-Bengu, Aljula (2013), Buletini-Universiteti Planetar i Tiranës, në w.w.w. planetar.edu.a
4. Sawcka, Irena (2008), Gjurmime albanologjike
5. Sawcka, Irena (2008), Gjurmime albanologjike
6. Sawcka, Irena (2008), Gjurmime albanologjike
7. Trubeckoi, (1985), Parime të përgjithshme të fonologjisë
8. Sawcka, Irena (2008), Gjurmime albanologjike
9. Ismajli, Rexhep (1985), Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)



Juliana KUME

**GERDA ULISCH RRETH PRANISË SË GREQISHTES SË RE NË  
GJUHËN SHQIPE (DISERTACION I 1964-S)**

Interesimi për studimet albanologjike në botën gjermane duke nisur nga vitet '60 deri në ditët e sotme ka vijuar me studiuesit si **Wilfried Fiedler**, **Oda Buchholz**, **Gerda Ulich** si dhe **Diter Nehring**. Në Austri tradita albanologjike vazhdon me glotologun **Hermann Ölberg**. Nuk duhet lënë mënjanë impenjimi i madh i studiuesve si **Norbert Boretzky**, **Hans-Jürge Sasse**, **Claus Haebler**, si dhe i studiuesve më të rinj si **Walter Breu** e **Elvira Glaser** etj, të cilët të formuar në Institutin e gjuhësisë së përgjithshme indoevropiane të Universitetit të Myhniut, nën drejtimin e **Martin Camajt** i kanë dhënë një impuls hulumtimeve të reja “në terren”, kryesisht në komunitetet arbëreshe të Kalabrisë.

Gerda Ulich në disertacionin e saj të viti 1964 me temë “Elementet e gr. së re në gjuhën shqipe” (hartuar në gjuhën gjermane) paraqet praninë e elementit të ri grek në gjuhën shqipe. Për krijimin e fjalorthit prej 1100 fjalësh (përfshirë këtu edhe njësitë leksikore ndërkombëtare) është mbështetur përkatësisht në: *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* të G.Meyer-it (nga i cili ka marrë 530 njësi leksikore); “*A short Albanian grammar*”, “*An historical Albanian English Dictionary*” të Mann-it; “*Albanesische Grammatik im Sudgeegischen Dialekt*” Weigand-it; “*Dizionario albanese italiano*” Leotti; Lambertez; Tagliavini etj.

Si vepër normative të literaturës gjuhësore shqipe studiuesja ka marrë “*Fjalorin e gjuhës shqipe*” të 1954-s, sepse në atë kohë ka qenë i pari dhe i vetmi fjalor i gjuhës shqipe. Megjithëse, në hyrje të Fjalorit, f. 4 thuhet:<sup>1</sup> “*Fjalori në këtë botim të parë të tij s’arrin të jetë një udhëzues i prerë i normave të gjuhës letrare aq sa dëshirohet*”. Një tjetër ndihmesë për grumbullimin e materialit grek ka qenë shfrytëzimi i literaturës duke filluar nga autorët e vjetër të veriut (Buzuku, Bardhi, Bogdani) e deri tek ata më modernët si (P. Marko, Spase, Gjata etj). Punimi i saj konsiston, kryesisht: a) në grumbullimin dhe përpunimin në mënyrë të hollësishëm të elementëve të greqishtes së re në gjuhën shqipe (të

---

<sup>1</sup> G. Ulich, Disertacioni *Elementet e gr së re në gjuhën shqipe*, Leipzig, 1964, f. 35

pranishme në atë kohë), përqendruar jo vetëm në materialin gjuhësor të folmeve jugore të Shqipërisë, por edhe në atë të folmeve shqiptare në Itali dhe në Greqi, b) si dhe në studimin dhe përshtatjen e elementeve greke sipas këndvështrimit fonetik, morfologjik dhe leksikor.

Ulisch citon se Fjalori i '54-s pas botimit të tij është kritikuar fort: *Fjalori normativ i gjuhës shqipe ka rreth 370 njësi greke, ka gjithashtu shumë njësi turke dhe mbi të gjitha ka shumë njësi neolatine dhe internacionale. Ky fjalor ka regjistruar shumë greqizma, të cilat kanë hyrë nga folmja e Gjyrokastres dhe kritika i ka quajtur barbarizma p.sh.: allonar "korrik"; adha "pra"; arhond "zotni"; igrasi "lagështi"; imonik "karpuz"; istero "yll"; llaps "shkëlqen"; lauz "popull"; psonis "blej"; qeras "gostis"; spano "qose, spërk"; taks "premtoj"; plevas "puskoj"; stis "ndërtoj"; tromaks "tremb"; fanitet "del hije", dheks "pranoj" etj.*

Në lidhje me këtë të fundit Ulisch trajton gjerë problemin e teprimeve (barbarizmave) në gjuhën shqipe dhe fjalëve të huaja që duhet të dalin jashtë fjalorit të gjuhës shqipe, për këtë ajo i është referuar F.E.Ndocaj, ku thuhet: *Greqizmat, për të cilat unë mendoj se janë të tepërta dhe që duhet të dalin jashtë fjalorit tonë janë: adha, afion, agoni, aguridhe, akoma, alivan, allonar, amnisti, argas, arbond, që respektivisht i kanë analoget shqipe. Gjithashtu, Ulisch duke mbështetur punën e bërë nga rilindësit<sup>2</sup> për mbajtjen pastër të gjuhës shqipe dhe ruajtjen nga fjalët e huaja, si turqizmat, arabizmat dhe greqizmat ngre shqetësimin e përdorimit të njësisve leksikore të tepërta në fjalor si: **farmak** në vend të fjalës *helm*, **igrasi** në vend të fjalës "lagështi", **ister** "yll", **imonik** "shalqi" etj.*

Nga ana tjetër problemin e fjalëve të huaja Ulisch e ka parë edhe nga ana stilistike. Ajo pohon: *"Në një shkrim nga Shqipëria e jugut me karakter popullor dubet të shfaqen fjalë greke, të cilat i përkasin gjuhës së folur, përndryshe këto pjesë nuk do të kishte karakter origjinal, të vërtetë".*

Duhet marrë parasysh, se shumë fjalë të gr. së re që kanë depërtuar herët nuk shfaqen si trupa të huaj në gjuhën shqipe. Natyrisht, shumica ka kuptim vetëm për dialektet jugore, atje ato janë pasuria e gjuhës dhe nuk asgjësohen.

<sup>2</sup> Në lidhje me punën e bërë nga rilindësit për mbajtjen pastër të gjuhës shqipe, Ulisch shpreh: *Shkrimtarët shqiptarë të Rilindjes karakterizohen nga një frikë e natyrshme ndaj fjalëve të huaja. Përpara se ato të përdornin një fjalë ato kërkonin nëse do të ishte fjalë rrënjës e gjuhës, ose krijonin neologizma duke u nisur nga thesari i gjuhës shqipe. Lëvrimi (pastrimi) i gjuhës shqipe mori hov të madh gjatë shek.XIX, sidomos gjatë tridhjetë viteve të fundit të atij shekulli, kur lëvizja patriotike, politike, kulturore mori përpjestime të gjera. Ajo thekson se: *problem shumë i rëndësishëm, që i del kur shqyrton përbërjen e fjalorit nga pikëpamja e normës letrare është, pa dyshim, problemi i fjalëve të huaja në shqipen e sotme. Ishte Petro Luarasi, i cili për pastrimin e gjuhës nga elementet greke krijoi kalke nga burimi i gjuhës shqipe p.sh.: fjalëshkëmbimet (dhialloget); çvetëtim (aforizëm); figuradhurim (idholatri); shateshat (themelitë); shënjtëdhëshmor (martir); veselit (themelet); njerimërzitës (misahthropzmit); njeridashës (filanthropik); rregullore (programë); përsydukës (hipokrit) etj.*Shih: G.Ulisch po aty f.42*

Gjithashtu, tek citon A. Xhuvani studiuesja ngre shqetësimin e drejtshkrimimit të disa greqizmeve, pjesë përbërëse të shqipes standarde<sup>3</sup>. A. Xhuvani thotë: duhet me u përdor shkronja **-t-** dhe **-d-** në njësitë leksikore greke si: *simpati* në vend të *simpathi*, *ortografi* < *orthografi*, *ide* në vend të *idhe*, *djftong* < *dhjftong*, *teologjike* < *theologjike*, *estetike* < *esthetike*, *histori* në vend të *istori*, *harmoni* në vend të *armoni*, etj.

Në pjesën e parë të disertacionit Ulich pasqyron në mënyrë të përmbledhur klasifikimin kronologjik të greqizmeve në gjuhën shqipe, përkatësisht në të vjetra dhe mesjetare. Kisha ortodokse greke ka luajtur një rol të rëndësishëm në jug të vendit, kështu disa prej greqizmeve të para fetare që kanë depërtuar në gjuhën shqipe gjatë periudhës bizantine janë: *munështir* < *μοναστήριον*, *putir* < *ποτήρι*, *kallojjer* < *καλόγερος*, *konë* , *korë*, *ikon* < *εικόνα*, *farmëk* < *φάρμακον*, *lajm* < *λάλημα*, *panagjir* < *παναγόρι*, *ajazëm* < *αγιασμός*, *naforë* < *αναφορά*, *fli* < *εὐλογία*).

Ajo ka folur për depërtimin e huazimeve të para të gr. re në dialektin gegë, si p.sh.: *dhomë*, *mellan*, *livadh*, *libonë*, *dhrom*, *rremë*, *stom*, *lango*, *feks*, *argas* etj.<sup>4</sup> Kështu, Ulich ka studiuar përhapjen e fjalëve greke në gjuhën shqipe duke theksuar se huazimet e reja vijnë nga dialektet e Shqipërisë jugore.<sup>5</sup> Por, të larmishme me elemente të gr. re janë dialektet e Çamërisë dhe të Labërisë. Shfaq interes shpërndarja gjeografike e greqizmeve jo vetëm në të folmet jugore të vendit, por edhe në të folmet e minoriteteve arbëreshe në Itali dhe arvanite në Greqi, duke theksuar, se shumë prej këtyre njëjive leksikore nuk përdoren në të folmet e Shqipërisë jugore. Disa prej greqizmeve tipike në të folmet arbëreshe të Italisë janë p.sh.: **adhjasej** “fshij”, **amahje** “luftë”, **angonë** “kënd, qoshe”, **gjtoni** “lagje”, **dhjori** “afat kohor”, **horë** “vend”, **taraks** “dridhem”, **llojas** “mendoj”, **paidhe** “çark, kurth”, **porseks** “kujdesem për dikë”, **pathim** “dhembje, vuajtje”, **karpisur** “i pjekur”, **haraks** “vizoj, mpreh”, **vares** “i mërztur”, **tharros** “guxim” etj. Greqizmat e reja studiuesja i trajton sipas rrugës së tyre të depërtimit në gjuhë, përkatësisht:

a) huazime të drejtpërdrejta, të cilat depërtojnë nga dialektet jugore të vendit: **astrit** < gr. re *ασπίτης* “një lloj gjarpri i verdhë, fig. trim” **dheks** < gr. re *δέχομαι*, *εδεξα* “pranoj, pëlqej, s’ma dheks shpirti, stomaku, s’ma do”. Formë kryesisht e tosk. jugore,

---

<sup>3</sup> G. Ulich, Disertacioni *Elementet e gr së re në gjuhën shqipe*, Laipzig, 1964, f. 32 si dhe A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, f.43

<sup>4</sup> G. Ulich, Disertacioni *Elementet e gr së re në gjuhën shqipe*, Laipzig, 1964, f.36

<sup>5</sup> Në lidhje me çështjen e huazimeve të reja nga dialektet e Shqipërisë jugore, ajo ka cituar një paragraf të marrë nga Menella Totoni: *Hyrja e shumtë e elementëve të gr. së re në gjuhën shqipe vjen si pasojë e pozitës gjeografike dhe historisë së bartësve të kësaj të folme, fesë ortodokse, shkollës greke, marrëdhënieve ekonomike me Janinën etj., mërgimit dhe më në fund fqinjësia me Pogonin.*<sup>5</sup> Po aty, po ajo f.37, referuar M. Totonit, Buletin 1, 1962, f.206

e çamërishtes. **hare** < gr. re χαρά “gëzim”. Fjalë e kolonive arbëreshe të Italisë. Sot përhapur në gjuhën e shkrimit e të literaturës. **metani-a, metanois** < gr. e re μετανοια, μετανωω “pendesë, gjunjëzim kishtar”.

b) huazime greke të tërthorta të ndërmjetësuar nga një gjuhë tjetër p.sh.: turqishtja, serbokroatishtja, italishtja etj. Shembuj të greqizimeve të ndërmjetësuar nga turq. **abanoz** < tk. abanoz < gr. mesme εβενος; **liman** < tk. liman < gr. mes. ολιμην; **temel** < tk. temel < gr. θεμελιον; **fener** < tk. fener < φαναριον; **fital** < tk. fital < gr. re. φυτίλι

c) Greqizma të ndërmjetësuar nga serbokroatishtja kanë depërtuar në gjuhën shqipe nga veriu i Shqipërisë: **kolibe** < skr. koliba < gr. καλύβα; **drum** < skr. drum < gr. δρόμος (rrugë); **livade** < skr. livada < gr. λειβάδι

Në studimin e saj shfaq interes grupimi i greqizimeve, sipas disa fushave të ndryshme leksiko-semantike, duke përfshirë jo vetëm greqizmat e të folmeve jugore të vendit, por edhe ato të folmeve minoritare arbëreshe në Itali dhe në Greqi. Sa më poshtë jemi përpjekur t'i grupojmë ato sipas fushave përkatëse leksiko semantike:

**Njësi leksikore të sferës materiale: apkladhe** “tabaka”, **bastun** “shkop i gjatë me dorezë të kthyer”, **caruqe** “opinga”, **cipura-t** “raki rrushi, bërsi rrushi”, **cohë** “stof leshi”, **dhiqel** “vegël bujqësore me dy dhëmbë hekuri”, **dhisk** “tabaka për të nxjerrë kafën mikut, tabaka për të mbledhur të holla”, **dhogë** “dërrasë”, **dhokan** “çark, kurth”, **dhomë**, **fanar** “fener”, **far** “fener”, **farmak** “helm, hidhërim, pikëllim i madh”, **fidhet** “makarona të holla për supë”, **flamur**, **fole**, **franxhollë** “një lloj buke”, **fustan**, **gliko** “ëmbëlsirë me fruta”, **gunë** “veshje”, **guvë** “shpellë, zgavër”, **haliç** “zall, zhavorr”, **honi** “hinkë, kaush”, **horë** “vend, qytet i madh”, **imonik** “shalqi”, **kaliqe** “nallane”, **kallamar**, **kamare** “vend i hapur në murin e shtëpisë, hapësirë e vogël si dritare” etj.

**Njësi që tregojnë gjendje fizike dhe psikologjike: agoni** “gjendje e rëndë e një njeriu, e pashpresë”, **aguridhe** “një njeri i papjekur, i pamaturuar”, **cuks** “kur diçka të shkakon dhimbje therëse deri në djegie”, **cipë**, **cimbis** “pickoj”, **cimbidh** “cimbis”, **evari** “mirënjohje”, **faqoll** “ngjyrat (njollat) e ndryshme që ka dikush (kryesisht kafshët) në faqe apo në trup”, **fanitet** “shfaqet papritur si hije, si vegim”, **farmakos** “helmoj, pikëlloj”, **feks** “shkëlqen, ndrin”, **firë** “humbje në peshë”, **fundos** “zhys”, **gargaris** “shplaj gojën, nxjerr një zë të veçantë, dërdëllis”, **gramë** “shkrim e këndim, shkollë”, **gremis** “rrëzoj, shëmb përdhe”, **gurgule** “zhurmë e madhe, trazirë”, **handakos** “shkatërroj, prish, dëmtoj”, **hare** “gëzim”, **honeps** “duroj” etj.

**Njësi të botës së gjallesave dhe të bimësisë: afion** “opium”, **aguridhe** “rrush i papjekur”, **argat** “punëtor krahu në bujqësi”, **arkond** “sundues, sundimtar”, **astrit** “lloj gjarpri i verdhë”, **cangadhe** “dhi a dele që ka mbetur pa qingj e pa kec e që e mbajnë për qumësht”, **cironkë** “gjuhçë”, **dafinë**, **dhaskal** “mësues”, **fasule**, **gaforre**, **gamile** “deve”, **glikanxo**, **glistër** “krimb unazor me ngjyrë të mishit, që rron në vende

me lagështi, në pleh; parazit që rron në zorrët e njeriut ose të kafshëve”, **gjeraqinë**, **gjiton** “komshi”, **igumen** “kryemurg”, **jasemin**, **kallam**, **kallamar** “butak deti” etj.

**Njësi të sferës fetare: ajodhimë** “pjesë e kishës ortodokse, ku prifti kryen shërbesat fetare”, **ajazmë** “ujë i bekuar”, **dhespot** “titull fetar në kishën ortodokse ndërmjet priftit dhe mitropolitit, peshkop”, **epitrop** “kujdestar i një kisha ortodokse”, **ikonom** “titulli më i ulët në hierarkin fetare ortodokse, prift i thjeshtë”, **kamillaf**, **llambadhe** “qeri i trashë që ndizet në kishë”, **metani** “pendim, pendesë”, **miro** “vaj i shenjtë, vaj aromatik”, **naforë** “lutje, refeim, relacion”, **petrahil**, **psal** “këndor në kishë”, **psalt** “psaltës, himnizues” etj.

Nëse do të paraqesim me përqindje sipas pjesëve të ligjëratës elementin grek të paraqitur nga G. Ulich (1100 njësi leksikore) në gjuhën shqipe rezulton se: 73.8% të huazimeve në gjuhën shqipe janë emra; 21.5% janë folje dhe 3.5% mbiemra.

Nga 1100 njësi leksikore të sjella nga Ulich përafërsisht 40% e tyre janë të përfshira në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të 1980-s<sup>6</sup>.

## Emri

Emrat në gjuhën greke, ashtu sikurse në gjuhën shqipe kanë tri gjini (mash., fem. dhe asnj.). Emrat e huazuar nga gr. në gjuhën shqipe kanë ruajtur gjininë përkatëse mashkullore ose femërore. Ndërsa, emrat grekë të gjinisë asnjëse kanë kaluar në gjuhën shqipe në gjininë mashkullore ose femërore, për shkak të rrudhjes së kësaj gjinie në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe ashtu sikurse në gjuhët e tjera të Gadishullit Ballkanik nyja i prapavendoset emrit, ndërsa në gr. e re nyja i paravendoset emrit.<sup>7</sup>

**ngr. o** γατρός > jatro-i “mjek”

**ngr. η** καλογρία > kallogre-ja “murgeshë ortodokse”

**ngr. το** δοκάνι > dhokan-i “kurth”

Emrat grekë në gjuhën shqipe janë huazuar nga trajta e pashquar e tyre, ose më saktë, gjuha shqipe ka huazuar rrënjën e fjalës (temën). Në këtë pikë shquarsia e emrave të huazuar grekë bëhet sipas rregullave përkatëse të gramatikës së gjuhës shqipe p.sh. ο γείτον-ας (o gjiton/as) > gjitón-i “komshi-u”; η δάφν-η (i dhafn/i) > dafinë-a; η αγρέλ-ια (i agrel/ia) > egërle-ja;

---

<sup>6</sup> Shihni në fund të punimit listën e greqizmeve të pranishme në gjuhën shqipe standarde të evidentuara nga punimi i G. Ulich-it

<sup>7</sup> E. Banfi, “Linguistica Balcanica”, 3.6.2. Postposizione dell’ articolo, f.64/65

## Folja

Sistemi foljor i gjuhës shqipe është mjaft i larmishëm me huazimin e foljeve dhe të prapashtesave nga gjuha greke. Si në gjuhët e tjera ballkanike dhe në gjuhën shqipe foljet dhe prapashtesat greke janë huazuar nga aoristi (koha e kryer e thjeshtë). Foljet përfundojnë me bashkëtingëllore dhe i përkasin zgjedhimit të dytë p.sh.: **shq.-is < gr. ισ(α), -ησ(α) cimbis** “pickoj” < gr.re τσιμπώ, τσιμπησα (cibo, cimbisa); **ormis** “përgatis, stolis” < ὀρμησα, ὀρμώ (ormo, ormisa); **shq. -es < gr. -εσ(α) ngales** “denoncoj” < gr.re εγκάλω, εγκάλεσα (engalo); **parkales** “lutem” < gr.re παρακαλώ, παρακάλεσα (parakalo, parakalesa); **shq.-as < gr. -ασ(α) djavás / dhjavas** “lexoj” < gr. mes. ose e re διαβάζω, διάβασα (dhiavazo, dhiavasa) **anangas/em** “ngacmoj” < gr.re αναγάζω, ανάγασα (anangazo, anangasa); **shq.-eps < gr. -εψ(α) zileps/enj** “kam zili” < gr.re ζήλευω, ζήλεψα (zilevo, zilepsa); **shq. ps < gr. -ψ-** (Foljet me -ψ- në greqisht vijnë nga shkrija e fundores së temës së foljes π me σ, e aoristit sigmatik ε-λειπ-σ-α)

**lips, lipsem** “nuk jam i pranishëm, mungoj” < gr.re έλειψα, λειπω (elipsa, lipo)  
**llamps** “shkëlqej, ndriçoj” < gr.re έλαμψα, λάμπω (elampsa, lambpo)

**perifaneps** “krenohem, mburrem, lëndohem” < gr.re υπερηφανεύομαι, υπερηφανέψ- (iperifaneps)

**shq. ks < gr. -ξ-**

**dhidhaks** “mësoj dike” < gr.re διδάξα, διδάσκω (dhidhaksa, dhidhasko)

**feks** “ndriçoj” < gr.re έφεξα, φέγω (efeksa, fego)

**cuks** “më djeg lëkura, syri” < gr.re έτσουξα, τσουζω (ecuksa, cuzo)

**shq.-aks < gr. -αξ(α)**

**taks** “premtoj” < gr. e re τάσσω, έταξα (tazo, etaksa);

**tromaks** “tremb” < τρομάξα, τρομάζω (tromazo, tromaksa);

**shq.-os < gr. -ωσα**

**farmakos** “helmoj” < gr. e re ose mes. φαρμακώνω, φαρμάκωσα (farmakovo, farmakosa);

**fanaros-em** “tregoj, kallëzoj, shfaq” < gr. e re φαναρώνω, φανάρωσα (fanarono, fanarosa)

Pothuajse, të gjitha foljet e huazuara në gjuhën shqipe nga greqishtja kanë hyrë si huazime gjuhësore, d.m.th., si sinonime, në dallim nga emrat e huazuar, që jo të gjithë kanë hyrë si huazime gjuhësore, sepse siç dihet në fushën e teknikës e të kulturës bashkë me emrin ka hyrë dhe objekti. Vet fakti se ekziston sinonimi asnjans i tyre, ndonëse nuk shfaqet në tekst, krijon kundërvënie në mungesë dhe rrjedhimisht ato janë të ngjyrosura stilistikisht p.sh.: *dbeks/pranoj; boneps/pëlqej; kopanis/rrah; cimbis/pickoj; karfos/ngul; llabataris/friksoj; ormis/rregulloj; kumbis/mbështes; pleks/ngatërroj; stis/ngre; mbodbis/pengoj; gremis/rrëzgj.*

Si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke folja përfaqësohet me vetën e parë, njëjës. Infiniti është zhdukur nga gjuhët ballkanike vetëm në gr. e re, në bullgarisht dhe në maqedonisht, ndërsa në gjuhën shqipe ka një përdorim të kufizuar. Në dialektin e



gegërishtes infiniti ka përdorim normal, ndërkohë që është tërësishtë i panjohur në dialektet toskë. Në gjuhën greke humbja e infinitit ka filluar nga shek. XI<sup>8</sup>

### Zhvillime semantike të fjalëve me prejardhje nga greqishtja

Në veçoritë e përgjithshme të gjuhës, si organizëm i gjallë, që zhvillohet, pasurohet, lëvizja kuptimore përbën një nga dukuritë më të rëndësishme. Sipas *“Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, mbi 50% e fjalëve kanë më shumë se një kuptim, d.m.th. janë polisemantike.<sup>9</sup> Një nga lëvizjet semantike më të rëndësishme është cilësuar prejardhja e kuptimeve. Fjalët që kanë vetëm një kuptim janë të rralla. Çdo fjalë ka një kuptim fillestar me të cilin ka hyrë në përdorim. Prej këtej, me kohën, ka dalë një kuptim tjetër, i cili ndaj kuptimit fillestar është i prejardhur. Pra, kuptimi i dytë shpjegohet me të parin. Pra, me prejardhje semantike lind një njësi e re semantike nga një njësi semantike e njohur p.sh. **karfos kal.** **1.** *kap me karficë një petk, disa letra etj;* **2.** *qep rrallë me pe;* **3.** *e kap dikë prej fyti, në puq, ngjit, mbyll mirë;* **4.** *e nënshtrijë dikë, e bëj të bindet, e vë poshtë, i marr mendjen*

**Greqizma që nuk kanë depërtuar me të gjitha kuptimet mbartëse në gjuhën greke, duke përfshirë këtu dhe ato figurative: pleks** < gr. re πλέκω, ἐπλεξα “thur, fig. thur lavde” > në shq. “1. thur, gërshejoj; 2. thur, ngatërroj dikë në një çështje” **nome** < gr. re η νομή “1. kullotë; 2. drejt. zotërim, shfrytëzimi i diçkaje të huaj; 3. ushqim për kafshët, foragjere” > në shq. “vend i mbrojtur nga era, ku pushon ose kullot bagëtia, kullotë, vathë”, kuptimi në fushën e drejt. që mbart fjala nome në gjuhën greke nuk është përcjellë në gjuhën shqipe, njëkohësisht kemi zhvendosje kuptimi, sepse nga “kullotë” në gjuhën greke “në vend ku kullot bagëtia” në gjuhën shqipe.

**Greqizma që në gjuhën shqipe janë zgjeruar semantikisht: aguridhe** < gr. re η αγουρίδα “rrush i papjekur” > në gj.shqipe është zhvilluar semantikisht “fig. vajzë apo djalë i papjekur, pa përvojë në jetë”

**feks** < gr. re φέγω, ἐφεξα “ndriçoj, i bëj dritë, lëshoj dritë” > në shq. “shkëlqen, llamburit, ndriçon, gdhin” zhvillime të tjera semantike “1. e pastroj diçka me të fërkuar deri sa të ndrisë e të shkëlqejë; 2. duket e shfaqet menjëherë diçka, bie menjëherë në sy, më vjen në mendje diçka; 3. fig. bised. ia arrin qëllimit, ia del në krye; 4. bised. e qëlloj me forcë dikë me pëllëmbë”

**Njësi leksikore të huazuara nga greqishtja, që në gjuhën shqipe kanë pësuar zhvendosje semantike: skile** < gr. re ο σκύλος, η συλα “qen, peshkaqen” > në shq. “1. dhelprë; 2. njeri dinak” **gone** < gr. re η γωνία “1. vatër kulture; 2. kënd; 3.

---

<sup>8</sup> E. Banfi, “Linguistica Balcanica”, 3.6.2. Postposizione dell’ articolo, f.58/59

<sup>9</sup> J.Thomai ‘Leksikologjia e gjuhës shqipe’; Lëvizja kuptimore, f. 82-83. Botimet Dudaj, 2005.

cep” > në shq. “tek. vegël e muratorit në trajtimin e një këndi të drejtë” **lingua-oi** < gr. re o λαγός “lepur” > në shq. “1. qen me trup të zhdërvjelltë, zagar; 2. fig. njeri i shkathët e i mprehtë, që i nuhat shpejt gjërat”

**Greqizma me të njëjtin zhvillim semantik ashtu sikurse dhe në gjuhën greke: aplladhe** “tabaka” < gr. re η απλάδα **dhiozëm** “mendër, nenexhik” < gr. re ο δούσμος, **fidhe-t** “makarona të holla për supë” < gr. re ο φιδές **dhokan** “çark, kurth” < gr. re το δόκανο

Shumica e greqizmeve kanë formuar strukturë polisemantike, ato janë zgjeruar/ndryshuar semantikisht qoftë me apo pa ndajshitesa, duke e zgjeruar kuptimin fillestar të temës së fjalës ose duke i dhënë njësisë leksikore një kuptim të ri e shpeshherë duke e veshur njëkohësisht njësinë leksikore me ngjyresa/ngarkesa semantike përkatëse. Kështu për të krijuar një fjalë të re duhet të nisemi nga një temë fjalëformuese p.sh.: **dhjak-onar**; dhe për të lindur një kuptim i ri, duhet të kemi një temë semantike d.m.th një kuptim të mëparshëm (**dhjak-u** < gr. re ο διάκος m. 1. *titull fetar në kishën ortodokse, grada më e ulët fetare në këtë kishë; ai që mbante këtë gradë e këtë titull, ndihmës i priftit në kryerjen e shërbesave fetare (në vendet ku vepron feja ortodokse, në të kaluarën edhe në Shqipëri; 2. **dhjak +** (prapashtesën e shqipes) **onar** 1. *njeri që kërkon ta kalojë jetën pa punuar duke mbledhur lëmosha nga të tjerët, ai që jeton në kurriç të tjerëve pa punuar; 2. njeri dinak, i pabesë e shpirtkeq).**

Pra, nga elementi i huazuar i greqishtes në gjuhën shqipe kemi zhvillim/ndryshim të kuptimit nga **dhjak** > **dhjak – onar**, me ndajshitesën **–onar**. Zhvillimi kuptimor i fjalës nga **dhjak** në **dhjakonar** është pasuar me ngjyresë kuptimore negative (*sepse nga titull fetar në kishën ortodokse (fjala e huazuar greke në gjuhën shqipe)* > në *njeri që kërkon të kalojë jetën pa punuar duke mbledhur lëmosha nga të tjerët*). **dhaskal-i** < gr. re ο δάσκαλος “mësues” me ngarkesë asnjane, ka kaluar në gjuhën shqipe me ngjyresë negative “*mësues që ka njohuri fare të pakta e që është i paaftë, mësues që nuk di t’i mësojë e t’i edukojë nxënësit*”. Pra, kemi zhvillim/zgjerim semantik me ngarkesë negative nga dhaskal “mësues” në gjuhën greke në dhaskal “mësues i paaftë” në gjuhën shqipe.

Tema semantike dhe fjalëformuese **kurm** ka formuar strukturën kuptimore të mëposhtme duke u zhvilluar/zgjeruar kuptimisht: 1. *trungu i trupit të njeriut; 2. kurriçi sidomos i shpendëve; thellë nga pjesa e kurriçit; 3. trungu i një druri* > **kurm +** prapashtesën e shq. **ëzo-j** 4. *shtrëmboj ose përkuul trupin a kurriçin (nga një dhembje etj).* kurm > **kurm +** prapashtesën e shq. **o-j** (*ndaj diçka në disa copa ose në disa thela, e ndaj kurma-kurma*).

Shtresa emocionuese e leksikut përfshin njësi me ngjyrim emocionues pozitiv ose negativ; këto njësi, përveç vlerës shënuese kanë dhe një element të mbishtresuar, ngjyrim emocionues.

**Njësi leksikore me ngjyrim emocionues negativ: honeps:** Kjo fjalë ashtu sikurse dhe në gjuhën greke Δέν μου το χωνεύει το στομάχι (Dhen mu to honevi to stomachi) “nuk ma tret stomaku”; Δέν τον χωνεύω (Dhen ton honevo) “nuk e duroj dot”

ka depërtuar në gjuhën shqipe me ngjyresë negative, si në kuptimin e parë ashtu edhe në kuptimin e dytë të figurshëm.

Kuptimi i parë: *tret, bluaj për ushqime. Nuk i boneps fasulet. Nuk ma boneps stomaku.* Kuptimi i dytë i figurshëm: *pëlqej, duroj, pranoj.* Kjo fjalë shoqërohet nga pjesëza mohuese nuk: *Nuk e boneps dot kur vjen e qahet si gjynafqare.* FGJSH '80, f. 691

**psonis** “gjej, kërkoj. Në gjuhën shqipe ka marrë ngjyrim emocionues negativ *Ku vajte dhe e psonise atë djalë!*“ FGJSH '80, f. 1564 < gr.re ψωνίζω –σω në gjuhën greke ka kuptim asnjans “bëj pazarin”.

Gjithashtu, njësia leksikore greke **porropi-a** “mbrapshti, e keqe; prishje e shkatërrime; rrokullimë, greminë; arrati” në gjuhën shqipe ka marrë ngjyrim emocionues negativ *U lyri porropia. Mori porropinë. I dha vajzës porropinë.* (E martoi larg)” FGJSH '80, f. 1522 < gr. re ροπή “prirje (dëshirë, aftësi e natyrshme për diçka), tendencë”.

**Fjalë me ngjyrim emocionues pozitiv: sihariq** / συγχαριαια: *lajm i mirë dhe i gëzuar: Dhamë sihariqin e fitores. Po sihariqet e kishës i keni marrë vesh?* FGJSH '80, f. 1751

**sqimë-a** / το σχημα: *njeri i veshur me sqimë.* Ngjyresa tjetër kuptimore e kësaj fjale në gj. shq. është *teka, naze* p.sh.: *Plot buqe e naze.* FGJSH '80, f. 1785

Tek fjalët greke të shqipes ngjyrimi emocionues pozitiv apo negativ mund të veçohet nga kuptimi leksikor, sepse ky ngjyrim është bërë më vonë gjatë përdorimit të figurshëm të fjalëve. Pjesa më e madhe e greqizimeve në gjuhën shqipe i përkasin kësaj kategorie. Pra, me sa shohim nga ato pak shembuj të shfaqura më lartë më e pasur është rruga e përdorimit të figurshëm të fjalëve, veçanërisht, nëpërmjet metaforës gjuhësore (kur emërtimin e diçkaje e përdorim për diçka tjetër, sipas një tipari të përbashkët) p.sh. **skile** (*dhelpër, me kuptimin e figurshëm dinak, i pabesë etj*); **aguridhe-ja** (*rrush i papjekur, me kuptimin e figurshëm i papjekur, pa përvojë në jetë*) etj. Nga ngjyrimi emocionues që mori fjala skile (dhelpër) u zhvillua kuptimi i figurshëm “diank, i pabesë”, i cili u bë temë semantike prodhuese për kuptimin e fjalëve të prejardhura prej saj p.sh.: *skile > skileri-a; kope > koperi-a; çuçuris > çuçurjar-i (formuar me ngjyresë negative); dhaskal > dhaskallicë, dhaskaleshë; sqimë > sqimatar; sihariq > sihariqtar, i/e sihariqtë; nikoqir > nikoqir/e-ja, nikoqirllëk-u; kope > koperi-a; kusar > kusari-a.*

Duke e ndarë leksikon arrijmë të dallojmë edhe një kundërvënie ndërmjet fjalëve asnjansë dhe fjalëve me ngjyrim emocionues edhe pse tiparet shënuese janë të afërta, sinonime.<sup>10</sup> Nga sa më lart, kuptohet, që për t’i dhënë ligjëritim bukuri e shprehësi më të lartë, duhet t’i zgjedhim mirë fjalët, si ato të shtresës asnjansë, ashtu edhe ato të shtresës emocionuese.

---

<sup>10</sup> J.Thomai, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Akademia e Shkencave të RPS. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shkalla e shndërrimeve kuptimore e, f.104-105, Tiranë 1989.

## Greqizma të vjela nga disertacioni i G.Ulisch, të depërtuara në standardin e gjuhës shqipe

**afendiko-i**, FGJSH '80, f. 7. < gr. re ο αφεντικός

**afion-i**, FGJSH '80, f. 8. < gr. re το αφιονόν "fj. e huaj hashash, opium"

**agoni-a**, FGJSH '80, f. 11. < gr. re η αγωνία "ankth, të dhënit shpirt"

**aguridhe-ja**, FGJSH '80, f. 12. < gr. re η αγουρίδα "rrush i papjekur"

**ajazmë-a**, FGJSH '80, f. 14. < gr. biz. ο αγιασμός "bekim"

**ajodhimë-a**, FGJSH '80, f. 16. < gr. re το αγιοβήμα "hierore, kungë"

**akoma**, FGJSH '80, f. 17. < gr. re ακόμα "ende"

**alisivë-a**, FGJSH '80, f. 24. < gr. re η αλισίβα, me burim prej it. "fj. e huaj finjë"

**amin**, f. 29. < Ka dy rrugë: nga gr. re (e mesme) αμήν, nga turq.amin "fj. e huaj fet. ashtu qoftë"

**anames**, FGJSH '80, f. 31. < gr. re ανάμεσα "midis, në mes"

**anangas**, FGJSH '80, f. 31. < gr. re αναγκάζω, ανάγκασω/ω "detyroj"

**angari-a**, FGJSH '80, f. 35. < prej turq., kjo prej gr. re η αγγάρεια "fj. e huaj: punë e detyruar"

**aplladhe-ja**, FGJSH '80, f. 42. < gr. re η απλάδα "tabaka"

**aradhe-ja**, FGJSH '80, f. 44. < gr. re η αράδα "rresht, radhë, varg"

**argas-em**, FGJSH '80, f. 47. < gr. re αργάζω, άργασω "regj, argas lëkurët, zhdëp në dru, rrah fort"

**argat-i**, FGJSH '80, f. 47. < Huazim i dyfishtë: Pjesërisht drejtpërdrejt nga

gr. re ose e mesme ο αργάτης, pjesërisht prej turq. "punëtor krahu në bujqësi"

**argjilë-a**, FGJSH '80, f. 48. < gr. re η αργίλλα "argjilë, deltinë, botë"

**arkond-i**, FGJSH '80, f. 50. < gr. re ο άρχοντας "sundues, sundimtar, kryezot"

**armatos**, FGJSH '80, f. 51. < gr. re αρμάτωνω,αρμάτωσ/ω "pajis me armë; fig. pajis me njohuri me dije, stolis, zbukuroj"

**aromë-a**, FGJSH '80, f. 54. < Burim i dyfishtë: Në tosk. popullore nga gr. re η αρώμα.

**astrit-i**, FGJSH '80, f. 64. < gr. re ο αστροίτης "gjarpër, nëpërkë fig. njeri shumë i shkathët"

**barbun-i**, FGJSH '80, f. 100. < gr. το μπαρμπούνι "fj. e huaj: një lloj peshk deti"

**bastun-i**, FGJSH '80, f. 109. < gr. το μπαστούνι.

**burbuqe-ja**, FGJSH '80, f. 198. < gr. re το μπουρμπούνι, μπουρμπούνια "gonxhe"

**cangadhe-ja**, FGJSH '80, f. 213. < gr. re η τσαγγάδα.

**caruqe-ja**, FGJSH '80, f. 214. < Fjalë e truq., ndërmjetësuar nga gr. biz. τα τσαρούχια "opinga"

**cergë-a**, FGJSH '80, f. 219. < gr. re η τσέργα "fj. e huaj: lloj mbulesë e ashpër"

**cefël-a**, FGJSH '80, f. 214. < gr. re το τέφλοι.

**cikmë-a**, FGJSH '80, f. 222. < Me burim nga turq. çenk, ndërmjetësuar nga gr. re η τσίικμα.

**ciknë-a**, **ciknos**, FGJSH '80, f. 222. < ndërmjetësuar gr. re η τσίικνα me burim të huaj "zë ciknë gjella"

**cimbidh**, FGJSH '80, f. 224. < gr. re το τσιικπιδι "mash për zjarr"

**cimbis-em**, FGJSH '80, f. 224. < gr. re τσιικπώ, τσιικπησ/ω "pickoj, fig. τσιικπήθηικε "dashurohem"

**cingëris**, FGJSH '80, f. 225. < gr. re τσιικγριζω, τσιικγρισ/ω "nguc, shpoj, ngacmoj, shkrej zjarrin me mash"

**cipë-a**, FGJSH '80, f. 227. < gr. re η τσιικπα "cipë e hollë e qumështit, fig. namus, turp άνθρωπος χώρικ τσιικπα "njeri pa cipë"

**cipura-t**, FGJSH '80, f. 227. < gr. re το τσιικπούρο "fj. e huaj: raki rrushi, bërsi rrushi"

**cironkë-a**, FGJSH '80, f. 228. < gr. re ο τσιικρος. Burimi i dyshimtë "cirua, gjuhçë, fig. ειικνε τσιικρος 'u bë cironkë, u dobësua shumë"

**cohë-a**, FGJSH '80, f. 230. < Me burim nga turq. coha, ndërmjetësuar nga gr. re η τσόχα "fj. e huaj: stof leshi, fig. dinak, batakçi, ειικναι μιια τσόχα" është një dinak, një batakçi"

**cuks**, FGJSH '80, f. 233. < gr. re τσιικσουζω, έτσιικσουζι/ω "shkakton dhembje therëse si nga djegia, fig. prek dikë, plagos moralisht p.sh.: τα λόγια σου έτσιικσουζαν "fjalët e tua e prekën e përcëlluan", το τσιικσουζει "për një person qe pi pije alkoolike"

**dafinë-a**, FGJSH '80, f. 283. < Trajta dhafën drejtpërdrejt prej gr. re δάφνη, forma me d-dafinë prej lat. popullore daphine "fitore, nder e lavdi"

**dyfek-u**, FGJSH '80, f. 390. < gr. re το ντουφέικι.

**dhaskal-i**, FGJSH '80, f. 399. < gr. re ο δάσικαλος "mësues"

**dhespot-i**, FGJSH '80, f. 402. < gr. re ο δεσπότης "despot, tiran, fet. dhespot, peshkop, metropolit"

**dhiqel-i**, FGJSH '80, f. 407. < etimologji dyfishe. Forma me d- nga turq., ajo me dh- nga gr. το διικέλλι "bujq. diqel, vangë"

**dhisk-u**, f FGJSH '80, q.407. < Trajta me d- prej it. disco, ajo me dh- prej gr. bizantine, mesjetare ο δισκος "disk, hedhja e diskut, disku i biçikletës, tabaka, fig. fushatë ndihme"

**dhogë-a**, FGJSH '80, f. 410. < nga gr. re η δόγα, kjo nga it. doga.

**dhokan-i**, FGJSH '80, f. 410. < gr. re το δόικανο "çark, kurth"

**dhomë-a**, FGJSH '80, f. 410. < gr. e mes. το δώμα.

**dhrahmi-a**, FGJSH '80, f. 411. < gr. re η δραχμή.

**epitrop-i**, FGJSH '80, f. 432. < gr. re ο επιτροπος "peshkop, dhespot"

**evari-a**, FGJSH '80, f. 439. < gr. re η ευχαριστια "mirënjohje"

**evgjit-i**, FGJSH '80, f. 439. < gr. re ο αιγύφτιος nga gr. vj. αιγυφτιος "egjiptian"

**fanar-i**, FGJSH '80, f. 449. < gr. re το φανάρι "fener"

**fanitet, -em**, FGJSH '80, f. 449. < gr. re φαν/ερώνω + it. "zbuloj, tregoj, kallëzoj, nxjerr një të fshehtë, shfaq"

**faqoll-e**, FGJSH '80, f. 452. < Elementi latin depërtuar nëpërmes gr.

meseme ose të resë το φακίδι “shami koke, rubë, çember”

**far-i**, FGJSH '80, f. 452. < gr. ο φάρος “fener”

**farmak-u**, FGJSH '80, f. 455. < gr. re το φαρμάκι “helm, shumë e hidhur”.

**farmakos, -em**, FGJSH '80, f. 456. < gr. re φαρμακίωνω, φαρμάκωσ/ω “helmoj, pikëlloj, fig. hidhëroj shumë”.

**fasule-ja**, FGJSH '80, f. 456. < gr. re το φασούλι. Fjalë me etimologji dy apo shumëfishe.

**feks**, FGJSH '80, f. 460. < gr. re φέγω, έφεζω “ndriçoj, bëj dritë, agon dita, gdhin”

**fidhe-të**, FGJSH '80, f. 467. < gr. re ο φιδές “makarona të holla për supë”

**firë-a**, FGJSH '80, f. 474. < gr. re η φύρα “firë, firo, fig. llum i shoqërisë”

**flamur-i**, FGJSH '80, f. 484. < gr. biz. το φλαμούρι.

**fole-ja**, FGJSH '80, f. 492. < gr. re η φωλία “strofkë, strofull, fole, fig. strofkë keqbërsisht”

**franxhollë-a**, FGJSH '80, f. 501. < Forma me -x- nga gr. re η φραντζόλα, ndërsa ajo me -xh- nga turq.

**fund-i**, FGJSH '80, f. 515. < gr. re φούντα “fj. huaj xhufkë, xhufka e festes”

**fundos**, FGJSH '80, f. 517. < gr. re φουντώνω, -ωσω.

**fustan-i**, FGJSH '80, f. 520. < gr. το φουστάνι.

**gaforre-ja**, FGJSH '80, f. 530. < gr. re κάβουρας, καβουρι, nga gr. vjetër.

gajas, FGJSH '80, f. 530. < gr. re

**gamile-ja**, FGJSH '80, f. 533. < gr. re η καμήλα “deve”

**gargaris, -it**, FGJSH '80, f. 535. < gr. γαργαρίζω, γαργάρισ/ω “gudulis,

bised. kilikos, giciloj fig. τον γαργαλίσε η προικα της = e kilikosi, e joshi prika e saj”

**gargarë-a**, FGJSH '80, f. 535. < gr. η γαργάρα.

**glikanxo-ja**, FGJSH '80, f. 555. < gr. re το γλυκάνισμο “anason”

**gliko-ja**, FGJSH '80, f. 555. < gr. re το γλυκό “gliko rrushi, gliko portokalli etj”

**glistër-ra**, FGJSH '80, f. 555. < gr. η γλιστρία “shkarje, rrëshqitje”

**gone-ja**, FGJSH '80, f. 565. < gr. re η γωνία “vatër kulture, kënd, cep”

**grafi-a**, FGJSH '80, f. 568. < gr. το γραφείο “zyrë, byro”

**gramë-a**, FGJSH '80, f. 569. < gr. re το γράμμα “shkronjë, letër, fet. librat e shenjtë”

**gremis**, FGJSH '80, f. 572. < gr. re γρεμνίζω “rrëzoj, shemb përdhe, rrëno, fig. zhdruk”

**gunë-a**, FGJSH '80, f. 588. < gr. mes. η γούνα.

**gurgule-ja**, FGJSH '80, f. 591. < e afërt me gr. re γουργουρίζω “trazirë, zhurmë”

**guvë-a**, FGJSH '80, f. 594. < gr. re η γούβα “shpellë, zgavër”

**gjeraqinë-a**, FGJSH '80, f. 612. < prej gr. re το γεράκι, nga gr. vjetër “fajkua, skifter”

**gjiton-i**, FGJSH '80, f. 621. < gr. re ο γείτονας “fqinjë-a, komshi/-u, -ja”

**haliç-i**, FGJSH '80, f. 643. < gr. vj. το χαλίσι “zall, zhavorr”

**handakos**, FGJSH '80, f. 646. < gr. χαντικώνω, χάντικωσ/ω “shkatërroj, prish, dëmtoj”

**hare-ja**, FGJSH '80, f. 653. < gr. re η χαρά “gëzim”

**hon-i**, FGJSH '80, f. 691. < gr. re η χωνί “hinkë, kaush”

**honeps**, FGJSH '80, f. 691. < gr. χωνεύω, χώνεψ/ω "shkri, shkri metalet, tres ushqimim, δέν το χωνεύω = s'e honeps dot atë, nuk e pëlqej"  
**horë-a**, FGJSH '80, f. 692. < gr. re η χώρα "vend, qytet i madh, pjesë e trupit të njeriut"  
**hutin-i**, FGJSH '80, f. 704. < gr. το χουτίνι.  
**ide-ja**, FGJSH '80, f. 707. < gr. re η ιδέα.  
**idhull-i**, FGJSH '80, f. 710. < Forma me dh- nga gr. re το είδωλον, ajo nga it.idol.  
**igrasi-a**, FGJSH '80, f. 710. < gr. re η υγρασία "lagështi"  
**igumen-i**, FGJSH '80, f. 710. < gr. re ο ηγούμενος "igumen, kryemurg"  
**ikonom-i**, FGJSH '80, f. 711. < gr. re ο οικονόμος "ekonom, ai që merret me punët e ekonomatit, fet. titull nderi, ekonom; usht. intendent; kursimtar, ekonomiqar"  
**imonik-u**, FGJSH '80, f. 715. < gr. re το χειμωνικό "shalqi"  
**jasemin-i**, FGJSH '80, f. 738. < gr. re γιασεμί.  
**kafkë-a**, FGJSH '80, f. 758. < gr. mes. καύκαλον  
**kaliqe-ja**, FGJSH '80, f. 765. < prej gr. re τα καλικά, kjo nga lat. calina  
**kallam-i**, FGJSH '80, f. 770. < gr. το καλάμι "1. kallam, 2. masur për penj, 3. kërciri i këmbës"  
**kallamar-i**, FGJSH '80, f. 765. < gr. re το καλαμάρι.  
**kallamboq-i**, FGJSH '80, f. 770. < gr. re το καλαμπόκι "miser"  
**kallame-ja**, FGJSH '80, f. 770. < gr. re η καλαμιά "kallame, kallamishte"  
**kallamidhe-ja**, f. 770. < gr. re καλαμιδι "vegël peshkimi"

**kallogre-ja**, FGJSH '80, f. 773. < gr. re η καλογρία.  
**kamare-ja**, FGJSH '80, f. 775. < gr. re η καμάρα "qemer, harku i këmbës, i shputës"  
**kamillaf-i**, FGJSH '80, f. 776. < gr. re το καμηλάκι.  
**kanat-i**, FGJSH '80, f. 778. < gr. η κανάτα "fj.huaj; kanat i dritare, kanë (me ujë)".  
**kandil-i**, FGJSH '80, f. 779. < gr. re ose e mes. καντήλα, το καντήλι, kjo prej lat. kandela "kandil me vajgur".  
**kanisk-u**, FGJSH '80, f. 780. < gr. re το κανίσι "etnograf. kanisk πηγαίαν στο γαμό με κανίσι = në dasmë shkonin me kanisk".  
**kanistër-ra**, FGJSH '80, f. 780. < gr. re η κανίστρα.  
**kapar-i**, FGJSH '80, f. 782. < gr. re το καπάρι.  
**kaparos**, FGJSH '80, f. 783. < gr. καπαρώνω, καπάρωσ/ω.  
**karavidhe-ja**, FGJSH '80, f. 790. < gr. re η καρραβίδα.  
**karfos-em**, FGJSH '80, f. 791. < gr. re καρρώνω, -ωσω "mbërthej, gozhdoj, ngul"  
**karvanar-i**, FGJSH '80, f. 793. < gr. ο καρβουνάρης "qymyrtar, qymyrbërës, qymyrxhi"  
**katandis**, FGJSH '80, f. 797. < gr. re καταντώ, -ησω.  
**katua, katoq**, FGJSH '80, f. 802. < gr. re το κατώγι.  
**kofin-i**, FGJSH '80, f. 839. < gr. re το κοφίνι.  
**kokallë-a**, FGJSH '80, f. 841. < gr. το κόκαλο "kockë"  
**kolit-is**, FGJSH '80, f. 849. < gr. re κολλώ, κολλησ/ω

“ngjis”

**komb-i**, FGJSH '80, f. 852. < gr. re o κόμπος “nyje e një litari, fill, pike”

**kollare-ja**, FGJSH '80, f. 851. < gr. re το κολλάρο.

**konizëm-ma**, FGJSH '80, f. 860. < gr. το εικονισμα “ikonë, pikturë, tablo”

**kopan-i**, FGJSH '80, f. 866. < gr. re το κοπάνο “kopan, shtypësi i havanit, fig. njeri i trashë, i pagdhendur”

**kopanis**, FGJSH '80, f. 866. < gr. κοπανίζω, -ισω “rrah me kopan, shtyp me havan, fig.rrah, qortoj”

**kope-ja**, FGJSH '80, f. 866. < gr. re η κόπια.

**kremastar-i**, FGJSH '80, f. 882. < gr. re το κρεμαστάρι “varëse rrobash”

**krevat-i**, FGJSH '80, f. 884. < gr. re το κρεβάτι.

**ksestër-ra**, FGJSH '80, f. 899. < nga gr. re ζέστη “i gdhendur, i latuar”, gr. mesme ζεση, kjo prej lat. sextarius.

**kufomë-a**, FGJSH '80, f. 905. < gr. re το κούφωμα.

**kukudh-i**, FGJSH '80, f. 907. < gr. re το κουκούδι.

**kukull-a**, FGJSH '80, f. 907. < gr. η κούκλα.

**kukuvajkë-a**, FGJSH '80, f. 907. < gr. η κουκουβάγια + kë.

**kunadhe-ja**, FGJSH '80, f. 913. < gr. re το κουνάδι “shqarth”

**kunel-i**, FGJSH '80, f. 917. < gr. το κουνέλι “lepur i butë”

**kusar-i**, FGJSH '80, f. 927. < gr. re o κουρσάρος “pirat, kusar”, kjo nga lat. mesme cursarius.

**kuvli-a**, FGJSH '80, f. 931. < gr. re το κλουβί “kafaz”

**laik-e**, FGJSH '80, f. 937. < gr. λαϊκός “popullor”

**lingua-oi**, FGJSH '80, f. 944. < gr. re ο λαγός “lepur”

**lastar-i**, FGJSH '80, f. 953. < gr. re το βλαστάρι.

**lavos**, FGJSH '80, f. 956. < gr. re λαβώνω, λάβωσ/ω “plagos”

**lavomë-a**, FGJSH '80, f. 956. < gr. το λάβωμα “plagosje, lavomë”

**lips-em**, FGJSH '80, f. 1003. < gr. re λείπω, έλειψ/ω “mungoj”

**litani-a**, FGJSH '80, f. 1008. < gr. η λειτανία.

**liturgji-a**, FGJSH '80, f. 1008. < gr. re η λειτουργία.

**llahtari-a**, FGJSH '80, f. 1034. < gr. re η λαχτάρα “dëshirë e zjarrtë, mall, padurim”

**llahtaris-em**, FGJSH '80, f. 1034. < gr. re λαχταρίζω “dëshiroj me plot zjarr, me plot passion”.

**llambadhe-ja**, FGJSH '80, f. 1035. < gr. re η λαμπάδα “llambadhe-ja, fig.έχει κορμι λαμπάδα = ka trup të hedhur”

**llamburit-is**, FGJSH '80, f. 1035. < gr. λαμπυρίζω, λαμπύρισ/ω “ndrit, shkëlqen, vezullon”

**llangos-i**, FGJSH '80, f. 1035. < gr. ο λαγός “lepur”

**llauz-i**, FGJSH '80, f. 1035. < gr. laus/λαός, λαούς “popull”

**magjeps-em**, FGJSH '80, f. 1047. < gr. μαγεύω, μάγεψ/ω “magjeps, josh e mahnitë dike”

**martir-i**, FGJSH '80, f. 1060. < gr. re ο μάρτυρας, το μαρτυρίο.

**marule-ja**, FGJSH '80, f. 1060. < gr. re το μαρούλι, kjo prej lat.

**mballomë-a**, FGJSH '80, f. 1076. < gr. re το μπάλλωμα “arnë”

**mballos**, FGJSH '80, f. 1076. < gr. μπαλλώνω, μπάλλωσ/ω “arnoj, mballos, fig. rregulloj, ndreq,



fitoj”

**mbodhi-a**, FGJSH '80, f. 1092. < gr. το εμπόδιο “pengesë”.

**mbodhis**, FGJSH '80, f. 1092. < gr. μποδίζω “pengoj”

**mellan-i**, FGJSH '80, f. 1108. < gr. re το μελάι “bojë”

**merudhi-a**, FGJSH '80, f. 1116. < gr. η μυρωδιά “erë e mirë, e këndshme, aromë”

**mesit-i**, FGJSH '80, f. 1118. < gr. ο μεσίτης “komisionar, ndërmjetës, seksor, mesit”

**metani-a**, FGJSH '80, f. 1121. < gr. re η μετόνια “pëndim, pëndesë”

**miro-ja**, FGJSH '80, f. 1147. < gr. re το μύρο “fet. vaj i shenjtë, vaj aromatik, erë e mirë, parfum”

**miros**, FGJSH '80, f. 1147. < gr. re μυρώνω, έμυρωσα “parfumo, aroamtizo”

**mistri-a**, FGJSH '80, f. 1149. < gr. re το μυστήρι.

**moleps-em**, FGJSH '80, f. 1161. < gr. re μολεύω, μόλεψ/ω “moleps, infekto”

**molis-em**, f. 1162. < gr. μολύνω, μόλυσω “ndot, infekto, përhap microbe”

**monedhë-a**, FGJSH '80, f. 1163. < gr. re η μονέδα, kjo nga ven. moned = it. moneta.

**monopat-i**, FGJSH '80, fq1164. < gr. re το μονοπάτι “shteg i ngushtë, udhë dhishë”

**more**, FGJSH '80, f. 1166. < gr. mes. μωρέ.

**munk-u**, FGJSH '80, f. 1184. < gr. μούγγος

**mustak-u**, FGJSH '80, f. 1187. < gr. re το μουστάκι.

**naforë-a**, FGJSH '80, f. 1196. < gr. mes. η ανάφορα “raport, relacion, lutje, referim”

**llamburit-is**, FGJSH '80, f. 1035. < gr. re ανακατώνω, ανακάτωσ/ω “përziej, trazon, ngatërroj”

**nanuris-em**, FGJSH '80, f. 1197. < gr. re νανουρίζω, νανούρισ/ω “vë foshnjën në gjumë”

**navlo-ja**, FGJSH '80, f. 1199. < gr. re ο ναύλος “paratë e rrugës, së udhëtimit”

**nikoqir-i**, FGJSH '80, f. 1266. < gr. re ο νοικοκύρης.

**nisi-a**, FGJSH '80, f. 1267. < gr. re το νησί “ishull”

**nojme-a**, FGJSH '80, f. 1269. < gr. re το νόημα “shenjë me kokë, ose me sy”

**noti-a**, FGJSH '80, f. 1271. < gr. re η νοτιά “erë e jugut, jug, lagështi”

**oreks-i**, FGJSH '80, f. 1306. < gr. re η ορεξίς.

**orgji-a**, FGJSH '80, f. 1309. < gr. re η οργή “zemërim i madh, inat”

**oriz-i**, FGJSH '80, f. 1310. < gr. το ορίζιο.

**ormis-em**, FGJSH '80, f. 1310. < gr. re ορμώ, όρμησ/ω “sulem, vërsulem, turrem”

**pallaskë-a**, FGJSH '80, f. 1339. < me burim nga turq., ndërmjetësuar nga gr. re η παλάσκα “fj. e huaj: fishekore”

**pallat-i**, FGJSH '80, f. 1340. < gr. re ose e mes. το παλάτι.

**pat-i**, FGJSH '80, f. 1385. < gr. re ο πάτος “fundi i diçkaje, pjesa e poshtme e një ene, shollë”. (Meyer f. 373, Ulich f. 184)

**patomë-a**, FGJSH '80, f. 1387. < gr. το πάτωμα “dysHEME”

**peksimadhe-ja**, FGJSH '80, f. 1395. < gr. το παξιμαδι.

**periudhë-a**, FGJSH '80, f. 1403. < gr. η περιόδος.

**peronë-a**, FGJSH '80, f. 1404. < gr. re η περόνη “karficë, pirun, kocka e jashtme e kërcirit”.

**petavër-ra**, FGJSH '80, f. 1411. < gr. vj. το πέταυρο.

**petrahil-i**, FGJSH '80, f. 1412. < gr. re το πετραχίλι.

**pirg-u**, FGJSH '80, f. 1487. < gr. re ο πύργος “kullë, pirg”.

**pirun-i**, FGJSH '80, f. 1487. < Nga gr. re το πειρούνη, në gegërishte përdoret piru nga it.

**pisë-a**, FGJSH '80, f. 1487. < gr. re πίσσα “katran, fig. e zezë katran”

**pite-ja**, FGJSH '80, f. 1489. < gr. η πήτα.

**pjatë-a**, FGJSH '80, f. 1490. < gr. το πιάττο.

**pleks**, FGJSH '80, f. 1501. < gr. re πλέκω, έπεξε/ω “thur, fig. thur laved”

**plithar-i**, FGJSH '80, f. 1504. < gr. re το πλιθάρι, prej gr. vjetër πλινθος “qerpiç”

**pllakë-a**, FGJSH '80, f. 1508. < gr. re η πλάκα.

**pllakos**, FGJSH '80, f. 1509. < gr. πλακώνω, πλάκωσ/ω “shtyp, shkel, fig. vjen befas”

**porfir-i**, FGJSH '80, f. 1518. < gr. re η πορφύρα “1. purpur, 2. pëlhurë ose veshje e purpurt. 3. një lloj sëmundje lëkure”

**pramati-a**, FGJSH '80, f. 1529. < gr. re η προματεία “tregti, biznes”

**pras-i**, FGJSH '80, f. 1535. < gr. το πράσο.

**prizë-a**, FGJSH '80, f. 1550. < gr. η πριζα.

**prokopi-a**, FGJSH '80, f. 1556. < gr. re η προκοπή “dobi, hair”.

**psal**, FGJSH '80, f. 1562. < gr. ψάλλω, ψάλλω “këndo, fig. himnizoj, fet. Psal”

**psalt-i**, FGJSH '80, f. 1562. < gr. ο ψάλτης “psalti, psaltësi”

**qeli-a**, FGJSH '80, f. 1693. < gr. re το κελί, fj. e huaj.

**qelizë-a**, FGJSH '80, f. 1593. < gr. το κελί “qel”) me sufiks in deminutiv të shqipës –zë.

**qëndis**, FGJSH '80, f. 1606. < gr. re κεντώ, κέντησω.

**qeramidhe-ja**, FGJSH '80, f. 1598. < gr. re το κεραμίδι “tjegull”

**qeras**, FGJSH '80, f. 1598. < gr. re κερνω, κεράσω.

**qiparis**, FGJSH '80, f. 1613. < gr. re το κυπαρίσι “selvi”

**qiri-u**, FGJSH '80, f. 1614. < gr. re το κηρί.

**qitro-ja**, FGJSH '80, f. 1616. < gr. το κίτρο.

**qivur-i**, FGJSH '80, f. 1616. < gr. re το κιβούρι

**radhique-ja**, FGJSH '80, f. 1631. < me burim nga it. radicchio, ndërmjetësuar nga gr. re το ραδικί.

### **Bibliografi**

1. Banfi, E. "Linguistica Balcanica", Bologna, 1989.
2. Çabej, E: Studime etimologjike vëllimi I, II, III, IV, V, VI, VII.
3. Fjalor greqisht-shqip i Niko H. Gjini, Janinë 1993.
4. Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2005.
5. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe i 1980.
6. Fjalori i gjuhës shqipe, Instituti i shkencave, Tiranë, 1954.
7. Fjalori shqip-greqisht i K.Kristoforidhit 1904, nën përkujdesjen e A. Xhuvanit, Tiranë, 1961.
8. Thomai, J: Leksikologjia e gjuhës shqipe, botimi i tretë.
9. Thomai, J: *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave të RPS. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1989.
10. Ulich. G: Disertacioni '*Elementet e gr. re në gjuhën shqipe*' 1964.



Bade BAJRAMI

## GRAMATIKAT E GJUHËS SHQIPE TË ALBANOLOGËVE FRËNGË

Botimi i veprave “*Manuel de la langue chikipe ou albanaise*” nga Auguste Dozon dhe “*Analyse de la langue albanaise*” nga Louis Benloew, në vitin 1879, shënon një interesim të madh për gjuhën shqipe nga ana e gjuhëtarëve frëngë. Studimet e tyre u bazuan te Boppi, Kamarda, Kristoforidhi. Vepra e Dozonit përbëhet nga një studim i fonetikës, i morfologjisë dhe i fjalëformimit të shqipes kurse ajo e Benloewit ua kushton një pjesë gramatikës, leksikut dhe krestomacisë të gjuhës shqipe. Edhe pse Benloew jep disa perfundime të gabueshme në lidhje me vendin e shqipës në mesin e gjuhëve të tjera dhe të lidhjeve të saj me familjen e madhe indoevropiane, mund të themi se për atë kohë këto ishin studime serioze, me ç’rast shqipja e zgjonte kërshtërinë e gjuhëtarëve të huaj.

Megjithatë, ky interesim duket se u shua pothuajse për një shekull. Në pjesën e dytë të shekullit XX, vëmendja e studiuesve frëng për gjuhën shqipe shfaqet përsëri. Gjuhëtarë të ndryshëm si Bonnet, Gut, Brunet, Mario Roques, Boissin dhe D’Angély merren me gjuhën shqipe.

Enigma e cekur nga Dozon që në rreshtet e para të veprës së tij “gjuha, e cila i ndan shqiptarët nga të tjerët, do të duhej ta jepte çelësin e prejardhjes së tyre dhe të zbulojë prej nga vijnë. Por kjo gjuhë, mozaik i çuditshëm i elementeve që duken çdokund të huazuara, jep në shikim të parë një enigmë tjetër bizare dhe të padeshifrueshme”<sup>1</sup>, synon të zgjidhet nga Robert d’Angely (1893- 1966) në veprën e tij e titulluar « *Enigma...origjina e racës dhe e gjuhës së pellazgëve, arianëve, hititëve, helenëve, etruskëve, grekëve dhe shqiptarëve, etj...tashmë e zgjidhur.*» e shkruar në shtatë vëllime, e cila në vitin 1962 ishte e gatshëm për botim, qëndroi e pabotuar për gati 30 vjet. Pesë vëllimet e parë përbëjnë një vështrim etnografik, historik e gjuhësor mbi Shqipërinë dhe shqiptarët dhe ku paraqiten të dhëna të shumta mbi kohën antike të shqiptarëve, të historisë, të kulturës së tyre dhe sidomos një studim gjuhësor i gjërë që nga Ballkani e deri në Egjipt duke përfshirë edhe Italinë. Autori, i bindur nga lashtësia e shqipës, sjell argumentet e tij duke konsideruar gjuhën shqipe si paraardhëse e greqishtes së vjetër në Greqi dhe të

<sup>1</sup> Dozon A. parathënie

etruskishtes dhe latinishtes në Itali. Dy vëllimet e fundit përmbledhur në një, përbëjnë një Gramatikë shqipe të krahasuar, që përfaqëson për autorin një atu madhore shkencore të veprës së tij.

Ekziston edhe një vepër, e botuar në bashkautorësi të Christian Gutit, Brunet-Gut dhe Pernaska, “*Parlons albanais*” e botuar në vitin 1999. Libri përmban një mori informatash lidhur me tema të ndryshme siç janë historia e Shqipërisë, kultura, por edhe i ofron atij që dëshiron të mësojë shqipën, materiale të domosdoshme për të ushtruar një bisedë të thjeshtë. Një leksik frëngjisht-shqip (3400 fjalë përafërsisht) dhe shqip-frëngjisht (më se 5400 fjalë) si dhe një bibliografi plotësojnë këtë libër të shkruar në një stil të qartë dhe të kapshëm për të gjithë. Meqenëse veprat e sipër shënuara nuk janë gramatika të mirëfillta, ne nuk do të ndalemi më tepër te ato.

Vëmendja jonë do të përqëndrohet te e vetmja gramatikë ekzistuese e shqipës, ajo e Henri Boissin, që mban titullin “*Grammaire de l’albanais moderne*” e botuar në vitin 1975. Meqenëse kjo gramatikë u botua para gati 40 vitesh, kuptohet vetvetiu se në njëfarë mënyre është e tejkualuar për ata të cilët e përdorin ende sot e kësaj dite. Do të paraqesim në vijim disa pika kryesore ndryshimi nga Gramatika e akademisë që kemi nxjerrë nga ajo.

Henri Boissin, profesor në INALCO<sup>2</sup> harton një Gramatikë të shqipes bashkëkohore, e cila përmban 341 faqe. Siç e thotë autori, qëllimi i kësaj gramatike është të përmbushet një zbrazëti sepse nuk ka pasur në gjuhën frënge, përveç asaj të Dozonit, gramatika të tjera të botuara në këtë gjuhë. Autori synon të japë një pasqyrë sa më të qartë të gjendjes së gjuhës shqipe, si të shkruar, ashtu edhe të folur.

Pas një historiku të gjuhës shqipe, çështjes së alfabetit dhe disa vërejtje të ndryshme të përfshira në pjesën përgjithësimë mbi gjuhën shqipe autori trajton tingujt, theksin me rastet e dobësimit të *ë* (*gëzëj/gzëj /*) pastaj elementet proklitike dhe enklitike të gjuhës shqipe dhe rregullat e enklizës. Po ashtu, paraqiten fenomene fonetike të ndryshme si ai me «ë» e lëvizshme (*motër, motra*). Autori me të drejtë konstaton se nuk ka gjeminacon në gjuhën shqipe përvec *ll* dhe *rr* që janë vetëm në dukje gjeminative. Disimilimi, asimilimi, alternanca vokalike, analogjia fonetike, nyjtimi, formimi i shumësit, atracioni rasor, ndarja e fjalëve shqyrtohen hollësisht nga Boissin, i cili propozon shpesh dy versione a me tepër të fjalëve sipas dialekteve toskë apo gegë.

Pjesa e dytë e kësaj gramatike, më voluminozja, i kushtohet morfologjisë (f.55-277). Aty trajtohen fillimisht, nyjet e shqipes duke paraqitur tre llojet e saj: shquese, joshquese dhe përparme. Duhet vënë në pah emërtimin e dhënë nga autori për nyjën e përparme « *article de connexion* » (nyje e bashkimit, e lidhjes). Nyja trajtohet si pjesë e ligjëratës sepse konsiderohej ende në atë kohë si pjesë përbërëse e ligjëratës; mos të

<sup>2</sup> Instituti kombëtar i gjuhëve dhe i civilizimeve të Lindjes.

harrojmë se ky libër u botua me 1975 pa u bërë ende ndryshimet në gramatikën e Akademisë. Megjithatë, po kjo gramatikë e Akademise (2002) pranon për nyjet e përparme se « në mungesë të një termi më të përshtatshëm do të përdoret vetëm konvencionalisht termi nyje» (38).

Në pjesën sintaksore, megjithëse cekën raste të përdorimit të nyjës së shquar, si dhe të formës jo të nyjësuar e cila përdoret pa nyje të shquar, prapëseprap vërehen hezitime në të përdorurit e saj. Këtë po e ilustruam me çështjen e përdorimit të nyjes ku Boissin thekson se në përgjithësi ajo përdoret në të njëjtat kushte si ajo e frëngjishtes, forma e shquar duke marrë parasysh një përcaktim kurse e pashquara nuk ka përcaktim. Ai jep raste të përdorimit të nyjës së shquar si fjala vjen te krahasimet pas fjalëzës si : *luftuam si burrat*<sup>3</sup>, por ai shton se përdoret edhe *luftoi si luan*, dmth e pashquar kurse Gramatika e Akademisë për rastet e përdorimit të trajtës së pashquar jep te krahasimet: «kur emri i përgjithshëm paraqitet si përfaqësues i pacaktuar i klasës përkatëse të sendeve me të gjitha vecoritë e tyre, prandaj përdoret në trajtën e pashquar: “*luftoi si luan, qëndroi si burrë*»<sup>4</sup>. Shihet qartë se për GA vetëm trajta e pashquar e emrit është e pranueshme në raste krahasimi .

Sa u përket rasave, thirrvoja trajtohet kurse sot nuk konsiderohet më si rasë e mirëfilltë . Aty bëhet një ndarje e pazakonte sepse autori përdor termin « cas oblique » apo më mirë të themi rasë e zhdrejtë e cila në gramatikat tradicionale dhe në gjuhët ku rasat lakohen , tregon të gjitha rasat përveç emërores dhe thirrores. Prandaj Boissin e bën ndarjen e njësisit në 3 rase : 1.Emrore dhe thirrore; 2. kallëzore dhe 3. rasë e zhdrejtë kurse atë të shumësit në vetëm dy rase: 1.emërorja, thirrvoja , kallëzorja dhe 2. rase tjetër, obliku apo rase e zhdrejtë në lakimin e shquar dhe të pashquar. Aty thekson se dhanorja dhe gjinorja kanë të njëjtën formë por dallojnë për nga prania në gjinore të nyjës së përparme.

Nën emërtimin *emrat e numrave*<sup>5</sup>, që sot duket i gabuar dhe në vend të tij përdoret numërorët të cilët konsiderohen si pjesë e ligjëratës, Boissin trajton numërorët rendorë dhe numërorët rreshtorë vazhdon me thyesat, me numrat shumëfishor, si dhe shprehjet e ndryshme me numra. Në gramatikat aktuale, numërorët rreshtorë trajtohen në kuadër të mbiemrave marrëdhëniorë ku dhe emërtohen mbiemra marrëdhëniorë e jo më numërorë rreshtorë.

Emrin prejfoljor<sup>6</sup>, Boissin e përcakton si forma shpesh e nyjtuar e përdorur sidomos në njëjës e formës së pashtjelluar e paraprirë nga nyja e përparme të . Emri

<sup>3</sup> Boissin, f. 282

<sup>4</sup> GA , f. 129

<sup>5</sup> Po aty, f. 106

<sup>6</sup> Po aty, f. 147

është pra në formën e nyjtuar të llojit *të...it*. I panyjtuar dhe i paraprirë nga një parafjalë, ai ka vlerë paskajoreje: *për të pasur*. Aty trajton edhe formën e të ashtuquajturit *supin* që jep për çdo folje në tabelat të zgjedhimit dhe thot se është rrjedhorja e pashquar e emrit prejfoljor që paraqitet me formen *se...i*, (*të lënduar përballë së lënduari*). Kjo s'është pa na kujtuar tabelat e zgjedhimeve të latinishtës. Të shtojmë se termi « *supin* » është huazim nga terminologjia gramatikore latine. Benvenisti (1948) konsideronte se *supini* është përdorim foljor i një emri; prandaj ky term që nga përdorimi i parë i tij është nën « shenjën » e ambiguitetit foljo-emror. Zakonisht gramatikat tona na mësojnë se kjo formë përdoret për të shprehur mbarimin e një veprimi në togfjalëshat e llojit *mbarova së foluri*, ku gjymtyra e parë është kryesisht *mbaroj* ose *pushoj*, e ndjekur nga forma e ngurosur e rrjedhores së një emri prejfoljor asnjans në trajtë të pashquar. Përkundër këtyre gramatikave që janë të cekta lidhur me këtë pikë, Boissin paraqet raste të ndryshme për përdorimin e kësaj forme jo vetëm për të shprehur mbarimin e një veprimi por edhe pas foljeve dhe shprehjeve të ndryshme (*larg së qeni*).

Është e ditur se lidhja ndërmjet veprimit dhe kryefjalës së fjalisë shprehet morfologjikisht me dy palë forma: forma veprore dhe forma joveprore, kështu që dalin katër diateza në gjuhën shqipe: diateza veprore, mesore, pësore dhe vetvetore. Boissin paraqet vetëm dy diateza, veproren kurse mesoren dhe pësoren i tkurr në një, meso-pësoren duke mos e zënë fare në gojë diatezën vetvetore. Ky anashkalim është për t'u habitur sepse kjo diatezë ekziston edhe frëngjisht ndonëse tradicionalisht nuk emërtohet si diatezë por si formë vetvetore.

Një tjetër konfuzion qëndron te foljet njëvetore dhe pavetore të cilat i quan folje njëvetore apo pavetore dmth se i ngatërron, i trajton si një, kurse këto duhet dalluar në shqip. Ai i përcakton si folje që përdoren me një ndërtim pavetor, me ose pa kundrinor në rasën e sipërshtënuar e zhdrejtë dhe eventualisht me një kryefjalë. Por gramatika e shqipes bën dallimin në mes të foljeve pavetore dhe njëvetore, të parat nuk kanë kryefjalë të shprehur as të nënkuptueshme, kurse të dytat mund të kenë një kryefjalë të shprehur apo të nënkuptueshme; këto folje përdoren kryesisht në vetën e tretë njëjës.

Për lidhoren, ai thot se shërben si substitut i paskajores e cila nuk ekziston në gjuhën shqipe: *dëshiroj të udhëtoj (je désire voyager)* dhe kur paraprihet nga *le*, ajo shpreh vetat e urdhërorës që nuk përmbajnë forma speciale<sup>7</sup>: *le të udhëtojmë / voyageons*. Duhet cekur se për urdhëroren si të formës veprore ashtu edhe të formës joveprore ai jep tri vetat e njëjësit ashtu edhe të shumës kurse dihet se shqipja paraqet vetëm vetën e dytë të njëjësit dhe vetën e dytë të shumës. Është e vërtetë se mund të përdoret një lidhore e paraprirë ose jo nga pjesëza *le* për vetën e tretë të njëjësit dhe shumës kur folësi nëpërmjet bashkëbiseduesit dëshiron të urdhërojë një apo disa persona që nuk marrin pjesë në bisedë. Gjithashtu me vlerën e urdhërorës përdoret edhe veta e parë shumës e

<sup>7</sup> Po aty, 297



së tashmes së lidhore në ato raste kur folësi nxit për veprim një grup njerëzish ku bën pjesë edhe vete<sup>8</sup>. Për mendimin tonë është vështirë të flitet për formë të urdhërores sepse në fakt është një lidhore por me vlerë urdhërore .

Sa u përket përemrave vetorë, ai pohon se asnjë përemër vetor nuk ka gjinore në lakimin e tij. Por kjo është e vërtetë vetëm pjesërisht, sepse përemri vetor nuk përdoret në gjinore për vetën e parë dhe të dytë (zakonisht në gjuhën e folur, ndjekur nga një ndajshim kryesisht në ndërtime të tipit *Si do të veje balli i neve*). Mirëpo veta e tretë ka një gjinore dhe përdoret në gjinore (*i atij, i asaj, i atyre*). Poashtu rrjedhja e vetes tretë njëjës është e tejkaluar *asi, aso*, në vend të *atij, asaj*.

Kështu trajtohen parafjalët, lidhëzat, ndajfoljet dhe pasthirmat. Por duhet cekur edhe mungesën e trajtimit të pjesëzes, e cila është lënë anash ndoshta sepse është vështirë të dallohet prej pjesëve tjera të ligjëratës prej nga e kanë prejardhjen si lidhëzat dhe ndajfoljet.

Në fjalëformimin e emrave me prapashtesim, ai jep një pasqyrë mjaft të plotë të prapashtesave të gjuhës shqipe si dhe fjalëformimit të mbiemrave dhe foljeve.

Pjesa tjetër i kushtohet sintaksës me çështjen e përshtatjes në gjini dhe në numër, me kryefjalët, me kallëzuesit, me emrat kolektivë dhe përfundon me llojet e ndryshme të fjalive të shqipes, nënrenditese dhe bashkërenditese me të gjitha llojet e tyre.

Nën emërtimin të *ndryshme*, ai i kushtohet ekspresivitetit në gjuhën shqipe duke paraqitur shprehje të ndryshme të klasifikuara sipas proceseve të ndryshme të formimit siç janë përsëritja e termave (*me laçka e plaçka, kashe e lashe, dhëmbet e dhëmballat*), asonanca (*qesh e ngjesh, pa fjalë pa balë*), përdorimi i urdhërorës në shprehje idiomatike si *shkel e shko*.

Kjo gramatikë përfundon me ndërtime dhe fenomene të ndryshme ku konstatohet prirja e shqipes për përdorimin e asinetës. Krahasuar me gjuhë të tjera shqipja përdor një lidhëz bashkërenditese aty ku shumë gjuhë të tjera sikur frëngjishtja përdorin një lidhëz nënrenditese *Lauresha ... shkoi e u ul maje nje guri*<sup>9</sup> (FGJ), *ra e fjeti (il est allé se coucher)*.

Megjithëse nuk kemi të bëjmë me një gramatikë të krahasuar, autori anon shpesh të bëjë krahasime dhe hipoteza, lidhur me shqipen dhe gjuhët e tjera të Ballkanit. Ja p.sh. një mendim i tij : «ekziston shpesh një thirrore e ngjashme me emëroren, ...një thirrore me formë të veçantë, vetëm në disa emra farefisnie ose të asimiluar . Ehtë e mundur të jetë ky një ndikim i sllavishtës nëpërmjet kanalit të këngës popullore (*biro, nëno, dajo, etj*)<sup>10</sup> ». Ky anim kuptohet vetvetiu pasi që ai ishte njohës i gjuhëve sllave dhe i greqishtës së vjetër të cilat edhe i ka ligjëruar,

<sup>8</sup> Dhrimo et al, 239

<sup>9</sup> F. 326

<sup>10</sup> F. 84

## **Përfundim**

Pas një periudhe të gjatë lënie anash të gjuhës shqipe, duket se interesimi i gjuhëtarëve frënge filloi të zgjohej përsëri në pjesën e dytë të shekullit XX. Pamë se dy gramatika u botuan por si gramatikë e mirëfilltë mund të konsiderohet vetëm kjo e Boissin-it e cila , ndonëse mjaft e plotë, është e vjetruar, e tejkualuar pasi që u botua pothuajse para 40 vite. Synimi i Boissinit që të japë një pasqyrë sa më të qartë dhe të plotë të gjuhës shqipe duket sot i tejkualuar.

**Bibliografia**

1. ASHSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe I ( Morfologjia), Tiranë, 2002
2. BENLOEW Louis, (1879), *Analyse de la langue albanaise: étude de grammaire comparée*, Maisonneuve, Paris.
3. BENVENISTE E., (1948), *Noms d'action en indo-européen*, Paris.
4. BOISSIN Henri. Quelques concordances entre le serbo-croate et l'albanais. In: *Revue des études slaves*, Tome 40, 1964. Mélanges André Vaillant. pp. 36-42. doi : 10.3406/slave.1964.1832  
url: [http://www.persee.fr/web/revues/home/prescript/article/slave\\_0080-2557\\_1964\\_num\\_40\\_1\\_1832](http://www.persee.fr/web/revues/home/prescript/article/slave_0080-2557_1964_num_40_1_1832) Konsultuar më 22 gusht 2013
5. BOISSIN Henri, (1975), *Grammaire de l'albanais moderne*, Chez l'auteur, Paris. f. 341.
6. BONNET Guillaume, (1998), *Les mots latins de l'albanais*, ed. Harmattan, Paris.
7. ANGELY d' Robert, *L'énigme ... des origines de la race et de la langue des Pélasges, Ary as, Hittites, Hellènes, Etrusques, Grecs ou Albanais etc. ... résolue* , Cismonte è Pumonti.1991
8. DHRIMO et al., Gramatika e gjuhës se sotme letrare shqipe ( Morfologjia) , Enti i teksteve... Prishtinë, 1985
9. DOMI Mahir. L'albanais et sa structure grammaticale. In: *Revue des études slaves*, Tome 45, fascicule 1-4, 1966. pp. 19-32 doi : 10.3406/slave.1966.1905  
url :[http://www.persee.fr/web/revues/home/prescript/article/slave\\_0080-2557\\_1966\\_num\\_45\\_1\\_1905](http://www.persee.fr/web/revues/home/prescript/article/slave_0080-2557_1966_num_45_1_1905) , Konsultuar më 22 gusht 2013
10. DOZON Auguste, (1879), *Analyse de la langue chkipe ou albanaise, grammaire-vocabulaire-chrestomathie*, ed. Leroux, Paris.
11. GUT Christian, BRUNET-GUT Agnès, PERNASKA Remzi, *Parlons albanais*, L' Harmattan, 1999



**Bahri KOSKOVIKU**

## **SINTAGMA FOLJORE SIPAS AUTORËVE GJERMANË BUCHHOLZ-FIEDLER**

Në këtë kumtesë shkencore do të trajtojmë kontributin e autorëve gjermanë *Buchholz e Fiedler* në përshkrimin e strukturës sintaksore të shqipes, duke zgjedhur vetëm në një segment të rëndësishëm të saj, strukturën e sintagmës foljore, me fokus të veçantë, lidhjet relacionore të foljes me plotësit e saj në aspektin semantiko-funksional dhe përshkrimi i strukturës së tyre sintaksore.

Koncepti i sintagmës foljore në gramatikat shqipe shpjegohet si një lidhje logjike e semantike e foljes dhe e plotësve të saj të njohura si gjymtyrë të dyta, të cilët në raport me foljen shprehin funksione të ndryshme sintaksore: atë të plotësit të domosdoshëm (kundrinorët) dhe të plotësve jo të domosdoshëm, përcaktorët dhe rrethanorët. Po kështu shpjegohet lidhja e foljes me një SE në funksion të kryefjalës, si një relacion semantik i dy gjymtyrëve kryesore të fjalisë, të cilët strukturalisht cilësohen si togfjalësha me lidhje të veçantë, të njohur në gramatikat shqipe si togfjalësha predikativë apo lidhje kallëzuesore.

Rregullat e ndërtimit të fjalisë nga *Buchholz-Fiedler* shpjegohen përmes grupit të fjalëve, të cilët ndahen në dy grupe të mëdha, në grupe njëfunktionale dhe shumëfunktionale. GF bën pjesë në grupin e njësive shumëfunktionale, e cila si një konstrukt sintaksor i nivelit qendror në rrafshin e analizës gjuhësore realizohet strukturalisht nga një folje e shtjelluar si elementin që ndërton qendrën strukturale-sintaksore të fjalisë, e cila në bazë të valencës së saj përcakton numrin e aktantëve të nevojshëm për ndërtimin e kësaj strukture dhe përcakton ndërtimin e tyre morfo-sintaksor (Buchholz-Fiedler: 1987).

Lidhjen e foljes me elementet obligative në rrafshin funksional e quan lidhje predikative të ngushtë LPng. Buchholz e Fiedler konsiderojnë se predikati i fjalisë përfaqësohet nga një GF, thelbi i të cilit duhet të jetë një trajtë foljore e shtjelluar, por ai mund të shprehet edhe si i vetëm (Buchholz dhe Fiedler, 1987:428). Ky përkufizim i GF është i ngjashëm me atë që bën R. Hudleston, G. pullum në gramatikën e tyre *English grammar* se koka e një fjalisë është sintagma foljore, kurse koka e një sintagme foljore është folja.

Termi grup fjalësh, i përdorur nga *Buchholz-Fiedler* është një përpjekje për të zgjidhur problemin terminologjik në shqipe për atë njësi sintaksore që qëndron midis fjalës si njësi sintaksore më e vogël dhe fjalisë si njësi e shkallës së lartë, e cila i përkufizon semantikisht raportet me plotësit e saj përmes teorisë së valencës. Ata paraqesin edhe strukturën e përbërësve sintaksorë edhe nga pikëpamja sasiore që është e ndryshme nga ajo e gramatikave shqipe.

Kriteret e për të përcaktuar strukturën e përbërësve sipas teorisë grupit të fjalëve nga *Buchholz-Fiedler* nuk përkon me teorinë e togfjalëshit e cila nuk e vë foljen si qendër të fjalisë, si një element që drejton kategoritë tjera gramatikore, por si një nga gjymtyrët kryesore të fjalisë e cila hyn në lidhje njëfishe, dyfishe, trefishe e kështu me radhë me gjymtyrët tjera të fjalisë, pra kemi një lidhje lineare elementesh, ku elementi parë lidhet me të dytin (Kr.+kall), i dyti me të tretin (Kr+kund. e dr ose e zhdr. ), i dyti me të katërtin (kall+ reth) e kështu me radhë.

Pra koncepti i gjymtyrës si një konstituente sintaksore është i ngushtë, ai përgjithësisht lidhet me konceptin e pjesëve të ligjëratës (natyrisht kjo mohohet nga gjuhëtarët në përgjithësi dhe tërhiqet vërejtja se fjala dhe gjymtyra janë njësi të ndryshme), por gjymtyra është konceptuar në shumtën e rasteve mbi bazën e kësaj teorie) P.sh: **Miku uroi dhëndrin e nusen**, sipas kriterit formal **miku** është një GE me strukturë minimale në funksionin e subjektit, ndërsa sipas teorisë së togfjalëshit **miku** përfaqëson një gjymtyrë fjalie dhe jo një togfjalësh, për të qenë i tillë ai duhet të hyjë në marrëdhënie semantike me foljen, ngase struktura minimale e një togfjalëshi është dygjymtyrësia. Që do të thotë se sipas teorisë së togfjalëshit, nuk mund të bëhet dallimi midis grupeve të fjalëve me strukturë minimale dhe atyre me strukturë komplekse, ndërsa pjesa tjetër e fjalisë është një grup shumëfunktional, ku folja është e shoqëruar nga një GE në kallëzore në funksion të kundrinorit të drejtë. Struktura, funksioni dhe roli i tyre semantik përshkruhet me një gjuhë të thjeshtë.

## Subjekti

Subjekti semantikisht është një aktant i obligueshëm i foljes, që në strukturën themelore të fjalisë është zakonisht para foljes, strukturalisht ka mundësi të ndryshme të reprezentimit në fjali P.sh;

*Miku uroi dhëndrin e nusen* – kryefjala ka strukturë minimale, ajo përfaqësohet nga një emër

*Miku i shtëpisë uroi dhëndrin e nusen.* - kryefjala ka strukturë komplekse, emri + përcaktor

*Miku që është i shtëpisë uroi dhëndrin e nusen*- emër + fjali e varur.

*Thubet se ju do t'i bashkoheni kësaj lëvizjeje*- plotësi funksional është fjali e varur

Sikundër dihet, kryefjala mund të përfaqësohet edhe nga një sintagmë zero, si: -  
*ç'bën këtu? – Po i vështrij valët e detit.*

### **Kundrinori i drejtë**

Edhe kundrinori i drejtë si një plotës i detyrueshëm i foljes reprezentohet në fjali nga një GE në rasën kallëzore me strukturë të ndryshme, p.sh:

*Era hodhi librin* – kundrina e drejtë ka strukturë minimale, përfaqësohet vetëm nga një emër

*Era hodhi librin e kujtimeve*- GE kundrinor përbëhet nga një emër+ përcaktor

*Era beson se ka të drejtë*-fjalja e varur është një plotës funksional

### **Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë**

Përfaqësohet nga një GE në dhanore, zakonisht është element fakultativ i foljes drejtuese.

Struktura e tij ruhet kur fjalja transformohet nga aktivi në pasiv, p.sh:

*Shokët u ndihmuan të plagosurëve.*

### **Kundrinori i drejtë me parafjalë**

Strukturalisht përshtatet me një GP në funksion të përcaktorit ndajfoljor.

Është shumë interesant nocioni i kalimtarisë sipas *Buchholz-Fiedler*. Sipas tyre jo të gjitha foljet që pranojnë një GE në kallëzore janë kalimtare, por vetëm ato modele të fjalisë tek të cilat kur bëhet transformimi nga aktivi në pasiv, me ç'rast objekti kalon në funksion të subjektit dhe anasjelltas subjekti kalon në një GP në funksion të kund. me parafjalë (*Buchholz-Fiedler* i njeh në shqipe kund. me parafjalë), si:

*Profesori kritikoi studentët/ studentët u kritikuan prej profesori.*

Ndërsa modelet e fjalive si: *Ky libër përmban këngë popullore*, folja nuk është kalimtare, ngase nuk është i mundur transformimi në pasiv, që rezulton se vetëm foljet që kanë një subjekt në funksionin e agjentit është i mundur ky transformim, ndërsa foljet që kanë një subjekt në funksionin e patientsit nuk janë kalimtare meqë këtu s'kemi veprim të kryefjalës që kalon te një objekt, por një gjendje të dhënë dhe GE cilësohet si një zgjerim kallëzuesor.

Njësoj si në gramatikën e Akademisë *Buchholz-Fiedler* e njohin një njësi sintaksore që është e vonë në gramatikat shqipe, kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë. Në traditën tonë gramatikore përdorej termi plotës, të cilën S.Prifti si kategori funksionale fut në mesin e rrethanorëve. *Buchholz-Fiedler* provojnë të shtrojnë disa kritere që dallojnë

kundrinorët parafjalorë nga përcaktorët ndajfpljorë me strukturë të njëjtë sintaksore: e para, kundrinorët parafjalorë nuk mund të zëvendësohen nga një ndajfolje sikur që ndodh me sintagmën parafjalore me funksion ndajfoljor. E dyta nr. i parafjalëve është i kufizuar nga foljet që pranojnë kundrinë parafjalore. E treta në analiza kontrastive, kur në një gjuhë marrëdhëniet sintaksore midis foljes dhe plotësit të saj jepet me një SP, kurse në gjuhën tjetër me një GE në kallëzore, kemi të bëjmë me një kundrinë parafjalore. Por pavarësisht nga këto ata e shohin shumë të vështirë të dallohen GP si kundrinor parafjalor nga përcaktori ndajfoljor i shprehur me GP. Së voni, nga shumë sintaksologë edhe në studimet sintaksore në shqipe, mbështetur edhe nga përvojat e koncepteve strukturaliste e gjenerativiste nuk u njihet statusi i kundrinorëve të zhdrejtë me parafjalë grupeve parafjalore që shprehin marrëdhënie mjeti, shoqërimi dhe vepruesi me folje jotransitive.

Nga kjo rezultojmë se një GF sipas *Buchholz-Fiedler* mund të ketë strukturë minimale (sipas një parimi të njohur se elementi i detyrueshëm i një sintagme është koka e saj), kur folja është njëvalente dhe ka në strukturën e saj vetëm subjektin. Të tilla në shqipe janë fjalitë dykryegjymtyrëshe me strukturë të mbyllur si: 1) *era pushoi*. Kontekstualisht subjekti edhe mund të mungojë kur ideja e subjektit është e dhënë përmes mbaresës foljore: *ç'bën tani?- po punoj*. Një GF mund të ketë edhe strukturë komplekse kur thelbi i tij është një folje dyvalente, kalimtare veprorë, valenca e së cilës kërkon domosdoshmërisht një plotësor të brendshëm, një GE në kallëzore në funksionin e kundrinës së drejtë dhe një të jashtëm një GE në emërore si kryefjalë. Këta vlerësohen si aktantë të obliguar që varen drejtpërdrejt nga folja dhe ndërtojnë atë që *Buchholz-Fiedler* e quajnë LPng, ndërsa elementet tjera jashtë saj janë elemente fakultative.

## Përfundim

Botimi i kësaj gramatike në Lajcpig të Gjermanisë më 1987 shënon një kontribut të madh për gjuhësinë shqiptare, veçanërisht për studimet sintaksore në shqipe në fushën e vështimeve të reja teorike. Kur merret parasysh viti i botimit dhe kur dihet se gramatika shqipe e Akademisë, ribotimi i saj i fundit është bërë më 2002, është për t'u habitur indiferenca ndaj zhvillimeve të tilla, po ashtu është për t'u habitur si nuk është parë e arsyeshme nga qarqet akademike në Prishtinë dhe Tiranë përkthimi i këtij libri me rëndësi kapitale që shquhet për një saktësi dhe qartësi të rrallë të strukturës së përbërësve sintaksorë si në asnjë gramatikë tjetër dhe shfrytëzimi i tij si një tekst universitar.

Gramatika e autorëve gjermanë, *Buchholz-Fiedler* nga studiues tanimë të njohur në Prishtinë vlerësohet si një nga gramatikat më të sakta në përshkrimin e strukturës



sintaksore të shqipes. Kjo gramatikë e ka të veçantë mënyrën e shpjegimit dhe interpretimit të fakteve gjuhësore, siç është p.sh. përshkrimi i strukturës së përbërësve me një gjuhë të thjeshtë të qartë dhe të kuptueshme si për studiuesin ashtu edhe për studentët. Prandaj duke e parë vlerën dhe rëndësinë e kësaj gramatike propozoj që sa më parë të bëhet përkthimi e kësaj vepre me rëndësi kapitale për shqipen, jo vetëm si respekt për autorët, por në radhë të parë si interes për gjuhësinë shqiptare.

**Bibliografia:**

1. Buchholz Oda, Fiedler Eilfred (1987), *Albanische Grammatik*, VEB Verlag Enzyklopadie Leipzig.
2. Grup autorësh (2002), “*Gramatika e gjuhës shqipe 1*” ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë Tiranë
3. Grup autorësh (2002), “*Gramatika e gjuhës shqipe 2*” ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë
4. Prifti, Stefan(1971), “*Sintaksa e gjuhës shqipe*”, ETMMK, Prishtinë
5. Domi, Mahir (1971), “*Sintaksa e gjuhës shqipe*” ETMMK, Prishtinë.
6. ASHARSH,(1995), Instituti i Gjuhësisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I* (Morfologjia), Tiranë.
7. ASHARSH, (1997), Instituti i Gjuhësisë, *Gramatika E Gjuhës Shqipe II*
8. Chomsky, Noam (1957), *Syntactic structure*, Neë York
9. Huddleston, Rodney and Pullum, Geoffrey,(2007), *English Grammar*, Cambridge University press
10. Çeliku, Mehmet, (2012), *Sintaksë e Gjuhës Shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Tiranë, Sh.B.Ilar
11. Lyons, John. *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*,(Përkthim i vitit 2010), Sh.B.”Dituria”

Vjosa HAMITI

## MODALITETI DHE MUNDËSITË E SHPREHJES SË TIJ SIPAS “ALBANISCHE GRAMMATIK” TË ODA BUCHHOLZ-IT DHE WILFRIED FIEDLER-IT

### 1. Hyrje

Duke iu referuar temës së seminarit të këtij viti (2013) “**Studiuesit e huaj për shqipen në pjesën e dytë të shek. XX**”, mund të themi me siguri të plotë, se në plejadën e këtyre studiuesve, vend të posaçëm zënë edhe studiuesit e shumtë të vendeve gjermanofolëse, kontributi i të cilëve është i pakontestueshëm në zhvillimet albanologjike të periudhës në fjalë. Veprimtaria e albanologëve nga vendet gjermanofolëse daton me filltet e studimeve albanologjike nga studiues të huaj, çka do të thotë se ata filluan shumë herët dhe vazhdojnë edhe në ditët e sotme me studimet dhe hulumtimet e tyre për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Ndër emrat më të shquar të pjesës së dytë të shekullit XX të studiuesve të vendeve gjermanofolëse janë: **Wilfried Fiedler, Oda Bucholz, Dieter Nehring, Gerda Uhlrich, Walter Breu** etj. Fokusi i kësaj kumtese do të jetë studiuesi **Wilfried Fiedler**, për çka në vazhdim do të paraqes një panoramë të plotë të punimeve të tij në gjuhësinë shqiptare. Një studim dhe paraqitje më e hollësishme do t’i bëhet gramatikës së gjuhës shqipe “Albanische Grammatik” të cilën Fiedler e ka hartuar në bashkëpunim me albanologen tjetër gjermane **Oda Buchholz**. Gjatë shtjellimit të mëtejshëm të kumtesës do të fokusohem te modaliteti dhe mundësitë e shprehjes së tij, të paraqitura sipas kësaj gramatike, çka do të realizohet edhe duke e krahasuar gramatikën në fjalë me gramatikat e tjera të gjuhës shqipe.

### 2. Përshkrimi i gramatikës “Albanische grammatik”

Gramatika e gjuhës shqipe e albanologëve, **Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it**, “*Albanische Grammatik*“ u botua në vitin 1987 në Leipzig të ish-Gjermanisë Lindore. Autorët bëjnë me dije që për përpilimin e kësaj gramatike janë marrë si bazë

gramatikat e gjuhës shqipe, si dhe ato të gjuhës gjermane dhe ruse. Kjo e shpjegon edhe terminologjinë e përdorur nga autorët, e cila karakterizohet me ish pjesën lindore të Gjermanisë, që pjesërisht është terminologji e vjetëruar, për çka edhe shumë terma nuk gjenden në gramatikat e gjuhës gjermane të përpiluara po në atë kohë. Mu për shkak të terminologjisë së vjetëruar që karakterizon atë periudhë e që është terminologjia mbizotëruese e gramatikës “*Albanische Grammatik*“, sidomos gjeneratat më të reja, të cilat nuk kanë qenë pjesë e sistemit të atëhershëm, hasin në vështirësi gjatë përdorimit të kësaj gramatike. Përkundrajt terminologjisë së vjetëruar, sërish “*Albanische Grammatik*”, vlerësohet nga njohësit e saj si gramatika më e plotë e shqipes.

Kjo gramatikë është shumë e ngjeshur dhe janë përdorur shumë shkurtesa për të cilën autorët edhe në hyrje kërkojnë mirëkuptim nga përdoruesit eventualë (lexuesi). “*Albanische Grammatik*” dallon nga gramikat e tjera të gjuhës shqipe për studimin më të hollësishëm të pjesëve të ligjëratës, çka edhe ofron perspektiva më të mëdha për studimin e shqipes.

Gramatika “*Albanische Grammatik*” përbëhet nga 5 pjesë apo kapituj kryesorë. Në hyrje të saj (f. 13-19) i bëhet një përshkrim i detajuar si në rrafshin diakronik, por edhe atë sinkronik gjuhës shqipe dhe trevave ku ajo flitet.

Pjesa e parë e kësaj gramatike është një hyrje në fonetikën dhe fonologjinë (f. 27-57) e gjuhës shqipe. Në të është shtjelluar detajisht gjuha e shkruar dhe e folur, të cilën autorët e përshkruajnë si problematike për shkak të dialekteve gege dhe toske, të cilat kanë ndikim si në të folur, por edhe në të shkruar.

Pjesa e dytë i kushtohet sistemit foljor të shqipes (f.60-193) dhe në të bëhet një përshkrim i detajuar i foljes dhe formave foljore të shqipes. Autorët potencojnë që për dallim nga gramikat e tjera të deriatëhershme të gjuhës shqipe, në të cilat shtjellimi studimor zakonisht fillohet me emrin e vazhdohet më tutje, këta e fillojnë me foljen, duke u arsyetuar me faktin që folja në gjuhën shqipe ka një rol qendror.

Pjesa e tretë shtjellon sistemin nominal ku përshkruhen gjerësisht emri (f.202-272, përemri (f. 273-313), mbiemri (f.314- 348) dhe numërorët (f. 349- 360). Ajo çka mund të veçohet nga ky kapitull ka të bëjë me atë se, autorët në këtë gramatikë, nuk e përshkruajnë njëjën e prapavendosur dhe paravendosur, sikurse shumë gramatika të gjuhës shqipe si një element i një grupi të veçantë të Ligjëratës, por si një morfemë gramatikore, e cila është e varur nga faktorët sematiko-funksional, përmes të cilave ushtrohen funksione të ndryshme.

Pjesa e katërt përshkruan pjesët e pandryshueshme të ligjëratës ku në mënyrë të detajuar shtjellohen ndajfoljet (f. 361- 371), parafjalët (f. 373- 384), lidhëzat (f. 385-391), pjesëzat (392-395) dhe ekuivalentet e fjalisë, siç quhen nga autorët, (f.395-405) si pasthirrmat, onomatopitë etj . Autorët nënvizojnë që përqendrimi i tyre gjatë përshkrimit të këtyre pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, është jo vetëm te

funksionet e tyre sintaksore, por edhe roli i tyre për shprehjen e modalitetit dhe emocionalitetit.

Në pjesën e fundit të kësaj gramatike apo pjesën e pestë i bëhet një përshkrim fjalisë dhe fjalëformimit (f. 407- 562) të gjuhës shqipe. Kjo pjesë i kushtohet sidomos aspektit sintaksor të shqipes duke marrë për bazë teoritë e gramatikës gjenerative.

### 3. Modaliteti në “Albanische Grammatik”

Kategoria e modalitetit është njëra prej kategorive që është studiuar shumë në gjuhët evropiane (si p.sh.gjermane, angleze, frënge, italiane etj). Kjo kategori konsiderohet nga studiuesit si e ndërlikuar dhe gërshetohet edhe me fusha të tjera shkencore, si Filozofia, Semiotika, Logjika etj. Modaliteti si koncept me ndarje dhe nëndarje, që përdoret sot në gjuhësinë gjermane, angleze<sup>1</sup> etj, është marrë nga Filozofia apo me saktë nga Logjika modale. Punimet e shumta bazohen në punimin “*Essay on Modal Logic*” i Filozofit **Georg Henrik von Wrights** i cili u botua në vitin 1951. Von Wright konsiderohet si themeluesi i ndarjeve, por edhe i emërtimeve të modaliteteve në gjuhësi. Fatkeqësisht gramatika e Buchholz dhe Fiedler, nuk i paraqet modalitetet e ndryshme sipas kësaj ndarjeje.

Në pjesën e përshkrimit të përdorimit të foljeve (f. 122-123) Buchholz dhe Fiedler potencojnë se sistemi foljor i shqipes në krahasim me pjesët e tjera që i posedon gjuha shqipe si p.sh. fjalori (leksiku), Intonacioni etj. i ofron folësit më shumë mjete pragmatiko –komunikative, për ta shprehur atë. Format foljore marrin në shumicën e rasteve pozicionin dhe vlerësimin e fakteve, të cilat janë ngushtë të lidhura me intonacioni gjatë të folurit. Autorët përdorin termat veprim apo ngjarje në spektër më të gjerë, duke potencuar faktin se përmes tyre përshkruhen veprime, gjendje, procese etj. Përmes formave foljore të shqipes mund të shprehen këto kategori semantike-funksionale: temporaliteti, aspektualiteti-akcionaliteti, modaliteti dhe emocionaliteti <sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Për më shumë shih John Lyons, Frank Palmer, Joan Bybee at.al, etj.

<sup>2</sup> Foljet në gjuhën shqipe, sipas Camaj (1984), f. 148, mund të përmbliidhen në tri funksione:

- Format që shprehin kohën;
- Klasifikimi i formave sipas aspektit (në zgjedhim të foljeve) [FGJSSH, 1981:63: Në gjuhësi: Kategori grammatikore në disa gjuhë, që tregon mënyren se si rrjeth veprimi. Aspekti i kryer (i pakryer). Apektet e foljes.]
- Ndërtimet me forma foljore (të eptuara apo të ngurta), të cilat, si njësi analitike, shprehin modalitete, p.sh. domosdoshmëri (necessity) [foljet modale **duhet** dhe **lypet** janë tipike për këtë përdorim], apo posibilitetit (që e përmban **mund**), etj.

Nga këto kategori fusha më e pasur në gjuhën shqipe konsiderohet të jetë ajo e modalitetit. Modaliteti<sup>3</sup> mbërthen përpos mënyrës së raportit apo qëndrimit të folësit mbi përmbajtjen e një fjalie (apo shprehjeje), edhe raportin e përmbajtës së fjalisë (shprehjes) me realitetin që do të thotë raporti mes së kumtuarit dhe realizimit të tij.

Autorët përdorin termin **Heischemodalität**<sup>4</sup>, që do të thotë fjali dëshirore, fjali që shpreh një dëshirë sipas realizimit të fakteve. Ky lloj i emërtimit të modalitetit nuk gjendet në literaturën gjermanofolëse. Mund të thuhet që ky term është me i vjeter dhe është i lidhur ngushtë me autorët.

Ky lloj i modaliteti paraqitet në këtë gramatikë si kompleks me Imperativin, (për mes së cilit shprehet urdhri, kërkesë, norma etj), optativitetin (dëshira, mallkime, etj.) admisivitetin ("lejimi i dëshirës" (zulassendes Heischen). Në këtë grup, autorët fusin edhe volitativin përmes së cilit shprehet dëshira.(f. 133).

Modaliteti i tillë paraqitet edhe si kompleks ndaj interrogativitetit, ku pyetjet neutrale janë diskutabile që të futen në kategorinë e modalitetit, por për arsye praktike ato vendosen në këtë kategori nga autorët. Kategoria e modalitetit është më e qartë në pyetjet dyshuese apo interrogativiteti dubitativ dhe interrogativiteti deliberativ apo debitiv (apo pyetjet për një urdhër të huaj) si dhe interrogativiteti polemik (pyetje retorike apo pyetje të bezdisshme).

Kompleks me kondicionalitetin dallohet modaliteti real, ireal (joreal) apo potencial dhe fjalia kryesore në kondicionalitet. Në këtë pjesë autorët përmendin dhe përdorin në tërë gramatikën edhe një modalitet tjetër që e quajnë "Fallsetzungsmodalität" që të thotë janë forma ku hyjnë konstruktionet me pjesëza të ndryshme si p.sh. *në* , *po*, *dot*, *le* etj. përmes së cilave shprehen modalitetet e lartpërmendura.

Kompleksi i "modalitetit subjektiv" apo "presupozimit" përmban: presupozimin në kuptim të ngushtë të fjalës, që do të thotë presupozimi subjektiv, lejimi subjektiv, posibilitativi subjektiv, nezesiviteti subjektiv. Këtu autorët bashkëngjisin edhe modalitetin e druatjes (frikës). Këtij modaliteti mund t'i shtohet edhe modaliteti "objektiv" apo "jobjektiv", siç e quajnë autorët, që shprehin presupozimin objektiv, lejimin objektiv, posibilitativin objektiv, nezesivitetin objektiv.

<sup>3</sup> Buchholz /Fiedler (1987) f. 60: „Am reichsten ist der Bereich der Modalität vertreten. "Modalität" schließt hier sowohl die Art der Beziehung/Haltung des Sprechers zum Inhalt der Aussage als auch die Beziehung des Inhalts der Aussage zur Wirklichkeit, d. h. das Verhältnis des Mitgeteilten zur Verwirklichung, ein.“

<sup>4</sup> Bußmann (2008),S. 803:“ Heischesatz grammatisch begründeter Satztyp zum Ausdruck von Wünschen, der im Dt. Durch Verb -Erst-Stellung und Konjunktiv u.a. gekennzeichnet ist: *Wäre diese Last doch endlich von mir genommen.*“

Kompleks i komentativitetit apo ligjëratës së zhdrejtë, përbëhet nga më shumë nëntipa dhe diferencon para së gjithash pjesëmarrjen në momentin e të folurit (Sprechakt) dhe qëndrimin e folësit për një thënie (shprehje). Autorët në këtë pikë potencojnë që admirativi ka funksion modal (komentativin), por edhe emocional, që sipas tyre është edhe funksioni kryesor i admirativit, i cili signalizohet nga format foljore.

Nga kjo paraqitje del që Buchholz /Fiedler modalitetin e ndajnë në modalitet objektiv dhe subjektiv. Mirëpo edhe emocionlitetin e ndajnë si kategori të veçantë nga modaliteti, që zakonisht hyn në këtë kategori. Gjithashtu si modalitet të veçantë e ndajnë edhe Heischenmodalität- i cili është fjalia dëshirore me ngjyime të ndryshme modale (imperfekt, optativitet etj), por edhe “Fallsetzungsmodalität” që nënkupton konstruksione më pjesëza të caktuara të shqipes.

Te përshkrimi i foljeve modale, apo foljet të cilat singanlizojnë një modalitet të caktuar, autorët dallojnë këto modalitete (f.61):

des Müssens (Nezessativ)	e domosdoshmërisë
des Wollens (Volitivität)	e dëshirës
des Könnens (Possibilitativität)	e mundësisë
des Zögerns oder der Furcht	e frikës apo hezitimit
der Disposition	e dispozicionit

Duke u ndalur te koha si kategori gramatikore e foljeve të shqipes, Buchholz dhe Fiedler përpos aspektit morfologjik, kohët e shqipes i specifikojnë të tilla që përshkruhen nga tri aspekte: temporaliteti, aspektualiteti dhe modaliteti<sup>5</sup>. Në këtë përshkrim mugojnë kohët e së ardhmes. Autorët këto forma foljore i përshkruajnë tek mënyrat e e foljes nën emërtimin Volitiv.

Kategoria e mënyrës te Buchholz dhe Fiedler përshkruhet gjithashtu në rrafshin e modalitetit dhe temporalitetit. Kjo gramatikë numëron tetë mënyra<sup>6</sup> të foljes që dallon nga ajo gramatikave të tjera të shqipes që numërojnë vetëm gjashtë të tilla. Nga të gjitha format foljore që në gjuhën shqipe konsiderohen si mënyra, dëftorja, lidhorja, dëshirorja dhe urdhërorja janë të padiskutueshme si të tilla, jo vetëm nga kjo gramatikë, por edhe të tjerat që janë shkruar nga albanologë të huaj (Shih Newmark et al, Breu etj) . Janë pikërisht format analitike të posibilitativit, obligativit, kondicionalit dhe admirativit që

---

<sup>5</sup> Për më shumë shih “Albanische Grammatik” f. 123-133

<sup>6</sup> Edhe Leonard Newmark et al. (1987) numëron tetë mënyra të foljes së shqipes. Kohëve të fundit është edhe Walter Breu (2010) i cili numëron dhjetë mënyra të shqipes.

kategorizohen herë si mënyra, herë si konstrukte me folje modale, si p.sh: habitorja si evidencialitet, ndërsa kushtorja si kohë.<sup>7</sup>

<b>Agalliu e të tjerët</b>	<b>Buchholz/Fiedler</b>
Mënyra Dëftore	Indikativ
Mënyra Lidhore	Konjuktiv
Mënyra Urdhërore	Imperativ
Mënyra Kushtore	-----
Mënyra Habitore	Admirativ
Mënyra Dëshirore	Optativ
	Volitiv (Futur-Konditional)
	Jussiv
	Possibilitativ

Siç u potencua edhe në hyrje, kjo gramatikë i bën një studim të hollësishëm edhe pjesëve të pandryshueshme të fjalisë, ku përpos aspektit sintaksor që luajnë ato në fjali, shtjellohet edhe rrafshi semantik i tyre.

#### **4. Kontributet albanistike të Wilfried Fiedler**

Në këtë pjesë të kumtesës do të paraqitet jeta dhe kontributi albanistik i Wilfried Fiedler-it. Fiedler (1933) pas studimeve në Humboldt-Universität në Berlin u pranua asistent në këtë Universitet, ku më vonë u hap edhe dega e albanologjisë. Fiedler përpos që është marrë me studime gjuhësore, është marrë edhe me përkthime, ndër të cilët është edhe "Gjenerali I ushtrisë së vdekur" i Ismail Kadarese . Në vitin 1991 Fiedler u zgjodh anëtar I jashtëm I Akademisë së Shkencave të Kosovës.

Në vijim paraqiten literatura e Fiedler-it :

##### **Librat:**

- Albanische Volksmusik. Bd. 1. Gesänge der Camen. Berlin 1965 (së bashku me Doris dhe Erich Stockman)
- Wörterbuch Albanisch-Deutsch. Leipzig 1977 (në bashkëpunim me Oda Buchholz und Gerda Uhlisch)
- Albanische Grammatik. Leipzig 1987,(me bashkëautoren Oda Buchholz).
- Fjalor Gjermanisht-Shqip 1997, (me Ardian Kloson)

<sup>7</sup> Për më shumë shih punimin e koleges Ismajli, Blertë (2012), Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja. Në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Albanian and Balkan Languages. ASHAK, Prishtinë, Fq. 473-483.



- Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555). Prishtinë 2004,
- Die Pluralbildung im Albanischen. Prishtinë 2007.

**Kumtesa/Studime:**

- Zum Verhältnis von arealer Linguistik und Arealtypologie (am Beispiel der Balkansprachen) . Në: ZPSK 42. (1989), 3, faqe 306–323.
- Ist das Albanische, „dem Typus nach“, die entscheidende Sprache des ganzen balkanischen Gebietes? Në: Albanica 3-4, 1992, faqe 78–95.
- Einführung in die Balkanphilologie. Në: Peter Rehder (Hrsg.): Einführung in die slavischen Sprachen. 3., (1998) (2003) , faqe 347–364.
- Tempus, Modus und Aspekt in den Sprachen Südosteuropas. Në: Uëe Hinrichs, Uwe Büttner (Hrsg.): Handbuch der Südosteuropa-Linguistik. (1999) faqe 487–517.
- Albanisch. Në: Thorsten Roelcke (Hrsg.): Variationstypologie. Ein sprachtypologisches Handbuch der europäischen Sprachen in Geschichte und Gegenwart/ Variation Typology. A Typological Handbook of European Languages Past and Present. (2003). Faqe 749-797.
- Der südosteuropäische Typus des grammatischen Analytismus – die „balkanische Partikelkonstruktion“ im Verbalsystem. In: Uwe Hinrichs, Uwe Büttner (Hrsg.): Die europäischen Sprachen auf dem Wege zum analytischen Sprachtyp. = Uwe Hinrichs (Hrsg.):Eurolinguistische Arbeiten. Band 1, 2004, faqe 363–398.

Sigurisht që Fiedler ka mbajtur ligjërata në Universitete të ndryshme të Gjermanisë, ku ekziston dega e Albanologjisë. Për më tepër, ai ka qenë pjesëmarrës në shumë konferenca si në Gjermani ashtu edhe jashtë saj, ku është paraqitur me kumtesa të shumta. Në fund të kësaj kumtese më duhet të përsëris që Albanologu Wilfried Fiedler është ndër kontribuesit më të mëdhenj të shekullit XX nga vendet gjermanofolëse.

**Literatura:**

1. Agalliu, F./Angoni, E./Demiraj, Sh./ Dhrimo, A./ Hysa, E./ Lafe, E. Likaj, E., (2002): Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë,
2. Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E., (2002): Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi II, Sitaksa, Tiranë,
3. Buchholz,O./ Fiedler,W. (1987): Albanische Grammatik, Leipzig
4. Bybee, Joan/Fleischmann, Suzanne (1995): Modality in grammar and discourse. Amsterdam, Philadelphia: Benjamins. (Typological Studies in Language 32).
5. Bybee, Joan; Perkins, Revere; Pagliuca, William (1994): The evolution of Grammar- Tense, aspect, and modality in the languages of the World, Chicago,
6. Ismajli, Blertë (2012), Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja. Në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Albanian and Balkan Languages. ASHAK, Prishtinë, Fq. 473-483
7. Newmark, L./ Hubbard, Ph./ Prifti, P. (1980): Standard Albanian. Stanford
8. Palmer, F.R.(2001): Mood and Modality, (Second edition) Cambridge University Press, perspective. Amsterdam/Philadelphia: Benjamins (Human cognitive processing 5).

**Remzi PËRNASKA, Tomorr PLANGARICA**

**KONTRIBUTI I KRISTIAN GYTIT PËR SHQIPEN DHE  
KULTURËN SHQIPTARE**

Kontributi i Kristian Gytit (Christian Gut) për shqipen dhe kulturën shqiptare është i tillë që të detyron të shqyrtosh me kujdes vendin në të cilin do ta vendosësh, sepse ruan tipare të një tradite franceze në këtë lëmë dhe, nga ana tjetër, përfton modelin e studiuesit me profile të spikatura qartë si njohës shumë i mirë dhe kontribues me vlerë në studimin e gjuhës shqipe, historisë dhe kulturës së saj.

Është e natyrshme që kontributet e dijetarëve të huaj (gjuhëtarë, historianë, etnologë, kulturologë etj.) në fushën e albanologjisë të jenë përvijuar si kontribute që vijnë në këtë fushë krahas prurjeve shkencore që ata sjellin në fushat e tjera parësore të interesimeve të tyre shkencore që lidhen jo vetëm me Shqipërinë, historinë e saj dhe gjuhën shqipe, por me kontekstet shkencore ku ata punojnë ose me gjuhët e ndryshme të Europës e Ballkanit, ose edhe më tej, me gjuhë të ndryshme indoeuropiane e më gjerë. Është e natyrshme po ashtu që interesimet e para për gjuhën, kulturën dhe historinë e popullit shqiptar të kenë lindur, si fillësë, nga kureshtja e sqima e tyre shkencore së cilës shqipja i jepte argumente jo të pakta për krahasime dhe përçasje, dhe historia e kultura e popullit shqiptar modele parake të konservimit të vlerave dhe zakoneve, etj. Edhe pse i krijuar me këtë zanafillë, kontributi i tyre mbetet i çmuar për albanologjinë dhe, në të shumtën e rasteve, edhe për çështjen shqiptare në rrjedhë të viteve dhe epokave, kur jo pak herë zëri i tyre ka qenë tejet i rëndësishëm në administratën e vendeve të tyre a në kancelaritë e ndryshme të vendeve europiane. Përvoja e përfutur prej këtyre kontributeve është e pranishme tashmë në bibliotekat europiane e më gjerë, e po ashtu, gjurmët e fjalës së tyre dallohen jo pak herë edhe në analet e politikës, historisë e diplomacisë europiane.

Në emrat më të njohur të kësaj trashëgimie, në suazën e kontributeve të studiuesve francezë për albanologjinë, spikatin emra të shquar si Lui Lysiën Bonoparti (Louis-Lucien Bonaparte), Ogyst Dozoni (Auguste Dozon), Lui Benlëvi (Louis Benloew), Lui Pod'horski (Louis Podhorszky), Mario Roku (Mario Roques), Gabriel

Anceu (Gabriel Ancey), Robert d'Anzhëli (Robert d'Angely), Hanri Buasëni (Henri Boissin), Zhan-Lui Dysheja (Jean-Louis Duchet), Zhorzhë Dretasi (Georges Drettas), etj..Për një rastësi të lumtur, por jo vetëm për rastësi, këto janë figura të rëndësishme me prurje të konsiderueshme në kulturën dhe studimet europiane. Ndoshta zhvillimet historike dhe kulturologjike të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX, si dhe shkollat gjuhësore dhe historiografike të asaj periudhe, por edhe kahje të ndryshme shkollash gjuhësore më vonë e parakuptonin dhe e nxisnin këtë natyre komplekse dhe enciklopedike të studimit.

Si për vijimësi të asaj tradite, por të formësuar në kushte aspak të njëjta, kontributi i K. Gytit, në gjysmën e dytë të shekullit XX, do të ketë pika të përbashkëta me ato përvoja. Në fushën e albanologjisë, ky kontribut do të formësohet qartë duke përvijuar profilet e ligjëruesit të çështjeve të rëndësishme të qytetërimit dhe kulturës shqiptare në institucione universitare dhe shkencore me zë në Paris, të mësimdhënësit të shqipes dhe historisë së popullit shqiptar, të studiuesit të aspekteve të ndryshme të historisë, personaliteteve dhe veprave të panjohura të tyre, të përkthyesit të letërsisë artistike, shkencore e politike, të hulumtuesit dhe paraqitësit kompetent të dokumenteve arkivore, të hershme dhe të reja; po ashtu, edhe të mbrojtësit të vlerave kulturore të popullit shqiptar në foltore të ndryshme të Parisit e më gjerë, ku kultura shqiptare kishte çka të thoshte dhe ku zëri i K. Gytit tingëllonte bindshëm dhe i fortë. Mjediset ku ky zë do të dëgjohej shkonin nga salla e Parlamentit e Senatit francez, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Francë e deri në auditoret e Universitetit të Sorbonës a Institutit të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Lindore. Ky kontribut i tij do të integrohet natyrshëm me atë traditë studiuesish francezë, duke u përshtatur, gjithsesi, me natyrën, kërkesat dhe nevojat bashkëkohore të një periudhe të re studimesh në fushën e albanologjisë. Për më tepër, ky kontribut është në vijim e sipër, si peng që profesor K. Gyti mendon që ende nuk e ka shlyer ndaj kulturës shqiptare pas së cilës është dashuruar vite e vite më parë.

\*            \*  
\*  
\*  
\*

Kristian Gyti lindi më 17 korrik 1931, në një familje inxhinierësh, në Paris, ku kreu me rezultate të shkëlqyera shkollën e mesme. Më 1951 doli i pari në konkursin e pranimit për studime universitare në institucionin me zë Shkolla kombëtare e Kartave (École nationale des Chartes), të cilën e kreu me rezultate të jashtëzakonshme, sepse zuri vendin e dytë midis të diplomuarve. Në këtë shkollë përsosi njohjen e latinishtes e greqishtes së vjetër, si edhe mjeshtërinë e paleografit (1955).

I etur për dije dhe punëtor i palodhur, mësoi me të paharruarin Hanri Buasënin (Henri Boissin) gjuhën shqipe dhe maqedonase në Shkollën Kombëtare të Gjuhëve Lindore të Gjalla, ku u diplomua me notën *shumë mirë* si për shqipen (1966), ashtu edhe për maqedonishten (1968).

Dashamiri dhe miku i shqiptarëve dhe i Shqipërisë Kristian Gyt ka mbrojtur edhe një doktoratë për qytetërimin shqiptar në Universitetin e Puatjesë (Poitiers) me vlerësimin më të lartë që ka Franca: *Tepër i nderuar me urimet e jurisë*.

Karrierën e vet K. Gyt i ka bërë në Francë si arkivist-paleograf, si kryearkivist i Departamentit të Uazës (Oise) (1955-1958); shef i shërbimit audio-vizual në Arkivat Kombëtare (1961-1966); drejtor i Arkivave të Senës (1966-1978); kryeruajtës i shërbimit teknik në Drejtorinë e Arkivave të Francës 1978-1984); drejtor i Qendrës spitalore të specializuar ndërdepartamentale të Klermont-dë-l'Uazë (1984-1989), etj. Karriera e tij është shumë më e pasur dhe e larmishme se kaq, ajo përbëhet edhe nga detyra e funksione të tjera; si ekspert pranë delagacionit francez në UNESCO (1976-1984); si ekspert i UNESCO-s për arkivat e Çadit, Kongos, Mauritanisë, Haitit, Qipros; si anëtar i Komitetit të mikrofilmit të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (1975-1978); si nënkryetar i Qendrës Ndërkombëtare të Informacionit për burimet e historisë së Ballkanit (1976-1984); si anëtar i Komisionit epror të arkivave (1978-1984); si sekretar i Konferencës Ndërkombëtare të Tryezës së Rrumbullaktë të Arkivave (1966-1979), etj.

Dhe kjo nuk është veçse një pjesë vërtet e qënësishme, por gjithsesi vetëm një pjesë e karrierës e këtij njeriu që gjithë jetën ka bërë punë dhe vetëm punë të dobishme.

Për punë të palodhur dhe shumë të vlefshme, ai është nderuar me shumë tituj e dekorata nga më të lartat nga administrata franceze: Kalorës i Urdhërit Kombëtar të Legjionit të Nderit (Chevalier de l'Ordre national de la Légion d'honneur) (1983), Kalorës i Urdhërit Kombëtar të Meritës (Chevalier de l'Ordre national du Mérite) (1968), Oficer i Arteve dhe Letrave (Officier des Arts et des Lettres) (1978), etj.

\*

\* \*

Edhe si albanolog është treguar mjaft prodhimtar. Ka qenë i ngarkuar me ligjëratat për qytetërimin shqiptar (letërsi, histori, gjeografi), të cilat i krijoi vetë, në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Lindore të Parisit (1966-1992), i ngarkuar me mësimdhënien e gjuhës shqipe në po këtë Institut (1970-1992), drejtor i Departamentit të Europës Qendrore dhe Lindore të këtij Instituti (1971-1980) dhe zëvendës-drejtor i tij (1990-1992); meritë madhore e tij është krijimi i një strukture trevendëshe për mësimdhënien e gjuhës dhe të qytetërimit shqiptar në këtë Institut, strukturë që para tij mungonte. Po ashtu, ai zhvilloi ligjëratat për historinë dhe filologjinë shqiptare në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta në Sorbonë.

Pjesë të rëndësishme të interesimeve të tij si shkencëtar ai ka edhe studimin e botës shqiptare. Veprimtaria e tij si albanaolog është e larmishme dhe me ndihmesa të mira për studimin e gjuhës, historisë dhe qytetërimit shqiptar. Për ta përkapur më mirë këtë veprimtari po renditim ndihmesat e tij sipas tematikës dhe kohës.

Ai ka bërë punë të lavdërueshme për njohjen e Shqipërisë, të popullit dhe qytetërimit shqiptar në Francë dhe në botën frankofone, ka qenë ambasador dhe përkues i këtij qytetërimi në Francë dhe më gjerë, si dëshmojnë, ndër të tjera, edhe këto shkrime të tij nëpër enciklopedira dhe përmbledhje shkencore : « Notice sur l'histoire de l'Albanie », *Encyclopedia universalis*, v. I, Paris, 1968, f. 551-554 ; « Notice sur Esad Mekuli », *Histoire des littératures*, Paris, 1976 ; « La littérature albanaise », *Histoire littéraire de l'Europe médiane des origines à nos jours*, Paris, 1998, f. 19-29 ; « Le Kosovo dans la littérature albanaise », *Annales de l'autre Islam*, n° 7 (2001), f. 37-41 ; « Notices sur la littérature albanaise des XIVème-XIXème s., la littérature populaire et orale » *Dictionnaire universel des littératures*, Paris, 1994, « Pasco Wassas », *Dictionnaire universel des littératures*, Paris, 1994, f. 83-84; 2946 dhe 3991. Këtyre u duhen shtuar edhe ligjëratat e videokonferencat për të drejtën zakonore shqiptare, sidomos për Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Profesor Gyti i ka kushtuar vëmendje të veçantë mësimdhënies së gjuhës shqipe në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Lindore në Paris. Ai ka hartuar disa doracakë për këtë mësimdhënie, si « Les sources en langue albanaise de l'histoire de l'Albanie, des origines au début du XIXème siècle (fasc. 1). Sources littéraires », Paris, 1970, 34 f. ; « Les sources en langue albanaise de l'histoire de l'Albanie, des origines au début du XIXème siècle (fasc. 2). Sources ethnographiques », Paris, 1970, 33 f., « Les sources de l'histoire de l'Albanie (fasc. 3). Littérature populaire », Paris, 1972, 33 f. dhe « Les sources ... de l'histoire de l'Albanie ... (fasc. 4). Sources diplomatiques et juridiques ».

Gjendjen e studimeve albanologjike dhe mësimdhënien e shqipes në Francë i ka parashtruar në shkrime e kumtesa të ndryshme, si, p.sh., « L'état présent des études albanologiques en France », *Akten des internationalen Kolloquiums ... zum Gedächtnis an Norbert Jokl*, Innsbruck, 1977, f. 113-118 dhe « Mësimi i gjuhës shqipe në Francë dhe sot », *Gjuha jonë*, n° 1 / 4, Tiranë, 1995 f. 113-127.

\*

\* \*

Përveç kontributeve shkencore si arkivist-paleograf i historisë së mesjetës franceze, me rreth 100 artikuj dhe disa libra të botuara për këtë fushë studimi, K. Gyti ka hartuar edhe për historinë e Shqipërisë një seri shkrimesh, si « Inventar i Korrespondencave të Konsujve të Francës në Durrës », 1699-1726, *Gjurmime albanologjike*, n° 1-2, Prishtinë, 1970, p. 295-312; « Les structures administratives de l'Albanie pendant les premières années de son indépendance », *Colloque Langues O'*, Paris,

1984, f. 75-85 ; « Notices sur l'histoire de l'Albanie, Ali pacha et Les îles ioniennes », *Dictionnaire Napoléon*, Paris, 1987, f. 59, 64-65 dhe 937-938 ; « Religions et identités culturelles en Europe centrale et orientale, l'exemple albanais », në *Groupe de travaux sur l'Europe centrale et orientale. Bulletin d'information*, n° 2, 1978, f. 38-41 dhe 50-58 ; « La commission internationale de contrôle et le statut organique de l'Albanie », *Albanie*, n° 16, 1989, f. 26-32 ; « La vendetta dans le Kanun », *Albanie utopie. Huis clos dans les Balkans*, Paris, 1996, f. 62-67 ; « Organizimi administrativ, juridik dhe ushtarak i Shqipërisë, 1912-1914 », *Seminari XVIII ndërkombëtar për gjubën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Tiranë, 1996, f. 47-54 ; « Une œuvre peu connue de Pasco Wasa *Esquisse historique sur le Monténégro* », *Seminari i katërt ndërkombëtar Shkodra në Shekuj*, v. 1, Shkodër, 2002, f. 171-176 ; « Un document inédit sur les rapports de Pashko Vasa et de Preng Bib Doda », *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Studime*, 8-9, Prishtinë, 2002, f. 325-329 ; « Çështja e Lindjes », *Buletini shkencor i Universitetit « Aleksandër Xhuvani »*, Elbasan, 2004, n° 2, f. 207-228 ; «Bosnja dhe Herzegovina vështuar prej Pashko Vasës (1863-1864) », *Buletini shkencor i Universitetit « Aleksandër Xhuvani »*, Elbasan, 2004, n° 2, f. 97-106, etj.

\*

\* \*

Vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe studimit të shqipes, ndërtimit të saj gramatikor, sidomos në rrafshin filologjik, përqasës dhe krahasues : « Kontakte linguistike midis shqipes dhe maqedonishtes », *Gjurmime albanologjike*, n° III, 1973, f. 51-55 ; « Combien l'albanais a-t-il de cas? », *Cahiers balkaniques*, n° 19, Paris, 1994, f. 207-216 ; « Një tekst shkodran i pabotuar i viteve 1850 », *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Studime*, 4, 1997, Prishtinë, 1998, f. 147-158 ; « Edhe një herë për tekstin e pabotuar shkodran të viteve 1850 », *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Studime*, 4, 1997, f. 339-341 ; « Vështrim përqasës midis sistemeve fonetike të gramatikës së Kostandin Kristoforidhit dhe asaj të Ogyst Dozonit », *Përmbledhje me studime për Konstandin Kristoforidhin*, Elbasan, 2002, f. 48-55 ; « Vështrim përqasës midis sistemeve [foljore] të gramatikës së Dozonit dhe asaj të Kristoforidhit », *Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare*, Tiranë, 2004, f. 245-254 ; « Pashko Vasa dhe alfabeti », *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Studime*, 12, Prishtinë, 2006, f. 61-65.

\*

\* \*

Megjithëse me funksione të larta në administratën franceze, ai ka gjetur kohën e duhur për të përkthyer disa prej veprave të njohura të letërsisë artistike, shkencore e politike shqiptare. Përkthimi i parë i botuar është *La ville du Sud (Qyteti i jugut)* i Ismail Kadarese, Paris, 1985, 190 f., me parathënie të Robert Eskarpitit. Ka përkthyer në shqip poezitë e Pashko Vasës të hartuara në frëngjisht, *Pashko Vasa, Vepra*, t. I, Prishtinë, 1989, f. 315-326 dhe në frëngjisht poezi të Preç Zogajt, *Poésie 93*, n° 46, Paris, 1993, f.

88-90. Ia ka dalë me sukses të përkthejë disa prej veprave nga më të vështirat për t'u përkthyer në gjuhë të huaj si *Grandeur et décadence du camarade Zulo* (*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zulo*) i Dritëro Agollit, Paris, 1990, 285 f. ; *La mort me vient de ces yeux-là* (*Vdekja më vjen prej syve të tillë*) i Rexhep Qoses, Paris, 1994, 321 f. me parathënie të Ismail Kadaresë dhe *Kanun de Lekë Dukagjini* (*Kanuni i Lekë Dukagjinit*), Pejë, 2001, 298 f. Për përkthimin e romanit *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zulo* është shkuar deri aty sa të thuhet se nuk është përkthim, por i shkruar në frëngjisht, dhe s'kishte sesi të ishte ndryshe, se e ka zgjatur përkthimin për vite të tëra, e ka limuar, i ka thënë gjërat ashtu si i thonë vetë nëpunësit francezë. Përkthimi i *Kanunit të Lekë Dukagjinit*, që i mori rreth 15 vite pune, është i vetmi deri më sot në frëngjisht. Ai është jo vetëm më i ploti, por edhe më i sakti ndër të gjitha përkthimet e bëra në gjuhë të tjera deri më sot, çka dëshmon për njohje të thellë të ligjit të maleve shqiptare. Një përkthim i tillë ndihmon për njohje më të mirë të vetëqeverisjes tradicionale shqiptare, por që, si model i vërtetë përkthimi, mund të ndihmojë njëherazi për përkthimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit në gjuhë të tjera. Ndër përkthimet me karakter më të përgjithshëm, janë edhe « Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut », (nga frëngjishtja në shqip), *Republika*, n° 1/2, 1994, f. 28-29 dhe *La question albanaise* (*Çështja shqiptare*) e Rexhep Qoses, Paris, 1995, 326 f. Ai ka të përkthyer, por të pabotuara, edhe vepra të tjera, si *Lulja e kujtimit* e Foqion Postolit, etj. Me përkthimet e veta nga shqipja në frëngjisht ka ndihmuar kolegët dhe miqtë e vet shqiptarë, si, p.sh., shkrimin e gjatë të Andromaqi Gjergjit « Kultura popullore shqiptare », për përmbledhjen *Peuples et civilisations européennes*, l'Encyclopédie de la Pléiade, etj., etj.

\*

\* \*

Letërsia shqiptare e ka joshur gjithmonë mikun e nderuar të shqiptarëve, ai është marrë gjatë me të dhe i ka kushtuar një seri shkrimesh, ndër të cilat mund të përmenden : « Poezitë e papërfillura të Pashko Vasës », *Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike*, n° XVI, Prishtinë, 1986, f. 169-182 ; « Mbi gjendjen ekonomike të familjes së Pashko Vasës », *Gjurmime albanologjike, seria e shkencave historike*, n° XVII, Prishtinë, 1987, f. 171-176 ; « Një ndodhi e panjohur nga jeta e Pashko Vasës », *Studime filologjike*, Tiranë, 1988, n° 2, f. 197-199 ; « [Pashko Vasa], Biografia me bibliografi », *Pashko Vasa. Vepra*, IV, Prishtinë, 1989, f. 233-238 ; « Conscience nationale et conscience européenne dans l'oeuvre d'Ismail Kadare », *Colloques langues O'. Convergences européennes*, Paris, 1993, f. 247-259 ; « Dorëshkrimet e vjershës *O moj shqypni* të Pashko Vasës », *Studime filologjike*, Tiranë, 1993, n°1-4, f. 137-140 ; « Pashko Vasa et son œuvre », *Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës. Studime*, 10, Prishtinë, 2004, f. 29-32, etj.

\*

\* \*



Përveç librave për historinë mesjetare të Francës, ka botuar edhe dy libra të karakterit albanologjik : *Parlons albanais*, Paris, 1999, 485 f., ribotuar disa herë, dhe *Pashko Vasa*, Prishtinë, 2008, 275 f. I pari, fryt i një bashkëpunimi me kolegë, është doracak me njoftime historike, gjeografike, etnografike, letrare, gjuhësore dhe me disa tekste bashkëbisedimesh nga më të nevojshmet, si edhe me dy fjalortha shqip-frëngjisht dhe frëngjisht-shqip. Ky doracak mbetet deri tani më i ploti në llojin e vet. I dyti, është studimi më i plotë monografik deri më sot për rilindasin e madh, që kaq shumë e ka joshur K. Gytin dhe për të cilin ai ka punuar vite e vite të tëra. Në këtë libër, fryt i një pune monografike kërkimore disadhjetëvjeçare, lexuesi gjen materiale dhe fakte të reja të njohura pak ose aspak për rilindasin tonë të ndritur, por edhe saktësinë dhe thellësinë e analizës shkencore të autorit.

Vitet nuk e kanë ndalur profesor Gytin të jetë i pranishëm edhe në mjediset universitare shqiptare, me kumtesa, cikle ligjëratah dhe shkrime në periodikët shkencorë të universiteteve shqiptare. Ai ka qenë i pranishëm në auditoret, foltoret dhe buletinet shkencore të Universitetit të Tiranës, të Universitetit të Elbasanit ‘A. Xhuvani’, të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, të atij të Gjirokastrës ‘E. Çabej’ etj.

*Magister dixit (Mjeshtri e tha fjalën e tij)* – thekson një thënie latine. Në respekt të kësaj fjale, institucione të ndryshme universitare dhe shkencore shqiptare e kanë nderuar atë me tituj të lartë shkencorë dhe akademikë, si Anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (1996), Profesor i jashtëzakonshëm i Universitetit « Aleksandër Xhuvani » të Elbasanit (1998), Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tiranës (2000).

\*

\* \*

Mjeshtri e tha fjalën e tij – por në fakt mjeshtri ka ende shumëçka për të thënë, madje shtysat mbeten të fuqishme jo vetëm nga mendja por edhe shpirti. *Ecce Homo (Ja njeriu)* - do të mund të përsëritnim duke iu referuar nja latinizmi të huazuar më tej edhe nga Niçja. Me një akt domethënës bamirësie tash së fundi profesor K. Gytin i dhuroi Bibliotekës së Universitetit të Elbasanit bibliotekën e vet albanologjike e balkanologjike, fondi i së cilës arrin në rreth 5 mijë ekzemplarë, që përfshijnë rreth 3500 tituj; tituj që do t’i bënin nder çdo biblioteke universitare e akademike. Në të ka vlera, libra të rrallë e botime të vjetra si *Historia e Skënderbeut* e Lavardënit, *Fjalori* i F. Bardhit, *Gramatika e gjuhës shqipe* e Ogyst Dozonit etj., sidomos libra të botuar në shekullin XX, tashmë të rrallë. Me interes është fakti se ka, në seri të plota, revistat dhe përmbledhjet albanologjike të botuara në Shqipëri, Kosovë, diasporë e gjetiu.

Dhurimi i një biblioteke të tërë sjell në mjedisin ku dhurohet jo vetëm dijeni, kulturë, informacion, por, njëkohësisht me to, edhe praninë e gjithëkohshme pranë atij institucioni të modelit të dijetarit që e ka krijuar në vite atë pasuri, si shenjë të përkushtimit mendor ndaj një gjuhe, kulture dhe qytetërimi; sjell praninë e modelit të studiuesit që ka qëmtuar me kujdes dhe dashuri vlerat e atij qytetërimi, duke u lënë brezave të studiuesve dhe studentëve frymën e dijes. Ishte ky model, i ngjizur në vlera të spikatura intelektuale dhe shpirtërore të cilin Këshilli Bashkiak i qytetit të Elbasanit kërkoi ta nderojë duke i akorduar profesor K. Gytit titullin ‘Qytetar nderi’ (2012).

Mjeshtri ka ç’të thotë sërish edhe në shkencë. Ai ndodhet në punë e sipër për përgatitjen e materialeve për një histori të Skënderbeut në frëngjisht dhe një tjetër për të drejtën zakonore shqiptare. Njeriu që nuk di veçse të punojë është duke bashkëpunuar gjithashtu për një fjalor shqip-frëngjisht të tipit të mesëm.

Le të presim fjalët e tjera të mjeshtrit dhe t’i përgjigjemi atij me respekt të shumëfishuar.

Shkumbin MUNISHI

## KONTRIBUTI I JANET BYRON PËR HISTORINË E STANDARDIZIMIT TË SHQIPES

### *Abstrakt*

Në këtë punim trajtohen pikëpamjet e autores amerikane Janet Byron për shqipen standarde dhe për bazën e saj dialektore. Autorja në fjalë bën një përshkrim sociolinguistik të procesit të standardizimit të shqipes, duke konstatuar se pas vitit 1945 qe ndërprerë procesi i standardizimit të shqipes i bazuar në dialektin e Elbasanit, me përzgjedhjen e dialektit të Jugut si bazë dialektore e shqipes standarde. Autorja e cilëson këtë proces si përzgjedhje midis alternativash të ndryshme, në të cilin rolin vendimtar në përzgjedhjen e standardit e ka luajtur establishmenti komunist i kohës. Konstatimin e saj se shqipja standarde është toskërishtja e normuar pas vitit 1945 Byron e bazon në faktin se ndryshoret kryesore midis dialekteve të ngritura në normë janë ato ndryshore të cilat i takojnë dialektit të Jugut.

*Fjalët kyçe:* shqipja standarde, dialekt, gegërishtja, toskërishtja, politikë dhe planifikim gjuhësor, Rilindja Kombëtare, sociolinguistikë.

### 1. Sfondi

Procesi i standardizimit të shqipes, i trajtuar në rrjedhën e tij historike nxjerr në pah ndikimin e fuqishëm të faktorëve jashtëgjuhësor në rrjedhat e planifikimit të gjuhëve dhe të politikës gjuhësore. Ky ndikim i faktorëve jashtëgjuhësor është i ndërlikuar ngushtë dhe i përcaktuar nga ndryshimet e përgjithshme shoqërore dhe ideologjike, të cilat manifestohen brenda bashkësive shoqërore.

Në trajtimet e rrjedhave të planifikimit të shqipes standarde dhe të politikës gjuhësore në Shqipëri dhe në Kosovë, nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e deri në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, për një periudhë të gjatë ka ekzistuar vetëm një e qëndrim zyrtar për shqipen standarde, për rrugën e formimit të saj, për bazën dialektore dhe për sistemin e saj. Ky qëndrim zyrtar, në fillim të viteve '50 të shekullit

XX, i shprehur sidomos në sesionet e vitit 1952, ka qenë se shqipja standarde është toskërishtja. Pa dashur të futemi në trajtime më të shteruar, një konstatim i tillë mund të ilustronet më së miri me argumentimet që Dhimitër Shuteriqi, i cili në atë kohë ishte nënkryetar i Lidhje së Shkrimtarëve dhe anëtar i Institutit të Shkencave, i bënte shqipes standarde që po përvijohet, në sesionet e vitit 1952. Duke pohuar se dallimi midis dy dialekteve të shqipes nuk është aq i madh, se toskërishtja u bë dialekti më i shkruar për shkak të epërsisë së Jugut në pikëpamje ekonomike, kulturore, politike që nga Rilindja, se kleri katolik që ishte gegë nuk u përpoq për bashkimin e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, se toskërishtja edhe gjatë LNÇ-së mbisundoi gjerësisht dhe se në këtë kohë Jug, i cili ishte vatra më e madhe e Luftës nxori më shumë kadro të reja, Shuteriqi përfundonte se nuk mund të mohohet se baza e gjuhës letrare shqipe ishte toskërishtja (Shuteriqi, 1952, Ismajli, 1998; Munishi, 2002, 2013). Vërehet qartë që argumentet kryesore të Shuteriqit nuk bazoheshin në argumente gjuhësore, por ishin kryekëput argumente të karakterit politik dhe ideologjik. Edhe në atë periudhë pati autorë, të cilët kërkonin që çështja e shqipes standarde duhet të merrej më shtruar dhe këtu në radhë të parë kemi parasysh pikëpamjet e Aleksandër Xhuvanit, Eqrem Çabejtë, Osman Myderrizit e Lirak Dodbibën, të cilët në sesionet e vitit 1952 dolën hapur kundër qëndrimeve zyrtare të shprehura lidhur me shqipen standarde nga Dhimitër Shuteriqi, Sejfullah Maleshova e disa autorë të tjerë që insistonin që toskërishtja të ngrihej në normë si gjuhë standarde. Në ato vite nuk ka asnjë dyshim se perceptimi i përgjithshëm publik ishte se shqipja standarde ishte toskërishtja dhe kjo gjë thuhej haptas.

Nga viti 1955 hetohen shenjat e para të modifikimit të ndryshimit të qëndrimit zyrtar se shqipja standarde ishte toskërishtja e ngritur në normë. Modifikimi i këtij qëndrimi vërehet së pari në deklaratimet e udhëheqësit kryesor të partisë dhe të shtetit shqiptar të asaj kohe, Enver Hoxhës. Më 15 qershor 1955 Enver Hoxha deklaronte: “gjuha e sotme letrare shqipe nuk është toskërishtja e ngritur drejtpërdrejt në gjuhë kombëtare, por është e ndërtuar mbi bazën e elementit të përbashkët të shqipes, duke thithur njëkohësisht në përpjesëtime të ndryshme elementet e veçanta e të rëndësishme nga struktura fonetike, gramatikore e leksikore e të dy dialekteve” (cituar sipas Luka, 1993:68; Munishi 2002). Më tej, ky konstatim do të shërbejë si bazë për të gjitha trajtimet e rrugës së standardizimit të shqipes në Shqipërinë komuniste dhe, pas vitit 1968, këto argumente do të përdorshin edhe në Kosovë. Nga fundi i viteve '50 të shek. XX, Androkli Kostallari do të bëhej interpretuesi kryesor i procesit të standardizimit të shqipes dhe i çështjeve gjuhësore e jashtëgjuhësore të ndërlidhura me këtë proces. Pikëpamjet e tij kryesore për shqipen standarde dhe për procesin e formimit të saj mund të përmblihen në disa shtylla:

- gjuha letrare kombëtare është formuar historikisht gjatë shekullit XX dhe po kristalizohet përfundimisht si një koine letrare *sui generis*

- politika gjuhësore në Shqipërinë socialiste ishte përpunuar në mënyrë të thellë shkencore e me perspektivë shumë të qartë nga shoku Enver Hoxha dhe ka gjetur shprehje të shumanshme në veprën e tij... me hyrjen e Shqipërisë në rrugën e socializmit, shoku Enver Hoxha e bëri çështjen e gjuhës një nga çështjet qendrore të kulturës e të shkencës kombëtare, e vuri trajtimin e zgjidhjen e saj mbi bazën e patundshme të metodologjisë marksiste-leniniste. Mbi këtë bazë ai bëri edhe rivlerësimin e vlerave të traditës dhe i integroi në politikën gjuhësore të epokës sonë idetë themelore të rilindësve.
- baza dialektore e shqipes standarde është e ndërtuar nga elemente të përbashkëta të të dy dialekteve ku pesha specifike cilësore e këtyre elementeve të përbashkëta zë vendin kryesor në të gjitha nënsistemet e gjuhës sonë letrare shqipe.
- në bazën fonetike të gjuhës letrare shqipe përveç elementeve të përbashkëta, janë gërshetuar edhe elemente të veçanta të të dy dialekteve. Për nga sasia mbizotërojnë elementet e dialektit jugor, por ky nuk është edhe ndonjë mbizotërim cilësor, për shkak të pranisë së elementeve të dialektit verior.
- në sistemin morfologjik në elementet dialektore nga sasia mbizotërojnë elementet e dialektit jugor, por ky nuk është njëkohësisht edhe një mbizotërim aq i thellë cilësor, prandaj në krahasim me fonetikën, në fushën e normave morfologjike shtohet pesha specifike e elementeve tipike për të folmet veriore dhe mbizotërimi i elementeve tipike për të folmet jugore bëhet me i vogël se në fonetikë.
- në sistemin sintaksor norma letrare nuk mund t'i zgjidhte problemet në planin sintaksor të shkëputura nga plani morfologjik. Ajo zgjodhi kështu drejtimin e rrudhjes së ndërtimeve që lidhen me paskajoren e tipit me+pjesore dhe kjo ka pakësuar shumë në shkrim dallimin themelor sintaksor midis varianteve letrare të veriut dhe jugut, duke lehtësuar kristalizimin e një norme të njësishtme sintaksore

Këto pikëpamje të Kostallarit, të cilat i kemi trajtuar në një vend tjetër dhe këtu i paraqitem në mënyrë të përgjithësuar, shërbyen si bazë për ta ndërtuar të vërtetën e vetme për procesin e formimit të shqipes standarde dhe strukturës së saj në Shqipërinë socialiste deri në fillim të viteve '90 të sh. XX (Munishi, 2002, 2013).

Edhe në Kosovë, nga viti 1968 deri më 1990, me përjashtime të rralla, konceptet e Kostallarit u përqaftuan, u riinterpretuan dhe u bënë bazë për përshkrimin e procesit të standardizimit të shqipes. Argumentime të ngjashme me ato të Kostallarit i gjejmë të Idriz Ajeti (1973, 1980), Fadil Raka (1997).

Duhet theksuar se deri në fillim të viteve '90 të shek. XX zërat e vetëm që kundërshtonin pikëpamjet zyrtare për shqipen standarde shpreheshin nga autorë shqiptarë, të cilët jetonin dhe vepronin kryesisht në vendet perëndimore. Këtu, në radhë të parë, kemi parasysh pikëpamjet e shprehura nga Tahir Kolgjini (1974) dhe Arshi Pipa (1989). Nga mesi i viteve '70 të shekullit të kaluar autorja amerikane Janet Byron u shfaq në opinionin shkencor me një studim të saj sociolinguistik mbi shqipen standarde, studim ky i cili, duke qenë se qe kryer nga një studiuese e huaj, mund të konsiderohej si një qasje objektive në trajtimin e procesit të standardizimit të shqipes. Në vazhdim do të paraqiten pikëpamjet e saja kryesore për rrugën e formimit të shqipes standarde, për bazën dialektore dhe për sistemin e saj.

## 2. Pikëpamjet e Byron-it për shqipen standarde

Autorja amerikane Janet L. Byron është, në fakt, studiuesja e parë e huaj që u mor me trajtimin e ecurisë së standardizimit të shqipes pas Luftës së Dytë Botërore. Për dallim nga gjuhëtarët shqiptarë të kohës, të cilët problemin e shqipes standarde e trajtonin kryesisht nga këndvështrimi linguistik, shpeshherë edhe nga aspekti ideologjik, Byron-i në trajtimin e saj të rrugës së formimit të shqipes standarde niset nga qasja sociolinguistike. Baza teorike e pikëpamjeve të saja mbështetet në konceptet sociolinguistike të kohës lidhur me planifikimin gjuhësor dhe politikën gjuhësore. Qasja e Byron-it paraqiste një përpjekje të re, më ndryshe dhe më gjithëpërfshirëse, për ta trajtuar procesin e standardizimit të shqipes. Këtë trajtim sociolinguistik të rrugës së formimit të shqipes standarde ajo e mbështeste në konceptet e autorëve, si Punya Sloka Ray, Einar Haugen, Valter Tauli dhe Jiri V. Neustupný, të cilët në mënyrë teorike përvijuan drejtimit të cilat i ndjekin gjuhët standarde në proceset e planifikimit të gjuhëve. (Byron, 1976: 17-30).

Në rastin e shqipes, ajo niset nga një përshkrim kronologjik i zhvillimeve kryesore në shqipe që nga Rilindja Kombëtare e këndeje, si dhe nga përshkrimi i tipareve kryesore dalluese dhe i tipareve të përbashkëta të dy dialekteve të shqipes. Ajo konstaton me të drejtë se Rilindja Kombëtare ishte periudha kur u shprehën pikëpamjet e para për nevojën e formimit të shqipes standarde. Kjo ndodhte për faktin se rilindësit gjuhën e shihnin si një mjet unifikues për kombin (f. 39), ndonëse kemi të bëjmë me ide të përgjithshme, pa elaborime më të thella lidhur me rrugët eventuale të cilat duhej të ndiqeshin (f. 53). Në këtë pikë Byron-i është në një linjë me pothuajse të gjithë studiuesit shqiptarë, të cilët janë marrë me trajtimin e procesit të standardizimit të shqipes, të cilët zanafillën e këtij procesi e shohin në Rilindjen Kombëtare. Rilindja Kombëtare dhe rrethanat historike në të cilat ka ndodhur ajo, si dhe sfondi ideologjik i saj, padyshim i

kanë krijuar rrethanat për shfaqjen e pikëpamjeve për nevojën dhe rëndësinë e krijimit të shqipes standarde.

Më tej ajo ndalet në trajtimin e dialekteve të shqipes dhe në këtë kuadër konstaton afërsitë midis dialekteve të shqipes dhe kuptueshmërinë reciproke, por përshkruan edhe dallimet sistemore, të cilat ekzistojnë midis toskërishtes dhe gegërishtes. Sipas Byron-it dallimet më të mëdha midis toskërishtes dhe gegërishtes shfaqen në rrafshin fonetik, sidomos në vokalizëm dhe më pak në konsonantizëm. Ndërkaq dallimet morfo-sintaksore sipas saj janë më të vogla. Byron identifikon pesë dallime kryesore që, sipas saj, ekzistojnë midis toskërishtes dhe gegërishtes. Në këtë kuadër ajo ka parasysh: dukurinë e rotacizmit në toskërishte dhe mungesën e kësaj dukurie në gegërishte; dallimet në grupet nistore *va* për toskërishten dhe *vo* për gegërishten; ekzistencën e ë-së së theksuar në toskërishte, së cilës në gegërishte u përgjigjen një â dhe ê; dukurinë e nazalizimit, e cila është e dpranishme në gegërishte dhe mungesën e kësaj dukurie në toskërishte; dhe, së fundi, ekzistencën e formave të paskajores në gegërishte të tipit *me punue*, së cilës në toskërishte i përgjigjen format e pashtjelluara të tipit *për të punuar* dhe format e lidhores së foljeve. Më tej, ajo paraqet edhe dallimet e tjera midis dialekteve, por konsideron se këto pesë tipare paraqiten si dallime më kryesore (f. 43-44). Përveç dallimit të grupeve nistore *va-vo* midis dy dialekteve, i cili paraqitet si dallim në një numër të kufizuar fjalësh dhe nuk çon peshë, Byron konstaton me të drejtë se dallimet e tjera janë praktikisht dallimet me thelbësore sistemore midis dy dialekteve të shqipes.

Në vazhdim ajo përshkruan përpjekjet për standardizimin e shqipes para vitit 1945 dhe konstaton me të drejtë se që nga Kongresi i Elbasanit dhe pastaj me Komisin Letrare të Shkodrës, dialekti qendror, jo krejtësisht e folmja e Elbasanit, u ngrit në normë dhe u përdor si gjuhë me status zyrtar deri më 1944. Pas luftës, elbasanishtja nuk favorizohej më dhe mbase qëndrimet zyrtare ndaj kësaj norme kishin qenë negative (f. 57-58). Më tej, duke përshkruar rrjedhat e planifikimit të shqipes pas LDB, ajo konstaton se toskërishtja me mbështetjen e elitës politike të kohës, e cila me origjinë ishte me shumicë kryesisht nga zonat jugore të Shqipërisë, po bëhej gjuhë standarde. Në të vërtetë, ajo konstaton me të drejtë se deri nga mesi i viteve '60 të shekullit XX në opinion mbizotëronte pikëpamja se shqipja standarde ishte toskërishtja. Më pas, ky qëndrim u ndryshua, sidomos nga Androkli Kostallari, i cili në shkrimet e tij të shumta për shqipen standarde i mbronte qëndrimin se shqipja standarde ishte përzierje dialektesh, apo koine letrare *sui generis*, siç dëshironte ta quante ai (sh.m.) (f. 59-62). Ky qëndrim bazohej në ekzistencën e disa elementeve të përbashkëta në standard. Por, Byron ndonëse pranon një shkallë të përzierjes së dialekteve përbrenda standardit për shkak të pranisë së elementeve të gegërishtes, hedh poshtë pikëpamjen se shqipja standarde është përzierje dialektesh. Pikëpamjen e saj të kundërt ajo me të drejtë e bazon

në faktin se nga pesë izoglosat kryesore, siç i quan ajo, të cilat ekzistojnë midis toskërishtes dhe gegërishtes, të gjitha alternativat përkatëse të toskërishtes janë ngritur në normë (f. 62-65). Sipas saj, elementet e caktuara të gegërishtes që janë përfshirë në standard, këtu e ka fjalën për grupin *zanor ue* dhe për përemrin pronor *i vetë*, mund të konsiderohen si huazime të gegërishtes në toskërishte dhe rrjedhimisht në standard (f. 62). Këto forma alternative të gegërishtes ajo i quan me terma të Joshua Fishmanit, si “forma të dëshirueshme kundrejt formave të padëshirueshme”, të cilat janë lënë jashtë standardit, siç janë p.sh. pjesoret e shkurtuara dhe paskajorja e gegërishtes. Këto elemente të dëshirueshme mbase janë pranuar edhe për faktin se qenë përdorur më parë në toskërishten letrare, por edhe në dokumentet e shkruara të lëvizjes komuniste gjatë LNÇ-së. Këto elemente, sipas saj, duket të kenë qenë elemente të cilat i kanë mbuluar zbrazëtitë që i ka pasur toskërishtja (f. 88-89). Duke u nisur nga dallimet dialektore dhe nga përkrahimi i sistemit fonologjik-fonetik dhe morfo-sintaksor i shqipes standarde, ajo konstaton me të drejtë se baza dialektore dhe shqipja standarde, në përgjithësi, mbështeten në dialektin e jugut.

Qëndrimi ndaj këtyre pikëpamjeve të Janet Byron në gjuhësinë shqiptare fillimisht ka qenë refuzues dhe mohues. Ky refuzim dhe ky mohim në fillim ka ardhur nga Androkli Kostallari. Ndonëse në punimet e tij nuk kam gjetur gjëkund të ketë bërë një paraqitje të pikëpamjeve të saja dhe pastaj t'i diskutojë ato me argumente shkencore, për qëndrimet e Byronit, Kostallari shprehej se: “Nga pozita aprioristike, në ndonjë punim të veçantë janë bërë edhe përpjekje për ta futur mekanikisht formimin e shqipes letrare të njësuar në disa skema të përgjithshme të sociolinguistikës së sotme. Ndër to bie në sy sidomos monografia e Xhenet Bajronit me titull “Përzgjedhja ndërmjet alternativave në standardizimin e gjuhës: Rasti i shqipes” botuar nën drejtimin e sociolinguistikës të njohur Xhoshua Fishman”... “Në këtë vepër, që përmban mjaft pohime kundërthënëse, formimi i shqipes letrare të njësuar trajtohet në mënyrë të shtrembëruar e të thjeshtëzuar. Përfundimet themelore që jepen aty nuk kanë dalë nga analiza e thelluar e objektivit të sistemit dhe e nënsistemeve të gjuhës letrare shqipe, të parë në zhvillimin e saj të pandërprerë, në lidhje të ngushtë me faktorët shoqërorë e me dialektet, sidomos nga epoka e Rilindjes Kombëtare. Ato janë nxjerrë në mënyrë subjektive, duke zbatuar mekanikisht e në mënyrë eklitike për shqipen teza e përfundime të një vargu sociolinguistikësh si Punya Sloka Rey, Einar Haugen, Valter Tauli, Jiri V. Neustupny, Joshua A. Fishman, Charl A. Ferguson etj. të cilët, siç dihet, kanë trajtuar, mjaft herë nga pozita të ndryshme e të njëanshme, aspekte të përgjithshme të ‘standardizimit’ të gjuhëve e çështje të gjuhëve të veçanta, sidomos joeuropiane, por nuk kanë pasur asnjëherë si objekt studimi gjuhën shqipe” (Kostallari, 1984:37).

Në anën tjetër, pikëpamjet e saj, jo vetëm që janë paraqitur besnikërisht, por në masë të madhe janë tumirë, fillimisht nga Rexhep Ismajli, dhe pastaj nga Bahri Beci dhe



autorë të tjerë. Këto pikëpamje kanë kontribuar në mënyrë vendimtare në ruajtjen e së vërtetës shkencore në studimet të cilat synojnë ta trajtojnë procesin e standardizimit të shqipes në mënyrë shkencore dhe pa ngarkesa politike e ideologjike.

### **Përfundime**

Pikëpamjet e Janet Byron për procesin e standardizimit të shqipes paraqesin padyshim një kontribut të çmuar për historinë e shqipes standarde. Autorja amerikane, në të vërtetë, ishte e para që me një bazë të fortë teorike sociolinguistike dhe me argumente shkencore, po përshkruante drejt rrugën që ishte ndjekur në standardizimin e shqipes, sidomos nga viti 1945 e këndej. Në këtë kuadër ajo na sjell tri të vërteta të pamohueshme, të cilat përbëjnë bazën e qëndrimeve të saja.

E para, që pas Luftës së Dytë Botërore që ndërprerë zhvillimi i dialektit qendror (elbasanishtes) në gjuhë standarde, proces ky që kishte marrë hov nga Komisia Letrare e Shkodrës deri më 1945.

E dyta, në rastin e përzgjedhjes së bazës dialektore të shqipes standarde pas vitit 1945, establishmenti komunist i kohës në Shqipëri kishte luajtur rol vendimtar, duke e mbështetur dialektin e Jugut.

E treta, nga pesë dallimet kryesore dialektore midis toskërishtes dhe gegërishtes, që të pesë format alternative të toskërishtes janë ngritur në normë, duke e ngritur kështu toskërishten letrare në nivel të gjuhës standarde, e cila u normua pastaj në vazhdimësi nga viti 1947 e këndej.

Pikëpamjet e Byronit, ndonëse për një kohë të gjatë nuk u bënë publike në gjuhësinë shqiptare, erdhën në kohët kur e vërteta për shqipen standarde dhe për procesin e normimit të saj po fshihej dhe po retushohej nga gjuhëtarët shqiptarë të kohës, pa ndonjë arsye të fortë praktike, por më shumë për arsye të luftës ideologjike dhe politike klasore.

Kontributi më domethënës i Byronit për historinë e standardizimit të shqipes qëndron në faktin se pikëpamjet e saja, jo vetëm që janë të paanshme dhe të pangarkuara me ngarkesa ideologjike absurde, por bazohen në argumente shkencore dhe në koncepte teorike sociolinguistike të qëndrueshme.

## Referencat

1. Ajeti, Idriz (1973). *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë. Studime filologjike*. Tiranë.
2. Ajeti, Idriz (1980). *Probleme aktuale të kulturës së gjuhës. Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe*. Instituti Albanologjik. Prishtinë 1983.
3. Ajeti, Idriz-Lafe, Emil (1998). *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrimen në të ardhmen)*. Studime filologjike 1-2. Tiranë.
4. Beci, Bahri (2002). *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*. Dukagjini. Pejë.
5. *Buletin për Shkencat Shoqërore IV*, Tiranë 1952
6. Byron, Janet L. (1976). *Selection among alterantes in language standardization: The case of Albanian*. Mouton, The Hague, Paris. Printed in Netherlands.
7. Dodëbiba, Lirak (1952). *Mbi gjuhën letrare kombëtare*. *Buletin për Shkencat Shoqërore IV*. Tiranë.
8. Ismajli, Rexhep (1998). “Në gjuhë” dhe “për gjuhë” (Rrjedhat e planifikimit të shqipes në Kosovë 1945-1968). Dukagjini. Pejë.
9. Kolgjini, Tahir (1974). *Shqiptarët në Jugosllavi dhe gjuha e unjisuar, Shëjzat – Gli Pleiadi 1-10*. Romë.
10. Kostallari, Androkli (1984), *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984)*. Tiranë 1988.
11. Luka, David (1993). *Përse ithtarët e Kongresit të Drejtshkrimit nuk e pranojnë debatin shkencor*. *Hylli i dritës 2-3*. Tiranë.
12. Munishi, Shkumbin (2002). *Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për shqipen standarde*. Zero Print. Prishtinë 2013.
13. Munishi, Shkumbin (2007). *Pikëpamjet e Idriz Ajetit për bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe*. ASHAK. Prishtinë.
14. Myderrizi, Osman (1952). *Problemi i gjuhës letrare të përbashkët*. *Buletin për Shkencat Shoqërore IV*. Tiranë.
15. Pipa, Arshi (1989). *The politics of language in socialist Albania*. Columbia University Press. New York.
16. Raka, Fadil (1997). *Historia e shqipes letrare*. Universiteti i Tetovës. Blendi. Prishtinë.
17. Shuteriqi, Dhimitër S. (1952). *Mbi gjuhën letrare kombëtare*. *Buletin për Shkencat Shoqërore IV*. Tiranë 1952.

**Merita HYSA**

**SHTRESËZIME KONCEPTUALE NË “ALBANIAN PHONOLOGY”  
TË G.L.BEVINGTON**

Struktura fono-gramatikore e shqipes, është bërë shpesh objekt studimi nga gjuhëtarë vendas dhe të huaj. Nivelet e përfaqësimit gjuhësor, si dhe mënyra e bashkëveprimit të tyre ka ngjallur kureshtjen e studiuesve të ndryshëm, pasi korpusi gjuhësor nuk mund të shihet si një shtresëzim i pjesshëm nivelesh, por si një strukturim i plotë i elementeve të sistemit, ku secili prej tyre bashkëvepron natyrshëm me nivelet e tjera të organizimit gjuhësor.

Shembuj të një ndërveprimit të tillë të rrafshve gjuhësore na sjell “*Albanian Phonology*” e albanologut amerikan Gary Loyd Bevington.

Përmes një shtrirjeje inovative të proceseve fonologjike, nën ndikimin e të dhënave që ofronte gjuhësia gjenerative, ai paraqet një këndvështrim të ri në studimet shqiptare.

Në këtë punim do të ndalemi në analizën e fakteve gjuhësore, të sjella nën një dritë krahasuese, si në nivel fonologjik, ashtu edhe në shkëndijat e para të së ashtuquajturës fonologji leksikore, të cilën autori e trajton hollësisht kur studion përbërjen fonemore të strukturave morfemore të shqipes, si dhe proceset fonologjike që ndodhin gjatë përdorimit të fjalëve në paradigma të ndryshme.

Kur flasim për studim gjuhësor, kemi parasysh trajtimin e detajuar të të gjitha elementeve që karakterizojnë një gjuhë të veçantë. Autori përpiket të rrokë në planin më të gjerë rregullsitë dhe problematikat (në nivel teorik dhe praktik), që dalin nga vëzhgimi i mënyrës se si funksionon një gjuhë e veçantë si shqipja. Përmes një shqyrtimi në nivelet e përfaqësimit në të cilat shfaqen njësitë bazë gjuhësore, Bevington parashtron modele të hollësishme analize fono-morfologjike të ndikuara nga ciklet gjenerative.

Ashtu siç e thekson edhe vetë autori, thelbi i punimit të tij kishte të bënte me trajtimin sistematik të problemeve në nivel fonologjik dhe morfologjik në dy paradigmat themelore, atë foljore dhe emërore.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> G.L.Bevington, *Albanian Phonology*, Wiesbaden, 1974, f.1.


Duke qenë se në kohën kur është bërë studimi, nuk ishte kristalizuar ende një normë e ngulitur e shqipes<sup>2</sup>, autori ka përdorur si korpus analize organin zyrtar të shtypit të shkruar të kohës “Zëri i Popullit”. Ai thekson faktin<sup>3</sup> që kjo është një formë e shkruar dhe jo e folur gjuhësore, por përmend maketet ortografike dhe ortoepike që ishin duke u shqyrtuar në ato vite.<sup>4</sup>

Në përpjekjen për të kuptuar qartë proceset fonologjike nën dritën e gramatikës gjenerative, autori strukturon bazën teorike mbi të cilën mbështeti analizat mbi korpusin e shqipes, duke i kundruar strukturat fonologjike si elemente të strukturave dhe proceseve gramatikore.

Zhvillimi i fonologjisë gjenerative (dhe i gramatikës gjenerative në përgjithësi) ka lindur nga një mënyrë e re e të vështruarit të fakteve gjuhësore. Përkrahësit e saj, shpreheshin se gramatika gjenerative ishte këndvështrimi i parë shkencor i fakteve gjuhësore, i pari që renditi në një formë të tillë marrëdhëniet mes nënsistemeve gjuhësore dhe që mund të quhej një teori e plotë shkencore<sup>5</sup>.

Teoria e fonologjisë gjenerative, merret me strukturat sipërfaqësore që gjeneron përbërësi sintaksor i gramatikës. Ajo mund të përfytyrohet si një mekanizëm që ka *hyrje* dhe *dalje* : në hyrje, përbërësi sintaksor i gramatikës jep vargun e përbërësve të drejtëpërdrejtë (“formativët” në terminologjinë gjenerativiste), kurse në dalje (output) kemi përfytyrimet tingullore të këtij vargu, dmth. vargun e foneve (Chomsky, 1965:519).<sup>6</sup>

Vargu i morfemave që i jepet fonologjisë nga sintaksa, përbën rrafshin bazë (underlying level), ose fonemor të rishkrimit. Pas zbatimit mbi njësitë e këtij rrafshi të një vargu rregullash fonologjike, përftohet forma sipërfaqësore (surface form), ose rrafshi fonetik i rishkrimit.



<sup>2</sup> (bëhet fjalë për vitin 1970)

<sup>3</sup> Po aty, f. 3.

<sup>4</sup> duke cituar A.Dodin 1968, apo kur përmend Fjalorin e gjuhës shqipe (1954)

<sup>5</sup> Po aty, f. 72.

<sup>6</sup> R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, 2008, f. 215.

Kemi dy koncepte të strukturës sipërfaqësore: njëri që është *dalje* (output) i përbërësit sintaksor dhe tjetri që shërben si *hyrje* (input) për rregullat fonologjike<sup>7</sup>.

Niveli i strukturës sipërfaqësore i përgjigjet konceptit të parë të strukturës sipërfaqësore, kurse niveli i rishkrimit fonologjik i përgjigjet konceptit të dytë. Këto dy nivele Çomski-Halle-ja i dallojnë, duke i quajtur përkatësisht “rishkrim leksikor” dhe “rishkrim fonologjik”. Me anë të rishkrimit leksikor jepen elementet leksikore dhe formantet gramatikore nga të cilat përbëhet struktura sipërfaqësore.

Duke ndjekur modelet algoritmike të teorive matematikore, fonologët gjenerativistë specifikuan një tërësi të dhënash që vepronin në nivelet themelore (underlying levels), që i quajtën hyrje (input), të cilat gjenerojnë struktura më komplekse në dalje (output).

Teoritë e hartuara nga gjuhëtarët gjenerativistë përfshinin renditjen e rregullave fonologjike, duke diferencuar të ashtuquajturën fonologji eksplicite (e qartë), e cila përdor mjete derivuese (që identifikohen përmes analizës në segmente të vazhdueshme) për të gjeneruar forma gjuhësore.

Format e vëzhguara nga Bevington, si në paradigmen foljore, ashtu edhe në atë emërore, jepen si prodhime (output) të një sekuence rregullash fonologjike, të cilat veprojnë mbi format bazë. Si rezultat, ai vëren se si rregullat e trajtëformimit (ose transformacionale) përdorshin për të gjeneruar format sipërfaqësore nga format bazë të strukturës së thellë foljore ose emërore.

Një parim i rëndësishëm i teorisë gjenerative ishte parimi i binarizmit, i cili mundëonte karakterizimin e tipareve me (+) ose (-), në kuptimin që segmentet ose janë të markuara (+) ose jo (-) me tiparet përkatëse. Binarizmi ishte një parim themelor jo vetëm në strukturën gjuhësore, por edhe në dijen njerëzore në përgjithësi (sikurse mendohet se edhe në kodet informatike të bazuara në alternimin e vlerave 1 dhe 0, ose në disa operacione logjiko-matematikore që bazohen në alternativat e saktë ~ e gabuar)<sup>8</sup>.

Tiparet nuk përshkruhen, dallohen, ose ndahen në klasa të veçanta, vetëm për të parashtruar dhe pasuruar inventaret tingullore të studiuara nga foneticienët dhe fonologët. Qëllimi i përkufizimit të tyre, që në fillim ishte të përshkruanin në mënyrë të pagabueshme njësitë segmentore në nivel fonologjik, si dhe të hidhnin dritë mbi ndërrimet fonetike.

Bevington për herë të parë e paraqet sistemin fonologjik të shqipes përmes tipareve binare, që nevojiten për të përshkruar segmentet tingullore të shqipes.

---

<sup>7</sup> P.Kiparsky, *From cyclic to lexical phonology*, në H. van der Hulst, N. Smith, eds. *The Structure of Phonological Representations*, Dordrecht: Foris, 1982, f. 86.

<sup>8</sup> C.P.,Browman, & L.,Goldstein, *Articulatory gestures as phonological units*, *Phonology*, 6, 1989, f. 218.

Megjithëse nuk i specifikon kriteret sipas të cilave grupohen, ai i parashtron hollësisht thujtë të gjitha tiparet, qoftë sipas klasave kryesore, vendit të formimit e shkallës së hapjes dhe mënyrës së formimit. Tiparet binare janë si më poshtë<sup>9</sup>:

- Silabik
- Konsonantik
- Sonorant
- I lartë
- I ulët
- I prapmë
- labial
- Koronal
- I zëshëm
- Kontinuant
- Hundor
- Strident
- Lateral (anësor)
- SHLN

Ai trajton edhe statusin e klasave themelore të tingujve, duke dalluar zanoret, bashkëtingëlloret dhe glide-t, të diferencuara këto si nga ana nyjëtimore ashtu edhe nga ajo funksionale. Është pikërisht prania e këtyre tipareve ajo që përlligj ndryshimet funksionale të strukturave segmentore në rrethime të ndryshme fonetike.

Përfaqësimet fonologjike që gjenerohen në strukturën sipërfaqësore, janë sekuenca lineare që shfrytëzojnë vlera të tipareve fonologjike të segmenteve. Bashkëveprimi, fshirja ose ndryshimi i tipareve gjatë proceseve fonologjike, është rezultat i ndikimit të disa rregullave fonologjike. Sipas këtyre rregullave fonologjike, transformimi i tipareve ndodh atëherë kur krijohen kushtet për një ndryshim të tillë, i cili kushtëzohet nga tipare me natyrë fonetike, pjesërisht edhe nga veçori fonomorfologjike. Të tilla ndryshime janë të detyrueshme. Bevington këto ndryshime i sheh në format paradigmatiche, si këmbime morfologjike të vetës, numrit e kohës te foljet, e të numrit e gjinisë te emrat.

Proceset fonologjike nuk janë të rastësishme, por sistematike dhe një prej detyrave të fonologjisë është të kuptojë dhe të përshkruajë mekanizmin e funksionimit të tyre, përmes një trajtimi teorik të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë nënkuptohet ekzistenca e një niveli më kompleks, që shfaqet përmes përfaqësimeve fonologjike, të

<sup>9</sup> G.L.Bevington, *Albanian Phonology*, Wiesbaden, 1974, f.20.

cilat falë rregullave transformacionale, projektohen në një nivel sipërfaqësor, që u korrespondon formave reale të prodhuara nga folësit<sup>10</sup>.

Në teorinë segmentore të fonologjisë, përfaqësimi ka të bëjë me një sekuençë lineare segmentesh ( zanore ose bashkëtingëllore) dhe me josegmente ( dmth kujfij morfemash + dhe fjalësh #), si dhe mbisegmentesh ( dmth. theksi, tonet etj).

Në këtë këndvështrim, segmentet konceptohen si njësi të përbëra nga një varg tiparësh të bazuara në kritere nyjetimore dhe pa ndonjë rend hierarkik, dmth. ato konfigurohen si një tërësi linearisht e parregullt tiparësh që shfaqin karakteristika të njëkohshme, të pranishme në artikulimin e segmentit.

Duke u mbështetur në teorinë gjenerative transformacionale, Bevington trajton proceset e ndryshimeve tingullore, që veprojnë në nivel paradigmatic, duke i përqsasur teorikisht me elemente nga shqipja. Në parim ai trajton të gjitha ato procese që ndryshojnë strukturën segmentore të fjalëve gjatë formave paradigmatiche.

Rregullat e fonologjisë segmentore shfaqin ndryshimet nga forma themelore, në atë sipërfaqësore, duke përshkruar ndryshimin përmes vargut të tipareve. Në përshkrimin e dukurive, fonologjia lineare shërbehet nga të ashtuquajturat rregulla fonologjike, dmth, përshkrime formale të dukurive fonologjike, të cilat specifikojnë përmes tipareve, se cili segment preket ose jo nga X dukuri a ndryshim dhe brenda cilës strukturë ndodh ky proces.

Në këtë mënyrë, ato tregojnë se:

- a- cili segment ndryshon;
- b- në ç'mënyrë ndryshon;
- c- në ç'kontekst ndryshon

Të gjitha këto informacione kodifikohen në rregulla fonologjike. Ato mund ti shprehim formalisht përmes algoritmit të mëposhtëm:

1.  $A \sim B / \_\_\_\_\_\_ Y$
2.  $A \sim B / X \_\_\_\_\_\_$
3.  $A \sim B / X \_\_\_\_\_\_ Y$ <sup>11</sup>

- ku **A**, është elementi që pëson ndryshimin, dhe përkufizohet në mënyrë jo ambigue nga një varg tiparësh dalluese. Në rastin e një inserimi, dmth të një segmenti që mungonte, që futet në kontekste të përcaktuara, A merr vlerën /É/ (zero).

- B-ja është rezultati i ndryshimit, ose outputi i rregullit dhe mund të jetë zero (/É/) në rastin e rënies së tingujve ( psh.: libër~ librari). B-ja përshkruhet përmes tiparit

---

<sup>10</sup> G.Clements, George N., *The geometry of phonological features*, Phonology Yearbook 2 , 1985, f. 229.

<sup>11</sup> Po aty, f. 238.

ose tipareve që janë të ndryshëm, krahasuar me modelin nistor A. Ajo tregon rezultatin e ndryshimit, ose siç quhet outputin e rregullit;

Në të djathtë të vijës së pjerrët ,/, tregohet konteksti në të cilin vërehet procesi fonologjik, ndërsa vija horizontale , ---, tregon pozicionin e segmentit A, që pëson ndryshimin, i cili saktësohet duke përcaktuar ose elementin X që i paraprin, ose elementin Y që e ndjek, ose të dy.

Edhe segmentet X dhe Y, duhen specifikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë përmes një vargu tiparesh, në mënyrë të tillë që të dallohen në brendësi të një sistemi fonologjik.

Në rastin kur në brendësi të një serie segmentesh veprojnë njëkohësisht dy procese fonologjike, ato (proceset) nuk mund të shprehen vetëm me një rregull.

Rregullat e rishkrimit gjenerativ, përmes së cilave gjenerohen strukturat sipërfaqësore nga strukturat e thella, Bevington i paraqet përmes hartimit të një sërë rregullave fonologjike, të cilat ilustron skemat e paradigmave foljore dhe emërore në shqipe. Secila nga rregullat nisat nga një formë bazë, e cila sipas këtij autori gjeneron trajta fonologjike të ngjashme, duke na dhënë forma të ndryshme sipërfaqësore, sipas kategorive gramatikore të ndryshme. Tërësia e rregulla që shpjegon fonologu amerikan, rreken të argumentojnë ciklet e ndryshimeve fonemore që vërehen në forma të ndryshme paradigmatiske, siç janë rëniet e tingujve, metafohia, apofonia, sinkopa, apokopa, monoftongimi e diftongimi etj.

Ndarja që ai i bën temave foljore, si folje me temë në zanore (V-stem) dhe në bashkëtingëllore (C-stem), si dhe paradigmatiske që krijojnë ato në kohë dhe mënyra të ndryshme, është këndvështrim i veçantë i sistemit morfologjik të shqipes, parë nën dritën e fakteve fonetike.

Analiza e detajuar e të dhënave të shqipes nga ky autor, paraqitet përmes një sërë algoritmesh që rreken të shpjegojnë natyrën e ndërrimeve fonetike, të cilat pasqyrohen në alternimet nga forma bazë (underlying) në atë sipërfaqësore. Sipas tij, të gjitha klasat e foljeve kanë të njëjtën strukturë bazë, si në formë, ashtu edhe në formantet trajtëformuese, por përmes ndërrimeve tingullore, lloje metatezash, apo sinkopime, ato shfaqen me ndryshime në sipërfaqe. Këtu ai u referohet sidomos mbaresave vetore që marrin klasat e foljeve, apo edhe formanteve emërore, sipas lakimit, numrit dhe gjinisë.

Të gjitha diferencimet formale, Bevington i sheh si rezultate të kombinimit të strukturave tingullore, dmth. tingujt fundorë kushtëzojnë përdorimin e formanteve trajtëformuese, si në paradigmen foljore, ashtu edhe në atë emërore.

Gjatë zbrërthimit të tipareve, autori shënon disa tipare të reja që karakterizojnë temat me ndryshime fonetike, siç është psh. tipari [+U] (+umlaut), i cili karakterizonte temat që i nënshtroheshin ndryshimeve metafonike dhe [-U], ato tek të cilat mungonte ky tipar.



Po kështu përmes rregullave të transformimit, ai identifikon raste të asimilimeve dhe disimilimeve në format vetore, si psh. në format e së pakryerës<sup>12</sup>, pa u ndalur në tingujt antihiatizues që marrin këto forma.

Krahas analizës së sistemit emëror, Bevington përshkruan pjesërisht edhe klasën e mbiemrave, të cilët i kundron shkurtimisht në paradigmat e pjesshme<sup>13</sup>.

Gjatë analizës së paradigmës emërore, krahas diferencimit të kategorive gramatikore si gjinia, trajta, numri, rasa, ai ndalet edhe në shqyrtimin e formave flektive për secilën prej tyre, duke dalluar klasa emrash mbi të cilat veprojnë rregulla të veçanta fonologjike, siç është rasti i një -r-je epentetike në tema që mbarojnë me zanore, por që nuk është e pranishme në të gjithë paradigmën e këtyre emrave.

Shpeshherë ne vëmë re se Bevington i referohet natyrës së skemave theksore, megjithëse ai ndalet shumë shkurt te dukuritë prozodike, vetëm e përkufizon theksin duke iu referuar përsëri A.Dodit. Ai thekson karakterin e ngulitur të theksit në shqipe në format paradigmatiche<sup>14</sup> dhe dallon disa prapashtesa fjalëformuese që nuk e bartin theksin mbi vete (-as për ndajfoljet dhe -ull tek emrat). Dallon tipat e togjeve të zanoreve, të cilat theksohen në zanoren e parë të togut, duke i cilësuar me tiparet [ $\pm$  e theksuar], psh.: *djell* [i] është [+ e theksuar].

Duke përfunduar Bevington<sup>15</sup> pohon se gjatë analizës së sistemit emëror dhe foljor, dalin në pah rreth 36 rregulla fonologjike, të cilat shërbejnë për të krijuar format sipërfaqësore nga format abstrakte bazë, të dhëna këto përmes algoritmeve të tipareve siç i përshkruam teorikisht më sipër.

Në ndryshim nga trajtimet e deriatëhershme, Bevington na sjell një perceptim të ri të ndërveprimit gjuhësor. Mënyra se si rregullat fonologjike e përdornin informacionin morfologjik gjatë krijimit të formave flektive, përbën thelbin e trajtimit teorik të “Albanian Phonology”. Duke dhënë këtë përjasje mes perceptimit të fonologjisë, saktësisht të niveleve bazë, si dhe rregullave fonologjike që derivojnë përfaqësime leksikore prej tyre, mund të vërejmë mënyrën se si funksionojnë këto rregulla brenda sistemit gjuhësor. Ai shfrytëzoi një korpus të gjerë të dhënash, duke u përpjekur të ndërpusë këndvështrimin gjenerativist në analizën e një gjuhe të veçantë si shqipja, nismë kjo që mbeti në nivelin e përpjekjeve, pasi në studimet e kohës u la në heshtje. Do të ishin studimet më të reja në lëmë të shqipes, ato që do ti shfrytëzonin të dhënat e sjella nga Bevington, sidomos në përcaktimin e tipareve binare të segmenteve tingullore të

---

<sup>12</sup> G.L.Bevington, *Albanian Phonology*, Wiesbaden, 1974, f.70-72.

<sup>13</sup> Po aty, f.108.

<sup>14</sup> Po aty, f.24.

<sup>15</sup> Po aty, f.135.

shqipes. Duke theksuar nivelin morfonologjik, në këtë parashtrim teorik, rregullat fonologjike dhe morfologjike bashkohen brenda një strukture të njëjtë, e cila jep të dhëna lidhur me ndërveprimin mes fonologjisë dhe morfologjisë gjatë proceseve trajtëformuese.

“Albanian Phonology” mund të cilësohet si një vepër që zë një vend të rëndësishëm në korpusin e studimeve gjuhësore të shqipes, jo vetëm për mënyrën e trajtimit të fakteve gjuhësore, por edhe për modellet e analizave fonologjike që ofron.

Bevington ka trajtuar në mënyrë të detajuar ndërrimet morfonologjike të shqipes, nën dritën e të dhënave që ofronte gjuhësia gjenerative. Përveç kësaj, ne mund ta cilësojmë atë si një nga studiuesit që ka hedhur dritë mbi faktet e fonologjisë leksikore. Megjithëse është ndalur vetëm tek eptimi, ai ka sjellë disa shembuj të ndërveprimit mes rrafshëve gjuhësore gjatë formimit të trajtave paradigmatiche të fjalëve.

### **Bibliografia**

1. Bevington, G.L., *Albanian Phonology*, Wiesbaden, 1974,
2. Clements, G., George N., *The geometry of phonological features*, *Phonology Yearbook* 2 , 1985,
3. Browman, C.P., & Goldstein, L., *Articulatory gestures as phonological units*, *Phonology*, 6, 1989,
4. Dodi, A., *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1968.
5. Kiparsky, P., *From cyclic to lexical phonology*, në H. van der Hulst , N. Smith, eds. *The Structure of Phonological Representations*, Dordrecht: Foris, 1982.
6. Memushaj, R., *Gjuhësia generative*, Tiranë, 2008.



**Julie M. KOLGJINI**

**PËR (Ç)PENGIMIN E GJUHËS SHQIPE NË KOHËN POST-MODERNE, MARRË SHKAS NGA KONTRIBUTI I JANET BYRON-IT NË DRITËN E RISHQYRTIMIT TË STANDARDIT AKTUAL**

1.0 HYRJE. Kanë kaluar gati katër dekada që nga publikimi i studimeve të Janet Byron-it në vitet 1970 (1973, 1976, 1978, 1979) në lidhje me politikën zyrtare dhe planifikimin gjuhësor (PPGj) të shqipes së njësuar letrare (që më vonë nisi të quhet shqipja letrare dhe kohët e fundit Shqipja Standarde) nga gjuhëtarë dhe letrarë të perzgjedhur shqiptarë, në mesin e të cilëve dhe intelektualë të ndryshëm. Në përshkrimet, karakterizimet dhe analizat e Byron-it përfshihen: a.) përbërësit e ndryshëm gjuhësorë të perzgjedhur për t'u përfshirë në *gjuhën letrare të njësuar* (GjLNj, dhe në këtë mënyrë edhe përberësit e përjashtuar), b.) pjesëmarrësit zyrtarë të përfshirë në fazat e shumta të proceseve vendimmarrëse, si dhe c.) vendimet e miratuara zyrtarisht. Analizat e saj janë vlerësuar si të arsyetuara dhe të mirë-argumentuara, sidomos nga gjuhëtarët, të cilët e kanë trajtuar gjerësisht gjuhën shqipe. Vlen për t'u përmendur që gjatë viteve (si para e gjatë procesit, ashtu edhe menjëherë pas tij e deri në ditët e sotme), dijetarë të shumtë i kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me monocentrizmin e GjLNj-së, dmth bazimin e standardit në njërin variant (në dëm të varianteve dhe alternativave të tjera të mundshme), pra në një perzgjedhje të tillë të elementeve që pasqyrojnë atë që njihet si ideologjizim i gjuhës standarde, që përfshin imponimin e një uniformiteti gjuhësor dhe invariance, një qëndrim të superioritetit moral dhe hegjemon, (shih Milroy 2001; Milroy & Milroy 2012; Lippi-Green 1994; Tollefson 1991). Duke pasur parasysh karakterizimet e Byron-it për procesin e formimit të GjLNj-së, në dritën e teorive të reja bashkëkohore, natyrshëm mund të lindin sugjerime dhe propozime për ndjekjen e rrugëve të reja në lidhje me modifikimet e mundshme të standardit. Adaptimi i komponentëve të teorisë që referohet si de-standardizim (Deumert 2010) ose disinvencion (Makoni & Pennycook 2007) gjuhësor, kombinuar me një qasje kritike ndaj PPGj-së (e parë nën dritën e teorisë kritike sociale dhe post-modernizmit; shih Pennycook 2001, 2010a, 2010b) mund të krijojë kushte për

një gjuhë më të relaksuar e të balancuar, dmth, të tillë që lejon riintegrimin e asaj që Byron-i (1976:120) e quan “alternativë e përjashtuar,” që është më shumë user-friendly për shumicën e folësve të saj (sidomos në reflektimin e përdorimit aktual dhe bashkëkohor të gjuhës) në shekullin e 21-të. Kjo qasje është e një rëndësie të veçantë në peizazhin bashkëkohor gjuhësor që merr parasysh realitetin e tanishëm sociolinguistik, teoritë më të fundit mbi ideologjinë e standardit gjuhësor dhe kulturor (Ricento 2000; May 2005; Milroy 2001; Milroy & Milroy 2012; Armstrong & MacKenzie 2013), sociolinguistikën kritike, praktikimin lokal të gjuhës prej përdoruesve, variacionet gjuhësore dhe diversitetin, ekologjinë gjuhësore, identitetin, metrolinguizmin, plurilingualizmin, shkrimin e këndimin, dhe bi/multikulturalizmin në hapësirën urbane kaq dinamike (Pennycook 2001, 2010a, 2010b).

2.0 POLITIKA GJUHËSORE DHE PLANIFIKIMI I SAJ: MARRË SHKAS NGA STUDIMET E JANET BYRON-IT NË DRITEN E RISHQYRTIMIT TË STANDARDIT AKTUAL. Aktivitetet që lidhen me PPGj-në kanë qenë prezent për shekuj. Karam (1974:104-105) vë në dukje, se termi “planifikim gjuhësor ndoshta është përdorë së pari në literaturë nga Haugen (1959),”<sup>1</sup> ku përcaktohet si: “Puna normative e akademike dhe komiteteve të gjuhës, të gjitha format e asaj çka në përgjithësi është njohur si kultivimi gjuhësor (Germ. *Sprachpflege*, Dan. *Sprogroegt*, Swed. *Språkvård*), si dhe të gjitha propozimet për reforma gjuhësore ose standardizuese.” Studiues të tjerë, p.sh. Rubin dhe Jernudd, e kanë përcaktuar planifikimin e gjuhës si “ndryshim i qëllimshëm i kodit të gjuhës ose të të folmes, apo të të dyjave” (shih Karam 1974:105). Fishman e sheh planifikimin e gjuhës si një “përpjekje të organizuar për zgjidhjen e problemeve të gjuhës, zakonisht në nivele kombëtare” (Karam 1971:105). Për qëllimin e këtij shkrimi, është adaptuar, terminologjia e Ricentos (2000:209, fusnota 1) për politikën gjuhësore dhe planifikimin e saj, ku politika e gjuhës është “një term mbizotërues i cili përfshin planifikimin gjuhësor”, shpjegon ai: “Hulumtimi i Politikave gjuhësore është shoqëruar jo vetëm me akte zyrtare dhe jozyrtare të subjekteve qeveritare dhe institucioneve të tjera, por edhe me ngjarjet historike dhe kulturore si dhe të proceseve që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë, qëndrimet sociale dhe praktikat në lidhje me përdorimin e gjuhës, nxënjes dhe statusit.” Ky është planifikimi gjuhësor që shihet si një komponent integral i politikës gjuhësore.

<sup>1</sup> Haugen (1959:8) shkruan: “By language planning I understand the activity of preparing a normative orthography, grammar, and dictionary for the guidance of writers and speakers in a non-homogeneous speech community. In this practical application of linguistic knowledge we are proceeding beyond descriptive linguistics into an area where judgment must be exercised in the form of choices among available linguistic forms” (tek Hornberger 2009:26).

Në shumë prej botimeve të Janet Byron-it (si në 1973, 1976, 1978, 1979), përmenden përpjekjet e ndryshme të bëra nga gjuhëtarët, kryesisht në periudhën pas luftës së dytë botërore për të krijuar një teori të unifikuar për PPGj-në (p.sh. Ray 1963; Haugen 1966a, 1966b, 1966c; Tauli 1968; Neustupny 1968, shih Byron 1973 dhe 1976), dhe në veçanti se si përpjekjet e tilla janë aplikuar në GjLNj. Para se të perqendrohemi tek hulumtimet e Byron-it, është e rëndësishme të theksohen lëvizjet e ndryshme dhe ndikimet në PPGj gjatë viteve 1960.

Ricento (2000:197) thekson që gjatë viteve 1960 një numër i madh faktorësh ishin të rëndësishëm për shumë prej individëve të angazhuar në PPGj: Faktori makro socio-politik i formimit shtetror dhe dekolonializimi, elementi epistemologjik i strukturalizmit brenda sferës së shkencave shoqërore, dhe faktori strategjik si “besimi i përhapur” se “problemet gjuhësore mund të zgjidhen përmes planifikimit, sidomos në kuadër të sektorit publik.” Kjo situatë ishte e një rëndësie të veçantë për zhvillimet kombëtare ku dhe linguistët e sapo trajnuar në strukturalizëm, shumë prej të cilëve ishin të interesuar për të shqyrtuar lidhjet e ndryshme ndërmjet shoqërisë dhe gjuhës, ku teoritë e ndryshme mund të testoheshin, veçanërisht në lidhje me planifikimin e korpusit dhe të statusit<sup>2</sup> (shih Fishman 1968a: 6). Diglossia stabile, ku në një komunitet plurilingual një gjuhë (apo dialekt) përdoret kryesisht në kontekste më formale (p.sh. arsim dhe dokumente zyrtare) dhe një gjuhë tjetër (apo dialekt) përdoret më shumë në mjedise informale (p.sh. në shpji), është diskutuar gjerësisht, gjithashtu (Ferguson 1959). Për shumë gjuhëtarë, diversiteti gjuhësor dhe variacionet u konsideruan pengesë për zhvillimin e kombit dhe të ndërtimit të tij, ku homogjeniteti gjuhësor dhe uniformiteti (invarianca)<sup>3</sup> ishin të lidhura me modernizimin (shih Milroy 2001). Në atë kohë, u përhap gjërësisht besimi në shumë qarqe, se parakusht për një shtet-komb të

---

<sup>2</sup> Ndërsa planifikimi i korpusit, tenton të përfshijë grafikizimin (drejtshkrimin), modernizimin e leksikut, gramatizimin, dhe standardizimin, planifikimi i statusit, merret me zgjedhjen e një gjuhe kombëtare (apo dialekti) në mënyrë që të nxisë ndërtimin e shtetit, mjetet instruktuese të të mesuarit, të një gjuhe zyrtare krahas objektivave të tjera (Ricento 2000: 197-198; shih gjithashtu Wiley 2002).

<sup>3</sup> Milroy (2001:531-2, 4) shënon: “[S]tandardization consists of the imposition of uniformity upon a class of objects...[U]niformity has to be *imposed* on such classes of objects and uniformity, or invariance, then becomes in itself an important defining characteristic of a standard form of language...[U]niformity of usage has been institutionally imposed on pre-existing convergent states of language.” Armstrong & Mackenzie (2013:7) shtojnë: “As J. Milroy remarks (2001:532), the idea of the standard as invariant cannot in any case be equated with its prestige: ‘It is not sensible to apply the notion of prestige to sets of electric plugs, for example, although they are plainly standardized, and many things that are unstandardized, like hand-made suits, may actually be the ones that acquire prestige.’”

suksesshëm ishte një gjuhë e zhvilluar, shkruajtur, e standardizuar, në mënyrë të tillë që të luajë rolin e një gjuhe kombëtare - dmth “idealizimi i idesë një komb-një gjuhë (standarde) kombëtare” (Ricento 2000: 198). Ashtu si Ricento (2000:199-200) shpjegon se, literatura shkencore mbi PPGj-në gjatë periudhës së pas luftës së dytë botërore u shënua nga një dëshirë për unifikim (p.sh. një rajon, një grup fetar), modernizim dhe efikasitet, ku gjuha konsiderohej si burim, ndërsa planifikimi i korpusit dhe statusit të saj të shihej si ideologjikisht neutral. Shumë prej këtyre koncepteve janë aplikuar në mjedisin gjuhësor të shqipës gjatë kësaj periudhe të njëjtë, duke filluar që në vitin 1945 dhe duke kulmuar në atë që u quajt gjuha letrare e njësuar (gjuha letrare dhe shqipja standarde) në vitin 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë (Byron 1973, 1976, 1978, 1979; Camaj 1984; Ismajli 2005a).

Në shpjegimin e këtyre teorive të ndryshme të PPGj-së dhe të aplikimit të tyre në rastin e GjLNj-së, Byron-i bën një analizë historike dhe sociolinguistike të realitetit bimodal letrar të gjuhës shqipe, ku dygjuhësia pasive (dhe *biliteracy*-a) ishte prezente deri para inxhinierimit të GjLNj-së (Byron 1976:59-72). Duke ndjekë këtë logjikë, ajo vë theksin në elemente të shumta fonologjike, sintaksore, morfologjike dhe leksikore të të dy varieteteve (letrare), të shkruara dhe të folura, të gegnishtes dhe tosknishtes (p.sh. prania ose mungesa e hundorëzimit të zanoreve, schwa-së, rrotacizmit si dhe infinitivit të shkurtë). Byron-i shpenzon kohë të konsiderueshme duke analizuar se si njëri variant (toskë) u përzgjedh mbi alternativat e tjera të mundshme dhe bindëse (që do ti jepnin përbërje pluricentrike, gjuhës së perbashkët) po ashtu dhe implikimet prej një përzgjedhjeje të tillë, sidomos kur kjo përzgjedhje ishte realizuar nga ata që posedonin pushtetin politik në atë kohë. Ajo citon Haugen-in (1966a: 19) në lidhje me procesin e përzgjedhjes në përgjithësi për gjuhët standarde, sidomos në Evropë: “e shkruar nga dhe për elitat ... e vetë-zgjedhura”, për të cilën ajo shton në lidhje me GjLNj-në: “e diktuar nga përdoruesit e grupit që ndodhi që të kishin pushtetin apo prestigjin, ne vend te startimit përmes vlerësimit të alternativave ekzistuese” (Byron 1976:24). Kjo bëri që përdorimi të ishte i kufizuar vetem nga elita drejtuese që tashmë e ka standardin gjuhë amtare, dhe ta diktojë normën që duhet të ndiqet nga popullsia (shih gjithashtu Byron 1976:59-72). Ajo na kujton, gjithashtu, se edhe Haugen e parashikon një problem të tillë se: “Përzgjedhja e një varianti si normë do të thotë favorizim i grupit të njerëzve që e flasin atë variant. Kjo u jep atyre prestigjin si normë-mbartës dhe i vendosë ata në krye të garës për pushtet dhe pozitë” (Haugen 1966a: 18 tek Byron 1976:62). Ja pra pse, ata të cilët e flasin tosknishten si dialekt amtar, automatikisht do të bëhen grupi dominues. Byron-i (1976:62-65), gjithashtu vë në dukje se në mes të viteve 1960, Kostallari ishte i pari që hodhi poshtë që GjLNj-ja ishtë bazuar kryesisht në tosknishten, duke këmbëngulur se ajo ishte një gjuhë e përzier ku secili variant dominon njësoj. Por Byron-i shpjegon se GjLNj-ja është e bazuar kryesisht në një sistem monocentrik (krh.



me atë Policentrik, si p.sh. anglishtja), ku “gegnishten letrare e ka zbritë nga një variant i lartë shoqërisht në një variant të ulët” (Byron 1976:65). Ajo shënon se iluzioni i ekzistencës së një shumësie të risive gjuhësore (p.sh. rotacizmi, *-ua*, dehundorizimi, mungesa e paskajores së shkurtë) në variantin toskë (në krahasim me atë gegë) ishte marrë në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes, pavarësisht përdorimit jo aq të shpeshtë të formave të tilla, kur krahasohen me forma të tjera më arkaike (gege) që ishin me gjasë (në mos më shumë), në të njëjtën masë në përdorim të zakonshëm (Byron 1976:24, 43, 103). Gjithashtu, Byron-i (1976:119) kujton se biles edhe Çabej ka theksuar se “asnjëri nga dialektet nuk ka monopolin mbi karakteristika inovuese.” Inovacionet e tilla ishin menduar ndoshta nga standardizuesit për ta bërë gjuhën standarde të duket më “moderne” (Byron 1976:120), dhe kështu më “e përshtatshme” si GjLNj.

Siç vë në dukje Byron-i, zbatimi i GjLNj-së ishte për pjesën më të madhe i imponuar dhe i sanksionuar nga lart, pra nga lart-poshtë (shih Byron 1973, 1976) i cili edhe u konsiderua varianti legjitim<sup>4</sup>. Format alternative u dekurajuan shumë dhe sigurisht që pritej një prescriptivisëm i rreptë. Ishte intolerancë e konsiderueshme, sidomos, për perdoruesit e jo-standardit, si për folësit ashtu edhe për shkruesit e formave dhe varianteve të përjashtuara tashmë (të gegnishtes). Heshjtja e variabilitetit gjuhësor<sup>5</sup> u përhap, veçanërisht në drejtim të përdorimit të gegnishtës së stigmatizuar rishtazi; folësit e saj nuk ishin më në gjendje të gëzojnë prestigj duke e përdorë atë haptas, ishte zhveshur nga prestigji që kishte gjatë periudhës bimodale letrare dhe kur ai kishte shërbyer si standard gjatë periudhës midis dy luftërave. GjLNj-ja dhe dialekti toskë tashmë u ngritën në variantin me prestigj të dukshëm në vend të asaj (shih Byron 1976:50, 68-72; Milroy & Milroy 2012:5-6; 15-18). Siç mund të shihet në të gjitha shkrimet e saj, analiza e Byron-it rreth procesit të standardizimit të GjLNj-së spërkatet me grimca që lënë të kuptohet kahja kritike ndaj sociolinguistikës, sidomos mbi strukturat e pushtetit dhe përzgjedhjen e varietetit me prestigj të lartë (planifikimin e statusit).

---

<sup>4</sup> Ashtu siç Bourdieu shpjegon që, ky standard i imponuar dhe zyrtarisht i mandatuar është pra i vetmi prej autoriteteve si “the only legitimate language,” ose dialect ne këtë rast, për të komunikuar në të shkruar dhe të folur (Bourdieu 1991:45 tek May 2005:322).

<sup>5</sup> Byron-i (1976:72) shkruan: “[P]aradoxically, monopoly of the superposed variant should cause the decline of superposed variation (i.e. intra-personal variation: Gumperz 1966:29-30), for the speaker would have fewer options for differential use according to topic, audience, and other such factors. This seems unnatural, not only (on humanitarian grounds) for language planning, but also linguistic grounds, since a normal linguistic community is always diverse.”

Në lidhje me historinë më të fundit intelektuale të PPGj-së, në kapërcyell të shekullit të 20-të (1990-ave) në komunitetin e gjerë të planifikuesve gjuhësor dhe shkencëtarëve socialë në veçanti, kishte nevojë për një qasje apo paradigmë të re, të PPGj-së, qasje e cila të orientohej nga vështrimi kritik. Kjo teori ka nisë hulumtimin në qarqet e ndryshme shkencore dhe revista akademike që nga viti 1990 (p.sh. Bourdieu 1991; Lippi-Green 1997; Ricento 2000; Hornberger 2009:34; Tollefson 2009; shih gjithashtu Koffi 2012). Ky qëndrim kritik ndaj PPGj-së mbulon elemente nga teoria kritike sociale (Pennycook 2001, 2009, 2010a, 2010b; Carlson 2004; Tollefson 2009; Hornberger 2009: 34; Ricento 2000, 2009), analiza kritike të diskursit, teoria kritike letrare, postmodernizmi (shih Pennycook 2009:62), hegjemonia (Gramsci 1988)<sup>6</sup>, pushteti (Foucault, 1972, 1979)<sup>7</sup>, konflikti<sup>8</sup>, rezistenca<sup>9</sup>, shtypja dhe shfrytëzimi, drejtësia sociale, të drejtat gjuhësore të njeriut, ekologjia gjuhësore (May 2005; Tollefson 2009) si dhe ideologjia e gjuhës standarde (Milroy 2001; Milroy & Milroy 2012:18-23, 29; Armstrong & Mackenzie 2013:1<sup>10</sup>) dhe autoriteti (Milroy 2001; Milroy dhe Milroy 2012). Kjo përfaqëse kritike, gjithashtu e quajtur si kritikë e PPGj-së (ose *critical language planning CLP*; Tollefson 2009), sociolinguistikë kritike (*critical sociolinguistics CS*) dhe/ose aplikim kritik gjuhësor (*critical applied linguistics CALx*), ofron një kritikë mbi të metat e ndryshme që rezultuan nga shumë politika të modernizimit gjuhësor, duke përfshi politikat e paefektshme, diskriminimin, pamundësinë për inxhinierimin e shoqërive komplekse (sidomos ato me histori të tipit kolonial), pabarazinë gjuhësore, duke sugjeruar, në të njëjtën kohë, që theksi duhet të vendoset mbi konceptet e ndryshme post-moderne, sidomos në ekologjinë gjuhësore dhe (pa)barazinë sociale (shih Ricento

<sup>6</sup> “Gramsci (1988) defines hegemonic practices as institutional practices that ensure that power remains in the hands of the few” (Tollefson 2009:47).

<sup>7</sup> Tollefson (2009:46) shkruan: “In CLP research power is implicit in the policy-making process, and language policies are seen as an important mechanism by which the state and other policy-making institutions seek to influence language behavior (Tollefson, 1991).”

<sup>8</sup> Tollefson (2009: 46) shpjegon: “Most language policies adopted by the state and other institutions controlled by dominant groups are viewed as serving the interests of the oppressors...[O]ppressed groups may seek to expand their power and further their interests through language policies...In general, CLP researchers assume an adversarial model for social change, in which struggle is a prerequisite for social justice.”

<sup>9</sup> Milroy (2001:542) shkruan: “Standardization, as it is imposed from above, is normally resisted.” “[D]espite language policies favoring dominant groups, oppressed ethno-linguistic groups may exercise resistance by creating and sustaining alternative social hierarchies in which ‘non-standard’ languages [and varieties] are crucial, and also by engaging in ongoing struggles to adopt alternative policies that lead to greater social justice” (Tollefson 2009:48).

<sup>10</sup> “...Milroy’s ‘ideology of the standard’ (Milroy & Milroy 1999) is a term referring to the view that favours a dominating or hierarchical situation, not only in language but in the ordering of society, the counterpart of this ideology, that which opposes standardization, has no one name that comes very readily to mind, at least in linguistics” (Armstrong & Mackenzie 2013:1).

2000:200-209; May 2005:322-323). Tollefson (2009:42-43) shpjegon se qasja kritike në hulumtime të tillë përfshin një kritikë implicite të rrjedhave të pergjithëshme mbi tradicionalen, qasjeve të zakonshme...Kërkimet tradicionale (të quajtura 'qasja neoklasike' nga Tollefson-i, 1991)...së pari u shfaqën në vitet 1960 dhe 1970 me qëllim për të ndihmuar programet e 'modernizimit' të vendeve në 'zhvillim'...Në kontrast me këtë hulumtim optimist tradicional, një qasje kritike vëzhgon se politikat shpesh krijojnë dhe mbështesin forma të ndryshme të pabarazisë sociale, dhe se hartuesit e tyre zakonisht promovojnë interesat e grupeve shoqërore dominante.

Një qasje e tillë kritike nënvizon ndryshimet shoqërore, në veçanti rolin e "politikave gjuhësore në pabarazinë sociale, politike dhe ekonomike, me qëllim zhvillimin e politikave që reduktojnë format e ndryshme të pabarazisë" (Tollefson 2009:43; shih gjithashtu May 2005:322-323). Një theksim tjetër i kësaj qasje është koncepti i pushtetit, siç shpjegohet nga Foucault, duke përfshirë institucionet, dhe hegjemoninë siç shtrohet nga Gramsci. Për më tej, Ricento (2009:3) shpjegon se, "karakterizimi postmodern për gjuhën problematizon idenë se një gjuhë është një kod i fiksuar". Në mënyrë të ngjashme, Hopper argumenton se "nuk ka një strukturë fikse të natyrshme të gjuhës. Përkundrazi, folësit huazojë shumë nga përvojat e mëparshme të komunikimit në rrethana të ngjashme, për tema të ngjashme, dhe me interlokutorë të ngjashëm. Sistematizimi, në këtë pikëpamje, është një iluzion i prodhuar nga zgjidhje të pjesëshme ose shtresime formash të përdorura shpesh në nënsisteme të përkohshme" (tek Ricento 2009:3-4). Këtu, teoria e gjuhës është shikuar në aspektin e diskurseve të shumta, ku folësit i përkasin ndërthurjes së komuniteteve të ndryshme (në të folur).

Duke pasë parasysh situatën e tanishme me GjLNj, komponentë të ndryshëm të një qasje të tillë kritike mund të eksploroehen dhe të konsiderohen në aspektin e aplikimit të sotëm të tyre në gjuhën shqipe. Në vend të përjetësimit të politikave remenishente që të kujtojnë ideologjinë e gjuhës standarde dhe të kaluarën hegjemoniste (po ashtu dhe qëndrimin intolerant ndaj variacionit gjuhësor sidomos kur në audience publike përdoren elemente të gegnishtes), ndoshta strategji të ndryshme që të përqëndrohen në barazinë gjuhësore të folësve, sidomos të atyre që ishin të disavantazhuar nga sistemi i mëparshëm (dhe në një fare mënyre dhe ai aktual), mund të investigohen. Për shembull, konsiderimi i konceptit që njihet si *deregulation* gjuhësor (shih Tollefson 1980, 1993, 2002), destandardizim (Deumert 2010), disinvencion (Makoni & Pennycook 2007; Pennycook 2009:69), dhe "anti-standardizimi" (Armstrong & Mackenzie 2013:197, 200) janë disa konstrukte gjuhësore që mund të shqyrtohen. Këto strategji mund të nxjerrin në pah dhe evidentojnë përhapjen aktuale të alternativave të ndryshme, ndërtime jo-standarde morfologjike dhe leksikore në mënyrë që të merren në konsideratë si kapitale

gjuhësore, entitete legjitime që mund të përfshihen në standard (p.sh. infinitivi i shkurtë gegë dhe schwa-ja e unifikuar për komponentët e ndryshme leksikore dhe morfologjike, dy prej të cilave mund të shihen si risi, po ashtu si dhe përfshirjen e elementeve leksikore të ndryshme ish-letrare nga varietetet aktualisht jo-standarde). Theksi do të duhej vendosë në mirsërdhjen e huamarrjeve dialektore (më saktë nga gegnishtja në GjLNj) që ka qenë i përhapur në komunitetet urbane të përdorimit për një sasi kohe të konsiderueshme. Si rezultat do të kishim nivelim vertikal dialektor (Armstrong & Mackenzie 2013:201, 206) (në krahasim me një vernakularizacion ose koinazacion të standardit) dhe ndryshim nga poshtë, në vend të diktimit nga lart (shih Milroy 2001; Labov 1966, 1972).

Le të konsiderojmë disa nga implikimet e mundshme të adaptimit të strategjive të tilla në lidhje me rishqyrtimin e standardit aktual, i cili mund të jetë një hap në drejtim të avancimit post-modern në kultivimin gjuhësor për gjuhën shqipe, që do të nxiste një qasje drejt teorisë kompozicionale (në bazë të përbërjes së dialekteve) të planifikimit gjuhësor, në krahasim me atë ekzistues, unitar (bazuar në një dialekt të vetëm; shih Byron 1976:60).

Një qasje e tillë do të inkurajonte një lehtësim të vogël prej respektimit rigoroz të rregullave të përshkruara të GjLNj-së, në këmbim të rishikimeve natyrale, organike që janë të pasqyruara tashmë në praktikatat e përdoruesve aktual (tashmë të pranishme jo vetëm në të folur por edhe në të shkruar në gjuhën e përdoruesve të shumtë, në çalltisjen për të përdorë GjLNj-në, bazuar në praktikatat e zakonshme të përdorimit të folësve shqiptarë) në peizazhin urban, pa përjashtuar një numër të shumtë në mjedisin intelektual<sup>11</sup>. Byron-i (1976:120) shkruan se “alternativat e refuzuara mund të futen në funksione stilistike” për hir të komunikimit njerëzor. Ajo shton (1976:120): “Më e rëndësishme, sidoqoftë, është që ky zhvillim ndoshta shënon një ndërrim të qasjes në gjuhën shqipe, prej politikës planifikuese në atë të kultivimit të saj, të problemeve gjuhësore,” si për ta vlerësuar më mirë hipotezen “se një standard, me kohë bëhet heterogen dhe i izoluar nga gjendja e tij fillestare.” Edhe pse një kategori njerëzish mund të insistojnë fillimisht se modifikimet e tilla janë devijime, imorale, korruptive e të paligjshme, në vend të kësaj, përkundrazi, ato mund të konsiderohen si të natyrshme,

---

<sup>11</sup>Një qasje e tillë për rivlerësimin e elementeve të ndryshme do të ishte remenishencë e propozimit të Faik Konicës se “the dialects be combined on a rational and scientific basis and a unified grammar be constructed from the compounded parts” si një kompozitë dialektesh, ku shumë fjalë mund të “be used interchangeably, according to the writer’s preference” (Byron 1976:55). Byron-i shkruan se në atë kohë “[p]robably the most popular proposal for a common literary language was that the speech of Elbasan be taken as the base” (Byron 1976:57).

organike, me bazë evolutive, folës-prurje<sup>12</sup>, me legjitimitet gjuhësor, ardhje nga poshtë të cilat janë të denja për të qenë të përfshira në standard (shih Milroy 2001:550). Modifikime të tilla të vogla, por kuptimplote, në standardin aktual mund të përfshijnë paskajoren e shkurtë (p.sh. në formen *me shkë*, pa togzanorën dialektore *ue ~ ua*, shih Agim Morina në botimin *Gjuha e këputun e shqipëse* Gashi 2010:15-19; Elezi 2009; Bokshi 2011; Kolgjini 2011; Munishi 2011), unifikimin e schwa-së (shih Topalli 2011; Klosi 2011), si dhe përfshirjen e alternativave të ndryshme leksikore që janë refuzuar paraprakisht (p.sh. *tamël*, *thynë*, *marre* e kështu me radhë; shih gjithashtu Elezi 2009) – jo vetëm në letersi (sic tashmë pranohet edhe prej studiueve më konservatorë) por edhe në të gjitha fushat e tjera. Kështu do të shkohej potencialisht drejt lehtësimit të diskriminimit gjuhësor dhe social dhe eliminimit të pabarazisë, ku një lloj emancipimi nën dritën e teorive post-moderne në kultivimin e gjuhës mund të shërbejë si një përpjekje për pajtimin gjuhësor në mënyrë të ndryshme nga rruga e ndjekur në të kaluarën e saj të pakëndëshme, në të njëjtën kohë edhe pasurimin me dialektet përbërëse të gjuhës së përbashkët.

3.0 PËRFUNDIMI. Nëse praktika e tanishme e *fait accompli* gjuhësor do të mbizotërojë (shih May 2005:325-327), vazhdimësia e hiperkoreksioneve dhe viruseve gramatikore (Armstrong & Mackenzie 2013:58-59) do të shtohen në mënyrë të veçantë prej një numri të konsiderueshëm të folësve jo-native të standardit, jo vetëm brenda kufijve juridik të Shqipërisë, por gjithashtu edhe në rajonet përreth, p.sh. Kosova, Maqedonia, Mali i zi apo Greqia, ku “shibboleth of language” siç Toynbee (1953) e cilëson atë, [do të] ndikojë edhe më shumë” (May 2005:332). Gjithashtu, strategjia e propozuar këtu, synon akomodim të ndërsjelltë (shih May 2005:336-337) që merr në konsideratë zgjedhjet racionale (May 2005:328-331, 337), që gjithashtu, mund, të ndërpresin getoizimin e mëtejshëm të varieteteve të tjera me legjitimitet të barabartë në gjuhën shqipe (shih May 2005:333). Në këtë kontekst, ka ardhur koha për “një qasje ‘bottom-up’ në çështjet e të drejtave gjuhësore” (May 2005:338-9). Në vend të

---

<sup>12</sup> Trudgill (1992:iv) shkruan: “Obviously, languages without speakers do not change. Linguists, however, have not always drawn the correct conclusion from this truism, namely that it is speakers who change languages. A language changes as a result of what its speakers do to it as they use it to speak to one another in everyday face-to-face interactions” (tek Armstrong & Mackenzie 2013:123). Armstrong and Mackenzie (2013:124) shton: “[C]hange itself implies borrowings – from speaker to speaker or group to group.” Milroy fokuson: “[F]or the variationist [...] a sound change does not get initiated in a ‘language’; it takes place in a community of speakers” (tek Armstrong & Mackenzie 2013:124).

këmbënguljes në fushatat për ruajtjen e kopshtit hegjemonist të gjuhës së “sterilizuar” dhe intolerancës (May 2005:323-325), ndoshta autoritetet fuqiplote mund të konsiderojnë një strategji që ndriçon barazinë gjuhësore dhe sociale si dhe integron një qasje më bazë-folës (shih Armstrong & Mackenzie 2013)<sup>13</sup>, duke çuar kështu në atë që Byron-i (1976:120) e quan pak më shumë “komunikim human.”

---

<sup>13</sup> Gertrued Stein dikur pati thënë: “For a very long time everybody refuses, and then almost without a pause everybody accepts” (tek Armstrong & Mackenzie 2013:2).

#### 4.0 REFERENCAT

1. ARMSTRONG, NIGEL AND IAN E MACKENZIE. 2013. *Standardization, Ideology, and Linguistics*. Basingstoke: Palgrave Macmillan
2. Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe Vols. I-II. 2007. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
3. BRUTHIAUX, PAUL. 2006. Restandardizing localized Englishes: Aspirations and limitations. *International Journal of the Sociology of Language* 177.31-49.
4. BYRON, JANET LEOTHA. 1973. Selection and evaluation of alternatives in Albanian language standardization. Philadelphia, PA: University of Pennsylvania dissertation.
5. BYRON, JANET LEOTHA. 1976. *Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian*. The Hague: Mouton.
6. BYRON, JANET LEOTHA. 1978. Displacement of one standard dialect by another. *Current Anthropology* 19.613-614.
7. BYRON, JANET LEOTHA. 1979. Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia. *Word* 30(1:2).15-44.
8. BYRON, JANET LEOTHA. 1985. An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia. *International Journal of the Sociology of Language* 52.93-109.
9. BECI, BAHRI. 2000. *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*. Pejë: Dukagjini.
10. BECI, BAHRI. 2002. *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*. Tiranë: Dituria.
11. BOKSHI, BESIM. 2011. Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe. Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore. Durrës 15-17 dhjetor 2010). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë). 159-163.
12. CAMAJ, MARTIN. 1984. *Albanian grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
13. CAMERON, DEBORAH. 1995. *Verbal hygiene*. London: Routledge.
14. CANAGARAJAH, SURESH. 2004. Language rights and postmodern conditions. *Journal of Language, Identity and Education* 3(2).140-145.
15. CARLSON, MATTHEW. 2004. A critical look at the construction of power between Applied Linguistics and Critical Applied Linguistics. *International*

- Journal of Applied Linguistics* 14(2).167-184.
16. CHAMBERS, J. K. 1992. Dialect acquisition. *Language* 68(4).673-705.
  17. CURTIS, MATTHEW COWAN. 2012. Slavic-Albanian language contact, convergence, and coexistence. Columbus, OH: The Ohio State University Dissertation.
  18. DEUMERT, ANA. 2010. Imbodela zamakhumsha – reflections on standardization and destandardization. *Multilingua* 29.243-264.
  19. DEUMERT, ANA. 2003. Bringing speakers back in? Epistemological reflections on speaker-oriented explanations of language change. *Language Sciences* 25.15-76.
  20. DEUMERT, ANA AND WIM VANDENBUSSCHE (Eds.). 2003. *Germanic Standardizations. Past to Present*. Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
  21. DEUMERT, ANA AND WIM VANDENBUSSCHE. 2003. Standard languages: Taxonomies and histories. In Deumert, Ana and Wim Vandebussche (Eds.) *Germanic Standardizations. Past to Present*. Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
  22. DEUMERT, ANA AND WIM VANDENBUSSCHE. 2003. Research directions in the study of language standardization. In Deumert, Ana and Wim Vandebussche (Eds.) *Germanic Standardizations* (pp. 455-469). *Past to Present*. Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
  23. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. 1973. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
  24. ELEZI, MEHMET. 2009. *Gjuha Shqipe Me Një Mushkëri*. Tirane: Enti Botues Gjergj Fishta
  25. FERGUSON, CHARLES. 1959. Diglossia. *Word* 15.325-340.
  26. FISHMAN, JOSHUA A. 1964. Language maintenance and language shift as a field of inquiry. *Linguistics* 9.32-70.
  27. FISHMAN, JOSHUA A. 1972a. *The sociology of language*. Rowley, Mass.: Newbury House.
  28. FISHMAN, JOSHUA A. 1972b. Language maintenance and language shift as a field of inquiry: Revisited. *Language in sociocultural change* (pp. 76-134). Standford: Standford University Press.
  29. FISHMAN, JOSHUA A. 1973a. Language modernization and planning in comparison with other types of national modernization and planning. *Language in Society* 2.23-43.
  30. FISHMAN, JOSHUA A. 1973b. Language planning and language planning research: The state of the art. *Advances in Language Planning* 15-33.



31. FISHMAN, JOSHUA A. 1974a. The sociology of language: An interdisciplinary social science approach to language in society. *Current Trends in Linguistics* 12.1629-1784.
32. FISHMAN, JOSHUA A (Ed.). 1974b. *Advances in language planning*. The Hague: Mouton.
33. FISHMAN, JOSHUA A. 1977. Standard versus Dialect in bilingual education: An old problem in a new context. *The Modern Language Journal* 61(7).315-325.
34. HORNBERGER, NANCY H. 2009. Frameworks and models in language policy and planning. In Thomas Ricento (ed.) *Introduction to Language Policy: Theory and Method* (pp. 24-41). Hoboken: Wiley-Blackwell.
35. FRIEDMAN, VICTOR. 1992. Dialectal Base, Variation and Codification of the Balkan Literary Languages: Albanian, Bulgarian, Macedonian and Romany. *Balkan Forum*, Vol. 1, No. 1. 147-153. (English version of 65).
36. FRIEDMAN, VICTOR. 1994. Variation and grammaticalization in the development of Balkanisms. Paper presented at the CLS 30 Papers from the 30<sup>th</sup> Regional Meeting of the Chicago Linguistic Society, Volume 2: The Parasession on Variation in Linguistic Theory, Chicago
37. FRIEDMAN, VICTOR. 2003. Vendi i gegnishtes në gjuhën shqipe dhe në Ballkan [Albanian: The position of Gheg in Albanian and in the Balkans]. *Phoenix* (Shkodër) Vol 7 No. 1-6. 40-56
38. GASHI, SHKËLZEN. 2010. Gjuha e këputun e shqipes: Përmdledhje intervistash mbi mundësinë e hapjes së shqipes standarde. Prishtinë: Rrokullia.
39. ISMAJLI, REXHEP. 1982. *Gramatika e parë e gjuhës shqipe: botim kritik, me studim e transkriptim*. Prishtinë: Rilindja.
40. ISMAJLI, REXHEP. 1985. *Gjuha shqipe e kuvendit të arbënit (1706)*. Prishtinë: Rilindja.
41. ISMAJLI, REXHEP. 2005a. *Drejtshkrimet e shqipës*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
42. ISMAJLI, REXHEP. 2005b. *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërise.
43. JOSEPH, BRIAN. 1983. *The synchrony and diachrony of the Balkan infinitive: A study in areal, general, and historical linguistics*. Cambridge Studies in Linguistics, Supplementary Series. Cambridge: Cambridge University Press.

44. KARAM, FRANCIS X. 1974. Toward a definition of language planning. In Joshua A. Fishman (Ed.) *Advances in Language Planning* (pp. 103-124). The Hague: Mouton.
45. KING, KENDALL A. ET AL. (eds.). 2008. *Sustaining linguistic diversity: Endangered and minority languages and language varieties*. Washington, D.C.: Georgetown University Press.
46. KLOSI, ARDIAN. 2011. *Eqrem Çabej dhe Lehtësimit i Shqipësisë së Shkruar. Shqipja në Etapën e Sotme Politikat e Përmirësimit dhe të Pasurimit të Standardit*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike. Botimet Albanologjike.
47. KOFFI, ETTIEN. 2012. *Contributions to the sociology of language: Paradigm shift in language planning and policy: Game-Theoretic solutions*. Hawthorne, NY: Walter de Gruyter
48. KOLGJINI, JULIE M. 2011. Mundësia e përdorimit të paskajores në standardin e gjuhës shqipe. Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore. Durrës 15-17 dhjetor 2010). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë). 217-234.
49. LIPPI-GREEN, ROSINA. 1994. Accent, standard and language ideology, and discriminatory pretext in court. *Language in Society* 23.163-98.
50. MAKONI, S AND ALASTAIR PENNYCOOK. 2007. Disinventing and reconstituting languages. In S. Makoni and A. Pennycook (Eds.) *Disinventing and reconstituting languages* (pp. 62-89). Clevedon: Multilingual Matters.
51. MAY, STEPHEN. 2005. Language rights: Moving the debate forward. *Journal of Sociolinguistics* 9(3).319-347.
52. MEMUSHAJ, RAMI. 2006. The first congress phenomenon: The case of Albanian. *International Journal of the Sociology of Language* 178.113-127.
53. MILROY, JAMES. 2001. Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics*. 5(4).530-555.
54. MILROY, JAMES AND LESLEY MILROY. 2012. *Authority in language: Investigating Standard English* (4th ed.). Florence, Ky: Routledge.
55. MUFWENE, SALIKOKO. 2008. Colonization, population contacts, and the emergence of new language varieties: A response to Peter Trudgill. *Language in Society* 37(2).254-258.
56. MUNISHI, SHKUMBIN. 2006. *Gjuha standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimit e zhvillimit të saj*. Disertacion i doktoratës. Universiteti i Prishtinës.
57. MUNISHI, SHKUMBIN. 2011. Mbi mundësinë e integritit të paskajores në gjuhën standarde shqipe. Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore. Durrës 15-17

- dhjetor 2010). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë). 195-204.
58. MUNISHI, SHKUMBIN. 2011. Politika dhe planifikimi gjuhësor i shqipes në kontekstin e sotëm. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 30, Prishtinë 2012.
59. MYERS-SCOTTON, CAROL. 1993. Elite closure as a powerful language strategy: The African case. *International Journal of the Sociology of Language*. 103.149-163.
60. NEVALAINEN, TERTTU. 2003. English. In Deumert, Ana and Wim Vandenbussche (Eds.) *Germanic Standardizations. Past to Present* (pp. 127-156). Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
61. PENNYCOOK, ALASTAIR. 2001. *Critical applied linguistics: a critical introduction*. Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum.
62. PENNYCOOK, ALASTAIR. 2007. Chapter 1: ELT and colonialism. In Jim Cummins and Chris Davison (Eds.) *International Handbook of English Language Teaching* (pp. 13-24). New York: Springer.
63. PENNYCOOK, ALASTAIR. 2009. Chapter 4: Postmodernism and language policy. In Thomas Ricento (Ed.) *Introduction to Language Policy: Theory and Method* (pp. 60-76). Hoboken: Wiley-Blackwell.
64. PENNYCOOK, ALASTAIR. 2010a. *Language as a local practice*. London: Routledge.
65. PENNYCOOK, ALASTAIR. 2010b. Critical and alternative directions in applied linguistics. *Australian Review of Applied Linguistics* 33(2). PAGES???
66. PIPA, ARSHI. 1989. *The politics of language in socialist Albania*. Boulder: East European Monographs.
67. PIPA, ARSHI. 1991. *Contemporary Albanian literature*. Boulder: East European Monographs.
68. POOL, JONATHAN. 1993. Linguistic exploitation. *International Journal of the Sociology of Language*. 103.31-55.
69. RICENTO, THOMAS. 2000. Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics* 4(2).196-213.
70. RICENTO, THOMAS. 2009. Theoretical perspectives in language policy: An overview. In Thomas Ricento (Ed.) *Introduction to Language Policy: Theory and Method* (pp. 3-9). Hoboken: Wiley-Blackwell.
71. TOLLEFSON, JAMES. 1980. The language planning process and language rights in Yugoslavia. *Language problems and language planning*. 4(2).141-56.

72. TOLLEFSON, JAMES. 1991. *Planning language, planning inequality*. London: Longman.
73. TOLLEFSON, JAMES. 1993. Language policy and power: Yugoslavia, the Philippines, and Southeast Asian refugees in the United States. *International Journal of the Sociology of Language*. 103.73-95.
74. TOLLEFSON, JAMES. 1997. Language policy in independent Slovenia. *International Journal of the Sociology of Language*. 124.29-49.
75. TOLLEFSON, JAMES. 2002. The language debates: Preparing for the war in Yugoslavia, 1980-1991. *International Journal of the Sociology of Language*. 154.64-82.
76. TOLLEFSON, JAMES. 2007. Chapter 2: Ideology, language varieties, and ELT. In Jim Cummins and Chris Davison (Eds.) *International Handbook of English Language Teaching* (pp. 25-36). New York: Springer.
77. TOLLEFSON, JAMES. 2009. Chapter 3: Critical theory in language policy. In Thomas Ricento (Ed.) *Introduction to Language Policy: Theory and Method* (pp. 42-59). Hoboken: Wiley-Blackwell.
78. TOPALLI, KOLEC. 2007. *Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Dituria.
79. TOPALLI, KOLEC. 2011. Drejtrishkrimi i Shqipësisë si Sistem. Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore. Durrës 15-17 dhjetor 2010). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike (Institut i Gjuhësisë dhe i Letërsisë). 245-308.
80. TRIX, FRANCES. 1997. Alphabet conflict in the Balkans: Albanian and the Congress of Monastir. *International Journal of the Sociology of Language*. 128.1-23.
81. TRUDGILL, PETER. 1983. *Sociolinguistics: An introduction to language and society*. New York: Penguin.
82. TRUDGILL, PETER. 1986. *Dialects in contact*. Oxford: Blackwell.
83. VOKSHI, HASAN. 1959. *Gramatika për klasën e VII e VIII të shkollave fillore*. Prishtinë: Rilindja.
84. VOKSHI, HASAN. 1963. *Gramatikë e gjuhës shqipe për klasën e VI të shkollës fillore*. Beograd: Enti për Botimin e Teksteve të Republikës Socialiste të Serbisë.
85. WALD, BENJI. 1974. Bilingualism. *Annual Review of Anthropology* 3.301-321.
86. WILEY, TERRENCE G. 2002. Heinz Kloss revisited: National socialist ideologue or champion of language-minority rights? *International Journal of the Sociology of Language*. 154.83-97.
87. WILEY, TERRENCE G. 2009. The lessons of historical investigation: Implications for the study of language policy and planning. In Thomas Ricento (Ed.) *Introduction to Language Policy: Theory and Method* (pp. 135-152). Hoboken: Wiley-Blackwell

88. WOOLARD, KATHRYN A. & BAMBI B. SCHIEFFELIN 1994. Language ideology. *Annual Review of Anthropology* 23.55-82.
89. XHUVANI, ALEKSANDER. 1941. *Historija e letërsisë greke klasike (si mbas librit të G. Sett-it) për kursin e naltë të*
90. *licent klasik (libri shteti për shkolla të mesme – nr. 15)*. Tiranë: Botim i Ministrisë s'Arsimit.
91. YAEGER-DROR, MALCAH E. 1992. Communicative accommodation: A new perspective on 'hypercorrect' speech. *Language and Communication*. 12(3).181-192.
92. ZARITSKY, DONNA. 1983. Gramsci's theory of hegemony. Unpublished MA Thesis McGill University.



**Orjeta BAJA**

## **KRISTIAN GYT (CHRISTIAN GUT) PËR GJUHËN SHQIPE**

Në gjysmën e dytë të shek. XX, interesimi për Albanologjinë në Francë erdhi duke u rritur e për rrjedhojë njohu përparim të vijueshëm, si për sa i përket numrit të të interesuarve, ashtu edhe për sa i përket gjerësisë së tematikës së trajtuar në fusha nga më të ndryshmet.

Ndër albanologët francezë me një numër më të madh studimesh për shqipen të kësaj periudhe mund të përmendim: Henri Boissin, Agnès Brunet, Marcel Courtiade, Christian Gut, Christian Leteux, Mario Roques etj.

*Christian Gut-in* (Kristian Gyt) e tërhoqi shumë gjuha shqipe, për çka ndikim të veçantë ka pasur edhe filologu i mirënjohur francez Henri Boissin, nxënës i të cilit ishte. Gyt është studiues i fushave të ndryshme të shkencave të albanologjisë. Për mëse 35 vjet të veprimtarisë së tij të dendur shkencore dhe pedagogjike, ai ka merita të mëdha për njohjen dhe përhapjen e gjuhës e të kulturës shqiptare në vendet e frankofonisë dhe më gjerë. Përveç se albanolog, Gyt është arkivist, historian, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Lindi në Paris në vitin 1931. Po aty, kreu studimet e larta dhe u diplomua në degën arkivist paleograf (1955) dhe më vonë për gjuhën shqipe në Shkollën Kombëtare të Gjuhëve të Gjalla Orientale (1966). Krahas detyrave të tjera që ka kryer, Gyt ka qenë edhe përgjegjës i mësimdhënies së gjuhës e qytetërimit shqiptar në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Lindore në Paris (1971-1995), si dhe përgjegjës i Seminarit të Historisë dhe Filologjisë shqiptare në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta, Sorbonë-Paris (1972-2002), me nismën e të cilit edhe u hap si degë.

Në pothuajse 50 artikujt dhe studimet e tij, një vend të konsiderueshëm zënë punimet në fushën e albanologjisë. Gyt pati fatin të punonte në një kohë kur studimet albanologjike në Francë ishin konsoliduar dhe organizuar mjaft mirë në planin shkencor. Duke qenë për disa kohë edhe drejtor i INALKO - s (Institutit Kombëtar i Studimeve të Gjuhëve dhe Kulturave Orientale), bën disa studime, si: mbi lidhjen e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera ballkanike, përkthen autorë të kohës, analizon kompleksitetin që paraqet procesi i mësimin të gjuhës shqipe nga të huajt etj.

Në këtë kumtesë po ndalemi te **ndihmesat e Kristian Gyt-it në studimin e gjuhës shqipe**. Për këtë po i referohemi kryesisht bibliografisë së shkrimeve të këtij albanologu të paraqitur nga Emil Lafe në artikullin me temë “*Sprovë bibliografike e studimeve për gjuhën shqipe nga autorë francezë pas luftës së dytë botërore*”<sup>1</sup>:

- *L'état présent des études albanologiques en France*<sup>2</sup>, në “Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Univ. – Prof. Dr. Norbert Jokl, Innsbruck, 28 September bis 3 Oktober 1972”, **Innsbruck**, 1977, f. 113-118.

- *Kontakte linguistike midis shqipes dhe maqedonishtes*, në “Gjurmime albanologjike” **3, Prishtinë, 1973**, f. 51-55.

- *La reprise pronominale du complément d'objet dans les langues balkaniques d'après un ouvrage récent*, në “Revue des Etudes Slaves”, 53, **Paris, 1981**, f. 501-506.

- *Sa rasa ka gjuha shqipe?*, në “Cahiers balkaniques” 19, **Paris, 1994**, f. 207-216.

- *Një tekst shkodran i pabotuar i viteve 1850*, në “Studime”, **Prishtinë, 1997**, f. 147-158.

- *Mësimi i gjuhës shqipe në Francë, dje dhe sot*, në “Gjuha jonë”, **Tiranë, 1995 (1997)**, 1-4, f. 113-125.

- *Edhe një herë për tekstin e pabotuar shkodran të viteve 1850*, në “Studime”, **Prishtinë, 2002**, f. 339-341.

Nga kërkimet e mia në shtypin shkencor, kësaj liste bibliografike i shtoj edhe një shkrim tjetër të Gut me titull:

- *Vështrim përfaqësues midis sistemeve fonetike të gramatikës së Kostandin Kristoforidhit dhe asaj të Ogyst Dozonit*, në “Përmbledhje me studime për Kostandin Kristoforidhin”, **Elbasan, 2002**, f. 48-55.

Gjithashtu, Kristian Gyt në bashkautorësi me Anjezë Bryne (Agnès Brunet) e Remzi Përnaskën kanë hartuar metodën “*Parlons albanais*”, **Paris, 1999**, në të cilën gjenden përveç një gramatike të shkurtuar dhe një glosari themelor frëngjisht-shqip dhe shqip-frëngjisht, edhe nocione për historinë, gjeografinë, gjuhën e letërsinë, arkeologjinë dhe folklorin.

Në vitin 2008, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në kolanën “Botime të veçanta” përfshiu edhe botimin e monografisë së filologut francez Kristian

---

<sup>1</sup> Emil Lafe, *Sprovë bibliografike e studimeve për gjuhën shqipe nga autorë francezë pas luftës së dytë botërore*, në “Studime shqiptare” 13 (Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë, dhe kulturën shqiptare), Shkodër, 2005, f. 71.

<sup>2</sup> Kumtesë e mbajtur gjatë Kolokuiumit ndërkombëtar të organizuar më 1972 në Innsbruck në kujtim të albanologut të madh austriak Norbert Jokl, botuar në “Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Univ. – Prof. Dr. Norbert Jokl” nga Hermann M. Olberg, Innsbruck, A.H.OE, 1977.



Gyt, *“Pashko Vasa”*.<sup>3</sup> Kjo monografi rreth jetës dhe veprës së patriotit të Rilindjes sonë Kombëtare, u bë objekt i kësaj trajtесе vetëm sa i përket nivelit gjuhësor të trajtuar nga albanologu.

Monografinë, Kristian Gyt e ka ndarë në 6 krerë, ku ne na interesuan për objektin tonë të kumtesës 2 krerët e fundit, i pesti dhe i gjashti, përkatësisht: *Pashko Vasa dhe gjuha shqipe* dhe *Gjuha e “Shqypnija e Shqyptart”*.

Kreun e pestë Gyt e nis me çështjen e alfabetit, ku edhe për Pashko Vasën, ashtu si për të gjithë rilindësit, problem për t’u zgjidhur ishte pranimi i një alfabeti të vetëm për të shkruar gjuhën shqipe. Për këtë çështje, Gyt i referohet disa dijetarëve, si: M. Domi, Dh. Shuteriqi, S. Frashëri, T. Osmani, R. Qosja, J. Kastrati, J. Rrota etj. Gjuhëtari Tomor Osmani shprehet se “në shekullin e ri edhe K. Gyt i e ka trajtuar këtë problem, duke e parë punën e Pashko Vasës në rrafshin historik, letrar dhe gjuhësor”<sup>4</sup>. Si çështje të dytë trajton gramatikën e Pashko Vasës “Grammaire albanaise à l’usage de ceux qui désirent apprendre cette langue sans l’aide d’un maitre”, botuar në Londër, më 1887, në koleksionin mjaft të njohur të gramatikave Trübner, nën inicialet P.W.. Duke cituar Jup Kastratin<sup>5</sup>, Gyt shkruan se “ndoshta e shkruar si reagim ndaj veprave të Kristoforidhit e të Sami Frashërit, ajo nuk njohu suksesin e shpresuar, pavarësisht nga vlera e saj shumë reale”<sup>6</sup>.

Gyt, në mënyrë të përmbledhur ka paraqitur përmbajtjen e kësaj gramatike, duke bërë një analizë të saj. Siç dihet, është ndër gramatikat e para për shqipen, por e shkruar në frëngjisht, ndonëse bashkatdhetari i tij Sami Frashëri, një vit më parë, botoi një gramatikë për gjuhën shqipe që është e para e shkruar në shqip.

Në kreun e gjashtë, autori merret me gjuhën e veprës *“Shqypnija e shqyptart”* (1879) (njëri prej dy krijimeve të shkruara në gjuhën shqipe nga P. Vasa<sup>7</sup>), ku përshtkruan veçoritë gjuhësore në nivele të ndryshme, si: grafik, fonetik, morfologjik, sintaksor dhe në fund merret me fjalorin dhe drejtshkrimin.

Është pikërisht ky fakt: hulumtimi i shqipes në të gjitha nivelet gjuhësore, që e karakterizon këtë dijetar francez për gjuhën shqipe. Mund të përmendim këtu, p.sh.: në fushën e sintaksës, i kushton rëndësi rimarrjes së kundrinës me të ashtuquajturat trajta

<sup>3</sup> Christian Gut, “Pashko Vasa”, Prishtinë, 2008, 275 faqe. (Përkthyer nga Remzi Përnaska)

<sup>4</sup> Tomor Osmani, *Christian Gut*, në “Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor”, Shkodër, 2009, f. 262.

<sup>5</sup> Jup Kastrati, *Grammatikat e shqipes*, në “Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës”, vëll. 5, 1964, f. 270.

<sup>6</sup> Christian Gut, *Mësimi i gjuhës shqipe në Francë, dje dhe sot*, në “Gjuha jonë, 1-4, 1995, f. 114-115.

<sup>7</sup> Dy krijimet në gjuhën shqipe, të shkruara nga P. Vasa, janë poezia “O moj Shqypni” dhe skica historike “Shqypnija dhe shqyptart” e botuar në “Alfabetaren e gjuhës shqipe” të Shoqërisë së Stambollit.

të shkurtra të përemrave vetorë, ku rreth kësaj dukurie sintaksore, Gyt shkruan duke recensuar studimin “Përsëritjet përemërore të kundrinës në gjuhët ballkanike” të gjuhëtarit rus Jurij A. Lopashov<sup>8</sup>; në fushën e morfologjisë, i kushton shumë rëndësi sidomos sitemit rasor të gjuhës shqipe me synimin për të përcaktuar sa rasa ka gjuha jonë, etj.

Ndër artikujt studimorë të renditur më sipër të albanologut Gyt, vetëm dy prej tyre janë të botuar në shtypin shkencor në Shqipëri: njëri në “Përmbledhje me studime ...” në Elbasan, tjetri në revistën shkencore “Gjuha jonë” në Tiranë, siç u përmendën pak më sipër.

Sa i përket artikullit në revistën “Gjuha jonë” (1-4, 1995), me temë “**Mësimi i gjuhës shqipe në Francë, dje dhe sot**”, i botuar në vitin 1997, albanologu Gyt, siç e pohon edhe vetë, kufizohet në problemet që lidhen me gjuhën dhe letërsinë, por jep si shtojcë edhe të dhëna të shkurtra bio-bibliografike për mësimdhënësit e gjuhës shqipe, si edhe një listë të veprave të letërsisë shqiptare të përkthyer në frëngjisht dhe të botuara në Francë.

Po shkëpusim nga ky artikull këto publikime e fakte<sup>9</sup> që përmend Gyt:

Më 1879, Auguste Dozon, njohës i mirë i gjuhëve ballkanike, boton “Grammaire de la langue chqipe ou albanaise”, vepër kjo, e qartë, e përpiktë dhe e saktë, e mbështetur në dialekt toskë, në atë të Përmetit, e shoqëruar me tekste, dhe me përkthime, tregime, këngë, proverba dhe një fjalor frëngjisht-shqip.

Në të njëjtin vit, pohon Gyt, gjuhëtari dhe helenisti Luis Benloew paraqiti “Analyse de la langue albanaise”, ku krahas pohimeve të rastit, ai merrte pozicion në të mirë të autoktonitetit të shqiptarëve.

Pak kohë më vonë, vazhdon Gyt, rilindasi i madh shkodran Pashko Vasa mbështetej krejt natyrshëm në gegërishten në “Grammaire albanaise à l’usage de ceux qui désirent apprendre cette langue sans l’aide d’un maitre”, që përmendëm më sipër”.

Gjithashtu, Gyt shkruan për artikuj të Louis Dufour, e sidomos për doracakun e vogël të tij “La langue albanaise en 30 leçons”, Paris, pa datë (rreth 1930), 98 faqe.

Në artikullin në fjalë, ai përmend edhe shkrime të tjera, si: “Gramatika shqiptaro-franceze” që jepet në numrin 29 gusht 1925 të “Zëri i Korçës” dhe “Orthographe et prononciation de la langue albanaise” në numrin 1 (dhe të vetëm) të revistës “L’Albanie nouvelle”, për të cilat shprehet se nuk duket se kanë lënë gjurmë.

<sup>8</sup>Emil Lafe, *Sprovë bibliografike e studimeve për gjuhën shqipe nga autorë francezë pas luftës së dytë botërore*, në “Studime shqiptare” 13 (Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare), Shkodër, 2005, f. 74.

<sup>9</sup> Christian Gut, *Mësimi i gjuhës shqipe në Francë, dje dhe sot*, në “Gjuha jonë, 1-4, 1995, f.114-115.

Në vijim të artikullit të tij, pasi pohon se “themeluesi i mësimit të shqipes në Francë ka qenë mësuesi dhe miku i tij Henri Boissin”<sup>10</sup>, albanologu Gyt shkruan se “Gramatika e shqipes së sotme” (*Grammaire de l’albanais modern*) që Boissin na dha para vdekjes së tij (1975), mbetet fundamentale, edhe pse disa pjesë të saj janë vjetëruar, dhe është për të ardhur keq që ai nuk pati kohë të zhvillonte pjesën e sintaksës, ashtu siç dëshironte<sup>11</sup>.

\*\*\*

Si monografia “Pashko Vasa”, si artikujt dhe studimet gjuhësore për shqipen, si studimet në fushën e historisë e të përkthimit, në përpjekje për një ravijëzim sa më të qartë e të plotë të profilit të Shqipërisë e gjuhës së saj nga albanologu francez Kristian Gyt, përbëjnë një punë që duhet të vlerësohet shumë, sidomos kur e bën një studiues i huaj, duke merituar gjithë nderimin e mirënjohjen tonë të thellë si shqiptarë.

---

<sup>10</sup> Christian Gut, *Mësimi i gjuhës shqipe në Francë, dje dhe sot*, në “Gjuha jonë, 1-4, 1995, f. 115.

<sup>11</sup> Po aty, f. 118.

## **Bibliografi**

1. Artan Haxhi - Tefë Topalli, “Leksikon (Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë)”, Shkodër, 2012
2. Christian Gut, *Mësimi i gjuhës shqipe në Francë, dje dhe sot*, në “Gjuha jonë, 1-4, 1995
3. Christian Gut, “Pashko Vasa”, Prishtinë, 2008, 275 faqe. (Përkthyer nga Remzi Përnaska)
4. Emil Lafe, *Sprovë bibliografike e studimeve për gjuhën shqipe nga autorë francezë pas luftës së dytë botërore*, në “Studime shqiptare” 13 (Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë, dhe kulturën shqiptare), Shkodër, 2005
5. Jup Kastrati, *Gramatikat e shqipes*, në “Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës”, vëll. 5, 1964
6. Tomor Osmani, *Christian Gut*, në “Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor” 3, Shkodër, 2009
7. Universiteti i Shkodrës, *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë, dhe kulturën shqiptare*, “Studime shqiptare” 13, Shkodër, 2005

**Majlinda BREGASI**

**KONTRIBUTI I LEONARDO MARIA SAVOIAS PËR  
ALBANOLOGJINË, NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XX**

Leonardo Maria Savoia është një nga figurat më eminente të gjuhësisë italiane bashkëkohore si edhe një nga studiuesit më seriozë të shqipes. Përpjekja për të bërë një prezantim të punës së tij, bart një sërë vështirësish më vete, qoftë nga aspekti i klasifikimit të interesave të tij kërkimore, ashtu edhe për një përzgjedhje të rezultateve shkencore, pasi janë të shumta.

Formimi kryesisht mentalist e shtyn Savoian të studiojë nga format morfosintaksore e fonologjike të raportit teorik mes gjuhës dhe komunikimit, nga studimi i dialekteve italiane, arbëreshe dhe të shqipes së Ballkanit, deri te problematika e teorisë gjuhësore, nga studimi i situatave sociolinguistike e pragmatike të studimi i detajizuar i politikave gjuhësore, minoriteteve gjuhësore etj. Savoia ka gjithashtu një numër të madh publikimesh mbi historinë e studimeve gjuhësore.

Kontributi i tij mbi gjuhësinë shqiptare dhe, veçanërisht, atë arbëreshe, është i një rëndësie të veçantë. Ai është një prej personaliteteve më të spikatura të “qarkut italian” të albanologjisë, ku në vija të trasha do të përfshinin studietit Francesco Solanon, Giuseppe Faracon, Antonino Guzzettën, Francesco Altamarin, Matteo Mandalà, Italo Fortinon etj.

Interesi i tij mbi gjuhësinë shqiptare dhe varietetet arbëreshe në veçanti, zunë fill gjatë viteve ’70 të shekullit të kaluar, kur Savoia ishte docent në Universitetin e Kalabrisë dhe për herë të parë u vu në kontakt me komunitetet arbëreshe të Kalabrisë, Lukanës dhe Pulies përmes studentëve të tij. “Për një gjuhëtar, sikurse dëshiroja që të bëhesha unë që një rast i papërsëritshëm për të studiuar, nga njëra anë, dukuritë gramatikore të varieteteve të izoluara dhe në të njëjtën kohë të ndikuara nga kontakti dhe nga bilinguizmi, dhe nga ana tjetër, aspektet sociolinguistike dhe pragmatike të situatave sociolinguistike komplekse sikurse janë ato të arbëreshëve të Italisë. Ato ofronin elemente të rëndësishme për analizën e mekanizmave morfosintaksore, fonologjike, dhe pragmatike të lidhur me kushtet e mikrovariacionit dialektor.”(Savoia, 2008).

Prej atëhere e deri më sot, që është profesor ordinar i gjuhësisë së përgjithshme

në Universitetin e Firenzes, gjuhësia shqiptare dhe dialektologjia arbëreshe përbëjnë një objekt konstant të kërkimeve të tij shkencore.

Një skemë e thjeshtë e studimeve të tij albanologjike do të ishte si më poshtë:

- Studimet dialektologjike, të cilat japin një model të shkëlqyeshëm për zhvillimin e dialektologjisë bashkëkohore shqiptare, bazuar mbi modelet teorike të gjuhësisë gjenerative, e cila mungon.

- Studimet gramatikore të shqipes, me theksim te morfosintaksa dhe fonologjia.
- Studimet socio-linguistike e socio-kulturore të komuniteteve arbëreshe, por edhe të atyre shqiptare

- Të përvetësuarit e gjuhës (language acquisition) edhe mbi kontekstin arbëresh
- Studimet mbi politikën gjuhësore

**1. Studimet dialektologjike**, japin një model të shkëlqyeshëm për zhvillimin e dialektologjisë bashkëkohore shqiptare, bazuar mbi modelet teorike të gjuhësisë gjenerative, e cila thuhet mungon tërësisht në studimet tona.

“Askush para tij nuk ka bërë një punë aq organike dhe aq komplekse të studimit të varieteteve arbëreshe. Përveç përshkrimeve, me përjasje të reja të tipit gjenerativist, të disa varieteteve të arbërishtes, sikurse ajo e San Marzanos, në Puglia (Savoia, 1980), dhe varieteteve arbëreshe të zonës së Vultures, në Bazilikatë (Savoia, 1984), këto kontribute të tij tenonin për herë të parë të jepnin një inkuadrim unitar dhe më kompleks të dukurive të përgjithshme të morfologjisë dhe të sintaksës arbëreshe që përfshinin varietete e ndryshme italo-shqiptare të studiuara nga ai, nga Molise deri në Sicili (Savoia, 1984), duke na përshkruar disa procese të ristrukturimit analogjik në fleksionin verbal (Savoia 1983a, 1983b, 1985, 1986, 1992) dhe disa karakteristika morfosintaksore të kauzativit (Savoia 1989a, 1989b, Brandi e Savoia 1990)” (Altamari te Savoia, 2008).

Komunitetet arbëreshe paraqesin një tërësi dukurish të code-switching, huazimit, konvergencës dhe të hibridizimit gjuhësor si rrjedhojë e situatës së bilinguizmit mes shqipes dhe dialektit roman që ka zgjatur për një kohë shumë të gjatë (Camaj 1974, Bibbò 1974, Gamabarara 1980, Bolognari 1986, Savoia, 2008). Në punimin ‘Variacioni dhe përzierja gjuhësore në sistemet arbëreshe: Code-mixing, huazime dhe konvergencë në kushtet e bilinguizmit’ Savoia analizon thellësisht këto procese të gjuhëve në kontakt duke u nisur nga një interpretim i ngushtë i programit minimalist që e përjashton lëvizjen dhe kategoritë abstrakte dhe bazohet në një model që përfaqëson lidhjet sintaksore. Savoia e Manzini propozojnë një model, i cili nuk parasheh ndarjen mes kategorive funksionale dhe elementeve të tjera leksikore, duke përjashtuar këtu elementet abstrakte si veçoritë e fonemave si edhe kategoritë boshe të cilat u shërbejnë ekskluzivisht proceseve sintaksore. “Komputacioni sintaksor

ndërtohet pra mbi bazën e veçorive semantike të regjistruara nga elementet leksikore dhe nuk projektton domosdoshmërisht të gjithë përbërësit e asaj të cilën ne e quajmë kuptimin e fjalisë (Savoia, 2008: 56). Me këtë model ata kritikojnë disa pika thelbësore të modelit të MacSwan-it, i cili bazohet pikërisht mbi ndarjen e kategoriave funksionale dhe leksikore.

“Në rastin e komuniteteve arbëreshe, në përgjithësi është arbërishtja ajo që inkorporon veti dhe mjete të morfosintaksës dhe fonologjisë romane, megjithatë janë dokumentuar edhe dukuri të konvergencës së gramatikës romane mbi atë arbëreshe. Një shembull interesant i gjithë këtij procesi jepet nga dialekti kalabrez që flitet në Vena, në të cilën shfaqen tipare, të cilat, nga njëra anë, rrjedhin nga mekanizmat e riorganizimit gramatikor që kanë të bëjnë me gjuhët e mësuara dhe, nga ana tjetër, janë pikërisht të trashëguara nga arbërishtja (Savoia, 2008:1).”

Në këtë punim Savoia zhvillon idenë se variacioni gjuhësor vjen nga pikënisje të ndryshme të hapësirës konceptuale (sikurse është përcaktuar nga teoria e gramatikës universale) që regjistrohet nga elementet leksikore. Variacioni pra varet nga analiza e fundit e vetive leksikore të elementeve (Savoia, 2008:56), ndërsa huazimet dhe dukuritë e përzjerjes përkojnë me mënyra të leksikalizimit të hapësirës konceptuale më shumë sesa të reduktosheshin në një farë forme me idiosinkracitë e një grupi të veçantë thëniesh në situata të kontaktit gjuhësor. Huazimi dhe përzjerja pra nuk përkojnë me transpozimin mekanik të strukturave morfosintaksore dhe leksikore, por implikojnë mekanizma kognitivë të përgjithshëm që kanë të bëjnë me ndërlidhjet mes sistemit senso-motor dhe vetive komputacionale (Savoia, 2008:56). Në këtë kuadër Savoia fut edhe riorganizimin fonologjik, për aq sa ai paraqet rezultatin e përvetësimit të vetive dhe proceseve që përbërësi fonologjik përvetëson nga sistemi ndërlidhës senso-motor.

## **2. Studimet gramatikore të shqipes, me theksim te morfosintaksa dhe fonologjia**

Rezultatet e studimeve të tij këtu, jo vetëm janë thelbësore për shqipen, por shpjen edhe më tej teorinë gjenerativiste, duke hapur debate të reja.

Në punimin ‘*Rasa dhe veti treguese: fleksioni emëror në të folmen geqe të Shkodrës*’ Savoia e Rita Manzini mbështeten në modelin e propozuar po prej tyre me 2005, 2007, sipas të cilit komputacioni sintaksor ndërtohet mbi bazën e veçorive semantike të regjistruara nga elementë leksikorë që përfshihen në fjali; ata nisen nga hipoteza se rasa dhe fleksioni i përshtatjes së emrit (gjini, numër) mbartin të njëjtat veti konceptuale.

Pas shqyrtimeve të detajuara të sistemit të rasës ku ata ndalen te: 1) Paradigmat emërore dhe përemërore në gegërishten e Shkodrës, 2) Shpërndarja e morfologjisë së

rasës: sinkretizime dhe statuti teorik i rasës 3) Vetitë treguese të rasës, ata dalin në përfundimin:

“Brenda këtij kuadri teorik rasa nuk shihet si një primitiv i sintaksës, por si një morfologjizim i vetive treguese në varësi të rastit (argumentë, kuantifikues) nëpërmjet formantëve që normalisht lidhen me veti të klasës emërore apo të kuantifikuesve. Kështu, argumenti i jashtëm dhe i brendshëm i foljes trajtohen nën terminologjinë e klasës emërore, ose, në rastin e shumësit, si kuantifikues për individë apo sende.”

Një kapitull i rëndësishëm në këto studime paraqitet edhe studimi mbi varietetin gjuhësor të Shkodrës “**Pjesorja dhe Paskajorja në të folmet e Shkodrës**” (ASHSH dhe IGJL, 2003, VITILVII (XL).

Savoia e Manzini arrijnë në përfundimin se klitikët [...mund të shqyrtohen si kategori sintaksore, të mbështetura në cilësitë shenjuese të strukturave emërore.] (Savoia, Manzini, 2003:107) . Pas shqyrtimit të këtyre kategorive, ku D paraqet shquarsinë, R-referimin specifik, Q-cilësitë kuantifikuese, P (ose veta) cilësitë e referimit ndaj folësit ose dëgjuesit, Loc referimin ndaj koordinatave hapësinore të aktit të ligjërit, N-cilësitë kallëzuese të emrit dhe Op- cilësitë intensionale, dalin në përfundimin se këto përkrijnë me kategoritë që përcaktojnë nyjëtimin e brendshëm të togfjalëshit emëror, sipas skemës themelore që paraqet pozicionet e tyre hierarkike në strukturën e fjalisë D-Q- P- N.

Duke u mbështetur në qasjen tradicionale, e cila ilustron në teorinë e Chomskyt (1995), ndaj eptimit foljor, e cila thotë se eptimi përbëhet nga një tërësi tiparesh të papërcatuara të lidhura me foljen, vlera e të cilave përcaktohet nga tiparet përgjegjëse të kryefjalës së fjalisë, Savoia e Manzini bëjnë njësimin e analizës sintaksore të fjalisë dhe të sintagmës emërore me atë morfologjike. [ Njësimi i morfologjisë dhe i sintaksës i paraqitur këtu shpie në përfundimin se eptimi foljor ka brenda foljes të njëjtin status që ka kryefjala përemërore brenda fjalisë (Savoia, Manzini 2008: 108).

Shkodër, shembulli : e ‘krehi, ‘kre:h, ‘kreh:h, ‘krehim, ‘krehni, ‘krehin, e kreh etj.

a.		F	
	F		D
	kreh	D	
		in	
b.		F''	
	F		D''
	krehin		
		D	
		ato	



ku qoftë kryefjala përemërore, qoftë eptimi foljor karakterizohen si D (Paraqet shquarsinë). Dallimi ndërmjet këtyre dy elementeve qëndron në faktin se eptimi foljor i paraqitur në a. ndodhet në pozicion D brenda fjalës kreh që vetë ndodhet në pozitë F, ndërsa në b. folja në tërësinë e saj vendoset në F e ndiqet nga kryefjala përemërore që vendoset në D.

Përfundimi tjetër i rëndësishëm në këtë punim është se pjesorja është një strukturë fjalie e pavarur. Savoia e Manzini mendojnë se jo vetëm pjesorja i përgjigjet një fjalie, por që edhe të ashtuquajturat folje ndihmëse jam dhe kam në kontekstet folje ndihmëse - pjesore kanë vlerën e foljeve të zakonshme me tipare leksikore të veçanta, sikurse ndodh në gjuhët romane.

“Përkimi i pikave të ngjarjes së fjalisë së varur pjesore me ato të fjalisë kryesore varet nga fakti që pjesorja lidhet me një argument të mundshëm të ngopur jo në brendësi të fjalisë së vetë, por nga të njëjtat tipare kohore F që kënaqin ndryshoren e mundshme të foljes drejtuese. Rrjedhoja e këtij identifikimi të argumenteve të mundshme është identifikim i tërë strukturës së argumentit (Savoia & Manzini :132)”

## Bibliografia

1. M. Savoia, 1980, La parlata albanese di S. Marzano di S. Giuseppe: appunti fonologici e morfologici, in Zjarri, XII, 27, pp. 8-26
2. 1983, Assetto della grammatica e realizzazione sociale nel cambiamento linguistico: un esempio di variazione morfologica in una varietà arbëreshe, in Quaderni dell'Istituto di Linguistica dell'Università di Urbino, 1:25-67
3. 1983, Ristrutturazione analogica: sviluppi in alcune parlate albanesi, in AA.VV., Scritti in onore di G.B. Pelegrini, Pacini, Pisa, fq. 1171-1187
4. 1985, La morfologizzazione del vocalismo tematico nel perfetto in \*o in alcune parlate arbëreshe, in Zjarri, XVII, 29, fq. 43-64
5. 1989, Alcune caratteristiche del causativo arbëresh, in AA.VV., Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del 2° Congresso Internazionale, Comune di Piana degli Albanesi, fq. 363-420
6. 1991, Alcuni elementi per una classificazione dei dialetti arbëreshë, in AA.VV. La lingua albanese nell'Italia meridionale, Università di Salerno, fq. 13-52
7. 1993, Condizioni fonologiche e morfosintattiche della coincidenza fra flessione media e attiva nei dialetti di Barile e di Ginestra, in Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Firenze, 4, fq. 133-162
8. 1994, Parametrical variation in prosodic licensing: evidence from italo-Albanian dialects, in Rivista di grammatica generativa, 20:105-141.
9. 2003, Ideologia nazionale e indagine linguistica. Due conferenze albanesi, in Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Firenze, 13:127-152
10. 2006, Elementi di Linguistica albanese, in Cinzia Fia, Albanesi, cossovani e molti altri nella scuola di Monteroni D'Arbia, Edizioni Gorèè, Iesa (Siena): 75-100
11. L. SAVOIA (2007). Introduzione. Aspetti della linguistica di De Rada nel quadro delle ricerche linguistiche arbëreshe del '700 e dell'800. In: F.
12. Altissimi. Gerolamo De Rada, Opera omnia, X – Opere grammaticali, pp.
13. 9-26, SOVERIA MANNELLI (CZ): Rubbettino, ISBN:9788849816358.
14. L.M. Savoia & M. R. Manzini, Studi sulle varietà arbëreshe, Università della Calabria, 2008
15. L.M. Savoia (2010). Albanese, comunità. In: Raffaele Simone, Gaetano
16. Berruto, Paolo D'Achille. Enciclopedia dell'italiano, 2 volumi, pp. 33-37, Roma: Istituto dell'Enciclopedia Italiana G. Treccani, ISBN:9788812000401.
17. M.R. Manzini, L. Savoia (2010). Rasa dhe veti treguese: emëror në të folmen

- gege të Shkodrës. In: AA.VV.. Identitete gjuhësore dhe kulturore, pp. 13-29, Shkodër: Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
18. M. R. Manzini; L. M. Savoia (2012). The Interaction of DOM and Discourse-Linking in Arbëresh Pronouns: Case as Nominal Property. In: Giuseppina Turano, Rami Memushaj, Flora Koleci. Theoretical and empirical studies in Albanian Syntax. Studime teorike dhe empirike në fushën e sintaksës së shqipes, pp. 119-139, München: Lincom Europa, ISBN:9783862883547.
19. Leonardo M. Savoia; M. Rita Manzini (2012). Case as Nominal Property: the Interaction of DOM and Discourse-linking in Shkodër Pronouns. In: Rexhep Ismajli. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit - Albanian and Balkan Languages, pp. 411-432, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ISBN:9789951615037.



Linda MËNIKU

**KONTRIBUTI I PROF. VICTOR FRIEDMAN-IT NË STUDIMET  
PËR GJUHËN SHQIPE**

Studimet për gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare në Shtetet e Bashkuara, ndonëse i kanë fillimet në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, me krijimin e komunitetit shqiptar në SHBA, në mënyrë të veçantë u zgjeruan në pjesën e dytë të shekullit XX. Studiuesit amerikanë “*me përshkrimin e gjuhëve, teknikat dhe metodat e zhvilluara për hulumtimin në terren kanë bërë që ata të japin vepra me vlerë [...] si studimet e Victor Friedman-it për morfosintaksën, për tekstet e shekullit të 19-të ashtu si për krahasimet e thelluara me gjuhët e tjera ballkanike*”<sup>1</sup>

Studimet e gjuhëtarit amerikan Victor Friedman, profesor i nderuar në Departamentin e Sllavistikës dhe të Linguistikës në Universitetin e Çikagos, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, një nga ekspertët më të njohur në botë për gjuhët e Ballkanit, kanë një rol të jashtëzakonshëm në gjuhësi dhe në mënyrë të veçantë për gjuhësinë shqiptare.

Ashtu sikurse e thekson prof. Kolec Topalli<sup>2</sup>, Victor Friedman-i është i njohur “*si ballkanist, albanolog, sllavist e turkolog, duke i shtrirë interesat e tij gjuhësore përtej gjuhëve ballkanike deri te gjuhët e Kaukazit.*”

Mes 200 publikimeve në fushën e gjuhësisë, një vend të rëndësishëm në studimet e tij zë trajtimi i problemeve teorike dhe problematika e lidhjes ndërmjet gjuhëve ballkanike, e njohur me termin *Sprachbund*. Për prof. Friedman-in “*gjuhët e Ballkanit si një grup, janë me interes për t’u studiuar pasi edhe pse kanë marrëdhënie të largëta, përmes kontaktit gjuhësor dhe ndikimit tek njëra-tjetra, ato kanë zhvilluar kategori të përbashkëta që janë më komplekse nga ato të pjesës më të madhe të gjuhëve të tjera europiane*”<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Ismajli, Rexhep. Studimet albanistike të Prof. Eric P.Hampit. www.kosova.com.

<sup>2</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, f.121.

<sup>3</sup> Pinner. Diantha. Pattern and Structure in Balkan Languages. *Endeavors: Research and Graduate Education at the University of North Carolina, Chapel Hill* Vol. 3, No. 2, 1986, fq.

Si një ballkanist i njohur, me një punë kërkimore në rajon prej më shumë se 35 vjetësh, Victor Friedman-i është përpjekur që jo vetëm të identifikojë kategoritë e përbashkëta mes gjuhëve të Ballkanit, por duke depërtuar në ngjashmëritë mes gjuhëve, të kuptojë dallimet reale mes tyre dhe t'i shpjegojë ato.

Ndër veçoritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike, “*autori ka shfaqur interes të veçantë për njërin nga format foljore që është formuar në zhvillim të brendshëm gjubësor të disa gjuhëve ballkanike. Është fjala për mënyrën habitore që me përdorime të veçanta sipas gjuhëve gjendet në shqip, maqedonishte, bullgarishte e turqishte*”.<sup>4</sup> Fillimisht, në një botim të vitit 1977<sup>5</sup> për kategoritë gramatikore të foljes në maqedonisht prof. Friedman-i trajton në një kapitull të veçantë kategori të ngjashme të gjuhëve të tjera ballkanike, duke përfshirë dhe gjuhën shqipe, kurse në vitin 1980 boton për herë të parë një artikull<sup>6</sup> për historinë e hulumtimeve të habitores në gjuhët ballkanike, ku një vend të rëndësishëm zë trajtimi i habitores në gjuhën shqipe

Duke krahasuar historinë e studimit të formave të habitores në gjuhët e Ballkanit (bullgarisht, maqedonisht, turqisht dhe shqip), prof. Friedman-i nxjerr në dukje faktin se “*trajtimi më i hershëm i kësaj dukurie gjubësore është në gjuhën shqipe, e cila është gjuha e vetme në Ballkan ku ajo ka një set të dallueshëm formash*”.

Duke iu referuar studiuesve të ndryshëm, Friedman-i ka përmendur si disa nga çështjet kryesore të habitores së gjuhës shqipe: origjinën, numrin e seteve paradigmatiche që realizohen aktualisht, kuptimin bazë, dhe statusin e saj si një kategori gramatikore. Për origjinën e habitores së shqipes, Friedmani u referohet përfundimeve të dhëna nga prof. Shaban Demiraj se origjina e mënyrës habitore në gjuhën shqipe duhet konsideruar nga koha e kryer në formë të invertuar; kurse për format e mënyrës habitore i referohet studimit të detajuar të prof. Emil Lafes.

Duke u ndalur në vështrim krahasues me bullgarishten, maqedonishten dhe turqishten, Friedman-i ka theksuar faktin se përdorimi habitore i së shkuarës së papërcaktuar në bullgarisht u vu re së pari në krahasimin që iu bë asaj me turqishten dhe me gjuhën shqipe. Në përfundim të këtij artikulli, ai shtron dy probleme të rëndësishme:

19. “*The Balkan languages as a group are particularly interesting to study, Friedman says, because they are only distantly related; yet, through linguistic contact and influence, they have developed shared categories that are more complex than those of most other European languages*”.

<sup>4</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, f.122.

<sup>5</sup> Friedman, Victor. *The Grammatical Categories of the Macedonian Indicative*. Columbus. Slavica. 1977.

<sup>6</sup> Friedman, Victor. The Study of Balkan Admirativity: Its History and Development. *Balkanistica*, Vol. 6, 1980, fq.7-30.

<sup>7</sup> Friedman, Victor. The Study of Balkan Admirativity: Its History and Development. *Balkanistica*, Vol. 6, 1980, fq.23. “*The earliest treatment of the phenomenon occurs in the description of Albanian, which is the only Balkan Language in which the admirative constitutes a distinct set of forms*”.

ekzistencën dhe ndikimin e këtyre gjuhëve tek njëra-tjetra për habitoren, dhe natyrën e kategorisë gramatikore të shprehur nga format e përdorura për habitoren, duke u ndalur në faktin nëse habitorja është modale, aspektore apo diçka tjetër.

Pikërisht këtyre çështjeve që ai i lë hapur për diskutim, në artikullin e vitit 1980, përpiket që t'u përgjigjet një vit më vonë, në vitin 1981, në dy artikuj ku krahason sistemet foljore të shqipes dhe të maqedonishtes. Në artikullin e parë<sup>8</sup>, Friedman-i trajton dy probleme të rëndësishme në lidhje me përdorimin e habitores. Në këtë artikull ai përpiket që me anë të fakteve të shqipes t'i përgjigjet pyetjes se nëse format e habitores në gjuhët sllave të Ballkanit dhe në turqisht janë të markuara si forma të së shkuarës, si mund të përdoren në kohën e tashme. Kurse me anë të fakteve nga gjuhët sllave të Ballkanit dhe nga turqishtja, Friedman-i përpiket që të shpjegojë faktin që nëse këto forma të habitores janë të markuara nga disa forma të raportimit, si mund të përdoren ato për diçka që në fakt dëshmohet nga vetë folësi.

Duke dhënë shembuj nga gjuhët e analizuara, Friedman-i arrin në konkluzionin se përdorimi i habitores në marrëdhënien e saj të së shkuarës me të tashmen ruan pjesërisht kuptimin e së kryerës nga e cila vijnë kohët e pamarkuara, ndërsa mbartin në të njëjtën kohë disa nuanca të moskonfirmimit të cilat i kanë fituar gjatë zhvillimit të tyre në kundërvënien me zhvillimin e markimit të statusit konfirmues në të kryerën e thjeshtë.

Në këtë mënyrë, përdorimi i habitores në gjuhët sllave të Ballkanit dhe në turqisht është në përputhje me kuptimet e tyre kontekstuale të mospohimit. Kjo pikëpamje mbështetet nga situata në gjuhën shqipe, ku janë pikërisht format e shkuara të markuara të habitores që lejojnë përdorimin që vihet re në të shkuarën e pamarkuar të gjuhëve sllave të Ballkanit dhe në turqisht.

Përsa i përket çështjes së dytë, Friedman-i mendon se një pjesë e mirë e sistemit foljor në gjuhën shqipe është imazhi pasqyrë i kësaj dukurie në gjuhët sllave të Ballkanit dhe në turqisht. Nëse në gjuhët sllave të Ballkanit dhe në turqisht, kohët e kryera janë zhvilluar në kohë të shkuara të pamarkuara me kuptime kontekstuale të moskonfirmimit, e kryera e shqipes është ndarë në dy pjesë: e kryera e zakonshme është shndërruar në të shkuarën e pamarkuar, kurse nuancat jopohuese i janë lënë së kryerës së invertuar që më vonë u zhvillua në sete paradigmatiche të markuara për statusin e mospohimit: *habitores*.

Duke këmbëngulur në faktin se në investigimin e problemeve gramatikore në një gjuhë të Ballkanit, mund të përdoren dukuri nga gjuhë të tjera të Ballkanit për të dhënë

---

<sup>8</sup> Friedman, Victor. Admirativity and Confirmativity. *Zeitschrift für Balkanologie*, Vol. 17, No. 1, 1981, fq.12-28.

zgjdhje, Friedman-i trajton në një artikull të veçantë habitoren e bullgarishtes<sup>9</sup>, të krahasuar me shqipen dhe me turqishten. Duke përmendur faktin se ishte Weigandi, në vitin 1923, që vuri re i pari se “e kryera” e bullgarishtes mund të përdoret me një kuptim në të tashmen për të shprehur habi, në një mënyrë që të kujtonte habitoren e shqipes, thekson se që përveç disa vëzhgimeve të bëra nga Fiedleri (1968) dhe Demiraj (1971), nuk ka pasur një studim krahasues mes këtyre gjuhëve. Për këtë arsye, duke u bazuar në veprën e Konstantinovit “Baj Ganjo” në origjinalin në bullgarisht, dhe në përkthimet përkatëse të kësaj vepre në gjuhën shqipe (1975) dhe në turqisht (1972), Friedman-i përpiqet të analizojë marrëdhënien e habitores së bullgarishtes me habitoren e shqipes dhe atë të turqishtes. Por dhe në këtë studim, Friedman-i konsideron si bazë të krahasimit, përkthimin në gjuhën shqipe dhe jo origjinalin në bullgarisht, pasi “*habitorja e shqipes është kategori e dallueshme morfologjike, dhe si rrjedhojë, një kategori e identifikueshme, kurse në bullgarisht dhe në turqisht, habitoret janë thjesht përdorime specifike të formave më të përgjithshme foljore dhe nuk janë kategori gramatikore të pavarura*”<sup>10</sup>.

Nga të dhënat e këtij krahasimi, Friedman-i e vendos përdorimin e habitores së bullgarishtes në një pozicion të ndërmjetëm mes shqipes dhe turqishtes.

Ndikimin e habitores së shqipes në gjuhët e Ballkanit, Friedman-i e vë re dhe tek arumanishtja. Nga studimi i arumanishtes në fshatin Belicë e Sipërme, afër Strugës, në Maqedoni, ai arrin në konstatimin se “*kjo habitore u formua përmes një analizimi abduktiv të habitores së gjuhës shqipe*”<sup>11</sup>. Fakti që në të folmet e arumanishtes, morfema *-ka* që në shqip shënon vetën e tretë të habitores është kuptuar si shenja e habitores në përgjithësi, është tregues se kategoria jovërtetuese e habitores është marrë hua nga gjuha shqipe.

Friedman-i i rikthehet sërish habitores së shqipes, në një artikull në vitin 2010, kur ai vlerëson faktin se “*shqipja na jep një dëshmi të çmuar për rindërtimin e indo evropianishtes.*”<sup>12</sup> Dhe si një nga problemet që qëndron në qendër të dëshmisë së shqipes, Friedman-i konsideron moshën dhe origjinën e mënyrës habitore. Në këtë

<sup>9</sup> Friedman, Victor. Admirativity in Bulgarian Compared with Albanian and Turkish. *Bulgaria Past and Present*, ed. D. Kosev, Vol. 2. Sofia: Akademia Bullgare e Shkencave, 1982, fq.63-67.

<sup>10</sup> Friedman, Victor. Admirativity in Bulgarian Compared with Albanian and Turkish. *Bulgaria Past and Present*, ed. D. Kosev, Vol. 2. Sofia: Bulgarian Academy of Sciences. 1982, fq.63. “*In this paper, the Albanian translation rather than the Bulgarian original will function as the basis of comparison, due to the fact that Albanian admirative is a morphologically distinct and therefore unambiguously identifiable category, whereas the Bulgarian and Turkish admiratives are merely specific uses of more general forms and are not independent grammatical categories*”.

<sup>11</sup> Friedman, Victor. *Studies on Albanian and Other Balkan Languages*. Peja: Dukagjini, 2004, f.117.

<sup>12</sup> Friedman, Victor. The Age of the Albanian Admirative: A Problem in Historical Semantics. *Ex Anatolia Lux: Anatolian and Indo-European Studies in Honor of H. Craig Melchert*. ed. by Ronald Kim, Norbert Oettinger, Elisabeth Riecken, and Michael Weiss. New York: Beech Stave Press. 2010. “*Albanian gives us precious evidence for the reconstruction of Indo-European.*”



artikull, ai përpiket të argumentojë se në kundërshtim me prof. Demirajn (1971), i cili argumenton e habitortja e shqipes daton para pushtimit turk, ai mendon se “*dëshmia semantike në tekstet e vjetra favorizon periudhën osmane si kohën kur habitortja e shqipes konsolidoi kuptimet që në gjejmë në gjuhën standarde sot, dhe, për më tepër, rruga e zhvillimit të këtyre kuptimeve mbart shenjat e ndikimit turk, edhe pse në njëfarë mënyre, zhvillimi është tërësisht specifik për shqipen*”<sup>13</sup>.

Friedman-i thekson se ndonëse është i të njëjtit mendim me Demirajn se ka dallime të dukshme mes habitores së turqishtes dhe habitores së shqipes, ai argumenton se këto dallime nuk përjashtojnë periudhën otomane dhe ndikimin turk për gjendjen e sotme. Për më tepër, koha dhe shpërndarja argumentojnë fuqimisht për një ndikim të tillë. Duke iu rikthyer tekstit më të vjetër të shqipes, “Mesharit” dhe shembujve të habitores të nxjerrë nga ky tekst prej Demirajt (1971), prof.Friedman-i vëren se asnjë nga përdorimet e habitores modale të Buzukut nuk korrespondon me habitoren në shqipen moderne dhe se përdorimi i Buzukut dallon në mënyrë thelbësore nga habitortja moderne për disa arsye. Së pari, asnjë prej këtyre shembujve nuk është në të tashmen ose në të kryerën e habitores, ndërkohë që në shqipen moderne, e tashmja është forma më e përhapur. Së dyti, rreth 90% të formave të përdorura nga Buzuku janë modale, por në shqipen moderne format modale të habitores janë jashtëzakonisht të rralla si në të shkruar dhe në të folur.

Friedman-i argumenton se në lidhje me zhvillimin e habitores së shqipes kemi të bëjmë me një kombinim të një ndryshimi gjuhësor të brendshëm dhe të një ndikimi nga kontaktet. Përdorimi i invertuar i mëse të kryerës duket të ketë qenë origjina nga lindi habitortja, dhe ky përdorim mund të ketë ndodhur para ndarjes së dialekteve, edhe pse Friedman-i mendon se për këtë nuk mund të jemi të sigurt. Friedman-i është i mendimit se përhapja e inversionit në të kryerën, dhe shndërrimi i së kryerës së invertuar në një të tashme të vërtetë, duket të ketë ndodhur në një zonë rreth lumit Shkumbin. Kjo risi nuk u përhap në toskërishten jugore, dhe nuk ka përfunduar as në kohën kur dialekte të toskërishtes veriore migruan në zonën e Trakisë dhe përgjatë Detit të Zi. Fakti që ndryshimi bazë ndodhi në Shqipërinë Qendrore, në zonën më me ndikim turk, si dhe “*dëshmia që del nga tekstet e vjetra, e kombinuar me zhvillime të ndryshme dialektale, mbështesin konceptin se habitortja e gjuhës shqipe është një zhvillim specifik i shqipes që u ndikua nga kontakti gjuhësor ballkanik*”<sup>14</sup>.

---

<sup>13</sup> Po aty. “...the semantic evidence in the oldest text actually favors the Ottoman period as the time when the Albanian admirative consolidated the meanings that we find in the standard language today, and, moreover, the path of the development is entirely specific to Albanian itself.”

<sup>14</sup> Friedman, Victor. The Age of the Albanian Admirative: A Problem in Historical Semantics. Ex *Anatolia Lux: Anatolian and Indo-European Studies in Honor of H. Craig Melchert*. ed. by Ronald Kim,

Në përfundim, në lidhje me studimet për habitoren e gjuhës shqipe mund të thuhet se Friedman-i ka trajtuar disa nga çështjet kryesore që karakterizojnë habitoren e shqipes, maqedonishtes dhe të turqishtes, duke theksuar faktin që bullgarishtja është pak a shumë si maqedonishtja nga kjo pikëpamje, dhe për qëllimin e studimit, maqedonishtja ka përfaqësuar edhe bullgarishten në këto studime. Ai arrin në përfundimin se termi *habitore* “*përmbledh dukuri të ndryshme, që kanë si tipare: shfaqjen e habitës, kuptimin kohor të së tashmes dhe lidhjen me perfektin*”<sup>15</sup>

Për Friedman-in<sup>16</sup> habitortja e shqipes në krahasim me maqedonishten dhe turqishten ka një të tashme të vërtetë, kurse përdorimi habitort i së kryerës së vjetër të maqedonishtes dhe turqishtes gjithnjë kanë të bëjnë me diçka të lidhur me të shkuarën. Friedman-i përmend katër argumente kryesore.

1. E tashmja e habitores së shqipes në më tepër se 90% të rasteve përkthehet me të tashmen normale të gjuhëve të tjera në përkthimet e teksteve nga maqedonishtja, bullgarishtja dhe turqishtja në shqipen, si dhe nga shqipja në këto gjuhë.

2. Në kontekste ku maqedonishtja dhe turqishtja përdorin një folje me domethënie habitore, edhe në gjuhën shqipe hasen kohët e tjera të habitores.

3. Përdorimi habitort i maqedonishtes dhe i turqishtes nuk lejohet në pyetje që kanë të bëjnë me një fakt vetëm në të tashmen pa lidhje me të shkuarën.

4. Habitortja e shqipes nuk përdoret vazhdimisht në tregime të lidhura, të gjata, kurse në turqisht dhe në maqedonisht një përdorimi i tillë është i lejuar.

Interesimi i prof.Friedman-it për sistemin foljor të shqipes është aq i madh sa vetë Friedman-i ka theksuar se “*angazhimi im shkencor për gjuhën shqipe ka të bëjë kryesisht me kategoritë e foljeve.*”<sup>17</sup>

Friedman-i ka trajtuar dhe format kohore të mëse të kryerës së mënyrës dëftore në vështrim krahasues mes shqipes dhe maqedonishtes. Në artikullin “Koha mëse e kryer në shqip dhe në maqedonisht”<sup>18</sup> të botuar në vitin 1981, Friedman-i i konsideron kategoritë gramatikore të mëse të kryerës në shqip dhe në maqedonisht si një “*mikrokozmos për sistemet dëftore të këtyre gjuhëve, prandaj një krahasim i mëse të kryerës në këto*

---

Norbert Oettinger, Elisabeth Riecken, and Michael Weiss. New York: Beech Stave Press. 2010. “...the evidence of the oldest texts combined with the various dialectal developments supports the notion that the Albanian admirative is a specifically Albanian development that was also influenced by Balkan linguistic contact..”

<sup>15</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, fq.121.

<sup>16</sup> Friedman, Victor. *Studies on Albanian and Other Balkan Languages*. Peja: Dukagjini, 2004.

<sup>17</sup> Friedman, Victor. Shqipja është një gjuhë unike shumë interesante. *Rilindja*, 25. VIII. 95, fq.9.

<sup>18</sup> Friedman, Victor. The Pluperfect in Albanian and Macedonian. *Folia Slavica*, Vol. 4, No. 2-3, 1981, fq.273-282.

*gjuhë nxjerr më në dukje ngjashmëritë dhe dallimet*<sup>19</sup>. Në këtë studim krahasues Friedman-i thekson se “*duke marrë parasysh se habitortja është indikativ (argumentet janë në artikull), shqipja dhe maqedonishtja kanë të njëjtën numër formash apo paradigmas, dhe kategoritë foljore janë të njëjta, por organizimi i kategorive është krejt tjetër në të dyja gjuhët*”<sup>20</sup>.

Ashtu sikurse nxjerr në pah dhe prof. Kolec Topalli “*për gjuhën shqipe janë me vlera analizat krahasuese të formës të mëse të kryerës në raport me të kryerën e tejsbkuar dhe me të kryerën e thjeshtë, nga të cilat Friedman-i ka nxjerrë përfundime me rëndësi për ngjashmërinë dhe sinoniminë, si dhe për dallimet e tyre*”<sup>21</sup>.

Me shumë interes në studimet krahasuese janë dhe studimet për dallimet aspektore mes shqipes, bullgarishtes dhe turqishtes. Në lidhje me këto dallime aspektore, në artikullin “Opozicione aspektore në bullgarisht, shqip e turqisht”, prof.Friedman-i ka arritur në përfundimin se e kryera e thjeshtë përdoret më shumë në gjuhën shqipe sesa në bullgarisht dhe në turqisht. Ndryshimet që vihen re në mënyrën e përdorimit të së pakryerës dhe të së kryerës së thjeshtë në këto gjuhë, Friedman-i i lidh me konceptet e kundërvënies *e pakryera/e kryera e thjeshtë* në të tria gjuhët, ku “*në gjuhën shqipe ka një sistem aspektual më të mpleksur në kundërvënien e tipit kisha punuar/pata punuar që nuk ekziston në dy gjuhët e tjera*”<sup>22</sup>.

Në përpjekjen e tij për të shpjeguar ngjashmëritë e sipërfaqshme mes gjuhëve ballkanike, prof.Friedman-i ka trajtuar dhe kohën e pakryer në shqip dhe në maqedonisht. Ndonëse në pamje të parë *e pakryera* është një strukturë e përbashkët mes të dyja gjuhëve, sepse në të dyja gjuhët përdoret për të treguar një veprim në proces në të shkuarën, prof. Friedman-i sjell shembuj ku “*e pakryera e shqipes emërton kohëzgjatje, njësoj si e pakryera e maqedonishtes, por nuk lejon konceptin e kufizimit të një periudhe kohe*”<sup>23</sup>.

---

<sup>19</sup> Friedman, Victor. The Pluperfect in Albanian and Macedonian. *Folia Slavica*, Vol. 4, No. 2-3, 1981, fq.278.

<sup>20</sup> Friedman, Victor. Studies on Albanian language, fq.117. “*The grammatical categories of the Macedonian and Albanian Pluperfects constitute a microcosm of these languages indicative systems, and thus a comparison of their pluperfects brings out the most salient points of similarity and difference*”.

<sup>21</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, fq.121.

<sup>22</sup> Friedman, Victor. Aspectual Oppositions in Bulgarian, Albanian, and Turkish. *Săpostavitelno ezikožnanie*, Vol. 17, No. 3, 1992, fq.33-38.

<sup>23</sup> Friedman, Victor. Pattern and Structure in Balkan Languages. Endeavors: Research and Graduate Education at the University of North Carolina, Chapel Hill Vol. 3, No. 2, 1986, fq.19. “*The Albanian imperfect denotes duration just as the Macedonian perfect does, but it does not allow for the concept of bounding a period of duration*”.

Në sistemin foljor, Friedman-in e ka tërhequr dhe mënyra lidhore në disa gjuhë të Ballkanit<sup>24</sup>. Në një artikull<sup>25</sup> për tipologjinë morfo-sintaksore të ndërtimeve të lidhore në shqip, arumanisht, rumanisht, bullgarisht, maqedonisht dhe greqisht, Friedman-it i ka tërhequr vëmendje fakti se në këto gjuhë lidhorida formohet nga “*një pjesëz me forma të ndryshme por me funksione të njëjta*.”<sup>26</sup>

Brenda sistemit foljor një studim krahasues mes gjuhëve të Ballkanit, është bërë nga prof. Friedman-i për urdhëroren treguese në gjuhët e Ballkanit. Friedman-i mendon se urdhërorja treguese paraqitet si një ballkanizëm deri tani i paidentifikuar dhe thekson se “*përdorimi i mënyrës urdhërore në tregim është karakteristik për gjubën shqipe si dhe për gjubët sllave. Megjithatë, përdorimi shqip dhe sllavoballkanike shkon së bashku dhe përdorimi në gjubët sllave joballkanike është tjetër*”<sup>27</sup>. Çështja që shtrohet prej tij është nëse kemi të bëjmë me një dukuri të shkaktuar nga kontakti. Ai mendon se edhe pse nuk ka të dhëna tekstore historike “*përhapja në gjubët romane, sllave dhe dialektet rome së bashku me përdorimet shqip dhe turqisht sugjeron se duhet të kemi të bëjmë me një dukuri areale që tani është më e gjallë pikërisht në qendër të zhvillimeve gjubësore ballkanike*”.

Me interes për studimet e prof. Friedman-it është dhe sistemi nominal i gjuhës shqipe, i cili ashtu sikurse thekson ai “*zë një vend qendror në gjubësinë ballkanike qysh nga fillimet e kësaj shkencë*”<sup>28</sup>. Për prof.Friedman-in “*ka shumë paraqitje nominale ballkanike të tjera ku gjuba shqipe zë një vend të veçantë, p.sh. përdorimi i numrit një si një nyjë joshquese, dëftimi dyfish i tipit ai njeriu, topikalizimi më një përemër në kallëzore apo dhanore (i ashtuquajtur 'reduplikimi'), dhe shumë elemente të tjera*.” Në mënyrë të veçantë prof.Friedman-i nxjerr në pah faktin se megjithë përpjekjet që po bëhen “*për të formalizuar një teori që kombinon tipologjinë me lingistikën areale dhe sipas së cilës tërë Europa është një lidhje gjubësore me një qendër në kufirin romano-gjerman nga Holanda deri në Italinë Veriore, dhe me Ballkanin në periferi (Haspelmath 1998, Heine & Kuteva 2006), megjithatë lingvistika areale është një fushë historike—dhe nga kjo pikëpamje Ballkani është qendër me vetveten, dhe gjuba shqipe merr një vend qendror atje*”<sup>29</sup>.

<sup>24</sup>Friedman, Victor. La typologie morpho-syntaxique des constructions en da-të-să-ná dans les langues balkaniques. *Cahiers Balkaniques*, Vol. 12. Paris: INALCO. 1988, fq.77-94.

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, fq.122.

<sup>27</sup> Shqipja në studimet ballkanike është e dorës së parë. [www.koha.net](http://www.koha.net).

<sup>28</sup>Friedman, Victor. Sistemi nominal i gjuhës shqipe nga pikëpamja ballkanistike. *Twenty-Ninth International Seminar for Albanian Language, Literature and Culture*. Prishtina: University of Prishtina. 2008, fq. 319-322.

<sup>29</sup> Po aty. Fq.321.

Prof. Friedman-i vë në dukje rolin që ka gjuha shqipe në analizën e shumë dukurive gjuhësore ballkanike, duke theksuar se ndërsa mbetet ende shumë punë për t'u bërë në këtë fushë “*kufiri shqiptaro-sllav paraqet shumë interes*”<sup>30</sup>.

Në studimet për gjuhën shqipe, për të përcaktuar vendin qendror dhe shumë të rëndësishëm që zë shqipja në lidhjen gjuhësore ballkanike, të një rëndësie të madhe janë për prof.Friedman-in hulumtimet dhe analizat e dialekteve të gjuhës shqipe. Ai ka dalluar si karakteristika panshqiptare: *ruajtjen e mënyrës dëshirore, mbetjet e rrjedbores dhe në dialekte dhe të lokativit dhe shprehjen komplekse të përemrave pronore të shqipes*.<sup>31</sup>

Përveç dallimeve mes gegërishtes dhe toskërishtes, në disa plane, si “theksimin e fjalëve, në sistemin zanor e bashkëtingëllor, si dhe në planin morfologjik, në dy kategoritë më të rëndësishme leksiko-gramatikore, emrit e foljes”<sup>32</sup>, prof.Friedman-i është përpjekur që të shohë më nga afër detaje të dialekteve shqiptare, veçanërisht të dialekteve në kontakt me gjuhë të tjera ballkanike. Ai vë re se se një numër karakteristikash të përgjithshme të toskërishtes ose të gegërishtes tregojnë ose se janë një risi e vonshme nga qendra në periferi, nga kontakti në periferi ose nga zhvillimet e pavarura rajonale, ndër të cilat ai ka analizuar: humbjen e gjatësisë, e cila ruhet si në gegërisht dhe në toskërishten jugore; shurdhimin e bashkëtingëlloreve, tipik për toskërishten veriore dhe i pranishëm dhe në gegërishten veriperëndimore dhe qendrore apo dhe praninë e zanores *ë* në gegërishten qendrore si rezultat i procesve të mëvonshme të diftongizimit<sup>33</sup>.

Nga analiza konkrete e dialekteve të shqipes në kontakt me gjuhët sllave, prof. Friedman-i argumenton se “*konvergencat e vjetra ballkanike janë më karakteristike për toskërishten, ndërsa konvergencat e mëvonshme viben re në gegërisht, të paktën pjesërisht si rezultat i proceseve historike, social-politike*”. Studimet e tij për dialektet e gjuhës shqipe, si dhe për dukuritë e tjera gjuhësore, prof. Friedman-i i ka realizuar nga rezultatet e punës konkrete shumëvjeçare në terren, pasi për të “*folësi amtar është subjekti bazë i kërkimit gjuhësor*”<sup>34</sup>.

---

<sup>30</sup> Po aty. Fq.322.

<sup>31</sup> Friedman, Victor. Albanian in the Balkan Linguistic League: A Reconsideration of Theoretical Implications. *Studia Albanica* Vol. 28, No.1. 2005, fq.33-44.

<sup>32</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, fq.122.

<sup>33</sup> Friedman, Victor. Albanian in the Balkan Linguistic League: A Reconsideration of Theoretical Implications. *Studia Albanica* Vol. 28, No. 1. 2005, fq.33.

<sup>34</sup> Pinner. Diantha. Pattern and Structure in Balkan Languages. *Endeavors: Research and Graduate Education at the University of North Carolina, Chapel Hill* Vol. 3, No. 2, 1986, fq.19. “*The native speaker is the essential subject of language research*”.

Në një botim të vitit 2000<sup>35</sup>, prof.Friedman-i propozon një zgjerim të mekanizmave teorikë për studimin e dukurive në kontakt në Ballkan, ku të përfshihen elemente të tilla si: një dallim i kujdesshëm mes roleve strukturore dhe sociale të dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë; analiza e diskursit dhe pragmatika; aplikimi i teorisë për çështjen e divergjencës krahasuar me konvergjencën, teoritë e ideologjisë së gjuhës, zhvillimi i gjuhëve standarde, dallimet e regjistrit, dhe praktikatat gjuhësore kombëtare krahasuar me ato lokale.

Në kuadër të zgjerimit të fushës së studimeve krahasuese mes gjuhëve të Ballkanit, në një botim për situatën e ballkanizmave sot, Friedman-i analizon lidhëzat, për të cilat ai shprehet se ashtu si dhe pjesëzat e diskursit janë “*subjekt i marrjes hua mes gjuhëve, dhe për më tepër ka një hierarki në mundësinë e huazimit, sipas së cilës lidhëzat kundërshtore si ‘por’ janë kandidatë më të mundshme sesa lidhëzat veçuese ‘ose’, të cilat nga ana tjetër kanë më shumë mundësi të huazohen sesa lidhëza të tilla kombinatorë si ‘dhe’*”<sup>36</sup>.

Përmes këtij studimi, prof.Friedman-i synon të tregojë se krijimi i kalkeve për lidhëzat është i mundshëm dhe vazhdon të ekzistojë në lidhjen gjuhësore ballkanike edhe pse ka kaluar më shumë se një shekull nga vendosja e kufijve mes shteteve. Duke analizuar gjuhët e Ballkanit, në mënyrë specifike shqipen dhe maqedonishten, prof.Friedman-i vëren se kemi të bëjmë me një rast interesant dhe të rrallë të një kalku gjuhësor dhe jo të huazimit të lidhëzave. Ky është rasti specifik ku në shqipen e Maqedonisë, kombinimi i kufizimit të dëshirores së shqipes vetëm tek urimet, i kombinuar me ngjashmërinë e përdorimit të dëshirores së maqedonishtes së formës –/ me përdorimin e saj jokonfirmues, veçanërisht me foljen *jam* ka rezultuar në zëvendësimin kalk të *qoftë* me *qenka* në kuptimin “*nëse, ...ose*”, e cila në maqedonisht zëvendësohet nga *bilo*. Prof.Friedman-i mendon se përdorimi i shqipes në këtë rast është një kalk dhe jo një huazim, dhe kjo thekson bilinguizmin e gjatë mes komuniteteve shqipfolëse dhe maqedonase, që ka çuar në *Sprachbund*-in ballkanik. Ai shkron më tej duke theksuar se është pikërisht kalku i shqipes që “*iluminon kompleksitetin e strukturës në maqedonisht*”<sup>37</sup>.

<sup>35</sup> Friedman, Victor. Albanian in the Balkan Linguistic League: A Reconsideration of Theoretical Implications. *Studia Albanica* Vol. 28, Nr. 1. 2005, fq.36. “*It can be argued that old Balkan convergences are more characteristic of Toskë, while later convergences are to be seen in Geg, at least in part as a result of differing socio-political historical processes*”.

<sup>36</sup> Friedman, Victor. Conjunction Calquing — A Heartland Balkanism. *Balkanismen heute — Balkanisms Today — Balkanizmy segodnja*, ed. by T. Kahl, M. Metzelin & H. Schaller, 31-37. Vienna: Lit Verlag, 2012. “*...are subject to borrowing among languages, and, moreover, there is a hierarchy in the likelihood of borrowing according to which disjunctives such as ‘but’ are more likely to be borrowed than combinatory conjunctions such as ‘and’*”.

<sup>37</sup> Po aty. “*It is the Albanian calque that illuminates the grammatical complexity of the Macedonian structure*”.

Ndikimin e gjuhës shqipe dhe rolin qendror të saj, prof.Friedman-i e shikon dhe në termat e sllavishtes<sup>38</sup>, Kështu, prof.Friedman-i vëren se në gjuhën shqipe fjala *fis* mund të përdoret për njësi njerëzore, dhe dallon nga *vllazni* e krijuar nga gegërishtja *vlla*. Ai mendon se etimologjia e fjalës sllave “*bratsvo*”, ekuivalente me fjalën shqipe “*vllazni*”, e ka burimin nga termi i përdorur në Zavala në Mal të Zi, ku fjala sllave “*rod*” përdoret vetëm për familjen e nuses. Duke u nisur nga fakti se ky përdorim ndodh pikërisht në Mal të Zi, kjo vjen si ndikim semantik i gjuhës shqipe.

Profesor Friedman-i ka dhënë kontributin e tij në studimin e historisë së shqipes dhe të Ballkanit si pjesë e Perandorisë Otomane, e deri në procesin e standardizimit dhe të konflikteve gjuhësore që kanë goditur thellësisht gadishullin e Ballkanit, me synimin për të kuptuar rolin bazë të gjuhës në krijimin e identitetit kombëtar. Një nga studimet krahasuese që ai bën, është në lidhje me rolin e nacionalizmit dhe të gjuhësisë në formimin e gjuhëve letrare të gadishullit të Ballkanit. Duke analizuar procesin e standardizimit të gjuhës shqipe, prof.Friedman-i thekson faktin se “*nën Mbretin Zog (1925-1939), u bënë përpjekje për të bazuar një gjuhë standarde mbi dialektin geg jugor të Elbasanit, por standardizimi serioz nuk arriti progres deri në pas Luftës së Dytë Botërore*”.<sup>39</sup>

Ai e konsideron gjuhën shqipe si imazhin pasqyrë të serbishtes, bosnjishtes dhe kroatishtes ku “*feja in nënvendos gjuhës në ndërtimin e identitetit dhe dallimet signifikante mes dialekteve geg (Veri) dhe tosk (Jug) nuk u trajtuan deri në periudhën e komunizmit kur në Shqipëri u krijua një standard i bazuar te toskërishtja, dhe më pas u adaptua nga shqiptarët në Jugosllavi*”.<sup>40</sup>

Profesor Friedman-i ka studiuar dhe çështje që kanë të bëjnë me kontaktet gjuhësore mes shqipes dhe gjuhëve të tjera gjatë periudhave të ndryshme historike. Ndër artikujt që i përkasin kontaktit gjuhësor të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, duhen përmendur artikujt për konceptet nacionale në fjalorin trigjuhësh të Gjorgji Pulevskit dhe të fjalorit shqip të murgut Arkadii në një dorëshkrim të gjysmës së dytë të shekullit

---

<sup>38</sup> Friedman, Victor. *Balkanisms of Color: Black, and White and Red All Over. Balkanskij spekt: Ot sveta k cvetu*, ed. M.M.Makarcev, I.A.Sedakova, T.V.Civ’jan, fq.63-66. Moskë: Institut Slavjanovedenija, Akademia Ruse e Shkencave. 2011, fq.63-66.

<sup>39</sup> Friedman, Victor. *National Language and Linguistic Nationalism in the Balkans. Språkforholdene på Balkan og i Øst-Europa*. Universitetet i Bergen Institutt for fonetik og lingvistik: Skriftserie Nr. 32, Serie A, 1988, fq.10. “*Under King Zog (1925-1939), efforts were made to base a literary standard on the southern Geg dialect of Elbasan, but serious standardization did not progress until after World War II*”.

<sup>40</sup> Victor A. Friedman. *The Balkan Languages and Balkan Linguistics. Annual Review of Anthropology*, Vol. 40. 2011, fq.275-291. “*Albanian is a mirror image of BCS: Religion was subordinated to language in constructing identity and the significant dialectal differences between Geg (north) and Tosk (south) were not addressed in practice until the communist period, when a Tosk-based standard was promulgated in Albania then adopted by Albanians in Yugoslavia*.”

XIX, nga një manastir në Hilendar në Malin Athos. Prof.Friedman-i mendon se fjalori maqedonisht-shqip-turqisht i Pulevskit “*ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për zhvillimin e kombit maqedonas dhe të gjuhës maqedone, por edhe për kombet shqiptar dhe turk në Maqedoni*”<sup>41</sup>. Prof.Friedman-i vlerëson mendimin modern të Pulevskit në përcaktimin e kombësive në Maqedoni, i cili “*mund të ketë rëndësi për shqiptarët dhe për të gjithë në Maqedoni*”<sup>42</sup>. Përsa i përket fjalorit të Arkádii-së, rëndësia e tij qëndron në faktin se kemi të bëjmë me një dokument të çmuar të dialekteve të diasporës që fliteshin në Traki dhe Moesi, dhe që më vonë do të përdoshin dhe në Besarabi, Ukrainë dhe Maqedoni.<sup>43</sup> Duke e konsideruar një dokument shumë të vlefshëm këtë fjalor, prof. Friedman-i është përpjekur të përcaktojë origjinën e dialektit të tij.

Një nga sugjerimet që ai bën duke u bazuar në këtë dokument është fakti së nën ndikimin e gjuhëve sllave dhe të turqishtes në shqipen e folur në diasporën lindore vihet re se zhvendosja e rendit të fjalëve në fjali ka filluar me “*ndërtimet mbiemërore dhe më vonë të ndërtimet e gjinore, duke pasur parasysh se në Ukrainë dhe në Mandricë dokumentohen të dyja zhvendosjet, por në fjalorin e Arkádii-së dokumentohet vetëm zhvendosja e parë dhe jo e dyta*”<sup>44</sup>. Në përpjekjen për të përcaktuar saktësisht dialektin e përdorur në këtë dokument, prof.Friedman-i vëren se “*trajtimi i përemrave pronorë argumenton se dialekti i Arkádii-së zë një vend të ndërmjetëm mes Mandricës dhe Devnjës, por zhvillimi i paraqitur nga njësi leksikore si dëborë, kerie, dhe spijurti sugjeron se origjina e tij mund jetë më afër Korçës*”<sup>45</sup>.

Friedman-i<sup>46</sup> mendon se në kontekstin e vet ballkanik, edhe trajta e shkurtër na tregon një sërë gjërash për gjuhët në kontakt, duke na dhënë një ilustrim të qartë të mënyrës sesi një dukuri pragmatike bëhet sintaksore dhe në fund gramatizohet

<sup>41</sup> Friedman, Victor. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vëpra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, fq.118.

<sup>42</sup> Po aty. Fq.120.

<sup>43</sup> Miceli, Anna Maria Totaro. 2000. "La Linguistica Albanese secondo Victor Friedman." Tezë Masteri. Universiteti i Palermos.

<sup>44</sup> Friedman Victor. Slavic-Albanian Contacts and Early Polyglot Lexicons. "La langue albanaise dans le contexte balkanique principalement sous le point de vue des contacts albano-slaves": Konferencë e sponsorizuar nga Akademia Polake e Shkencave. Varshavë, shtator 1989. “*...in head-adjective constructions and moved from there to head-genitive constructions, given the fact that the Ukraine and Mandrica display both shifts but Arkádii has only the former and unshifted examples of the latter.*”

<sup>45</sup> Friedman Victor. Slavic-Albanian Contacts and Early Polyglot Lexicons. "La langue albanaise dans le contexte balkanique principalement sous le point de vue des contacts albano-slaves": Conference sponsored by the Polish Academy of Sciences. Warsaw, September 1989. “*Arkádii's dialect occupies an intermediate position between Mandrica and Devnja, but the development represented by lexical items such as dëborë, kerie, and spijurti suggest that its origin may be closer to Korçë than others.*”

<sup>46</sup> Friedman, Victor. Balkan Object Reduplication in Areal and Dialectological Perspective. *Clitic Doubling in the Balkan Languages*, ed. nga D. Kallulli&L. Tasmowski. Amsterdam: Benjamins. 2008, fq.25-63.



pothuajse në pikën e morfologjizimit. Shpërndarja e përdorimit të trajtës së shkurtër dhe shkalla e integritit të saj në sisteme të ndryshme gjuhësore ballkanike, reflekton në fakt faza të ndryshme diakronike si dhe sisteme të ndryshme sinkronike. Në të njëjtën kohë, kjo shpërndarje gjeografike është dëshmi e mënyrës në të cilën ndryshimet gramatikore mund të kuptohen nga mekanizma pragmatikë: objekti i dyfishtë përdoret në mënyrë më të gramatikalizuar në Ballkanin Perëndimor, dhe variacionet e gjetura në gjuhët sllave të Ballkanit, gjuhët romane të Ballkanit dhe në shqip, tregojnë faktin që kemi të bëjmë me një karakteristikë areale.

Sikurse mund të shihet nga studimet në fusha të ndryshme, materialet e përzgjedhura nga puna e kujdesshme në terren, prej njohjes së shkëlqyer e disa gjuhëve ballkanike, vepra e prof.Friedman-it të mund të konsiderohet si një kontribut me shumë vlerë dhe krejtësisht i veçantë në studimet albanologjike. Një nga kontributet kryesore të prof.Friedman-i është dokumentimi dhe analiza e detajuar e tipareve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike, të cilat nuk kanë qenë të njohura sa duhet. *“Me këto hulumtime ka dalë në dritë dhe roli i gjuhës shqipe në krijimin e lidhjeve të përbashkëta ndërmjet gjuhëve të ndryshme të Gadishullit Ballkanik, lidhje të cilat në mjaft raste i shtrinë dhe përtej këtij areali, si krijime me tipologji të njëjtë.”*<sup>47</sup>

---

<sup>47</sup> Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, fq.122.

## Bibliografia

1. Friedman, Victor. *The Grammatical Categories of the Macedonian Indicative*. Columbus. Slavica. 1977.
2. Friedman, Victor. The Study of Balkan Admirativity: Its History and Development. *Balkanistica*, Vol. 6, 1980, fq.7-30.
3. Friedman, Victor. Admirativity and Confirmativity. *Zeitschrift für Balkanologie*, Vol. 17, Nr.1, 1981, fq.12-28.
4. Friedman, Victor. The Pluperfect in Albanian and Macedonian. *Folia Slavica*, Vol. 4, Nr. 2-3, 1981, fq. 273-282.
5. Friedman, Victor. Admirativity in Bulgarian Compared with Albanian and Turkish. *Bulgaria Past and Present*, ed. D. Kosev, Vol. 2. Sofia: Bulgarian Academy of Sciences. 1982, fq.63-67.
6. Friedman, Victor. Shqipja është një gjuhë unike shumë interesante. Rilindja, 25. VIII. 95, fq.9.
7. Friedman, Victor. Pattern and Structure in Balkan Languages. Endeavors: Research and Graduate Education at the University of North Carolina, Chapel Hill Vol. 3, Nr. 2, 1986, fq.19.
8. Friedman, Victor. La typologie morpho-syntaxique des constructions en datë-sà-nà dans les langues balkaniques. *Cahiers Balkaniques*, Vol.12. Paris: INALCO, 1988, fq.77-94.
9. Friedman, Victor. National Language and Linguistic Nationalism in the Balkans. *Språkeforholdene på Balkan og i Øst-Europa*. Universitetet i Bergen Institutt for fonetik og lingvistik: Skriftserie Nr. 32, Serie A, 1988, fq.10.
10. Friedman, Victor. Aspectual Oppositions in Bulgarian, Albanian, and Turkish. *Såpostavitelno ezikoznanie*, Vol. 17, No. 3, 1992, fq.33-38.
11. Friedman, Victor. Vendi i gegnishtes në gjuhën shqipe dhe në Ballkan [Albanian: The position of Gheg in Albanian and in the Balkans]. *Phoenix* (Shkodër) Vol 7, Nr. 1-6, 2003, fq.40-56.
12. Friedman, Victor. Shqipja standarde në Amerikë: Studime shkencore, pedagogjike, dhe planifikimi gjuhësor. Konferencë Shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot [Albanian: Standard Albanian in America: Scholarly Studies, Pedagogy, and Language Planning]. *Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot* (Scholarly Conference: Standard Albanian and Albanian Society Today), ed. J. Bulo, E. Lafe, S. Mansaku, E. Hysni. Tirana: Albanian Academy of Sciences. 2003, fq.155-157

13. Friedman, Victor. *Studies on Albanian and Other Balkan Languages*. Peja: Dukagjini, 2004.
14. Friedman, Victor. Albanian in the Balkan Linguistic League: A Reconsideration of Theoretical Implications. *Studia Albanica* Vol. 28, Nr.1. 2005, fq.33-44.
15. Friedman, Victor. Balkanizing the Balkan Sprachbund: A Closer Look at Grammatical Permeability and Feature Distribution. *Grammars in Contact: A Cross Linguistic Typology*, ed. by A. Aikhenvald and R.F.W. Dixon. Oxford: Oxford University Press. 2007, fq.201-219.
16. Friedman, Victor. Balkan Object Reduplication in Areal and Dialectological Perspective. *Clitic Doubling in the Balkan Languages*, ed. by D. Kallulli and L. Tasmowski. Amsterdam: Benjamins. 2008. 25-63.
17. Friedman, Victor. Sistemi nominal i gjuhës shqipe nga pikëpamja ballkanistike. *Twenty-Ninth International Seminar for Albanian Language, Literature and Culture*. Prishtina: University of Prishtina. 2008, fq. 319-322.
18. Friedman, Victor. Determination and Doubling in Balkan Borderlands, *Harvard Ukrainian Studies*, Vol 28, 2009, fq.117-130.
19. Friedman, Victor. Lability as a Scalar Balkanism. *Glagolnata sistema na Balkanskite ezysi — nasledstvo i neologija* [Macedonian: The Verbal System of The Balkan Languages — Heritage and Neology]. Sbornik dokladi ot Međunarodna naučna konferencija "VTU Sv. Kiril i Metodij", 2009, fq.63-69.
20. Friedman, Victor. The Age of the Albanian Admirative: A Problem in Historical Semantics. *Ex Anatolia Lux: Anatolian and Indo-European Studies in Honor of H. Craig Melchert*. ed. by Ronald Kim, Norbert Oettinger, Elisabeth Riecken, and Michael Weiss. New York: Beech Stave Press. 2010.
21. Friedman, Victor. Admirativity and Modality in Albanian-Macedonian Language Contact.. *Wir sind die Deinen Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, ed. by Bardhyl Demiraj. Wiesbaden: Harrassowitz. 2010, fq. 277-281.
22. Friedman, Victor. Balkanisms of Color: Black, and White and Red All Over. *Balkanskij spekt: Ot sveta k cvetu*, ed. M.M.Makarcev, I.A.Sedakova, T.V.Civ'jan, fq.63-66. Moscow: Institut Slavjanovedenija, Russian Academy of Sciences. 2011, fq. 63-66.
23. Victor A. Friedman. The Balkan Languages and Balkan Linguistics. *Annual Review of Anthropology*, Vol. 40. 2011, fq.275-291.

24. Friedman, Victor. Conjunction Calquing — A Heartland Balkanism. *Balkanismen heute — Balkanisms Today — Balkanizmy segodnja*, ed. by T. Kahl, M. Metzelin & H. Schaller. Vienna: Lit Verlag. 2012, fq.31-37.
25. Friedman Victor. Slavic-Albanian Contacts and Early Polyglot Lexicons. "La langue albanaise dans le contexte balkanique principalement sous le point de vue des contacts albano-slaves": Konferencë e sponsorizuar nga Akademia Polake e Shkencave, shtator 1989.
26. Ismajli, Rexhep. Studimet albanistike të Prof. Eric P.Hampit. [www.kosova.com](http://www.kosova.com).
27. Miceli, Anna Maria Totaro. 2000. "La Linguistica Albanese secondo Victor Friedman." Tezë Masteri, Universiteti i Palermos.
28. Pinner. Diantha. Pattern and Structure in Balkan Languages. *Endeavors: Research and Graduate Education at the University of North Carolina*, Chapel Hill Vol. 3, No. 2, 1986, fq.19.
29. Topalli, Kolec. Studies on Albanian and other Balkan Languages. *Vepra themelore në Albanologji*. Tiranë, 2009, f.121.
30. Shqipja në studimet ballkanike është e dorës së parë. [www.koha.net](http://www.koha.net).

Mensur VOKRRI

## VICTOR FRIEDMAN PËR HABITOREN E SHQIPES

### *Abstrakt*

Mënyra habitore e gjuhës shqipe është një nga mënyrat më të veçanta e karakteristike jo vetëm në këtë gjuhë, por edhe në një kuadër gjuhësh të ndryshme të botës, si nga ndërtimi formal ashtu edhe nga ana kuptimore. Kjo mënyrë hyn në mesin e formave të shtjelluara të foljes, e cila si kategori gramatikore shënon habinë e kryerjes së një veprimi përmes foljes nga ana e një subjekti folës. Habitoretja e shqipes ka katër kohë (të tashmen, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën), me anën e së cilave e bën edhe nuancimin kohor të kryerjes së veprimit në kohët e përmendura më lart.

Ky punim ka për objekt studimi ndihmesën e gjuhëtarit amerikan Viktor Friedman për mënyrën habitore të gjuhës shqipe, duke u mbështetur në artikujt studimorë të tij të bërë për këtë mënyrë, të publikuar në vëllimet studimore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare-Prishtinë & Tiranë, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Qendrës së Studimeve Albanologjike etj. Në kuadër të interesimeve shkencore e studimore të V. Friedman-it për gjuhën shqipe, pra për strukturën e saj, më shumë në aspektin morfologjik, vend të veçantë studimi, analize e krahasimi zë kategoria gramatikore e mënyrës habitore.

Punimi i pranishëm mëton të shohë e të paraqesë, të shqyrtojë dhe të përmbledhë kontributin e gjuhëtarit amerikan V. Friedman për habitoren e shqipes, i cili studiuës i përket një gjenerate më të re, asaj të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Realizmi i këtij punimi do të bëhet përmes metodës së përshkrimit, të analizës e të krahasimit dhe të sintezës, të cilat do të na e mundësojnë vështrimin dhe paraqitjen e plotë të kontributit të V. Friedman-it për mënyrën habitore të shqipes.

Vlera dhe rëndësia e studimeve për shqipen përgjithësisht e për habitoren e shqipes veçanërisht e nxjerrin Friedman-in studiuës serioz shkencor, me rezultate për albanistikën dhe shkencëtar të pakontestueshëm.

***Fjalët çelës:*** mënyrë, habitore, e shqipes, kohë, e tashme, e pakryer, e kryer, më se e kryer, folje, ndihmëse, ka, pjesore, e përmbysur etj.

## Victor A. Friedman për habitoren e shqipes

Mënyra habitore e gjuhës shqipe është bërë objekt studimi nga shumë studiues shqiptarë e të huaj. Mirëpo, punimi ynë ka për qëllim ta pasqyrojë kontributin e gjuhëtarit të shquar amerikan Victor Friedman për habitoren e shqipes, të parë në lidhje e ndikim edhe me gjuhët e tjera, si: maqedonisht bullgarisht, rumanisht e tuqisht.

Friedman-i, duke iu referuar Wilfried Fiedler-it (1968: 131), tregon se në arumanishte ndeshen forma të mënrës habitore apo përdorime foljore të ngjashme (gjermanisht Admirativ-Kommentativsystem), gjë që ngjet në disa gjuhë ballkanike të tjera, si: shqip, maqedonisht dhe bullgarisht. Po ashtu, sipas tij, tek Atanasov (1920: 220) lexojmë se në gjuhën megleno-rumune kemi një të kryer të përmbysur (perfekt të përmbysur) me foljen ndihmëse prapa pjesores dhe me kuptime të ngjashme me të mënyrës habitore të shqipes, apo me të përdorimeve jovepruese (habi, dyshim, ritregim) të maqedonshtes dhe të bullgarishtes, siç shihet në shembullin e parë:

(1)    ă bră, tu fost-ăi mări om!

          a be, ti si bil golem čovek!

          ‘mais je viens d’apprendre que tu es une personne importante!’ (Atanasov 1990:221)

          ore, ti qenke njeri i madh!<sup>1</sup>

Këtu fjala **fost** është pjesore dhe **ai** është folje ndihmëse. E kryera normale megleno-rumune do të ishte **ai fost**. Paralelja morfologjike me gjuhën shqipe bie në sy, por, megjihatë, është krejtësisht e mundshme që të kemi të bëjmë me një tendencë tipologjike dhe jo me kontakt midis shqipes dhe megleno-rumanishtes. Edhe pse dimë se në shekujt e kaluar shqiptarët kanë mërguar nëpër Meglen në rrugën e tyre për në vende të tjera, nuk kemi evidencë më të saktë. Prandaj, nuk mund të themi më shumë për prejardhjen e së kryeës së përmbysur në megleno-rumanishten.<sup>2</sup>

Sidoqoftë, deri tani arumanishtja është dukur si një ishull gjuhësor (më saktë si një arqipelag) në Ballkanin Qendror, në të cilin jovërtetimi nuk shprehet me kategori fojore (shih. Goab 1984). Përveç arumanishtes, gjuhët në këtë zonë (shqip, maqedonisht, bullgarisht dhe megleno-rumanisht) e kanë këtë kategori, e cila përmes

<sup>1</sup> Victor A. Friedman, *Ndikimi i të shqipes në të folmet arumne të Maqedonisë Jugperëndimore: Mënyra habitore*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, vol. 1, Prishtinë, 1994, f. 195 dhe Victor A. Friedman, *Mënyra habitore në gjuhën arumune dhe në gjuhën shqipe – Paralele dhe ndikime*, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universiteti i Prishinës Fakulteti i Filologjisë, EuroRilindja, 1995, Tiranë, f. 221

<sup>2</sup>Po aty, f. 195-196; f. 222

turqihites, i lidh me zonën linguistike më të gjerë të Euroazië, që karakterizohet me shfaqjen e kundërvënieve të tilla të “statusit” (shih. Friedman, 1979, 1988). Ndër gjetjet e Friedman-it për habitoren e shqipes e të folmen arumune, kur ishte në Ohër (Republika e Maqedonisë) më 1992, ishte ndeshja e formës foljore jovërtetuese në arumanishte të Belicës, e cila funksionon si habitoria e shqipes dhe disa përdorime të formës foljore me **-I** të maqedonishtes, siç shihet në shembullin e dytë:

(2) Mi P’oi di minti: “A be tora tini fuskă avut om”!

Se šašardisav: “A be sega ti si bil bogat čovek”!

U habita: “Ore, tani qenke njeri pasur”!<sup>3</sup>

Kur kemi parasysh faktin se deri në kohë të vona banorët e Belicës dinin shqip dhe se së paku një pjesë e tyre kishte ardhur më përpara nga Shqipëria, sipas Friedman-it, duket se, kjo habitore arumune u formua përmes një analizimi abduktiv të habitores së shqipes. Siç dihet, në gjuhën shqipe habitoria është formuar prej një perfekti të përmbysur të tipit pjesore+folje ndihmëse, për shembull: **ai ka qenë – ai qenka**. Në këtë të folme të arumanistes duket se morfema **-ka**, që në shqipe shënon vetën e tretë të habitores, do të jetë kuptuar si shenjë e habitores në përgjithësi dhe do të jetë lidhur me pjesoren arumune kështu: **\*fusta+ka – fuska**, që përdoret për çdo vetë dhe me shumë folje. (Ndryshimi i tingullit /a/ në /a/ mund të ketë dalë nga ndikimi i pjesores, po mund të jetë edhe tipar dialektor).<sup>4</sup>

Duke shqyrtuar çështjen e habitores, Friedman-i më tutje thoshte se kjo dukuri ka kuptime më të gjera. Një çështje qendrore në diskutimet mbi prejardhjen e kategorive të jovërtetimit në gjuhët e Ballkanit është pyetja a ishin këto kategori kalke të drejtpërdrejta nga turqishtja, domethënë nga perfeki me sufiksën **-mis**, apo ishin trajta autoktone, të cilave ndoshta turqishtja u kishte dhënë shtysë të zhvilloheshin më tej. Demiraj (1971) ka shkruar për moshën e habitores së shqipes, ndërsa autori ynë (1978) ka paraqitur evidenca për një fillim autokton edhe në gjuhët ballkano-sllave. Ky diskutim ka lidhje me pyetjen më të gjerë rreth tendencës që perfektat të zhvillohen në trajtat që janë të markuara për “statusin”. Megjithëse për dukurinë e habitores së arumanishtes nevojitet një gjurmim më i thellë e më i hollë, Friedman-i shpjegon se, megjithatë, dëshmia që dhamë këtu është më tepër se një shembull interesant i një morfeme gramatikore që ishte huazuar (**-ka** shqipe në arumanishte), i një kalku ballkanik (përdormi i pjesores si bazë), si dhe kundërpërgjigje për mendimin se në arumanishte

<sup>3</sup> Victor A. Friedman, *Ndikimi i shqipes në të folmet arumune të Maqedonisë Jugperëndimore: Mënyra habitore*, f. 195-196; V. Friedman, *Mënyra habitore në arumanishte e shqipe – Paralele e ndikime*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 222

<sup>4</sup> Po aty, f. 196; f. 222-223 dhe Victor A. Friedman, *Studies on Albanian and other Balkan languages*, Vepra themelore në Albanologji, *Aktet e Konferencës shkencore ndërkombëtare 18-20 dhjetor 2008*, Qendra e Studimeve Albanologjike, *Botimet Albanologjike*, Tiranë, 2008, f. 117

mënyra habitore nuk ekziston. Kemi këtu një dëshmi krejtësisht të padyshimtë se, në të cilën kategoria e “statusit”, domethënë kategoria jovërtetuese e habitores është huazuar dhe është huazuar nga gjuha shqipe.<sup>5</sup>

Zhvillimi i kategorive foljore që lidhen me marrëdhënien e folësit me informacionin në mesazh d.m.th. format foljore si habitorja e shqipes, minalo preizkazvano e bullgarishtes dhe prekazuvanjeto e maqedonishtes, mazii nakli i turqishtes, të cilat Friedman-i i ka përshkruar si opozicioni gramatikor vërtetues/jovërtetues, sipas tij, kurrë nuk ishin marrë parasysh në katalogun e ballkanizmave klasike. Arsye e rëndësishme për këtë, vazhdon ai, ishte fakti që fenomeni i tillë nuk është i njohur as në greqisht, as në rumanisht, e duke i shtuar kësaj edhe të dhënë tjetër se, në krahasim me fenomenet që duken qartë, si për shembull nyja e caktuar (shquese), morfologjia e së ardhmes, si dhe numërorët, kjo kategori foljore është më subtile dhe më e vështirë për ta përcaktuar. Dëshmi për këtë, Friedman-i sjell faktet se në fillimin e traditës moderne gramatikore shqipe dhe bullgare këto forma dhe kuptime mungojnë, duke u mbështetur në autorë si Parvev, Ismajli, Kastrati etj., porse, shtonte më tej ai, tani ka literaturë sekondare mjaft të madhe rreth këtij problemi. Sipas Friedman-it, habitorja e shqipes dhe dukuri të ngjashme të sllavishtes janë karakteristike më tepër të gjuhës së folur dhe më të rralla në gjuhën e shkruar, veçanërisht në stilet formale dhe tregimtare.<sup>6</sup>

Vështirësi që lidhen me përshkrimin dhe bile me identifikimin e trajtave që shënojnë jovërtetimin (jokonfirmimin) shihen edhe nga fakti që vetëm kohët e fundit bëhet e njohur ekzistenca e trajtave të tilla të veçanta në romanishten ballkanike (d.m.th. romanitetin ballkanik) jugor, më saktë me megleno-rumanishten dhe në një dialekt arumun. Megjithëse ende në tekstet megleno-rumune të Capidanit (1925), shpjegonte Friedman-i, ndodhet trajta e së kryerës së anasjelltë (d.m.th. me foljen ndihmëse prapa pjesores), që janë shënuar edhe nga Caragiu-Marioteau (1975). Vetëm në vitin 1984 Atanasov shënoi se këto trajta kanë kuptimet jovërtetuese të ngjashme me përdorimet e perfektit të vjetër të maqedonishtes dhe, sipas Friedman-it, me habitoren e shqipes. Pikërisht në këtë seminar, por në atë numër 17, në referimin “Mënyra habitore në gjuhën arumune dhe në gjuhën shqipe-paralele dhe ndikime, Friedman-i solli të dhëna të reja mbi një përdorim të morfemës –ka, huazuar nga veta e tretë njëjës e habitores së shqipes, si një pjesëz me vlerën e habitores në të folmen e arumunëve “Fërshëloci” të

<sup>5</sup> Po aty, f. 196; f. 224

<sup>6</sup> Victor A. Friedman, *Haborja e shqipes dhe “Prezuntivul” e rumanishtes*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Akademia e Shkencave, Institui i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, *Toena*, Tiranë, 1996, f. 581



fshatit Belicë e Sipërme, fenomen të cilin Friedman-i e kishte zbuluar me ndihmën e Mr. Marjan Markovik nga Uniersiteti i Shkupit vetëm më 1992.<sup>7</sup>

Duke shqyrtar kontekstin ballaknik, Friedman-i theksonte se një dukuri në gjuhën rumune që lidhet me çështjen e jovërtetimit, përcaktohet me të njëjtat kuptime si habitoja e shqipes (d.m.th. habi dyshim, ritregim etj.). Ky krahasim, mendonte Friedman-i, edhe pse nxjerr se të dy kategoritë janë përcaktuar në të njëjtën mënyrë, më pas konstatonte se ato nuk bashkëngjasin në përdorimet e veta, por formojnë një kontinuum, në të cilin shqipja është në një anë e rumanishtja në tjetrën. Sipas tij, situata në kategorinë e jovërtetimit është e ngjashme me atë të paskajores, që është analizuar shumë saktë nga Brian Joseph (1983).<sup>8</sup>

Çëshja e mënyrës prezumtive në gjuhën rumune, shtonte Friedman-i, mund të krahasohet me habitoren e shipes nga ana tipologjike, si dhe nga ana semantike. Nga ana tipologjike, ka tri lloje realizimesh të kategorisë së jovërtetimit: pragmatiko-gramatikore (sllavisht dhe turqisht), paradigmatiche (shqip, megleno-rumanisht) dhe morfemike (arumanisht e Belicës së Sipërme dhe sipas Kostovit gjuha rome e Slivenit). Duke i shtjelluar më tutje këto tri lloj realizimesh, Friedman-i vlerësonte se në bullgarisht, maqedonisht e turqisht, e kryera ka kuptimet jovërtetuese në kontekstet pragmatike, por edhe gramatikalizohen me trajtat e mëvonshme, si p.sh., bullgarisht *bil napravit*, maqedonisht *imal napraveno*, turqisht *yapmısmıs*, ndërkaq, në gjuhën shqipe, si dhe në megleno-rumanishte, habitorja ose e kryera e anasjelltë është gramatikalizuar krejt dhe s'ka kontekst ku kuptimet e jovërtetimit të mos jenë të pranishme. Në gjuhën arumune dhe në atë rome, kuptimi i jovërtetimit është sjellë nga një morfemë e pandryshueshme –ka, në arumanisht nga shqipja, -li në romisht nga bullgarishtja. Këtu mënyra prezumtive e rumanishtes është disi midis këtyre tipareve.<sup>9</sup>

Në fund të fundit, duket se megjithëse disa realizime të opozicionit vërtetues/jovërtetues janë padyshim me originë kontakti si pë shembull në të folmen arumune të Belicës së Sipërme dhe të tjerat kanë munësi të jenë autoktone, megjithëse ka edhe mundësi të ndikimit nga një gjuhë tjetër, si është situata me shqipen dhe sllavishten në lidhje me turqishten, sipas Friedman-it, ka edhe tendencë areale në Ballkan për gramatikalizim të kuptimit të jovërtetimit, që bën një kontinuum midis formave paradigmatiche jomodale të shqipes nëpër trajtat pragmatike-gramatikore të sllavishtes dhe turqishtes, deri në trajtat modale me karakter, ose pragmatik të rumanishtes.<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Po aty f. 581-582

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Victor A. Friedman, *Haborja e shqipes dhe "Prezuntivul" e rumanishtes*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 582

<sup>10</sup> Po aty, f.585

Friedman-i shpjegonte se habitorja e arumanishtes, që deri tani është dëshmuar në Maqedoninë jugperëndimore te folësit e fshatit Gorna Belica (Beala di sus) që erdhën aty para afërsisht një shekulli nga Shqipëria, është krejt qartë huazim morfologjik dhe gramatikor i mbështetur nga shqipja. Është evidente se morfema e vetës së tretë njëjës të habitores shqipe –ka, që është më e zakonshmeja njësoj logjikisht dhe statistikisht, u interpretua si pjesëz që shënon jo-konformativitetin dhe iu shtua bazës pjesore të arumanishtes.<sup>11</sup>

Paradigmat shqipe dhe arumune kanë rrjete formash të kohës së tashme që mund t’u rrefeohej ngjarjeve të filluara në çastin e perceptimit ose që ngjajnë gjatë çastit të të folurit.<sup>12</sup>

Për sa i përket formave të habitores së shqipes maqedonishtes, bullgarishtes e turqishtes, Friedman-i flet për tri argumente të cilat i shtron në kontekstin e studimeve të gjuhëve ballkanike.

I pari argument është se e tashmja e mënrës habitore shqipe në më tepër se 90% të rasteve përkthehet me të tashmen normale të gjuhëve të tjera në përkthimet e teksteve nga maqedonishtja, bullgarishtja dhe turqishtja në shqipen, si edhe nga shqipja në këto gjuhë. Kështu, për shembull, në fjalinë shqip *Ju e ngrënkeni çorbën fare pa bukë!* forma *ngrënkeni* i përgjigjet bullgarishtes *jade* dhe turqishtes *ıçyorsunuz*. Domethënë që habitoretja e shqipes i përgjigjet përdorimit habitore të kohëve të gjuhëve të tjera vetëm rrallë.

I dyti argument është se pikërisht në kontekstet ku maqedonishtja dhe turqishtja përdorin një folje me domethënie habitore, edhe në gjuhën shqipe i takojmë kohët e tjera të habitores. Për shembull, në kontekstin e përmendur më përpara për “Ah, ti qenke këtu!” është e mundshme të themi edhe “Ah, ti paske qenë këtu!”, apo “Ah, ti qenkëshe këtu!”, apo “Ah, ti paskëshe qenë këtu!”. Domethënë përdorimi sllav apo turk ka të bëjë me habi gjithnjë kur zbulojmë një fakt papritur që ekzistonte para se ta kemi zbuluar.

I treti argument është fakti se përdorimi habitore i maqedonishtes dhe turqishtes nuk lejohet në pyetje që kanë të bëjnë me një fakt vetëm në të tashmen pa lidhje me të shkuarën. Për shembull, kur një myshteri hyn tek një berber duke pritur se pronari i dyqanit do të jetë atje, por s’është, dhe në vendin e pronarit është vetëm çiraku, myshteri mund të thotë shqip: “Ku qenka mjeshtri?” Në një kontekst të tillë është krejt e pamundshme që myshteri të pyesë turqisht “Usta neredeymiş?” apo maqedonisht “Kade bil majstorot?” Shkaku është se në këtë kontekst nuk kemi asfarë lidhjeje me të

<sup>11</sup> Victor A. Friedman, Kontakti dhe ndërjegjja në lidhjen gjuhësore ballkanike, Studime 3, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 241

<sup>12</sup> Po aty, f. 243

shkuarën, dhe për këtë arsye përdorimi habitor i së kryerës maqedonase apo turke nuk lejohet, sepse këto forma duhet të kenë njëfarë lidhjeje me të shkuarën.<sup>13</sup>

Më në fund, thotë Friedman-i, mund të vështrojmë se habitorja e shqipes nuk përdoret vazhdimisht në tregime të lidhura të gjata, kurse në turqisht dhe maqedonisht një përdorim i tillë është i lejueshëm.<sup>14</sup>

---

<sup>13</sup> Victor A. Friedman, *Studies on Albanian and other Balkan languages*, Vepra themelore në Albanologji, Aktet e Konferencës shkencore ndërkombëtare 18-20 dhjetor 2008, Qendra e Studimeve Albanologjike, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2009, f. 115-116

<sup>14</sup> Po aty

## Literatura

1. Friedman, Victor A., (1994). *Ndikimi i shqipes në të folmet arumne të Maqedonisë Jugperëndimore: Mënyra habitore*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, vol. 1, 1994, Prishtinë.
2. Friedman, Victor A., (1995). *Mënyra habitore në gjuhën arumune dhe në gjuhën shqipe – Paralele dhe ndikime*, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universiteti i Prishinës, Fakulteti i Filologjisë, *EuroRilindja*, Tiranë.
3. Friedman, Victor A., (1996). *Habitorja e shqipes dhe “Prezuntivul” e rumanishtes*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Akademia e Shkencave, Institui i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, *Toena*, Tiranë.
4. Friedman, Victor A., (2008). *Studies on Albanian and other Balkan languages, Vepra themelore në Albanologji, Aktet e Konferencës shkencore ndërkombëtare 18-20 dhjetor 2008*, Qendra e Studimeve Albanologjike, *Botimet Albanologjike*, Tiranë.
5. Friedman, Victor A., (1997). *Kontakti dhe ndëryjegja në lidhjen gjuhësore ballkanike*, Studime 3, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.

Berton SULEJMANI

**PIKËPAMJET E BOZHIDAR VIDOEVSKIT PËR KONTAKTET  
GJUHËSORE TË MAQEDONISHTES DHE SHQIPES (NË  
RRAFSHIN DIALEKTOR)**

*Në këtë punim do të paraqesim studimin e sllavistit të njohur, Bozhidar Vidoevskit, rreth kontakteve gjuhësore të maqedonishtes dhe shqipes në rrafshin dialektor. Sistemi konsonantik i të folmeve maqedone periferike është i ngjashëm (përputhet) me sistemin konsonantik të të folmeve shqipe të zonës kufitare. Një grup të veçantë paraqesin edhe huazimet shqipe. Në disa të folme në studimet dialektologjike ka vërejtur këto leksema: ала 'halle' (alla), баща 'dele e bardhë' (barxhë), буп dem. буpe djalë, fëmijë, буса (buzë), баа 'djalë, fëmijë (bir), бок (bukë), крена 'gur i madh shkrep' beca (besë). Numri i fjalëve shqipe, gjithsesi, është më i madh veçanërisht në fshatrat maqedone të Prespës në Shqipëri dhe në rrethin e Korçës, vëren B. Vidoevski.*

Është e njohur se ekzistojnë ndikime reciproke të shumta dhe të llojllojshme në mes gjuhëve të ndryshme në arealet gërshetuese gjeografike. Deri më tani në trevat lindore shqiptare (Maqedoni) janë botuar një varg studimesh e disa monografi gjuhësore ku janë trajtuar ndikimet gjuhësore maqedone-shqiptare, të cilat janë reciproke dhe me një përmasë bukur të madhe. Këto ndikime vërehen në fonetikë, fonologji, gramatikë (morfologji-sintaksë), e veçanërisht në leksik të cilat i vërejnë edhe folësit që nuk kanë njohuri elementare për gjuhësinë si shkencë. E them këtë, sepse ndikimet e një gjuhë mbi tjetrën në strukturën gramatikore të një gjuhe janë të rrezikshme dhe shumë të vështira për t'u vërejtur edhe nga gjuhëtarët, ndërsa fjalët e huaja, veçanërisht të rejat i hetojnë të gjithë pjestarët e asaj gjuhe. Studime gjuhësore shqiptare – maqedonase janë bërë nga shumë gjuhëtarë shqiptarë<sup>1</sup>, por një gjë e tillë është bërë edhe nga ata maqedonas (por me numër më të vogël). Viteve të fundit në Maqedoni janë bërë një numër i madh i studimeve kontrastive në mes shqipes dhe maqedonishtes.

---

<sup>1</sup> R. Ismajli, *Disa fjalë shqipe në maqedonishten*, GJA, VII, Prishtinë 1974. S. Hoxha, *Elementet leksikore të shqipes në disa të folme të maqedonishtes*, Buletini shkencor, nr. 2, Shkodër, 1984, Q. Murati, *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, Prishtinë, 1990.

Pikëpamjet e B. Vidoevskit<sup>2</sup> për ndikimet e shqipes mbi maqedonishten, gjeografikisht shtrihen / përfshijë territorin e zonës kufitare maqedono-shqiptare që nga Mali Sharr e gjer në Korçë dhe Gramsh në jug. Në të dy anët e kufirit jeton popullsia e përzier dhe sipas përkatësisë gjuhësore, edhe sipas asaj konfesionale, maqedonas të krishterë dhe myslimanë, shqiptarë, gjithashtu të të dy konfesioneve, në pjesën jugperendimore edhe grekë dhe arumunë (vllehë). Në gjithë këtë territor popullsia është bilinguale dhe / ose multilinguale.

**Tiparet dialektore (të shqipes) të fushës së fonetikës dhe fonologjisë që kanë ndikuar mbi të folmet e maqedonishtes.** B. Vidoevski në punimin e tij tregon se hundorëzimi (nazalizmi) i zanoreve në afërsi me sonant nazal në të folmet shqipe është mjaft i përhapur<sup>3</sup>, sidomos në arealin geg. Nën ndikimin e dialekteve të shqipes janë zhvilluar edhe zanore hundore edhe në të folmen e Korçës, khs.: **Вангел, копанка, тапанца, фамбрика, франико, шандан**, (shqip: Vangjel, kopankë / kofshë, fabrikë, fambricë, fransko, shandan – mbajtëse qirinjshe), ndoshta edhe në shembujt me një nazalizëm të theksuar të tipit: **грѣди, дрѣнк, фѣмба, лендинѣ** (shq. Gjoks, thanë, kërpudhë, lëndinë) në qoftë se është ruajtur shqipëtimi organik khs. shq. **Kāmb, dhāmb**.

Diftongimi i zanoreve të theksuara /o/ → [yo] dhe i /e/ → [ue] është një veçori e përbashkët e të folmeve maqedone dhe shqipe të rrethit të Dibrës, khs.: buoc (një lloj bari), çuorb (çorbë), vçuorb (enë prej balte).

Edhe diftongjet e të folmeve maqedone perendimore në shumicën e rasteve kanë ngjashmëri me diftongjet e të folmeve shqipe. Khs.: **dhai (dhi), trai (tre), mōi (mi), shēi (shi), shoum (shumë), ktau (këtu)** në të folmet e Dibrës, **grua, diell** në të folmet e Korçës dhe Pogradecit etj. Paralelizmi ndërmjet të folmeve maqedone dhe shqipe në drejtimin Dibër – Ohër – Korçë vërehet edhe në prirjen që disa nga diftongjet të monoftongizohen, khs.: **gru (grue), mi:ll (miell)**, në të folmet kalimtare (transitive), maqedonisht **то (toa / ajo), то:р (тоар / barë), че:к (чоек / pjeri), забре:но (заборавено / e harruar), Нао:м, Но:мче рranë Ном, Номче (Наум, Наумче)** në të folmet e Ohrit dhe Prespës.

Studiuesi B. Vidoevski më tej vë në pah se në të fomen e Korçës dhe të Kosturit në shumë shembuj në vend të zanores /o/ në rrokje nistore përdoret /a/-ja, **khs.: апет, лабода, матика, пануда, тапола** (shq. *apet/përsëri, pulëbardhë, shatë, ofertë, plep*). Një proces i ngjashëm fonetik haset edhe në disa të folme shqipe, khs.: *gamor, dallap, keates*,

<sup>2</sup> МАНУ, Македонски славистички комитет, *Реферати на македонските слависти за XI меѓународен славистички конгрес во Братислава*, Скопје, 1993.

<sup>3</sup> Në bibliografinë e punimit të B. Vidoevskit i gjejmë edhe studimet: 1. Beci Bahri, *E folmja e Lushnës së Dibrës*, Dialektologjia shqiptare, II, Tiranë, 1974, f. 223-281; 2. Çeliku Mehmet, *Të folmet e Kavajës*, Dialektologjia shqiptare, II, Tiranë, 1974, f. 193 – 222.

*apet* në të folmen e Kavajës. Më tej, sistemi konsonantik i të folmeve maqedone preiferike është i ngjashëm (përputhet) me sistemin konsonantik të të folmeve shqipe të zonës kufitare.

Ndërdhëmboret (interdentalet) /*φ*/ dhe /*ð*/ në të folmet maqedone të Korçës janë huazuar drejtpërdrejt nga shqipja dhe greqishtja. Fonema /*x*/ (*s*) në pozicione të ndryshme, gjithsej ka qenë ka qenë e përkrahur nga shqipja e arumunishtja.

Ndërhyrja e bashkëtingëllores /*b*/ (*ḡ*) në sekuencat /*m + r, ll*/ (*m + p, ʌ*) është kryer sipas shqiptimit shqiptar në të folmen e Korçës dhe përgjithësisht në të folmet toske.

Një ngjashmëri tjetër, shumë të dukshme sipas gjuhëtarit Vidoevski, në mes të folmeve shqipe dhe maqedone është edhe fonema /*h*/ (*x*). Në disa punkte maqedone, ku ende ruhet tingulli /*h*/ në disa pozicione, ky tingull përdoret edhe në të folmet fqinje shqipe dhe afërsisht në të njëjtat pozicione. Në shumë të folme shqipe është vërejtur edhe kalimi i /*h*/ në /*f*/. Kështu p.sh. në një pjesë të të folmeve shqipe të Korçës bashkëtingëllorja /*h*/ ka rënë në të gjitha pozicionet, khs.: sho për: shoh, she për: sheh, stre për: strehë. Në të folmen e Devollit *h*-ja ka rënë vetëm në pozicionin fundor, khs.: kra për: krah, ndërsa në pozicionet tjera, në të folmen e myslimanëve, *h*-ja është ruajtur, kurse të krishterët ka rënë, khs: hekur, duhan : ekur, laemi (lahemi), vëren B. Vidoevski.

Një vend të rëndësishëm në diferencimin (dallimin) dialektor ndërmjet të folmeve perëndimore periferike dhe atyre qendrore, gjithsesi, zënë edhe ***dialektizmat leksikore***, të cilat i klasifikon në tri grupe:

**Në grupin e parë** i ka vendosur leksemat sllave, të cilat në të folmet qendrore janë të jashtëzakonshme ose nuk përdoren fare. Mirëpo, një pjesë e mirë syresh përdoren në ligjerimet dialektore shqipe. Ato paraqesin huazime të vjetra sllave në shqipen dhe gjithsesi mjaft ka kontribuar për stabilizimin e tyre në ligjerimet dialektore maqedone. Në vazhdim do t'i shënojmë ato fjalë që i zgjodhëm si më karakteristike paralelisht me ekuivalentet shqipe: б'л'уд(о) (bludë), вода 'brazdë vadë për ujë' (vadë), вид 'vend i ngritur, i vogël' (vis), гал'а / галница (galë), забел 'vend i ndaluar, zabran' (zabel), зазабница 'sëmundje e dhëmbëve' (zambicë) клека 'bimë e ngjashme me dëllinjën' (klekë), кадеши 'tym', кади 'del tym, tymoset' (kadis), када 'kacë' (kadë), кат / кант 'qosh' (kënd), коложек 'tuaçi janar' (kolozhek), кика 'majë' (kikë), косор 'një lloj sopate' (kosrë, kosore), кат (kat), ко̀бел 'enë druri për qumësht' (kabel), котар 'vend i rrethuar ku rrinë derrat' (kotar), которок, 'mace, maçok' (kotele), кланик (тланик) 'gur që është vënë në zjarr të hapur' (kllanik), капиш 'vend guror' (kërshë), каленица 'enë, pjaë prej balte' (kalenicë), капица 'tufë bari i mbledhur' (kapicë), котец 'çerdhe pulash' (kotec), копан / копанка 'koritë' (kopan), лапа 'çorbë, lëng i trashë' (llapë), лигавец 'kërmilli lakuriç, i zhveshur' (ligavec), ложник 'lloj mbulese prej leshi' (lozник), лапка 'lopë e re, dele para kohe që ka pjellë qengj' (llashkë), matka 'bletë mbretëreshë; maticë' (matkë), мочал 'vend i lagët, moçalik' (moçal), мома (momë), обор (oborr), окит 'borë e ngrirë në dru' (okitë), отава 'barë i kositur për herën e dytë' (otavë), отреш 'pjesë e

parmendës, pllugut' (otresh), плоска 'enë për verë' (plloskë), прапшта 'pjesë e samarit' (prshhtë), порач 'endacak' (trugaç), сотина 'mjalti i bletëve në koshere' (sotinë) etj<sup>4</sup>. Pjesa më e madhe e këtyre leksemave përdoren në të folmet e Korçës dhe të Kosturit, si dhe në ato të Ohrit dhe të Prespër, një masë më të kufizuar edhe në rrethin e Dibrës, shton akad. B. Vidoevski.

**Në grupin e dytë** paraqet huazimet shqipe. Në disa të folme në studime dilektologjike ka vërejtur edhe këto leksema: ала 'hallë' (alla), барца 'dele e bardhë' (barxhë), бир, dem. бире 'djalë, fëmijë (bir), беса (besë), бренда 'burg' (brenda), буза (buzë), бук (bukë), бабо 'at, baba' (babë), бауре 'oxhak' (buhare), бишч (bisht), вокра 'dele zeshkane, kaleshe' (vok-er, -ra), вайза 'bijë' (vajzë), гропа 'vrimë' (gropë), дамалук 'pllug me dy dorëza' (damalug), дајо 'daj' (dajë), даш (dash), ѓал 'djalosh, djalë' (gjalë), зотни (zotni), жур 'nujë, kuç i këmbës' (zhur), журинште 'lum që lë uji' (zhurishtë), кацал 'kërcell, koçan misri', какарда 'kakërdhitë e dhenve, dhive etj.' (kakërdhi), кокареп 'misër i zier' (kokareç), кушерија 'fqj, komshi' (kushëri), кундри 'këpusë' (kundër – tur. kundura), куфрија 'megjë, sinor' (kufi), л'але 'vëllai më i madh' (kur i drejtohem) (lalë), л'опар 'ruajtësi i lopëve' (lopar), л'опа (lope), мургап, мурго 'qen me qime të thinjura, të murme' (murgash – rum. murg), мотива (motër), нуса 'nuse' (nuse), нона 'nënë' (nona), огич / угич 'dash' (ogic), пус 'bunar' (pus, rum. put, lat. ballk. putes), прешп 'praz' (presh), пороже 'itar i vogël' (porozhe), пул'че, 'jariçkë' (pulë), теза 'motra e nënës' (tezë), туричка 'turri i derrit' (turi), чафе 'kthesë malore, majë' (qafë, qafalik), кен (qen), цуца 'vajzë' çikë, gocë (cucë), чакар 'njeri me sy të shtrembër, të çakaritur' (çakarr), цацо 'axhë' (xhaxha, xhaxho), шенлија 'i gëzueshëm' (shend – gëzim, hare), шкамп 'vend guro' (shkëmp – shkrep, karpë, stenë), шкумба (shkumbë), шкоп / чкор 'corë druri' (shkorrë, shkurrë), ѓур (gur), кушерија 'fis, soj (kusheri) etj. Makedonisti thekson se numri i fjalëve shqipe, gjithsesi, është më i madh nga lista që e jep në punimin shkencor, veçanërisht në fshatrat maqedone të Prespës në Shqipëri dhe në rrethin e Korçës.

Në të folmet jugperëndimore periferike në drejtim Ohër – Korçë – Kostur që paraqet **grupin e tretë** hyjnë numri i dialektizmave leksikorë me një numër "ballkanizmas", leksema këto që janë të njohura në dy ose më shumë gjuhë joslave ballkanike. Parasysh i ka marrë vetëm ato leksema që kanë një areal më të kufizuar në diasistemin maqedon. Po i japim vetëm disa shembuj vetëm në formën dialektore maqedone (ashtu paraqiten në punim): варуле 'enë druri, kadë për verë' (gr.shq.) веленце 'lloj mbulose, qilimi' (gr. e re, shq. arum.), жужулеп 'lloj insekti' (gr., shq.,

<sup>4</sup> Të gjithë shembujt e dhënë në punimin e gjuhëtarit në fjalë mund t'i gjeni në: Божидар ВИДОЕСКИ, *Меѓујазичниот контакт (на дијалектно рамниште) како фактор за дијалектната диференцијација на македонскиот јазик*, МАНУ, Македонски славистички комитет, Реферати на македонските слависти за XI меѓународен славистички конгрес во Братислава, fq. 33 – 54, Скопје, 1993.



arum.), заркада 'sorkadhe, kaproll'(gr. shq. arum.), кукувајка (gr. e re, shq., arum.), карпус 'bostan'(gr. e re, arum. shq.), крачун 'badnik, kremtet e kërshëndellave'(arum. shq.), лелек 'lejlek' (shq. gr. tur.), луканик / луканки 'mish në zorrë, kobasica, suxhuk'(gr. e re, shq.), мартир 'dëshmor'(gr. e re, shq. arum.), миска 'quran'(arum. shq.), пепон / пепун 'kaun'(gr. shq.), пјато 'pјatë'(greq. e re, shq. arum. it.), птит/ прике 'dhuratë, pajë, çeziz'(greq. shq.), роска 'patë', росак 'mashkulli i patës, patok, patan'(arum. shq.), скепар, / шкепар / шкепар 'lloj teslice'(greq. e re, shq.), тартабик, тавтабита, 'tartabiqe'(tur. shq. arum.) etj.



Naser PAJAZITI

## WACLAW CIMOCHOWSKI MBI TË FOLMEN E DUSHMANIT

Prej studimeve dialektologjike, të cilat janë pjesë e truallit të shqipes, do ta veçonim monografinë shteruese, të realizuar me mjaft mjeshtëri nga albanologu i njohur polak Waclaw Cimochowski “*E folmja e Dushmanit*”, në të cilën autori bën një përshkrim të hollësishëm të sistemit fonetik, morfologjik dhe sintaksor, duke na dhënë kështu një pasqyrë të qartë të pamjes gjuhësore të kësaj së folmeje, kryesisht në aspektin sinkronik.

Waclaw Cimochowski me qëllim të mbledhjes dhe studimit të materialit dialektor erdhi në Shqipëri në vitin 1937 ku në viset e thella të saj, në Dushman të Dukagjinit, qëndroi një vit, dhe duke u mbështetur në materialin e mbledhur gjatë kësaj kohe sa qëndroi në Shqipëri, ai hartoi dhe më vonë në vitin 1951 studimin “e folmja e Dushmanit” që atë e bëri një emër të njohur në qarqet e studimeve albanologjike.

Vepra në fjalë ndahet në tri pjesë, në pjesën e fonetikës, në pjesën e morfologjisë dhe në pjesën e sintaksës.

Në pjesën ku i kushtohet fonetikes do t’i veçonim disa dukuri gjuhësore që kanë gjetur shtrirje si në sistemin vokalik ashtu edhe në sistemin konsonantik.

Në sistemin vokalik sipas Cimochowski-t e folmja e Dushmanit, por edhe tërë krahina dialektore e Shqipërisë Veriore ka tri lloje zanoresh: zanore të shkurtra *kerah, lis, mot, mur, gur*, etj zanore të gjata: *ar, shp, zj, lop, me le* dhe zanore gjysmë të gjata: *me u duk, me vesh, me hyp* etj.

Sikur në të folmet trevave verore edhe në trevën e Dushmanit, Cimochowski vëren qartë dukurinë e hundorësisë së zanoreve, duke theksuar faktin se, zanoret hundore në Dushman janë gjithmonë të gjata.

Në Dushman nuk ka gjurmë të ruajtjes së diftongut i vjetër **uo**, por as nuk vërehet kalimi i diftongut **ue** në **u**: *punue, due, grue*. Në këtë të folme nuk i nënshtrohen procesit të monoftongimit, por shqiptohen të plota edhe diftongjet **ye, ie miell, siell**.

Në fushën e konsonantizmit Waclaw Cimochowski ka hetuar këto dukuri:

---

1. Waclaw Cimochowski, *E folmja e Dushmanit*, në *Për gjuhën shqipe*, ASHLAK, Prishtinë, 2004.

bashkëtingëlloret qiellzore të mesme **q** dhe **gj** në të folmen e Dushmanit, si edhe në të folmet tjera të veriut kanë kaluar në afrikate palatale.

Grupet e vjetra **kl**, **gl** dalin si grupi **ki**, **gi**: *kiai, kijoft, gjuba, i gjat etj.*, dukuri gjuhësore që është karakteristikë për të folmet e gegërishtes veriperëndimore

Grupet **nd**, **mb** janë thjeshtuar: **nd**, **nn**, **n** dhe **mb** **mm**, **n**: *ner, me mush, me mledh.*

Në pozicion në fillim të fjalës para konsonantit **sh** në të folmen e Dushmanit vërehet kalimi **mb** në **p** *pshtjell* për mbështjell, *me pshtet* për mbështet. Një dukuri e tillë gjuhësore ka gjetur shtrirje edhe në të folmet tjera të veriut.

Sipas Cimochowski-t në Dushman vërehet kalimi i grupet **pl** në **pi**, **bl** në **bi**, **fl** në **fi**: *piak-plak, pieshta-pleshta, i piot-plot, bieta-bleta, me bie-me ble, fiok-flok, fieta-fleta etj.*, ndonëse, sipas tij, një dukuri e tillë ende nuk ka përfunduar, dhe se herë pas here mund të dëgjohen format ku këto grupe janë ruajtur të plota.

Përzjerja e fonemave **dh** me **ll**, dukuri gjuhësore që ka përhapje më shumë në të folmet e perëndimit, në të folmen e Dushmanit, sipas **Cimochowski-t**, vërehet shumë më rrallë. Si shembull për këtë ai merr fjalët *llalltë (dballë)* dhe *noll (ndodh)*.

Pjesën më të madhe të studimit për të folmen e Dushmanit Cimochowski i ka rezervuar sistemit morfologjik, në të cilin autori spikat ato tipare gjuhësore morfologjike, që sipas tij, janë me interes për t'u trajtuar në një studim të këtillë.

Në sistemin morfologjik do të veçonim:

Emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore të ndryshme me përjashtim të emrave që mbarojnë me **k** dhe **g**, në numrin shumës elementi **-t** paraqitet si karakteristikë e trajtave të shquara në të gjitha rastet, ndërsa mungesa e **t-së** tregon trajtën e pashquar p.sh em. *vesh,-t*, gjin.dhan. *veshve,-t*, kall *vesh-t*.

Tek emrat e gjinisë femërore që në trajtën e shquar të rasës emërore njëjës nuk mbarojnë me zanore dhe që në rrokjen e fundit kanë, para bashkëtingëllores fundore, një zanore të gjatë, nëse theksi bie mbi të, zanorja **ë** para elementit përcaktues, në gjinore e dhanore njëjës para **-s** dhe në rasën kallëzore para **-n** është zhdukur në gjinore e dhanore, kurse në kallëzore shndërrohet në një **e** të shkurtër të patheksuar si, p.sh. gjin. dhan. *lops*, kall. *lopen*.

Sa i përket gjinisë asnjësore, në të folmen e Dushmani me përjashtim të emrit *djathët* që del si asnjës, numri i madh i emrave asnjës përfaqësohet me emrat prejmbiemëror dhe emrat prejpjesor: *t ftohtët, t parmit, t folunit, të ardhunat etj.*

Përemrat vetorë kanë dy trajta në rasën dhanore dhe në rasën kallëzore njëjës dhe shumës *m* dhe *mue*.

Sipas Cimochowski-t, te përemrat pronorë, trajtat të ashtuquajtura të shquara të përemrave dalin në raste kur përemri përdoret pa emër, funksionin e të cilit e kryen edhe kur përdoret si kallëzues emëror. Këta përemra mund të kenë ose të mos kenë elementin përcaktues (si edhe mbiemrat e emëruar) p.sh u *ka dhan të tuvet* ose *u ka dhan t tuve*.

Cimochowski ka hetuar se te përemrat pronorë trajtat e rasave të zhdrejta te *tem* dhe *tan* janë përgjithësim të trajtave të kallëzores dhe se herë-herë janë formuar trajtat analogjike si *i em*<sup>2</sup>.

Meqë çështja e klasifikimit të foljeve në zgjedhime në gjuhën shqipe është një punë shumë e vështirë, Cimochowski për kriter të klasifikimit merr trajtat e kohës së tashme dhe raporti ndërmjet kësaj trajte dhe “temës foljore” të cilat janë marrë si bazë e ndarjes së foljeve në klasë për zgjedhim, por duke pasur parasysh edhe mënyrën e sajimit të kohës së kryer të thjeshtë si dhe të kohëve të tjera. Duke u mbështetur në kriteret e përmendura më lart, ai foljet i ndanë XV klasë të zgjedhimit e disa prej tyre edhe në nënklasë dhe njëkohësisht, duke dhënë kështu shembuj për gjitha zgjedhimet dhe duke i paraqitur ato në formë tabelare.

Mënyra lidhore në vetën e dytë njëjës del me mbaresat **-sh** ose **-ish**, gjegjësisht **-ush**: *t piekush, t mushish, t matish*.

Koha e ardhme në Dushman del në dy trajta në *do+ lidhborja* dhe *kam + paskajorja*. Këto dy trajta kanë përdorim të barabartë, megjithatë tipi i së ardhmes *kam +paskajorja* ka një përdorim më të gjerë.

Trajtën e pjesores *tue ba, due ardh, tue luftue, tue ken* Cimochowski s’e quan përcjellore, por pjesore të së tashmes<sup>3</sup>.

Në pjesën e sintaksës jepen të dhëna për përdorimin e rasave, trajtës së shquar dhe të pashquar, të parafjalëve dhe të përdorimit të tyre, funksioni sintaksor i mënyrave dhe i kohëve të foljeve si dhe llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje.

Waclaw Cimochowski në veprën e folmja e Dushmanit përdori metoda të reja që deri atëherë kishin munguar në studimet edhe ashtu të pakta dialektologjike në gjuhën shqipe dhe, duke u mbështetur mirë, kryesisht në materialin gjuhësor të vjelë nga një subjekt i kësaj së folmeje, material të cilin e shënonte me kujdes e me besnikëri, duke e verifikuar, siç thotë ai, herë pas herë, bën që kjo monografi të marrë formën e një studimi të mirëfilltë dhe me peshë të madhe gjuhësore e dialektologjike.

Monografia “E folmja e Dushmanit” është një kontribut i çmueshëm dhe me vlerë të madhe për studime gjuhësore të shqipes dhe kushto që, në mënyrë të veçantë, do të merret me studimin e dialekteve të shqipes, por edhe me historinë e zhvillimit të saj, do t’i hyjë në punë dhe medoemos do t’i referohet kësaj monografie të thellë shkencore, hartuar me mjeshtëri nga albanologu polak Waclaw Cimochowski.

<sup>2</sup> Mahir Domi, *Veprimtaria shkencore e Vakavë Cimobovskit në fushën e Albanologjisë, Studime filologjike*, 4-1983, Tiranë, 1983, f. 174.

<sup>3</sup> Mahir Domi, pun. cit, f. 174.

## Literatura

1. A.V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972
2. Mahir Domi, *Vëprimtaria shkencore e Vokalve Cimobovskit në fushën e Albanologjisë*, **Studime filologjike**, 4-1983, Tiranë, 1983.
3. Emil Lafe, Ndihmesa e V. Cimobovskit në studimet shqiptare, **Studime filologjike**, 1-2, 2002, Tiranë 2002
4. Shaban Demiraj, *V. Cimobovski rreth dy risive në sistemin emëror të shqipes*, **Studime filologjike**, 1-2, 2002, Tiranë 2002.
5. Rexhep Ismajli, Waclaw Cimochowski për studimet e shqipes, në *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2004.
6. Waclaw Cimochowski, *E folmja e Dushmanit*, në *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2004.

**Xhavit BEQIRI, Bahtijar KRYEZIU**

**E FOLMJA E SHKODRËS SIPAS DIALEKTOLOGES A. V. DESNICKAJA**

***Abstrakt***

Studiuesja e njohur e areales gege të shqipes, autorja e librit *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, dialektologja A. V. Desnickaja, ka një pikëshikim interesant për të folmen e Shkodrës, e cila, sipas saj, ndahet në dy nënloje: *e folmja e popullsisë myslimane* dhe *e folmja e popullsisë katolike*.

Kjo ndarje, sipas konceptit të saj, u formua gjatë kohës së sundimit turk, duke e shndërruar grup më vete të folmen e Shkodrës në kuadër të nëndialektit veriperëndimor të gegërishtes.

Duke i shqyrtuar edhe vërejtjet e disa albanologëve tanë që janë marrë me këtë çështje, ky punim synon t'i shtjellojë me detajisht argumentet gjuhësore e kulturore, mbi të cilat e mbështet Desnickaja tezën e saj për të folmen e Shkodrës dhe për ndarjen e saj.

Dialektologja e njohur A. V. Desnickaja, autore e librit *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, ka një pikëshikim interesant për të folmet e Shkodrës, të cilat, përveç të tjerash, ajo i ndan në dy të folme të veçanta: *e folmja e popullsisë muslimane* dhe *e folmja e popullsisë katolike*.

Të formuarit në Shkodër të dy të folmeve të veçanta, sipas saj, “është fakt karakteristik i marrëdhënieve gjuhësore, që janë formuar në Shqipëri në periudhën e sundimit turk”<sup>1</sup>. Dhe, shpjegimin për këtë ajo e kërkon në kushtet sociale-politike të ekzistimit të banorëve të këtij qyteti, të cilat, siç dihet botërisht, nuk ka qenë të njëjta për të dy bashkësitë religjioze jo vetëm të këtij qyteti, por të mbarë viseve shqiptare të pushtuara nga Perandoria Osmane, veçanërisht në mjediset me popullsi të përzier si Shkodra.

---

<sup>1</sup> A. V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, ETMM, Prishtinë, 1972, fq. 89.

## Të folme a bashkësi gjuhësore?

Në shekullin XVI Shkodra u rrënua nga pushtimi, por rëndësia strategjike e saj, si njëfarë ure lidhëse në hartën tregtare mes Detit Mesdhe dhe krahinave të brendshme të Siujdhesës Ballkanike, shpejt e ktheu ndikimin e humbur të këtij qyteti. Madje, në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, Pashallëku i Shkodrës, i udhëhequr nga dinastia e Bushatëve, u bë pothuajse një territor pavarur, me shtrirje edhe në pjesë të Kosovës.

Duke trajtuar rritjen graduale të popullsisë së Shkodrës, gjatë një procesi të vendosjes në qytet të banorëve të krahinave malore të Shqipërisë së Veriut, Desnickaja rreket t'i shqyrtojë edhe rrethanat shoqërore e politike, rrethanat jashtëgjuhësore, të cilat shkaktuan diferencimin e qytetarëve në besime të ndryshme, në musliman dhe katolik, e që këndej edhe krijimin e dy bashkësive të veçanta folësish që në terminologjinë sociolinguistike tashmë është bërë traditë të quhen *bashkësi gjuhësore*.

Sado që Desnickaja operon me terminologjinë dialektologjike tradicionale, asokohe të standardizuar, duke i parë këto grupime si *të folme*, konsiderojmë se ato, duke u mbështetur në kriteret sociolinguistike, mbase mund të cilësohen si bashkësi gjuhësore.

Sintagma/termi bashkësi gjuhësore i referohet një bashkësie të përcaktuar mbi baza gjuhësore, ndërsa përkufizimet që kanë dhënë sociolinguistët kanë qenë të ndryshme. Ndonëse, siç e ka vërejtur Hudson<sup>2</sup>, “ka pasur shumë pështjellim dhe mosmarrëveshje për natyrën e saktë të një bashkësie gjuhësore”, pasi që sociolinguistët shpeshherë kanë dhënë përkufizime mjaft të ndryshme, sot përgjithësisht pranohet se “nuk ekzistojnë kufij në sasinë dhe në varietetin e bashkësive gjuhësore që mund të individualizohen në shoqëri”.

Sipas këtij këndvështrimi - thotë Hudson - mund të pritet që çdo popullsi (e një qyteti ose fshati ose e një kombi të tërë) të përmbajë një numër mjaft të madh bashkësish gjuhësore, me përkitjet (e pjeshme ose përputhjet) e grupeve dhe të sistemeve gjuhësore<sup>3</sup>.

Që ta mbyllim këtë shikim mbi përkufizimin e termit bashkësi gjuhësore, po ashtu, duhet të rikujtojmë se ka edhe pikëpamje, sipas të cilave “bashkësitë gjuhësore duhet të kenë njëfarë konsistence psikologjike”, ndaj lehtë mund të identifikohen bashkësitë e ndryshme gjuhësore në të njëjtën popullsi.

---

<sup>2</sup> Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, ShbB “Dituria”, Tiranë, 2002, fq. 34.

<sup>3</sup> Hudson., vep. e cit., fq. 37.



## Roli i esnafëve

Zhvillimi divergjent i shoqërisë shqiptare nën pushtimin turk pati efektet e veta; pjesëtarët e besimit të parë kishin privilegje e, si rrjedhojë, edhe një status superior në shoqërinë e kohës në raport me bashkëqytetarët e tjerë, të cilët nuk e morën besimin e pushtuesit turk, ndaj edhe mbetën në pozitë shoqërore inferiore.

“Islamizmi, si religjion shtetëror i Perandorisë turke u jipte privilegje të mëdha muslimanëve. Për këtë arsye, nuk është për t’u habitur se muslimanët përbënin dy të tretat e popullësisë së vjetër të Shkodrës. Në përputhshmëri me këtë, katolikë përbënin një të tretën e popullësisë. Popullësia muslimane mbizotëronte jo vetëm kuantitativisht, por edhe luante një rol më aktiv në jetën e qytetit”<sup>4</sup>, shkruan Desnickaja. Madje, vëren Desnickaja, përkatësia religjioze e përcaktonte edhe pjesëmarrjen në organizatën e esnafëve.

“Në Shqipërinë feudale, pjesëmarrja në organizatën e esnafëve ishte e lidhur me religjionin. Në esnafë të veçantë bashkoheshin vetëm përfaqësuesit e religjionit të caktuar. Përveç kësaj, më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm kanë qenë esnafët e muslimanëve. Në mes tyre jo vetëm në Shkodër, por edhe në qytetet e tjera vendin e parë e zinte enafi i lëkurarëve - tabakët (tur. tabak = lëkurarë, kr. arab. debbag = lëkurë)”<sup>5</sup>, citon Desnickaja një punim të Z. Shkodrës.

Roli i këtij esnafi ishte dominues jo vetëm pse në Shqipërinë e atëhershme eksporti i lëkurës kishte vënë monopolin në tregtinë e përgjithshme, por, për më tepër, edhe për faktin se ky esnaf arrinte t’i plotësonte nevojat e ushtrisë turke.

Fuqia tregtare e këtij esnafi kishte ndikim të drejtpërdrejtë në jetën politike të kohës. Në shek. XVIII, në Sanxhakun e Shkodrës, sukcesi i dinastive feudale në skenën politike varej shumë nga përkrahja e tij.

Esnaf tjetër me ndikim ishte ai i terzive, i cili, megjithatë nuk ishte aq i fuqishëm, sa të rivalizonte me atë të lëkurarëve. Edhe esnafi i terzive përbëhej nga muslimanët. Sipas Desnickajës, “esnafet e tjera të Shkodrës - organizatat e zejtarëve të punuesve të armëve, ergjëntarët, punuesit e mëndafshit dhe të leshit e të tjerë, edhe pse ishin në zë për mjeshtërinë e tyre, një rol të tillë politik nuk e kanë luajtur dot. Esnafët që i përbënin katolikët hynin në këtë rend të dytë për nga rëndësia. Në mes të tregëtarëve të Shkodrës, katolikët zinin vend të rëndësishëm. Mirëpo, tregëtarët muslimanë shkonin krahas me ta; përveç kësaj ata shfrytëzonin të gjitha privilegjet dhe të drejtat e barabarta si qytetarë

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Desnickaja i referohe: Z. Shkodra, *Roli dhe pozita e veçantë e esnafit të tabakëve gjatë sundimit turk*, Bul. Univ., Ser. Shk. Shoq., 1962, Nr. 1.

të Perandorisë turke. Shtresa ushtarake dhe aristokracia feudale përbëhej ekskluzivisht prej muslimanëve”<sup>6</sup>.

Shkodra ishte ndarë në dy pjesë, në pjesën muslimane dhe në atë katolike. Secila bënte jetë të posaçme, ndërsa qytetarët takoheshin së bashku vetëm në treg, aty ku kishin mundësi të piqeshin edhe me fshatarët që vinin nga krahinat malore dhe të rrafshit të Shqipërisë së Veriut. Në këto rrethana, pjesa muslimane e borgjezisë tregtare bënte jetë më të lirë, përkthyer me termat e sotëm, ishte më e integruar në institucionet e Perandorisë, ndërkohë që pjesa katolike mbetej më e veçuar. Porse, “në shek. XVIII qytetarët katolikë merrnin pjesë aktive në luftën e partive politike e në shek. XIX, pjesa më e madhe e tyre qëndronte anësh kryengritjeve të armatosura kundër reformës centraliste të pushtetit turk (të Tanzimatit), organizatorë të së cilës ishin esnafët muslimanë”<sup>7</sup>.

Në kryengritjet e shekujve XVIII dhe XIX, të cilat bazën e patën në Malësnë e Mbishkodrës, malësorët morën pjesë aktive. Meqenëse ishin me shumicë katolikë, ata ruajtën lidhje gjinie me katolikët e Shkodrës, ashtu si edhe me pjesën më të madhe të familjeve muslimane. Ky farë dyzimi, me gjasë, duhe të ketë qenë faktori që e pengonte veçimin e mëtejme të pjesës katolike brenda qytetit.

### **Ndryshimet në mes dy të folmeve të Shkodrës**

Në vijim të këtij teksti, do t’i shohim dallimet gjuhësore në mes dy të folmeve të Shkodrës sipas Desnickajës. Prandaj, edhe do t’i përmbahemi terminologjisë së saj (*të folme jo bashkësi gjuhësore*). Duke i marrë në konsideratë të dhënat e shkencës së historisë, Desnickaja miraton faktin se “popullsia muslimane e Shkodrës që mbizotëronte në pikëpamje kuantitative dhe që shfrytëzonte të drejta të mëdha, kishte lidhje më të gjerë ekonomike, politike dhe shoqërore me popullsinë e krahinave të tjera të Shqipërisë”<sup>8</sup>. Kjo popullsi kishte lidhje të tilla sidomos me qytetet e Shqipërisë qendrore, si Elbasani, Tirana, Kavaja dhe Durrësi, të cilat, gjithashtu, mbizotëroheshin nga popullsia muslimane. Në forcimin e këtyre lidhjeve, rol të rëndësishëm kishte edhe rruga tregtare, e cila përshkonte ultësirën e Shqipërisë së Mesme, vijën bregdetare të Adriatikut dhe bashkonte Shkodrën me Shqipërinë qendrore dhe të Jugut.

Gjithashtu, Desnickaja e sheh si faktor të rëndësishëm të “bashkimit” të popullsisë muslimane të Shkodrës me banorët e krahinave të qytetit shërbimin në armatën turke dhe në administratën turke. Përveç kësaj, ajo mendon se lidhjet e popullsisë muslimane

---

<sup>6</sup> Desnickaja, vep. e cit., fq. 90.

<sup>7</sup> Po aty

<sup>8</sup> Po aty.

të Shqipërisë, qendrore dhe të Jugut, duhet të kenë qenë më intensive, sesa ishin supozuar gjer në kohën e saj. Së këndejmi, ndikimi i ndërsjellë ka prekur edhe kulturën shpirtërore (poezia e bejtexhinjve, arkitektura, veprimtaria e sekteve të ndryshme muslimane, si bektashinjtë etj.).

Në këto kushte, e folmja e Shkodrës, në një masë, “ka qenë e këputur nga baza e saj primare e gegërishtes së veriut dhe ka qenë në ndikimin e koinesë bashkëbiseduese të gegërishtes së jugut, që është formuar në qytetet dhe në fushat e Shqipërisë qendrore”<sup>9</sup>. Pikërisht kjo, mendon Desnickaja, “ka përcaktuar specifikën e saj në krahasim me të folmen e pjesës katolike të popullësisë, e cila vijonte të zhvillohej si e folme tipike gege e veriut, që ka ruajtur veçoritë karakteristike të së folmes së banorëve të krahinavet malore”<sup>10</sup>.

Natyrisht, kjo dialektologe nuk i sheh këto dy tipe të folmesh, të formuara brenda kufijve të një qyteti, si një sistem të mbyllur, sepse “përveç bazës së përgjithshme, gjithashtu bashkoheshin me ndikimet reciproke”. Ky pohim i saj përkon me atë të Dwight Bolinger, sipas të cilit “nuk ekzistojnë kufij në mënyrat me të cilat njerëzit lidhen me njëri-tjetrin për motive vetidentifikimi, sigurimi, fitimi, argëtimi, besimi fetar apo çdo lloj qëllimi tjetër të përbashkët”<sup>11</sup>.

Megjithatë, ndonëse është e bindur se “ekzistimi i ndryshimeve të veçura në pikëpamje konfeksionale në të folmen e banorëve të Shkodrës është fakt i njohur mirë në Shqipëri”, Desnickaja nuk gjen ndonjë “përshkrim simerik”, madje as ndonjë “vëzhgim të thjeshtë të tyre gjertani”. Kësodore, ajo “detyrohet” t’u referohet “disa vështrimeve interesante”, siç i cilëson vetë, të Gj. Loumenit në *Fonetika e shqipes*<sup>12</sup>, i cili kishte vjelë material nga katër folës banorë të Shkodrës, dy muslimanë dhe dy katolikë.

Ndryshimet në mes dy tipeve të të folmeve të Shkodrës Desnickaja pjesërisht i sheh si rezultat të karakterit konservativ të së folmes së katolikëve.

“Në lëmin e konsonantizmit ky, para së gjithash, është të ruajturit tipik për të folmet gege të veriperëndimit të korelacionit në mes reflekseve të grupeve të vjetra *k/*, *g/* dhe të okluzivet qiellzore të mesme të vjetra, që kanë kaluar në afrikate të qiellzës së mesme. Në fjalët qaj (<klaj), qumësht (<klumësht), qoftë (<kloftë), gjuhë (<gluhë), (i) gjatë (<glatë), katolikët i shqiptojnë qiellzoret e prapme okluzive pak të palatalizuara në kombinim me *i* që nuk formon rrokje (k’jaï), (k’jumsht), (k’joft), (g’juh), (g’jat). Ky shqiptim i posaçëm së pari është shprehur edhe në traditën ortografike të Shkodrës. Kështu, për shembëll, në fjalorin e botuar prej shoqërisë “Bashkimi” në fillim të vitevet

<sup>9</sup> Desnickaja, vep. e cit, fq. 91.

<sup>10</sup> Po aty

<sup>11</sup> Dwight Bolinger, *Aspects of Language*, 2<sup>nd</sup> edition, Neë York: Harcourt Brace Jovanovich, 1975, fq. 333.

<sup>12</sup> G. S. Loëman, *The Phonetics of Albanian. Language*, VIII, 1932, Nr. 4.

900<sup>13</sup>, përdoren këto shënime: kiai, kiumshte, por cafe (qafe), cen (qen), ceef (qejf < turqishtes keyif); giuhe (gjuhë), (i) giate (gjatë), por grah (gjak), ghume (gjum), ghysh (gysh)<sup>14</sup>, vëren Desnickaja. Ajo vë në dukje se ky dallim nuk ekziston në të folmen e muslimanëve të Shkodrës, sikundër që nuk ekziston as në krahinën gege të jugut, të cilët, në të gjitha rastet, i shqiptojnë “qiellzoret e mesme, okluzive, tepër të afrikuara”.

Ndërsa, kur është fjala për vokalet, Desnickaja pohon se “konservativizmi përkatës i së folmes së katolikëve vërehet në të ruajturit e pjesërishëm të diftongjeve të vjetra *ie, ye, ue* në të njëjtën kohë, kur në të folmen e muslimanëve në mënyrë plotësuese përforcohet shqiptimi monoftonigjal – vokalet e gjata *ī, y, ū*. Krahaso: diell – dill, me lye – me ly, me shkue – me shkū, grue – grū<sup>15</sup>. Mirëpo, siç vëren Desnickaja, duke iu referuar edhe Eqrem Çabejt, ky dallim është relativ, sepse “tendenca e fortë nga monoftongizimi i diftongjevet që është përhapur nga Shqipëria e Mesme mjaft heret ka hyrë në të folmen e pjesës katolike të popullsisë së qytetit të Shkodrës dhe të fushavet që bashkohen me të, për të cilin dëshmojnë monumentet e shkrimit të shek. XVI-XVII<sup>16</sup>. Edhe Desnickaja, sikurse Çabej para saj, kujton faktin se trajtat e vetmuara me monoftongje shënohen në “Mesharin” e Gjon Buzukut (shek. XVI) – grua (grueja), qilleet (qiellet); gjithashtu te Pjetër Budi (fillimi i shek. XVII) – durt (duert) dhe te Frang Bardhi (shek XVII) – cruu (krue).

Në të folur, sipas Desnickajës, të shqiptuarit e monoftongjeve mbizotëron qëmoti. Mirëpo, “të ruajturit e pjesërishëm të shqiptimit të diftongut ndihet qartë në popullësinë e Shkodrës, e cila është shumë e kujdesshme ndaj dallimeve gjuhësore gjë që është veçori për pjesën e saj katolike<sup>17</sup>. Këtu, sërishmi, ajo rikujton Louman-in, modelet katolike të të cilit i kishin shqiptuar qartë (u:e) – në ato raste ku muslimanët kanë shqiptuar (u:).

Porse, përveç veçorive konservative, Desnickaja në të folmen e katolikëve të Shkodrës dallon edhe inovacione. Pjesërisht, pohon ajo, në shqiptimin e një vagu të bashkëtingëlloreve del qartë në shesh tendenca ndaj velarizimit. Sipas saj, shpesh vërehet përzjerja e fonemave **ll** (l) dhe **dh** (đ). Duke u përpjekur të agumentojë këtë, ajo thekson se shqiptimi i (l) paraqitet në vend të shqiptimit (đ), kurse zëvendësimi i kundër haset më rrallë. Si shembuj ilustrues ajo përmend: ull (ul), ka noll (nol) illnim (ilnim), elle (ele) = let. udhë, ka ndodhë, idhnim, edhe.

Edhe në këtë pikë, Desnickaja tregohet e kujdesshme, sepse, me të drejtë, ka tërhequr vërejtjen se, jo vetëm te të sprovuarit e Louman-it, por edhe në të folmen e të

<sup>13</sup> Fjaluer i Ri i Shcypes. Scutari, 1908.

<sup>14</sup> Desnickaja, vep. e cit., fq. 92.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Desnickaja këtu i referohet: E. Çabej, *Gjon Buzuku*, Bul. Shk. Shoq., 1955, Nr. 2, f.88.

<sup>17</sup> Po aty.

njëjtë njeri, shpeshherë mund të vërehen luhatje. Pak a shumë, të njëjtën brengë ka Hudson, kur thotë se “dy folës nuk kanë kurrë të njëjtën gjuhë, sepse dy folësit nuk kanë të njëjtën përvojë gjuhe”<sup>18</sup>. Prandaj, në “matje” të tilla, gjithmonë duhte të kihet parasysh se dallimet në mes folësve mund të jenë fare të vogla, ashtu siç mund të jenë edhe dallime të plota.

Relativitetin e dallimit dh - ll Desnickaja mundohet ta theksojë edhe me shënimin fonetik të tekstit të përrallës nga Shkodra, të cilin e ka bërë M. Lamberci, e në të cilin, paralelisht me trajtat i mǎli, e mǎle, ilnim (let. i madhi, e madhe, idhnim) gjithashtu hasen edhe trajtat e mǎde, eǎde.

“Mund të supozojmë se përzjerja e plotë e fonemave dh (ǎ) dhe ll (l) prapëseprapë nuk bëhet madje edhe në të folmen e përfaqësuesvet më tipikë të së folmes së vjetër të popullsisë katolike të Shkodrës. Gjatë shqiptimit më të kujdesshëm, zakonisht del në shesh tendenca për shqiptimin e tyre të diferencuar. Kjo gjendje është paraqitur qartë edhe në normën e drejtshkrimit. Mirëpo, ndikimi i tendencës së gjallë fonetike ka qenë dhe është mjaft i fortë. Për këtë arsye, pa marrë parasysh normën ortografike, shqiptim i fonemës (l) në fjalët që kanë fonemën (ǎ) në të kaluarën shpeshherë është fiksuar në tekstet e shtypura, e nganjëherë edhe në trajtat e poetëve të Shkodrës”, shkruan A. V. Desnickaja.

Për ta argumentuar këtë pohim, ajo (në fusnotë) përmend një vjershë të Ndre Zadëjës, në të cilën vargjet rimohen me trajta të tilla fjalësh, si: hollë dhe ndollë (ndodhë), sollë dhe ndollë (ndodhnë) (Leka, 2934, f. 12.). Mbase, Desnickaja, në atë kohë, nuk ka mundur ta përmendë Fishtë, por kjo dukuri ka qenë e pranishme edhe në krijimet e tij, duke e përfshirë edhe *Lahutën e Malcís*.

Po ashtu, do theksuar se Desnickaja mendon se me tendencën e të kthyerit të ǎ>l është e lidhur ngushtë edhe tendenca e tërheqjes prapa dhe e labializimit të zanores së gjatë *ǎ*. Shembujt e cituar nga teksti i përrallës në shënimin e Lambercit, i mǎli (let. i madhi), e mǎle (let. e madhe), sipas saj, janë shembuj tipikë të së folmes së gjallë të popullsisë katolike të Shkodrës. Po në këtë tekst, ajo veçon edhe trajtat: kalǎja (let. kalaja), mǎre (let. mbarë) etj.

Këtë tip shqiptimi ajo thotë se e ka ndeshur edhe në qarqet e arsimuara shkodrane, në rrethin e intelektualëve të këtij qyteti, të cilët “që disa vite jetojnë në Tiranë” dhe “kryesisht përdorin norma toske apo gege të të folmes gojore letrare”.

“Gjertani, labializimi i zanores *ǎ* të gjatë, përveç tendencës ndaj përzjerjes së fonemave dh (ǎ) dhe ll (l) është veçori më karakteristike e të folmes së posaçme që rrjedh prej rrethit katolik të qytetit të Shkodrës dhe të rrethit të saj. Në të folmen e popullsisë muslimane të këtyre vendeve, tendencat e përmendura nuk çfaqen me një intensitet të tillë. Sipas të gjitha gjasave, faktor i qëndrueshëm këtu ka qenë ndikimi i gjatë dhe i fortë i koinesë bashkëbiseduese gege të jugut, që është përhapur në veri që

<sup>18</sup> Hudson, vep. cit., fq. 21.

në periudhën e sundimit turk dhe, si duket, ka përcaktuar tipin e përgjithshëm të të folmes së muslimanëve të Shkodrës”, vlerëson Desnickaja.

Për ta përmbyllur këtë vështrim, po theksojmë atë që në gjuhësinë moderne merret botërisht si fakt i mirëqenë: *të gjitha gjuhët i janë nënshtruar një ndryshimi të pandërprerë* (J. Lyons). Këto ndryshime ndonjëherë mund të shpjegohen me një radhë faktorësh, ndonjëherë këta faktorë mund të mbeten vetëm pjesërisht të kuptuar.

“Të gjitha gjuhët e gjalla, kështu mendohet, në thelb, janë sisteme komunikimi për veprim dhe zhvillim në shërbim të nevojave të ndryshme dhe të larmishme të bashkësive që i përdorin ato. Me ndryshimin e këtyre nevojave priret edhe gjuha të ndryshojë, për t’iu përgjigjur kushteve të reja”<sup>19</sup>, shkruan John Lyons.

Nuk shohim ndonjë arsye që të shihen prej ndonjë prizmi tjetër as ndryshimet e shqipes, ndryshimet dialektore e nëndialekore të saj. Këto ndryshime shpeshherë janë nxitur nga faktorë jashtëgjuhësorë. Edhe ndryshimet e dy të folmeve/bashkësive gjuhësore të Shkodrës duket se “u motivuan” nga ndryshimet sociale e shpirtërore të banorëve të saj pas pushtimit turk. Si kudo që kanë ndodhur shkundullima të tilla!

---

<sup>19</sup> John Lyons, *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, ShB “Dituria”, Tiranë, 2001, fq. 55.

**Asllan HAMITI**

## **SHQIPJA NË DY FJALORËT SHUMËGJUHËSH TË GJORGJI PULEVSKIT**

Studimet filologjike zënë vend të posaçëm në albanologji. Deri më tani është shkruar për gjuhën e shumë shkrimtarëve tanë të traditës. Megjithkëtë edhe më tej duhet vazhduar studimi dhe analiza e teksteve të shkruara. Rezultatet e arritura do të ishin dobiprurëse dhe do të ndriçonin shumë çështje të historisë së gjuhës së shkruar, zhvillimit të dialekteve dhe do të ishin të vlefshme për kulturën tonë në përgjithësi. Puna e tillë do të japë rezultate shumëdimensionale, veçmas kur kihet parasysh se shqipja është gjuhë e folur shumë herët, por mjerisht vonë e dokumentuar.<sup>1</sup>

Duke u nisur nga kjo pikëpamje, qëllimi ynë është të ndriçojmë një shqipe të shkruar të shekullit XIX.

Gjorgji, emrin e të cilit e gjejmë të shënuar në disa variante: Gjorgjo, Gjorgjija, Gjorgje, Gjergj dhe me mbiemrin Pulevski e Pula u lind në fshatin Galicnik, Rekën e Vogël të Dibrës (1838-1895)<sup>2</sup>. Ai qe autodidakt, murator, por la gjurmë si leksikograf. Hartoi dy fjalorë shumëgjuhësh: a) Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht – shqip – turqisht, greqisht, Beograd, 1873; dhe b) Fjalor bisedimor trigjuhësh: maqedonisht – shqip – turqisht, Beograd, 1875.

Si vepra të shkruara në shekullin XIX këta fjalorë kanë rëndësi të madhe për të vëzhguar zhvillimin historik të gjuhëve të përfaqësuara në fjalorin katërgjuhësh e në fjalorin tregjuhësh. Nga ana tjetër, teksti i fjalorëve siguron material të vlefshëm për të parë ndikimin ndërghjuhësor të gjuhëve ballkanike në takim, përkatësisht të shqipes, maqedonishtes, turqishtes e greqishtes.

Për gjuhën e Pulevskit kanë shkruar disa gjuhëtarë, si Bllazhe Koneski, Bllazhe Ristovski, Harallampie Polenaković, Trajko Stamatovski, Tome Szadov, Vesna Matijasheviq, Olivera Jashar – Nasteva, Viktor Fridman, Imri Badallaj, autori i këtij artikulli<sup>3</sup> etj. Materiali i dy Fjalorëve është shfrytëzuar në punimin e Aleksandër Beliqit

---

<sup>1</sup> Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 8.

<sup>2</sup> Bla`e Ristovski, *\or\ija M. Pulevski*, Odbrani stranici, Makedonska kniga, Skopje, 1974, f. 5.

<sup>3</sup> Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005, 220 f.

“Dialekti i Galiçnikut”, Beograd, 1935, por ai mund të shfrytëzohet edhe për shumë çështje të tjera gjuhësore, kulturore e historike.

Vëzhgimin tonë filologjik të paraleles shqipe të fjalorëve të Pulevskit e kemi mbështetur mbi botimin në origjinal të të dy fjalorëve, në studimet dhe punimet kushtuar këtij autori si edhe në punime dialektore për të folmen e Dibrës dhe të folmet e tjera përreth.<sup>4</sup>

Vetëdija për përkatësinë kombëtare të banorët e Rekës ka qenë dhe ende është mjaft e zbehur. Duke u mbështetur në të dhënat për jetën dhe veprimtarinë e tij, pavarësisht nga etnogjeneza, Pulevski nuk e ndjeu veten shqiptar. Lindi dhe vetëm fëmijërinë e hershme (deri në moshën kur kishte shtatë vjet) e kaloi në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesën tjetër të jetës e kaloi në kurbet, përkatësisht në Rumanë (në vendin e quajtur Turno-Mogurell), Serbi (Beograd) e Bullgari (Sofje). Ai mori pjesë në disa luftëra e kryengritje serbe, bullgare e maqedonase kundër perandorisë osmane (në anën e rusëve në luftën ruso-turke (1877/78, mori pjesë në kryengritjen e Kresnenit në Maqedoninë Lindore, që u bë në tetor të vitit 1878, në vitin 1878 ishte prefekt i Qustendillit, në shoqërinë letrare sllavo-maqedonase (“Славјанско-Македонска книжевна дружина”) me seli në Sofje në vitin 1888 Pulevski ushtroi detyrën e kryetarit, vdiq dhe u varros në Sofje (1895).

Fjalorët në shqyrtim dallohen mjaft njëri nga tjetri si në strukturë, ashtu edhe në metodën e mbarështrimit, në grafë etj. Fjalorin katërgjuhësh mund ta quajmë në një mënyrë si fjalor të mirëfilltë. Në kolonën e parë janë shënuar fjalët në maqedonisht e pastaj në kolonat gjegjëse për gjuhët e tjera është dhënë fjala e përkthyer. Këtu nuk kemi fare të dhëna për përkatësinë gramatikore të fjalës, as për shumëkuptimësinë e fjalëve, figurshmërinë e tyre, fushat e përdorimit etj., por janë dhënë vetëm fjalët pa shënuar asgjë pas tyre.

Fjalori katërgjuhësh ka mbi 2500 (2.560) fjalë e shprehje shqipe, por duke marrë parasysh se ka raste kur një fjalë e vetme na paraqitet me forma të ndryshme, ky fond fjalësh është më i vogël. Ky fjalor ka 98 faqe të formatit 14 x 17 cm. Fjalori është i ndarë në 74 çerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme. Fjalori tregjuhësh (Fjalor nka tre g-juha) është i formatit 14 x 20 cm me gjithsej 162 faqe tekst të shkruar me pyetje-përgjigje në tri kolona: maqedonisht, shqip dhe turqisht me fjali e periudha të tëra.

<sup>4</sup> “**Re~nik отъ ~etiri jezika:** I. Srpsko-Albanski. II. Arbanski-Arnautski. III. Turski. IV. Gr~ki. Skrojena i napisana отъ Ћорѓа М. Пуљвски, архитекта у Гали~никъ, окру`је дibransко, 1872 godine. I-va ~astъ. Beogradъ. Шtamparия N. Stefanoviha i Dru`ine, 1873” dhe “**Re~nik od tri jezika:** S. Makedonski, Arbanski i Turski. Kwiga II. Napisao Ћorѓe M. Pulevski, mijak gaqi~ki. U Beograd, u dr`avnoj {tampariji, 1875”. Të dy fjalorët gjenden në Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Shkupit me siglat: Fjalori katërgjuhësh – R II-1501/I, ndërsa Fjalori tregjuhësh – R II-1501/II dbl.



Alfabeti që e përdori Pulevski qe fonematik i plotësuar me alfabetin rrokjesor. Përgjithësisht mund të thuhet se fjalët i shkroi sipas parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhet ashtu siç shqiptohen dhe lexohen ashtu siç shkruhen. Në shkrim, siç dihet, fonemën e përfaqëson grafema, andaj në këtë vëzhgim gjuhësor do të flitet për grafinë e Pulevskit. Përgjithësisht, me një shkronjë Pulevski ka shkruar një fonemë, ka edhe dyshkronjësha si dhe ndonjëherë me një shkronjë ka paraqitur një rrokje (sipas rusishtes e bullgarishtes).

Sistemi grafik i teksteve të Pulevskit, si edhe gjuha e tij, dallohet nga teksti në tekst dhe nuk është i njëjtë. Grafia e dy Fjalorëve të botuar në Beograd dallon nga grafia e teksteve të tjera të botuara në Sofje. Edhe dy fjalorët e Pulevskit botuar në Beograd në dallim kohor vetëm për dy vjet (Fjalori I më 1873, ndërsa Fjalori II më 1875) dallohen mjaft edhe në grafë. Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional (me shkronja serbe-ruse-sllave), ndërsa në Fjalorin tregjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit. Për shkrimin e të gjitha paraleleve gjuhësore të fjalorëve, d.m.th. në maqedonisht, shqip, greqisht e turqisht është përdorur i njëjti alfabet.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për grafinë e Pulevskit, më poshtë po paraqesim dy alfabetet, të fjalorit I dhe të Fjalorit II:

Alfabeti i Fjalorit katërgjuhësh:

Alfabet fonetik							
A a	B b	C c	Ч ~	D d	E e	Б (б)	F f
G g	Ђ ђ	H h	I i	J j	K k	L l	Л л
M m	N n	O o	P p	Ћ ћ	R r	S s	[ {
T t	Ѡ ѡ	U u	V v	X x	Z z	@ `	
Alfabet rrokjesor							
Ђ	Я я	Ю ю	Ы ы				

Alfabeti i Fjalorit trigjuhësh:

Alfabet fonetik							
A a	B b	C c	Ч ~	D d	E e	-	F f
G g	Ђ ђ	H h	I i	J j	K k	Q q	L l
M m	N n	O o	P p	Ћ ћ	R r	S s	{
T t	Ѡ ѡ	U u	V v	X x	Z z	@ `	
Alfabet rrokjesor							
Je je	Ja ja	Ju ju	Ji ji				

Nga këto dy tabela të alfabeveve, mund të shihet se pjesa më e madhe e shkronjave është e njëjtë në të dy Fjalorët. Numri i shkronjave në paralelen shqipe në të dy Fjalorët është e njëjtë – 35 shkronja, me dallim që në Fjalorin I përdor edhe një shkronjë më tepër, siç e quajnë në gjuhët sllave “erin e madh” <ь>, por pa ndonjë vlerë fonematike.

### **Veçoritë kryesore fonologjike e fonetike të tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit janë:**

1. *Dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve.* Zanoret e shkurtra dhe të mesmet i regjistron vetëm me një shkronjë, ndërsa të gjatat, marrë në tërësi, me dyzimin e po të njëjtave shkronja.

2. *Inventar fonemash pa zanore hundore.* - Duke u mbështetur në kundërvëniet me vlerë fonologjike të shkallës së gjatësisë së fonemave zanore (të shkurtra ~ të gjata), pa serinë e fonemave hundore (nga se nuk i ka), mund të pohojmë se shqipja e Fjalorëve të Pulevskit në rrokje të theksuar ka gjithsej 12 fonema zanore: /a/, /a:/, /u/, /u:/, /e/, /e:/, /o/, /o:/, /i/, /i:/, /Y/ dhe /ë/. Analiza e tekstit shqip të këtyre Fjalorëve na nxori 26 fonema bashkëtingëllore. (Në krahasim me shqipen standarde këtu mungojnë paragjuhuria afrikate e zhurmët [x], sonorja shumëdridhëse [rr] dhe laringalja [h]).

3. *Zanorja [ë].* - Siç dihet në të folmet e gegërishtes [ë]-ja është e paqëndrueshme: ajo nuk përdoret asnjëherë në rrokje të theksuar dhe nuk bën pjesë në inventarin e fonemave zanore, d.m.th. në të folmet geqe ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës. Mirëpo, te shkrimi i shqipes në fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë jemi të mendimit se ekzistojnë pak shembuj të ruajtjes së kësaj zanoreje edhe në pozitë fundore.

4. *Buzorëzimi i zanores [ë] në [o].* - Te Pulevski vërejtëm disa raste buzorëzimi të [ë] > [o]: *numor* (< numër) I 9, *pollomba* (< pëllëmba) I 24, *thongjill* (< thëngjill) I 38, *këpucar* (< këpucar) I 55, *fomei* (< fëmijë) II 155, *tono* (< tonë) II 70 e 74 dhe ndonjë rast tjetër.

5. *Buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o].* - Në fjalët si *nona* < nana, *bojet* < bahet II 87, *bona* < hana, *bone* < bane etj. [a]-ja hundore, dikur e mbarë gegërishtes, buzorëzohet aq shumë sa që në fjalorët e Pulevskit është shndërruar plotësisht në zanoren e buzorëzuar [o].

6. *Qiellzorëzimi i [ë]-së në [i].* - Zanoren gjysmë të hapur të radhës së mesme [ë] në rrokje të patheksuar në disa raste e gjejmë të qiellzorëzuar.

7. *Rënia e [ë]-së para zanoreve [r, l, ll, m, n, nj].* - Përpos rasteve (që shënuam) të ruajtjes së zanores [ë] para bashkëtingëlloreve tingëlloese, mjaft e shpeshtë është dukuria e rënies së kësaj zanoreje në pozitë para sonanteve.

8. *Diftongimi dytësor i zanoreve të theksuara [i] dhe [u].* - Shpërbërja e [i]-së dhe e [u]-së së theksuar në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit është dukuri fonetike mjaft e

shpesh të, që është karakteristik për tërë krahinën e principatës së Kastriotëve, përkatësisht grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore.

9. *Monoftongimi i grupzanoshit [ue] ose [ua] në [u:]*. – Grupi vokalik [ue] është monoftonguar në [u:] të gjatë dhe si i tillë në pak raste është ruajtur në Fjalorët e Pulevskit., si *du:l* (< dolì) I 15, II 70; *bu:ll* (< buell, buall) I 41, *kapru:ll* (< kapruell) I 47, *shkru:r* (< shkruar) I 61, *besu:* (< besue, besuar) I 68, *i kullu:m* (< i kulluem, i kulluar) I 90 etj. Këto janë raste të rralla ku [u]-ja e theksuar i ka përballuar risisë diftonguese.

10. *Prania jo e vogël e togut zanor [ua]*. – Togun vokalik [ua] e kemi hasur në disa fjalë në shqipen e fjalorëve të Pulevskit.

11. *Ka forma të rotacizuara*. – Krahas formave të fjalëve me [n] ndërzanore, kur dihet se fjalorët janë shkruar në dialektin e gegërishtes: *pruna* I 68, *i pasun* I 69, *xhulpan* I 88, *barna* II 6 etj., ka edhe një numër të konsiderueshëm fjalësh në formë të rotacizuar, si bie fjala: *egërsira* II 9, *ature* (atyre) II 13, 15; *i varfër*, *vllazër* II 67, *verë* (pëje), *diturija* I 59, I 88; *breshër* II 88, si dhe në pjesoret toske *shitur* I 88, *shtrirë* I 72, *shkurtuar*, *çiruar* I 72; *mbledbur*, *zbuluar*, *grisur* I 71, *gëzuar* I 59, *shitur* I 88 etj.

12. *Zhbuzorëzimi i [y]-së në [i]*. – Zanorja e përparme e mbyllur [y] në të shumtën e rasteve është zhbuzorëzuar në [i]: *tlin* < tëlin < tëlien < tëlyen I 39, *brim* < brymë, *fill* < fyell I 57 etj.

13. *Shpërbërja dytësore e [y]-së në [ëi] dhe rrallëherë në [ei]*. – Te një numër i konsiderueshëm fjalësh [y]-ja e theksuar, përveç që është zhbuzorëzuar në [i], ajo pastaj ka evoluar edhe më tej dhe, sipas rrethanave fonetike, është diftonguar në [ëi]: *fëit* < fit < fyt, *frëim* < frim < frymë, *sëi* < si < sy etj.

14. *Shndërrimi i [y]-së në [u]*. – [Y]-ja e mbarë shqipes në fjalorët e Pulevskit në pak raste ka evoluar në [u], si te *shut* < shyt I 42, *çush* < çysh II 71, *kryqa* < kryqa II 73, *nryshe* < ndryshe II 72 e në ndonjë fjalë tjetër.

15. *Përdorimi i një [y]-je më pak buzore se e rëndomta*. – Përveç shumë zhvillimeve të larmishme që ka pësuar zanorja [y] në shqipen e shkruar të fjalorëve të Pulevskit, na ra në sy edhe përdorimi i një [y]-je më pak buzore se ajo e rëndomta, të cilën e ndeshim të shkruar me kombinimin e shkronjave <ui>, ne do ta shënojmë me [Y].

16. *Përdorimi i grupit [vo] në fillim të fjalës*. – Në fjalorët e Pulës e kemi hasur grupin [vo] në fillim të fjalëve, që është karakteristik për dialektin verior të shqipes.

17. *Togzanori [ie] është monoftonguar në [i:]*. – Për ta përdëftuar këtë dukuri fonetike po mjaftohemi të sjellim dy shembuj të shënuar nga dy herë: *dilli* (< dielli) I 91 dhe II 70; *çilli* (< qielli) I faqe 11 dhe faqe 14.

18. *Afrikatizimi i qiellzoreve [q, gj] në [ç, xh]*. – Sipas gjendjes faktike, fjalorët e Pulevskit karakterizohen me praninë e dy çifteve bashkëtingëlloresh: bashkëtingëllore qiellzore ~ bashkëtingëllore afrikate, por shpeshherë dallimi i tyre nuk del i qartë, d.m.th. bëhet përzjerja e tyre në të shkruar.

19. *Humbja e kundërvënies fonologjike e fonemave /r/ ~ /rr/*. – Në të folmen e Dibrës si dhe në shqipen e fjalorëve të Pulevskit nga sistemi bashkëtingëllor është zhdukur shumëdridhësja /rr/ dhe vendin e saj e ka zënë dridhësja simotër /r/ në të gjitha pozicionet e fjalës

20. *Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd], [ng] me pak përjashtime*. – Përgjithësisht, mund të themi se në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] janë ruajtur të papërngjashmuara.

21. *Përdorimi i rrallë i mesgjuhores [j]*. – Bashkëtingëllorja mesgjuhore sonante shtegore [j] në shqipen e dy fjalorëve për të cilët jemi duke bërë fjalë përdoret mjaft rrallë, krahasuar me dendurinë e përdorimit të rëndomtë në gjuhën e sotme shqipe, po edhe me dendurinë relativisht të madhe të saj në të folmet shqipe.

22. *Grupet e vjetra konsonantike [k], [g] kanë evoluar në [q] e [g]*.

23. *Grupet e bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] janë paraqitur në variante të ndryshme*. – Grupin e parë konsonantik e gjejmë të shënuar në dy forma: [pl] dhe [pj], ndërsa grupi [bl] në fjalorët e Gjergjit del si [bj]. Edhe [fl]-ja në fjalorët në vështrim ka dhënë [f].

24. *Qiellzorëzimi i grupeve [tj] > [q] dhe [dj] > [g]*.

25. *Qiellzorëzimi i [g]-së në [g] në disa raste*.

26. *Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore*.

27. *Rënia e bashkëtingëllores glotale shtegore të shurdhët [h]*.

28. *Ruajtja e grupit bashkëtingëllor [fsh]*. 29. *Shndërrimi [th] > [f]*.

30. *Këmbimi [f] > [v]*.

31. *Zëvendësimi [h] > [f]*.

32. *Metateza*. – Kjo dukuri fonetike, e ndërrimit të tingujve ose të rrokjeve brenda fjalës, në shqipen e fjalorëve të Pulevskit është e shpeshtë.

33. *Përngjashmimi*. – Dukuria e përngjashmimit të tingujve është e shpeshtë në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit. Vërehet asimilimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve, por më i shpeshtë është përngjashmimi i zanoreve, sidomos asimilimi i plotë në largësi.

34. *Përngjitja*. – Dukuria e përngjitjes ka një përhapje të madhe në shqipen e fjalorëve në shqyrtim.

35. *Shtimi i tingujve*. – Në tekstin shqip për të cilin po bëjmë fjalë ka një numër fjalësh me tinguj ose fonema të shtuara, të shprehura nëpërmjet grafemave. Kemi hetuar shtimin e tingujve në fillim të fjalës, në mes dhe në fund të fjalës.

36. *Rënia e tingujve*. – Dukuria fonetike e rënies së tingujve në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit është më e shpeshtë sesa shtimi i tingujve. Gjuha e këtij autori i përket stilit të bisedimit dialektor, por edhe ky stil nuk është paraqitur me besnikëri, sepse ai qe autodidakt dhe duket se nuk e ka njohur aq sa duhet strukturën e fjalëve të shqipes.

**Larmia dialektore e shqipes së fjalorëve.** - Gjatë shtjellimit të grafisë si dhe veçorive fonologjike e fonetike të paraleles shqipe të dy fjalorëve shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit na dolën në shesh një numër i madh veçorish gjuhësore që e karakterizojnë tekstin shqip në spikamë.

Për të nxjerrë përfundime të drejta vlejnë të përmenden disa fakte nga jeta dhe veprimtaria e Gjergjit. Kështu, nga shkrimet shqipe që ka lënë trashëgim, mund të konstatohet se Pulevski nuk e ka njohur mirë as edhe ligjërimin dialektor të shqipes. Ishte autodidakt dhe sipas gjithë gjasash pa njohuri për traditën e shkrimit të letrave shqipe. U end mjaft dhe nuk qëndroi për një kohë të gjatë as në vendlindje e as në ndonjë vendbanim tjetër. I ati e mori me vete në Rumani qysh kur Gjergji kishte vetëm shtatë vjet. Pati kontakt me shumë individë, pjesëtarë të të folmeve të ndryshme të shqipes. Njohu disa gjuhë ballkanike dhe tek ai u reflektua dukuria e ndërndikimit gjuhësor.

Nga jetëshkrimi për Pulevskin gjetëm mbështetje dhe arsyetim të tipareve dialektore të gjuhës së tij. Përgjithësisht, gjuha e Pulevskit është mjaft e larmishme nga aspekti dialektor. Duke e krahasuar shqipen e shkruar në Fjalorin Katërgjuhësh si dhe në Fjalorin Tregjuhësh me studimet dialektore për disa të folme shqipe, të përafërta me gjuhën e fjalorëve në shqyrtim, kemi arritur në përfundim se:

a) Bazën dialektore të gjuhës së Pulevskit e përbën e folmja e vendlindjes së tij (e folmja e Rekës së Dibrës). Këtë e dëshmojnë, si bie fjala, mospërdorimi i fonemës /y/, përkatësisht zhbuzorëzimi i saj në /i/ dhe diftongimi dytësor i saj; shpërbërja dytësore e zanores së theksuar [i] në [ëi] dhe e [u]-së në [ou]; mosshqiptimi i ndërthunshëm i zanoreve që gjenden ose janë gjetur pranë bashkëtingëlloreve hundore; dallimi i gjatësisë së zanoreve: në zanore të shkurtra e të mesme kundrejt zanoreve të gjata; rënia e laringales [h] në të gjitha pozitat e fjalës; defonologjizimi i kundërvënies ndërmjet çiftit të tingëllueseve dridhëse /r/ e /rr/; mosafrikatizimi i qiellzoreve [q, gj]; ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] përgjithësisht të parrëguara; qiellzorëzimi i shpeshtë i prapagjuhores [g] në [gj]; mbizotërimi i zhvillimit të grupeve [pl, bl, fl] në [pj, bj, fj]; qiellzorëzimi i grupeve të vjetra konsonantike [kl, gl] në [q, gj] dhe mosafrikatizimi i tyre etj.

b) Prania e një numri të konsiderueshëm veçorish gjuhësore tipike për toskërishten, si: përdorimi i /ë/-së në rrokje të theksuar; rotacizmi, shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore të fjalës; shquarsia e emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret [k, g, h] me mbaresën -u; e pakryera asigmatike e foljeve në formën veprorë; përdorimi i lidhores e jo i paskajores gege, përdorimi i pjesoreve të toskërishtes si dhe shumë veçori të tjera.

c) në tekstet shqip të fjalorëve të Pulevskit aty-këtu hetohen edhe disa tipare të të folmeve të tjera të gegërishtes (e jo të të folmes së qarkut të Dibrës), veçmas të të

folmeve të rrethit të Gostivarit e të Kërçovës, të cilat për nga sasia janë më të pakta. Zaten, shpeshherë vërehen veçori që janë karakteristike për grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore si dhe për disa grupe të tjera të folmesh, si p.sh. buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o]; monoftongimi i grupit [ue] në [u:], afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhore [q, g] në [ç, xh]; përngjashmimi i rrallë i grupeve [mb, nd, ng] në [m, n, g e k]; qiellzorëzimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [tj] > [q] e [dj] > [g] etj.

Në bazë të vëzhgimit filologjik, përmbledhtas, mund të themi se shqipen e fjalësve të Pulevskit e karakterizojnë:

a) *tipare fonetike e fonologjike, morfologjike e leksikore të të folmes së qarkut të Dibrës, të cilat mbizotërojnë;*

b) *tipare dialektore të të folmeve të tjera geqe, që bashkëpërkojnë veçmas me të folmen e Gostivarit e të Kërçovës;*

c) *veçori dialektore të toskërishtes, dhe*

ç) *kalke, huazime e krijime fjalësh artificiale që nuk përkojnë me asnjë të folme shqipe.*

Një karakteristikë e përgjithshme e gjuhës shqipe të paraqitur në fjalorët nga autori në fjalë është konstatimi se ligjërimi shqip i Pulevskit është mjaft i ndikuar nga gjuhët sllave.

Format morfologjike të fjalëve në të dy fjalorët gjykojmë se nuk paraqesin ndonjë interes e as që kanë rëndësi të madhe për gramatikën e gjuhës shqipe, as për dialektologjinë historike të shqipes e as për historinë e gjuhës shqipe, përkatësisht për morfologjinë historike të shqipes. Kësaj mund t'i shtojmë edhe faktin se në përgjithësi veçoritë dalluese në rrafshin dialektor janë më të mëdha në fushën e fonetikës e të fonologjisë sesa në morfologji.

Posa të mënjanohen gabimet e shumta e të rënda në format morfologjike të fjalëve shqipe, do të vërehet se baza morfologjike e gjuhës së tij është e folmja e vendlindjes, përkatësisht e folmja e Rekës së Dibrës.

Në lidhje me format rasore mund të themi se përdorimi i rasave në shqipen e fjalorëve në vështrim është shumë i pavend, saqë nuk kemi mundur të nxjerrim ndonjë sistem apo rregull për të parë mënyrën e përdorimit të tyre.

Në gjuhën e shkruar shqipe të Pulevskit kjo kategoria morfologjike e foljes na del e koklavitur, meqë autori nuk e ka njohur në thelb sistemin morfologjik të shqipes. Gabime janë bërë si në vetë, numër, kohë, diatezë, zgjedhim etj. Përgjithësisht, fjalorët janë shkruar në mënyrën dëftore. Përdorim më të madh gjejnë koha e tashme, koha e pakryer, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe koha e ardhme.

Përgjithësisht mund të thuhet se shqipja e fjalorëve të Pulevskit është një “amalgamë gjuhësore artificiale”: një gjuhë popullore joautentike, një stil që dëshmon nivelin e ulët të njohjes së natyrës së shqipes, me përzierje të shqipes territoriale, me

shumë ndikime të huaja joreale, pa ndarje morfologjike në shkrimin e fjalëve, përplot me kalke e krijime artificiale të autorit etj.

Duke pasur para vetes një përfaqësim të tillë të dobët të shqipes së një autodidakti, me grafi jokonsekuente e pa kritere të caktuara gjuhësore, kuptohet se e kishim mjaft të vështirë të gjejmë rregulla të përgjithshme për tërë sistemin gjuhësor të shqipes së fjalorëve. Megjithatë, jemi përpjekur të nxjerrim dhe t'i njoftojmë të interesuarit shqiptarë me tiparet kryesore të variantit shqip të të dy Fjalorëve.

Përkthimi, sintaksa dhe leksiku i fjalësve të Pulës mund të jetë edhe temë shqyrtimi më vete, ngase siç dihet, autori ka qenë njohës i disa gjuhëve sllave e joslave dhe nuk ka mundur t'i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi të ky na del shumë qartë në shesh dukuria e ndikimit ndërgjuhësor. Prandaj, kjo temë sociolinguistike është me interes të trajtohet. Dukuria e interferencës gjuhësore të individët shumëgjuhësorë është e njohur në gjuhësinë e zbatuar. Ne me këtë rast do të përpiqemi t'i vijëzohet veçoritë themelore të përkthimit, sintaksës si dhe të leksikut të idiolektit shqip të Pulevskit.

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit në gjuhën sllave. Por, megjithëkëtë, fund e krye fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam), që e dëmtoi shumë tekstin shqip të fjalorëve. Kështu, Pulevski krijoi trajta e konstruktive të pamundshme në shqipe. Për mosnjohjen e natyrës së shqipes si dhe bastardimin e saj nga ana e autorit dëshmojnë mjaft qartë edhe përkthimi i disa përhëndetjeve dhe i shprehjeve përhëndetëse në faqet 75-78 të Fjalorit katërgjuhësh. Ka fjali ku edhe kuptimi (semantika) i tyre është mjaft i errët. Sasia e çrregullimeve semantike, përveç pëshëllimeve të tjera të shumta gjuhësore (fonetike, fonologjike, morfologjike, sintaksore) është shumë e madhe, zaten e kanë përfshirë tërë idiolektin shqip të Pulevskit.

Si njohës i përciptë i disa gjuhëve, si duket, Pulevski me belbëzimin e tij në shqipe është shembull tipik i përzierjes gjuhësore. Në këtë pikëpamje, shumë gjurmë të gjuhëve sllave shihen në gjuhën e shkruar shqipe të këtij autori; gjurmë të shqipes në idiolektin e sllavishtes së tij, por edhe gjurmë të greqishtes e të turqishtes në dy gjuhët e përmendura. Praktikisht, gjuha e Pulës është **një amalgamë gjuhësore sllave - shqipe - greke - turke**. Kjo përzierje gjuhësore vërehet në të gjitha rrafshet, si në fonetikë e fonologji, morfologji, leksik e sintaksë. Nuk është i vogël edhe ndikimi sintaksor i shqipes në paralelen e shkruar të maqedonishtes.

Në bazë të studimeve gjuhësore është përdëftuar se forma më e shpejtë dhe më masive e ndikimit ndërgjuhësor është huazimi leksikor. Kështu, edhe në fjalorët e Gjergjit, në ndikimet ndërgjuhësore që janë pasojë e plurilinguizmit individual të autorit, në të gjitha rrafshet, padyshim leksiku zë një vend mjaft të rëndësishëm. Aty do të gjejmë një numër të madh fjalësh që janë të përbashkëta për shqipen, maqedonishten,

turqishten e greqishten si dhe për gjuhët e tjera ballkanike; pastaj huazime leksikore sllave në gjuhën shqipe, albanizma në paralelen e maqedonishtes, orientalizma e greqizma në shqipen e sllavishten etj. Në gjuhën shqipe të fjalorëve të Pulevskit ka një numër të konsiderueshëm huazimesh leksikore orientale. Përgjithësisht, mund të thuhet se pjesa më e madhe e këtyre orientalizmeve edhe sot e kësaj dite përdoren në të folmen e Dibrës e më gjerë, por këta dy fjalorë nuk janë shumë të vërsuar me orientalizma. Ndonjë prej tyre tani më ka kaluar në leksikon pasiv të shqipes dhe janë historizma.

Ndikimet ndërgjuhësore të gjuhëve në kontakt nuk bëhet vetëm në njërën kahje. Nga kjo rrjedh se edhe shqipja ka ndikuar në leksikon e sllavishtes së Pulevskit. Do t'i regjistrojmë disa albanizma që kemi mundur t'i hetojmë në paralelen e maqedonishtes së fjalorëve të Pulevskit: *farosh* (enë ku ruhen farat) I 34; *specare* (enë ku ruhet biberi i specave) I 35, *vatra* I 38, *lopar* (bari lopësh), *plluk*, *pllug* I 57; *lesh*, *lesha*, *leshi* I 49, *përç* II 93, *buçi*, *buçët* II 37, *kokar* (ndoshta nga kokërr ose kokë, meqë qepujka del në kokë, në krye të qepës, qepujkë) etj.

Edhe greqishtja merr pjesë në interferencën gjuhësore të gjuhëve të përfaqësuara në fjalorët e Gjergjit. Për greqizma i kemi konsideruar fjalët *metron* (matë, peshon) II 16, *gjoll* (liqen) II 18, *as*, *aspër* (para, monedhë) II 28, *kalloj* I 25; *pras*, *praz* I 50, *daskall* (mësues) I 59 etj.

Pas gjithë kësaj që u tha, do përmendur se huazimet leksikore përbëjnë një nga veçoritë leksikore të gjuhës së fjalorëve të Pulevskit. Megjithëkëtë, karakteristikë kryesore e leksikut të shqipes së fjalorëve të tij është ajo se autori për nevojat e përkthimit më tepër krijoi fjalë të reja (neologjizma) sesa që huazoi.

Edhe përkundër faktit se fondi leksikor i fjalësve të këtij autori është mjaft i varfër, Pulevski nuk diti të shfrytëzojë pasurinë e madhe e të pashtershme të fjalëve shqipe. Ai për nevojat e përkthimit ndonjë fjalë e ka përdorur me vend, por shpeshherë krijoi edhe shumë fjalë të tjera në mënyrë artificiale: disa nga to janë kalke, disa krijim i paqëlluar i autorit me brumë të shqipes, shpeshherë emërzoj folje etj. Përgjithësisht, edhe fusha e leksikut, si edhe e rrafshëve të tjera gjuhësore pasqyrojnë gjuhën e një individi. Ajo nuk e paraqet me besnikëri shqipen e folur të shekullit XIX në anët e Maqedonisë perëndimore. Megjithë shumë përshtjellime, gabime e paqartësi që ka gjuha e këtij autori, ajo mbështetet në të folmen e Dibrës dhe të qarkut të saj.

Tipar tjetër i leksikut të shqipes së fjalorëve të Pulës është edhe përdorimi i herëpashershëm i sinonimeve për të shpjeguar e qartësuar më mirë fjalët. Kjo mund të konsiderohet edhe si përpjekje e autorit për t'i kapërcyer kufijtë vendorë dhe vepra të ketë karakter më të përgjithshëm e përdorim më të gjerë.

Dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, vështruar në tërësinë e trashëgimisë tonë leksikografike, edhe pse nuk meritojnë të zënë ndonjë vend qendror, por për periudhën kohore në të cilën u botuan, meritojnë të përmenden në kuadrin e fjalorëve



shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen në historinë e leksikografisë shqiptare. Vështruar në retrospektivën kohore, fjalorët patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm (por jo autentik) për të parë ndikimet ndërgjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike. Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për shkencën albanologjike, veçmas për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.

## Bibliografia

1. Basha, Naim: *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.
2. Berani, Shaqir: *Gjuba e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988.
3. Fridman, Viktor: *Gjorgji Pulevski, fjalorët e tij dhe Rilindjet kombëtare Shqiptare e Maqedone*, Konferenca për 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, Prishtinë, 1978.
4. Pulevski, \or|i: "Re~nik otb ~etiri jezika: I. Srpsko-Albanski. II.
5. *Arbanski-Arnautski. III. Turski. IV. Gr~ki*. Skrojena i napisana otb Ћorђa M. Pulvski, arhitekta u Gali~nikъ, okru`je dibransko, 1872 godine. I-va ~astъ. Beogradъ. [tamparija N. Stefanoviha i Dru`ine, 1873]" (Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873).
6. Pulevski, \or|i: "Re~nik od tri jezika: S. Makedonski, Arbanski i Turski. Kwiga II. Napisao Ћorђе M. Pulevski, mijak gaqi~ki. U Beograd, u dr`avnoj {tampariji, 1875." (Fjalor tregjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875).
7. Halimi, Mehmet: *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985, f. 273.
8. Hamiti, Asllan: *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.
9. Hamiti, Asllan: *Recipro~noto vlijanie na makedonskiot i albanskiot jazik vo re~nicite na Pulevski*, Makedonskiot jazik vo XIX vek, Shkup, 1995, f. 215-222.
10. Hamiti, Asllan: *Albanskiot jazik vo re~nicite na Pulevski*, Jazicite na
11. po~vata na Makedonija, AShAM, Shkup, 1996, f. 177-185;
12. Hamiti, Asllan: *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000, f. 161-176.
13. Haruni, Sefedin: *E folmja shqipe e Rekës së Epërme*, Shkup, 1998.
14. Janura, Petro: *Zna~ajot na deloto na \or|i Pulevski kako prethodnik*
15. *vo kulturnata prerodba na Albanskiot narod*, Bigorski nau~no-kulturni sobiri, Nau~en sobir I, f. 169-175.
16. Janura, Petro: *Kirilicata vo albanskata pismenost*, Literaturën zbor nr. 6, Shkup, 1969.
17. Koneski, Bla`e: *Za jazikot na Pulevski – grafiski, fonetski i fonolo{ki osobenosti*, Makedonskiot od XIX vek, Kultura, Shkup, 1986, f. 210-223.
18. Koneski, Bla`e: *Bele{ki za Pulevski (jazi~no i kni`evno-istoriski*
19. *prilozì)*, Makedonskiot IX vek, Kultura, Shkup, 1986, f. 224-230;

20. Koneski, Bla`e: *Kon makedonskata prerodba*, Makedonskite u~ebnici od XIX vek, Shkup, 1949, f. 87-97.
21. Koneski, Bla`e: *Makedoniotot \or|i (\or|o) Pulevski*, Kulturen `ivot, Shkup, 1961, VI, nr. 2, f. 25-26.
22. Koneski, Bla`e: *Za makedonskiot literaturen jaz`ik*, Izbrani dela vo sedum knigi. Kultura, Shkup, 1967, f. 253-265.
23. Koneski, Bla`e: *Gramatikata na \. Pulevski*, Makedonski jazik IV, Shkup, 1953, 2, f. 45-47.
24. Koneski, Bla`e: *\or|i Pulevski*, Литературен збор, XXV, libri 2, Shkup, 1954.
25. Koneski, Bla`e: *Istorija na makedonskiot jaz`ik* (Historia e gjuhës maqedonase), Shkup, 1989.
26. Koneski, Bla`e – Nasteva - Ja`ar, Olivera: *Balkanski jaz`i~ni paraleli vo re~nicite na \or|i Pulevski*, Prilozi IX 2, ASHAM, Shkup, 1984, f. 57-63.
27. Lep~eski, D.: *\or|ePulevski*, Kulturen `ivot, Shkup, 1965, viti X, nr. 6, f. 25-27.
28. Matija`evi}, Vesna: *Jaz`ikot na tekstovite na \or|i Pulevski* (punim magjistrature, arkivi i Fakultetit Filologjik “Billazhe Koneski”, Shkup, 1992).
29. Nasteva - Ja`ar, Olivera: *Za re~nicite na Pulevski i albanskata paralela vo niv*, Prilozi (contributions), IX 2, ASHAM, Shkup, 1984, f. 43-56;
30. Nasteva - Ja`ar, Olivera: *Iska`uvavata na \or|i Pulevski za jaz`i~nata situacija vo Makedonija*, Jazicite na po~vata na Makedonija, ASHAM, libri 3, Shkup, 1996, f. 33-51.
- a. Panovski, D.: *\or|ija M. Pulevski*, Literaturni portreti, Razvitok, Manastir, 1975, f. 105-117.
31. Pangovski, T.: *Nov prilog kon izdavaveto na re~nicite na \or|u Pulevski vo Belgrad*, Prosvetno dello, Shkup, 1965, XXI, nr. 7-8, f. 399-404.
32. Ristovski, Bla`e: *\or|ija M. Pulevski*, Odbrani stranici, Makedonska kniga (zgjedhje, redaktim, parathënie dhe shënime), Shkup, 1974.
33. Ristovski, Bla`e: *\or|ija M. Pulevski i negovite kni`eki* “Samovila
34. makedonska” i “Makedonska pesnarka”, Institut za folklor I, Shkup, 1973.
35. Ristovski, Bla`e: *\or|ija M. Pulevski kako poet i folklorist*, “Makedonskata narodna i umetni~ka literatura”, [estti “Racinovi sredbi”, Titov Veles, 1969, f. 70-83.
36. Ristovski, Bla`e: *Prilog kon prou~uvaveto na makedonskite nau~no-literaturni dru`tva i afirmacijata na makedonskata nacionalna i dr`avna misla*, “Razvitok na dr`avnosta na makedonskiot narod”, Shkup, 1966, f. 171-188.
37. Ristovski, Bla`e: *Pojavi i profili od makedonskata kulturna istorija*, pjesa 2, Studentski zbor, Shkup, 1982.

38. Ristovski, Bla`e: *Bele{ki} za Pulevski*, Makedonskiot XIX vek, Jazi~no i kni`evno-istoriski prilozhi, Shkup, 1986, f. 225-230.
39. Ristovski, Bla`e: *Za gramatikata na Pulevski*, Makedonski jazik IV, 1953, nr. 8, f. 188-189.
40. Polenakovih, H.: *Mija~ki leksikograf Torhe M. Pulevski*, Glas Juga,
41. Shkup, 1941, f. 30-32.
42. Stamatovski, Trajko: “*Slognica re~ovska*” – *izraz na nacionalnata svest na Pulevski*, Nova Makedonija, Shkup, 28. 12. 1980, f. 9;
43. Stamatovski, Trajko: *Od istorijata na makedonskata kni`evnost – “Gramatika” - izraz na nacionalnata svest na Pulevski*, Nova Makedonija, Shkup, 28.12. 1980, f. 9.
44. Stamatovski, Trajko: *Gjorgji Pulevski dhe gramatika e tij*, Jehona nr. 10, Shkup, 1987, f. 29-40.
45. Stamatovski, Trajko: *Stranici od istorijata na na{iot jazik, Makedonistot \or|i Pulevski – avtor na prvata gramatika na makedonskiot jazik*, Nova Makedonija nr. 3432. XI (04. 12. 1955), f. 5.
46. Stamatovski, Trajko: *Kon grafiski sistem na Pulevski*, Bigorski nau~no-kulturni sredbi, I, Nau~na sredba, Gostivar, 21-22. 10. 1971, Shkup, 1973, f. 37-44.
47. Stamatovski, Trajko: *\or|i Pulevski i negovata “Slognica re~ovska”*, Makedonski jazik XXXI, Shkup, 1980.
48. Sazdov, Tome: *\or|i Pulevski*, Izbrani tekstovi, Shkup, 1985;
49. Sazdov, Tome: *Vepra e Gjorgji Pulevskit (1838-1895)*, Jehona nr. 7, Shkup, 1984, f. 92-109.
50. Smilanih – Bradina, T.: *Torhe M. Pulevski (Mijak gali~ki)*, Ju`ni pregled, Shkup, 1927, I, nr. 2-3, f. 61-65.

## Martin SUROVČÁK

### J. U. JARNÍK (1848–1923): THEMELUESI I ALBANOLOGJISË ÇEKE

#### *Abstrakt:*

Referimi i kushtohet jetës dhe veprës së Jan Urban Jarník-ut, albanologut të parë çek, me rastin e 90-vjetorit të vdekjes së tij që mbushet sivjet. Ai e mishëronte studiuesin e pasionuar të gjuhëve të huaja, i cili vinte në mes të popullit të thjeshtë për ta studiuar gjuhën dhe folklorin drejtpërdrejt. Ndonëse gjatë gjithë rinisë së tij ishte ballafaquar me probleme të rënda ekonomike, arriti të studionte në Universitetin e Vjenës, ku profesorët ia nxitën interesimin për gjuhët romane, sidomos për rumanishten. Më vonë ia tërhoqi vëmendjen gjuha shqipe, e cila sapo kishte filluar të studiohej seriozisht nëpër Evropë. Me ndihmë të një shqiptari, Jarník-u e përvetësoi dialektin shkodran aq mirë saqë ishte në gjendje t'i kushtonte shqipes disa studime, madje planifikonte të ndërmernte një ekspeditë në Shqipëri që në fund nuk u realizua kurrë.

*Fjalët kyçe:* J. U. Jarník, albanologjia, shekulli XIX, Çekia, gjuha shqipe, folklor

Jan Urban Jarníku u lind më 25 maj 1848 në Potštejn, një qytezë në Boheminë lindore, si biri më i vogël në një familje të varfër. E motra Anna vdiq në moshën e fëmijërisë, kurse i vëllai František iku nga shtëpia shumë herët për të ndihmuar të xhaxhain. I ati František Vojtěch Jarník merrej me zanatin e endjes dhe e ëma Františka jepte kontribut në buxhetin modest të familjes me shitjen e frutave në pazarin e Žamberkut ku e përcillte shpesh djali i vogël. Me gjithë kujdesin që gëzonte nga prindërit, Jarníku e kaloi fëmijërinë në varfëri të skajshme, madje rrëfente për kohërat e krizës kur *një copë bukë i dukej si delikatesë*.<sup>1</sup>

Pasi kreu shkollimin fillor në Potštejn, prindërit e paramendonin kopshtar apo tregtar, mirëpo gjithçka tregonte që Jarníku do ta trashëgonte zanatin atëror. Për studimet u vendos nga rastësia gjatë një mëngjesi veror teksa Jarníku shoqëronte priftin dhe mësuesin: *Kur mbusha 13 vjet, në një mëngjes të bukur vere isha duke vajtur nga varrezat për*

---

<sup>1</sup> JARNÍK, Jan Urban. Jak jsem šel na studie In: FRANTA, Ondřej – VYCPÁLEK, Josef (eds.). *Pelclův almanach z prací bývalých žáků gymnasia rychnovského a úvodního nástinu životopisného Františka Martina Pelcla od Fr. Tischra*. Rychnov nad Kněžnou, 1893, f. 92.

*në shtëpi me veladonin dhe rasën e priftit në dorë. Ai po ecte disa hapa përpara meje bashkë me mësues Polakun. Edhe pse mbabesha mjaft larg prej tyre, befasi dëgjova emrin tim. Padeshur i ngrëba veshët dhe dëgjova mësuesit e mi që po shprehnin keqardhje që prindërit e mi ishin kaq të varfër, sepse djali i ndershëm e i zellshëm si unë meritonte të studionte. Këto fjalë kanë qenë nxitëse për mua: po, studime, studime! më tingullonte fort në mendje, por më preku mobimi i të dy burrave që për arsye të varfërisë së prindërve kjo ishte e perealizueshme. Pasi i dorëzova gjërat në famulli, shkova në shtëpi, por nuk hyra në dhomë, veç në kopsht ku ndenja në një stol duke përfytyruar se sa mirë do të ishte, po të kisha mundësi të studioja. Dhe më ra në mend që pas pushimeve disa prej shokëve të klasës (djem të zyrtarëve dhe të qytetarëve më të pasur) kishte për të shkuar në shkollat e larta. Më erdhi keq dhe shpërtheva në lot.<sup>2</sup>*

Pastaj mori situatën në dorë nëna duke i siguruar strehim dhe ushqim në Vysoké Mýto, ndërsa Jarníku shkante në klasën përgatitëse për shkollat e larta. Një vit më pas u pranua në gjimnazin në Rychnov nad Kněžnou, por vegimi i jetesës më të mirë e çoi në Borromeum të porsahapur në Hradec Kralové, njëfarë konvikti katolik për djemtë, të cilët synonin të studionin në shkollat priftërore. Që në moshën e re Jarníku tregoi interes të zjarrtë për gjuhë të huaja, përderisa në Borromeum mësonte gjermanisht, latinisht, frëngjisht dhe italisht dhe në kohën e lirë u mor me sllavishten kistare dhe me hungarishten. Për këtë arsye nuk hezitoi të zgjidhte drejtim filologjik, pasi dha provimet e maturës në vitin 1870.

Në moshën 22-vjeçare u regjistrua në Universitetin e Vjenës ku ndiqte ligjërata të filologëve të shquar të asaj kohe si p.sh. ato të Shererit, Mikloshiqit dhe Musafisë. Në vitin e parë të studimeve u sëmur rëndë nga pleuriti dhe për këtë arsye u kthye në Çeki për mjekim. Meqë mjeku i rekomandoi të mos kthehej menjëherë pas shërimit në Vjenë, Jarníku kaloi disa javë në zonën malore të Moravisë dhe me këtë rast ndërmoi një hulumtim të dialektit të atjeshëm të çekishtes, çka me siguri i shërbeu më vonë edhe për studimin e gjuhëve ballkanike në terren.

Kur i kishte përfunduar studimet në vitin 1874, fitoi njëllor burse nga Universiteti i Vjenës për qëndrim studimor njëvjeçar në Paris. Mu atje njohu Konstantin Xhorxhanin, një student rumun, të cilit i kërkoi mësimë private të rumanishtes dhe këto mësimë vijonin edhe më vonë përmes letërkëmbimit. Rumanishtja i hapi Jarníkut rrugën për në Evropën Juglindore dhe, sikurse dihet, gjuha dhe folklori rumun paraqesin kryetëm të studimeve të tij të mëtejshme, madje kontributi i tij në këtë fushë u çmua nga vetë rumunët dhe emri i tij u bë gjerësisht i njohur ndër ta. Pas kthimit në Vjenë iu ofrua vendi i mësuesit të gjermanishtes dhe të frëngjishtes në shkollën reale të Leopoldstadtit. Ndërkohë lidhi kontakte me shoqatën studentore “Rumania e re”, merrte pjesë në takimet e saj dhe në këtë mënyrë përmirësonte komunikimin në

<sup>2</sup> Po aty, f. 98.

rumanisht. Më 1876 u doktorua për filologji romane dhe i kërkoi drejtorisë së shkollës reale pushim me qëllim që të mblidhte në Rumani materiale për habilitim. Vendosi të shkonte në qytetin Blazh në Transilvani, i cili në atë kohë ndodhej brenda territorit të Austro-Hungarisë. Më vonë iu dha rasti edhe dy herë për të shkuar në Rumani duke vizituar mes të tjerëve edhe çiftin mbretëror si dhe përfaqësuesit e Akademisë së Skencave të Rumanisë, për më shumë edhe disa intelektualë të diasporës shqiptare në Bukuresht. Ai publikoi më dhjetëra artikuj nëpër gazeta dhe revista rumune dhe përveç kësaj ka përkthyer në rumanisht dy kryevepra të letërsisë çeke.<sup>3</sup>

Jarníku u bë njohës i shkëlqyeshëm i rumanishtes dhe dashamirës i madh i kulturës rumune, por sikurse ndodh shpesh me filologë të pasionuar, ai nuk u mjaftua me një gjuhë të vetme. Për t'i dhënë përgjigjen pyetjes se çfarë e shtyri Jarníkun të merrej krahas rumanishtes edhe me gjuhën shqipe duhen marrë parasysh jo vetëm interesimet e tij personale, por edhe sfondi historik. Nga shkrimet e tij autobiografike mësohet se përpjekjet e tij për të mësuar shqip dhanë ag në vitin 1879, d.m.th. në periudhën e turbullt pas mbajtjes së Lidhjes së Prizrenit, ndërsa Austro-Hungarinë e përshkonin lajmet për kryengritjet shqiptare kundër fuqive osmane dhe vetë shqiptarët si etni njiheshin kryesisht ndër qarqe shkencore. Nëse veprat e J. G. Hahnit dhe ato të F. Boppit konsiderohen pikë kthese në histori të albanologjisë, atëherë vetëm 2–3 dekada e ndajnë Jarníkun nga mëvetësimi i albanologjisë nga trangu i studimeve ballkanistike. Është me rëndësi që me gjuhën shqipe janë marrë edhe dy paraardhës të tij, J. Kopitari dhe F. Mikloshiqi, veçanërisht me bashkëpërkime midis shqipes dhe rumanishtes. Edhe vetë Jarníku pohon në disa pika që shqipja do t'i shërbente fillimisht si mjet për të ndriçuar marrëdhëniet e rumanishtes me gjuhë të tjera ballkanike. Për këtë thotë në autobiografinë e tij gegërisht: *“Masi u ktheva në Beç, ku u zgjedha msues i gjuhës franceli edhe tu desh në një shkollë qi i thonë real, shpesh u nnoshe, qi kto të dy gjuha, e vllabe edhe e shqyp, në disa puna janë fort të barabarshme. Mue pra më mur malli me e ditë edhe ket gjuhën edhe më pak e njoftun se i vlla.”*<sup>4</sup>

Ai kërkonte një folës nativ, i cili do t'i jepte mësim të shqipes, siç e kishte bërë më herët me rumanishten. Një gjë e tillë në mes të Vjenës dukej pothuajse e pamundur, megjithatë fati vendosi ndryshe. Në rrethana shumë kurioze Jarníku rastësisht njohu Marko Shantojën, një shkodran katolik i cili erdhi në Vjenë për t'i shërbyer një korespondenti austriak nga lufta serbo-turke. Meqë Shantoja ua shpëtoi jetën disa fëmijëve në shtëpinë që mori flakë, për famën e tij dëgjoi edhe Jarníku. Gjatë takimeve të shpeshta Shantoja ia korrigjonte gabimet gramatikore dhe mbushte boshllëqe në

<sup>3</sup> ŠRÁMEK, J. Česko-rumunské vztahy v pohledu Jana Urbana a Hertvíka Jarníkových. *Sborník prací filozofické fakulty brněnské univerzity*, C41 (1994), f. 91–100.

<sup>4</sup> JARNÍK, J. U. *Si e kam fillue me msue gjuhën shqyp* (dorëshkrim i pabotuar), f. 1.

tekste të tij të shkruara shqip dhe në këtë mënyrë Jarníku zotëroi dialektin shkodran për mrrekulli. Sikurse dihet, në mesin e shekullit XIX mbizotëronte në Austro-Hungari, por edhe më gjerë interesimi për toskërishten si pasojë e kontakteve të ngushta me Mbretërinë Greke (le të përmenden J. R. Xylander, J. G. Hahn), kurse Jarníku, vështruar nga kjo pikëpamje, bën përjashtim.

Më 1881, pasi që bëri përparime të dukshme në të mësuarit të shqipes, Jarníku iu desh të ndërmernte një ekspeditë në mjedisin shqipfolës. Duke qenë se vëllai i Marko Shantojës, prift katolik në Shkodër, i kishte ofruar përkrahje si në Shkodër ashtu edhe në rrethinën e saj, Jarníku e kishte të siguar strehimin. Përveç vizitës së Shkodrës po ashtu planifikonte të qëndronte në mes të malësorëve me qëllim që të nxirrte sa më shumë nga thesari folklorik shqiptar. As nuk do të shkonte në Shqipëri i vetëm, përderisa për synimet e tij ishte njoftuar Gustav Meyeri, albanologu i famshëm nga Graci i Austrisë, i cili e vizitoi në Vjenë. Ata shtronin plane për udhëtim të përbashkët. Meyeri ishte pajisur me njohuri të thella të gjuhësisë krahasimtare, kurse Jarníku e kalonte kolegun në përdorimin e shqipes në aspektin praktik. Gjithçka do të kishte shkuar mirë, po të mos ia kishte mbyllur Jarníku rrugën burokracia austro-hungareze. Ndonëse i ishte drejtuar këshillit arsimor me kërkesën për pushim pa pagesë dhe kryetari i këtij këshilli, një mik i ngushtë i J. G. Hahnit, e siguroi se patjetër do t'i jepej leje për udhëtim nëpër Shqipëri, vendimi përfundimtar ka qenë mohues me arsyetim që dy vjet më parë e kishte shfrytëzuar lejen për qëndrimin në Rumani. Ai nuk u pajtua me ngushëllimin hipokrit që pasi të bëhej profesor në Pragë, mund të kërkonte leje sa të donte, për më tepër nuk e fshihte hidhërimin për mosinteresim nga ana e zyrtarëve. Pra, G. Meyeri shkoi në Shqipëri vetë, ndërsa Jarníku të paktën kishte mundësi të merrte pjesë në botimin e materialeve të tij të sjella nga Shqipëria. Ndërkohë punonte për konsolidim të romanistikës në Pragë dhe në moshën e shkuar nuk guxonte më të ndërmernte një ekspeditë të tillë. *“Kështu pra, udhëtimi nuk u bë dhe kuptohet se nuk do të bëhet kurrë. Sinqerisht më vjen keq. Këtu qëndron fjala e urtë që hekuri duhet rrahur sa është i nxehtë dhe mund të them se dëshira ime për t'u përsosur në këtë gjuhë ka qenë e nxehtë. Po të mos kishte ndodhur ajo fiasko, ndoshta do të kisha fituar po aq dije në gjuhën shqipe sa kam fituar në gjuhën rumune, për të cilën çuditën me mua,”* ankohet Jarníku në shkrimet e tij.<sup>5</sup>

Marko Shantoja ishte jo vetëm mësues i aftë i shkodranishtes, por edhe tregimtar i shkëlqyeshëm i prozave popullore, prandaj Jarníku i kërkonte t'i diktonte disa tregime anekdotike, përralla, fjalë të urta etj. Një pjesë të këtyre materialeve si dhe poemën *Moj, Shqypni, e mjera Shqypni* të Pashko Vasës i botoi gjermanisht me shënime gjuhësore në veprën *Zur albanischen Sprachenkunde* (Kontribute për gjuhësinë shqiptare, Leipzig 1881), në të cilën zbatoi metodën moderne të përkthimit interlinear. Pasi që Universiteti i

<sup>5</sup> JARNÍK, J. U. Za jazykem albánským. *Osvěta* (1916), f. 185.



Pragës në vitin 1882 u nda në universitetin gjerman dhe atë çek, Jarníku u vendos në Pragë si profesor i asociuar i romanistikës. Atje në kuadër të ligjëratave të Shoqatës Mbretërore Çeke të Shkencave botoi një vepër tjetër, tashmë në çekisht, *Prísspěvky ku poznání nářečí albánských* (Kontribute për njohjen e dialekteve shqipe, Pragë 1883), kurse përkthimin e 37 tregimeve të Shantojës në gjermanisht botoi në revistën *Zeitschrift für Volkskunde* me titullin *Albanesische Märchen und Schwänke* (Tregime dhe anekdota shqipe, 1889–1890). Po sjellim një shembull të shkurtër:

**XXVII. Turku i Āakóvs tuj dek.**<sup>6</sup>

*ñi Turke pre Āakovet Ščyptarijet i erdh koha me dek. përpára se po diste, mennój: „une po des, se kũ škoj nuk e di, ā škoj n džehnět o n džehněm.“ ky thiri hodžen edhé ñi přifit, i thot hočs edhé přifit: „po ju lá ká pės činn groš, pės činn groš per káš e pės činn groš per džami e kab kjojt má mir, anněj voša.“*

Fatkeqësisht vetëm një prej këtyre tregimeve është përkthyer në çekisht.<sup>7</sup> Përveç veprave të lartpërmendura publikoi edhe një numër të konsiderueshëm kritikash në revista të ndryshme shkencore. Nuk mund të mos përmendet fakti që një pjesë e madhe e veprave të tij mbeti në dorëshkrime: një autobiografi shqip *Si e kam fillue me msue gjuhën shqyp*, disa punime mbi frazeologjinë shqipe, një fjalor shqip-çekisht-gjermanisht etj. Duke qenë se atëherë nuk ishte arritur ende pajtueshmëria e plotë rreth sistemit grafik të shqipes, ai përdorte alfabetin latin nën ndikimin e qarqeve katolike të Shkodrës, por me disa shënja diakritike të çekishtes.

Marko Shantoja ka qenë i vetmi shqiptar, me të cilin Jarníku ruante kontakt të drejtpërdrejt për më gjatë, por në Vjenë pati rast të njihej edhe me portierin e ambasadës osmane me origjinë shqiptare nga viset e Jugut. Këtij portieri i kërkoi t’i përkthente disa tregime në variantin tosk me qëllim që t’i krahasonte të dy dialektet e gjuhës shqipe dhe të gjente tipare të tyre dalluese, mirëpo informatori i tij i dytë nuk ishte aq i besueshëm sa i pari, prandaj Jarníku nuk guxoi të publikonte një studim krahasimtar. Megjithatë, duhet theksuar se Jarníku u mor mjaft seriozisht me çështje dialektologjike të shqipes pothuajse plot 80 vjet para A. V. Desnickajës – në të njëjtën kohë, kur Konstandin Kristoforidhi publikonte përkthime paralele të Biblës toskërisht dhe gegërisht. Në shkrimet e tij autobiografike përmend që edhe pas vendosjes në Pragë vazhdonte takimet personale me shqiptarë, por rol kyç në kontakte të tij me botën shqiptare luante letërkëmbimi. Deri më sot dihet që u shkruante letra jo vetëm albanologëve të tjerë (G.

<sup>6</sup> JARNÍK, J. U. *Prísspěvky ku poznání nářečí albánských*, Praha: Královská česká společnost nauk, 1883, f. 18.

<sup>7</sup> JARNÍK, J. U. *Ukázka jazyka albánského. Listy filologické (1887)*, f. 423–433.

Meyer, G. Weigand, Gj. Pekmezi etj.), por edhe shqiptarëve të shquar (Th. Mitko, B. Curri etj.) të asaj kohe.

Më 1923 Jarniku ndërroi jetë në një sanatorium të Pragës pa e parë asnjëherë Shqipërinë e ëndërruar.

**Anton PANÇEV**

**PROF. PETJA ASENOVA DHE GJUHËSIA SHQIPTARE**

**Hyrje**

Në këtë kumtesë paraqiten roli dhe puna e profesoreshës bullgare Petja Asenova për hulumtimin e gjuhësisë shqiptare dhe të asaj ballkanike. Ajo ka kontribut të madh për studimin e përgjithshëm të Lidhjes Gjuhësore Ballkanike, si edhe për sqarimin e pozitës kryesore të shqipes në kontaktet gjuhësore në rajon. Prof. Asenova ka bërë shumë punë të rëndësishme për studimin e morfosintaksës së gjuhëve ballkanike, si dhe për analizën e sistemit leksikor, statusin e ballkanizmave në strukturën e gjuhësisë ballkanike, e për shumë aspekte të tjera të gjuhëve nga Gadishulli Ballkanik. Prof. Asenova ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë aktive edhe në fushën e studimeve ballkanike në universitetet bullgare dhe botërore. Kumtesa përqendrohet mbi arritjet hulumtuese të profesoreshës, si dhe mbi meritat e saj për themelimin e degës së Ballkanistikës në Universitetin e Sofjes, në të cilën studimi i gjuhës shqipe merr një vend kryesor.

***Prof. Asenova si studiuese***

Prof. Asenova ka hulumtuar shumë aspekte nga gjuhësia ballkanike dhe shqiptare. Këtu do të përmendim shkurtimisht vetëm arritjet e saj më kryesore. Prof. Asenova ka treguar interes të veçantë për bilinguizmin bullgaro-shqiptar në pjesët perëndimore të Maqedonisë në të kaluarën në lidhje me studimin e të folurit të fshehtë të muratorëve<sup>1</sup>. Sipas Asenovas burim për formimin e leksikut të kësaj gjuhe kanë qenë edhe gjuhët fqinje ballkanike, në vend të parë gjuha shqipe. Shumë fjalë me prejardhje greke ose turke kanë hyrë në dialektet perëndimore bullgare përmes ndërmjetësimit shqiptar, gjë që shihet nga forma e tyre fonetike. Parimet e nominimit u janë nënshtruar kërkesave kriptomorfike, tipike për një të folur të fshehtë. Për këtë arsye, nominimi në të folurin e fshehtë të muratorëve gjen përshtatje semantike jo vetëm në të folurit e tjerë të fshehtë

---

<sup>1</sup> Vassilka Aleksova, Russana Beyleri. Professor Petya Assenova Turns 60.

(p.sh. në të folurin e fshehtë shqiptar “dogançe”), por edhe në gjëgjëzat popullore bullgare<sup>2</sup>.

Huazimet e fjalëve nga gjuha shqipe në të folurin e fshehtë të muratorëve pësojnë në të gjitha rastet adaptim morfologjik përmes të cilit përfshihen në ndonjë nga klasifikimet gramatikore të gjuhës bullgare. Në raste të caktuara, huazimet ndryshohen nën ndikimin e formës gramatikore ose të kategorive gramatikore, të natyrshme për leksemën bullgare me semantikë të njëjtë, p.sh. шато „село” < алб. Fshat; доце „праса” < алб. Dosë; шуле „дете” < алб. Shul; пешка „риба” < алб. Peshk. Disa prej huazimeve ndikohen përveç nga forma gramatikore edhe nga modeli fjalëformues i leksemës së përkatëse në gjuhën bullgare, p.sh. вайзиче „момиче” < алб. Vajzë; нуска „невяста” < алб. Nuse; шрувалц „огледало” < алб. Vështroj; драска „дъска” < алб. Dërrasë<sup>3</sup>.

Shumë interesante në lidhjet gjuhësore bullgare-shqiptare janë tipat fjalëformuese hibride. Asenova pohon se tek ta shihet qartë forma e huazuar, të përdorur si material për fjalëformim të pavarur me ndihmën e elementet aktive derivacione tipike për të folurin e fshehtë, p.sh.: гурач „камък” < алб. Gur; кенче „куче” < алб. Qen; мекрес „брадат” < алб. Mjekër; пуняшка „работа” < алб. Punë; фла’ъсалкъ „радио” < алб. Flas<sup>4</sup>.

Sipas Asenovas, i foluri i fshehtë na jep, megjithatë edhe pak, por prova interesante për karakterin bilingv të grupit shoqëror në të cilin ka funksionuar. Këto janë karket semantike, kryesisht sipas modelit shqiptar, të cilat supozojnë një simbiozë më të plotë shqiptaro-bullgare, meqë prekin shtresat më të thella të interferencës gjuhësore. Ky fakt është plotësisht i natyrshëm, nëse merret parasysh, se mjeshtrit muratorë kanë prejardhje nga krahina gjeografike, e njohur me popullsinë e vete shumë të përzier. Disa huazime nga gjuha shqipe në të folurin e fshehtë muratore janë marra si rezultat i segmentimit të parregullt fonetik të frazës shqiptare si klitikat kanë qenë kuptuar si elemente përbërëse në ndërtimin e fjalëve: апунувам „работя” < алб. Punoj<sup>5</sup>.

Prof. Asenova nuk kufizohet vetëm me hulumtimin e ndikimit shqiptar në dialektet perëndimore bullgare por sqaron edhe etimologjinë e shumë fjalëve me prejardhje shqiptare në gjuhën bullgare: апо „брат” < алб. Арë; бабита „надница” < алб. Mëditje<sup>6</sup>.

<sup>2</sup> Към характеристиката на тайните говори в България.- *СЕЗ*, IX (1984), 1, 29-43 (съавтори Т.Кацори, У.Лукова), с. 30.

<sup>3</sup> По аty, f. 33.

<sup>4</sup> По аty, f. 34.

<sup>5</sup> По аty, f. 35.

<sup>6</sup> По аty, f. 36-41.

Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-bullgare kanë qenë objekt për hulumtim nga ana e sllavistëve dhe albanologëve. Elementet sllave (respektivisht bullgare) janë hulumtuar në mënyrë të thellë dhe të rëndësishme (F. Mikloshiq, A. Selishçev, G. Majer, N. Jokël, P. Skok, H. Bariq, St. Mladenov, E. Qabej, A. Desnickaja). Të kundërtën – elementet shqiptare në gjuhën bullgare janë përqendruar kryesisht në ashtuquajtura të folmet e fshehta (meshtrenski) dhe rrallë përdoren në gjuhën e përgjithshme. Ato janë të studiuara krahasimisht pak dhe Asenova plotëson ngapak këtë zbrazasi<sup>7</sup>.

Fusha e onomastikës zë një vend të spikatur në hulumtimet e prof. Asenova ende nga periudha e parë e veprimtarisë së saj shkencore. Fokusi i saj është kryesisht mbi toponimet ballkanike dhe antroponimet. Mbi bazën e 300 toponime dhe 5000 antroponime nga Peloponesi veriperëndimor (prej arkivave osmane nga shekulli XV), ajo ka arritur përfundime të rëndësishme për origjinën etnike të popullsisë dhe migrimet e saj, lidhja midis toponimet dhe patronimet në strukturën dhe në semantikën e mbiemrave familjare në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik<sup>8</sup>.

### ***Prof. Asenova si profesore***

Prof. Asenova ka merita të shumta për zhvillimin e studimeve ballkanike në Bullgari dhe në disa vende të tjera. Ajo e ka krijuar Departamentin e Ballkanologjisë te Universiteti i Sofjes “Shën Kiliment Ohridski” më 1994 (katër vjet më vonë edhe në Univeristetin e Veliko Tërnovos prapë nën kujdestarinë e saj). Me hapjen e kësaj dege për herë të parë edhe shqipja fitoi statusin e disiplinës së detyrueshme me një orar rreth 500 orë për 4 vjet dhe u fut kursi i letërsisë shqiptare me 90 orë. Lëndët teorike gjuhësore shqyrtohen në plan krahasues për shqipen, rumanishten, greqishten dhe bullgarishten pikërisht në kuadrin e leksioneve të gjuhësisë ballkanike. Ajo disa dekada ka qenë profesoreshë të rregullt në Katedrën e Gjuhësisë të përgjithshme, ballkanike dhe indoevropiane. Ajo ka përgatitur qindra studentë në fushën e gjuhësisë përmes lëndëve si Hyrja në gjuhësi, Gjuhësia krahasimtare ballkanike etj. Prof. Asenova ka qenë lektore në shumë universitete evropiane në Belgjikë, Danimarkë, Greqi, Japoni, Rumani dhe Shqipëri. Për arsye të punës së saj, u arrit marrëveshje për bashkëpunim midis Universitetit të Sofjes dhe Universitetit të Tiranës<sup>9</sup>.

### ***Prof. Asenova si autore***

Prof. Asenova ka qindra publikime në shumë vende të botës dhe në revistat më me ndikim në shkencë. Me më shumë rëndësi ndoshta është libri i saj “Gjuhësia

<sup>7</sup> Някои думи от албански произход в български език.- *БЕ*, XXIX (1979), 1, 67-70 (съавтори У. Дукова, Т. Капори), с. 67.

<sup>8</sup> Vassilka Aleksova, Russana Beyleri. Professor Petya Assenova Turns 60.

<sup>9</sup> Vassilka Aleksova, Russana Beyleri. Professor Petya Assenova Turns 60.

ballkanike”. Botimi i parë i veprës përgjithësuese të prof. Petya Assenovës “Ballkansko ezikoznanie” (Gjuhësia ballkanike) pa dritë më 1989, tre vjet pas vdekjes së gjuhëtarit dhe ballkanologut të autoritetshëm bullgar Vlladimir Georgiev. Ai la “amanet” për një punim të tillë, i cili të pasqyronte zhvillimin e gjuhësisë ballkanike 50 vjet pas librit të K. Sandfeld *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats. Paris 1930*<sup>10</sup>.

Kapitujt kryesorë të librit janë: periudhizimi i gjuhësisë ballkanike; çështja e gjuhëve që hyjnë në bashkësinë ballkanikë; detyrat kryesore të gjuhësisë ballkanike në periudhën bashkëkohore; vepra përgjithësuese bashkëkohore në fushën e gjuhësisë së përgjithshme; sistemi fonologjik; sistemi leksikor; morfosintaksa sintaksa; statusi i ballkanizmave në strukturën e gjuhësisë ballkanike. Pjesa më e madhe e veprave të prof. Asenovës i kushtohen zhvillimit të sistemit foljor, sintaksës dhe lingistikës së tekstit dhe në këto pjesa të veprës përqendrohet kontributi i saj personal për zhvillimin e çështjeve të analizuar<sup>11</sup>.

Por në qoftë se gjuhët e tjera janë të pajisura me tekste mësimore dhe manuale teorike gramatikore të botuara në gjuhën bullgare, libri i prof. Asenovës është burimi i vetëm në bulgarisht ku studentët, ashtu si dhe specialistët e tjerë, mund të marrin fakte dhe njohuri të sistematizuara teorike për shqipen. Këtu përmendim se prof. Asenova zotëron mirë gjuhën dhe ka lexuar kursin e saj shqip një vit (94-95) në Universitetin e Tiranës<sup>12</sup>.

Kështu në variantin e ri prof. Asenova merr parasysh veprën kapitale me të njejtin emër të prof. Shaban Demirajt që doli në Shkup më 1994. Po kështu janë marrë shembuj nga Gramatika e shqipes (v.I dhe v.II). Në fushën e frazeologjisë ka plotësime, që pasqyrojnë Fjalorin frazeologjik ballkanik, hartuar nën udhëheqjen e prof. Jani Tomait në v. 1999<sup>13</sup>.

## Përfundim

Si përfundim mund të shënojmë se prof. Asenova ka publikuar dy libra të rëndësishëm mbi gjuhësinë ballkanike, si dhe shumë hulumtime dhe artikuj shkencorë, në të cilët merret me aspekte të ndryshme të gjuhësisë ballkanike. Ajo merret me

<sup>10</sup> Ballkansko ezikoznanie (Çështjet kryesore të Bashkësisë ballkanike gjuhësore), Petja Asenova, V. Tërnovo, “Faber”, 2002 (375 f.).

<sup>11</sup> Ballkansko ezikoznanie (Çështjet kryesore të Bashkësisë ballkanike gjuhësore), Petja Asenova, V. Tërnovo, “Faber”, 2002 (375 f.).

<sup>12</sup> Ballkansko ezikoznanie (Çështjet kryesore të Bashkësisë ballkanike gjuhësore), Petja Asenova, V. Tërnovo, “Faber”, 2002 (375 f.).

<sup>13</sup> Ballkansko ezikoznanie (Çështjet kryesore të Bashkësisë ballkanike gjuhësore), Petja Asenova, V. Tërnovo, “Faber”, 2002 (375 f.).

problemet gjuhësore mbi 50 vjet dhe që nga mbarimi i studimeve për doktoraturë në vitin 1970 me mbrojtjen e punimit “Ngjashmëri në përdorimin e parafjalëve të gramatikazuara më tipike në gjuhët ballkanike” prof. Asenova punon për sqarimin e dukurive të gjuhësisë ballkanike. Ajo punon në shumë fusha të gjuhësisë: gjuhësi të përgjithshme në kontekstin e teorisë gjuhësore dhe të bilinguizmit, onomastikë, gjuhësi krahasimtare, etnolinguizëm, gjuhën bullgare etj<sup>14</sup>. Shqipja gjithmonë zë një vend të rëndësishëm në hulumtimet e profesoreshës bullgare dhe ajo mund të radhitet pa dyshim midis albanologëve më të shquar në botën akademike.

---

<sup>14</sup> Vassilka Aleksova, Russana Beyleri. Professor Petya Assenova Turns 60.

## Bibliografi

1. Асенова, Петя. Балканско езикознание. (Gjuhësi ballkanike. Çështjet kryesore të Bashkësisë ballkanike gjuhësore). V. Tërnovo, "Faber", 2002.
2. Българо-албанската интерференция в говора на Голо бърдо (Албания).- *Българите извън България . Сборник с материали от Международния симпозиум, състоял се на 20 и 21 юни 1997 г. в Бургас.* ИК "Знак '94". Велико Търново 1997. стр. 57 -60.
3. Към характеристиката на тайните говори в България.- *СЕЗ*, IX (1984), 1, 29-43 (съавтори Т.Кацори, У.Дукова).
4. Някои думи от албански произход в български език.- *БЕ*, XXIX (1979), 1, 67-70 (съавтори У.Дукова, Т.Кацори).
5. Albano-graeco-bulgarica dans l'onomastique de la Grèce.-*Relations et influences réciproques entre Grecs et Bulgares XVIIIe - XXe siècle. Cinquième colloque organisé... Thessaloniki et Jannina, 27-31 mars 1988*, Thessaloniki 1991, 431-440. (съавтор Ch.Symeonidis).
6. Gruaja monolingje në Ballkanin biling.- *Studime albanologjike* , Tiranë 1996, 1, 85 - 90.
7. Навиторја në гjuhën shqipe dhe mënyra e ritregimit në billgarisht.- *Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Tiranë 1996. TOENA
8. Mbi karakteristikën e te folurës së fshehtë në Bullgari.- *Tempulli*. Revistë periodike kulturore. 8. Korçë f. 69-81. (Thoma Kacori, Ute Dukova), 2003.
9. Observations sur l'emploi de l'aoriste en grec et en albanais, *Z.f.B.* 33/2 (1997), pp. 137 – 147.
10. Une construction syntaxique d'intensification en grec et en albanais.- *LB* XXVII (1984), 3, 31-34.
11. Vassilka Aleksova, Russana Beyleri. Professor Petya Assenova Turns 60. Konferencë, Sofja, 2001.



**Matilda PARLLAKU (ÇOLLAKU)**

**KONTRIBUTI I M. LAMBERTZ PËR TRAJTIMIN E RAPORTEVE  
KUSHTORE NË GJUHËN SHQIPE**

**Përmbledhje**

*Albanologu i njohur austriak Maksimilian Lambertz (1882-1963) i diplomuar në gjuhësinë kerabasuese, e ka studiuar gjuhën shqipe që prej vitit 1907 dhe vëmendjen e tij, përveç këngëve popullore epike, dialektologjisë, letërsisë shqipe, folklorit shqiptar, e ka tërhequr edhe gramatika e kësaj gjuhe. Një nga punimet e tij për gramatikën e gjuhës shqipe, monografia për periudhën hipotetike në gjuhën shqipe<sup>1</sup> përbën një dëshmi për punën e tij serioze për të vënë në dukje disa nga veçoritë e sintaksës së kësaj gjuhe, duke e kerabasuar me gjuhën rumune apo me greqishten e vjetër e të re.*

*Me anë të këtij shkrimi do të përpiqemi të sjellim kontributin e tij konkret për trajtimin e raporteve kushtore në gjuhën shqipe në nivelin e fjalisë dhe në atë të periudhës me fjali të nënrenditur, në lidhje me çështje si: mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore, kriteri sipas të cilit klasifikohen llojet e fjalive të nënrenditura kushtore; mjetet lidhëse që takohen më shpesh në këto ndërtime, etj.*

Në prag të gati 100-vjetorit të shkrimit prej Lambertzit të këtij studimi, thajse shterues, për një nga llojet e njërive sintaksore të gjuhës shqipe, studimi i tij mbetet mjaft aktual dhe me vlera të çmuara. Megjithëse në këtë libër raportet kushtore trajtohen më gjerësisht në nivelin e periudhës dhe më pak në atë të fjalisë, mund të thuhet me bindje se trajtimi i raporteve kushtore në këtë rrafsh, prej këtij autori shënon një hap të rëndësishëm dhe baza të sigurta mbi të cilat do të mbështeteshin më pas sintaksologët shqiptarë.

---

<sup>1</sup> M. Lambertz, Die hypotetische Periode im Albanischen, në "Indogermanische Forschungen", 1914-15, vëll. 34 përkthimi në gjuhën shqipe nga V. Dashi, material i siguruar pranë IGJL 163 faqe

M. Lambertz, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi, IGJL A-8 Sintaksa, f. 1

Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011

Mendimet dhe vlerësimet e këtij autori prej gjuhëtarëve të njohur, duke filluar që nga E. Çabej<sup>2</sup>, J. Kastrati<sup>3</sup>, E. Lafe<sup>4</sup>, M. Gero<sup>5</sup>, S. Mansaku<sup>6</sup> dhe T. Topalli<sup>7</sup>, për vetë autorin dhe studimin monografik në fjalë, takohen në disa pika të përbashkëta, për vlerat e tij si njohës i mirë i gramatikës shqipe, duke vënë në dukje metodën e tij krahasuese të studimit të saj, por edhe duke folur me konsideratë për punën e tij për nxjerrjen e veçorive të gjuhës shqipe, e sidomos për vlerat e veçanta të punimit, jo vetëm për kohën kur është shkruar, por edhe për çështjet specifike që ai trajton në të.

Megjithëse në titull ai është kufizuar në trajtimin e periudhës si njësi sintaksore më e madhe se fjalia, në brendësi të studimit ai trajton edhe çështje që kanë të bëjnë me shprehjen e raporteve kushtore në nivelin e fjalisë si, për rrethanorin e kushtit të shprehur me ndajfolje, me emra të prirë nga parafjalët *me* a *pa*, me emra të prirë nga lokucioni parafjalor ***në rast***, apo me mbiemra prejpjesorë.

Kontributi i Lambertzit qëndron në radhë të parë në:

1. Mënyrën që zgjodhi për trajtimin e raporteve kushtore në periudhë ku raportet e varësisë studiohen ndërmjet fjalive kryesore dhe të nënrenditura që bashkohen ndërmjet tyre me ose pa lidhëza.

Në këtë aspekt, puna e tij u përqendrua në evidentimin e shembujve, gjithnjë nëpërmjet krahasimit me gjuhët e tjera, ku fjalitë në periudhë bashkohen nga lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore kushtore:

***ndë, për në, ndë qoftë se, ndë qoftë që, ndë se, ndë që, andë, po, po që, pokka, kur, sikur, sikur në, si, masi, kah, ku, nekë, kish***<sup>8</sup>

Duket se ndër nga të gjitha këto mjete lidhëse që trajton përgjatë punimit, janë përfshirë edhe të tilla që mund të jenë ndeshur prej tij në gjuhën e folur, si ***kah, nekë*** apo ***kish***, meqenëse në fokusin e tij të nxjerrjes së materialit për punimin, duhet të kenë qenë edhe dialekte e të folme, jo vetëm tekste e materiale shkrimore.

<sup>2</sup> E. Çabej, Studime gjuhësore V, Prishtinë 1975, f. 182

<sup>3</sup> J. Kastrati, "Histori e gramatologjisë shqiptare", "Rilindja", Prishtinë, 1980, f. 320-321

<sup>4</sup> E. Lafe, SF/1982, 4, f. 180-181

<sup>5</sup> M. Gero, "Kontribute të albanologëve të huaj për studimin e gjuhës shqipe", Studime shqiptare 5, Universiteti i Shkodrës, Shkodër, 1996, f. 126-127

<sup>6</sup> S. Mansaku, Dy fjalë vlerësuese për studimin "Periudha hipotetike në gjuhën shqipe të Maximilian Lambertz", Tiranë 10 maj 2010, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011, f. 297-299

<sup>7</sup> Po aty, T. Topalli, f. 269-289

<sup>8</sup> M. Lambertz, *vep. cit.* f. 15-175

M. Lambertz-i ka trajtuar paralelisht me mjetet lidhëse të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore edhe kohët dhe mënyrat e foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur që fillon me lidhëzën përkatëse, por gjithashtu edhe kohën dhe mënyrën e foljes kallëzues me të cilën bashkëlidhet në fjalinë drejtuese, madje në fund të monografisë ai ka paraqitur në një tabelë përmbledhëse të numërtuar deri në 37 raste të mbledhura të bashkëlidhjes së trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues në të dyja fjalitë që ndërtojnë periudhën hipotetike, sidomos *irale*, sipas lidhëzave përkatëse apo sipas mjeteve dhe formave të tjera me të cilat del se janë shprehur raportet kushtore në atë periudhë. Lidhëzat janë sjellë edhe në variante dialektore të shoqëruara me shembuj, por sidomos me argumente se si janë ndërtuar ose përfutur analogjikisht nga ndikimi i ndonjë gjuhe tjetër romane perëndimore apo nga rumanishtja dhe me funksionet e ndryshme që ato kryejnë, përveç atij të bashkimit të dy fjalive përbërëse të periudhës hipotetike. Pas analizës së secilës lidhëz, autori jep paralelisht kohët dhe mënyrat e foljeve që ndërtojnë 3 fjalinë drejtuese dhe atë të nënrenditur të emërtuara *apodozë* dhe *protazë* dhe rendin e fjalive, pa lënë mënjanë edhe diskutimin për modalitetin e periudhës kushtore.

Ndër mjetet e tjera të formësimit të periudhës, Lambertz trajton edhe trajtat kohore e mënyrore të foljeve kallëzues dhe bashkëlidhjen e tyre brenda periudhës, duke përforcuar faktin e njohur, që përdorimet e tyre brenda së njëjtës mënyrë me vlerën e njëra-tjetrës apo të mënyrave të tjera të foljeve kallëzues, janë dëshmi e fleksibilitetit të gjuhës shqipe dhe e pasurisë së saj në forma kohore e mënyrore.

Lidhëzën **në** M. Lambertz e cilëson si *“lidhësi hipotetik që përdoret më shumë se të gjithë në gjuhën shqipe”*, duke sjellë edhe përpjekjet e G. Meyer-it që e identifikon këtë lidhëz me parafjalën *“ndë (në)”* dhe ato të H. Pedersen-it që e mendon **në** të formuar nga *të*, pa lidhje me parafjalën. Me sa duket, vetë Lambertz-i, përkrah mendimin që **në** ka origjinë parafjalore gjë që duket kur ai vë në dukje ndryshimet ndërmjet parafjalës në dhe pjesëzës të, si në pozicionet në të cilat ato gjenden, ashtu edhe në përdorimin e tyre. Duke bërë paralelizmin me disa lidhëza të tjera, për të cilat shpjegon prejardhjen nga greqishtja, ai e përforcon mendimin për lidhëzën **ndë**: *“...prandaj konjucionet e greqishtes este dhe ente që përdoren me kuptimin temporal pa relativin... të cilat bazën e kanë ke prepozicionet dhe janë zhvillue ma gjatë prej tyne...janë paralele krejt identike për ndë tonë dhe kanë ardhë nga një epokë më e re e gjuhës, sikundër dubet që ta pranojmë edhe për ndë.”*<sup>10</sup>

Duke u nisur pikërisht nga trajtimi i kësaj lidhëzeje të nënrenditur, e cila në punim zë pjesën më të madhe të kapitullit I dhe shihet në rrafsh krahasues në aspektin leksikor

---

<sup>9</sup> M. Lambertz, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përktb. nga V. Dashi*, IGJL A-8 Sintaksa, f. 1

<sup>10</sup> Po aty, f. 4

dhe atë funksional, me të njëjtin mjet lidhës në gjuhët e tjera, ai jep ndihmesë pikërisht për të kuptuar atë lidhës që qëndron në bazë të ndërtimit të lokucioneve të tjera lidhëzore kushtore që shërbejnë për bashkuar fjalitë në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore. Ai e shpjegon përdorimin e lokucionit **për në** me nuancën e përforcimit që parafjala *për* i jep ndërtimit në periudhën hipotetike: “*Shqipja mund t’i formojë ma fort postpozitivët, si edhe gjuhët e tjera në bazë të natyrës së tyre, me një në me optativin, për shembull: Nderoni babën, në daçi me e shkue mirë jetën e me jetue shumë mbi tokë!*”, ose përpara **në** vjen prepozicioni *për*, i cili tregon qëllimin, premisën e ardhshme.”<sup>11</sup>

2. Në aspektin e klasifikimit të periudhave sipas modalitetit në *reale*, *ireale* dhe *potenciale*.

Në këtë aspekt, në punim autori flet për *supozime potenciale* duke shprehur mendimin që “... *Kuptimi potencial shprehet me anë të në që ka indikativin dhe me mund. Në rrasën e parë protaza asht potenciale dhe apodoza reale, d.m.th. folësi afërmon konsekrativin me 4 saktësi të plotë, por len me kuptue njëkohësisht, se beson që kondita mund të plotësohet.*”<sup>12</sup>. Në këtë kuptim ai përpiket të shpjegojë nëpërmjet shembujsh që, realizimi i pasojës në fjalinë e nënrenditur, është rezultat i plotësimit të kushtit në fjalinë kryesore, duke e menduar si të mundshëm kushtin e shprehur. Paralelisht me këtë fakt, Lambertzi numëron edhe kohët dhe mënyrat, në të cilat vendosen foljet në fjalitë brenda periudhës. Por e veçanta e trajtimit të këtij klasifikimi nga ky autor është pikërisht vënia e shenjës së barazimit ndërmjet kohës së periudhës *potenciale* me atë të periudhës *joreale*<sup>13</sup> (një barazim ky i cili nuk përfordhet, kur jep thujse të gjitha rastet e identifikuar prej tij të bashkëlidhjes kohore e mënyrore të foljeve kallëzues në fjalitë brenda periudhës *ireale*) Përveçse në disa prej rasteve të bashkëlidhjes kohore e mënyrore, nuk duket mjaftueshëm i argumentuar mendimi që “*forma e potencialit asht një me atë të irealit*”<sup>14</sup> Kjo, për arsye se në rastet e shprehjes së një kushti të mundshëm (potencial), jo vetëm që ndryshojnë kohët e foljeve, ato i përkasin më tepër së tashmes apo edhe së pakryerës, por jo kohëve të shkuara të së kryerës apo të më se të kryerës, siç ndodh në rastet e periudhave *hipotetike ireale*.

<i>(ndë) paskishë</i>	<i>kishe me dhanë</i>
<i>po të kishe pasë</i>	<i>do të kishe dhanë</i>
<i>kish t` kishe pas</i>	<i>kishe dhanë, etj.</i> <sup>15</sup> ,

<sup>11</sup> “Periudha hipotetike në gjuhën shqipe të Maximilian Lambertz”, Tiranë 10 maj 2010, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011, f. 101

<sup>12</sup> Po ai, f. 42

<sup>13</sup> Po ai, f. 46

<sup>14</sup> Po ai, po aty, f. 255-259

<sup>15</sup> Po ai, f. 257, 258

por edhe për faktin që, *një kusht që është i mundshëm, mund të jetë pjesë e realitetit, në çastin e realizimit, kurse një kusht joreal e ka të përfshirë, madje të sigurt pamundësinë e realizimit.*

Mundësia e realizimit të pasojës varet nga realizimi i kushtit të fjalisë së nënrenditur, folja kallëzues e së cilës shpesh është *në të pakryerën e lidhores* dhe bashkëlidhet *me format e kushtores* në fjalinë e nënrenditur, duke e bërë në këtë mënyrë të mundshëm realizimin e kushtit e për rrjedhim edhe të pasojës.

3. Në terminologjinë që do të përdorej më pas nga gramatikanët e gjuhës shqipe.

Ajo që vihet re qartë në lidhje me terminologjinë sintaksore në përgjithësi dhe me atë kushtore në veçanti, është përdorimi i të dyja formave në latinisht dhe në shqip si për emërtimin e kohëve e mënyrave të foljeve kallëzues në fjali, të emërtimeve të pjesëve të tjera të ligjëratës, si edhe të fjalive drejtuese/kryesore e të periudhës hipotetike/kushtore.

*“konjunksion, fjali kondicionale, fjali koncesive, temporal, protaza; fjali e varme dhe fjali kryesore; supozim; plotësor adverbial, apodoza; prepozitive; postpozitive; por edhe: të prapavendosur; potencial; ireal, por edhe joreale; negacion, por edhe mohim, prepozicione, indikativi, konjuktivi, optativi, aoristi, admirativi, imperfekti, pluskuam-perfekti, substantiv, etj.”*

Fjali pjesore Lambertzi quan fjalitë që bashkohen me fjalinë drejtuese/kryesore pa mjet lidhës, me foljen në mënyrën lidhore, duke e konsideruar modalitetin e kësaj foljeje të vetëmjaftueshëm për të qëndruar edhe pa praninë e lidhëzës, por gjithashtu duke bërë dallimin e tyre nga ato fjali kushtore që kanë akoma karakterin e plotë të një fjalie kryesore: *“Prej fjalive pjesore pa konjunksion, të cilat njihen se janë fjali të varme nga shkakut i pozitës shumë herë të invertueme të fjalive, dubet t'i dallojmë fjalitë kondicionale që kanë akoma karakterin e plotë të një fjalie kryesore, të cilat me fjalinë e tyre konsektive gjinden në raportin e parataksës.”*<sup>16</sup> Gjithashtu ai ruan termin fjali të varme për ato që nga sintaksa e sotme quhen të nënrenditura. Termi *eksponent* përdoret në vend të *prepozicion*, në rastet kur i paravendosen pjesores për të formuar format e pashtjelluara përkatësisht përcjellore, paskajore dhe mohore, të cilat mund të shprehin kushtin në fjalinë e nënrenditur dhe që prej autorit trajtohen si mjete të tjera të shprehjes së raporteve kushtore, duke zëvendësuar fjalitë kushtore.

4. Në konsiderimin e formave të pashtjelluara foljore si fjali të nënrenditura kushtore, si pjesë përbërëse e periudhës me fjali të nënrenditur kushtore, sikurse edhe të fjalive që bashkohen asindetikisht, apo të fjalive lidhore që fillojnë me përemrin lidhor *kush*.

---

<sup>16</sup> Po ai, po aty, f. 180

Të gjitha këto ndërtime përfshihen nga M. Lambertzi në grupin ku “Fjalìa kondicionuese zàvendsobet me konstrukte të tjera”<sup>17</sup>

Në vëmendjen e tij kanë qenë disa mjete të tjera të shprehjes së këtyre raporteve siç janë: zëvendësimi i mundshëm i fjalisë së nënrenditur kushtore, herë me “*nji fjalì kryesore me indikativin, me një pyetje, indipendente ose me një shprehje eliptike (parataksë), rasti i proverbave.*”<sup>18</sup>, “Do të rrosb me nder mbi dhe/Me të liq mos u përçje.” herë me “*nji fjalì relative me një kuptim të përgjithshëm*”<sup>19</sup>, [fjalitë lidhore me përemrin lidhor të pacaktuar *kush*] “*Kush t`banjë kso gabimesh, me u ndëshkue me gjobë!*” apo herë me “*nji partìcip me prepozicionet me, tui, pa (kur kuptimi asht negativ), d. m. th. prej përfaqësuesit të infinitivit ose të gerundiimit të gjubës shqipe*”<sup>20</sup> “*Me pam ndë një pasqyrë një dritë pakëzë larg, kishin me u dukun trij drita.*”; (pa shumë shpjegime, vetëm nëpërmjet shembujsh): “*Tui ndru gjubën t`falitunit mendojn, se vjen gjyteterimi.*” “*Pa dyshim dyke e mesuar qendrin e gjubës, do të mundemi me kohë t`a gjejmë nder këto dialekte të qendrit edhe kërtbizën e gjubës s`onë.*”.

5. Në fokusin e tij kanë qenë edhe pasqyrimi dhe trajtimi i rasteve të bashkimit të fjalive në periudhë me mjetin lidhëz *zero*, në rastet kur fjalìa e nënrenditur fillon me folje kallëzues në mënyrën lidhore,

Në këtë aspekt, duket se Lambertzi ka qenë i pari që ka hedhur bazat e asaj që do të provohej në praktikë nëpërmjet shembujsh dhe më pas edhe në tekste të gramatikave, nëpërmjet pohimit: “*Falë këtij modaliteti, (të mundësisë) por ndonjëberë edhe atij të dëshirës që mund të shprehë, foljìa në mënyrën lidhore, sidomos në kohën e tashme të saj, kuptimi themelor i së cilës është “të tregojë një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqit si të mundshme a të dëshirueshme*”<sup>21</sup> ajo mund të mos jetë e shoqëruar nga lidhëzat kushtore zakonisht **po**, ose **sikur**, por mund ta realizojë e vetme kuptimin kushtor.

Për këto lloj fjalish kushtore, që i emërton *pjesore* ai shprehet: “*Këtu kemi të bajmë me fjalì të dikursbme të subordinueme dëshirore ose kushtore, të cilat dallohen nga konjuktivi se janë të tilla dhe që i përdor me qejf latinishtjìa ose gjubët romane, sidomos frëngjishtjìa, italishtjìa e vjetër dhe retoromanishtjìa.*”<sup>22</sup> “*Të dish punërat e mija që më kanë ngjarë, çuditësh shumë.*”; “*Të futim një dorë në një ujë të nxehtë dhe tjartrën doboret e t`i lemë, sa njëra të ngrohet mjaft e tjarëra të ftobet, pa t`i nxjerrim të dyja e t`i futim në një ujë të vakurë, asaj dorë që ka qenë në dëboret, uj`i vakurë do t`i vinjë i ngrohtë.*”<sup>23</sup>

<sup>17</sup> Po ai, po aty, f. 195

<sup>18</sup> Po aty, f. 197-198

<sup>19</sup> Po aty, f. 199

<sup>20</sup> Po aty, f. 203-217

<sup>21</sup> Po aty, f. 321

<sup>22</sup> Po ai, po aty, f. 180

<sup>23</sup> Po ai, po aty, f. 183

Sillen gjithashtu shembuj të fjalive kushtore të bashkuara me pranëvënie të cilat prihen nga: **ndo-ndo, o-o, në më-në më, (në mos më)** etj. Fjalitë kanë ndërtim të njëjtë pozitiv ose njëra pozitiv dhe tjetra negativ me “shprehjen **në mos, në jo, jo, jo,** pa verbin”(f. 115). Po në këto ndërtime ky studiuues i gjuhës shqipe përfshin edhe të ashtuquajturat *konstrukte tautologjike*.

6. Lambertzi i ka trajtuar raportet kushtore në gjuhën shqipe edhe në nivelin e fjalisë, duke numëruar këtu raste, kur fjalia e nënrenditur kushtore zëvendësohet me ndajfoljet e mënyrës *ashtu, kështu, ndryshe, përndryshe* (të cilat i prijnë një fjalie të nënrenditur shkakore) apo me emrat me parafjalët me apo pa: “Fjala më e rëndomtë për “*se tjetrazë*” asht “*ndryshej*”: *Sulltan Murati ka dijt me sunnue, se ndryshe s’ ishte rrit Turku. Nga një herë fjalinë kondicionale e zëvendësojnë ashtu ose kështu, për shembull: J’a dashtë Zoti e t’grihen..., pse kështu anmiqt t’ onë vogloben... Fjalinë kondicionale mund ta zëvendësojë edhe një plotësor adverbial, qoftë pozitiv me me, qoftë negativ me pa: Svetisgrad u dha prej tradhtijet, se me fuqi s’ pat me mujt kurr m’e marr; Pa mysylmanët Shqipetare këto fusha do të ishin sot të slavosura fare”<sup>24</sup>*

Këtë koncept të Lambertzit për ekzistencën e rrethanorit të kushtit, të emërtuar prej tij “*plotësor adverbial*” e gjejmë mëse të zbatueshëm në kushtet e sotme, kur mundësia e zëvendësimit të fjalisë së nënrenditur kushtore prej tij, shërben si një mënyrë alternative e shprehjes së raporteve kushtore në nivelin e fjalisë. *Ndryshe, përndryshe*, zakonisht përmbledhin përmbajtjen e fjalisë ose të gjithë periudhës paraprijëse në formën mohuese.

Të njëjtin mendim në lidhje me ndajfoljet e mënyrës *ndryshe, përndryshe*, duket se ka edhe S. Mansaku, sipas të cilit: “*Disa ndajfolje mënyre ndryshe, përndryshe, ... shpesh herë përmbajnë një kusht të supozuar. Këto ndajfolje zëvendësojnë brendinë e një fjalie kushtore të pashprehur, por të nënkuptuar lehtë nga konteksti. Ndajfolja ndryshe (përndryshe) paraqet një supozim për të kundërtën e asaj që është thënë më parë.*”<sup>25</sup>

7. Gërshetimi funksional i raporteve kushtore me ato lejore (koncesive), kohore (temporale), shkakore (kauzale), nuk i ka shpëtuar vëmendjes së këtij gjuhëtari të shquar. Ai ka shpjeguar se për cilat lloje të fjalive flet në raste të tilla, ku raportet kushtore fitojnë një nuancë kuptimore shtesë: “*... Ne do të merremi me ato konstrukte fjalish, të cilat qendrojnë në mes të fjalive kondicionale dhe koncesive, me anë të të cilave, si kundër edhe në fjalitë koncesive, prapset një konsequencë qi mund të nxirresh nga protazja, por fjalia pjesore e tyne përmban një supozim sikundër edhe periudhat hipotetike... Fjalitë pjesore të këtyne periudhave fillojnë me ndë (negacioni*

---

<sup>24</sup> Po ai, po aty, f. 221-224

<sup>25</sup> S. Mansaku, Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme, SF, 1969/3, f. 104

*mos), tamam si fjalitë kondicionale dhe kanë indikativin ose optativin, ose kemi në qoftë se ose edhe në...”<sup>26</sup>*

8. Ai ka trajtuar gjithashtu edhe pozicionin e fjalëve [gjymtyrëve në fakt, sepse flet për pozicionin e *subjektit* dhe *predikatit*] në fjalinë e nënrenditur kushtore dhe jo vetëm në fund, por edhe gjatë shtjellimit të çështjeve të ndryshme në lidhje me fjalinë kushtore, e ka treguar se ajo mund të *para* ose *pasvendoset* ndaj fjalisë drejtuese.

Duke përmbledhur gjithë sa thamë më sipër, kontributi i madh i këtij gjuhëtari të vëmendshëm ndaj, jo vetëm gramatikës së shqipes, e sidomos ndaj sintaksës së saj, vlen të evokohet në aktivitete shkencore të tilla, për të kuptuar pikërisht trashëgiminë e pasur terminologjike dhe praktike sintaksore që ai ka lënë, nëpërmjet punimit për periudhën kushtore në gjuhën shqipe. Falë tij, edhe sot raportet kushtore studiohen në nivelin e periudhës dhe në atë të fjalisë, duke ruajtur një pjesë të mirë të mjeteve sintaksore dhe të formave që shërbejnë për t’i shprehur ato. Në nivelin e periudhës duke bërë ndarjen në lidhëzore dhe palidhëzore të periudhave me fjali të nënrenditura, në të parat, vendin më të rëndësishëm e zë shprehja e tyre me lidhëza e lokucione lidhëzore kushtore, të cilat trajtohen paralelisht me mjetin tjetër, atë të bashkëlidhjes së trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë. Në bashkimet e tyre pa lidhëza rolin më të rëndësishëm e luan mënyra lidhore, me modalitetin e saj, që justifikon dhe bën të qëndrueshëm ndërtimin sintaksor, edhe pa praninë e lidhëzës/lokucionit lidhëzor kushtor, me lidhëzën *zero*. Nëpërmjet pranëvënies së fjalive në periudhë dhe duke marrë përparësi nuancat kuptimore, realizohet bashkimi jolidhëzor i tyre. I vetmi dallim, që e vë në dukje edhe T. Topalli është trajtimi nga ky autor i formave të pashtjelluara foljore të ndërtaura mbi bazën e pjesores: “... të cilat sot fitojnë kallëzuesi kur kanë një kryefjalë referente, ose të përbashkët me kryefjalën e fjalisë drejtuese.”<sup>27</sup> Në nivelin e fjalisë, Lambertz numëron rastet e shprehjes së raporteve kushtore me anë të *plotësorit adverbial* (rrethanorit të kushtit) nga i cili sjell raste të shprehjes me emrat e prirë nga parafjalët *me* apo *pa* apo raste të tjera, të sjellë nëpërmjet shembujsh. Shprehja e këtyre raporteve në nivelin e fjalisë edhe nëpërmjet ndajfoljeve, siç u përmend më sipër, ku ato zënë vendin e një fjalie kushtore në periudhë, janë gjithashtu aktuale. Nëpërmjet trajtimit edhe të rendit të gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur kushtore (*fjali e varme kondicionale*), ai vë në dukje një veçori të shqipes ku *predikati* prin *subjektin* në këto lloj fjalish të nënrenditura dhe sjell

<sup>26</sup> “Periudha hipotetike në gjuhën shqipe të Maximilian Lambertz”, Tiranë 10 maj 2010, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011, f. 232

<sup>27</sup> T. Topalli në “Periudha hipotetike në gjuhën shqipe të Maximilian Lambertz”, Tiranë 10 maj 2010, Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011, f. 284



edhe disa statistika në lidhje me rendin e tyre, kur para ose pasvendoset *apodoza*, meqë zakonisht *protaza* i prin asaj, gjithnjë duke qenë i kujdesshëm që këto përgjithësime t'i bëjë duke iu referuar rasteve të mbledhura nga ai vetë.

### **Bibliografi**

1. ASHRSH Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, IGJL Tiranë 1997
2. Demiraj, Sh., Eqrem Çabej, Tiranë 1990, shtypshkronja “8 Nëntori”
3. Lambertz, M., Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011
4. Topalli, T., Sintaksa e fjalisë, Gramatikë e gjuhës shqipe, Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Instituti i Studimeve Albanologjike, sprovë monografike, Tiranë 2011
5. Haxhi, A., “LEKSIKON”, Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë, Sh. Botuese
6. Topalli, T., “FIORENTINA”, Shkodër 2012

**Erzen KOPERAJ**

**VENDI I SHQIPES NË VEPRËN E V. PISANIT**

Vitore Pisani është një prej gjuhëtarëve më të njohur të gjuhësisë indoevropiane të mesit të shek. XX. Veprat e tij “Saggi di linguistica storica” (Torino, 1959) dhe “Geolinguistica e indoeuropeo” (Torino 1940) e bëjnë atë një prej studiuesve kryesorë të neolinguistikës dhe gjeografisë gjuhësore. Në prej gjuhëve që ka tërhequr vëmendjen e tij, ka qenë edhe shqipja. Pisani bën përpjekje që në përcaktimin e vendit të shqipes në gjirin e familjes indoevropiane të mos trajtojë raste të izoluar, por t’i japë në sistem afritë mes shqipes dhe gjuhëve simotra, në atë fonetik, leksikor dhe në strukturën morfologjike.

Përcaktimi i vendit që zë një gjuhë në familjen gjuhësore që i përket, gjuhësia diakronike gjithnjë e më shumë i referohet jo më lidhjeve me elementin e trungut indoevropian, por kryesisht të afrive më të afërta që dy a më shumë gjuhë paraqesin me njëra tjetrën. Aq më tepër që gjithnjë e më shumë përforcohet mendimi që gjuha i.e. nuk duhet të ketë qenë një gjuhë unitare, studimet mbi tokarishten dhe hetitishten, një analizë më e hollësishme për shqipen, armenishten e trako-frigishten, të bëjnë të mendosh se ideja e një gjuhe indoevropiane të përbashkët, e një gjuhe të vetme mëmë, është gjithnjë e më pak e mbështetur. Izoglosa nga më të ndryshmet kryqëzohen dhe përzihen nga çdo anë, shpesh në kontrast me njëra tjetrën.<sup>1</sup> Metodat e gjeografisë gjuhësore mbi lidhjet gjuhësore janë ato që po vazhdojnë të mbajnë në këmbë gjuhësinë krahasuese. Në këtë artikull do të parashtrijmë rezultatet e studimeve të linguistit të njohur italian Vitore Pisani, i cili duke ndjekur parimet neolinguiste, dha një kontribut mbi çështje të fonetikës dhe gramatikës historike të shqipes. I ndikuar nga Trubetskoi dhe Jakobson, **V. Pisani** do të ishte ndër indoevropianistët më të njohur që *sprachbund*-in (lidhjen gjuhësore) e ktheu në një model teorik koherent dhe përgjithësues, të vlefshëm jo vetëm për familjen gjuhësore i.e. por në veçanti për çdo gjuhë. Çdo gjë për Pisani-n është *sprachbund*. Përpjekja e tij, ishte që të hidhte poshtë

<sup>1</sup> Alinei M, “Origini delle lingue d’Europa”, Bologna, 1996, fq. 18

<sup>2</sup>Termi përdorur për të shënuar lidhjet gjuhësore mes gjuhëve indoevropiane nga Trubetskoi, lidhje dhe afri që u krijuan si rezultat i kontakteve historike mes popujve dhe jo si rezultat i një trungu të përbashkët gjuhësor.

konceptet gjenealogjike me të cilët ishte lidhur puna për zbulimin e trungut indoevropian. Ky pozicion prej “heretiku”, i ngjashëm me atë të Trubetskoit, shihet qartë në teorinë e Pisanit, i cili nuk pranon ekzistencën e një gjuhe të përbashkët indoevropiane, që në prehistorinë e popujve indoevropianë, e cila më pas duke u copëzuar në dialekte krijoi kurorën e gjuhëve që fliten sot nga Evropa në Azi (dhe ky është mendimi i neolingvistëve në përgjithësi). “...indoevropianishtja?-një krijesë e glotologëve, të cilët, të udhëhequr prej gjenealogjizmit shljaherian, kanë besuar se mund të diktonin në themel të çdo grupi gjuhësor një gjuhë-mëmë, dhe se mund ta rindërtonin këtë duke u mbështetur jo vetëm në tiparet e përbashkëta të gjuhëve që bëjnë pjesë në atë grup, por edhe në hipotezën, pak a shumë të lëshuar në erë, se ndër këto gjuhë paskan humbur tipare që ata glotologë ia veshin mëmës së tyre. Ajo që ka ndodhur, brenda disa kufijve, nga një ose më shumë qendra, disa izoglosa risishë të jenë përhapur me shumicë ndër dialekte të cilët edhe më parë kishin izoglosa të vjetra të përbashkëta.”-shprehet Pisani. Qëndrimi i tij radikal, bëri që indoevropianisti më i njohur italian, të mos kishte një ndikim të madh tek rrethet gjuhësore të indoevropianistëve jashtë Italisë.<sup>3</sup>

Në këtë rrjedhë logjike, ai i kushton një rëndësi të madhe studimit të **izoglosave**. Areali ku zotërojnë të njëjtat dukuri gjuhësore, quhet fusha e izoglosave, ndërsa aty ku kryqëzohen fushat e izoglosave, për të kemi të bëjmë me kufijtë e dialekteve, apo të folmeve. Sistemi që lidh dy a më shumë fusha izoglosash, përbën një gjuhë. ***Gjuha shqipe është një sistem izoglosash, që shtrihen në dy dialektet e saj, gegërisht dhe toskërisht, dhe jo e kundërta, gegërishtja dhe toskërishtja nuk janë dy degë të zhvilluara nga një shqipe më e vjetër.***<sup>4</sup> Prandaj të bësh historinë e një gjuhe, konsiston në ndjekjen e zhvendosjes së sistemit të izoglosave, të cilin ai e quan gjuhë, nga format më të hershme deri tek ato më të fundit, duke treguar çdo herë origjinën, që sipas tyre, nuk mund të jetë veçse individuale, si dhe shkaqet që e lindën atë.<sup>5</sup>

Pisani bën përpjekje që në përcaktimin e vendit të shqipes në gjirin e familjes indoevropiane të mos trajtojë raste të izoluara, por t’i japë në sistem afritë mes shqipes dhe gjuhëve simotra, në atë fonetik, leksikor dhe në strukturën morfologjike. Parimi që ndjek është, nisja nga analiza e gjendjes së sotme gjuhësore drejt së shkuarës dhe jo e

<sup>3</sup> Alinei, A, “Origini delle lingue d’ Europa”, 1996, fq.271. “...Pisani një prej indoevropianistëve më të mirë të rruzullit, por vepra e tij nuk qe e njohur jashtë Italisë, sepse nëse Renfrew e të tjerë, kundërshtarë të teorisë tradicionale të stammbaum(drurit gjenealogjik), nëse do ta njihnin do të kuptonin se teza e Trubetskoit nuk është vetëm një “program heretik”, por edhe një teori e plotë dhe e hartuar deri në detajet më të hollësishme në lëmin e indoevropianistikës, por që në nuk ndryshoi në thelb teorinë tradicionale...”

<sup>4</sup> Pisani.V “Sulla genesi dell’albanese”, Akten Innsbruck, 1972, fq.346

<sup>5</sup> Pisani.V La lingua e lasua storia, Archivio Glottologico XXXI fq.8

kundërta, sepse, sipas tij<sup>6</sup>, përndryshe do të kufizoheshim në bërjen e historisë të një numri të pakët elementesh që ndodhen edhe tani në këtë gjuhë, parim që do ta përkrahte më pas dhe Çabej.

Pisani sjell një kontribut të njohur në artikujt e tij, “Sulla genesi dell’albanese”, Akten des internationalen albanologischen kolloquiums, Innsbruck”, 1972, “La lingua e la sua storia”, Archivio glottologico XXXI, Torino 1943, “Geolinguistica e indoeuropeo”, Torino 1940, “Lexikalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indogermanischen Sprachen” JKF 3/1 1955, “Albanica I”, Le sorti albanesi di *s* e di *i* indoeuropeo”.1947, “Albanais et langues indo-europeennes”, në “Annuaire de l’Institut de Philologie et d’Histoires Orientales et Slaves”, Bruksel 1950, “L’articolo posposto in albanese e questioni connesse”, në Studia Albanica 1969/1, Les origines de la langue albanaise. Question de principes et de methode”, në Stud. Alban. I, 1964. Në sistemin fonetik, tek vokalizmi, Pisani nxjerr përkimet që ka shqipja me gjuhët gjermanike dhe ato balto-sllave në shndërrimin **o:a** (*nox* = *natë*, *asht*=*όστειον*)(seria e shkurtër). Për Pisanin, tek gjuhët sllave zanorja **o** ka dalë nga një **a** ose **â**, më e vjetër, prandaj forma me **o** të sllavishtes *noć*, nuk është konservim i zanores i.e. **o**, prandaj ky grup gjuhësh mund të përfshihet në këtë izoglosë. Fenomeni paralel që ka ndodhur në sanskritisht dhe iranisht duhet të ketë ndodhur në mënyrë të pavarur, nga **e** i.e në **a**, shndërrim që ka ndodhur përmes një faze të ndërmjetme **o**, duke përfshirë këtu edhe nga **o** i.e në **a** në rrokjet në trup të fjalës dhe ato fundore (psh. *svasaram* < *\*suesorm*, përkundrejt *pitaram* < *\*peterm*). Më tej mund të shihet që në gjuhët gjermanike dhe ato balto-sllave, **o**-ja i.e është ruajtur për një kohë të gjatë, sidomos në rrokjet në mes dhe në fund të fjalës, ashtu siç u tha dhe për sanskritishten dhe iranishten, ndërsa tek huazimet nga gjuhët ungro-fine, dallohen ende **a** dhe **o** të vjetra. Duhet nënvizuar se shqipja nuk merr pjesë në shndërrimin për sa i përket zanores së gjatë **o** në **a**, sepse kemi tjetër refleks, **o** > **e**, p.sh. *ne* < *nos*, ndërkohë që **â** > **o** p.sh. *motër* < *mater*, e kundërta e asaj çfarë ka ndodhur në gjuhët gjermanike dhe balto-sllave. Sipas Pisanit, në shqip **e** është shndërruar fillimisht në **a** për të kaluar më pas në **o**, ashtu si **a** indoevropiane, psh. (*im*)pletus > *i* plotë.<sup>7</sup>

Përsa i takon diftongjeve, refleksi **i** < **ei**, p.sh. *dimër* = *χειμων*, nuk paraqet ndonjë rëndësi të veçantë, pasi është një fenomen shumë i përhapur në gjuhët i.e. Përkundrazi historia e diftongjeve të tjerë i.e. paraqitet mjaft interesante. Para se

<sup>6</sup> Pisani. V, Albanais et langues indo-europeennes, në “Annuaire de l’Institut de Philologie et d’Histoires Orientales et Slaves”, Bruksel 1950. fq.521

<sup>7</sup>Shih edhe K.Topalli, “Fonetika historike e gjuhës shqipe” 2007 fq. 94. ku mbështet këtë mendim se /e/ është bashkuar që në kohë parahistorike me zanoren /a/ ashtu si në gjuhët e degës indo-iraniene.

gjthash, gjithë diftongjet në **a**, kanë një zhvillim të ndryshëm nga ata në **o**, çka tregon se shkrirja e dy zanoreve të diftongut nuk është shumë e hershme për Pisanin:

**ai, au > a:** *gjalmë*: gjerm. *Seil* (rrënja \**sail-mo*-)  
*agoj*: lat. *augeo*;<sup>8</sup>

Për sa i përket refleksit **ai > a**, shembulli del edhe tek Çabej, ndërsa për refleksin ka pasur mendime të ndryshme. Sipas Meyer-it, refleksi i diftongut të hershëm i.e ka qenë **ai > e**, mendim të cilin e mbështet edhe M. Huld<sup>9</sup> e K. Topalli<sup>10</sup>, ndërsa Çabej tek studimet e tij etimologjike<sup>11</sup> po me shembullin që jep edhe Pisani (*gjalm*), por edhe në analizën etimologjike të *gja*<sup>12</sup> mendon që diftongu i.e. **ai**, bashkë me diftongun tjetër **oi**, kanë dhënë /a/, por në lidhje me *gjalm* mendon të ketë ardhur nga një bazë \**gelm*, ndërsa më vonë i rikthehet mendimit të Meyer-it, kurse S.Man mendon se ky diftong në fund të fjalës ka dhënë -**aj**<sup>13</sup>, por ky mendim nuk i shpëton kritikave<sup>14</sup>, ndërsa Demiraj nuk mban një qëndrim, duke e quajtur ashtu si dhe për refleksin e diftongjeve të tjerë i.e. në shqipe, “të vështirë, në mos të pamundur, të përcaktohen disa rregulla përgjithësuese”<sup>15</sup>. Ndërsa diftongjet indoevropiane **oi,eu** dhe **ou > e**: shq. *verë* = (F)οινοϋς; shq. *shteg* = got. *staiga* (rrënja \**steigh*-); shq. *desha* = ε/γευσα/μεν, shq. *re* = gjermanishte e vjetër veriore, *rouh* (tym).<sup>16</sup>

Këtë zhvillim të diftongjeve i.e. Pisani e gjen të ngjashëm me armenishten<sup>17</sup>, ku **ai** dhe **au** kanë qenë të ruajtura, (p.sh. arm. *ayc* 'dbr' = gre. αιξ; arm. *au-t* 'strehë nate' = gre. αυλις).

**ei** ka dhënë **i**, p.sh. \**ji*- = χειμερινοϋς, por **oi** ka dhënë **e**, ndërsa **eu** dhe **ou** kanë dhënë **oi**, arm. *dez* (mur) = gre. τοιχοϋς, përballë, arm. *loys* (dritë) = gre. λευχοϋς, arm. *p'oyt'* (zell) = gre. σπουδι.

<sup>8</sup> Pisani.V, vep e cit. fq. 523

<sup>9</sup> Huld.M, “Basic Albanian etymologies”, Los Angeles 1984, fq.154

<sup>10</sup> Topalli.K. “Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes”, Tiranë 1998 fq.36

<sup>11</sup> Çabej.E, “Studime rreth etimologjisë në fushë të shqipes” Vëll.IV, Tiranë 1996, fq.312-313

<sup>12</sup> Çabej E. “Studime etimologjike në fushë të shqipes” Vëll.IV, Tiranë 1996, fq.310-311

<sup>13</sup> Mann.S “The indo-european vowels in Albanian” në Language, London 1950, fq.386

<sup>14</sup> Shih tek Topalli.K, “Zhvill. hist. dift. shqipes” 1998, fq.37

<sup>15</sup> Demiraj.Sh, “Fonologjia historike e gjuhës shqipe”, Tiranë 1996, fq.89

<sup>16</sup> Këto reflekse janë përgjithësisht të pranueshme nga gjuhëtarët. Shih Topalli.K, “Zhvill.hist.dift.shqip” Tiranë 1998, fq.38-57 dhe Demiraj.Sh. në “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” 1996, fq.90-92.

<sup>17</sup> Pisani.V “Ricerche linguistiche”, 1950, fq.165

Nëse në shqipen, ngjan që **ou** (nga **eu** dhe **ou**) të jetë shndërruar fillimisht në **oi**, më pas së bashku me **oi** janë kthyer në **e**<sup>18</sup>, në armenisht diftongu i lashtë i.e **oi** është kthyer në **e**.

Në një fazë të mëvonshme **ou** ka dhënë **oi**, një diftong më të ri, i cili këtë radhë është ruajtur në armenisht.

**Shqip**

**ei>i, ai, au >a**

**oi, ou, eu> e**

**Armenisht**

**ei>i, ai dhe au ruhen**

**I. oi> e II. ou, eu>oi**

Sipas Pisanit, nëse këto fakte janë të lidhura historikisht, mund të mendojmë që tek shqipja dhe armenishtja ka ndodhur refleksi **e<oi** dhe **oi<eu, ou**, ndërsa në një periudhë të mëvonshme, **oi** në shqip, ndryshe nga armenishtja, sërish u shndërrua në **e**, që ndoshta mund të lidhet me dukurinë që ndeshet tek gjuhët sllave **ai** (refleks i diftongjeve i.e. **oi,ai**) > **e**<sup>19</sup>. Një përkim tjetër të shqipes me armenishten në sistemin fonetik, tek zanoret, Pisani gjen në zhvillimin **ens>ish**, shq.**mish**=arm.**mis** nga një \***mems-**, krhs. sllav.**meso**, lat. **membrum**. Kalimi **i < e** përpara një nazaleje, është një zhvillim normal fonetik në armenisht, ndërsa në shqip, për Pisani-n, e kemi vetëm në raste të izoluar, madje edhe shembujt e Meyer-it, ai i kritikon si të pasigurt ose të gabuar, të dhënë për këtë refleks.<sup>20</sup>

Në shqip ashtu si në një pjesë të gjuhëve sllave, vihet re procesi hundorëzimit të zanoreve përpara **n,m** + bashkëtingëllore, me rënien e bashkëtingëllores hundore, nën shtypjen që krijojnë rrokjet e mbyllura. Por dukuria e hundorëzimit në gjuhën shqipe ngjan të jetë, së pari një zhvillim i periudhës historike të shqipes, dhe nëse mund të flitet për lidhje gjuhësore për këtë fenomen, më parë mund të hiqen paralelet me rumanishten ku ka ndodhur edhe rotacizmi. Madje, sipas Çabejt, “nazalizimi i shqipes ka një lidhje historike me atë të rumanishtes. Po kështu edhe rotacizmi në shqipen dhe rumanishten lidhen me nazalizimin, sepse rotacizmi ka të bëjë me vokalet nazale..” (*Studime gjuhësore II*, Prishtinë 1970, fq.120). Por Demiraj mendon që kemi të bëjmë me një zhvillim të brendshëm, të pavarur, në gjuhën shqipe.<sup>21</sup>

<sup>18</sup>Sipas K.Topallit, i cili zgjeron mendimin e S.Mann-it, o>a, si rrjedhim -ou- është bashkuar me -au-, ashtu si -ai- me -oi- duke dhënë më pas të dy këto diftongje kanë dhënë /e/. Shih Topalli vep. e cit. fq.56

<sup>19</sup>Për këtë refleks shih vërejtjet e mësipërme për shembullin *gjalm*.

<sup>20</sup>Pisani, V, Albanais et langues indo-europeennes, në “Annuaire de l’institut de Philologie et d’Histoires Orientales et Slaves”, Bruksel 1950. fq.523, ku shprehet se shembujt e dhënë nga G.Meyer në Alb.Stud.III,fq.85 janë të pasigurtë, ose të gabuar.

<sup>21</sup>Demiraj.Sh.”Fonologji hist.gjuh.shqip.”Tiranë 1996, fq.80

Duke kaluar tek konsonantizmi, Pisani gjen që okluzivet e aspiruara indoevropiane, dalin në gjuhën shqipe si okluzive të zëshme, duke bërë që kjo gjuhë të marrë pjesë në një izoglosë që përfshin një numër të madh të gjuhëve indoevropiane, duke lënë jashtë vetëm disa zona anësore, si indishtja, greqishtja, latinishtja dhe osko-umbrishtja.<sup>22</sup> Këtu Pisani ndjek metodën e Bartolit, nga e cila, ky i fundit, nxori normën e gjuhëve qendrore dhe anësore, por ndryshe nga ky i fundit çapirimin e sheh si një risi dhe jo si një prirje konservative.

Duke vërejtur të pazëshmet indoevropiane që sonorizohen në shqip, në grupin bashkëtingëllor *nt* kemi zhvillimin në *nd*, psh. shq.**dhëndër** = lit.**žentas**; shq.**ndenj** = gre. εν-τενω; diçka e ngjashme ka ndodhur edhe tek **zet**, tek numërori 20, ndaj greqishtes εΙΧΟΣΙ, sanskr. **vimçati**, ku **z** mund ta ketë burimin nga **k'** e sonorizuar pas një bashkëtingëlloreje hundore në formë analoge me trajtën e fjalës në sanskritisht. Për E.Çabejn, vështirë se **-zet** të ketë ardhur nga **\*-k'm<sup>o</sup>t**, pasi shndërrimet **k<sup>o</sup>>z** dhe **m<sup>o</sup>** apo **n<sup>o</sup>>e**, janë të pavërtetuara për shqipen, **-zet** i përgjigjet më shumë gr. ζευχτος.<sup>23</sup> Ky proces i sonorizimit të bashkëtingëlloreve të shurdhëta pas një nazaleje, gjendet edhe në armenisht.

Por përse i takon origjinës së shqipes, ai asnjëherë nuk shfaq mëdyshje në lidhje me vazhdimësinë e shqipes nga ilirishtja, ose më saktë, të gjuhës së shqiptarëve nga disa dialekte ilire, pavarësisht nga ndikimet prej gjuhëve tjera të Ballkanit antik, si trakishtja, mbi të cilën vetë Pisani thotë se është e vështirë dallimi i kufirit që ndan atë me ilirishten<sup>24</sup>. Historinë e shqipes, Pisani mundohet ta ndriçojë përmes zbatimit të metodave neolinguiste, shtresëzimit kronologjik të materialit gjuhësor, pasi **një gjuhë është shuma e disa dialekteve ku zotërojnë izoglosat e përbashkëta**. Çështja që duhet sqaruar, thekson Pisani, është formacioni gjuhësor që paraqet ilirishtja. Përcaktimi hapësirës gjeografike të ilirishtes të folur si gjuhë nuk mund ndërthuret me shtrirjen e fiseve ilire në Ballkan, apo dhe më tej. “I ndjeri panilirizëm, që vërshoi ndërmjet viteve tridhjetë e dyzet, ishte një përshtjellim makroskopik i këtyre koncepteve, që projektohej në kohët parahistorike. Por, edhe nëse kufizohemi, në mënyrë modeste të flasim për ilirë duke iu referuar popullsive të cilave historianët e lashtë ua jepnin këtë emër, do të jetë përherë me vend të kihen parasysh kuptimet e mundshme të atij emri. Për shembull a do të kenë folur të njëjtën gjuhë të gjithë shtetasit e mbretëreshës Teuta?”-shprehet Pisani<sup>25</sup>. Prandaj, detyra që del përpara gjuhëtarit është përcaktimi i grupeve të dialekteve që formonin ilirishten, duke evidentuar izoglosat e përbashkëta mes tyre.

<sup>22</sup> Pisani.V, Geolinguistica e Indoeuropeo fq.11.

<sup>23</sup> Çabej E. “Studime etimologjike në fushë të shqipes” Vëll.VII, Tiranë 2006, fq.289-290.

<sup>24</sup> Pisani V. Sulla genesi dell'albanese, në Acten Innsbruck, 1972, fq.352-353

<sup>25</sup> Pisani V. “Ilirët në Itali”, në Kuvendi i studimeve ilire Vëll.II Tiranë 1974, fq.82



Pisani është ndër studiuesit e parë që dëshmoi se venetishtja nuk ishte një dialekt ilir, mbi të cilin shumë gjuhëtarë mbështeteshin për të vërtetuar karakterin kentum të ilirishtes, argumenti kryesor gjuhësor i përdorur nga mjaft dijetarë për mohimin e lidhjes iliro-shqiptare.<sup>26</sup> Venetishtja afrohet në disa izoglosa me Ilirishten po ashtu si me grupin e gjuhëve gjermanike, baltosllave dhe trakishten. Në periudhën indoevropiane, venetishtja së bashku me ilirishten duhet të kenë qenë dialekte i.e. që janë folur në Evropën qendrore dhe lindore, por, për Pisanin nëse faktet historike dhe ato pak materiale gjuhësore të japin të drejtë të mendosh për lidhjen gjuhësore etnike dhe gjuhësore të mesapishtes me ilirishten, të lidhësh këtë të fundit me venetishten nuk kemi asnjë motiv, sepse përkimet e rradha onomastike nuk tregojnë lidhjen gjuhësore, apo përkatesinë në të njëjtin grup gjuhësor, pasi gjurmë të ilirëve janë gjetur gjithandej në Evropë. Lidhjet mes ilirishtes dhe venetishtes për Pisanin, ”janë shumë larg të qenurit të vërtetuara, ato paraqesin veçse mirazhe, që për fat të dhënat gjuhësore nga prehistoria nuk na lënë të na turbullohet shikimi nga këto fantazma gjuhësore, që shpesh herë glotologët mezi presin t’ia veshin fjalën “*ilirisht*” duke mbuluar me të një grup konceptesh të lidhura ndërmjet tyre.”<sup>27</sup> Megjithëse me një ton disi të ashpër, në një recension të artikullit të Georg Stadmüller në lidhje me adtheun e parë të shqiptarëve<sup>28</sup>, Pisani mendon se atdheu origjinar i shqiptarëve dhe i gjuhës shqipe, nuk ka qenë një zonë e ngushtë gjeografike, brenda një zone të ngushtë, të izoluar malore. Duke kritikuar Stadmüllerin, Pisani mendon se vetë kërkimi i një “atdheu primitiv” duke ecur në teorinë e “*urbeimat*” (*drurit gjenealogjik* të nxjerrë për herë të parë nga Schleiheri) për indoevropianishten, është një metodë e gabuar po të ndiqet në kërkimet historike dhe gjuhësore të historisë dhe protohistorisë ballkanike, sepse bazohet në “koncepte të lindura nga romantizmi i viteve tetëqind, por që janë prej kohësh të superuara”<sup>29</sup>, gjë që vihet re edhe në studime të ditëve të sotme që përmendëm më sipër. Sipas tij, kufizimi territorit të “*protoshqiptarëve*” i bërë nga Stadmüller, nuk qëndron, pasi është e pamundur që shqiptarët e vjetër të kenë qenë një popullatë e përbërë nga disa fise barinjsh që jetonin në male dhe “fjalët e fushës” i morën nga popullsia e romanizuar e ultësirës, kur dimrit së bashku me bagëtinë zbrisnin nga “*atdheu i tyre malor*”. Me të drejtë Pisani pyet, po para pushtimit romak, ku i shpinin në stinët e ftohta tufat e bagëtive të tyre “protoshqiptarët”. Gjithashtu si mund të shpjegohet ekzistenca e fjalës vendase “*del*” tek shqiptarët nëse ata ishin banorë terriroresh të largëta prej tij, nëse paraardhësit e

<sup>26</sup>Pisani V. “Il problema Illirico, tentativo di delimitazione” në *Linguistica generale ed indeuropea*, Milano 1946, fq. 90-93.

<sup>27</sup>Po aty, fq.97.

<sup>28</sup>G. Stadmüller “Forchungen zur albanischen Frühgeschichte” në Archivum Europae centro-orientalis, vëll.VII.

<sup>29</sup>V. Pisani në *Linguistica generale ed indeuropea*, Torino1947,fq.103

shqiptarëve nuk do të ishin nënshtetasit e Romës, si do t'i shpjegohen huazimet latine që paraqet shqipja në sferën e familjes, si *ungj, prind, fëmijë, emtë, kunat*, etj. Koha që përcakton, Stadmülleri për periudhën e futjes së huazimeve latine në gjuhën shqipe, pak para dyndjes së sllavëve, më të cilët pas shek.VI, ndoqën të njëjtën vijëmsi si me popullsinë e romanizuar të ultësirës, sipas Pisanit është një mendim krejt i pambështetur, pasi në këtë mënyrë nuk mund të shpjegohet prania e një shtresëzimi të vjetër të huazimeve latine që nuk gjenden as në gjuhët neoromane. Edhe nga ana konceptuale, sipas Pisanit është tërësisht e gabuar t'i mvishet një populli vetëm një formë jetese, ajo e barinjve nomadë (Stadmuller, fq.80).

Botimet e linguitit të njohur italian, V. Pisani, mbi shqipen janë të shumta dhe konsiderueshëm voluminoze, ato janë mbledhur pothuaj të gjitha në një vëllim nga një studiues i palodhur, por i pazë për shkak të rrethanave që jetoi e punoi Luigj Marlekaj, material që ndodhet në bibliotekën françeskane të Shkodrës "Gjergj Fishta".

**Ragip GJOSHI**

**NDIHMESA E ALBANOLOGUT RUMUN GRIGORE BRËNKUSHI  
FILOLOGJISË SHQIPTARE**

*Nëse doni të zbuloni historinë para Krishtit dhe  
shkencat e asaj kohe, duhet të studioni gjuhën shqipe!*

Gottfried Wilhelm Leibniz-*albanolog,  
matematicent, filozof gjerman*

**Hyrje**

Gjuha shqipe dhe gjuha rumune dhe marrëdhëniet në mes tyre kanë qenë objekt studimi të disa gjuhëtarëve tanë dhe të huaj. Në mesin e shumë albanologëve të huaj do të duhej të veçoheshin treshja rumune, N. Jorga, J. A. Kandra dhe G. Brancus. Problemet themelore të gjuhësisë sonë historike janë përkushtim i filoshqiptarit, G.Brënkushi. Ai, me gjithë opusin e hulumtimeve albanologjike, sidomos me botimin e përmbledhjes së studimeve të kësaj fushe në librin “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”, të Institutit rumun të Takologjisë, Biblioteka Trakologjike-VIII, ka zgjuar kureshtjen e hulumtuesëve tanë. Në këto studime, prof. dr. Grigore Brancus (Brënkush), gjuhëtar i shquar rumun, albanolog me kontribut të jashtëzakonshëm me një kujdes të veçantë i ka trajtuar marrëdhëniet e gjuhës shqipe me rumanishten. <sup>1</sup>Si një njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe, puna e tij u reflektua edhe në rezultatet e veprimtarisë së tij shkencore e veçanërisht, në aktivitetin didaktik universitar për afër gjysmë shekulli. Kërkimet shkencore të Brënkushit janë ndihmesë në zbardhjen e çështjes së elementeve të përbashkëta dhe ngjashmërive ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj rumune. Interesimin për problemet gjuhësore të albanologjisë ai e kishte filluar më herët, por punën shkencore

---

<sup>1</sup> Të dhënat biografike dhe bibliografike për G.Brënkushin kryesisht janë mbështetur te studiuesit, dr. Luan Topçiu dhe Baki Ymeri si dhe tek artikulli Th. Capidan, Simbioza Albano-Română și continuitatea românilor în Dacia (Simbioza Shqiptaro-Rumune dhe kontinuiteti i rumunëve në Daki), në Revista Fundaților regale, nr.5, Bukuresht 1943, f. 244.

e kurorëzoi me mbrojtjen e tezës “Marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare”, me të cilën fitoi titullin Doktor në filologji në vitin 1968. Ai ka ndjekur edhe disa studime specializimi në Shqipëri në vitet (1958-1959, 1965, 1972). U formua si albanolog nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Aleksandër Xhuvanit dhe Eqrem Çabejt. Grigore Brënkushi ka botuar studime të shumta. Në fushën e filologjisë për gjuhën rumune ai ka lënë disa vepra. Ndër to janë :“Sinteza të gjuhës rumune” (1972), “ Gjuha rumune moderne”, “Morfologjia e foljes” (1975), ka qenë bashkëpunëtor në hartimin ”Fjalori i gjuhës rumune moderne”, ” Fjalori autokton i gjuhës rumune”etj. Ndërsa, në fushën e albanologjisë ai ka lënë opus të pasur krijues,si: “Elementet e përbashkëta rumune-shqiptare” (1987), “Studime rreth fondit trako-dak të gjuhës rumune” (1995), “Përkime gjuhësore shqiptare-rumune” (2001), “Hyrije në historinë e gjuhës rumune”( 2002) etj. Në qendër të vëmendjes shkencore, ai për gjatë gjithë jetës kishte, “Hetimet në thellësi të marrëdhënieve rumuno-shqiptare, duke sjellë elemente origjinale dhe perspektiva të reja në problemin aq të diskutueshëm të “substratit të përbashkët të dy gjuhëve”.<sup>2</sup>Ai, në vitin 1968, mbrojti doktoratën me tezën “Lidhjet linguistike rumuno-shqiptare”. Është autor i një numri të madh studimesh mbi problemet e historisë së gjuhës, të dialektologjisë, të morfologjisë së fjalës, të gjuhës letrare. Në fushën e leksikologjisë dha kontribut për hartimin e Fjalorit akademik të gjuhës rumune, ndërsa në fushë të filologjisë shquhet për botimin kritik të veprës monumentale “Etymologicum Magnum Romaniae”, të B.P. Hashdeu. Ndërkaq, vepra e G. Brënkushit, “Fjalori autokton i gjuhës rumune” (1983), që është teza e tij e doktoratës, nxjerr në pah fondin e përbashkët të rreth njëqind fjalëve të sigurta, që i ka shqipja me rumanishten dhe të po aq fjalëve të tjera, që kanë ngjashmëri të mundshme. Në këtë kontekst shquhen edhe veprat e tjera të tij, si “Historia e fjalëve” (1991), “Hulumtime mbi fondin trakodak të gjuhës rumune” (1995), “Konkordanca linguistike rumuno-shqiptare” (1999). Në përkthimin e tij, në vitin 1967, **Bukureshti** botoi librin e parë të Migjenit në gjuhën rumune “Fructul oprit” (Fryti i ndaluar). Profesor Brënkushi mbështeti prejardhjen trako-ilire të shqiptarëve, duke e zgjeruar territorin autokton shqiptar, deri në brigjet e Moravës (Dardania). Ai në takimet e tij me komunitetin shqiptar në Rumani dhe kudo në letërkëmbimet e tij shpreh me admirim respektin për shqiptarët e Shqipërinë.“Më ka marr malli ta shoh Shqipërinë. Aq shumë më ka marrë malli, saqë kam filluar ta konsideroj Shqipërinë si atdheun tim të dytë...! Gjuha shqipe është jeta ime. Shqipja na ndihmon ta deshifrojmë jo vetëm substratin e gjuhës rumune, por, përmes zhvillimit të

<sup>2</sup> Baki Ymeri, doktorant i Universitetit të Bukureshtit, “Më ka marrë malli ta shoh Shqipërinë”(fjalë rasti e poetit e ,përkthyesit e studiusit shqiptar në Bukuresht),në manifestimin “ Filoshqiptarët e Bukureshtit-Albanologu Brënkush në 75 vjetorin e tij”,Bukuresht, 2004.

saj fonetik, ajo na ndihmon ta identifikojmë edhe toponominë tonë madhore”<sup>3</sup>. Kështu, këtë albanolog të huaj e gjejmë të rreshtuar në shkollën e gjuhëtarëve tanë të mirënjohur, të viteve të shekullit të kaluar, duke patur për udhëheqës Eqrem Çabejn<sup>4</sup> këtë kolos të albanologjisë. Për të hedhur dritë mbi kontributin e veprës studimore të filologjisë dhe opusit të tij shkencor, lidhur me argumentet, se gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik; për të treguar respekt për një thesar që la pas vetes filologjinë shqiptare dhe i motivuar nga thellësia e trajtimeve të tij, por edhe për të mos ndodhë “harresa” e për “të larë pak borxh” për zhgënjimin e këtij albanologu rumun që ai e kishte shfaqur, lidhur me përkujdesin e pamjaftueshëm për filoshqiptarët, ju qasa me këtë vështrim një segmenti të ndihmesës së tij për filologjinë tonë. Ai, në një rast e kishte shprehur indinjatën e tij, duke shfryrë “Më shumë përkujdesej ndaj nesh administrata e Enverit, se sa kjo e tranzicionit”! Prof. dr. G. Brënkushi prioritet shkencor kishte që të argumentojë fqinjësinë antike, trako-ilire, andaj në trajtesën time po prezentoj disa qasje lidhur me elementet e përbashkëta ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj rumune, ngjajshmëritë e ardhura përmes një bashkëjetese të këtyre dy popujve në një rajon të vetëm. Në këtë kontiunitet ngjashmërie duket se fillet e shënimit të shkëputjes burojnë nga koha kur nisën ardhjen sllavët, duke shkëputur romanitetin ballkanik. Albanologët rumunë e edhe Brënkush, konstatojnë se ky është momenti historik i udhëve të ndara të dy gjuhëve dhe dy popuj që jetuan me shekuj pranë njeri-tjetrit. I ndikuar nga Çabej edhe Brënkush e shpjegon fenomenin e fqinjësisë dhe lashtësisë parasllave, rumuno –shqiptare, sepse, duke konstatuar afërsinë ndërmjet shqipes dhe rumanishtes, Çabej vlerësonte se “gjatë një periudhe prej disa shekujsh të historisë së tyre, kanë ecur krah për krah në Gadishull të Ballkanit”.<sup>5</sup> Objekt i trajtesës sime, ku reflektohet ndihmesa e filologut rumun, janë kundrimet nga libri ku janë përmbledhur nëntë studime të prof. dr. G. Brënkushit, e që është pagëzuar, “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”. Studiuesi bashkëkohor rumun, Grigore Brënkush (Grigore Brâncuș), në versionin shqip, me një përkthim brilant nga rumanishtja erdhi nga Luan Topçiu, njohës i shkëlqyer i gjuhës dhe kulturës rumune. Këto trajtesa të filologut rumun janë organizuar sipas këtyre përmbajtjeve: Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit; Një mënyrë fjalëformimi e përbashkët për

---

<sup>3</sup> Në një letër, të cilën në vitin 1959 Brënkush ia kishte shkruar Aleksandër Xhuvanit, ky studius i pasionuar i gjuhës shqipe shpreh gjithë dashurinë për këtë gjuhë të lashtë

<sup>4</sup> Prof. dr. G. Brënkushi: “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune” (Përmbledhje artikujsh), Botim i Shtëpisë Botuese 55, Tiranë 2009, fq.4.. Shih E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1975, fq. 170 . Shih S. Poçi, “Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre” Tiranë, 2009, fq.53-58 Studime Albanologjike.

<sup>5</sup> E. Çabej, “Studime Gjuhësore” (Vëllimi III) Prishtinë, 1987, fq.78.

rumanishten dhe shqipen; Elementë leksikorë autokton në dialektin arumun; Zanorja ã/ë; Bashkëtingëllorja h; Bashkëtingëllorja ș/sh; Rotacizm; ,Origjina e strukturës së numërorit në rumanisht dhe Shënime mbi prapavendosjen e nyjes së shquarsisë.<sup>6</sup> Në këto studime, para lexuesit shqiptar rifreskohen shembuj të afërsisë midis rumanishtes dhe shqipes. Në nëntë studimet e tij hetohet se elementet e substratit të rumanishtes janë të njëjtit rang me ato shqipe të konsideruara vetëm si “huazime” të kryera në latinishten danubiane. Në këtë vëllim prezentohet edhe aftësia për t’u transferuar në onomastikë e emrave të përbashkët të substratit. Brënkushi si “nxënës” i mirë i shkollës së vërtetë të albanologjisë së Eqrem Çabejt, pati ndikim, edhe në hulumtimet e Aleksandër Xhuvanit, studimet e Mahir Domit, Spiro Floqit dhe Shaban Demirajt. Në përmbledhjen e studimeve, që kryesisht i përkushtohen substratit gjuhësor të rumanishtes, dy nga studimet (Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit dhe Shënime mbi prapavendosjen e nyjes së shquarsisë) botohen për herë të parë, kurse të tjerat ishin të botuara në revistat rumune. Disa nga studimet hetohet se janë ribërë, veçanërisht ato që i kushtohen zanores ã dhe bashkëtingëlloreve h dhe ș . Në veprën e filologut rumun kërkimet janë të fokusuar në fjalorin, fonetikën, gramatikën, lidhur me veprimet e substratit trako-dak mbi latinishten danubiane, kryesisht përmes krahasimit historik me shqipen

*Etnogjeneza e gjuhës shqipe nuk mund të shqyrtohet pa in qasur të njëjtit problem edhe për gjuhën rumune*

Prof. dr. G.Brënkush, në fushën e relacioneve linguistike rumuno-shqiptare është i bindur se në periudhën parasllave trakasit dhe ilirët ishin popuj që jetonin pranë njëri-tjetrit. Brënkush është mbrojtës i tezës se në periudhën trako-ilire (parasllave), Shqipëria kufizohej me Rumaninë. Sipas tij, marrëdhëniet midis këtyre dy popujve, e më pas edhe dy gjuhëve janë parë me interes nga të gjithë gjuhëtarët që i ka preokupuar shqipja dhe rumanishtja, që nga Hahni, N. Jokli, G. Weigandi, A. Philipides, Thunman, Xhuvani, Çabej, Demiraj, etj. Ky albanolog argumenton se populli shqiptar shfaqet në horizontin e historisë gjatë shek. II. nga nënshtarti ilirik. Është kjo periudhë historike që për herë të parë nxjerrë në spikamë në territorin aktual të Shqipërisë, një fis me emrin Albanoi, me qendër qytetin Albanopolis. Brënkushi me kujdes kishte studiuar veprat e Bogdan Petriçiuku Hashdeut, Nikolla Jorgës, Teodor Kapidanit, dhe albanologëve të shkollës gjermane dhe shqiptare. Në këtë rrugëtim, ai heton se ndërmjet gjuhës rumune dhe gjuhës shqipe ekziston fond elementesh të përbashkëta, në të cilën është krijuar

<sup>6</sup> Prof. dr. G. Brënkushi: “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune” (Përmbledhje artikujsh), Botim i Shtëpisë Botuese 55, Tiranë 2010.

nënshtresa e fjalëve më të vjetra dhe më të bukura që i kanë shqipja dhe rumanishtja. Prof. dr. G. Brënkush, shkencërisht me bindje thotë se *“shqipja është një gjuhë e një rëndësie të jashtëzakonshme për identifikimin e elementeve jolatine të rumanishtes”*.<sup>7</sup> Madje, si dhe shumë gjuhëtarë edhe filologu rumun Brënkush pajtohet dhe se *“etnogjenezën e popullit shqiptar dhe gjuhës shqipe e sheh të vështirë për t’u studiuar, shqyrtuar e sqaruar bindshëm pa iu qasur të njëjtit problem edhe për gjuhën dhe popullin rumun.”*<sup>8</sup> Për gjuhën shqipe, shpjegimi i formave të lashta bëhet së pari nëpërmjet krahasimit të brendshëm dhe në vijim të tij, si një element ndihmës, vjen krahasimi i jashtëm me gjuhët e tjera e në veçanti me rumanishten. Kjo ka bërë që në studimet e thelluara të prof. E. Çabejt krahasimi midis këtyre dy gjuhëve të jetë i përhershëm e i shtrirë në të gjitha nënsistemet e gjuhës. Bashkëpërkimet e gjuhës popullore të dy popujve i gjejmë edhe në veprën e A. Xhuvanit, të sintaksës të M. Domi e S. Floqi. Këta studiues<sup>9</sup> janë marrë drejtpërdrejt me marrëdhëniet e shqipes e të rumanishtes, por ka edhe të tjerë që në punimet e tyre për historinë e gjuhës shqipe i janë drejtuar herë pas here krahasimit me rumanishten sikurse ka ndodhur në veprën e Sh. Demirajt, K. Topallit e S. Mansakut. Për rumanishten krahasimi me shqipen është i domosdoshëm, për të sqaruar problemin e gjenezës së gjuhës dhe të kombit rumun<sup>10</sup>. Midis gjithë gjuhëve ballkanike që kanë trajta të përbashkëta me shqipen, *vendin e parë e zë pa dyshim gjuba rumune. Shqipja dhe rumanishtja kanë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, morfologjisë, leksikut, të formimit të fjalëve, të sintaksës dhe frazeologjisë, të fjalëve të urta dhe lokucioneve proverbiale, aq sa, pa lënë jashtë vëmendjes ndryshimet, shpesh ke përshtypjen se është fjala për një gjuhë të vetme në dy forma të ndryshme. Në këtë kuptim, marrëdhëniet midis këtyre dy gjuhëve mund të zëvendësojnë, në një masë të caktuar periudhën e tyre paraletrare. Mendoj se këto lidhje mund të vlerësohen nën dritën e së vërtetës vetëm atëherë kur*

---

<sup>7</sup> Sipas lingvistit Jon Aurel Kandra, nëse sot kemi një gjuhë shqipe dhe një rumune, kjo i detyrohet një ngjarjeje të thjeshtë: kanë ardhur Sllavët dhe e kanë ndërprerë këtë masë të madhe rumuno ballkanike, duke i ndarë njëherit këta dy popuj që jetonin me shekuj së bashku (“Gjuha shqipe dhe raportet e saj me gjuhën rumune”, kurs universitar i mbajtur në Fakultetin e Filologjië dhe Filozofisë, Bukuresht 1930-1931, fq. 69-70).

<sup>8</sup> Vështirësitë e kësaj problematike janë për shkak të dokumentimit të vonë të të dyja gjuhëve (afërsisht në të njëjtën kohë). Teksti më i vjetër në rumanisht është një letër e shkruar në alfabet cirilik e qershorit 1521, në të cilën Neaçsu i Câmpulungut i shkruan kreut të Braşovit rreth një sulmi të mundshëm të turqve dhe teksti më i vjetër shqip “Formula e pagëzimit” e Pal Engjëllit.

<sup>9</sup> E. Çabej, Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumuno-shqiptare, SF, 1, 1975; Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, Studime gjuhësore, III, Prishtinë, fq. 74 .M. Domi, Concordances et analogies syntaxiques albano-roumaines “ Actes du premier Congres Internat. des etudes balkaniques et sud-est europeenes” Sofia, 1968, f. 681-695; Përkime e paralelizma sintaksore shqipe-rumune, SF, 3, 1981, f. 21-31.

<sup>10</sup> Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, f. 242.

do të shikohen në kuadrin më të gjerë të marrëdhënieve kulturore të këtyre dy popujve.<sup>11</sup> Kjo duket se është arsyeja që ka ngacmuar dhe vazhdon të bëhet objekt studimi prej kohësh edhe për rumunët, të cilët në mënyrë të vazhdueshme, për të sqaruar problemet historike të gjuhës së tyre, i drejtohen krahasimit me gjuhën shqipe. Në vazhden e këtyre përpjekjeve të pandërprera vjen edhe libri i Grigore Brâncus-it<sup>12</sup> *“Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”*. Në hyrje të kësaj vepre autori parashtrohet disa parime mbi të cilat është mbështetur, çështje të metodës së ndjekur etj. Artikujt e përfshirë në këtë vëllim prekin të gjitha nënsistemet e gjuhës, si: leksikun, gramatikën e fonetikën. Vërehet se autori ka shfrytëzuar një literaturë të pasur për t’i dhënë përgjigje çështjeve të mësipërme dhe është mbështetur në trajtimin e tyre edhe te studiuesit e mëparshëm e bashkëkohorë, të huaj ose rumunë, si: B. P. Hasdeu, B. Kopitar, Fr. Miklosich, W.Meyer-Lubke, Al. Graur, Al.Rosetti, S. Puscariu, I. Russu etj. Të gjithë studiuesit rumunë i kanë shprehur mendimin se trajtat që i atribuohen substratit në rumanisht mund të studiohen me sukses vetëm përmes krahasimit historik me shqipen. Në këtë hulli vijon edhe autori, i cili shprehet *“Një ndikim i thjeshtë (shqipja mbi rumanishten apo anasjelltas) nuk mund të shpjegojë numrin kaq të madh të ngjashmërive midis këtyre dy gjuhëve; vetëm përmes substratit mund të justifikohen trajtat e përbashkëta befasuese”*.<sup>13</sup>

Duke pasur për bazë “teorinë e substratit”, Grigore Brâncus, në artikujt e mësipërm, çështjet gjuhësore të pazgjidhura, apo të diskutueshme për rumanishten, përpiqet t’i sqarojë përkatësisht, duke i krahasuar edhe me gjuhën shqipe. I gjithë punimi udhëhiqet nga koncepti se *“diversiteti i trajtave që i atribuohen substratit, mund të studiohet me sukses, në radhë të parë, përmes krahasimit historik me shqipen”*.<sup>14</sup> Duke u ndalur në këtë pikë, sipas teorisë së substratit, ky albanolog pohon se shqipja vjen pandërmjetshëm nga një gjuhë jogreke e Ballkanit të lashtë. Sipas kësaj teze që nga Pedersenit e këtej është provuar që shqipja është vijuese e pandërprerë e një gjuhe satem të Ballkanit<sup>15</sup>. G. Brâncus, në vijim të argumentit të tij arrin në përfundimin *“...shumë afër së vërtetës më duket hipoteza që ngjashmëritë midis dy gjuhëve shpjegohen nga një gjuhë e tretë që flitej në këtë zonë në periudhën*

<sup>11</sup> Eqrem Çabej, „Disa probleme të historisë së gjuhës shqipe”, në SCL, 4, 1959, fq. 531.

<sup>12</sup> Prof. dr. G. Brënkushi: *“Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”* (Përmbledhje artikujsh), Botim i SHB 55, Tiranë 2009 (Disa nga punimet e tjera të këtij filologu rumun me kontribut të madh janë: “Despre valoarea aoristului in albaneze”, SCL, 1960, 1; “Paralele frazeologjike rumuno-albane”, SCL, 1960, 4; “Observatii asupra etimonurilor albaneze din” DLRM, 1961, 2; “Originea consoanei Hdin limba româna”, SCL, 1961, 4; *Vocabolarul autobon al limbii romane*, Bucuresti, 1983.)

<sup>13</sup> G. Brâncus, po aty, f. 9.

<sup>14</sup> G. Brâncus, po aty, f. 6

<sup>15</sup> H. Pedersen, “Die guttural im Albanesischen”, KZ, 36. 1900, f. 35; E. Çabej, *Fonetika historike e shqipes*, 1960, f. 109. Në qerthullin e këtyre teorisë ekziston edhe ajo që supozon praninë e një gjuhe më të lashtë në këto troje se ardhja e trakasve dhe ilirëve.



*pararomake*". Siç e thekson edhe vetë, objektiv i punës së tij nuk janë dallimet që ekzistojnë në të dyja gjuhët, por ngjashmëritë e përkimet, që janë më të pakta, por shumë të rëndësishme. Është dëshmuar shkencërisht se marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, herë-herë janë mbuluar nga gjykime të errëta, që kishin krijuar një përshtjellim mbi natyrën e këtyre marrëdhënieve. Shkak për një gjykim jo të drejtë ishte bërë mungesa e dokumentacionit për pjesën jogreke të Ballkanit antik. Vështirësitë erdhën nga shkaku se të dyja këto gjuhë kanë një dokumentim të vonë me shkrim (shek XV-XVI). Të gjitha këto i çuan shumë studiues në përfundime të gabuara. Disa studiues tanë vërtetojnë se marrëdhëniet midis shqipes e rumanishtes vështrohen si bashkëpërkime karakteristike vetëm për këto dy gjuhë dhe si bashkëpërkime të dy gjuhëve që bëjnë pjesë në lidhjen gjuhësore ballkanike.<sup>16</sup> Edhe E. Çabej, vlerëson se: "*Gjuhësia ballkanike merr në shqyrtim edhe analogjitë e përgjithshme dhe konkordancat pjesore*".<sup>17</sup> Ky filolog i përmasave të albanologëve më të mëdhenj të huaj është i bindur se "*Etnogjeneza e popullit shqiptar dhe gjuhës shqipe nuk mund të shqyrtohet e sqarohet bindshëm pa iu qasur të njëjtit problem edhe për rumunët dhe gjuhën rumune*".<sup>18</sup> Për gjuhën shqipe, shpjegimi i formave të lashta bëhet së pari nëpërmjet krahasimit të brendshëm dhe në vijim të tij, si një element ndihmës, vjen krahasimi i jashtëm me gjuhët e tjera e në veçanti me rumanishten. Kjo ka bërë që në studimet e thelluara të prof. E. Çabejt krahasimi midis këtyre dy gjuhëve të jetë i përhershëm e i shtrirë në të gjitha nënsistemet e gjuhës. Bashkëpërkimet e gjuhës popullore të dy popujve i gjejmë edhe në veprën e A. Xhuvanit, të sintaksës të M. Domi e S. Floqi. Këta studiues<sup>19</sup> janë marrë drejtpërdrejt me marrëdhëniet e shqipes e të rumanishtes, por ka edhe të tjerë që në punimet e tyre për historinë e gjuhës shqipe i janë drejtuar herë pas here krahasimit me rumanishten sikurse ka ndodhur në veprën e Sh. Demirajt, K. Topallit e S. Mansakut.

Në këtë këndvështrim edhe Brënkushi pajtohet se për rumanishten krahasimi me shqipen është i domosdoshëm për të sqaruar problemin e gjenezës së gjuhës dhe të

---

<sup>16</sup> Karagozi-Kore, Mimoza: "Disa tipare të përbashkëta të shqipes e rumanishtes, të para në të gjitha nënsistemet," *Revista Filologji...* Tiranë; 2010.

<sup>17</sup> Zgjidhja e këtij problemi vështirësohet për shkak të dokumentimit të vonë të të dyja gjuhëve (afërsisht në të njëjtën kohë). Teksti më i vjetër në rumanisht është një letër e shkruar në alfabet cirilik e qershorit 1521, në të cilën Neac su i Câmpulungut i shkruan kreut të Brasovit rreth një sulmi të mundshëm të turqve.

<sup>18</sup> Karagozi-Kore, Mimoza: Grigore Brënkush (Grigore Brancus): *Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune* (Përmbledhje artikujsh), ITSH, Studime Albanologjike, nr.4, Shkup, 2011, fq.43.

<sup>19</sup> E. Çabej, "Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumuno-shqiptare", *SF*, 1, 1975; "Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten", *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, f. 74; M. Domi, "Concordances et analogies syntaxiques albano-roumaines", *Actes du premier Congrès Internat. des études balkaniques et sudest européennes*, Sofia, 1968, f. 681-695; "Përkime e paralelizma sintaksore shqipe-rumune", *SF*, 3, 1981, f. 21-31. 3 Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, f. 242.

kombit rumun. Libri i Grigore Brâncus-it<sup>20</sup>, “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”, që është vetëm një segment nga opusi i tij i pasur kërkimor lidhur me marrëdhëniet në mes këtyre dy gjuhëve ballkanike. Në këto studime lavrimi i G.Brënkushit ka vijuar në të njëjtën hulli.

Nga nëntë artikujt e këtij libri kam përzgjedhur për trajtim studimin: *Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit dhe Një mënyrë fjalëformimi e përbashkët për rumanishten e shqipen*. Lidhur me këto dy probleme, ky filolog, trajtimin e transferimit të substratit të fjalëve në onomastikë e vë në pah duke prekur të gjitha nënsistemet e gjuhës, si: leksikon, gramatikën e fonetikën. Për të hedhur dritë mbi këtë problematikë komplekse vërehet se autori ka shfrytëzuar një literaturë të pasur të albanologëve shqiptarë, rumunë dhe të huaj (tek studiuesit e mëhershëm, por edhe tek ata bashkëkohorë). Konstatimet e këtij autori i bën të besueshme edhe fakti se të gjithë studiuesit rumunë rreth trajtave që i atribuohen substratit në rumanisht janë të një mendimi. Ata janë të bindur se rumanishtja mund të studiohet me sukses vetëm përmes krahasimit historik me shqipen, vijon në të njëjtën arë dhe kanë ecur në të njëjtën vijë. Duke pasur për bazë “teorinë e substratit (nënshtesës)”, G. Brënkush, në artikujt e kësaj përmbledhje, çështjet gjuhësore të pazgjidhura, apo të diskutueshme për rumanishten përpiqet t’i sqarojë duke i krahasuar edhe me gjuhën shqipe. Ndërkaq, i gjithë punimi që po e trajtojmë ,udhëhiqet nga koncepti se konkluzion se “...shumë afër së vërtetës më duket hipoteza që ngjashmëritë midis dy gjuhëve shpjegohen nga një gjuhë e tretë që flitej në këtë zonë në periudhën pararomake”<sup>21</sup>. Autori nuk sqaron nëse për të kjo “gjuhë e tretë” është ilirishtja, apo trakishtja, apo një gjuhë tjetër<sup>22</sup>, sepse për shqipen nuk ka ndodhur ndërrim gjuhe.

*Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit –reflektim i thellësisë së marrëdhënieve rumuno-shqiptare*

Në hulli të studimeve të këtij libri afria midis rumanishtes dhe shqipes nuk hetohet vetëm në fjalorin, por në gjithë tablon gjuhësore rumuno-shqiptare karahasimtare të fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe formimit të fjalëve. Brënkushi

<sup>20</sup> Disa nga punimet e tjera të këtij autori janë: “Despre valoarea aoristului in albaneze”, *SCL*, 1960, 1; “Paralele frazeologice rumuno-albane”, *SCL*, 1960, 4; “Observatii asupra etimonurilor albaneze din” *DLRM*, 1961, 2; “Originea consoanei Hdin limba româna”, *SCL*, 1961, 4; *Vocabolarul autohton al limbii romane*, Bucure si, 1983. 5 G. Brâncus, po *aty*, f. 9. 6 G. Brâncus, po *aty*, f. 6.

<sup>21</sup> Në vorbullin e këtyre teorive ekziston edhe ajo që supozon praninë e një gjuhe më të lashtë në këto troje se ardhja e trakasve dhe ilirëve.

<sup>22</sup>Autori citon: A. Dhrimon, A. Xhuvanin, E. Çabejn, I. Ajetin, Q. Haxhihasanin.

trajton lëmi të ndryshme të kulturës dhe qytetërimit popullor, studime të folklorit, mitologjisë, psikologjisë dhe artit popullor. Ai arrin të portretizojë ndritshëm pamjet reale të thellësisë së marrëdhënieve rumuno-shqiptare. Këto trajtesa të Brënkushit sforcojnë tezën se rumanishtja dhe shqipja krijojnë një grup më vete edhe në planin e afriës së tyre rumanishtja është gjuhë romanike, ndërsa shqipja idoevropiane. Brënkush, elementet e substratit të rumanishtes nuk i sheh vetëm si “huazime” të kryera në latinishten danubiane. Në këtë përmbledhje studimesh përfshihet edhe një studim i posaçëm mbi fjalorin autokton të dialektit arumun frashëriot, studim me vlerë teorike, përmes të cilit Brënkush ka ndjekur disa efekte të dygjuhësisë. Këtu fati i elementeve të substratit në një nga dialektet rumune të zhvilluara në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm me shqipen. Gjithashtu, kam hetuar nga afër aftësinë për t’u transferuar në onomastikë të emrave të përbashkët të substratit, duke hedhur dritë mbi rëndësinë e këtij fondi leksikor në ansamblin e fjalorit të rumanishtes. Në kërkimet e tij në lidhje me marrëdhëniet gjuhësore rumuno-shqiptare ai i referohet shkollës së albanologjisë të Eqrem Çabejt. Duke shfrytëzuar hulumtimet e të gjithë sektorëve të gjuhës, mbi origjinën e gjuhës shqipe, marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje, fonetikën dhe gramatikën historike, leksikon e shqipes (përshkrim, etimologji, onomastikë), ligjërimit funksionale, gjuhën popullore në të folmet rajonale (toskërisht dhe gegërisht), tekstet e vjetra, fiksimin e ortografisë dhe lëvrimin i gjuhës etj., mund të konkludohet se në formimin e tij vepra e Çabejt, duket të jetë mbresëlënëse, siç ka ndikuar edhe te Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi, Spiro Floqi dhe Shaban Demiraj.

*83 njësi të fondit të vjetër të rumanishtes, emra të përveçëm dhe toponime edhe në gjuhën shqipe*

Ky filolog heton se nga fondi i emrave të përveçëm dhe toponimeve që janë të shpërndara në të gjitha dialektet e kësaj gjuhe, pjesa më e madhe e tyre janë përdorur e përdoren si antroponime e toponime. Fondi onomastik që përbëhet prej tyre gjendet në të gjitha dokumentet e vjetra të gjuhës rumune. Një tjetër veçori dalluese është se këto njësi të fondit autokton emërtojnë kryesisht fshatra, kodra, pyje, lumenj që iu përkasin, në tërësi, realiteteve pastorale, jetës së blegtorëve. Autori, për shumicën e tyre, ka dhënë edhe përgjigjen në gjuhën shqipe, (për këtë i është dashur t’iu referohet edhe studiuesve shqiptarë<sup>23</sup>Duke lexuar veprën e Brënkushit hetohet se në tërësinë leksikore të gjuhës rumune, etimologjia e emrave të përveçëm dhe toponimeve është e motivuar me karakterin unitar të latinishtes danubiane, presupozohet se në epokën e rumanishtes së përbashkët (periudha para ndarjes në dialektet në jug të Danubit dhe në veri të tij).

---

<sup>23</sup> Autori citon: A. Dhrimon, A. Xhuvanin, E. Çabejn, I. Ajetin, Q. Haxhihasanin .

Brënkushi në artikullin *Transferimi në onomastikë i fjalëve të substratit*, ka vënë në analizë 83 njësi leksikore të fondit të vjetër të rumanishtes. Këto njësi leksikore ai i sheh të shpërndara në të gjitha dialektet e rumanishtes. Fillimisht ai sforcon argumentet për karakterin unitar të latinishtes danubiane që u ruajt e u forcua edhe nën ndikimin romak, kjo duket se ka ardhur ngase janë përdorur e përdoren si antroponime e toponime. Ky fond onomastik është ruajtur në të gjitha dokumentet e vjetra të gjuhës rumune. Sipas autorit, këto njësi të fondit autokton emërtojnë kryesisht *fshatra, kodra, pyje, lumenj që iu përkasin në tërësi jetës së blegtorëve, etj.* Në statistikën e këtyre fjalëve të përbashkëta, të cilat autori i ka konsideruar me prejardhje të sigurt nga substrati, ai pohon se ekzistojnë tri mënyra për të shpjeguar gjenezën e elementeve që rumanishtja i ka të përbashkëta me shqipen. Sipas Brënkushit, huazime nga shqipja në rumanisht si dhe N. Jokli e E. Çabej, vijnë nga evolucione të pavarura në secilën nga këto dy gjuhë, inovacione spontane në secilën prej tyre; elemente të trashëguara në mënyrë të pavarur nga substrati (trako-dak në rumanisht, ilir apo iliro-trak në shqip). Kështu nga ky filolog argumentohet se rumanishtja dhe shqipja janë të lidhura përmes substratit, nën degëzimin. Numrin e madh të ngjashmërive midis këtyre dy gjuhëve kryesisht përmes një substrati të përbashkët, Brënkush e mbështet në argumentin e trajtave të përbashkëta të zanorja *ă* (*è*), rotacizmi i *n*-së ndërzanore, prapavendosja e artikullit *etj.* Me materialin trako-dak, autori ofron shembuj që përmbajnë afrikate. Në këtë studim bëhet krahasimi i materialit leksikor pararomak i rumanishtes dhe shqipes. Kudo arrin të argumentohet se ndikimi i substratit trako-dak mbi latinishten karpato-danubiane u manifestua jo vetëm në fjalor, por edhe në sektorë të tjerë të gjuhës. Te ky artikull autori ka gjetur se mesatarisht 6 derivate për fjalë-bazë, ndërsa derivatet nga fjalët latine janë në një proporcion 4 me 1. Sipas këtij albanologu, disa fjalë si: *mânz, copil, buză, baltă, gard, groapă, mazăre, rață, moș, murg, brânză, brâu, căciulă, cioară, grumaz, măgar etj., kanë nga 7 deri në 15 derivate.* Në shumicën e tyre ndajshitesat janë latine, që ka shumë mundësi, që këto derivate të jenë krijuar herët. Sipas G.Brënkush edhe kalimi i emrave të përgjithshëm me origjinë nga substrati në antroponimi dhe në toponomastikë është i pranishëm. Këndvështrimi i filologut rumun në 83 fjalë, përbëjnë objektin e studimeve etimologjike më të vjetra. Ai nuk ka trajtuar mbiemrin *mare* (i madh), sepse, sipas tij, pjesa më e madhe e gjuhëtarëve e konsiderojnë si fjalë latine. Mirëpo, këta emra të përbërë që emërtojnë kodra, male, pllaja, fshatra, lumenj: *Ocolul Mare “Rrethi i Madh”, Fața Mare “Vajza e Madhe”, Groapa Mare “Gropa e Madhe”, Valea Mare “Lugina e Madhe” etj.*, autori për shumicën e tyre ka dhënë edhe përgjigjen në gjuhën shqipe, (për këtë i është dashur t’u referohet edhe studiuesve shqiptarë<sup>24</sup>, p.sh.: rum. *Balta* (Balte s, Balteanu, Baltescu) - shq. si emër fshati Beltoja (Shkodër), *Baltëza, Baltë* e *Bardhë*; rum.

<sup>24</sup> E. Çabej, *Studime etimologjike*, III, f. 140

Barza del si patronim: Barza, Barza, Barzoiu, Barzeanu, Barzea etj. Kjo fjalë në onomastikë ka një përdorim më të pakët për shkak të konkurrimit me fjalën *alb* “i bardhë” që ka hyrë në rumanisht nga latinishtja. Për shqipen sjell emrat e përveçëm: Bardhi, Bardha, Bardhec, Bardhuk, Bardhush, kurse në onomastikë, Gur i Bardhë, Bardhaj (fshat në Shkodër), Bardhan (j), Barzanj. Kësaj analize i janë nënshtruar të 83 njësitë që sillen nga fondi i vjetër i rumanishtes, kurse ato që i dalin si emra të përveçëm, a si toponime edhe në shqipe po i paraqesim si më poshtë: *Brad* “bredh”, *Bukura* “bukur”, *C aciul a* “kësulë”, *C atun* “katund”, *Ceaf a* “qafë”, *Ciok* “sqep”, *Cioar a* “sorrë”, *Ciuk a* “çukë”, *Ciut* “shytë”, *Curpen* “kulpër”, *Fluture* “flutur”, *Ghimbe* “gjëmb”, *Ghinj* “gjysh”, *Groap a* “gropë”, *Gusa* “gushë”, *Leurd a* “hudhër”, *Mal, M agar* “gomar”, *M arar* “maraj”, *Muscoi* “mushkë”, *Pârâu* “përrua”, *Sc ap ara* “shkrep”, *Tap* “cjap”, *Teap a* “thep”, *Vatr a* “vatër”, *Viezjyre* “vjedullë”.<sup>25</sup> Brënkushi vlerëson se një veçori e rëndësishme e këtij fondi onomastik është në dokumentet më të vjetra të gjuhës rumune. Shumë fjalë i takojmë në dokumentet sllavo-rumune të shek. XIV – XVI, shumë terma ai i gjen edhe në zonën e populluar nga të ashtuquajturit rumunë perëndimorë dhe shumë të tjerë që janë trajtuar nga studiues të ndryshëm në tekstet e vjetra latine, sllave, hungareze. Të gjitha këto dëshmojnë sa prezencën e rumanishtes në veri të Danubit, aq edhe shtrirjen etnike të rumunëve gjatë mesjetës. Ky filolog ka verifikuar etimologjinë e fjalëve, në të gjitha dialektet e rumanishtes, e të njëjtën përpjekje, me sa ka mundur, e ka bërë edhe për shqipen, por për disa nga njësitë e prezentuara duket se nuk ka arritur të dokumentojë se baza etimologjike të jetë e përbashkët. Kjo ndryshe shpjegohet nga gjuhëtarët tanë, sepse, *rum. ciok “sqep”: shq. cok është sqaruar për shqipen si një “fjalë e lashtë e leksikut ekspresiv, me një onomatopë”*.<sup>26</sup> pra përkimi me rumanishten a ndonjë gjuhë tjetër ballkanike është i rastësishëm. Po kështu për qasja rum. *leurd a*: shq. *hudhër* është një etimologji e përligjur vetëm semantikisht dhe jo fonetikiisht.<sup>27</sup> Duke qenë se onomastika është një fushë më konservatore se sa ajo e emrave të përgjithshëm, ky parim mund të ilustruhet me elementë apelativë të dalë nga përdorimi apo me përdorim të rrallë, të ruajtura si emra njerëzish, siç është rasti i mbiemrit bucur, i emrit bung (derivati bunget del rrallë), dru(druete), leurda etj. Sipas këtij albanologu, pjesa më e madhe e emrave të vendeve (fshatra, kodra, lugina, male, pyje, lumenj) të kujtojnë ritmin e jetës pastorale të dikurshme në vise rumune. Në përgjithësi, emrat e përveçëm të bazuara në apelativet

<sup>25</sup> G.Brënkush:Po aty,fq.

<sup>26</sup> E. Çabej, *Studime etimologjike*, IV, f. 380.

<sup>27</sup> Një gjë e tillë është vërejtur edhe nga studiuesit shqiptarë. Prof. Çabej vërente:” ...vihet re *aty* një pajtim mjaft i madh që vërehet te paralelizmi i ngushtë në shqiptimin dhe zhvillimin historik të tingujve, po shfaqet edhe në strukturën morfologjike, si në fleksion, si në *fjalëformim*, në sintaksë të emrit, ... E. Çabej, *SF*, 1, 1975, f. 50.

autoktone hyjnë në sistemin e formimit të toponimeve dhe antroponimeve rumune. Në rastin e toponimeve, shumë prej tyre janë fjalë të përbëra me emra dhe mbiemra të tipit: cap “kokë”, colț “cep”, deal “kodër”, față “fytyrë”, izvor “burim”, munte “mal”, pârâu “përrua”, vale “luginë”, vârף “majë” etj. si dhe mbiemrat mare “i madh”, mic “i vogël”, vechi “i vjetër” etj. Brënkush konstaton se fondi leksikor autokton ruhet mirë gjatë transferimit në antroponimi nëpërmjet nofkave dhe përmes llagapeve: Abur “avull”, Aburel “avullzë”, Baci “bari”, Balaur “ballaur”, Baligă “Bajgë”, Bradu “Bredhi”, Brânză “Djathi”, Brustur “Brushtull”, Bucur “Bukur”, Bungu “Dushku”, Buză “Buzë”, Căciulă “Kësulë”, etj. e shumë të tjera.

Brënkush thotë se *“ka pak fjalë psb. emra njerëzish, të lidhura me kuptimin e vjetër të apelativëve apo me kuptimet e afërta të përgjegjëse në shqip”*.<sup>28</sup> Sipas tij, disa emra shfaqen si shumë rezistentë në onomastikë, me një aftësi fjalëformimi, me mundësi të mëdha në rastin e toponimeve. Transferimit në onomastikë, të fjalëve të fondit autokton të gjuhës rumune, autori i ka dhënë interpretime të detajuara. Kjo dëshmon se fjalët nga repertori etimologjik trako-dak, me gjegjëse në shqip, kanë një status shumë të rëndësishëm në fjalorin e rumanishtes. Madje, ai pohon se ato kanë lejuar shtrirjen e tyre në onomastikë. *“Në Shqipërinë e veriut gjenden si emra vendesh Rrgal e Madhe, Kodra Rrgalave, Rragam, zona malore me gurë”*.<sup>29</sup> Nga krahasimi me shqipen duket se në toponiminë rumune argea fillimisht ka pasur kuptimin e “vend me gurë të mëdhenj, vend i varfër për bujqësi, shkëmb”, sipas Çabejt. Ky studiues pajtohet se në rumanisht ekzistojnë shumë emra vendesh që mbarojnë me –at, formante në pamje të parë mbiemërore: Adancata, Brusturata, Lapusata, etj. Por, edhe në shqip emrat e përveçëm (personash apo vendesh) që mbarojnë me –at janë të shpeshta, sidomos në arealin jugor (Xhuvani, Çabej, Prapashtesat, fq. 23, të cilët vlerësojnë se prapashtesa –at, është me origjinë ilire: Autariatae, Labeates, Ulcinatate, etj. emra fisesh). Brënkushi konstaton se emri Mal “breg, terren i ngritur me shpatë të thepisura, shpat, humnerë” haset rrallë si emër personi. Ai e gjen në disa derivate të toponimeve: Măleanu, Mălureanu, Mălurică, duke pohuar se, nga rumanishtja, fjala mal ka hyrë herët edhe në toponiminë hungareze: Mal (më 1276). Ai ka krahasuar me emrat në pjesën malore në veri të Shqipërisë, që quhet Mal(ë)si, Mal(ë)ci, emër abstrakt kolektiv nga rrënja *mal* (Xhuvani, Çabej, Prapashtesat, fq. 44). Janë këto disa nga fjalët e fondit të vjetër të rumanishtes, emra të përveçëm dhe toponime që i gjejmë edhe në gjuhën shqipe e që u transferuan në onomastikë si fjalë të substratit.

<sup>28</sup> Grigore Bërnkush: “Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune”, (Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2010), (Përkthyer nga Luan...), fq. 23.

<sup>29</sup> Eqrem Çabej, SF, nr. 3, Tiranë 1965, fq. 71-72.

## Përfundim

Ndihmesa e albanologut rumun Brënkush për filologjinë tonë është shumëdimensionale dhe vlerësohet lartë. Ai përveç çështjeve që u përmendën edhe në studimet lidhur me *mënyrën e fjalëformimit të përbashkët për rumanishten e shqipen*, thotë se ky fjalëformim është vokacion edhe i albanologëve tanë, sepse *“Procesi i fjalëformimit, kompozitave të këtij tipi është mjaft produktiv në shqipen popullore.”*<sup>30</sup> Autori sjell shembuj interesant të formimit paralel të kompozitave në gjuhën popullore rumune dhe atë shqipe. Brancus të njëjtat arsytetime i gjen edhe te studiuesit shqiptarë. Ai vlerëson se *“për rumanishten ka pasur vetëm ndonjë studim të veçuar në kuadrin e “shprehjeve paralele” në të dyja gjuhët*”<sup>31</sup>. Konstatimi vjen për arsye se ky studiues *“ në plan krabasues arrin në përfundimin ...kompozitat e këtij tipi janë identike në këto dy gjuhë, si për nga mënyra e formimit, ashtu edhe për nga kuptimi”*<sup>32</sup>. Brënkushi ka qëndruar në Shqipëri (1966), dhe nga këto kërkime shkruan studimin *“Elemente leksikore autoktone në dialektin arumun “*. Autori pranon se gjatë anketimeve, ka qenë i asistuar, në vazhdimësi, nga Emil Lafe, gjuhëtar në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në përmbyllje të kësaj trajtесе mund të konstatojmë se G.Brënkushi, edhe lidhur me zanoren *ă* të rumanishtes, pajtohet si shumica e filologëve se *“prej shumë kohësh se rumanishtja dhe shqipja kanë të përbashkët një zanore karakteristike ă shq. ë. e shfaqur në kushte identike.* Në këtë përmbledhje, siç kemi pohuar, Brënkushi i ndikuar prej filologëve tjerë rumunë, pajtohet se substrati trako-dak bashkëtingëllorja *Ş* (SH) e rumanishtes me arsyen e thjeshtë se ajo nuk ekzistonte në sistemin bashkëtingëllor të latinishtes dhe se në shqip kjo bashkëtingëllore është zhvilluar shumë herët. Përgjithësisht, pranohet se ligji fonetik i transformimit të s-së në sh ka vepruar deri në shek. XI.<sup>33</sup> Ndërkaq, në studimin lidhur me *Zanoren a/ ë, Brënkush vlerëson se prania e kësaj zanoreje në shqip ka tërhequr vëmendjen e ballkanologëve, por në mënyrë të veçantë ngjashmëritë që shfaqin këta tinguj në shqip e në rumanisht. Sipas tij, janë dy rrugët kryesore të përfutimit të kësaj zanoreje në të dy gjuhët: në mënyrë spontane nga /a/ e patheksuar, e cila ka dhënë /ë/ si në fjalët: latin. *familia*> rum. *fameie* shq. *fëmijë*, latin. *camisia*> rum. *c ameasa* shq. *këmishë*, latin. *sanitatem*> rum. *s an atate*, shq. *shëndet* etj. Kurse, rruga e dytë është lindja e kushtëzuar nga një /a/ e theksuar në pozicion hundor, p.sh.: latin *sanctus*>rum. *sânt*, shq. *shën* etj. Është i drejtë konstatimi i*

---

<sup>30</sup> Vepër e cituar, A. Xhuvani, *Kompozitat*, A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes*.

<sup>31</sup>E. Çabej. A .K. Cipo :Studime për leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë, I, 1972, f. 64-65.

<sup>32</sup> G. Brâncu s, *vep. cit.* f. 91.

<sup>33</sup> Shih detaje, E. Çabej, SGJ, III, fq. 137-139.

Brâncus-it se në të dyja këto gjuhë “... prezenca e kësaj zanoreje në rrokje të theksuar është e kushtëzuar nga një bashkëtingëllore hundore”. Po kështu në të dyja gjuhët vihet re mungesa e /a/, /ë/ në fillim të fjalës.<sup>34</sup> Ndërsa, për *Rotacizmin*, autori shpjegon shkaqet dhe mekanizmin e njëjtë të procesit të rotacizmit në të dyja gjuhët, duke konkluduar se koha e përfundimit të këtij procesi në të dyja gjuhët është e njëjtë, para kontaktit të tyre me sllavishten. Kurse, në artikullin e fundit *Sbënime në lidhje me prapavendosjen e nyjës shqipe*, G. Brâncus mbron tezën se në rumanishte, ashtu si në gjuhën shqipe prapavendosja e nyjës është një fenomen shumë i vjetër në të dyja gjuhët, që ka ndodhur para fenomenit të paravendosjes. Krejt në fund, mund të thuhet se, libri i G. Brâncus-it është një nga botimet e tij më të dobishëm dhe ndihmësë e çmueshme për studiuesit e historisë së gjuhës shqipe, veçanërisht për marrëdhëniet e shqipes me rumanishten.

---

<sup>34</sup> Në gjuhën shqipe ka disa fjalë me /ë/ nistore: *është, ëmë, ëmbël, ëndërr, ënjtem, etj.*



## Bibliografi

1. Barić, Hÿmje -Henrik Barić, Hÿmje në historinë e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1955
2. Brâncuş, Grigore: Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune, Tiranë, 2009, SHB 55.
3. Çabej, E.:Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1975.
4. Çabej, Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, ASHSH,IV. Tiranë, 1996.
5. Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore I*. Rilindja, Prishtinë, 1976.
6. Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.
7. Çabej,Eqrem:Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1975
8. Friedman, Viktor, *Ndikimi i shqipes në të folmet arumune të Maqedonishtes Jugperëndimore: Mënyra habitore*, Studime 1/1994, ASHAK,Prishtinë, 1995.
9. Ilievski, Petar, *Balkanološki lingvistički studii*, Skopje, 1988.
10. Instituti i Trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve-Shkup,Studime Albanologjike,nr.4,2011 , Shtypshkronja “Focus Print” – Shkup.
11. Karadafov, Petrula, *Vlasi – bit i kultura*, Muzej na Makedonija. Erheološki, Etnološki, Istoriski –Skopje, Skopje, 1992.
12. *Karagjozi – Kore,Mimoza:Kontaktet e lashta të shqipes me arumanishten,ITSH,*
13. *Studime Albanologjike,nr.4,Shkup,2011.*
14. Karagjozi-Kore,Mimoza:Grigore Brënkush (Grigore Brancus): *Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune* (Përmbledhje artikujsh), Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2009 .
15. Meyer, Gustav. Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, Botime Çabej ,2007.
16. Murati, Qemal, *Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptaremaqedonase*,Seminari i Albanologjisë i Universitetit Shtetëror të Tetovës,2007.
17. Murati, Qemal. *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve*, Tetovë, 1999.
18. *Murati,Qemal.:Shqipja dhe maqedoarumenishtja nga aspekti i kontakteve midis tyre,ITSH,Studime Albanologjike,nr.4,Shkup,2011.*
19. Nasteva, Olivera Jashar, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Logos-A, Shkup, 1998.
20. Papailia, N. Jorgji, Dictionar român-albanez (Fjalor rumanisht shqip,Botime Toena, Tiranë, 2000.
21. Poçi ,Spiridhulla: “Vlehtë, historia dhe gjuha e tyre” Tiranë, 2009.

22. Poçi, Spiridhulla, *Gjuha shqipe dhe marrëdhëniet e saj me arumanishten*, Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, 2009.
23. Poçi, Spiridulla, *Vllehët (arumunët) e Shqipërisë dhe gjuha e tyre*, Kërkime universitare, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, 2001.
24. Poçi, S: “Vllehët, historia dhe gjuha e tyre” Tiranë, 2009.
25. Poçi, Spiridhulla : *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-aromune në vështrimin e Grigore (Brâncuș)*, ITSH, Studime Albanologjike, nr.4, Shkup, 2011.
26. Popvasileva, Aleksandra, *Dvojažično raskazuvanja na narodni prikazni (Vlaško-makedonski i makedonski-vlaški relacii)*, Institut za folklor ‘Marko Cepenkov’, Skopje 1987.
27. Riska, Albert, *Gjurmë të arumanishtes në toponiminë e Shqipërisë*, Buletin shkencor, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, 2004/2.
28. Xoxi, Koli, *Nikolla Jorga – Dijetari pa frikë e pa njollë*, Horizont, Tiranë, 2001.
29. Ymeri, Baki: *Hipoteza dhe teori lidhur me lidhjet farefisnore rumuno-shqiptare*, ITSH-Shkup, Studime Albanologjike, Shkup, 2011.

## Shpëtim ELEZI

### ERIC P. HAMP-I PËR ORIGJINËN DHE VENDIN E SHQIPES

#### Hyrje

Eric P. Hamp-i, ky klasik i fundit i gjuhësisë indoevropiane, ka nisur të studiojë shqipen që në fillim të viteve '50 të shek. XX e deri më sot. Direkt ose indirekt, ai në vazhdimësi e ka bërë shqipen pjesë të interesimeve të tij shkencore, duke trajtuar një varg problemesh të gjuhës shqipe, që përfshijnë fonetikën, fonologjinë, gramatikën, studimet dialektore për të folmet skajore të shqipes, etimologjinë etj. Në mënyrë të veçantë, shquhen studimet e tij historike nëpërmjet të cilave në planin krahasimtar me syrin e një komparativisti të shquar të indoevropianishtes, ai ka trajtuar marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje ballkanike, sidomos me rumanishten, dhe në përgjithësi me gjuhët indoevropiane, për vendin e shqipes në rrethin e gjuhëve të kësaj familjeje, për reflektimin e laringaleve indoevropiane në gjuhën shqipe etj. Gjithashtu, në studimet e tij zënë vend edhe trajtimet për një numër jo të vogël etimologjish, për vendin e formimit të shqipes, për ndërtimin kronologjik dhe saktësimin e një varg ndryshimesh fonetike etj. Së këndejmi, profesori i Universitetit të Çikagos ka bërë preokupim të tijin edhe çështjen e burimit të gjuhës shqipe, për çka ai në tërë këto vite të gjata studimesh hera-herës ka diskutuar në periodikë të ndryshëm shkencorë në mbarë botën. Por, para së gjithash, në këtë kumtesë në mënyrë telegrafike do të pasqyrohen e sintetizohen disa nga pikëpamjet e tij lidhur me vendin e shqipes në mesin e gjuhëve IE, me vendin e formimit të shqipes dhe me prejardhjen e saj. Dhe, në këtë kuadër të këtyre çështjeve, do të veçohet e sqarohet edhe ndonjë argument rreth ndonjë etimoni nga trajtesat e tij për një numër jo të vogël etimologjish, që kalojnë caqet e rrafshit fonetik, duke u shpjeguar e zbërthyer edhe në aspekt morfologjik, apo edhe ndonjë argument për ndihmesat thelbësore lidhur me reflektimin e laringaleve IE në shqipen. Krejt kjo jo vetëm për të parë tezat e tij për prejardhjen dhe vendin e formimit të shqipes, si dhe për vendin e saj në familjen IE, por, kështu, për të vënë në pah edhe ndihmesat e tij në këtë fushë studimesh dhënë gjatë gjysmës së dytë të shek. XX e deri më sot. Këtu për këto probleme do të përpiqemi të diskutojmë veç e veç për të krijuar një ide më të qartë rreth tyre, edhe pse këto çështje në të vërtetë dalin shpesh të ndërlydhura me njëra-tjetrën

edhe në vetë trajtesat e tij, për më shumë ai qysh më 1966 në *The position of Albanian* (Hamp 2007: 116) shkon dhe më tej duke shprehur nevojën që studimi i këtyre problemeve duhet kombinuar me rezultatet dhe hulumtimet në tri fusha: ballkanistikë, linguistikë klasike dhe indoeuropianistikë, për çka, sipas tij, askush nuk mund të jetë njësoj kompetent.

## 1. Hamp-i për origjinën e shqipes

Kur indoeuropianisti amerikan Eric P. Hamp argumentoi origjinën ilire të shqipes në një tryezë albanologësh mbajtur në dhjetor të 2008-s në Tiranë<sup>1</sup>, kjo u prit atëbotë jo pa entuziazëm nga studiuesit. Aty ai argumentoi tezën “gjuha shqipe, pasardhëse e ilirishtes” nëpërmjet së cilës kërkoi që të njihen gabimet që janë bërë deri më sot mbi pozicionin e shqipes. Ky pohim i tij u vlerësua jo pak, jo pse një gjë e tillë nuk ishte thënë më parë nga të tjerët, pasi dihet që teza ilire është më e përhapura dhe më e mbështetura deri më sot, por sepse kjo po thuhej prej një emri të shquar të gjuhësisë krahasimtare IE, që ia kishte kushtuar jetën asaj dhe në këtë kuadër edhe shqipes, e cila, siç vlerëson R. Ismajli (*Parabhënie*, Hamp 2007: 15), “në shumë aspekte është gjuha e tij e parë e interesimit” për më shumë se gjysmë shekulli dhe tash së fundmi edhe “dashuri personale e imja.”, siç është shprehur vetë ai. (*Mapo*, 9 mars 2009). Prandaj, duke qenë indoeuropianist i shquar, diskutimet dhe mendimet e tij për albanistikën gjithmonë kanë peshë të madhe, sidomos për faktin jo të parëndësishëm që, për të ardhur në këtë përfundim, profesor Hamp-it i janë dashur pothuaj 50 vjet jetë (që nga vitet ’50 të shek. XX) studimi e hulumtimi të thelluar me shqipen në fokus ose me shqipen në krahasim me gjuhët e tjera IE. Në fakt, Hamp-i nga viti 1966 kur boton studimin *Vendi i shqipes* dhe më pas kishte një dilemë lidhur me ilirishten, që shkonte në kuadër të një tendence të përgjithshme të kohës, “sipas të cilës ilirishtja qenë një emërtim që nuk shpreh një gjuhë tamam.” (Ismajli, *Shekulli*, 19 dhjetor 2008). Por, në studimet e tij me referencë shqipen, të përmbledhura tashmë në veprën e ASHAK-ut *Studime krahasuese për shqipen* (2007), ai duke analizuar fakte gjuhësore përpiket të gjejë lidhjet e shqipes me gjuhët e tjera IE dhe me këtë edhe me paraardhësin gjuhësor të saj. Si rrjedhim, del se argumentet gjuhësore e kanë përafuar Hamp-in gjithnjë e më tepër me linjën e paraardhësve që mbështesin tezën ilire të prejardhjes së shqipes.

Por, për të ardhur deri te ky konkluzion, mendimi i tij për të vërtetën shkencore për origjinën e shqipes nga prizmi i një indoeuropianisti (sipas intuitave të Brugmann-it, Saussure-it) dhe në vijën e të menduarit komparatist modern (Meillet, Pedersen,

<sup>1</sup> Bëhet fjalë për një konkurs për veprën më të mirë albanologjike në pesë vitet e fundit, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, 18, 19, 20 dhjetor 2008, Tiranë, ku vepra e Eric P. Hamp-it “Studime krahasuese për shqipen”, botim i ASHAK-ut, Prishtinë, 2007, u vlerësua me “Çmimin e albanologjisë” në fushën e gjuhësisë.

Whatmough, Kurylowicz, Benveniste), më vonë dhe strukturalist e gjenerativit, gjithnjë me referencë faktet konkrete gjuhësore, të cilat i ka rimarrë dhe analizuar me shumë kujdes deri në detaje, ka pësuar ndryshime pak nga pak nga një fazë në tjetrën gjatë kësaj periudhe të gjatë studimi. Si kërkues i përhershëm i alternativave për të vërtetën shkencore, ai nuk prejudikon asgjë dhe ec pas fakteve gjuhësore deri në fund kudo që ato e shpien, madje edhe kur trajton “çështje të rëndësishme brenda teorive që kërkojnë abstraksion dhe që presupozojnë universalitet, Eric Hamp-i nuk heq dorë nga realitet gjuhësore dhe interpretimi i materialeve konkrete.” (*Parathënie*, Hamp 2007: 8). Pra, albanisti Hamp, në kontekstin e njohjeve të reja dhe gjithnjë në vorbullën e parimeve të punës së tij, edhe këtë çështje e ka diskutuar e ridiskutuar, duke përplotësuar shpjegimet e tij me argumente të reja. Prandaj, që të kemi një pasqyrim më të qartë të ideve të tij lidhur me këtë çështje mjaft të rëndësishme të historisë së shqipes, e shohim të rrugës të jepen në vazhdim fare shkurt argumente të thëna nga ai në studime të ndryshme në kohë të ndryshme, por që gjithnjë të para në kontekst të gjuhëve IE e ballkanike, gjenetike e areale, madje deri në faza të gjuhëve PIE.

Tani shtrohet pyetja: cili është mendimi i Hamp-it për ilirishten?

Në të vërtetë, Hamp-i, megjithëse ka shprehur ndonjë dilemë në fillim, nuk e ka mohuar asnjëherë ekzistencën e një realiteti të quajtur *ilirisht*. Madje ai “është ndër ata që ka gjetur një numër afërish midis shqipes e ilirishtes, më shumë midis mesapishtes e shqipes.” (Ismajli 1987: 35). Por, në vazhden e përhershme të kërkimit të së vërtetës, argumentet për realitet gjuhësore gjithnjë e më shumë e kanë shpënë atë, siç u tha dhe më lart, në të mirë të vazhdimësisë iliro-shqiptare. Si dëshmi kapitale për këtë lidhje, flet edhe argumentimi i tij (2007: 131-132) kundër karakterit *centum* të ilirishtes, e cila shfaq velare aty ku shfaqin gjuhë të tipit satem. Sipas tij, këtë e mbështet edhe fakti që shqipja, si edhe ilirishtja, por jo trakishtja, shfaq refleks të ndarë të labiovelareve përpara zanoreve të përparme. (2007: 132).

Është e njohur teza e tij e protoshqipes e quajtur me termin gjuhë *albanoide*. Deri te ky emërtim ai (në vitin 1980; cituar sipas Hamp 2007: 173) sqaron se ka ardhur duke u bazuar në elementet e përbashkëta rumune-shqipe, në të cilat thotë se kemi të përfaqësuara tri rrafsh kronologjike. Një korpus fjalësh nga fusha blegtorale dhe të tjera fjalë, si: *vatra*, (*h*)*urda*, *strunga* dhe *murg*, (të shtuara e shqyrtuara nga vetë Hamp-i), që i takojnë rrafshit të parë, përfshijnë një përhapje më të gjerë dialektologjike se vetëm rumanishtja dhe shqipja, me një shtrirje nga Karpatet (Ukrainase) në një zonë të gjerë deri te Shqipëria e Veriut. Sipas tij, nuk është më e rëndësishmja mosha dhe përhapja e kësaj shtrese, “është më parë fakti se kam qenë në gjendje të tregoj se këto njësi kanë të përbashkëta ndryshime të një natyre thelbësore me historinë e shqipes. Për këtë arsye, për këtë korpus materialesh përdor emërtimin proto-Albanoid” (Hamp 2007: 173), emërtim me të cilin nënkupton një grup dialektesh *albanoide*, që në lashtësi do të jenë

folur në Mezi, afër apo në Daki, ku do të jenë krijuar edhe konkordanca rumune-shqipe dhe karpato-ballkanike. “Duke i parë si të paqarta ilirishten, trakishten e dakomizishten hipotetike, Hampi preferon të flasë për protoshqipen si për gjuhë ‘albanoide’, gjë që nuk zgjidh gjë, po vetëm rinovon terminologjikisht dhe e saktëson rezervën në raportet shqipe/ilirishte-trakishte.” (Ismajli 1987: 35).

Ndërkaq, sa i përket vendit të protoshqipes, edhe pse nuk mendon se thotë diçka mungesa e fjalëve të trashëguara të detarisë, (disa leksema të tilla autoktone i cilëson kryesisht metaforike), ai në studimin *Vendi i shqipes* (2007: 117) e sheh atë jo në bregun e Adriatikut, por diku kah Dardania e vjetër e më në veri. Gjatë gjithë kësaj kohe albanishtja e hershme do të ketë qenë në veri të linjës Jireçek, dhe numri i vogël i huazimeve nga greqishtja klasike e konfirmon këtë. Më pas, qendra e gravitetit do të ketë lëvizur në perëndim drejt detit nën inkursionin e sllavëve të jugut. Së këndejmi, është me interes edhe përgjigjja e Hamp-it për vendndodhjen e shqiptarëve në kohën e ardhjes së sllavëve në Ballkan, ku thotë se është naive të kërkohe hapësira të rregullta dhe të pathyeshme ngulimesh, sidomos për gjendjen parakombëtare të tij, ndërsa dëshmon se vetëm shqiptarët kanë qenë aty para sllavëve dhe kurrë e kundërta. (126).

Në këtë kontekst, jo pa rëndësi është edhe mendimi i Hamp-it për guturalet, në saje të të cilave pozita e ilirishtes nuk është përcaktuar ende mirë (*centum / satem*), por Hamp-i (në vijën e argumentimit të Cimochowski-t) argumenton mendimin që së paku në pikën e trajtimit të tyre në fqinjësi me sonantet, ku spirantizimi i tyre nuk shkon gjer në fund, shqipja afrohet me ilirishten. Siç thekson Ismajli (1987: 27), “nuk është fare i sigurt karakteri *centum* i saj, madje ka mjaft dijetarë nga më seriozët që pohojnë të kundërtën. Në këto dhe pika të tjera, ajo shfaq afëri me gjuhët si gjermanikishtja e sllavishtja, në një anë, dhe me greqishten e armenishten, në anën tjetër. Kjo i shtyri dijetarët..., që ilirishten ta vendosin disi në qendër, ku përsëri e gjejmë shqipen.”

Po ashtu, me interes janë edhe disa glosa, rreth 20, që Hamp-i (në studimin *Shqipja dhe mesapishtja*, 2007: 147-170), përtej konceptit të tij të përgjithshëm të protoalbanoidishtes, i ka nxjerrë si elemente përafruese të shqipes me mesapishten, të cilat nuk janë mohuar deri më tash nga ndonjë studiues, për më tepër janë vlerësuar si të para në mënyrë më reale, prandaj dhe të drejta e të pranueshme. (Shih Ismajli 1987: 28). “Kjo për shkak se këto elemente “të rëndësishme me karakter specifik” japin “material të rëndësishëm plotësues në të cilin mund të shpresojmë ta mbështesim vërtetimin e fuqishëm të afriës së gjuhëve iliro-mesapike dhe shqipe.” Këto argumente për izoglosat e përbashkëta shqiptaro (mesapo) ilire, të hetuara nga Hamp-i, e para tij edhe nga Çabej, (ndërsa nga Jokl-i në raport me ilirishten), janë argumente që si izoglosa specifike në rrafshin IE “marrin peshën e argumentit të mirëfilltë gjuhësor.” (Ismajli 1987: 28).

Së fundmi (*Metropol*, 19 dhjetor 2008), ai jep një mendim të tijin edhe për raportin shqipe – pellazgishte, hipotezë të cilën me akribinë e një shkencëtari dhe duke lënë mënjanë imagjinatën e quan mit, madje edhe vetë pellazgishten e vlerëson si pjesë të mitologjisë. “Nuk është pretendim apo deklaratë serioze. Ajo çfarë them në këtë rast është: ju lutem, më tregoni fragmente, fjali nga pellazgishtja. Nuk është tamam një gjuhë. Grekët i referohen, e quajnë pellazglike, por çështja është se faktet nuk kanë qenë kurrë të mjaftueshme për të vërtetuar e thënë këtë. Shumë njerëz flasin për jetën, popullimin e Afrikës përpara se një njeri i bardhë të ketë qenë atje. Me pak fjalë, që origjina e njeriut vjen nga Afrika, përpara se të gjendej Kepi i Shpresës së Mirë. Përpara kësaj evropianët sigurisht që nuk e dinin ekzistencën e Saharasë. Lidhur me këtë kemi libra, fotografi që tregojnë, por megjithatë gjithçka është imagjinatë.”

## 2. Hamp-i për vendin e shqipes në gjuhët IE

Në kuadër të diskutimeve të shumta për përcaktimin e vendit të shqipes në mesin e gjuhëve të familjes IE, Hamp-i (2007: 115-143), pasi pajtohet për një varg lidhjesh që shqipja ka me këto gjuhë, sipas argumenteve të diskutuara dhe analizave etimologjike dhe pak a shumë në të njëjtën linjë mendimi me paramendimtarët Meyer-i, Pedersen-i, Jokl-i, Çabej, Desnickaja etj., ai e konsideron shqipen gjuhë IE satem me lidhje të mundshme gjenetike të parashqipes me grupin e madh balto-sllav të gjuhëve IE veriore. Këtë tezë të tijën ai e mbështet në saje të konkordancave të veçanta, që shqipja ka me këto gjuhë, si: refleksi i o-së së shkurtër IE në a; zhdukja e perfektit me dyfishim, dezaspirimi i aspirateve të zëshme, satemiteti i parealizuar deri në fund, sidomos në fqinjësi me sonantet (refleksi i palataleve), reduktimi i skemës së tri zanoreve në dy, disa elemente nga fusha e morfologjisë dhe një numër jo i vogël izoglosash leksikore etj. Me këtë rast, “do theksuar posaçërisht faktin se në pikat me të cilat shqipja lidhet me gjuhët veriore, (siç u tha), po në ato pika lidhet edhe ilirishtja (mesapishtja).” (Ismajli 1987: 28). Por ai nuk ndalet vetëm me kaq, pasi ngjashëm me Desnickaja-n, e cila jep disa argumente shtesë, edhe ky supozon se “dikur do të kemi pasur një farë afërsie më të madhe të shqipes me gjuhë të tjera më gjerë, ku hyjnë përveç gjuhët e grupit të gjuhëve IE veriore, edhe gjuhët gjermanike, gjuhët keltike e ndonjë para-gjuhë tjetër, duke formuar kështu jo më një grup në kuptimin gjenetik, po më parë në kuptimin areal (të një Sprachbundi). (Ismajli, *Parathënie*, Hamp 2007: 11-12). Të gjitha këto i përmbledh me emrin N(orth)W(est)I(ndo)E(uropean) (indoeuropianishtja veri-europiane). “Ndoshta kjo afërsi ishte më tepër e natyrës së lidhjes gjuhësore (Sprachbund). Kështu më duket se mund të shpjegohen disa momente të vështira në këtë fushë. Kjo lidhje do të kapte, përveç shqipes, edhe gjuhët balto-sllave”. (Hamp, *Rilindja*, 28 gusht 1976; sipas Ismajlit 1987: 35). Në këtë kontekst, Hamp-i “armenishten e afron shumë me

greqishten, ndërsa midis gjuhëve italiane, frigjishtes, trakishtes e greqishtes sheh një lidhje më të madhe afërie. (Ismajli 1987: 35). Prandaj dhe sa herë i referohet protoshqipës ai parapëlqen të flasë për gjuhë *albanoide* para se për ilirishte, trakishte e madje edhe dakomizishte. Ndërkaq, në kuptimin areal, ai shqipen e cilëson strumbullar rreth së cilës sillen gjithë gjuhësia ballkanike. “Shqipja është strumbullari rreth së cilës sillen gjithë gjuhësia ballkanike. Është themeli i sprachbundit ballkanik. Sllavishtja e vjetër dhe gjuhët baltike – edhe lituanezët do të binin dakord, u pëlqen apo jo – janë si binjakë. Por këta binjakë nuk do mund të rrinin bashkë pa trinjakun e tyre, shqipen”. (*Mapo*, 9 mars 2009).

Lidhur me sa u tha pak më lart, me interes është edhe tabela ku Hamp-i bën përdëgjimin e gjuhëve IE sipas afrive gjuhësore që ato kanë. Në këtë tabelë shihet se ai e grupon shqipen, në një anë, me grupin e madh të gjuhëve IE veriore (bashkë me keltishten e gjermanikishten) dhe, nga ana tjetër, në raport më të afërt me baltishten (lituanishten) e me sllavishten, gjë që, sipas Ismajlit (1987: 35) “nuk është vënë në dyshim nga asnjë studiues serioz”. Aty sheh lidhje (me vija) *të ndërprera* të shqipës me dakishten e mizishten, ndërsa trakishtja mbetet e grupuar jo me shqipen, po me greqishten e me armenishten. Ky veçim i trakishtes nga shqipja (albanoide) “në vështrim të parë duket kontradiktore,... po vetëm për aq sa termi *dako-mizishte* i Hampit përputhet me termin e Georgievit; ndërkaq konceptimet e këtyre dy autorëve ndryshojnë kryekëput në këtë pikë”, (Ismajli 1987: 35), pasi, nga njëra anë, dihet teza jo gjithaq e mbështetur e Georgievit për të lidhur shqipen me dako-mizishten (shih për këtë Ismajlin 1987: 28-29), dhe, nga ana tjetër, konceptimi i Hamp-it si për një gjuhë të lashtë ballkanike pararomane, të quajtur (proto)Albanoíde, “një realitet më i gjerë gjuhësor (me më shumë dialekte-gjuhë)” (Hamp 2007: 13), që përfshin ilirishten, trakishten dhe dakomizishten hipotetike.

Më herët (1966), “Hampi pajtohet me grupimin e Georgievit (*Isledovanija*, 1958) për aq përse ai e fut shqipen në grupin më të gjerë, në grupin qendror bashkë me greqishten, dako-mizishten (ku hyn shqipja), indo-iranishten, frigo-armenishten, trakishten dhe pellazgishten. Në po këtë studim (*The position of Albanian*) Hampi megjithatë lë të hapura shumë çështje konkrete lidhur me përcaktimin e vendit të shqipës, të cilat shpesh janë përdorur madje si të zgjidhura. Meritë e tij, bashkë me Çabejnë e me Desnickajan, është se çështjen e vendosjes së shqipës nuk ia le më në dorë vetëm kriterit satem/kentum, përkatësisht lindore/perëndimore, po insiston në shumë elemente të ndryshme, si në leksik bashkë me Joklin, ashtu edhe në morfologji.” (Ismajli 1987: 35).



**Bibliografia**

1. Barić, H. (1955). *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*. Prishtinë.
2. Cimochoowski, W. (1958). *Prejardhja e gjuhës shqipe*. BUSHT, nr. 2. ff. 37-53.
3. Cimochoëski, Waclaw (2004). *Për gjuhën shqipe*. ASHAK. Prishtinë.
4. Çabej, Eqrem (1976). *Studime gjuhësore III*. Rilindja. Prishtinë.
5. Demiraj, Shaban (1989). *Gjuba shqipe dhe historia e saj*. Rilindja. Prishtinë.
6. Demiraj, Shaban (1999). *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*. Shkenca. Tiranë.
7. Desnitskaja, A. V. (1984). *Sravniteljnoe jazykoznaie i istorija jazykov*. ff. 192-239. Leningrad.
8. Hamp, Eric P. (1957). *Albanian and Messapic*. në Ernst Pilgram (Ed.). Studies presented to Joshua Whatmough on his sixtieth birthday. 'S-Gravenhage. ff. 73-89. The Hague. Shih edhe në: *Studime krabasuese për shqipen*. ASHAK. Prishtinë. 2007. ff. 147-170.
9. Hamp, Eric P. (1966). *The position of Albanian*. në Henrik Birmbaum/Jaan Puhvel (Eds.). Ancient Indo-European Dialects. Berkley/ Los Angeles. ff. 97-121. Shih edhe në: *Studime krabasuese për shqipen*. ASHAK. Prishtinë. 2007. ff. 115-143.
10. Hamp, Eric P. (2007). *Studime krabasuese për shqipen*. ASHAK. Prishtinë.
11. Ismajli, Rexhep (1987). *Artikuj mbi gjuhën shqipe*. Rilindja, Prishtinë.
12. Ismajli, Rexhep (1996). *Ballkanistika, prejardhja e shqipes, hipotezat e Hampit*. Ora, 8 nëntor 1996, ff. 37-39. Prishtinë.
13. Ismajli, Rexhep (1997). *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*. në Studime, nr. 3, ff. 255-275. Prishtinë.
14. Ismajli, Rexhep (2007). *Studimet albanistike të profesor Eric P. Hamp-it*. Parathënie, ff. 5-17, në *Studime krabasuese për shqipen*. ASHAK. Prishtinë. 2007.
15. Jokl, N. (1924). *Albaner, Reallexicon der Vargeschichte*. Hsg. von Ebert, I.
16. Jokl, N. (1929). *Zur Vorgeschichte des Albanischen und der Albaner*. Wörter und Sachen. bd. XII, 6.
17. Jokl, N. (2011). *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip*. ASHAK. Prishtinë.
18. Katičić, R. (1985). *Die Sprachen im Römischen Reich der Kaiserzeit*. në Recherches albanologique 1. ff. 37-57. Prishtinë.
19. Miklošič, Franc (2007). *Gjurmime shqiptare*. ASHAK. Prishtinë.
20. Pedersen, H. *Die Gutturale im Albanesischen*. Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung XVI, 3. ff. 277-340.

21. Pedersen, Holger (2003). *Studime për gjuhën shqipe*. ASHAK. Prishtinë.
22. *Teza mbi ilirishten? Hamp na gëzon*, në *Shekulli*, 19 dhjetor 2008, nga Yllka Lezo, marrë në:  
<http://infoarkiva.com/lajme/artikull/iden/160819/titulli/Teza-mbi-ilirishten-Hamp-na-gezon> (Më 13 korrik 2013).
23. *Eric Hamp, indoevropiani i vetëm për shqipen në Tiranë*, në *Metropol*, nr. 1624, f. 22, 19 dhjetor 2008, nga Blerina Goce, marrë në:  
<http://infoarkiva.com/lajme/artikull/iden/161061/titulli/Eric-Hamp-indoevropiani-i-vetem-per-shqipen-ne-Tirane> (Më 13 korrik 2013).
24. *Edhe një herë "Gëzuar e tungjatjeta!" për Eric Hamp-ini*, në *Mapo*, 9 mars 2009, nga Elsa Demo, marrë në:  
<http://revistamapo.com/lexo.php?id=1656> (Më 13 korrik 2013).

Ismet OSMANI

## PIKËPAMJET E BLLAZHE KONESKIT PËR GJUHËN SHQIPE NË KONTEKST BALLKANIK

Shumë gjuhëtarë të huaj në veprat e tyre e kanë trajtuar edhe gjuhën shqipe në kontekst ballkanik dhe kanë vënë në spikamë një numër ta madh dukurish të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit. Në këtë kumtesë do të trajtoj kontributin e Blazhe Koneskit dhe pikëpamjet e tij për gjuhën shqipe, interferencat gjuhësore midis shqipes me maqedonishten, por edhe me gjuhët e tjera të Ballkanit. Të gjitha këto, do të trajtohen si bashkëpërkime të gjuhëve ballkanike në fushën e fonetikës, morfologjisë dhe sintaksës.

*Fjalët çelës:* interferenca, gjuhësi ballkanike, fonetikë, kategori morfologjike, sintaksë.

### 1. Hyrje

Shumë shkencëtarë pas çlirimit, për shkak të mungesës së kuadrit, qenë ballafaquar me nevojën e obligimit moral që të punojnë në më shumë fusha. Një prej tyre ishte edhe Blazhe Koneski. Ai gjatë jetës së vet punoi si profesor në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit “Qirili dhe Metodi” në Shkup, bëri studime në fushën e lingistikës, të historisë së letërsisë, të estetikës letrare, krijonte si shkrimtar (poezi dhe prozë), përkthente (poezi dhe prozë), përkthente tekste të vjetra dhe i redaktonte, shquhej si mbledhës i folklorit maqedonas.

Në veprat lingvistike të Blazhe Koneskit drejtpërdrejt ose tërthorazi është i pranishëm qëndrimi i tij ndaj gjuhëve ballkanike, përkatësisht shqipes, turqishtes dhe gjuhëve të tjera dhe me veprat e veta direkt ose indirekt ka ndikuar në standardizimin e disa elementeve të gjuhëve ballkanike në gjuhën maqedonase.

### 2. Jeta dhe vepra e Blazhe Koneskit

Blazhe Koneski punoi dhe krijoi në një periudhë të rëndësishme historike kur po konstituohej kombi dhe po kodifikohej maqedonishtja standarde. Me emrin e tij

lidhen veprat themelore të shkencës linguistike maqedonase të cilat janë faktorë për kodifikimin e një gjuhe: alfabeti, drejtshkrimi, gramatika, historia e gjuhës dhe fjalori.

### 3. Qëndrimi i Bllazhe Koneskit ndaj shqipes

Bllazhe Koneski me veprimtarinë e vet, me veprat e tij dhe ndjenjën subtile për gjuhën në përgjithësi dhe kompetencat linguistike është gjuhëtar me një ndikim të madh në Maqedoni dhe më gjerë në Ballkan.

Qëndrimin e Bllazhe Koneskut ndaj shqipes në kontekst ballkanik do ta ndjekim përmes tri veprave kapitale linguistike: Fonologjia historike, “Historia e gjuhës maqedonase” dhe “Gramatika e gjuhës letrare maqedonase”.

Në “Fonologjinë historike të gjuhës maqedonase”, Bllazhe Koneski vë në dukje ndikimet e gjuhëve ballkanike, veçmas të shqipes dhe të turqishtes në maqedonishten.

Bllazhe Koneski gjatë përshkrimit të sistemit vokalik vë në spikamë se, që nga periudha më e hershme, dialektet e maqedonishtes kanë pasur një sistem vokalik shtatëzanorësh (*u, e, y, o, a, ä, ä*). Koneski, ruajtjen e një zanoreje qendrore të përafërt me *ë*-në e shqipes e konsideron si element të gjuhëve ballkanike dhe romane, por edhe si element i të folmeve bullgare dhe të folmeve juglindore serbe. Megjithatë, ai nuk e shqyrton mundësinë e ndikimit të shqipes, që do të ishte shumë më e arsyeshme. Por, më tej thotë se disa pika të përbashkëta të kësaj zanoreje me gjuhën shqipe dhe arumune nuk mund të mohohen. Gjithashtu, ai vë në spikamë se në të folme të ndryshme paraqiten nuanca të kësaj fonemeje.

Në të folmet e maqedonishtes perëndimore fonema // del herë në dy e herë në tre tipe, varësisht nga pozita në fjalë. Vlen të zheksohet se në këto të folme sllave palatalja /j/ është e paqëndrueshme dhe pozhuajse po zhduket. Mensojmë se një dukuri e tillë i ka rrënjët te kontakti me shqipen, e cila për këtë ka dy fonema të ndryshme / dhe // që dallojnë nga qiellzoret sllave. Të njëjtën gjë e thotë edhe Aleksandër Beliqi, i cili në mënyrë të qartë pranon se //ja dhe /-ja janë të njohura në të folmet shqipe dhe arumune.

Koneski në Gramatikën e tij nuk përmend kurrfarë rreziku për rrafshimin e kundërvënies së palataleve q, gj me afrikatet *ç, xh*, qoftë edhe ai minimal. Lidhur me të Ante Popovski, në të folmet e Gostivarit konstaton se mesgjuhoret q, gj, pavarësisht prejardhjes së tyre janë afrikatizuar. Kjo, si edhe fonema të tjera, që mungojnë në gjuhët e tjera sllave të jugut si h-ja që e ka mbarë shqipja nuk na lë të mos mendojmë për kontaktin e këtyre dy gjuhëve, i cili sot në sajë të rrethanave jashtëgjuhësore ka marrë drejtim të ri.

Ndërkaq, lidhur me marrëdhëniet morfosintaksore po vëmë në spikamë çështjen e nyjës së prapme dhe të rimarrjes së kundrinës në gjuhën shqipe dhe në maqedonisht, fenomen i cili është ruajtur edhe sot si veçori themelore e sistemeve sintaksore të këtyre

dy gjuhëve, dukuri kjo që në bullgarishte e greqishte të re është e paqëndrueshme dhe e panjohur, që na shtyn të mendojmë se kjo maqedonisht mund të konsiderohet si ndikim i shqipes.

Ndikimi i shqipes mbi maqedonishten vërehet edhe emri foljor (*co*) едно одење, почнаа добри работи në shqip (*me*) një te shkumun, filluen punët e mira, të cilin B. Koneski e quan si ndikim gjuhëve ballkanike të arumanishtes dhe shqipes mbi maqedonishten.<sup>1</sup>

Mënjanimi i paskajores dhe zëvendësimi i saj me format vetore të lidhores (а – реченици në maqedonisht) është një proces i përgjithshëm ballkanik, që në gjuhët sllave është bërë nën ndikimin e gjuhëve ballkanike, greqishtes, rumanishtes dhe pjesërisht shqipes thotë B. Koneski.<sup>2</sup>

Me këtë rast dua të përmend edhe ndërtimin e disa kohëve të foljeve në maqedonishte nën ndikimin e shqipes, por që një pjesë e mohojnë këtë ndikim. Një dukuri tjetër është edhe përdorimi i foljes “*kam*”, e cila sipas B. Koneskit është përfutur nën ndikimin e arumanishtes, sepse kontaktet me popullatën vllahë të Maqedonisë Jugperëndimore kanë qenë shumë të fuqishme.<sup>3</sup> Prania e kësaj folje ndihmëse në të gjitha të folmet shqipe, por edhe në ato të arbëreshëve të Italisë flet qartë për vjetërsinë e kësaj forme, që mendoj se do të ketë ndikuar edhe mbi të folmet sllave, përkatësisht mbi maqedonishten.<sup>4</sup>

Jeta e përbashkët shumëshekullore, kontaktet e vazhdueshme gjuhësore dhe faktorët historik, ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor në zhvillimin e maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoni, ka kontribuar për një zhvillim konvergjent gjuhësor (për shumë ngjashmëri gjuhësore si dhe për interferenca gjuhësore). Gjuhëtari gjerman Hugo Shuhart (Hugo Schuchardt) konstaton se asnjë gjuhë nuk është plotësisht e pastër, pro në çdo gjuhë ka disa elemente të gjuhës tjetër.<sup>5</sup> Një gjë e tillë shumë vështirë pranohet nga gjuhëtarët sllav, përkatësisht ata maqedonas. Në sllavishte shumë herë është prekur ndikimi i maqedonishtes mbi shqipen, por assessi ndikimi shqipes mbi maqedonishten, gjë të cilën e mohojnë një numër i madh i sllavistëve, ashtu siç e mohonin edhe ndikimin e shqipes në dialektet serbe. Ndër gjuhëtarët e parë që ka përmendur këtë raport është Bllazhe Koneski, i cili nuk e mohan plotësisht këtë ndikim, por thotë se është një ndikim tepër i vogël, edhe atë në të folmet e fshehta të zanatçinjve

---

<sup>1</sup> Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Култура, Скопје, 1986, f.186

<sup>2</sup> Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Култура, Скопје, 1986, f.177.

<sup>3</sup> Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Култура, Скопје, 1986, f.199.

<sup>4</sup> Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë, 2004, f. 166.

<sup>5</sup> Hugo Schuchard, *Slavo-Deutsches und Slavo-Italianisches*, Gray, 1984.

(argot), për arsye se në qytetet e Maqedonisë shqipja nuk njihet mirë.<sup>6</sup> Për ndikimin e shqipes në argot në të gjithë Ballkanin flasin edhe shumë gjuhëtarë tjerë.<sup>7</sup>

Ndikimi i shqipes në maqedonishten, veçmas në rrafshin dialektor hetohet në të gjitha rrafshet gjuhësore e veçmas në fushën e leksikut. Fjalët shqipe kanë depërtuar në maqedonisht përmes kontakteve të drejtpërdrejta, përmes ritesh, këngësh etj. Mihajllöv pranon ndikimin e shqipes mbi maqedonishten, ku në mënyrë të qartë përmend maqedonishten e dibrës ku janë të pranishme shumë fjalë shqipe.

### ***Rezyme***

Gjuha shqipe si gjuhë e vjetër ballkanike, ka pësuar ndikime të ndryshme në kohë të ndryshme, por ka pasur ndikime edhe mbi gjuhët sllave, sidomos mbi maqedonishten, kur kihet parasysh fakti se folësit e shqipes dhe të maqedonishtes kanë jetuar në fqinjësi me shekuj. Marrëdhëniet reciprokë midis dy popujve në shkallë të ndryshme dhe në kohë të ndryshme kanë bërë që ndikimet gjuhësore midis këtyre popujve të jenë evidente.

---

<sup>6</sup> Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Култура, Скопје, 1986, ф.186

<sup>7</sup> В. Георгиев, *Вопроси на балгарската етимологија*, Сфонја, 1958, 49; К. Јиричек, О. Ј. Настева, *Албански зборови во тајните македонски јазици* (МЈ), 3 1953, 60-64; IV 4 1953, 132-139.

### Literatura

1. Asllan, H., Реципрочното влијание на македонскиот и албанскиот јазик во речниците на Пулевски, Македонскиот XIX век, Скопје, 1955.
2. Блаже К., Граматика на македонскиот литературен јазик, Култура, Скопје, 1987.
3. Блаже К., Историја на македонскиот јазик, Култура, Скопје, 1986.
4. Блаже К., Еден охридски текст од 19 век, Македонски јазик II, Скопје, 1951.
5. Божидар В., Дебарски Говори, МЈ XIX. Скопје, 1968.
6. В. Георгиев, Вapроси на балгарската етимологија, Сфoня, 1958,
7. Оливера Ј. Н., Блаже К., Божидар В., Контактите на македонските и албанските говори,
8. Петар М., Прилог кон хронологија на еден балканизам во македонскиот јазик, нe Македонски јазик 1-2, Скопје, 1962.
9. Петар М., Градскиот дебарски говор, Филозофски факултет Скопје, дипломски труд, 5, Скопје, 1954.
10. Rexhep I., Disa fjalë shqipe në maqedonishte, Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, 1/71, Prishtinë, 1972.
11. Shaban D., Gjuhësi ballkanike, Tiranë, 2004.





**Eliana PACO**

**MENDIMI I DREJTË I H. KRAHES MBI TOPONIMET SI  
VIJUSHMËRIA E NJË POPULLI**

***Abstrakti***

Ato që i rezistojnë kohës më shumë dhe që kalojnë gojë më gojë janë emrat e vendeve është me vend një thënie e Plutarkut që thotë se ilirët i ngritën qytetet dhe shtete në nderim të fitoreve të tyre. Cdo njeri vjen nga një vend dhe e ka origjinën prej diku. H. Krahe studiues i gjuhës, i historisë, gjeografisë dhe i etnografisë me udhëtimet e tija nëpër botë solli një material të pasur plot vlera për kohën e tij por edhe për brezat e më vonshëm. H. Krahe dijetar i njohur gjerman, lindur në Gelsenkirchen, më 1898, i apasionur deri në fund të jetës së tij 1968, pas udhëtimeve, kudo që vajti u interesua për historinë, etnografinë e për gjuhën e të parëve të këtyre popujve. Falë kulturës së tij si dhe studimeve që ai bëri në këto fusha, la një material të shfrytëzueshëm e plot interes për këdo. Me veprat e tij si *Altilyrische Personennamen*, *Balkanillyrischen Geographischen*, si dhe *Ilirët dhe indogjermanizmi*, ai ndihmon cdo kënd që është i interesuar ti hyjë studimeve historike-gjuhësore. Disa nga këto burime janë shfrytëzuar e vlerësuar, dhe kanë qënë ndihmesa të mëdha, për albanologët e huaj si dhe ata vendas. Edhe së fundit B. Broja ka bërë një studim mbi emrat e lumenjve duke u bazuar në veprën e H. Krahes. Ne mendojmë të sjellim këtu me punimin tone, disa emra vendesh e njerëzish që janë trashëguar nga antikiteti e transformimin e tyre sipas ligjeve gjuhësore që kanë vepruar në vite, si emrat e vendeve *Argyrokastra/Gjirokastër*, *Aulon/Vlorë*, *Drinos/Drin*, etj. H. Krahe ishte i mendimit se emrat e vendeve janë më të qendrueshmit e që përmbajnë në vetvete ndyshimet historike etnike gjuhësore të atij populli që i ka trashëguar. Ka pasur dhe kritika mbi këtë teori po me gjithatë veprat e H. Krahes do të mbeten baza e studimit të emrave të vendeve e të ujrave.

***Fjalët kyçe:*** Thyamis, Foinike, Arachtos, Aaos, Tragyas.

## Hyrje

Ato që i rezistojnë kohës më gjatë dhe që kalojnë gojë më gojë janë emërtimet e vendeve dhe të lumenjve. Çdo popull vjen nga një vend e ka origjinën prej diku. H.Krahe është një nga studiuesit dhe mbështetësit më të fortë të idesë së vijshmërisë së një populli në bazë të toponimeve e hidronimeve. Ai është i mendimit se emrat e vendeve si dhe të lumenjve përmbajnë ndryshimet historike, etnike e gjuhësore të atij populli që historikisht i ka trashëguar. Teoria e H. Krahes fillimisht është kritikuar sidomos nga kolegu e bashkëkohësi i tij, Valter Pol, po në vitet që pasuan u bë teoria bazë për të vërtetuar vijshmërinë e popujve në të njëjtat treva. H.Krahe ka lindur më 1898, në Gelsenkirchen, e ka vdekur në Heidelberg më 1968, duke punuar në universitet deri në fund të jetës së tij. H.Krahe shëtit shumë nëpër vende të ndryshme të Europës e Ballkanit, falë kësaj solli shumë të dhëna mbi historinë, filozofinë, etnografinë, jetën shoqërore si dhe studioi gjuhët e vjetra të të parëve duke analizuar emrat e lashtë të vendeve e të lumenjëve, duke bindur ndjekësit e tij se këto ishin vendimtare për të përcaktuar origjinën e vazhdimësinë e një populli. Emrat vetjakë të personave apo të fiseve janë të errëta se një popull mund t'i trashëgojë nga një tjetër apo t'i kalojë gojë më gojë. Dukuri kjo e përgjithëshme e Gadishullit të Ballkanit. Më të qendrueshëm paraqiten emrat e vendeve e të lumenjëve që natyrisht në ditët e sotme ato nuk janë më në formën e tyre nistore siç i sjellin autorët e antikitetit, por të ndryshuara konform ligjeve fonetike, që kanë vepruar në gjuhën e atij populli që i mbart, në rastin tonë sipas gjuhës shqipe. H.Krahe u tërhoq shumë pas popullit të lashtë ilir, që shtrihej nga Europa qendrore deri në gadishullin e Ballkanit dhe i kushtoi disa studime si *Lexikon altillyrische Personennamen*, Heidelberg 1929, *Die sprache der Illyren I*, *Die quellen*, Ëiesbaden 1955, *Die alten Balkanillyrischen Geografischen Namen*, Heidelberg 1925, *Die structure der alteneuropeischen Hydronomie* etj. Këto vepra janë një burim i mirë studimi jo vetëm për emrat e vendeve e të lumenjëve po sjellin mjaft të dhëna mbi gjuhën e ilirëve. Këto të dhëna kanë baza e studiuesve të ndryshëm dhe mbrojtësve të H.Krahes, për të mbështetur autoktoninë e popujve të sotëm. Studiues të ndryshëm si G.Mayer, H.Pedersen, Pouquville, E.Çabej, A.Xhuvani, Sh.Demiraj e të tjerë, i janë referuar veprave të H.Krahes, për të shpjeguar toponimitë si dhe fjalë të ndryshme me prejardhje nga ilirishtja. Shumë ndryshime fonetike që kanë pësuar këta emra vendesh e lumenjsh gjejnë shpjegimin e duhur në veprat e H.Krahes. Në këtë punim modest ne do të mundohemi të sjellim krahas emrave të vendeve e të lumenjve që na servir me studimet e tija H.Krahe edhe emra të tjerë të referuar në veprat e autorëve të antikitetit si Prokopi i Çezaresë (*De aedificiis*), Plini I II, Straboni, te ata më të rinj si Hamondi, Budina, Gubernantis, Çabej, etj.

Duke u mbështetur në veprën e H.Krahes, *Geografischen Namen*, do të trajtojmë emrat e vendeve dhe të lumenjëve duke i parë nga mënyra e formimit të tyre si me parashtesa, prapashtesa e kompozita ilire, e si janë të ndryshuar ato sot, sipas ligjeve fonetike që kanë vepruar në gjuhën shqipe.

Emra ilirë vendesh, lumenjsh e njerëzish të formuar me anë të parashtesave ar-:Arsia H.Krahe e sjell si emer ilir, Prokopi i Çezares, (De aedificiis), emrin *Arsia/Arsa*, na i sjell si emer kështjelle. Emrin *Arsa*, ne sot e gjejmë si emër vendi, në rrethin e Dukagjinit, pranë lumit Drin.

Ky emër e shohim të dalë sot dhe në toponime të tjera si Fushë Arrës. G. Mayer (Die sprache der alten Illyren) e lidh emrin Arsa, siç e citon Prokopi i Çezaresë, me formën e sotme Ras, gjasim ky më pak i ngjashëm.

Me parashtesat *agr-, aig-, ark-, alt-, akr-, agr-, and-*, H. Krahe i sjell si parashtesa ilire që kanë formuar emra njerëzish si *Agr-on, Aig-estis, Arkirius, Altinus, Akrabanis, Andena*, ndërsa *Argyas* e sjell nga forma më e vjetër e tij *Argunt*. Sot kjo formë jeton tek emri *Arian*, ku sipas ligjeve fonetike të shqipes *g* para *r* semantike kthehet në zanore dhe ka rënë *y* greke është kthyer në *i* si në shumë fjalë të tjera shqipe si *ilyria/iliria, epyrus/epir*, ndërsa prapashtesa *-an* që paraqitet te ky emër sipas E. Çabejt (St.Et.II), është një prapashtesë karakteristike për të treguar banorët e një qyteti, si *dibran, shkodran, matjan* etj. H. Krahe sjell dhe emra të formuar me parashtesat *arb-/alb-,si Arb-on, Arbatias* si emër kështjelle, si dhe emër vendi. *Arbon, Arbanon*, forma me *arb-* e këtij toponimi dëshmojnë herët të ilirët deri në kohën bizantine, ku gjejmë formën *alb-*, edhe te Prokopi i Çezaresë gjejmë formën *arb-*. Se cila është forma më e vjetër *arb-* apo *alb-*, ka mendime të ndryshme. Pedersen sjell si formën më të vjetër parashtesën *arb-*, ku bashkëtingëllorja *r*, ka kaluar në *-l*, gjë që është në natyrë të shqipes se e gjejmë dhe në emra të tjerë me prejardhje nga greqishtja e vjetër si *ormos*, gr.vj. *armeggio*,it, shqip *almise*. Forma *Arb-antias*, është pranuar si forma më e vjetër e emrit *Arbana*, fshat pranë Tiranës, nga *arb-antias/alba-an*, formë e përhapur në Shqipërinë e mesme që më pas u bë dhe emërtimi i gjithë shqiptarëve. Edhe E.Çabej (St.Et.II), pajtohet me mendimin e Pedersenit për vjetërsinë e kësaj prapashtese.

Parashtesë tjetër ilire, që na i sjell H.Krahe si pjesë për formimin e emrave të vendeve apo të lumenjve është parashtesa *bal-/Bal-cron, Bal-anson* emër kështjelle, sot e gjejmë si formën më të vjetër të emrit *Ballsh*, ky emër është transformuar në *Ballsh* në përputhje me ligjet fonetike të shqipes ku prapashtesa *-on*, ka rënë, grupi *-au* ka dhënë një *-ë*, të patheksuar që me kohë ka rënë, dhe një *-l*, që është kthyer në *-ll*, si *Apolonia/Apollonia, capitulum/kapitull,scapula/shpatulla*, ndërsa *-s*, ka dhënë *-sh*, si *Astibos/Shtëp,Scodra/Shkodra, Drivastum/Drisht*, (Bershevliev, Zur Deut. fq. 103), etj.

Parashtesat *ard-*, *art-*, Krahe na i sjell te emrat *Ardanus* emer ilir, *Art-as*, emër vendi ilir, nga një formë më e vjetër *Arachtos*. VI.Georgiev (La toponymie...fq 121) e lidh me fjalën *arakstos*-nga sanskr. e vjet.që do të thotë “përpijckje”, sot emrin *Arachtos* e kemi *Artë*, emer vendi që është përftuar nga veprimi i ligjeve fonetike të gjuhës shqipe, ku *-ch/h*, ka rënë , zanorja *-a* /në —ë, e pa theksur që më pas ka rënë. Ky emër del i cituar dhe te Prokopi i Çezarese si (De aedificiis), emër kështjelle, si dhe te Hamondi (Epyrus), në formën e tij *Arachtos*.

Parashtesa të tjera që sjell H.Krahe si ilire dhe që i gjejmë edhe sot tek emrat e toponimise së sotme janë *bed-*,*Bed-aurus*, emër ilir, *bor-*, *Bor-ia*, emër vendi, mund të lidhet me emrin e sotëm *bor- i*, *borigë*, *bul-*, *Bul-las* , emër vendi ilir, ne mendojmë se ky emër mund të lidhet me emrin *Bul-lis /Byllis*, që del në jug të Shqipërisë , parashtesa *dalm-*,*dalmatius*, banor i Dalmacisë, G.Mayer ( si dhe më pas E.Çabej (St.et.) e lidhin me fjalën *delme /dele* , po keshtu dhe fjalët që kanë parashtesën *dard-as* emer vendi, banor i Dardanisë. Autorët e më sipërm, Mayer e Çabej e lidhin me fjalën *darda/dardha* që është i përhapur në toponimi si *Fush- Dardhë*, *Dardha*, fshat ne rrethin e Korçës, ndërsa prapashtesa *-as*, sot del për të treguar banorët e disa krahinave si *beratas*, *tiranas*, *elbasanas*, etj. Si parashtesë ilire H.Krahe sjell dhe *tra- gas*, *Traguasi* emër vendi ilir. Ne mendojmë se është i njëjti emër me *Tragyas* emer vendi në jug të Shqipërisë, e citon dhe Prokopi i Çezaresë. Thuhet se Poseidoni nxorri kripë në këtë vend dhe e quajti “*kripa tragase*”. Ky emër lidhet sot nga vendndodhja me emrin *Tragias*, i përftuar nga ligjet fonetike te gjuhës shqipe ku *-g/-gj*, si te fjalët *argent/ argjend*, etj.Parashtesa *ur-* , H. Krahe na e jep për emër vendi ilir *Uria*. Ky emër mund të lidhet me *Euria*, emër kështjelle në jug të Shqipërisë, e citon Prokopi i Çezaresë (De aedificiis), në afërsi të Butrintit. Sot ky emër kështjelle e ka vendndodhjen pranë fshatit Qenur, njihet si *kështjella e Urias*, me rënie të *-e-* nistore.

Në veprat *Bemerkungen zu den Illyrischen Personennamen* dhe *Lexikon Altilyrischer Personennamen*, H.Krahe, na sjell një mori emrash vendesh, lumenjsh e njerëzish të formuar me anë të prapashtesave ilire. Emra me prapashtesën *-an/-ana*. Kjo prapashtesë gjendet e dokumentuar tek emrat ilirë që ruhen dhe sot në formën *-an*, me të cilën formohen emra vendesh (A.Xhuvani-E.Çabej Prapë në shqip). Me këtë prapashtesë H.Krahe sjell emra fisesh, lumenjsh e vendesh *Arbanon*, *Foretan*, *Loranum*, *Almana*, emër mali në Epir dhe emri *Dalmana*. Keto dy emrat e fundit A.Mayer (W.Et), i lidh me foljen *minda*, *minna/mënna*, *mënd*. Te Prokopi i Çezaresë (De aedificiis), me këtë prapashtesë del *Bessiana*, emër kështjelle në Dardani. Në hartën Ilirikum të shek.IV-VI, gjejmë *Bessana*, si emër qyteti, pranë *Lissusit* mbi Mathin. Mendojmë se bëhet fjalë për të njëjtin vend *Bessiana/Bessana*. Te G.Mayer (Die Sprache fq.79), e gjejmë në formën *Bessania* dhe ky autor e lidh me emrin *Pozana /Pezana*, vend në veri të Matit, Ne mendojmë se emri *Bessana*, është emri i sotëm *Berzana*, ku kanë vepruar ligjet e gjuhës shqipe, ku dy *-ss-*, në disa emra vendesh i shohim të ketë dhënë *-z-*,si te emrat *Sasson/Sazan*, *Gurasson/Gurëz*.

*Gurasson* na paraqitet si emër kështjelle në Maqedoni e sjell Prokopi i Çezaresë (De aedificiis), si dhe emër vendi në Dardani. Sot pranë Nishit ndodhet një kështjellë e quajtur *Gurbikon*, që sot sipas ligjeve fonetike të gjuhës shqipe ka dhënë Gurëz, emër vendi në veri të Shqipërisë.

Me prapashtesën *-ana*, del emri *Trana*, emër kështjelle e rindërtuar nga Justiniani në Epir, e sjell Prok. i Çez. (De aed.), sot e gjemë në formën *Treni*, vend ku janë gjetur mjaft objekte arkeologjike. Prapashtesa *-an*, *-ana*, në shumicën e emrave të vendeve ruhet sot si *-aj*, dhe del mjaft e përhapur në emrat e vendeve të Shqipërisë Verilindore, si *Bunaj*, *Kolgecaj*. Te emri *Tetiana*, emër kështjelle në Epirin e ri, e sjell si të tillë Prokopi i Çezaresë (De aedificiis), prapashtesa *-an*, del në formën *-aj*, si rezultat i kësaj përftohet emri *Tetaj*, emër vendi në Tropojë.

Prapashtesë tjetër që sjell H. Krahe, që hyn në formimin e emrave të vendeve, të lumenjve e të njerëzve është *-on/ona*. Me këtë prapashtesë del emri i vendeve *Aulon/Vlorë*, *Drinon/Drino/Drin*, që rrjedh nga një formë më e vjetër *drio/ rjedh* nga sanskritishtja. H. Krahe me këtë prapashtesë sjell dhe emra njerëzish ilir si *Agron*, i biri i *Pleuraton*. Te vepra De aedificiis e Prokopit të Çezaresë del *Pezion*, emër kështjelle në Epirin e vjetër. Ne mendojmë, duke u nisur dhe nga vendndodhja e tij, të jetë emri i sotëm *Pezë*, me rënien e prapashtesës *-ion*. Me këtë prapashtesë *-on/ona*, si një prapashtesë karakteristike ilire, H. Krahe mendon se ka shërbyer më shumë në krijimin e emrave të lumenjve dhe të vendeve, e më pak në formimin e emrave të njerëzve apo të fiseve p.sh.; emra vendesh si *Kranon*, emër qyteti, *Aulon*, *Chimerion*, emra njerëzish *Passaron*, *Milon*, *Esion Feton*, etj. Emra lumenjsh: *Drilon*, *Aberon*, *Naron*, *Rizon* etj. Në natyrë të shqipes shumica e këtyre prapashtesave nuk janë ruajtur në gjuhën shqipe të sotme sidomos ato që janë me origjinë latine, ndërsa te fjalët e trashëguara nga ilirishtja që na i sjell dhe H. Krahe shohim se pjesa më e madhe e tyre ruhet edhe sot në gjuhën shqipe. Emrat që H. Krahe i sjell si ilire me prapashtesën ilire-*er*, prapashtesë kjo që ruhet edhe sot në disa emra vendesh si *Shkodër*, *Dibër*, *Gjadër*. Hydronimin *Gjadër* te H. Krahe e gjejmë të shkruar me *-j-* nistore *Jader*. Ndërsa te Prokopi i Çezaresë (De aedificiis), e gjejmë të shkruar *Hadros*, si emër kështjelle në krahinën e Maqedonisë. Te vepra e Prok. të Çez. Gjejmë shpesh gabime në paraqitjen grafike të emrave, ky emër nuk ka mundësi të jetë me *b-*, nistore, sepse disa vite më vonë te hartat e A. Armaos, si dhe te hartat e A. Baldacit të viteve 1892, e gjejmë këtë emër të shkruar me *-j-* nistore. Po sipas mendimit të Joklit kjo *-j-* nistore nuk duhet të jetë tepër e vjetër se ndryshe duhet të kishte dhënë një *-z-* e jo *-gj-*, siç e gjejmë te fjalët *jugum* lat/ *zjedhë* në gjuhën shqipe. Jokli hidronimin *Gjader* e sjell nga një formë *Glader/Jadro*, që japin *Gjader*, ku grupi *-gl-/j-*, kanë dhënë *-gj-*. Kjo teori e Joklit qëndron se dhe te autoret e vjetër si Buzuku, Bogdani etj. për fonemën *gj-* kemi grupin *gl-*. Ka të ngjarë që forma me *-j-* nistore e këtij hidronimi të jetë

paraqitja e fonemës *gj-* e shqipes për të huajt. Ka shumë të ngjarë që të jetë kështu se dhe te harta e Gubernantisit, 1880, toponimi i *Tragjas*, e gjejmë të shkruar *Traias*,/*Tragyas*. Perderseni (Guturalet në shqipen fq.309) pohon se kjo *gj-*te hidronimi *Jader*,*Hadros*, *Gladro*, është kthimi i bashkëtingëllores *-s-* nistore, që sipas rregullit të zhvillimit të gjuhëve, është reflektuar në *-j-*, e më pas në *gj-* të gjuhës shqipe. Edhe nëse e shohim të shkruar sipas greqishtes së vjetër me *-b-* nistore, sipas rregullave të gjuhës shqipe, *-b-* nistore e greqishtes ka dhënë një *gj-*si *helpos*/*gjalp*, *baema*/*gjak*, *bolos*/*gjallë*. H.Krahe sjell dhe shumë prapashtesa të tjera ilire si *-aro*, *-ario*, *-at*, *-a*, *-et-it*, *-ot-nt*, të cilat duke u bashkuar me zanoret *-a*, *-o*, *-u*, *-e*, kanë luajtur një rol të madh në formimin e emrave ilirë, si *Dindaro*, *Dassaret*, *Pirustae*, *Peneste*, *Bladaurus*. Prapashtesa ilire *-ua* që na i sjell H. Krahe si ilire e hyn në formimin e emrave ilir si *Batua*, *Sapua*, ruhet edhe sot në disa emra njerëzish të gjinisë mashkullore si *Koçua*/*Koçoja*, *Miçua*/*Miçoja*, etj.

Prapashtesën *-in*, që del në formimin e disa emrave vendesh, *Lisin*, *Perante*, *Taranti*, H. Krahe e sheh si një prapashtesë të ardhur nga *-ent*, ku ka rënë *-t-*. H. Krahe sjell dhe shumë prapashtesa të tjera po që ne bëmë një përzgjedhje për caqet e kufizuara të kumtesës. Shumë të përdorura në toponiminë, hidroniminë dhe omoniminë janë dhe kompozitat. H. Krahe (Geogr. Namen. fq. 104) na sjell disa kompozita si *Epi-cadus*, *Ekeflode-ia*, *Bala-cros*, *Akra-banus*, *Mala-banus*, *Bal-laios*, e emër njeriu *Scaerdi-laedus*. Ketyre mund ti shtojmë dhe *Helicranon*, emër antik në Epirin e vjetër, P.Vlasova (Real. Encyk fq.87) e sheh si emër vendi në rënojat e *Panlis*, në veriperëndim të Delvinës, ndërsa M. Liku (Voyage dans le Grece) thotë se *Helicron* është emri i vjetër i Delvinës, Dh. Budina (St. Hist. 1972/2) e vendos në fshatin e sotëm *Krans*/*Krane*. Ne e mbështesim këtë mendim se vetë emri i sotëm e ruan një pjesë të emrit antik *Heli-cranon*. Edhe emri i vjetër i Beratit na paraqitet si një kompozitë *Anti-patrai*, po Berat ruan formën sllave të tij nga *Belgrad*/*Berat*. Kompozita të tjera që ruhen si të tilla në emërtimet e vendeve janë *Argyrokastra*/*Gjirokastër*, *Mallakastra*/*Mallakastër*, *Paleokastra*/*Paleokastër*.

Me këto shembuj që i përzgjedhëm për t'i sjellë këtu si dhe duke referuar dhe mendime të ndryshme të studiuesve të huaj e shqiptarë mbi emrat e vendeve, që nga origjina ilire e tyre e deri sot, deshëm të përforconim edhe njëherë mendimin e H. Krahes mbi vijshmërinë e një populli në trevat e veta. Materiali i pasur i H. Krahes e të tjerëve albanologë, i sjellë për territoret ilire, si dhe mungesa e të dhënave për ndonjë emigracion më të vonë të popullit shqiptar në tojet e sotme, të para së bashku, të shpien në konsekuencën e një rezultanteje që ky popull është vendas në viset që mban sot dhe që është pasardhës i një populli të gurrës ilire.

### **Biblografia**

1. H. Krahe, Die alten Balkanillyrischen Geografischen Namen, Heidelberg, 1925
2. Lexikon altillyrischen Personennamen Heidelberg, 1929.
3. Die Sprache der Ilyrier, 1 tel. Die Quellen, Eiesbaden 1955.
4. Bemerkungen zu den altillyrischen Personennamen, Heidenberg 1928.
5. H. Pedersen, Gutturalet në gjuhën shqipe
6. A. Xhuvani-E.Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë 1962.
7. A. Mayer, Die sprache der alten Illyrier
8. E. Çabej, Studime Etimologjike II, Prishtinë, 1976.
9. P. Caesarea, De aedificiis IV,
10. A. Mayer, Die sprache der alten Illyrer
11. G. L. Hamand, Epirus Oxford 1967.





**Elda RESMJA MOLLA**

**NDIHMESA E A.CIRRINCIONES PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE**

Anxhela Çirrintione është një studiuese e gjuhës shqipe, veçanërisht në fushë të historisë së saj. Duke qenë se ky seminar organizohet për kontributet e studiuesve të huaj për shqipen në pjesën e dytë të shekullit XX, objekt i kumtesës do të jetë libri i A.Cirrintiones, botuar në Romë, në vitin 1968, me titull: *“Sintassi degli antichi scrittori albanesi”*, (*Sintaksa e autorëve të vjetër shqiptarë*). Studiuesja synon të na njohë më sintaksën e gjuhës shqipe, duke na e dhënë të plotë, siç shprehet vetë ajo, bazuar në veprat e autorëve shqiptarë që nga 1462 deri në fund të 1800.

Siç shprehet dhe ajo vetw, për të ilustruar rregullat sintaksore, ajo e ka gjetur të rastit të heqë paralele mes Buzukut dhe Kristoforidhit. Kjo gjë është bërë për të nxjerrë në pah dukurinë e ruajtjes dhe evolucionit të strukturës gramatikore gjatë këtyre tre shekujve.

Libri është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë autorja flet për kryefjalën, foljen, përemrin, ndajshkrimin, nyjet etj. Një pjesë interesante e punimit mbetet analiza e sistemit rasor të shqipes në rrafsh sintaksor.

Autorja fillon me kryefjalën duke theksuar rolin e saj në fjali. Kryefjala mund të jetë një emër, përemër apo dhe një fjali e tërë.

*E prifti mbet e i tha.* (Budi,DC,f.74)

*Unë jam bariu i mirë* (Kristoforidhi,DhR,197,14)

Te përdorimi i emrave të përveçëm, autorja pohon se ato përdoren kryesisht në trajtën e shquar, por nuk mungojnë raste kur i gjejmë dhe në trajtën e pashquar, ashtu si në gjuhën e sotme. Të shihen shembujt e mëposhtëm.

*E përhapë renegoi Pjetri* (Buzuku, f.215)

*E prunë ndë Jerusalem* (Kristoforidhi, f.110)

*Tue klene Noe ën pesë qintsh vietë...*

Ka dhe raste ku emri del i shoqëruar me mbiemrin ku lakohet vetëm mbiemri;

*Biri i Bdek Buzukut* (Buzuku, f.379)

*Andre Bogdanit tim ungi ....*(Bogdani, CP, f.5).

Në libër pranohet ekzistenca e nyjeve, sidomos ajo e prapme si një dukuri jo vetëm e gjuhës shqipe. Nyja e përparme është përdorur para mbiemrave cilësorë si në shembujt e mëposhtëm.

*E bukurë je e bukurë bam* (Buzuku, f.13)

*Dheu i zi ban bukënë e bardhë* (Bardhi)

Autorja vëren faktin se ndonjëherë nyja që është e pranishme të autorët e rinj mungon tek autorët e vjetër.

*Jo, por djalëtë t'em anshtë ata qi anshtë gjall, e yiti anshtë ai qi anshtë vdekune* (Buzuku, 163)

*Muret e kësaj gjytet kjenë gjatë gjashtëdhjetë milija: gianë pesëdhjetë pash e nalt dyqind pash* (Bogdani, CP, f.58)

Përemri i gjithë e tjetër mund të kenë ose jo nyje të përparme, por mund të kenë nyje të prapme. Kur përdoren me parafjalë janë përdorur kryesisht pa nyje:

*Për gjithë ditën ban gosti* (Buzuku, 135)

*Ai qi ka prodhue tjerëvet vëllazënvet tanë* (Kuvendi i Arbënit, f.63)

Në fushë të përmrave të gjuhës theksohet dukuria e përdorimit të shpeshtë të trajtave të shkurtra. Megjithatë, nuk mungojnë raste si te Buzuku, Kristoforidhi, ku ky përdorim nuk është konstant si në gjuhën e sotme.

*Tba Jezû dishipujet vet* (Buzuku, f.135)

Një vend të veçantë, siç u përmend më lart, në punimin e autores zë dhe sistemi rasor i shqipes dhe funksionet kryesore të emrit sipas rasave. Rasa emërore përmendet si rasa e kryefjalës.

*Një guur s'ban muur* (Bardhi)

Nominativi i dyfishtë shihet i ndërtuar me foljet këpujore, *me qenë, me u ba*, si më poshtë.

*U jam zani i d'njai qi thëret ëndë dezertit* (Buzuku, f.79)

*E fjala u bë mish* (Matrënga, f. 209)

Në sistemin rasor po përmendim dukuritë më të rëndësishme.

Te përdorimi i emërores me parafjalët *ka, ke, tek, te*, si një dukuri tipike e shqipes, autorja ndalet gjatë. Ajo i konsideron parafjalë jo të mirëfillta, që ngjajnë më shumë me

ndajfole kohe a vendi, të cilat, sipas studiueses, në një formë sintatike tregojnë natyrën e ndajfoljes ndërsa në një formë tjetër shfaqen si parafjalë.

*Qi ën nesh duonë me ardhumë tek ju* (Buzuku, f. 135)

Në rasën kallëzore dhe dhanore autorja përmend faktin se në tekstet e vjetra nuk e gjejmë kundrinorin të përdorur rregullisht me trajtat e shkurtra.

*Suolla dhen, kërkova rruçullimin* (Kuvendi i Arbënit, f.62)

*Lavdi kloftë Atit e Birit e Shpirtit Shenjtë* (Buzuku, f.5)

*Të vobegjitë besonjëne Ungjillit* (Buzuku, f.79)

Te rasa rrjedhore vërehet përdorimi i rrjedhores së thjeshtë pa parafjalë.

*S'ishte njeri nesh që mkatë s'ka* (Matrënga, f. 15)

Në pjesën e dytë të librit, objekt është sistemi foljor, format e pashtjellura të foljes dhe sidomos llojet e fjalive të nënrenditura.

Kallëzuesi mund të përdoret në fjali në përputhje sipas kuptimit, që do të thotë se në emër kolektiv në njëjës, vjen me folje në numrin shumë.

*E shumica çuditëshme* (Buzuku, f.143, 57)

*Si kanë zakon gjindja e danjën vëlla me vëlla* (Budi, DC, f.74)

Megjithatë, te Kristoforidhi vërejmë përputhjen logjike në vend të përputhjes sipas kuptimit.

*Edhe gjindeja umerëkulue.*

Kur analizon kohët e foljes, ndalet tek e ardhmja. Sipas Cirrinçones shqipja nuk ka formë të veçantë të futurit dhe është e tipit *ka me ardhunë*. Këtë lloj futuri e lidh me ndërtimin e latinishtes, *amare habeo* kundrejt *amabo* të latinishtes klasike.

*E ënbas andaj ka me ardhunë* (Buzuku, f.69)

Te Matrënga gjejmë futurin tjetër *kam + lidhore*.

*Ai ka të vinjë, të gjykonjë* (f.15)

Një vend të veçantë studiuesja i ka kushtuar formave të pashtjelluara, si përcjellorja, pjesorja si dhe infinitivit të gegërishtes, të tipit *me +pjesore*.

*Ata duenë më u falunë* (Kristoforidhi, Dhj.Re. f. 9)

Studiuesja pajtohet me studiuesit e tjerë kur pohon se kjo paskajore zëvendësohet me lidhore në dialektin toskë.

*Të japsh të pijnë atire që kanë* (Matrënga, f.208)

Paskajores i nje funksione të ndryshme sintaksore

- a) në rolin e kryefjalës      *ma mirë me beshtunë se me fol* (Bardhi)  
 b) në rolin e kundrinorit      *nukë e dini qish doni me hypunë* (Buzuku, f. 133)

I njohur në latinishte dhe i sjellë në shqipe është dhe ndërtimi më mbiemrin *i denjë/ dingus*, të cilin autorja e sheh të ndërtuar me paskajoren, ashtu si dhe në tekstin latin.

*Nuk jam i denjë me u grishunë biri yji* (Buzuku, 141)

*Non sum dingus vocari filius tuus*

Te Kristoforidhi i njëjti varg është dhënë me paskajore.

Më tej autorja vijon me llojet e fjalive të nënrenditura si fjalia e nënrenditur lidhore, qëllimore, shkakore, kohore dhe kushtore të analizuara dhe të ilustruara me shembujt përkatës.

Në fund të librit studiuesja jep disa shënime mbi veçoritë sintaksore të shqipes, ku theksohet se si latinishtja ashtu dhe shqipja dallohen për rend të lirë fjalësh. Nëse në latinishte folja preferohet në fund të fjalisë, në shqipe ajo është në qendër. Pra, më së shumti kemi rendin S-V-O.

*Prijti mbet e tha* (Budi, DC, f.74)

Mund të jetë dhe në pozicion tjetër.

*E atë ëndiqnë e madhe shumicë* (Buzuku, 161) *sequebatur eum multitudo magna* (lat)

Mbiemri është gjetur shpesh para emrit, apo kur është në shkallën sipërore, si më poshtë,

*një i madh profet duol* (Buzuku, 173)

*ma të mirënë cobë* (Buzuku. f.141)

Gjatë studimit dhe analizës së njësive sintaksore, studiuesja për të mbështetur atë që pohon është marrë me fragmente të teksteve, pa e parë tekstin në tërësinë e tij. Si rezultat, bazuar në këtë metodë pune, shpesh studiuesja ka dalë në përfundime të gabuara mbi natyrën e strukturave të mirëfillta të shqipes, sidomos po të marrim parasysh faktin se shumica e teksteve të vjetra janë përthime nga gjuhë të tjera dhe se ndikimi i tyre do të ishte i dukshëm.

Këto dhe analiza të tjera të ilustruara me shembuj nga veprat e autorëve të vjetër kanë nxjerrë në pah veçori reliktoze të shqipes së hershme, por dhe dukuri të reja të evolucionit të strukturës sintaksore të gjuhës shqipe.

Flutura ÇITAKU

**GRAMATIKA PRAKTIKE NË PËRQASJE ME GRAMATIKËN E  
AKADEMISË (ME THEKS TË VAÇANTË NË TERMINOLOGJI)**

Siç dihet, botimi i Gramatikës së Akademisë<sup>1</sup> për gjuhësinë shqiptare shënon, përveç tjerash, një shkallë të lartë të standardizimit të terminologjisë gramatikore. Pothuajse të gjitha gramatikat dhe tekstet shkollore që u botuan pas GA-së (shkurtesë për Gramatikën e Akademisë) në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni u hartuan sipas modelit të kësaj gramatike, prandaj edhe terminologjia gramatikore nuk pësoi ndonjë ndryshim që do të vlente të cekej.

Ndërkaq, në vitin 1998 u botua një gramatikë tjetër e autorëve Çeliku, Karapinjalli, Stringa<sup>2</sup>, që gjithashtu është gramatikë tradicionale, por që në pika të caktuara del me disa trajtime ndryshe nga GA-ja, të cilat sollën ndryshime dhe prurje në terminologji.

Në këtë trajtesë jemi përpjekur t'i paraqesim dallimet që i kemi hetuar midis GP-së (shkurtesë për Gramatikën Praktike) dhe GA-së. Përfaqja mund të fillonte që nga ndarja e gramatikës në pjesë përbërëse. GA-ja trajton morfologjinë dhe sintaksën si dy pjesë të gramatikës ( në dy vëllime të ndara, të veçanta) dhe fjalëformimin në kuadër të morfologjisë, ndërsa GP-ja brenda një teksti rreth 500 faqesh trajton veç e veç morfologjinë, fjalëformimin dhe sintaksën.<sup>3</sup>

Duhet të cekim që në fillim se në këtë gramatikë nuk ka koncepte të reja por ka ndryshim të përmbajtjes konceptore dhe këto ndryshime në raste të caktuara janë emërtuar me terma të rinj.

---

<sup>1</sup> Gramatika e gjuhës shqipe<sup>1</sup>, Tiranë, 1976, (1995, 2002)

<sup>2</sup> M. Çeliku, M.Karapinjalli, R. Stringa, Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1998

<sup>3</sup> Në tezën tonë të doktoratës kemi përshkruar në hollësi përmbajtjen-pjesët e gramatikave të gjuhës shqipe dhe të disa gramatikave të gjuhëve të huaja.Gjithashtu kemi shprehur mendimin se fjalëformimi duhet të pavarësohet si disiplinë më vete.

## Në fushë të morfologjisë

Termi i ngulitur *nyjë* e *përparme* në GP emërtohet me një term të ri: *mbaresë* e *përparme*. Me *mbaresa* të *përparme* shoqërohen *mbiemrat* (pra, s'ka term *mbiemër* i *nyjshëm* dhe *mbiemër* i *panyjshëm* por *mbiemra* me *mbaresa* të *përparme* dhe *mbiemra* pa *mbaresa* të *përparme*. Kjo gramatikë përdor edhe termin *nyja* joshqese duke i konsideruar të tilla fjalët një dhe disa (ca). “Nyja e njëjësit është një; në shumës këtë funksion e kryen ca (disa) (Çeliku, Karapinjalli, Stringa 1998:23). Autori i parë i kësaj gramatike disa vjet më herët kishte konsideruar si *nyjë* joshqese edhe *nyjën zero* (shembulli për *nyjën zero*: *Ai nuk ka (-) vëlla. Ai është (-)student. Ai thotë se* “...nuk është e arsyeshme që për hir të ruajtjes së sistemit, meqë nuk ka *nyja* shqese në shqipe, të mohohen edhe *nyjat* joshqese ekzistuese. ...duhet njohur jo vetëm *nyja* joshqese një por edhe *nyja zero*” Madje, në një artikull të botuar më herët, propozon që ato të trajtohen “...edhe si pjesë të mëvetësishme të ligjëratës”(Çeliku 1996:199, 201)

Sa i përket termit *nyjë zero*, praninë e saj në letërsinë tonë gjuhësore e ka përligjur edhe Demiraj (1977:67) duke theksuar se “... kur flasim për *nyjë zero*, kemi parasysh ato raste kur emri përdoret i paprirë nga ndonjë përcaktor. Po kështu, për Agalliun. (1988: 154) është e papranueshme se si Çeliku “nga një anë nuk e njeh fare *nyjën* si pjesë ligjërate në gjuhën shqipe dhe në anën tjetër pranon *nyjën zero*...” dhe përfundon: “Për shqipen, ku *nyja* shqese si pjesë ligjërate nuk ekziston, sepse, duke qenë historikisht e prapavendosur, u ngjit e u shkri me *mbaresat* rasore dhe u përftua kështu tipi i lakimit të shquar, që i kundërvihet atij të pashquar, *pranimi* i një *nyje zero*, qoftë edhe në kuptimin tradicional të termit “*nyjë*” nuk ka kuptim.” Lidhur me *nyjën* e pacaktuar *nyjë* ai thotë: “...fjala një nuk është *nyjë* e mirëfilltë. ...ajo duhet të trajtohet si numëror themelor, i cili në disa përdorime ka fituar vlerat e *nyjës* së pacaktuar, duke humbur edhe theksin. (Agalliu 1988:155)

Në GA nuk pranohet *nyja zero*, madje as fjala disa (ca) nuk pranohet si *nyjë*, ndërkaq për numërorin një si *nyjë* e pacaktuar thuhet: “...emri i shoqëruar me të, tani në trajtën e pashquar, krijon kundërvënie me trajtën e shquar gjegjëse dhe në këtë përdorim fjala një i përgjigjet nga kuptimi dhe funksioni *nyjës* së pacaktuar të atyre gjuhëve që janë të pajisura me *nyja*.” (2002:129) Përfundimisht del se për GA-në ka vetëm *nyja* të *përparme*, që trajtohen si morfema edhe trajtëformuese edhe fjalëformuese.

GP-ja e rishqyrton çështjen e rasave dhe të numrit të tyre. Aty dalin pesë rase por jo për të dy trajtat e emrit, sepse "Emri nuk ka rrjedhore të shquar..."<sup>4</sup> dhe "...emri në gjinore dhe dhanore shumë të shquar ka sot mbaresën shquese zero. (Çeliku...1998:38) Kështu, kuptohet se –ve është mbaresë për gjinoren dhe dhanoren në të pashquarën, kurse në shumësin e shquar kjo-ve nuk është mbaresë, por është mbaresë–zeroja, që është në kundërshtim me konceptin për mbaresën e cila i shtohet temës së shumësit të emrave. Nëse e shikojmë trajtën e shquar sipas tabelës së dhënë në këtë gramatikë (Çeliku...1998:38-39) shohim se tema e shumësit për trajtën e shquar është lisave e dihet se tema e shumësit është e përbërë nga rrënja e fjalës lis dhe morfema e shumësit –a. Pra, lisa e jo lisave që, sipas nesh, nuk ka mbështetje shkencore.

Edhe Agalliu (1988:129) ka theksuar se kundërvënia njëjës-shumës tek emrat e gjuhës shqipe "gjen shprehje edhe në krijimin e një teme të veçantë për shumësin, të ndryshme nga ajo e njëjësit.

Është për t'u theksuar trajtimi i rasave që drejtohen nga parafjalët. Sipas GP-së "Dhanorja përdoret si plotësues i një foljeje ose i një fjale tjetër duke u paraprirë me parafjalët: pranë, larg, jashtë, afër, anës, brenda, gjatë, prapa; buzë, majë, midis, rrëzë, etj. për të treguar vend, kohë (*anës detit, anës dritës, pranë sofrës, rrëzë murit, buzë një ledhi, gjatë vitit...*)" (Çeliku...1998:50). Nga ana tjetër, kur trajtohet përdorimi i rasës rrjedhore, veç tjerash, thuhet se ajo "përdoret si plotësues i një foljeje duke u paraprirë nga parafjalët: prej, pas, para me emra në shumës që tregojnë fragmente kohore (*prej vitesh, pas dy orësh, pas një viti, pas disa muajsh*)" (Çeliku...1998:50-53) Në kapitullin mbi parafjalët gjejmë parafjalë të njëjta që drejtojnë dhanoren dhe rrjedhoren. Ato janë: ndaj, midis, afër, mes, larg, pranë, poshtë, sipas, para, prapa e shumë të tjera. Në një shënim thuhet se "Parafjalët e prejardhura nga emrat dhe nga ndajfoljet paraprijnë zakonisht emra në rasën dhanore, por përemra në rasën rrjedhore si: *Kalonte midis maleve-rrallë midis malesh*; por: *Qëndronte midis nesh* (rrjedhore); *Qëndronte para shqëpisë, por Qëndronte para meje*." (Çeliku...1998:221-222) Kujtojmë që brenda kësaj gramatike nuk është mbajtur qëndrim i drejtë sa i përket kësaj çështjeje dhe ka shumë paqartësi, prandaj në të ardhmen duhet qartësuar nëse këto parafjalë drejtojnë dhanoren apo rrjedhoren. Çeliku më herët kishte shprehur mendimin (të rimarrë nga Rrota) se është fjala për "parafjalë me më shumë se një reksion" (1996:202). Sidoqoftë, në të ardhmen shkenca jonë duhet të japë një përgjigje për këtë çështje. Nga ana tjetër, sipas GA-së, të gjitha rasat mund të drejtohen nga parafjalët, përveç dhanores.

---

<sup>4</sup> Kjo nuk është një risi në historinë e zhvillimit të shkencës sonë. I pari që ka mbrojtur këtë pikëpamje ka qenë Samiu, më vonë edhe gjuhëtarë si Myderrizi, Agalliu, Riza

Në klasën e foljeve gjithashtu janë për t'u theksuar disa trajtime ndryshe nga GA-ja. Në GP foljet sipas kuptimit dhe funksionit ndahen në: 1. Folje me kuptim të plotë leksikor, 2. Folje me kuptim modal (mund, duhet, lipset, do, kam, jam, dua)<sup>5</sup>; 3. Folje me kuptim aspektor (filloj, nis, zë, vazhdoj, mbaroj, pushoj, bëj); 4. Folje këputore (jam, bëj, kam, emëroj, shpall, etj.). Së fundi në një grup (grupi i 5-të) janë përfshirë folje që formojnë kohët e përbëra (në funksion të mbaresave): kam, jam, do. Foljet kam dhe jam quhen ndihmëse (siç janë quajtur tradicionalisht në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe, por edhe më gjerë edhe në gramatikat e gjuhëve të tjera ic..). Se ato funksionojnë si mbaresa” nuk ka asnjë mëdyshje, por i njëjti fakt nuk vlen, për foljen do, e cila, së pari, dihet se e ka humbur kuptimin leksikor (pra nuk është folje, por ka prejardhje foljore) duke kaluar në pjesëz trajtëformuese që formon të ardhmen dhe, së dyti, për rrjedhojë, forma *do të referoj* nuk është kohë e përbërë, sepse të tilla janë quajtur kohët që ndërtohen me foljet ndihmëse kam dhe jam. Ndryshe qëndron puna me foljen do të gjuhëve sllave, konkretisht të serbishtes dhe kroatishtes<sup>6</sup> kur kjo folje merr forma të ndryshme për të tri vetat. Folja ndihmëse ću (hoću) ndërton futurin I, si: *ja ću pevati, ti ćeš pevati, on će pevati, mi ćemo pevati...*(1998:111).

Lidhur me numrin e mënyrave të foljes në gjuhën shqipe, edhe në gramatografi, edhe në studime, gjuhëtarët ndahen në ata që kushtoren e konsiderojnë si mënyrë të veçantë dhe në ata që nuk e pranojnë si mënyrë të veçantë. Ky problem rrjedh nga format homonimike të dy kohëve të ardhme të së shkuarës të mënyrës dëftore nga njëra anë, dhe, të dy kohëve (e tashme dhe e kryer) të mënyrës kushtore, nga ana tjetër. Kushtorja në gramatografinë shqiptare nuk është pranuar si mënyrë e veçantë<sup>7</sup>, por nga ata që e kanë pranuar është trajtuar me lëkundje duke ia njohur asaj madje edhe më shumë se dy kohë<sup>8</sup>

Sa u përket gramatikave të shkruara pas GA-së duke e përfshirë edhe atë (Beci<sup>9</sup>, Munishi<sup>10</sup>, etj.) kushtoren e pranojnë si mënyrë me dy kohë. Kurse nuk e pranojnë Gramatika e Buholc- Fidlerit<sup>11</sup> dhe Gramatika Praktike.

<sup>5</sup> Për foljen dua si folje me kuptim modal nuk është dhënë asnjë shembull. Kjo folje nuk konsiderohet si e tillë në gramatikat e tjera, përveç te Riza.

<sup>6</sup> Ж. Станчић, Л. Поповић, С. Мицић, Сабремени српскохрватски језик и култура изражавања, Београд-Нови Сад, 1998

<sup>7</sup> Kristoforidhi (1882) dhe Samiu (1886)

<sup>8</sup> Kështu Xanoni(1909) ia njej asaj 6 kohë,duke I trajtuar si kohë të kushtores edhe forma foljoreqë përdoren në protasat e apodosat e periudhave hipotetike; Mikeli gjithashtu ia njej kushtores 6 kohë; Rrota e Myderrizi(1944) ia njohin kësaj mënyre nga 3 kohë.

<sup>9</sup> B. Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë, 1998

<sup>10</sup> Z. Munishi, Zgjedhimi i foljeve, Prishtinë, 1998

<sup>11</sup> O. Buchholz, W Fiedler, Albanische Grammatik, Leipzig, 1987



Ndër studimet e bëra për kushtoren, po japim pikëpamjet e disa gjuhëtarëve që kanë bërë përpjekje të argumentojnë pse kushtorja nuk duhet konsideruar si mënyrë më vete (Agalliu, Demiraj dhe Topalli).

Trajtat e mënyrës kushtore, sipas Agalliut “nuk mund të ndahen dot nga ato të së ardhmes së dëftores, bashkë me të cilat formojnë një sistem si për nga struktura e formimit, ashtu edhe për nga vlerat kuptimore që kanë ose fitojnë me kohë” (1968:134) Sipas Demirajt kohët e ardhme të së shkuarës mund të përdoren me vlerën e mënyrës kushtore në apodosat e periudhave hipotetike për të shprehur mundësinë ose pamundësinë e kryerjes së një veprimi që varet nga një kusht... duke u përdorur në periudha hipotetike u është forcuar kuptimi modal i mundshmërisë dhe u është dobësuar kuptimi kohor i së ardhmes së të shkuarës (1995:194).

Po kështu mendon edhe K. Topalli (2011:826) duke e lidhur praninë e kësaj mënyre edhe me ndryshimin e pikës së referimit kohor nga e shkuara në të tashmen.” ...kjo formë është kthyer nga një formë kohore relative (e varur nga një kohë e së shkuarës) në një formë kohore absolute (e varur nga e tashmja). Përfundimisht, sipas Topallit, në aspektin kohor, e ardhmja e së shkuarës është kohë relative dhe përdoret në stilin tregimtar, (krahas kohës së pakryer, të kryer të thjeshtë, më se të kryer), kurse kushtorja e tashme është kohë absolute dhe përdoret në bisedën e drejtpërdrejtë të ligjëruesit. (K. Topalli 2011:868)

GP-ja kushtoren nuk e konsideron si mënyrë më vete. Ndërkaq, arsyetimin është dhënë edhe në artikuj të botuar para gramatikës me fjalët se ”ajo nuk ka trajtë të veçantë” (Çeliku 1996:200; 2001:122).

GA-ja e pranon kushtoren si mënyrë më vete duke theksuar se format e saj janë homonimike me kohët e ardhme të së shkuarës së mënyrës dëtoje dhe se nga pikëpamja e modalitetit “mënyra kushtore afrohet me mënyrën lidhore. Ajo është shpesh e barasvlershme me të pakryerën, përkatësisht me më se të kryerën e lidhores të prirë nga folja modale mund (2002: 328).

Edhe trajtimi i formave të pashtjelluara në GP është ndryshe nga ai i GA-së dhe i shumicës së gramatikave të gjuhës shqipe. Çeliku i ka bërë një rishikim trajtimit të këtyre formave<sup>12</sup> dhe ka dhënë disa zgjidhje origjinale, të cilat do të përpiqemi t'i shtrojmë shkurtimisht edhe këtu. Sipas tij mangësia kryesore e trajtimit të këtyre formave është se kategorizimi i tyre “... nuk është bërë në bazë të një kriteri të përgjithshëm teorik që të përfshinte të gjitha format e tilla. Vëmendja është përqendruar kryesisht te karakteristikat foljore të tyre dhe ka munguar vështrimi përgjithësues e kategorizues i tyre në lidhje e përjasje me kategoritë e tjera leksiko-gramatikore.”

---

<sup>12</sup> Format e pashtjelluara është tema e tezës së doktoratës së M. Çelikut

(1984:136) Një kategorizim i mirëfilltë i formave të pashtjelluara mund të bëhet nëse kihet parasysh që “ato janë kategori gjuhësore ndërmjetëse, sepse gërshetojnë karakteristikat e foljes me ato të pjesëve të tjera të ligjëratës: të emrit, mbiemrit e ndajfoljes. Në çdo formë të pashtjelluar zakonisht mbizotëron një gërshetim dyanësor karakteristikash (të foljes dhe të emrit, të foljes dhe të mbiemrit, të foljes dhe të ndajfoljes)”(Çeliku1984:138). Te këto gërshetime dyanësore, Çeliku sheh të domosdoshme mbështetjen gjatë kategorizimit të këtyre formave në bazë të veçorive morfologjike, kuptimore dhe sintaksore të tyre, prandaj thotë se këto forma ”përbëjnë një kategori leksiko-morfo-sintaksore”(1984:139). Duke u mbështetur në këto kritere, ai ka arritur të konstatojë që shqipja ka tri forma të pashtjelluara të foljes: 1. Gerundi, që ka dy trajta rasore: a) të bërë-trajtë e kallëzores (*Dëshira për të lexuar e ka shoqëruar gjithë jetën*)<sup>13</sup> dhe b) së bëri-trajtë e rrjedhore (*Fshati mbaroi së ndërtuari shkollën*), ku gërshetohen kryesisht tipare të foljes e të emrit, por edhe të ndajfoljes; 2. Përcjellorja, që ka dy trajta: a) duke bërë-përcjellore e njëkohësisë (*Shkonte duke çaluar*) dhe b) pa bërë-përcjellore e parakohësisë (*Mos u nis pa marrë leje*), ku gërshetohen kryesisht tipare të foljes dhe të ndajfoljes, por rrallë edhe të mbiemrit 3. Pjesorja: bërë (*E gjeta me duar lidhur, E hodhi në vatër letrën e grisur*), ku gërshetohen tipare të foljes dhe të mbiemrit”. Në GP gjejmë po këto forma të pashtjelluara bashkë me nënndarjet e tyre të shoqëruara me shembuj (1998:128-129). Këtu duhet të shtojmë se termi gerund në gramatikat tona është përdorur për përcjelloren, pastaj forma mohore që këtu përfshihet te përcjellorja, bie fjala, në Gramatikën e Becit është trajtuar si formë e katërt e pashtjelluar. Dallimi thelbësor është trajtimi i fjalëve për dhe me si parafjalë nga Çeliku (më herët edhe nga Samiu, Sheperi, Cipo) që i shoqërojnë këto forma e jo si pjesëza (GA). Pra, trajtimi i formave të pashtjelluara ka pika jo të pakëta dallimi në trajtim, për rrjedhojë ka edhe dallime në terminologji.

Dallime janë parë edhe në kategorinë e kohës. Në GP, përveç dëftores, edhe haborja del të ketë kohën e ardhme (*Në lagjen tonë do t'u ndërtuaka edhe një pallat sporti*). Koha e tashme e mënyrës dëftore del me tri nënndarje: 1. E tashmja e pacaktuar (*punoj*); 2. E tashmja e caktuar (*po punoj*), 3. E tashmja e vazhdimësisë (*jam duke punuar*). Në GA ka veprim të caktuar dhe veprim të pacaktuar (2002:274), por jo terma gjegjës kohë e tashme e caktuar, kohë e tashme e pacaktuar dhe kohë e tashme e vazhdimësisë. Po këtë ndarje e gjejmë edhe te koha e pakryer, pra: e pakryera e pacaktuar (*punoja*), e pakryera e caktuar (*po punoja*) dhe e pakryera e vazhdimësisë (*isha duke punuar*). (Çeliku...1998:205) Po sipas formulës: folja jam (në kohën e duhur) + përcjellorja (e foljes kuptimplotë), përveç formave të së tashmes dhe të së pakryerës, mund të formoheshin edhe kohët e tjera të mënyrës dëftore (gjithsej 10) (Panolli, 1992:70)

<sup>13</sup> Shembujt janë nga Gramatika Praktike f.128-129

Në GP e ardhmja del me gjashtë nënndarje, në vend të katër nënndarjeve në GA. Ato janë: 1. E ardhmja (*do të punoj*), 2. E ardhmja e sigurisë (*kam për të punuar*), 3. E ardhmja e së shkuarës (*do të punoja*), 4. E ardhmja e së shkuarës e sigurisë (*kisha për të punuar*), 5. E ardhmja e përparme (*do të kem punuar*) dhe 6. E ardhmja e përparme e së shkuarës (*do të kisha punuar*). E ardhmja pra është pasuruar me dy terma të rinj: e ardhmja e sigurisë dhe e ardhmja e së shkuarës e sigurisë, ndonëse format e tyre janë të pranishme edhe në GA, por termat mungojnë. (2002:291) Pra, numri i përgjithshëm i kohëve të mënyrës dëftore në GP është 16. Edhe mënyra habitore është pasuruar me kohë. E tashmja del me dy nënndarje: 1. E tashmja e pacaktuar (*punuakam*), 2. E tashmja e caktuar (*po punuakam*) sikur edhe e pakryera: 1. E pakryera e pacaktuar (*punuakësba*), 2. e pakryera e caktuar (*po punuakësba*). E kryera (*paskam punuar*) dhe më se e kryera (*paskësba punuar*) janë si në GA. Risia tjetër, siç e thamë në fillim, është se kjo mënyrë konsiderohet të ketë të ardhmen (*do të punuakam*).

### Në fushë të Fjalëformimit

Siç e kemi cekur, Në GP fjalëformimi trajtohet në një kapitull të veçantë, pas atij të morfologjisë (Çeliku...1998:299-371). Edhe në këtë rrafsh kemi hetuar disa pika dallimi në trajtim. Kështu, sipas kësaj gramatike, formimet si: *përkerub*, *përdor*, *përbuz*, *përgjak*, etj., trajtohen si formime me parashtesë dhe prapashtesë njëherazi, më saktë, pranohet gjedhi: për+emër+prapashtesë zero për të formuar folje. Termin prapashtesë zero nuk e hasim në GA dhe formimet si këto konsiderohen të formuara vetëm me parashtesë (2002:349).

Në formimet me prapashtesa janë radhitur përveç atyre që formojnë emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje, edhe ato që formojnë gjininë femërore të frymorëve (-e, -ë, -eshë, -ushë, -onjë, etj). Prapashtesat e tilla në GA trajtohen te gjinia e emrit, megjithqë edhe aty thuhet se “ndryshimi i gjinisë mashkullore nga femërorja shprehet në disa mënyra, të cilat në të vërtetë përfaqësojnë procese fjalëformimi, por trajtohen këtu, para së gjithash, sepse seksi, siç u tha, lidhet drejtpërdrejt me gjininë gramatikore” (2002:91). Ne mendojmë se prapashtesat e tilla duhet trajtuar te prapashtesat trajtëformuese, siç janë prapashtesat e shumësit, të pjesores dhe ato që formojnë temën e dëshirores.

GP-ja nuk e pranon nyjëzimin si mënyrë të veçantë të formimit të fjalëve, sidomos të mbiemrave prejpjesorë. Edhe kur mbiemrat formohen me prapashtesë dhe nyjëzim, ose me nyjëzim, parashtesë dhe prapashtesë si *i sjellshëm*, *i përkohshëm*, kjo gramatikë i trajton si formime me prapashtesim, ose me parashtesë e prapashtesë (Çeliku...1998:338). Të njëjtat fjalë në GA konsiderohen të formuara me nyjëzim dhe

prapashtesim njëkohësishtose me nyjëzim e parashteso-prapashtesim (2002:79;192) Përfundimisht GP-ja nuk i pranon mënyrat e përziera të fjalëformimit.

Në GP, ashtu si në GA, prejardhja pa ndajshitesa (pa afikse, f.351-357) hyn në formimet me prejardhje, mirëpo, përveç modeleve F-E (*hap-hap-i, mund-mundi, pjell-pjellë...*); E-F (*kripë-krip, shoshë-shosh, myk-mykem*), që përkojnë me GA-në, po në këtë tip (pa ndajshitesa) hyjnë edhe shumë modele të tjera që nuk përputhen për nga mënyra e formimit me GA-në. T'i shohim me radhë: emra të formuar nga pjesorja (*goditur- e goditur-a, shtënë- e shtënë-a, folur-të folur-it, parë-të parë-t*); që në GA konsiderohen formime me nyjëzim; M-E (*e mirë-e mira, i varfër-i varfër-i, tetërrokësh-tetërrokësh...*), që në GA konsiderohen formime me konversion, ashtu si mbiemra të formuar nga emra (*kyç-kyç, fshatar-fshatar, punëtor-punëtor...*); mbiemra nga pjesoret: *ditur- i ditur, fjetur- i fjetur, vrarë- i vrarë, zgjuar- i zgjuar...*), që në GA konsiderohen formime me nyjëzim. Po në grupin e formimeve pa ndajshitesa në GP futen edhe formime të tjera si folje nga mbiemra (M-F): *i kuq-kuq, i shëndoshë-shëndosh*; ndajfolje nga mbiemra (M-N): *i mirë-mirë, i keq-keq, i kotë-kot, i drejtë-drejt* që në GA konsiderohen të formuar anasjelltas nga ndajfolja në mbiemër (N-M): me prapashtesën ë- dhe me një të përparme); ndajfolje nga emra (E-N): *moti-moti, sheshit-sheshit, fare-fare, natën-natën*; ndajfolje nga pjesore (F-N): *shtruar-shtruar, hapur-hapur...*; para-fjalë nga ndajfolje (N-Pa): *afër-afër, brenda-brenda...*; para-fjalë nga emra (E-Pa): *buzë-buzë, majë-majë*; lidhëza nga përemra (P-L): *që-që, sa-sa...*; lidhëza nga ndajfolje (N-L): *ku-ku, kur-kur...*; pjesëza nga ndajfolje (N-Pj): *vetëm-vetëm, plot-plot...*; pjesëza nga lidhëza (L-Pj): *edhe-edhe, sapo-sapo, se-se. që-që...*; pasthirrma nga emra (E-Pas): (*qyqja-qyqja, korba-korba...*) që në GA konsiderohen formime me konversion; ndajfolje nga përcjellore<sup>14</sup> mohore (*pa dashur-padashur, pa pritur-papritur...*) që dihet se janë formuar me një mënyrë të veçantë: me përngjitje.

Në GP, në kapitullin e mbiemrit termi fundore emërton: 1. Prapashtesat: -m/më, -t/të, -shëm që formojnë mbiemra; 2. Prapashtesat trajtëformuese (ky është term i saktë që përdoret në GA për këto morfema) -ur, -rë, -r, -ë, -në të pjesores (prej pjesoreve pastaj formohen mbiemrat me nyjëzim) dhe 3. Tingujt fundorë të mbiemrave të parmë si: ël, ër... Ky term (fundore) del me përmbajtje të zgjeruar konceptore me “morfemë që formon fjalë të re “(në GA: prapashtesë që formon mbiemra) dhe “morfemë që formon formë të re (Në GA: prapashtesë trajtëformuese që formon temën e pjesores ). Siç dihet, termi fundore në traditën gramatikore përdoret për tingullin a tingujt fundorë të fjalëve të parme<sup>15</sup>, që në këtë rast janë ël, ër..., prandaj, sipas nesh, nuk do të duhej të trajtoheshin së bashku.

<sup>14</sup> Pa dashur nga Çeliku trajtohet si një tip i përcjellores

<sup>15</sup> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 49, 72; Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 298 “rrokje, tingull a grup tingujsh në fund të fjalëve”

### **Në fushë të sintaksës**

Termi sifjali në GP emërton tri koncepte: 1. Fjalinë kryesore; 2. Fjalinë e varur dhe 3. Fjalinë e bashkërenditur brenda fjalisë së përbërë me bashkërenditje. Së këdejmi, brenda fjalisë së përbërë mund të ketë: 1. Sifjali kryesore, 2. Sifjali të varur; 3. Sifjali të bashkërenditur, terma këta që mungojnë në GA.

Ato që tradicionalisht (edhe në GA) janë quajtur: sintaksa e fjalisë dhe sintaksa e periudhës, si dhe janë trajtuar veçmas, në GP trajtohen bashkë, njëkohësisht. Pra, kryefjala dhe sifjalia kryefjalore, kallëzuesi dhe sifjalia kallëzuesore, rrethanori dhe sifjalia rrethanore, e kështu me radhë.

Termi plotësues i foljes në këtë gramatikë mbulon këto koncepte: 1. Përcaktorin kallëzuesor të kryefjalës dhe të kundrinorit të drejtë, 2. Rrethanorin, 3. Përcaktorin e emrit dhe 4. Kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, të cilat në GA emërtohen me terma të veçantë. Nga ana tjetër, nuk ka emërtime për kundrinorët (i drejtë, i zhdrejtë, i zhdrejtë me parafjalë). Vlen të thesohet gjithashtu që në pjesën e morfologjisë dalin disa terma të sintaksës që nuk i gjejmë në pjesën e sintaksës, madje me emërtime të huaja si: Objekt i drejtë dhe objekt i zhdrejtë i një foljeje (f.50); subjekt i foljes (f. 86); përsëritëse e objektit të drejtë ose të zhdrejtë (f. 88). Kjo ndodh për arsye se kjo gramatikë është shkruar nga tre autorë të ndryshëm. Në GA këta terma dalin vetëm shqip: kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë dhe kundrinor i përsëritur.

### **Përfundimi**

Përqasja midis dy gramatikave që janë marrë në shqyrtim prej nesh nxjerr në pah dallime në trajtimin e disa çështjeve, nga njëra anë, dhe emërtimin e koncepteve të caktuara me terma, qoftë të rinj, qoftë të tjerë, nga ana tjetër.

E shohim me interes dhe me vend që fjalëfomimi të trajtohet veçmas, ashtu siç ka dalë në Gramatikën Praktike. Janë për t'u vlerësuar termat: e tashme (e pakryer) e caktuar; e tashme (e pakryer) e pacaktuar dhe e tashme (e pakryer) e vazhdimësisë të cilat mungojnë në Gramatikën e Akademisë. Gjithashtu, vlerësojmë trajtimin e fajalëformimit më vete (si në GP e jo në kuadër të morfologjisë (si në GA)

Së fundi, mund të thoshim se prurjet në terminologji (krijimi i termave të rinj) nga GP-ja kanë ndikuar sipas nesh, që të lëkundet qëndrueshmëria dhe shkalla e standardizimit të terminologjisë së gramatikës tradicionale që ishte arritur nga GA-ja, përderisa terma të caktuar si: mbaresë e përparme, mbaresë fundore, mbaresë e prapme, prapashtesë zero, sifjali, ose trajtimi krejtësisht ndryshe i formave të pashtjelluara,

mospranimi i formimeve me nyjëzim e ndonjë tjetër, të mos prahohen nga qarqet shkencore. Risitë e sjella në këtë gramatikë përmes krijimit të termave të rinj, kanë shkaktuar ndryshime në fjalësin terminologjik të gramatikës dhe krijojnë tash për tash vështirësi, për të mos thënë huti në procesin e mësimdhënies, me të cilin ballafaqohemi për çdo ditë. Para mësimdhënësit dalin vështirësi të natyrës terminologjike, sepse ajo që tradicionalisht dhe në GA quhet mbaresë rasore në këtë gramatikë quhet mbaresë e prapme (me përcaktuesit joshquese dhe shquese), ose, ato që janë quajtur tradicionalisht nyja të përparme (në të gjitha gramatikat përfshirë edhe GA-në), në GP quhen mbaresa të përparme<sup>16</sup> kështu me radhë.

---

<sup>16</sup> Çeliku, në artikullin e cituar propozon edhe një term tjetër, përveç *mbaresë e përparme*, edhe *parambaresë*. Ky i fundit nuk del në GP

### Literatura e përdorur

1. Gramatika e gjuhës shqipe 1 (1976, 1995, 2002), Tiranë: ASHSH
2. Gramatika e gjuhës shqipe 2 (1983, 2002), Tiranë: ASHSH
3. M. Çeliku, M.Karapinjalli, R. Stringa, (1998) Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë,
4. Buchholz, O FiedlerW (1987), Albanische Grammatik, Leipzig
5. Agalliu, F (1968), Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore, Studime Filologjike 2 ASHSH, IGJL
6. Agalliu F. (1988), A ka një zero në gjuhën shqipe? Në Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Tiranë
7. Demiraj Sh, (1977) Rreth nyjave të përparme të shqipes vështruar edhe në përjasje me rumanishten, Gjurmime albanologjike VII, SSHF:Instituti Albanologjik
8. Çeliku M. (1984), Kategorizimi i formave të pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe (gerundi) dhe Trajtat e përcjellores në gjuhën e sotme letrare shqipe, Gjuha jonë 1 dhe 2, Tiranë: ASHSH
9. Çeliku, M (1971), Kontribut për dy probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, SF, nr. 1 , Tiranë: ASHSH, IGJL
10. Çeliku, M, (1996) Mbi disa çështje problemore të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë
11. M. Çeliku, (2001) Çështje të shqipes standarde, Tiranë
12. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, (1973), Tiranë: ASHSH
13. Fjalor i gjuhës shqipe, (2006) Tiranë: ASHSH
14. Panolli J (1992), Çështje të sistemit kohor të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, SF/1-4
15. Станчић, Ж, Поповић, Љ Мицић, С. (1998) Савремени српскохрватски језик и култура изражавања, Београд-Нови Сад
16. Topalli K. (2011). Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë





## **PËRMBAJTJA**

Sedat KUÇI, dekan i Fakultetit të Filologjisë FJALA PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E PUNIMEVE TË SEMINARIT XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE.....	7
Bardh RUGOVA, drejtor i Seminarit FJALA E HAPJES SË SEMINARIT XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE.....	9
<b>LIGJËRATA.....</b>	<b>11</b>
Rexhep ISMAJLI DISKUTIME PËR PREJARDHJEN E GJUHËS SHQIPE.....	13
Bashkim KUÇUKU DINAMIKA E IDENTITETIT SHQIPTAR NË BASHKËKOHËSI.....	45
Rrahman PAÇARIZI QASJA SOCIOKOGNITIVE NË TERMINOLOGJI – MEDIET E REJA DHE TEKNOLOGJIA.....	59
Kujtim M. SHALA SAMI FRASHËRI - AUTOR YNI.....	73
Maria MOROZOVA, Aleksandër RUSAKOV KORPUSI ELEKTRONIK I SHQIPES: PËRPUNIMI, PËRMBAJTJA DHE PËRDORIMI .....	85
Maria MOROZOVA, Aleksandër RUSAKOV PERFEKTI NË SHQIPEN E SOTME:..... STUDIMI I BAZUAR NË TEKSTET E KORPUSIT ELEKTRONIK TË SHQIPES .....	97 97

<b>TRYEZA .....</b>	<b>105</b>
Kujtim M. SHALA ORA E REXHEP ISMAJLIT .....	107
Linditë SEJDIU – RUGOVA REXHEP ISMAJLI PËR GJUHËSINË TEKSTORE .....	113
Shkumbin MUNISHI REXHEP ISMAJLI – NISMËTAR I DREJTIMEVE MODERNE LINGUISTIKE SHQIPTARE .....	117
Bardh RUGOVA NDIKIMI I SHUMËFISHTË I REXHEP ISMAJLIT NË GJUHËSINË SHQIPTARE.....	125
<b>I. GJUHËSI.....</b>	<b>129</b>
Teuta ABRASHI KONTRIBUTI I ODA BUCHHOLZ-it NË GJUHËSINË SHQIPTARE .....	131
Linditë SEJDIU - RUGOVA BRIAN JOSEPH-I PËR INFINITIVIN E SHQIPES.....	139
Ludmila BUXHELI GIUSEPPINA TURANO PËR PROCESET MORFOLOGJIKE NË SHQIPEN E SOTME.....	145
Anila ÇEPANI, Adelina ÇERPJA VËSHTRIME TË REJA PËR GRAMATIKËN E SHQIPES NË VEPRËN E AUTORËVE NEWMARK, HUBBARD DHE PRIFTI.....	151
Haki HYSENAJ IRENA SAWICKA PËR STRUKTURËN E RROKJES NË SHQIPEN E KOSOVËS.....	163
Juliana KUME GERDA ULISCH RRETH PRANISË SË GREQISHTES SË RE NË GJUHËN SHQIPE (DISERTACION I 1964-S).....	171
Bade BAJRAMI GRAMATIKAT E GJUHËS SHQIPE TË ALBANOLOGËVE FRËNGË .....	189

Bahri KOSKOVIKU SINTAGMA FOLJORE SIPAS AUTORËVE GJERMANË BUCHHOLZ-FIEDLER.....	197
Vjosa HAMITI MODALITETI DHE MUNDËSITË E SHPREHJES SË TIJ SIPAS “ALBANISCHE GRAMMATIK” TË ODA BUCHHOLZ-IT DHE WILFRIED FIEDLER-IT.....	203
Remzi PËRNASKA, Tomorr PLANGARICA KONTRIBUTI I KRISTIAN GYTIT PËR SHQIPEN DHE KULTURËN SHQIPTARE.....	211
Shkumbin MUNISHI KONTRIBUTI I JANET BYRON PËR HISTORINË E STANDARDIZIMIT TË SHQIPES.....	219
Merita HYSA SHTRESËZIME KONCEPTUALE NË “ALBANIAN PHONOLOGY” TË G.L.BEVINGTON.....	227
Julie M. KOLGJINI PËR (Ç)PENGIMIN E GJUHËS SHQIPE NË KOHËN POST-MODERNE, MARRË SHKAS NGA KONTRIBUTI I JANET BYRON-IT NË DRITËN E RISHQYRTIMIT TË STANDARDIT AKTUAL.....	237
Orjeta BAJA KRISTIAN GYT (CHRISTIAN GUT) PËR GJUHËN SHQIPE.....	255
Majlinda BREGASI KONTRIBUTI I LEONARDO MARIA SAVOIAS PËR ALBANOLOGJINË, NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XX.....	261
Linda MËNIKU KONTRIBUTI I PROF. VICTOR FRIEDMAN-IT NË STUDIMET PËR GJUHËN SHQIPE.....	269
Mensur VOKRRI VICTOR FRIEDMAN PËR HABITOREN E SHQIPES.....	285
Berton SULEJMANI PIKËPAMJET E BOZHIDAR VIDOEVSKIT PËR KONTAKTET GJUHËSORE TË MAQEDONISHTES DHE SHQIPES (NË RRAFSHIN DIALEKTOR).....	293

Naser PAJAZITI WACŁAW CIMOCHOWSKI MBI TË FOLMEN E DUSHMANIT .....	299
Xhavit BEQIRI, Bahtijar KRYEZIU E FOLMJA E SHKODRËS SIPAS DIALEKTOLOGES A. V. DESNICKAJA...	303
Asllan HAMITI SHQIPJA NË DY FJALORËT SHUMËGJUHËSH TË GJORGJI PULEVSKIT	311
Martin SUROVČÁK J. U. JARNÍK (1848–1923): THEMELUESI I ALBANOLOGJISË ÇEKE .....	325
Anton PANÇEV PROF. PETJA ASENOVA DHE GJUHËSIA SHQIPTARE .....	331
Matilda PARLLAKU (ÇOLLAKU) KONTRIBUTI I M. LAMBERTZ PËR TRAJTIMIN E RAPORTEVE KUSHTORE NË GJUHËN SHQIPE.....	337
Erzen KOPERAJ VENDI I SHQIPES NË VEPRËN E V. PISANIT.....	347
Ragip GJOSHI NDIHMEA E ALBANOLOGUT RUMUN GRIGORE BRËNKUSHI FILOLOGJISË SHQIPTARE .....	355
Shpëtim ELEZI ERIC P. HAMP-I PËR ORIGJINËN DHE VENDIN E SHQIPES .....	371
Ismet OSMANI PIKËPAMJET E BLLAZHE KONESKIT PËR GJUHËN SHQIPE NË KONTEKST BALLKANIK.....	379
Eliana PACO MENDIMI I DREJTË I H. KRAHES MBI TOPONIMET SI VIJUSHMËRIA E NJË POPULLI.....	385
Elda RESMJA MOLLA NDIHMEA E A.CIRRINCIONES PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE.....	393
Flutura ÇITAKU GRAMATIKA PRAKTIKE NË PËRQASJE ME GRAMATIKËN E AKADEMISË (ME THEKS TË VAÇANTË NË TERMINOLOGJI.....	397

**Sponsorë:**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës  
Rektorati i Universitetit të Prishtinës

Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

32/1

**Botues:** Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

**Tirazhi:** 300

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

008(=18)(496.51)(063)”2013”

811.18(496.51)(063)”2013”

821.18(496.51)(063)”2013”

Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare : Prishtinë, 19-30.08.2013 / [ Kryeredaktor Bardh Rugova]. – Prishtinë : Universiteti i Prishtinës : Fakulteti i Filologjisë ; Tiranë : Universiteti i Tiranës : Fakulteti Histori-Filologji, 2014. – 2 libra ; 24 cm.

[Libri] 1. – 412 f.

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

1.Rugova, Bardh

**ISBN 978-9951-00-163-2**

**ISBN 978-9951-00-164-9**